MUJORI

Përzgjedhje

V

Korrik - Gusht

Përktheu
Atë Justin Anthimiadhi

Botim i Manastirit të Hirshëm të Paraklitit
(Ngushëllimtarit)
Oropos-Atikë, Greqi, 2017

Titujt e origjinalëve: “Μηναῖον Ἰουλίου”
“Μηναῖον Αὐγούστου”

Dhuratë për vëllezërit tanë të dashur klerikë dhe psaltë
të Kishës së Shqipërisë

© Manastiri i Hirshëm i Paraklitit, Oropos-Atikë, Greqi

Duhet të kihen gjithmonë parasysh Udhëzimet në fillimin e volumit të parë, si p.sh. se “Në Leximet biblike të Dhiatës së Vjetër ***mbajmë qëllimisht, me vetëdije gabimet letrare*** *që ajo ka”.*

O shenjtorë të Perëndisë, ndërmjetoni për ata që bashkëpunuan me shpirt dhe u lodhën për himnimin tuaj.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Lejohet kopjimi i citimeve biblike, por të referohet burimi.
Ἐπιτρέπεται ἡ ἀντιγραφή τῶν βιβλικῶν παραπομπῶν μέ μόνη τήν ἀναφορά τῆς πηγῆς.
Copyrighting of biblical quotes are permitted; it is necessary only to reference the source.
Разрешается выписка библейских цитирований; необходимо сделать ссылку на источник.

MUAJI KORRIK

QË KA 31 DITË

1 KORRIK

Kujtimi i anargjendëve të shenjtë e çudibërës Kozma dhe Damian, që u martirizuan në Romë.

Tipikon

1. Nëse bie të premten pas Pentikostisë:

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit, Thirrtoret: 6 të Mujorit. Lavdi i Mujorit. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Pasvargjet e Mujorit. Lavdi i tij. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtorëve dhe përsëri e së kremtes.*

Në shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtorëve, por Tani i së kremtes. Trishenjti. Përlëshore e shenjtorëve. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtorëve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Kanunet: i dyti i së kremtes dhe i shenjtorëve. Pas Odes III, Ndenjësoret: e shenjtorëve dhe, në vend të Hyjlindësores, e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtorëve dhe Sinaksari. Zbritësoret e së kremtes (vetëm e Ting. IV Mjegull' e mbuloj). Më të nderuarën. *Dërgimësoret e shenjtorëve dhe të së kremtes. Lavdërimet e shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e shenjtorëve.*

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtorëve dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve. Të meriton. *Kungatore* Në kujtim të përjetshëm. Pamë dritën.

2. Nëse bie të shtunën e Mbylljes së Pentikostisë:

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit, Thirrtoret: 6 të së kremtes dhe 4 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtorëve dhe përsëri e së kremtes.*

Në shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Litia e shenjtorëve, por Tani i së kremtes. Trishenjti. Përlëshore e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e shenjtorëve dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të së kremtes. Kanunet: të dy të së kremtes dhe i shenjtorëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Ndenjësorja e shenjtorëve dhe e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtorëve dhe Sinaksari. Zbritësoret dublikate të së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, *Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: e para e së kremtes, e shenjtorëve dhe e dyta e së kremtes. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani i së kremtes. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.*

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e shenjtorëve dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i shenjtorëve. Në vend të Të meriton, *Irmosi i Odes IX të së kremtes (të Ting. IV* Mjegull' e mbuloj*). Kungatore e së kremtes [dhe* Në kujtim të përjetshëm]. Pamë dritën.

3. Nëse bie të Dielën e Gjithë Shenjtorëve:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Shenjtorëve dhe 3 të anargjendëve. Lavdi i Shenjtorëve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Leximet e Shenjtorëve. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i anargjendëve. Tani Hyjlindësore ngjallësore* (Zoti Krisht bërësi). *Përlëshoret: ngjallësore, e Shenjtorëve, e anargjendëve dhe Hyjlindësore ngjallësore* (Ti që linde për ne).

Në shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e Shenjtorëve dhe e anargjendëve tok me Lavdinë e tyre si Idhiomel i thjeshtë (pa Hyjlindësoren

e tyre). Lavdi si dhe Tani i Shenjtorëve. Himne Triadike. Trishenjti dhe Përlëshorja e Shenjtorëve. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pentikostarit, por në Tani të Stihologjisë së parë, Hyjlindësorja e Stihologjisë së dytë: Më ty gëzohet*; ndërsa në Tani të Stihologjisë së dytë, Hyjlindësorja e Stihologjisë së parë të anargjendëve:* Ty të shpall si të lum. *Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, i Shenjtorëve dhe i anargjendëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e anargjendëve. Ndenjësoret: e Shenjtorëve dhe të anargjendëve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Shenjtorëve. Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret* Ja gojën e çel tani; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore, e Shenjtorëve dhe të anargjendëve. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Shenjtorëve dhe 3 të anargjendëve. Lavdi Eothinoni (I). Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit, 4 nga Ode III e Shenjtorëve dhe 4 nga Ode VI e anargjendëve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Shenjtorëve, e anargjendëve dhe e kishës. Kontaqi i Shenjtorëve (kërkoje para Shtëpisë së tyre). Apostulli i anargjendëve. Ungjilli i Shenjtorëve. Të meriton. *Kungatore e Shenjtorëve.*

4. Nëse bie në një nga të dielat jashtë Pentikostarit:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të shenjtorëve. Lavdi i shenjtorëve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtorëve. Tani Hyjlindësore ngjallësore* (Zoti Krisht bërësi). *Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtorëve dhe Hyjlindësore ngjallësore* (Ti që linde për ne).

Në shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e shenjtorëve. Himne Triadike. Trishenjti dhe Përlëshorja e shenjtorëve. Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i shenjtorëve. Pas Odes III, Kontaqi, Shtëpia dhe Ndenjësoret e shenjtorëve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore dhe të shenjtorëve. Lavdërimet 4 ngjallësore dhe 4 të shenjtorëve. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të shenjtorëve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtorëve dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Apostulli i shenjtorëve dhe Ungjilli i së dielës.* Të meriton. *Kungatore [*Lavdëroni *dhe]* Në kujtim të përjetshëm.

NË MBRËMËSORE

Thirrtore
Ting. Tërth. II Olin apothémeni

Derisa në qiej lart* depozituan çdo shpresë,*[1] me thesar që s'vidhet dot,* pasuruan veten shenjtorët plot lavdi.*[2] Falas morën këta,* edhe falas japin* terapi te të sëmurët;[3] nuk fituan as argjend,* as ar, siç Ungjilli e thotë qart'.*[4] Te kafshët dhe te njerëzit* transmetuan mjaft mirëbërje pra,* që të bëhen bindës të Krishtit në çdo gjë, ndaj me guxim* të ndërmjetojnë për ne gjithnjë,* të shpëtohen shpirtrat tan'.

(2x)

Plot hir çift vëllazëror* bashkëbanues, me një shpirt,* me një mendje, sjellje krejt,* domethënë shenjtët, e neveritën fort* çdo gjë, lëndë mbi dhé,* ngaqë prishet, u bën'* porsi engjëj,[5] qytetarë qiejsh,[6] edhe pse me mish.* Japin terapi te sa vuajnë,* prandaj dhe mirëbërjen pra* falas nevojtarëve u dhurojn'.* Ne le t'i himnojmë në festa të përvitshme denjësisht,* se ndërmjetojnë me mjaft guxim,* të shpëtohen shpirtrat tan'.

(2x)

Dyshja e dëgjuar fort,* Damiani edhe Kozmai,* si hyjmendës morën pra* brenda tyre bashkë të dy Trininë Shenjt* si banore,[7] kështu* na burojnë kroje,* rrjedha terapish nga një gufim jetik. Shëron edhe* prekja e lipsaneve çdo pësim.*[8] Sëmundjet e të vdekshmëve* i dëbojnë emrat e tyre larg.*[9] Janë shpëtimtarë në Krishtin për të gjithë që u vijn',* dhe ndërmjetojnë me mjaft guxim,* të shpëtohen shpirtrat tan'.

(2x)

Lavdi

Ting. Tërth. II I Anatoliut

Hiri që shenjtorët morën nga Krishti është pa mbarim, prandaj dhe lipsanet e tyre veprojnë gjithmonë nga fuqia e hyjshme[8] përmes çudish; edhe vetëm emrat e tyre, kur thërriten me besë,

çlirojnë nga dhembje të pashërueshme.[9] Me anën e tyre, o Zot, na çliro edhe ne nga pësimet e shpirtit dhe të trupit, si njeridashës.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se Biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit[10] pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier; atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës dhe Lexime

Këndimi i profecisë së Isaias
(43.9-14)

Këto thotë Zoti: "Gjithë kombet u mblodhën së bashku dhe do të mblidhen arkondë nga ato. Kush do t'i njoftojë këto? Ose *gjërat* që nga fillimi kush do t'ju njoftojë? Le t'i sjellin dëshmitarët e tyre, dhe le të drejtohen, dhe le të dëgjojnë, dhe le të thonë të vërteta. Bëhuni dëshmitarët e mi dhe unë dëshmitar", thotë Zoti, Perëndia, "dhe fëmija im që zgjodha; që të njihni dhe të besoni, dhe të kuptoni se unë jam. Përpara meje nuk u bë Perëndi tjetër dhe pas meje nuk do të jetë. Unë Perëndia dhe, veç meje, nuk është ndonjë që shpëton. Unë lajmërova dhe shpëtova, talla dhe nuk ishte në mes jush i huaj. Ju, dëshmitarë për mua dhe unë, Zoti Perëndia, ende nga fillimi dhe nuk ka njeri që të shpëtojë nga duart e mia. Do të bëj, dhe kush do ta kthejë mbrapsht këtë?". Kështu thotë Zoti, Perëndia, që ju çliron, i Shenjti i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve *janë* në dorë Perëndie dhe nuk do t'i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën, dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre, dhe ecja nga ne dërrmim, por ata janë në paqe; sepse, edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre *është* plot pavdekësi; dhe, pasi do të edukohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do

të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojë në ta Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të, do të kuptojnë të vërtetën, dhe besimtarët me dashuri dhe durim do të qëndrojnë pranë tij, sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë dhe në Zot *është* paga e tyre, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë prej dore Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë si armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë Krijesën për mbrojtje armiqsh. Do të veshë *si* koracë drejtësi, dhe do të veshë *si* helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë *si* mburojë të pamposhtur oshënarí dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me të bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm te qëllimi predha rrufesh dhe, si nga një hark i plotë rrethi, nga retë do të hidhen në shenjë, dhe nga zemërimi që hedh gurë, do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmbytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligësi, dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur; mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinastí nga i Shumëlarti.

Në Liti Idhiomele
Ting. II

Burimi i shërimeve mjekonte vetëm një çdo vit.[11] Tenda e anargjendëve mjekon gjithë turmën e të sëmurëve, sepse pasuria e shenjtorëve është pa mbarim dhe nuk i nevojitet asgjë. O Krisht, me lutjet e tyre mëshirona.

I njëjti I Theofanit

Pasi vepruat praktikisht me aspiratë të zjarrtë e të hyjnueshme dhe me dashuri për të ardhshmet, përshkuat udhët shpëtimtare; prandaj e ruajtët të panjollshme pastërtinë e shpirtit dhe u larguat krejtësisht nga materialet; dhe, meqenëse u veshët me ar, pra me Shpirtin Hyjnor, u jepni të sëmurëve kurime pa ar, o çift i shenjtë,

vëllezër ndriçues, dyshe e shkëlqyer dhe e hyjshme, anargjendë, që na vizitoni ne në pikëllime dhe sëmundje, dhe shëroni pa argjend sëmundjet e shpirtrave tanë.

I njëjti I Gjermanoit

O të tërëfamshëm, megjithëse u denjësuat për dhurata të mëdha, vepruat mbi dhé me përulësi jete dhe, duke kaluar gjithkund, shëronit falas pësimet e të sëmurëve dhe u dukët shokë engjëjsh,[5] o Kozma së bashku me Damianin e urtë, o vëllezër ngazëllues; mjekojini me lutjet tuaja edhe pësimet tona.

I njëjti I të njëjtit

Ngazëllohet kori i shenjtorëve përjetë, sepse trashëguan mbretëri qiejsh.[12] Toka, kur pranoi lipsanet e tyre, lëshoi aromë. U bënë shërbëtorë të Krishtit, duke fushuar në jetën e amshuar.

I njëjti

O mjekë të të sëmurëve, thesare të shërimeve, shpëtimtarë të besnikëve, anargjendë të tërëlavdishëm, ata që bërtasin në nevoja dhe vuajnë, shërojini duke i lypur Perëndisë së mirë,[13] që të na çlirojë edhe ne nga kurthet e armikut.

Lavdi

Ting. Tërth. II I Andrea Pirit

Lindi sot i hyjshëm dhe i ndritshëm kujtimi i anargjendëve të Krishtit, duke feksur shkëlqyeshëm me rrezet e çudive. Ejani, pra, o kremtimdashës, le të bëjmë panair besërisht; ejani të rendim të gjithë me zell te lipsanet e shenjtorëve, që të marrim me bollëk prej tyre kurimin e shpejtë, sepse na japin të gjithëve pa argjend karizmat e shërimeve me anën e energjisë së Shpirtit të Shenjtë.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[14] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me anargjendët dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Pasvargje

Ting. I Ton uranion tagmaton

Kujtimin e anargjendëve ta kremtojmë pra,* të mblidhemi të gjithë* me ndërgjegje dhe zemër* krejt të paster,[15] t'u thërrasim tok ne:* Ki gaz dyshe, shërimi je* për të sëmurët, meqë morët prej Hyjnis'* ju pushtetin e shërimeve.[3]

Varg: Te shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

Kur porositë e Zotit mirë i ruajtët,* sëmundjen, argjendashjen,* urtësisht e ndërpretë,* ndaj shëroni pa para; pra nderojm'* fjetjen tuaj me plot respekt,* detyrimisht, çudibërës me dhembshuri;* lypni fort, që të shpëtojmë ne.

Varg: Ja pra, ç'është e mirë a ngazëlluese sesa të banojnë së bashku vëllezër?

Meqë nga Zoti i vetëm guximin morët pra,* hyjprurës anargjendë,* të shëroni, shpëtoni* nga çdo lloj rreziku me përdëllim* prej shtrëngimeve, ngasjeve* edhe pësimeve që shpirti, trupi ka,* na çlironi ne që ju himnojm'.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Duke pasur gjithmonë Krishtin si veprues brenda jush, o anargjendë të shenjtë, bëni çudi në botë, duke shëruar të sëmurë,[3] sepse dhe klinika juaj është burim i pasosur; sa më shumë marrim prej tij,[16] aq më shumë gufon dhe, kur derdhet, tepron; çdo ditë boshatiset dhe shumëfishohet duke u dhënë të gjithëve pa shteruar; dhe ata që nxjerrin prej tij, nginjen me terapi, dhe i pasosur mbetet ai; pra, si t'ju quajmë? Doktorë, mjekë shpirtrash dhe trupash, shërues pësimesh të pashërueshme, që i shëroni të gjithë falas, që keni marrë dhunti prej Krishtit Shpëtimtar, i cili na jep përdëllimin e madh.[16a]

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[14] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me anargjendët dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Përlëshore
Ting. Tërth. IV

O anargjendë të shenjtë dhe çudibërës, vizitojini sëmundjet tona; falas morët, falas jepnani.[3]

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Keni marrë prej Krishtit çuditërisht,* që nga qiejt lart, si një dhurim[3] të madh,* kurime, shëroni ju* çdo sëmundje përherë pra;* në ju ësht' shfaqur Hiri i Shpirtit, vepron kështu* duke dhuruar forc' terapish të hyjnueshme;*[17] ndaj edhe fituat përmes besës shumicë* të mirash që s'shprishen dot* me shpirt pa argjendashje pra,* anargjendë* hyjmbajtës shenjt';* ndërmjetoni te Zoti Krisht,*

të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tuaj të shenjt' me mall.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të shpall si të lum çdo brez njerëzor,*[18] si të vetmen që linde ti Perëndi* në mish pafarisht, edhe* si të virgjër, sepse në ty* Hyjnia e përzjarrtë fushoi, dhe mënd si foshnj'* Ndërtuesin dhe Zotin; gjinia e engjëjve,* gjithë njerëzia tok lëvdojn' lindjen tënde* të fortshenjtë denjësisht* dhe me një zë thërrasin pra* duke lypur* për ndërmjetim:* Lutju Zotit Krisht Perëndi,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve,* se i falemi lindjes sate pa cen me bes'.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV Epefanis símeron

Të festojmë plot me hir* për anargjendët,* o besnikë, panair,* t'i përgjërojmë fort ata* që nga sëmundje të llojllojshme* trupore dhe shpirtërore të na shpëtojn'.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Mbrojtje që s'luftohet je* për nevojtarët,* ndërmjetim i gatshëm pra* për sa besim kanë te ti;* prej çdo rreziku çliromë shpejt,* mos më shpërfill, se je ndihmë për gjithë ne.

Psalmi 50. Kanunet: i Hyjlindëses dhe i shenjtorëve.

Ode I
Kanuni i Hyjlindëses
Ting. Tërth. IV
Irmosi: Igrán dhiodhefsas

»Pasi kish kaluar det si steré* edhe »u shpëtua nga inati egjiptian,* me »zë Izraeli po thërriste:* Le t'i kë»ndojm'[19] Perëndis', Çlirimtarit Zot.

Imbytur prej ngasjeve si në det,* më ty po përikij dhe prej teje kërkoj shpëtim,* o nënë dhe Zonjë Virgjëreshë,* prej çdo rreziku dhe zie shpëtomë ti.*

Pësimet më mbushën me turbullim* dhe shpirtin ma mbytën me mërzitje dhe dëshpërim,* po ti qetësomë, Virgjëreshë,* me ngushëllimin dhe paqen e Birit tënd.*

Të lutem o Zonjë, o Shën Mari,* që linde Jisuin, ti shpëtomë nga çdo rrezik,* më ty po përikij dhe të lutem,* me tërë forcën e zemrës dhe shpirtit tim.*

Se shpirti dhe trupi keq m'u sëmur,* pra ti mëshiromë, edhe syrin mbi mua hidh,* kujdesu për mua Virgjëreshë,* e mirë vetë dhe nën' e të mirit Bir.*

Kanuni i shenjtorëve që ka Akrostihidhë: "Duhet t'i këndojmë mjekët e lavdëruar të njerëzve. Josif".
Ting. Tërth. II
Os en ipiro pezefsas

O anargjendë të ndritshëm, shkëlqeni fort* me lavdi të hyjshme krejt,* ndaj na feksni shpirtrat tan'* dhe shpërndani mjegullën* e veseve tona, që t'ju lavdërojmë besërisht.

Si u pastruat më parë nga çdo pasion* prishës me mundim të madh,* na pastroni, o të urt,'* nga sëmundjet me mjaft tmerr,* dhe dhimbjet e shpirtrave na lehtësoni mirësisht.

Meqë nga Zoti i çdo gjëje[20] morët ju,* o shenjtorë, falas krejt* dhurëti çudish me hir,* na shëroni,[3] lutemi,* pësimet e shumta, të vështira për shërim në mish.

Hyjlindësore

O e dëlirë, lind pa ligjin natyror* ti ligjdhënësin Jisu,* Çlirimtarin; lyp atë,* Zonjë dhe Hyjlindëse,* që të na shpëtojë nga mëkatet tona të shumta.

Zbritësore: Anikso to stoma mu

»Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej »Shpirtit[21] Shenjt* dhe këngë do t'i »këndoj nënës së madhe mbi fron;*[22] »dhe do ta kremtoj* me valle buzë»qeshur,* me zë do t'i shpall kudo »gjithë çudit' e saj.*

Ode III
Kanuni i Hyjlindëses
Irmosi: Uranias apsidhos

»Perëndi që apsidë bëre në q'ell si »çati,*[23] ti që je ndërtues i Kishës,[24] »mirë më siguro* në dashurinë që ke; »je maja e çdo dëshire,* njeridashës, »edhe mbështetja për çdo besnik.

Si përkrahje dhe mbrojtje të jetës sime të kam,* ty, o Virgjëresh' e kulluar, ti pra më qeveris* dhe në liman të më çosh, se ti na fal çdo të mirë,* ti besnikët përgjithmon' i mbron, Hyjlindëse.*

Po të lutem, o Zonjë, ma qetëso shpirtin tim* dhe pushoma shqotën e zemrës, se më bie zali,* se ti o Zonjë Mari, ke lindur Mbretin e Paqes,*[25] Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Mirëbërësin[26] linde, që bëri çdo mirësi,* pasurisht të gjitha të mirat jepna të gjithëve,* se ti në dorë e ke,[27] se ti ke lindur të fortin,* Shpëtimtarin, Zotin Krisht, ti o Hyjlindëse.*

Me sëmundje të liga dhe çfarëdo pasion,* dergjem un' i mjeri, o Zonjë, eja shëromë ti,* se s'të mungon asnjë

gjë, i ke të gjitha të mirat,* je thesar për çdo shërim, ti o Hyjlindëse.*

Kanuni i shenjtorëve:
Uq estin ájios os si

Shenjtorë, bota po këndon* për çuditë e shumta,* mirëbërjet e tëra që çdo ditë kryeni,* të barabartë vërtet* ju me engjëjt,[5] çudibërës mjekë pra.

Ju përgjërohemi, Kozma* dhe Damian, që jeni* të dy yjet e ndritshme[28] mistikisht në lartësin'* e Kishës sonë që feks,* na shkëlqeni zemrat krejt të gjithëve.

Ja, o shenjtorë, ku u mblodh* nga tërë vendet populli,* të himnojë dhuratat e mëdha, bamirësit'* në kishën tuaj, dhe ju* plotësoni lutjet e të gjithëve.

Hyjlindësore

Me fjalë, Zonjë e dëlir',* që trupëzove Fjalën* e mbishenjtë, çliromë nga pasionet pa logjik';* të përhimnoj, e pacen,* besërisht me fjalë të hyjnueshme.

Zbritësore: Tus sus imnologus

»O Zonjë dhe nën' e Perëndisë, bu»rim i pasosur jetësor,* ti siguroji »gjith' ata që të këndojnë plot me »zell;* dhe lart në q'ell ku mbretëron »kurorëzoji me çdo lavdi.*

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Te të gjithë u shfaqët si flakërim,* llambë dhe çudibërës dhurues, drit',* shërime me mrekulli* dhe me Hirin e Shenjtit Shpirt,* sepse freskoni flakë pësimi me besë drejt,* me të mjekoni mentalitet shpresëplotësh pra;* ndaj, meqë e keni kishën tuaj të hyjshme* klinikë për shpirtin ton',* drejt kësaj po përikim ne,* anargjendë* hyjprurës ju;* ndërmjetoni te Zoti Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tuaj të shenjt' me mall.

Hyjlindësore

Pasi rashë në ngasje të ndryshme keq* prej armiqve që duken a s'duken pra,* shtrëngohem në turbullim* prej mëkateve pa kufi;* meqë të kam përkrahje dhe strehë, o e pacen,* te mirësia jote vrapoj mu si në liman,* ndaj, e Tërëshenjtë, lyp atë, që prej teje* pa farë ka marrë mish,* për shërbyesit që ti ke* dhe pareshtur* të psalin ty;* ndërmjeto, dhe lutju gjithnjë* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve,* se i falemi lindjes sate me plot besim.

Ode IV
Kanuni i Hyjlindëses
Irmosi: Isakíkoa Kírie
tis ikonomias su

»Kam dëgjuar misterin qart'* të »ekonomis' sate dhe kuptova krejt* »veprat që ke bërë[29] dhe prandaj* »lavdërova un' hyjninë tënde, Zot.*

Shën Mari, o Hyjlindëse,* ti që linde Zotin, kapitenin ton',* zbute shqotën e pësimeve,* qetësoji valët e mëkateve.*

Ne të gjithë të lutemi,* dhembshurinë tënde tregona pa vones',* ti që linde njeridashësin,* Krishtin Shpëtimtarin e besnikëve.*

Për shumicën e dhuratave,* të falënderojmë ne mirënjohësit,* me këndime lavdëruese,* nënë virgjëreshë dhe Hyjlindëse.*

Ty të kemi përkrahëse* dhe fortesë të patundur dhe mbrojtëse,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* na shpëto përherë prej rreziqeve.*

O Hyjlindëse, e vetmja e virgjër gjithmonë, si mirëdashëse ndihmomë mua që dergjem në shtratin e dhimbjes dhe të sëmundjes[30] sime.

Kanuni i shenjtorëve:
Hristós mu dhínamis

Le t'i mburrim anargjendët e urtë, degët e hyjshme me fruta vërtet të mira të hardhisë hyjnore,[31] të cilat pikojnë verën mistike me ngazëllim.[32]

U dukët si shpatë, duke plagosur rëndë keqdashës të padukshëm; çlironani dhe ne nga shigjetat e tyre, duke u kujdesur për jetën tonë, o anargjendë të urtë.

S'ka njeri që nuk ju ka ndërmjetës të mirë drejt Krishtit, o anargjendë të shenjtë; atij përgjërojuni që të çlirohem nga zjarri i amshuar.[33]

Hyjlindësore

Pasi fushoi Zoti brenda teje, o e dëlirë, e tregon tendën e shenjtë burim shërimesh të shumta dhe pastrim pasionesh, o Perëndilindëse gjithmonë e virgjër.

Zbritësore: Tin aneksihníaston

»Të pagjurmësuarin plan perëndor,* »që po mishërohet i larti Zot* prej »Virgjëreshës,* Abakumi si profet e »pa dhe tha me zë të madh:* O Zot i »fuqishëm, lavdi më ty.*

Ode V
Kanuni i Hyjlindëses
Irmosi: Fótison imás

»Ndritna ti, o Zot,* përmes urdhrave »të tu[34] pra ne,* si dhe me krahun tënd »fuqiplot, të lart',*[35] o njeridashës, »na jep paqen tënde[36] përgjithnjë.

Zemrën na e çel* me gëzim dhe ngazëllim, o Zonj',* falna gazin e pasosur tani,* sepse ke lindur ti shkaktarin e gëzimeve.*

Zonjë na shpëto,* Virgjëreshë dhe Hyjlindëse,* prej helmeve si dhe rreziqeve,* se ti ke lindur[37] Shpëtimtarin, paqeprurësin.[38]*

Mjegullën largo* të mëkateve, Hyjlindëse,* me dritën tënde jetëdhënëse,* sepse ke lindur diellin e parajetëshëm.*

Zonjë na shëro,* nga pësimet e sëmundjeve,* na mëshiro edhe na vizito,* edhe shëndetin na dhuro me ndërmjetimin tënd.*

Kanuni i shenjtorëve:
To thio fegji su agathé

Meqenëse dëshiruan me gjithë zemër burimin e llamburitjeve, emërmëdhenjtë tërhoqën ndriçimin hyjnor dhe na shkëlqejnë çdo herë me pishtarë mrekullish.

Duke qenë çift i bukur, o të urtë, punoni brazda shpirtrash me çudi përherë, duke prerë pasionet si barëra të egra dhe duke shumëfishuar njëqindfish kallirin[39] e shëndoshjes.

Duke u forcuar me fuqinë e Krishtit, shkatërruat tërë fuqinë e të fortit në të keqen; na çlironi nga tirania e tij, o anargjendë, mbrojtësit tanë të pafjetur.

Hyjlindësore

O Zonjë e mirë, çliromë nga ngasjet e armikut, nga tortura e Gjehenës dhe nga robëria që më shtrëngon, dhe mos më turpëro mua që po të himnoj.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

»Të gjith' i habite ti me një çudi dhe »një lavdi,* ti, o Virgjëresh' e pamar»tuar;* Zotin e jetës që mbretëron lart »në q'ell[40] si një bir e mbajte në pëqi,* »dhe shpëtim që lartazi* u dhurove »besnikëve.*

Ode VI
Kanuni i Hyjlindëses
Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»Do derdh lutjen* para Zotit Perë»ndi,* dhe atij do t'ia tregoj hidhë»rimet* që kam,[41] sepse* shpirti im »është mbushur* me çdo të keqe, dhe »jeta po shkon në Hadh;*[42] pra si Jo»nai lutem un':* Jetën time nga prish»ja, ti ngrije,[43] Zot.

Atij iu lut,* se prej vdekjes na shpëtoj,* si u dha nën thonjt' e vdekjes dhe vetë,* prapë tani* shpirtin tim ta shpëtojë* nga shkatërrimi i vdekjes dërrmonjëse* dhe nga armiku zemërlig,* Biri yt, Zoti yt, o Hyjlindëse.*

Si mbrojtëse* ty të di dhe rojtëse,* të sigurt, o Virgjëreshë, për jetën;* ti i shpërndan* gjithë ngasjet e liga,* edhe veprime demonësh na i dëbon,* pra ty të lutem si gjithnjë:* Ti shpëtomë prej gjithë pësimeve.*

Fortes' e mur* ty të kemi, Zonja jon',* dhe shpëtim për shpirtrat tanë të plotë,* dhe ngushëllim* në mjerimet,[44] o Zonjë,* dhe n'errësirën me dritë na ngazëllon;*[45] pra ti, o Zonjë, dhe tani,* nga pësimet, rreziqet ti na shpëto.*

Në shtrat tani* i sëmurë shtrirë jam,* dhe për trupin tim shërim dot nuk gjendet;*[46] vetëm pra ti,* që ke lindur për botën* një Shpëtimtar dhe një mjek të sëmundjeve,* pra ty të lutem dhe tani:* Ti më ngri nga lëngatat, Hyjlindëse.*

Kanuni i shenjtorëve:
Tu viu tin thálasan

Banoni në qiell lart,* anargjendë, me gëzim;* në kishën tuaj që ka nder* shpejt arrini, nxitoni, dhe flakni tej* sëmundjet e trupit ton'* dhe pasionet e zemrave, ju lutemi.

Si veshët me bukuri* hijeshin' e hyjshme ju,* shenjtorë, si me petk, tani* prej pasionesh çnderimi na zhvishni ne;* meqë jemi lakuriq* pa virtyt, na stolisni perëndishëm pra.

U shfaqët shpëtuesit* për planetin, me çudi* si me stoli të veshur ju;* ndaj, shenjtorë, çlironani ne të gjith'* prej dëmit që bota sjell,* prej pasionesh çnderimi dhe dënimi pra.

Hyjlindësore

Jisui, pa djegur hiç* mitrën tënde, ndonëse* zjarr është, del nga ti në mish;* përgjëroju atij, e Dëlira ti,* nga zjarri dhe çdo dënim* të çlirohen sa besërisht të përhimnojn'.

Zbritësore: Tin thian taftin

»Këtë të kremte e lusim sot, për »Zonjën edhe nënën Hyjlindëse, gji»thë hyjmendësit,* eni trokisni pra »duartë*[46a] dhe lavdëroni Zotin që »lindi prej asaj.*

Kontaqi
Ting. II

Ju që keni marrë hirin e terapive,[17] shtrijeni fuqinë tek ata që janë në nevojë, o doktorë çudibërës të lavdi-

shëm; dhe me vizitën tuaj mposhtini arrogancat e armiqve, meqë shëroni botën me çuditë.

Shtëpia

Fjala e mjekëve të urtë është përmbi çdo mençuri dhe urtësi, dhe u jep dije të gjithëve; sepse, pasi morën Hirin e të Tërëlartit, u dhurojnë të gjithëve padukurisht shërimin; prandaj edhe mua më kanë dhuruar hir rrëfimi, që t'i himnoj si hyjmbajtës, të pëlqyer nga Perëndia dhe shërues, që japin me mbushulli terapi, se i çlirojnë të gjithë nga dhimbja, meqë shërojnë botën me çuditë.

Sinaksari

Muaji korrik, që ka 31 ditë. Dita ka 14 orë dhe nata 10 orë.

Më 1 të të njëjtit muaj, kujtimi i anargjendëve të shenjtë e çudibërës Kozma dhe Damian, që mbaruan në Romë.
Vargje: Gurët, kur hidheshin, nuk çanin vëllezërit,/ se ishin të dy të fiksuar në një gur.[47]
Në të parën e korrikut, anargjendët garonin përmes gurëve.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Vasili, i cili themeloi Manastirin e Vatheos Ríakos, d.m.th. e Rrëkesë së Thellë.
Vargje: Vasil, u duke vërtet se mbretërove/ mbi pasionet e palogjikshme.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënar Petros, i cili u bë patric, dhe ndodhet në vendet e Evandhrit.
Vargje: Kur vdiq, Petroja kungoi lavdi qielli,/ pasi la lavdinë e tokës dhe të pëlqyeshmet e saj.

Oshënar Leon eremiti, i cili, pasi jetoi i zhveshur, mbaron në paqe.
Vargje: Përderisa Leon eremiti, para se të vdiste në mish, nuk iu bind Evës,/ si Adami i parë, nuk i vinte turp që ishte lakuriq.[48]

Dy Mijë Martirët e shenjtë mbarojnë me shpatë.
Vargje: Një shpatë godet dy mijë burra,/ atletë të nderuar që e kishin larg frikën.

Martiri i shenjtë Mavriki, pasi u lye me mjaltë, mbaron duke u pickuar nga bletët.
Vargje: Mavrikiu, pasi u krezmua me mjaltë,/ konsideron pickimet e bletëve si mjaltë të ëmbël.

Të Njëzet e pesë Martirët e Shenjtë në Nikomedi, mbarojnë me zjarr.
Vargje: Numri i burrave të djegur është rrethi,/ se dukshëm pesë herë pesë është rrethi.

Martiri i shenjtë Konstandin dhe ata që ishin me të mbarojnë me shpatë.

Vargje: Ndonëse goditesh me shpatë, o Konstandin,/ edhe pse i vdekur, godet ti armikun e Zotit.

Në të njëjtën ditë, transferimi i lipsanit të shenjtë të oshënar Joanit në Rila.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Kanuni i Hyjlindëses
Irmosi: I ek tis Iudheas

»Tre Djem që nga Judea* përfunduan
»si robër dikur në Babiloni,* me besën
»e Triadhës kan' shkelur flakë furre,[49]
»duke psalur me gaz e hir:* O Perëndi
»atëror,* o Zot, je i bekuar.[50]

Për shpëtimin e botës,* në pëqi virgjëror ke banuar ti, o Jisu;* dhe nënën Virgjëreshë, e cila të ka lindur, na e bëre ne mbrojtëse.* O Perëndi i etërve,* o Zot, je i bekuar.[50]*

Birit plot me mëshirë,* që ke lindur, o nën' e kulluar, lutju për ne,* të na i ndjejë fajet dhe njollat shpirtërore, se thërresim me zë të madh:* O Perëndi i etërve,* o Zot, je i bekuar.[50]*

Thesarin e shpëtimit*[51] dhe burimin e paprishjes ty, Hyjlindësen pra,* kështjellën e përikjes dhe derën e pendimit ua shfaqe besnikëve.* O Perëndi i etërve,* o Zot, je i bekuar.[50]*

Sa po vijnë me shum' mall* edhe nën hijen tënde të gjith'sigurtë, o Zonj',* denjo që të shërohen si shpirtrat e sëmurë k'shtu dhe trupat në vuajtje,* se Krishtin ton' shpëtimtar,* për ne ti e ke lindur.*

Kanuni i shenjtorëve:
Dhrosovolon men tin káminon

Me arritjet në të mirat, i dhatë krahë mendjes drejt qielloreve dhe, pasi u bëtë pjesëmarrës në dhurata hyjnore, duke qenë shqiponja me flatra, përshkoni mbarë dheun duke bërë çudira përgjithmonë.

Meqë shkëlqyet si ar i pastër, o anargjendë, me anën e Hirit hyjnor, u pasuruat së tepërmi me hirin e terapive; prandaj t'ju vijë keq për ne që dimërojmë në dallgë ngasjesh dërrmuese.

Duke ia dorëzuar Zotit të pastër shpirtrat tuaj,[52] o anargjendë, pranuat prej tij hir të dëboni përherë shpirtrat e papastër; na çlironi të gjithë ne nga ligësia e tyre e hidhur.

Fjetët denjësisht gjumin e të drejtëve, o anargjendë të urtë, dhe jeni ndërmjetuesit e pafjetur të besëmirëve; prandaj vërini në gjumë përherë pasionet e tmerrshme të shpirtrave dhe trupave tanë.

Hyjlindësore

O e Tërëpaqortueshme, mos pusho së përgjëruari Perëndinë njeridashës, që të marrim faljen absolute të të këqijave dhe të arrijmë të mirat që u bënë gati në qiej[12] për ata që e duan.

Zbritësore: Uk elatrefsan

»Nuk u faleshin krijesave hyjmendë»sit, por Kryetarit lart,*[53] dhe kërcëni»min me zjarr* e shkelnin me trimë»ri,[49] psalnin me brohori:* Zot, lavdi »më ty, o Perëndi i etërve,* ti je vetëm »i bekuar.[50]*

Ode VIII
Kanuni i Hyjlindëses
Irmosi: Ton Vasilea ton uranón

»Mbretin në qiej,* që e himnojnë »ushtritë* engjëllore dhe ju ta him»noni* dhe ta lartësoni gjithnjë në »gjithë jetët.

Mos i harro kurr',* o Virgjëresh', sa të luten,* të himnojnë me bes' e me shpresë,* dhe të lartësojnë me zë për gjithë jetët.*

Ti i shëron krejt,* përher' e pa u kursyer,* gjith' ata që të luten, o Zonjë,* dhe të lartësojnë që linde Zotin tonë.*

Ti më shëron krejt* nga gjith' sëmundjet e shpirtit* dhe nga dhembjet e trupit, o Zonjë;* të të lartësoj pra, o Virgjëresh' hirplote.*

Ti i largon krejt* sulmet dhe ngasjet e liga,* dhe pësimet, o Zonjë e virgjër,* pra të lartësojmë me zë për gjithë jetët.*

Kanuni i shenjtorëve:
Ek flogós tis osiis

Si armiq sëmundjesh të shumëllojshme me aleancën e Shpirtit Hyjnor, o shenjtorë, pushojini sëmundjet e shpirtrave tanë dhe lehtësojini dhimbjet e trupave.

Duke qenë tani soditësit e hijeshisë së Zotit,[54] me të vërtetë vizitoni këtë kishën tuaj të bukur, o hyjprurës, dhe e bëni burim mrekullish të shumta.

Duke dalë si dy lumenj nga burimi i Parajsës, vadisni tërë faqen e dheut[55] me rrjedha shërimesh, dhe thani shirat e sëmundjeve.

Meqenëse zotëruat shpresa të lumura,[56] tani lumëroheni nga të gjithë, siç e meritoni, pasi u dëftyet përmbushësit e vullneteve hyjnore të Perëndisë sonë të lumur, o anargjendë.

O anargjendë, mjekë sëmundjesh të pashërueshme, mjekojini sëmundjet tona të pashërueshme, zbuteni dimrin e ngasjeve dhe shpërndajini retë e topitjes.

Triadik

Së bashku me engjëj të shenjtë le ta himnojmë Atin, Fjalën dhe Shpirtin e Shenjtë, një Hyjni në tri karaktere, një mbretëri dhe një pushtet.

Zbritësore: Pedhas evajís

»Djemat* e dënuar për t'u djegur, »prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit »Krisht, si simbol në lashtësi,*[57] dhe »si një veprim tani,* dhe tërë botën »po e mbledh për këng' e lavdërim:* »Himnojeni, ju veprat e Zotit,* dhe e »lartësoni përmbi të gjitha jetët.[58]*

Ode IX
Kanuni i Hyjlindëses
Irmosi: Kirios Theotokon

»Hyjlindëse të themi,* të pohojmë »ne që* shpëtuam, o e kulluar e vir»gjër, me ty;* me koret e të patrupve »të madhështojmë tok.

Shiko si qaj me lotë,* edhe mëshiromë,* se ti ke fshirë çdo lot prej fytyrave,*[59] o Virgjëreshë dhe Zonjë që linde Zotin Krisht.*

Gëzoje zemrën time,* Zonjë Virgjëreshë,* se ti ke lindur gëzimin për njerëzit,* dhe zhduke çdo helm me ndjesën e gjith' mëkateve.*

Liman dhe mbrojtje bëhu,* Zonjë Virgjëreshë,* kështjell' e mur i patundur, Hyjlindëse,* përikje, ndihmë dhe mbrojtje e gjithë njerëzve.*

Me rrezet dhe me dritën* ndritna Virgjëreshë,* edhe largo errësirën e mendjeve*[60] t'atyre që të lëçitin, Zonjë Hyjlindëse.*

Shëromë Virgjëreshë,* se jam i përmbysur,* edhe po dergjem[61] në shtratin e vuajtjes;* po eja ngremë dhe falmë shëndet edhe shpëtim.*

Kanuni i shenjtorëve:
Theón anthropis

Ja ku, porsi pra me yj të ndritshëm nur,* plot me çudi shtëpia juaj kaq hijesisht shkëlqen;* plot hare gjithnjë ju lumëron fort me zë* edhe kujtimin tuaj mjaft të nderuar kjo* pra po e kremton me besë, anargjendë me respekt.

Si dritë, diell i madh dhe i dyfisht'* e zbukuroni qiellin mendor, anargjendë ju,* dhe me rrezatim çudish shkëlqeni gjithnjë* zemrën e çdo besniku, ndaj po thërrasim ne:* Lutemi, na zgjidhni errësirën e pasioneve.

Sado banoni, shenjtorë, lart në tend',* me dhembshuri padukurisht mes nesh ejani, sepse,* në mes tendës suaj të hyjnueshme fort,* himne drejtojmë tek i Tërëfuqishmi Zot,* dhe ju lumërojmë vazhdimisht, të tërëfamshëm pra.

Të lartat bashkë me dheun kanë gaz* në panairin tuaj të nderuar, të hijshëm krejt,* që, o shenjtë, bëjmë ne; çlironani pra* nga errësira e sëmundjeve, nga çdo stres,* ngushtësi, ndëshkim të ashpër brenda Hadhit, o të urt'.

Hyjlindësore

Meqë të frikshme e kishe shtatzënin',* lutem, në gjyq, në ditën fort të tmerrshme, çliromë ti* nga vendimi aq i ashpër; bëmë kështu* një pjesëmarrës me ata që shpëtojnë pra,* e Dëlira hyjhirplotë, mua që të përhimnoj.

Zbritësore: Apas jijenís

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazë»llim te drit' e Shpirtit Shenjt',* eni »lavdërojeni;* engjëjt e q'ellit eni »kremtojeni* këtë të shenjtë panair »të kryezonjës Mari,* dhe thërrisni:* »Ti je më e lumura,* Virgjëresh' e ku»lluar Hyjlindëse.*

Dërgimësore
En Pnévmati to ieró

O anargjendë mjaft të lum',* morët hir terapie* nga Zoti,[3] Perëndia yn,'* dhe shëroni sëmundje;* mjekoni gjith' sa vrapojnë* për në kishën tuaj pra* me besë; ndaj lumërojmë* me një mendje bashkërisht* sot kujtimin tuaj ne* me plot respekt dhe siç duhet.

Hyjlindësore

E kishe ti në shtatzëni,* o e fortpacenuar,* pra Fjalën Zot[62] dhe Perëndi,* Perëndin' që vepronte* plot urtësi për shpëtimin* botëror, ekonomin'* shkëlqyese; të himnojmë* denjësisht, se ndërmjeton* tek ai që të shpëtojm'* nga çdo rrezik dhe sëmundje.

Lavdërime
Ting. IV Édhokas simíosin

Jeni si lumenj dhe dete plot me rrjedhë, e cila vjen* qartësisht që nga Shenjti Shpirt;* vaditni me mrekulli* kozmosin[55] me dhënie* terapish, dhe vese shpirtprishëse i thani krejt,* dëboni frymë edhe shëroni pra* sëmundje[3] mjaft çuditërisht, o anargjendë hyjprurës ju,* ndërmjetues për shpirtrat tan'* pranë Krishtit Zot Perëndi.

(2x)

Kur nënshtruat, o shenjtorë, veset e palogjikshme krejt* me fuqi shpirtërore ju,* dhuntin' e shërimeve* morët që nga Krishti*[3] pasurisht; kështu mirëbërje jepni pa kursim* në njerëz dhe kafshë; duke kryer pra* ne panairin tuaj dritëprurës dhe të hyjnue-

shëm,* po kërkojmë për shpirtrat tan'* mençuri, hir edhe ndriçim.

Kisha juaj fort e shenjtë u tregua si qiell krejt* dritëdhënës në lartësi;* porsi ujë ka çudi* shpëtimtare tashmë,* dhe si diell hijshëm jep energjin' e hyjshme pra* të terapive, Kozma i tërëlum* edhe Damian i fortkënduar, shërbëtorë të Zotit ton',* ndërmjetues për shpirtrat tan'* pranë Krishtit Zot Perëndi.

Lavdi

Ting. IV I Theofanit

Duke pasur burim shërimesh, o shën anargjendë, dhurojuni shërimet gjithë atyre që kanë nevojë, se u bëtë të denjë për dhurata shumë të mëdha prej burimit të pashterur të Krishtit Shpëtimtar; se Zoti ju thotë si zelltarë të njëjtë me apostujt: Ja, ju kam dhënë fuqinë kundër shpirtrash të ndyrë, që të nxirrni dhe të shëroni çdo sëmundje dhe çdo dobësi; prandaj, pasi keni jetuar mirë sipas porosive të tij, falas morët, falas jepni,[3] duke shëruar pasionet e shpirtrave dhe të trupave tanë.*

Tani

Hyjlindësore

Nga çdo lloj rreziku ruaji shërbëtorët e tu, o Hyjlindëse e bekuar, që të të lavdërojmë ty, shpresën e shpirtrave tanë.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipikët dhe Odet III dhe VI e shenjtorëve. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Kungatore:* Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] Kol. 1.5
[2] Matth. 6.20; 19.21; Mark. 10.21; Lluk.12.33; 18.22
[3] Matth. 10.1,8; Mark. 3.15; Lluk. 9.1
[4] Matth. 10.9; Vep. 3.6
[5] Matth. 22.30; Mark. 12.25; Lluk. 20.35-36
[6] Fil. 3.20
[7] Joan 14.23
[8] IV [II] Mbret. 13.21
[9] Vep. 3.6; 19.23
[10] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[11] Joan 5.2-4
[12] Matth. 25.34
[13] Matth. 19.17; Mark. 10.18; Lluk. 18.19
[14] Joan 15.1
[15] I Tim. 1.5; 3.9; II Tim. 1.3; 2.22; I Petr. 1.22
[16] Is. 12.3
[16a] Num. 14.19 etj.
[17] I Kor. 12.7-11
[18] Lluk. 1.48
[19] Eks. 14.22-15.1
[20] Urt. Sol. 8.3
[21] Ps. 118(119).131
[22] Ps. 44(45).10
[23] Gjen. 1.7-8; Is. 40.22
[24] Ef. 2.20-21

[25] Is. 9.6; Joan 14.27
[26] Vep. 10.38
[27] Mark. 1.40
[28] Gjen. 1.16
[29] Abak. 3.1-2
[30] Ps. 40(41).4
[31] Joan 15.5
[32] Ps. 103(104).15
[33] Matth. 18.8; 25.41; Juda 7
[34] Is. 26.9
[35] Eks. 32.11 etj.
[36] Joan 14.27
[37] I Kor. 1.30
[38] Fil. 4.7
[39] Matth. 13.8,23; Mark. 4.8,20
[40] Rom. 9.5
[41] I Mbret.[Sam.] 1.15; Ps. 141(142).3
[42] Ps. 87(88).4
[43] Jona 2.7
[44] II Mbret.[Sam.] 22.20; Ps. 4.2; 117(118).5
[45] Joan 5.35
[46] Ps. 37(38).4,8
[46a] Ps. 46(47).2
[47] Matth. 7.24; Lluk. 6.48
[48] Gjen. 3.6-7
[49] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
[50] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 28
[51] Is. 33.6
[52] Lluk. 23.46
[53] Rom. 1.25
[54] Ps. 26(27). 4
[55] Gjen. 2.6,10
[56] Tit. 2.13
[57] Dan. 3.25
[58] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[59] Apok. 7.17; 21.4
[60] Ef. 4.18
[61] Ps. 43(44).20
[62] Joan 1.1

MË 2 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i vendosjes së Rrobës së çmuar të Perëndilindëses së Tërëshenjtë në Vllahernë.

Tipikon

1. Nëse bie në Mbylljen e Pentikostisë:

Në Mbrëmësore, pas Qëndrimit të parë të Psaltirit, Thirrtoret: 6 të së kremtes dhe 4 të Perëndilindëses. Lavdi i së kremtes. Tani i Perëndilindëses. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Pasvargjet e së kremtes. Lavdi i Perëndilindëses. Tani i së kremtes. Përlëshoret: e së kremtes (2x) dhe e Perëndilindëses.*

Në Mëngjesore, Ndenjësoret e së kremtes dhe, në vend të Hyjlindësoreve, të Perëndilindëses. Kanunet: të dy të së kremtes dhe një i Perëndilindëses. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes. Ndenjësorja e së kremtes dhe e Perëndilindëses. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Perëndilindëses dhe Sinaksari. Zbritësoret dublikate të së kremtes. Në vend të Më të nderuarën, *Ode IX e Kanuneve. Dërgimësoret: të dyja të së kremtes, dhe e Perëndilindëses. Lavdërimet: 3 të së kremtes dhe 3 të Perëndilindëses. Lavdi i së kremtes. Tani i Perëndilindëses. Dhoksologjia e Madhe. Përlëshorja e së kremtes.*

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: e së kremtes, e Perëndilindëses dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i Perëndilindëses. Në vend të Të meriton, *Irmosi i Odes IX të së kremtes (të Ting. IV* Mjegull' e mbuloj*). Kungatore e së kremtes [dhe* Kupë shpëtimi*]*. Pamë dritën.

2. Nëse bie të Dielën e Gjithë Shenjtorëve:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Perëndilindëses dhe 3 të Shenjtorëve. Lavdi i Shenjtorëve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Leximet e Shenjtorëve. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Shenjtorëve. Tani i Perëndilindëses. Përlëshoret: ngjallësore, e Shenjtorëve dhe e Perëndilindëses.*

*Në shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e Shenjtorëve, por Tani i Perëndilindëses (*Pasi të pastrojmë mendjen, *kërkoje në Lavdi i*

Thirrtoreve). Himne Triadike. Trishenjti dhe Përlëshorja e Perëndilindëses. Në Mëngjesore, Ndenjësoret e Pentikostarit. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, një i Perëndilindëses dhe i Shenjtorëve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Shenjtorëve. Ndenjësoret: e Shenjtorëve dhe e Perëndilindëses. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Perëndilindëses. Sinaksari i ditës dhe i Pentikostarit. Zbritësoret Ja gojën e çel tani*; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore, e Shenjtorëve dhe e Perëndilindëses. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Perëndilindëses dhe 3 të Shenjtorëve. Lavdi Eothinoni (I). Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit, 4 nga Ode III e Perëndilindëses dhe 4 nga Ode VI e Shenjtorëve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Perëndilindëses, e Shenjtorëve dhe e kishës. Kontaqi i Perëndilindëses. Apostulli i Perëndilindëses. Ungjilli i Shenjtorëve. Të meriton. *Kungatore* Kupë shpëtimi *[dhe e Shenjtorëve].*

3. Nëse bie në një nga të dielat jashtë Pentikostarit:

Në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të Perëndilindëses. Lavdi i Perëndilindëses. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i Perëndilindëses. Përlëshoret: ngjallësore dhe e Perëndilindëses.*

Në Mëngjesore, Përlëshoret: ngjallësore (2x) dhe e Perëndilindëses. Ndenjësoret ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe të Perëndilindëses. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Perëndilindëses. Ndenjësorja e Perëndilindëses (2x). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore dhe e Perëndilindëses. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të Perëndilindëses. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Perëndilindëses. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Perëndilindëses dhe e kishës. Kontaqi i Perëndilindëses. Apostulli i Perëndilindëses dhe Ungjilli i së dielës. Të meriton. *Kungatore* Lavdëroni *[dhe* Kupë shpëtimi*].*

NË MBRËMËSORE

Thirrtore
Ting. IV Édhokas simíosin

Si i dhembshur, njeridashës, nënën tënde ndihm' ua dhe* shërbëtorëve, Zot, të tu,* përmes saj ekonomin'* tënde fort të frikshme* dhe të parrëfyeshme kreve, rimëkëmbe pra* ofiqin tonë hyjnor, që në fillim* na u krijua; ndaj nderojmë panairin me plot respekt* dhe himnojmë pushtetin tënd,* o i gjithëfuqishmi Krisht.

(2x)

O e Virgjër pa cen, që nuk njohe burrë, qyteti yt* po të mburr ty detyrimisht* edhe të nderon me shpirt,* se kujdesesh përmes* rrobës sate që kurrë s'çmohet; pra e ruan ti* gjithnjë nga lufta civile, çdo tërmet,* uri,[1] barbar fort ateist, hyjnuse Zonjë e tërëshenjt',* që je ndihma e njerëzve;* ndaj me gaz të lëvdon ai.

(2x)

Rrobën tënde të paçmuar ia dhurove qytetit tënd,* e dëlirë, hyjhirshme krejt,* si strehë, liman, shpëtim* për sa dimërojnë,* pasuri që s'hiqet, thesar shërimesh dhe lavdi,* burim çudish, muri që nuk çahet dot;* prandaj të lartësojmë edhe të lëvdojmë me himne ty,* o e tërëhimnuar, pra,* Zonja jonë pa cen aspak.

(2x)

Lavdi *dhe* Tani

Ting. II

Pasi të pastrojmë mendjen dhe arsyen, së bashku me engjëjt le të kremtojmë edhe ne panair, duke nisur me ëndje një melodi davidiane për nusen e re të mbretit Krisht, Perëndisë sonë, duke thënë: Ngrihu, o Zot, në prehjen tënde, ti dhe arka e shenjtërimit tënd;[2] sepse si një pallat mbretëror e stolise bukur dhe ia dhe si trashëgim qytetit tënd, o Zot, që të kujdeset për të dhe ta mbrojë nga armiq barbarë me anën e fuqisë sate të pushtetshme, sipas përgjërimeve të saj.

Pasvargje
Ting. I Panéfimi mártires

Pallat mbretëror për Perëndin',* Zonjë, ishe vetëm ti, dhe rrobën tënde të çmuar që porsi thesar e ka* kjo shtëpia jote* e hyjnueshme, hyjnënë, si një mur që s'mposhtet, si shenjtërim, ia ke dhuruar pra* besëmirëve; qyteti yt* përhimnon pushtetin tënd, shpëton me të.

Varg: Ngrihu, o Zot, në prehjen tënde, ti dhe arka e shenjtërimit tënd.

Dhurove, Hyjlindëse e thjesht',* te të gjithë si thesar* lavdie rrobën e çmuar që mbuloi trupin tënd* të shenjt' dhe të çmuar;* na e dhe porsi burim që rrjedha jetësore gjithnjë

gufon me hir; kremtojmë ne* pra vendosjen e kësaj edhe* të nderojm' ty që na ndere gjithë ne.

Varg: Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

O Zonjë, shtëpia jote pra,* si thesar me shenjtërim,* ka veshjen tënde të hyjshme, ndaj gjithnjë na shenjtëron* tërë ne që vijmë* me nxitim edhe të lumërojmë siç e kemi detyrë, kemi shpresën ton' në të,* se për shpirtrat tanë është kjo* siguri dhe strehë e qëndrueshme.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. II

Si një kurorë të përmbishkëlqyeshme, o Hyjlindëse, Zonjë e tërëpacenuar, rrobën tënde të shenjtë e veshi Kisha e Perëndisë,[3] dhe ngazëllohet me hijeshi sot, dhe kërcen mistikisht duke të thirrur: Gëzohu, o rreth i çmuar dhe kurorë e lavdisë[4] së tij hyjnore; gëzohu, lavdia e vetme e tërësisë dhe hareja e amshuar; gëzohu, limani dhe mbrojtja e atyre që rendin te ti, si dhe shpëtimi ynë.

Përlëshore
Ting. Tërth. IV

O Hyjlindëse gjithmonë e virgjër, streha e njerëzve, ia dhurove si veshje të fuqishme qytetit tënd rrobën dhe brezin e trupit tënd të pacenuar, që mbetën të paprishura në lindjen tënde të pafarshme; se në ty bëjnë novacion edhe natyra, edhe koha; për këtë të lypim ty, që t'i dhurohet botës paqe dhe shpirtrave tanë përdëllimi i madh.[4a]

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. IV Epefanis símeron

Populli yt sot kremton,* fort e himnuar,* për vendosjen me respekt* të rrobës sate plot me nder,* dhe të thërret vazhdimisht: Ki gaz,* e Virgjër, je mburrja e të krishterëve.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
E ngjashme

Po kremton sot kozmosi* vendosjen me nder* të mantelit tënd, e thjesht',* dhe të thërret me mallëngjim:* O Virgjëreshë, ki ngazëllim,* je ndihmëtarja e tërë besnikëve.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Të dy Kanunet e Hyjlindëses:

Ode I

Kanuni i parë që ka Akrostihidhë:
"Nderoj rrobën e Virgjëreshës
së tërëdëlirë. Josif".
Ting. IV
Irmosi: Tristatas krateús

»Karroc' me tre të fort',* pra tri pje-
»së të shpirtit,* lutem, mbyti krejt në
»fund*[5] pa vese, ti që lind* nga e Vir-
»gjra, që të të psal* meloditë trium-
»fale* përmes vrasjes së trupit tim*
»të mëkatshëm, porsi me timban[6]
»mendor.

Dhurove përgjithnjë,* o Hyjlind'se e virgjër,* rrobën tënde që ka nder* te populli yt ti,* si një mur të hyjnueshëm,* ndaj çdo sulm armiqësor, vrull* ne e zmbrapsim absolutisht* me fuqinë përherë të Shenjtit Shpirt.[7]

U shenjtërua krejt* rroba jote e hyjshme,* kur u prek nga trupi yt* si mbajte Krishtin Zot;* mbi dhé lindi prej gjakut tënd* të dëlir', për ne u njoh ky,* Virgjëreshë; përmes asaj* shenjtëron shërbëtorët e tu të gjith'.

Vërtet, e Virgjra Zonj',* u dhurove atyre* që me besë të nderojn'* thesarin që ka nder,* rrobën tënde të çmuar fort;* kjo na pasuron të gjithë* me dhurata nga Shenjti Shpirt,*[8] o e mirë, me shfaqje çudish shumë.

Zonj', shqerr' pa njollë je,* linde qengjin e Zotit*[9] përmbi mendje, na e dhe* ti rrobën tënde pra;* s'çmohet dot dhe pastron vërtet* përgjithmonë njollën, ndotjen* e atyre që e nderojn'* dhe i falen, e fortpaqortueshme.

Kanuni i dytë, i zotit Kozma
Ting. i njëjti Thalasis to erithreon

Pra kisha* e së Dëlirës krejt si qiell të kënaqshëm fort,* të çmuar gjeti rrobën e asaj* si llambadhe të ndritshme nur,* që s'perëndon dhe sot veron me llamburitje hiri rruzullin.

Si forcë* dhe lidhje sigurie, dhe pushtet që s'thyet dot,* qyteti yt, o Zonjë, ka vërtet* rrobën tënde të shenjt' pikërisht,* dhe me gëzim në ty krenohet, o e tërëpacenuar pra.

Hyjnënë,* vërtet te të mbidheshmit sarkofagu yt u duk* fort më i çmuar se, në lashtësi,* ishte Arka; se s'kishte simbol,*[10] por besërisht i ruante tiparet që ka e vërteta pra.

Ode III
Kanuni i parë
Irmosi: Oti stira éteken

»Meqë lindi shterpa bij, Kisha e ko-
»mbeve, nëna,* dhe Sinagoga plot
»me fëmij' u dobësua[11] keq,* le t'i
»thërrasim Zotit të çuditshëm fort:*
»Je i shenjtë, Perëndi.

Shenjtërimin fort të këndshëm, portën mbiqiellore,*[12] le ta himnojmë, nënën e Perëndisë sonë pra;* me mall ta puthim rrobën që e vishte kjo,* se hyjnisht buron dhunti.

Përmes lindjes sate të paprishme, gjith' ne, modeste,* me rrobë që nuk prishet na veshe, se u zhveshëm krejt* me prishje,[13] dhe si pasuri që s'vidhet dot,* rrobën plot nder na e dhe.

Strehë je për shpirtrat tan'; me rrobën tënde të hyjshme* atë që mbarë qiellin pra me re po e mbështjell,*[14] e ke mbështjell'; me bes', e pacen, të lëvdojm'* dhe i falemi asaj.

Kjo shtëpi e hyjshme është një klinikë krejt falas* për të sëmurët, mban rrobën tënde si burim që nxjerr* shërime pa pushim, e paqortueshme,* e tërëdëlirë pra.

Kanuni i dytë: Efrénete epí si.

Besnikë, sot ta nderojm',* me bes' t'i falemi pra rrobës që kish* e dëlira, sepse kjo* përmes prekjes me Perëndin' na lidh.

Sot rroba e çmuar fort* e së Dëlirës së himnuar me nam,* përmes Hirit po buron* për besnikët mjaft terapi, shëndet.

Si vesë rrjedh në agim,*[15] e pastër, gazi yt; gjithnjë vë në gjum'* furrën e pasioneve* të atyre që të himnojnë ty.

Irmosi: Efrénete epí si

»Dëfrehet në ty,[16] o Krisht,* dhe të »thërret pra Kisha jote me gaz:* Stre»ha, përforcimi im* dhe fuqia ime je »ti, o Zot.[17]

Ndenjësore
Ting. IV O ipsothís en to stavró

Perëndilindëse,* lumenj me çuditë* prej sarkofagut tënd* të gjithënderuar* si prej Edenit dalin; dheun, faqen e tij* e vaditin[18] duke nxjerrë hir* për besnikët që të nderojn';* ndaj të përhimnojmë ne,* me kushtim ty të mburrim* dhe me hare thërrasim përgjithnjë:* Shpresa e vetme* për sa të himnojn', ki gaz.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Ode IV
Kanuni i parë
Irmosi: Dhi' agápisin iktirmon

»Për dashurinë e ikonës sate,[19] o i »dhembshur, qëndrove mbi Kryqin »tënd dhe u shkrinë kombe;[20] sepse ti »je, o njeridashës, fuqia dhe himnimi »im.

Le ta madhështojmë të vetmen e bekuar,[21] dhe le ta përqafojmë me

besë rrobën e saj, që të nxjerrim Hirin e Shpirtit, si prej pusi.

O Vajzë, qyteti që të nderon, duke pasur si thesar të çmuar rrobën tënde, besërisht e puth me mallëngjim dhe merr hir.

O e Tërëpaqortueshme, e nderojmë rrobën tënde, sepse buron paprishje dhe është stoli lavdie[22] për gjithë sa të himnojnë.

Ti që u shfaqe e Tërëpaqortueshme dhe e vetmja e shenjtë më shumë se Keruvimet, na shpëto nga çdo peripeci shpirtrat neve që të nderojmë me besë.

Kanuni i dytë: Eparthenta se idhusa

Pasi Bërësi dhe Ndërtuesi të fiksoi si qiell të përmbiçmuar, si me yje të stolisi bukur me vezullime[23] të hyjshme, me anën e të cilave hijeshon skajet, o Perëndilindëse.

O Hyjnënë e thjeshtë, na ngre nga toka drejt qiellit rroba jote e hyjshme ne që u ndezëm zjarr nga malli për të; prandaj të lavdërojmë si shkakun e lavdisë më të lartë.

O kremtimdashës, ja hiri që nuk shteron; ejani të gjithë me zemër të sinqertë dhe nxirrni rrjedha të hyjnueshme, që burojnë pa kursim nga arkivoli i respektuar i Nënës së tërëdëlirë.

Ode V
Kanuni i parë
Irmosi: Si Kírié mu fos

»**S**i dritë, Zoti im,* në mbar' botën »ke ardhur ti,*[24] si shndritje e shenjtë, »që nxjerr* nga padija e errët[25] sa të »himnojnë me besim.

Ti, o Zonjë, u ke dhuruar shërbëtorëve të tu rrobën tënde të çmuar, si forcim dhe mur rrethues të hyjshëm.

O e Tërëpacenuar, kisha që zotëron rrobën tënde, u tregua Parajsë e këndshme, që lëshon erën e mirë të Shpirtit.

O e Tërëshenjtë, na shenjtëro shpirtrat dhe trupat neve që nderojmë me besim si tejet të çmuar rrobën tënde të shenjtë.

Na trego tempuj të Perëndisë[26] që banoi brenda teje, o Hyjlindëse, ne që të lumërojmë besërisht në kishën tënde të hyjshme.

Kanuni i dytë, Irmosi i njëjti

Ti, o Zot, e madhërove Nënën tënde, ti e lartësove lavdinë e saj pakrahasueshëm përmbi të gjitha esencat mendore.

O Perëndilindëse e tërëpacenuar, tani Hiri i Perëndisë[27] u jepet pa kursim nga sarkofagu yt i shenjtë atyre që të falen ty me mall.

Qyteti yt krenohet, o Perëndilindëse, duke të pasur përmes rrobës sate si ndërlidhëse; mbretërit besnikë të ngjeshin ty si fuqi.[28]

Ode VI
Kanuni i parë
Irmosi: Evóise protipón

»**V**arrimin tënd* të triditshëm e para-
»skiconte qart',* duke thirrur,* kur në
»një peshk të madh lutej, o Jisu,* shën
»Jona profeti:*[29] Mbret i forcave,[30] prej
»prishjes më çliro.[31]

E shfaqe mur* të paçar' rrobën tënde të shenjtë krejt,* të nderuar* te qyteti mbret mbi çdo qytet kudo,* ti që linde mbretin* e të gjithave, Zotin,[32] Hyjlindëse.

Me gaz hirin* e së Virgjrës le ta lavdërojmë ne,* t'ia nderojmë* rrobën e tërëshenjtë; prej saj na del* çdo shërim pareshtur,* që mjekon të sëmurët, u jep fuqi.

Të dimë ty* si burim jetërrjedhës, Hyjlindëse,* dhe nderojmë* rrobën tënde të hyjshme, nga nxjerrim ne,* tërë besëmirët,* kurdo, çdo dit' shërimet, shëndetin pra.

Me ty ishte,* o Hyjlindëse, Zoti;[33] esencën ton'* njerëzore* e familjarizoi edhe prej saj* e dëboi çdo dëm* të të huajit, pra të të ligut djall.

Kanuni i dytë: Thiso si metá fonís

Mbi mendim,* në kishën tënde Zoti të tërën pra* të lavdëroi, shkëlqeu,* Vajzë, të nderoi të tërën mbi fjal'* tok me rrobën* kutin' e shenjtë, brezin, Hyjlindëse.

Si fuqi* dhe krenari të kanë besnikët ty,* me lavdin ngjishen se kanë,* o Hyjnënë, brezin tënd të nderuar* si stoli pra* mjaft të shkëlqyer, si dhe të çmuar fort.

Dhimbje, mall* të hyjshëm kishin tërë profetët pra* qëmoti; donin ta shihnin* lavdin tënd që s'shprehet, ndërsa i qeni* përtej kohës* te ne u shfaq në ditët e fundme, Vajz'.

Irmosi: Thiso si metá fonís

»"**D**o flijoj* me zë himnimi",[34] Kisha
»thërret te ti,* o Zot, sepse përmes
»gjakut,* që nga brinja jote për për-
»dëllim rrjedh,*[35] u pastrua* nga çdo
»pisllëk prej gjakrash demonësh kjo.

Kontaqi
Ting. IV O ipsothís en to stavró

Dhurove veshje që* nuk prishet, e

pastër* dhe hyjhirplote krejt,* te gjithë besnikët,* pra rrobën tënde fort të hyjshme, meqë me të* e mbulove trupin tënd të shenjt,'* je për njerëzit strehë;* në vendosjen e kësaj* po kremtojmë me mall ne* dhe besërisht thërrasim fort me zë:* Ki gaz, e Virgjër,* je mburrja për çdo besnik.

Shtëpia

Tendën e pastër dhe të vërtetë të Fjalës Perëndi,[36] renë[37] e gjallë dhe shtambën e manës,[38] Mariamën Hyjlindëse, le ta lumërojmë besërisht gjithë sa shpëtuam me anën e lindjes së saj; dhe le ta përqafojmë rrobën e respektuar, me të cilën, pasi e mbështolli Zotin, e mbajti si foshnjë, kur ai veshi mish, nëpërmjet të cilit natyra e vdekatarëve u lartësua drejt jetës dhe mbretërisë së sipërme; prandaj të ngazëlluar thërrasim me zë të madh: Ki gaz, e Virgjër, je mburrja për çdo besnik.

Sinaksari

Më 2 të të njëjtit muaj, kujtojmë vendosjen e rrobës së çmuar të Perëndilindëses së Përmbishenjtë në sarkofag të shenjtë, në Vllahernë, në kohën e Leontit të madh dhe të Virinës, gruas së tij.

Vargje: Nga njëra anë këmisha e Birit shkoi te xhelatët që ruanin Krishtin,[39]/ nga ana tjetër rroba e Nënës te qyteti i ruajtur nga Krishti.
Në të dytën, vendosën rrobën e së Tërëdëlirës në sarkofag.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atletizmit të martirit të shenjtë Kointi; dhe kujtimi i atit tonë ndër shenjtorë Juvenali, kryepiskop i Jerusalemit.

Vargje: Megjithëse u dërrmua në këmbë, Kointi u shërua përsëri;/ por do të kurorëzohet, edhe pse vdiq me mbarim të përbashkët.
Mburr kujtimin e Juvenalit,/ varrin e hyjshëm të të cilit e ka Palestina.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit të shenjtë Llambro.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Kanuni i parë
Irmosi: Avramiei poté

»Në Babilonë, në zjarr,* djemat abra»mianë* e shkelën flakën përvëlo»njëse,* këndonin pra besërisht:* O »Perëndi edhe Zot, je i bekuar.[40]*

Me mendje tepër të lartë dhe zemër të përulur,[41] le ta lavdërojmë fronin tepër të lartë të Mbretit, Vajzën e tërëshenjtë, hirploten.

O dhomë nusërore e zgjedhur nga Perëndia, rrobën tënde, që gjendet në

këtë dhomën tënde të respektuar, e nderojmë besërisht, si arkë të shenjtë[10] dhe strehë shpresëplotësh.

Ripërtërihet çdokush që vjen me besim dhe puth sarkofagun e shenjtë, që mban rrobën tënde dritëdukëse, o Virgjëreshë e kulluar.

Sarkofagu yt, i cili mbuloi rrobën që mbuloi trupin tënd të nderuar, pastron çdo njollë shpirtërore, o Virgjëreshë e tërëpaqortueshme.

O Hyjnënë e dëlirë, shpëtoje qytetin që të nderon nga uria, tërmeti,[1] nga çdo keqtrajtim, mësymje kombesh dhe dëm kundërshtar.

Kanuni i dytë:
En ti kamino avramiei

Ti, o i Mirë, duke qenë i vetmi si diell drejtësie,[42] e bëre të hijshme hyjnisht kishën e së thjeshtës, nëpërmjet karizmave të tua të larmishme; në të ajo e lartëson rrobën e saj dhe i dërgon rrezet e saj.

Kanat e hyjshme të çudive të tua u burojnë me bollëk vërtet hir besnikëve, dhe nga sarkofagu derdhen me mbushulli tek ata që të nderojnë, si lumenj mendorë nga një Eden tjetër,[18] o e Tërëdëlirë.

Nxit mistikisht sarkofagu i Zonjës: Ejani tani me ngazëllim të gjithë mbi dhé, ejani, përqafoni brezin e saj të përmbilavdishëm, që mbaj brenda meje si thesar.

Ode VIII
Kanuni i parë
Irmosi: Litrotá tu pantós

»Fuqiplot', çlirimtar* për të gjithë ne, »te të rinj zbrite se* mbanin besën »fort* mes flakës; i freskove pra,*[40] »i mësove të psalnin:* Ju gjithë ve»prat,* ta bekoni, himnoni pra Zotin »ton'.[43]

Me zëra të gëzuar të përhimnojmë ty që na shkaktove të mirat e shumëllojshme, dhe puthim rrobën tënde të respektuar, o Vajzë, duke thirrur: Bekojeni, vepra, Zotin.[43]

Duke pasur para nesh si kandil mendor kandilmbajtëse[44] në tryezë mantelin e hyjshëm të Virgjëreshës së tërëkulluar, ndriçohemi përherë në beben e syrit dhe në zemër.

Nuk i le fare të privuar nga prekja jote e hyjnueshme shërbëtorët e tu të padenjë, o e Virgjër, sepse, në vend të trupit tënd jetëprurës, na ke dhuruar neve të gjithëve rrobën tënde.

Me himne dhe ode të perëndishme le ta nderojmë tendën e gjerë të Perëndisë,[36] të Tërëdëlirën mes nënash, portën qiellore,[12] përmes së cilës u mbyll dera që çonte drejt vdekjes.

Kanuni i dytë:
Hiras ekpetasas Dhaniíl

O Zonjë e tërëpacenuar dhe e qashtër, engjëj tani kërcejnë bashkë në kishën tënde të nderuar, dhe kujdesen për rrobën tënde të çmuar dhe të shenjtë, duke iu falur me mall, hare dhe me shumë ngazëllim, e duke përmhimnuar lavdinë e gjinisë sonë.

O e pacenuar, ti je shkopi që nxori lulen[45] e jetës, gëzimi i të gjithëve, kutia e shumëçmuar e Shpirtit, thesari i të mirave, burimi i aromave, nga i cili sarkofagu i hyjshëm gufon miron e shërimeve.

Ushtritë mendore himnojnë madhështitë e tua, o e Dëlirë e tërëpacenuar; i shpallin fuqishëm të gjithë patriarkët, profetët, kori i apostujve, tërësia e martirëve dhe mbarë shumica e oshënarëve; ndërsa ne të falemi tok me ta.

Irmosi: Hiras ekpsetasas Dhaniíl

»Duke* ngritur duart, Danieli mbylli »gojët e luanëve në grop';*[46] dhe shu»an forcën e zjarrit krejt,*[40] kur u ngje»shën me virtyt Djemtë,* pra miqtë e »shpresëtaris',* tok duke thirrur me »gaz: Bekoni* ju gjithë veprat e Zotit, »pra Zotin ton'.[43]

Ode IX
Kanuni i parë
Irmosi: Eva men to tis parakoís

»Eva, nga sëmundja e mosbindjes,[47] »mori keq* si banues brenda saj mall»kim;*[48] por, o Hyjlindëse e virgjër,* »ti, nëpërmjet lastarit të shtatzënis,'* »për botën e lulëzove bekimin krejt;* »ndaj gjithë ne të madhështojmë ty.

Ja, o shtrat i Solomonit,[49] të lëvdojmë ne* plot me melodi gëzuese* edhe rrethojmë rrobën tënde* të çmuar, si një arkë të shenjt'[2] tjetër,* dhe marrim shërime edhe shpëtim me gaz,* o Virgjëresh' gjithnjë dhe pa cenim.

Sarkofagu yt i shenjt' u duk, dhe ka tani* rrobën tënde fort të çmueshme* porsi burim me drit, e Virgjër,* kjo si ndriçim dërgon rreze terapish,* dhe terrin e çdo sëmundjeje e largon;* me ngazëllim dhe mall e puthim ne.

Tok me ne, e tërëpacenuar, ka hare* çdo ushtri në qiell, dhe të gjith',* edhe apostujt me profetët,* martirët, oshënarët, të drejtët pra* gëzohen, se rrobës sate i falemi,* Zonjë, e vetmja Virgjëresh' gjithnjë.

O shtëpi e tërëshenjtë e Jisuit Zot,* kur vendosej rroba jote pra,* po shenjtërohej tërë dheu,* Davidi ngazëllohej, ndërsa Arka* e vjetër[50] të

paraikonizonte ty,* kur kish pushuar,[51] Virgjëresh' gjithnjë.

O Hyjnënë virgjëreshë, ti mantelin tënd* e dhurove te qyteti mbret* që mbretëron mbi krejt qytetet,* dhe të nderon ty si mbretëreshën pra* të tërë krijesave, se e ka këtë* si mur rrethimi, veshje hyjësisht.

Kanuni i dytë:
Lithos ahirótmitos orus

Sarkofagu yt, o Hyjnënë, u duk si dhomë fort e vlefshme,* se ka brezin tënd krejt të vyer, edhe* stoli virgjërore, nusërore* e ka ky rrobën, dhe e mban* si një thesar të jetës përgjithnjë.

Sot në kishën e Virgjëreshës, që imiton mbarë sistemin* qiellor, të bukur, besnikë, erdhëm* dhe shndritëm me hir nga llamburitjet* e mrekullive, që shkëlqejn'* si yje lart me hijeshi[23] e lavd.

Brezin tënd dhe rrobën e shenjtë i ka qyteti yt porsi mur,* si bashkim të hyjshëm, njësi dogmash pra,* dhe mburrje për mbarë orthodhoksët,* triumf, trofe për mbretërit,* o e kulluar dhe Hyjnënë ti.

Hirin tënd që s'imagjinohet dhe lavdin tënd që nuk rrëfehet,* i himnojmë se je burim me urti* nga vjen Fjala, o e pacenuar,* për gjithë sa e madhërojn'* Birin tënd edhe të nderojnë ty.

Irmosi: Lithos ahirótmitos orus

»Si një gur i prerë pa dorë nga mali »yt i palatuar,* Virgjëresh', u pre porsi »gur[52] qosheje,*[53] pra Krishti, i cili i ba»shkoi* natyrat krejt të kundërta;*[54] »ndaj me gëzim të madhështojmë ty.

Dërgimësore
Fos analíoton Loje

Kohën, natyrën ti vetëm,* Hyjnënë, i përtërite,* se të paprishshme qen' lindja* dhe gjithashtu rroba jote;* strehon me të krejt qytetin tënd, dhe fuqinë* e jep te skeptrat e besës.

(2x)

Lavdërime
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Sarkofagu, që brenda mban* rrobën tënde, përditë ësht',* njihet, prej shërbyesve të tu si një ark'* me shenjtërim[2] dhe burim shërimesh, mur i hyjnueshëm,* krenari edhe lavdi;* ndaj këtu, si u mblodhëm tok* perëndishëm ne,* madhështitë e tua i himnojmë tash dhe detin e çudive, o e kulluar pa cen aspak.

(2x)

Ja një vend i lavdishëm krejt,* ja shtëpi me shkëlqim gjithnjë* përmes

Hirit; rrobën e çmuar, që e kish* Hyjbija, kjo e ka. Ejani dhe nxirrni prej saj, njerëz,* dritësim dhe zbutje tok,* dhe me zemër plot gaz të madh* thirrni tek ajo:* Virgjëreshë e tërëshenjtë, të bekojmë ne që u shpëtuam prej Birit tënd, që nga ti u lind.

Për vendosjen e shenjtë pra,* Zonjë, të rrobës sate, ne* me gëzim kremtojmë sepse denjove ti* që sot t'i jepet qytetit tënd kjo veshje e hyjshme krejt,* një thesar i çmuar fort,* pasuri terapish, shëndet* që nuk vidhet dot,* lum' të mbushur me plot dhunti të Shpirtit edhe ruajtje që kurrë nuk hiqet dot nga keqbërësit.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. II

Pasi të pastrojmë mendjen dhe arsyen, së bashku me engjëjt le të kremtojmë edhe ne panair, duke nisur me ëndje një melodi davidiane për nusen e re të mbretit Krisht, Perëndisë sonë, duke thënë: Ngrihu, o Zot, në prehjen tënde, ti dhe arka e shenjtërimit tënd,[2] sepse si një pallat mbretëror e stolise bukur dhe ia dhe si trashëgim qytetit tënd, që të kujdeset për të dhe ta mbrojë nga armiq barbarë me anën e fuqisë sate të pushtetshme, sipas përgjërimeve të saj.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipikët dhe 4 Tropare nga Ode III e Kanunit të parë dhe 4 tropare nga Ode VI e Kanunit të dytë. Pas Hyrjes, Përlëshoret: E Hyjlindëses dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Kungatore* Kupë shpëtimi.

CITIME

[1] Matth. 24.7; Lluk. 21.11
[2] II Kron. 6.41; Ps. 131(132).8
[3] I Kor. 1.2 etj.
[4] I Petr. 5.4
[4a] Num. 14.19 etj.
[5] Eks. 15.4
[6] Eks. 15.20
[7] Lluk. 4.14; Rom. 15.13,19
[8] Vep. 2.38; 8.20; 10.45
[9] Is. 53.7; Joan 1.29,36
[10] Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; II Kron. 6.41; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
[11] II Mbret. [Sam.] 2.5
[12] Gjen. 28.17
[13] Gjen. 3.7
[14] Ps. 146(147).8
[15] Urt. Sol. 11.12; Osia 6.4; 13.3
[16] Est. 4.17ff
[17] Ps. 17(18).2
[18] Gjen. 2.6,8
[19] Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
[20] Ps. 96(97).5
[21] Lluk. 1.29
[22] Is. 61.3
[23] Sirak 43.9
[24] Joan 3.19; 12.46
[25] Vep. 26.18

[26] I Kor. 3.16; 9.16; II Kor. 6.16
[27] Vep. 13.43 etj.
[28] I Mbret. [Sam.] 2.4; Ps. 17(18).33,40
[29] Matth. 12.40
[30] Ps. 67(68).13
[31] Jona 2.7
[32] Est. 4.17b
[33] Lluk. 1.28
[34] Jona 2.10
[35] Joan 19.34
[36] Eks. 25.8; 26.30; Num. kap. 8; Hebr. 9.2
[37] Eks. 13.21-22 etj.
[38] Eks. 16.32-33
[39] Joan 19.23
[40] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-28
[41] Matth. 11.29
[42] Mal. 4.2 (3.20)
[43] Ps. 102(103).22; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[44] Matth. 5.15; Mark. 4.21; Lluk. 8.16; 11.33
[45] Num. 17.23; Hebr. 9.4
[46] Dan. 6.22
[47] Gjen. 3.4-7
[48] Gjen. 3.16-19
[49] Kënga 3.7
[50] II Mbret. [Sam.] 6.12-16; I Kron. 15.25-29
[51] I Kron. 6.16(31); II Kron. 6.41
[52] Zah. 9.16; Dan. 2.34-35,44-45
[53] Is. 28.16; Ef. 2.20; I Petr. 2.6
[54] Rom. 5.10-11; II Kor. 5.18-19; Ef. 2.17-18

MË 5 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë oshënar Athanas Athoniti dhe i atit tonë oshënar Llambadh Çudibërësi.

Tipikon

Nëse bie të dielën, shërbesa e oshënar Llambadhit lihet, pra të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të oshënar Athanasit. Lavdi i oshënar Athanasit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i oshënar Athanasit dhe Tani i tij. Përlëshoret: ngjallësore, e oshënar Athanasit dhe Hyjlindësore e tij.*

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e oshënarit. Himne Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e oshënar Athanasit. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i oshënar Athanasit (pa Irmoset e tij). Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e oshënar Athanasit, dhe Ndenjësoret e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore, e oshënar Athanasit dhe Hyjlindësore e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të oshënar Athanasit. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e oshënar Athanasit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e oshënar Athanasit dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Apostulli dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore e së dielës.*

NË MBRËMËSORE

Thirrtore të oshënar Athanasit
Ting. II Piis efimión stémasin

Çfarë* lëvdate mburrjesh, fjalësh* Athanas oshënarit t'i sjellim?* I stolisur nëpërmjet veprave,* edhe i mbushur me hir ishte* që nga dritëderdhja e hyjndritshme.* Ai* është shpat' që pret vrullin e veshëve,* edhe* është shtyllë që shkëlqen[1] me teori,* llambë për vetëpërmbajtje* që mbi kandilmbajt'sen*[2] shpirtërore rrezaton nur* detyrat e Perëndis',* që jetë u jep të gjithave.[3]

Me çfar'* kurora fjalësh ne krejt* të pavlefshmit, shenjtor Athanasin* ta kurorëzojmë? Si skifter ky,* në etër rend, lartësohet pra,* dhe frekuen-

ton në qiej; krahët* i ka* teori hyjnore, ësht' pirg që s'çahet,* fortes'* e përulësis' për dallueshmëri,* dhe mur i patundur si dhe* hijeshi e thjeshtë* për stolisje nur në moral;* lyp Krishtin mëshirëplot,* të vetmin Zot pra, për bijt' e tij.

Dukesh* mëngjes, që shndrit përherë* me pishtar dhuntish, o oshënar ti;* tërheq drejt agimit që s'perëndon* ata që mjegulla e vesit* i verboi keq, hyjmendës atë,* meqë* ti shumëfishove talantin;[4] Krishti* të shfaq* ty mjek shpirtrash; heq kalbjen e plagëve* që s'kan' shërim, përmes shpatës,* që ësht' fjala[5] jote,* dhe u jep shëndet, shpëtimtar,* atyre që vijn' te ti;* o shën Athanas me nam të madh.

Të oshënar Llambadhit
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

O Llambadh i lumur atë, me vetëpërmbajtje të plot'* dhe me lutje intensivisht* çdo mentalitet mishor*[6] ia nënshtrove fort shpirtit tënd;* u mbushe pra me karizma dhe dhunti,* të cilat Shpirti i Tërëshenjtë jep;*[7] mbi të bazoheshe* dhe sheshove, mposhte krejt, o oshënar,* çdo kolonë frymësh, grup të ligjsh edhe dinak.

Atë i hyjfrymëzuar, na u shfaqe porsi thesar,* që ish fshehur[8] në shpella thell';* dhe me shenja dhe çudi*[9] kundërmon ti aromë mir',* o i hyjlum, brenda shpirtit të atij* që të afrohet me zell, thërresim pra:* Rrëmbena edhe ne* që të lavdërojmë, nga peripeci* përmes përgjërimeve të tua, shën Llambadh.

Atë i hyjurtë shën Llambadh, me një ushtrim asketik* ishe ngjitur me Perëndin',*[10] duke shndritur ti hyjnisht* me shkëlqime prej tij; ndaj je* si një llambadhe, që feks të gjithë ne* përmes virtytesh përherë; dhe kështu,* o i hyjlumur, pra* sot kremtojmë besërisht kujtimin tënd* dritëprurës me hare; u shfaqe shenjt i madh.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Sa e perëndishme ishte jeta jote dhe i tërëhyjshëm fundi yt, o atë Athanas! Se në të, pasi u mblodh shumica mbarë e Malit, sapo të pa pa frymë në shtrat, bërtiste me fjalë vajtuese: Jepu një fjalë të fundit shërbëtorëve të tu, o shenjt, na mëso, o atë, ku po i lë bijtë e tu, që të dhimbsen si atë vërtet i dhembshur, me dashuri; por, ndonëse mbulohesh këtu në varr, të gjithë që të nderojmë ty me mall, të kemi pasuri lart, si mbrojtës dhe ndërmjetues te Perëndia.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit[11] pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier; atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës

Në Liti Idhiomele
Ting. I

Ndriçuesit të paperëndueshëm të planetit,[12] oshënar Athanasit, le t'i këndojmë, sepse feksi më shumë se dielli në qiellin e besimit, dhe udhëzoi me llamburitje drejt virtytit tërësitë e shpresëplotëve, nga njëra anë me mësimdhënie të hyjfrymëzuara dhe këshillime fjalësh shpëtimtare, që i buronte prej buzëve si rrëke tepër të bollshme; nga ana tjetër duke tërhequr drejt zellit me anën e veprimtarisë së çuditshme dhe me sjelljen e barabartë me atë të engjëjve,[13] si edhe duke i treguar perëndishëm të dyja, jetesën dhe fjalën e përmbishkëlqyer, si pedagog i mrekullueshëm. Me përgjërimet e tij, o Krisht Perëndia ynë, ruaje këtë grigjë dhe forcoje besën orthodhokse si njeridashës.

Ting. II Ton ión tis vrontís

Koret e etërve, le të mblidhemi ta lavdërojmë dashuruesin e Krishtit, sinonimin e pavdekësisë, mistin e vërtetë të Shpëtimtarit, lavdinë, krenarinë dhe udhëzuesin e të gjithë murgjve, të shenjtëruarin që foshnjë për Zotin; sepse, pasi u zu në të dashuria hyjnore, la mashtrimin e botës dhe ngriti mbi supe zgjedhën e Krishtit,[14] dhe zmbrapsi me burrëri hordhitë e demonëve, duke na treguar praktikisht rrugën e shkëlqyer të dashurisë hyjnore; se, meqë dhe ai e përshkoi të njëjtën udhë duke vrapuar me nxitim, arriti dritën e vërtetë të Trinisë gjithëbërëse. O çudi që shtang dhe gjë e hyjduhur! Sepse, ndonëse ishte tokësor në natyrë, u bë i barabartë me esenca mendore,[13] duke marrë nga Hyjnia lavdërim dhe nder[15] pa masë, dhe bëhet për ne ndërmjetues, që të arrijmë të mirat e amshuara në ditën e Gjyqit.

Ting. IV Eksélthete ethni

Arenat e tërëmrekullueshme të jetës sate në asketizëm habitën Mendje,

çuditën dhe vdekatarë; sepse, pothuaj si i pamish, kishe mundje në mish tokësor me armiq të padukshëm;[16] prandaj të psalin melodikisht të gjitha gjeneratat e besëmirëve, dhe kryesisht grigja jote e çmuar, përmendorja e shkëlqyer e lodhjeve të tua; atë e tregove si qytet të kënaqshëm në shkretëtirë, të cilën e bëre vendbanimin e hijshëm të turmës së murgjve; ajo zbukurohet, si me rroba të çmuara, me triumfet e tua të mrekullueshme dhe trime; dhe kërkon, o Athanas, që me anën e lutjeve dhe ndërmjetimeve të tua të ruhet prej Krishtit, që ka përdëllimin e madh.[17]

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Le të trumbetojmë me bori këngësh, sepse Hiri i Shpirtit më mirë se çdo trumbetë i thërret të gjithë së bashku për himnin e atit hyjprurës. Mbretër dhe arkondë, le ta admirojnë shërbyesin autentik të tërëmbretit, i cili me armatim Shpirti Hyjnor triumfoi[18] mbi autoritetet dhe pushtetet e botësunduesit.[16] O barinj dhe mësues, le ta lartësojmë kanunin dhe prototipin e pimantikës vërtet të shkëlqyer, të lartin në dogma, trimin në besë, mendjelartin në teori, atë që në praktikë është më sipër se retë, përroin e shijimit[19] në mësime, drejtuesin e atyre që humbën rrugën, mbështetësin e të lëkundurve, bashkëvuajtësin e tërë të sëmurëve;[20] lavdin e madh të Athosit, duke e mburrur të gjithë, le të themi: O atë Athanas, kurora e Etërve, përgjithmonë mbrona ne, shërbëtorët e tu, dhe shpëtoje grigjën tënde me përgjërimet e tua.

Tani *Hyjlindësore*

Le të trumbetojmë me bori këngësh, se, pasi u përkul nga lart[21] tërëmbretëresha, nëna e virgjër, i kurorëzon me bekime ata që e himnojnë. Mbretër dhe arkondë, le të rendin së bashku dhe le ta duartrokasin me himne mbretëreshën që lindi mbret, i cili deshi nga mirësia të çlironte si njeridashës të burgosurit më përpara prej vdekjes. O barinj dhe mësues, le të mblidhemi e le ta lartësojmë nënën e përmbidëlirë të bariut të mirë,[22] kandilin arndriçues,[23] renë dritëprurëse,[24] më të gjerën se qiejt, arkën[25] e gjallë, fronin me pamje zjarri të Zotit,[26] shtambën manaprurëse floriri,[27] portën e mbyllur[28] të Fjalës; përikjes së mbarë të krishterëve le t'i themi kështu duke e mburrur me këngë hyjfolëse: O pallat mbretëror i Fjalës, denjësona ne të përulurit për mbretërinë e qiejve,[29] sepse asgjë nuk është e pamundur me ndërmjetimin tënd.

Pasvargje
Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu, o oshënar Athanas,* se shoqërohesh tok me koret e engjëjve,* meqë praktikove jetën e tyre mbi dhé vërtet* përmes asketizmit; si u shfaqe ti* pasqyrë e pastër krejt* dhe pa njollë, kur prite pra* dhe vezullimin* rrezatues[30] nga Shenjti Shpirt,* o i pasur fort,* o shenjtor, kur po shndriteshe,* shihje të ardhshmet dhe i parathoshe të gjitha qart',* mistikërisht i ndriçuar prej paraqitjes hyjnore ti* nga Krishti; atë lyp,* që të jepet përdëllimi i madh[17] te shpirtrat tan'.

Varg: E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarit të tij.

G'zohu, u bëre ti kryetar* asketësh, mbrojtës i pamposhtur, se preve krejt* pasionet nga rrënja, o Athanas, edhe trimërisht* i durove vrullet e demonëve;* kështu triumfove mjaft* mbi mashtrimin e tyre, që* humb shpirtrat, teksa* shfaqe forcën që s'mposhtet dot* si dhe energjin',* që ka Kryqi që na shpëton;* sapo me të u ngjeshe,[31] fort fitove mbi sa mohojn'* dukjen hyjnore në mish të Jisuit Krisht; përgjëroju pra* që shpirtrave tanë* t'u dhurojë përdëllimin e madh[17] dhe ndjesën tok.

Varg: I lumur ai burrë që ka frikë Zotin.

Shtyllë virtytesh, që ngjan me drit',*[1] e siguruar, re me hije për Athosin,* për murgjit, u shfaqe, shkoje nga dheu drejt qiellit* mu përpara njerëzve[24] që shikonin lart* te Zoti, me Kryqin pra* si me shkop ndave det[32] vesesh,* me forc' e mposhte* Amalikun[33] mendor, prandaj* gjete pa pengim,* i hyjlum, ngjitje qielli* si dhe trashëgimi pa cen; dhe rri[34] me gëzim të madh* me të patrupët, me engjëjt tok pranë fronit të Krishtit Zot;*[35] atij përgjëroju* të dhurojë përdëllimin e madh[17] te shpirtrat tan'.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Bukurinë e Etërve, lavdinë e asketëve, kroin e mrekullive dhe ndërmjetuesin e paturpëruar pranë Perëndisë, o kremtimdashës, pasi të mblidhemi me nxitim, le ta himnojmë me lavdërime melodike, duke thënë: Gëzohu, o kanuni dhe karakteri i jetës murgjërore si dhe tip, kanun tepër i saktë; gëzohu, o ndriçues që shkëlqen larg, që si pishtar feks Gjithësinë me shkëlqimet e virtyteve; gëzohu, ngushëllimtari i madh i atyre që janë në vuajtje, dhe mbrojtësi i flaktë i atyre që janë në peripeci; ti pra, o Athanas, mos pusho së ndërmjetuari te Krishti Perëndi për këtë grigjën tënde dhe për të gjithë shpresëplotët që ndërojnë fjetjen tënde të respektueshme.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[36] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me oshënarin tënd dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Përlëshore
Ting. III Tin oreótita

Rreshtime engjëjsh lart* jetesa jote, at',* në mish, i shtangu fort,* si kreve pra me trup* luftime të padukshme dhe plagose hordhi demonësh;* o i tërëfamshmi shën* Athanas, të shpërbleu ty* Krishti plot me pasuri* dhurëtish; ndërmjeto për ne* te Krishti Perëndi, t'i shpëtojë* shpirtrat edhe t'i mëshirojë.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Ty që ndërmjetove për shpëtimin e gjindjes son', të përhimnojmë, o Hyjlindëse Virgjëreshë; se, duke denjuar pësimin e Kryqit me trupin që mori prej teje Biri yt dhe Perëndia ynë, na çliroi prej prishjes si njeridashës.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Pasi more përmbi sup* me zell ti kryqin zotëror,* oshënar shën Athanas,* përmes veprimi asketik,* me besë shkove pas Krishtit,[37] u bëre shembull* dhe kanun për murgjit e tërë pra,* që ushtrohen mirë, me thjeshtësi;* meqë tani fitove mbretëri lart* përmes arenash të hyjshme krejt,* lyp pa ndërprerje,* që të shpëtojnë* shpirtrat tanë përjetë.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Si profeti të thërres:* Mos hyr me mua në gjykim,*[38] sepse unë, Krisht, i di* fajet e mia, dhe ato* më akuzojnë, të them pra me zë të lartë:* Mua të padenjin, të poshtrin krejt,* Njeridashës, nëpërmjet lutjeve* të nënës sate lindëse më mëshiro* si të përdalën,[39] plangprishësin*[40] dhe doganierin,*[41] kusarin;[42] shpëton* shkelësit, jo të drejtët.[43]

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV Epefanis símeron

Të pëlqeu, oshënar,* ty Krishti përmes* punësh të hyjnueshme,* me sjellje fort të pastër, pra* u denjë-

sove, o Athanas,* për trashëgim të patrupësh, i urti shenjt.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Mbrojtje që s'luftohet je* për nevojtarët,* ndërmjetim i gatshëm pra* për sa besim kanë te ti,* prej çdo rreziku çliromë shpejt,* mos më shpërfill, se je ndihmë për gjithë ne.

Kanunet
Ode I
Kanuni i shën Athanasit që ka Akrostihidhë: "Duke himnuar Athanasin, do të lavdëroj virtyt. Amin".
Ting. Tërth. IV
Irmosi: Armatilátin Faraó

»**Q**ëmoti e përmbyti Faraonin me ka»rrocat çuditërisht* shkopi moisiak,* »kur në formë kryqi e goditi detin që »u nda;* Izraelin që ikte më këmbë, »ky e shpëtoi krejt,* ndaj një këngë »psalte për Perëndin'.[43a]

Si sinonim pavdekësinë kishe ende kur jetoje, o shën* Athanas, u shfaqe* pjesëmarrës në pavdekësinë e vërtetë ti,* sapo nga të përkohshmet pra ike; si pranë Krishtit rri,* ne që të kujtojmë, kujtona, at'.

O oshënar, që nga fëmijëria ishe besëmirë, besnik;* për fitim virtytesh,* s'të pengoi dot privimi keq i prindërve, prandaj* tërësisht çdo dëshirë dhe mall e ktheve drejt Bërësit,* është ky i vetmi ndërtues Zot.

Po marr guxim të të këndoj himnim me buzë të papastra, sepse* më pushtoi malli,* dashuria jote, dhe më mban në pranga; por, o at',* falmë mua, dhe jepmë të të ofroj këtë lavdërim* siç e meriton, oshënari im.

Hyjlindësore

Vajzë, mbi mendje linde bir të ri, të vjetrin krejt të ditëve,*[44] që në dhé tregonte* udhë krejt të reja për virtyt, pra shërbëtori yt* emërmadh Athanas, i plagosur prej dashuris' së tij,* e ndërtoi për ty këtë shtëpi.

Kanuni i shën Llambadhit
Ting. II Dhefte laí

Bëj, oshënar,* lutje të shumta, me to më vadit* dhe furnizoje llambën time[45] shpirtërore, atë Llambadh shenjt hyjprurës,* dhe frymëzoje fjalën time, të të himnoj.

Ngrite mbi sup* kryqin tënd dhe vrave mishin tënd[46] ti,* dhe shkove pas atij,[37] o atë, që vullnetarisht kryqëzimin duroi*[47] për ty, o oshënar i madh, dritëprurës je.

Mundje, luftim* kundër keqbërësit bëje, o at',* me asketizëm, duke thi-

rrur fuqizim nga lart,[48] e përule atë pra;* kurorën e fitores thure me çdo lavdi.

Hyjlindësore

Kush ka fuqi* që denjësisht zënien tënde mbi fjal'* të na rrëfejë, o e Tërëshenjt', se linde Zot që në mish na u shfaq qart',*[49] Jisuin, Shpëtimtarin pra të të gjithëve.[50]

Zbritësore: Anikso to stoma mu

Ja gojën e çel tani *(shih fq. 12)*

Ode III
Kanuni i shën Athanasit
Irmosi: O stereosas kat' arhás

»Ti që formove në fillim* me mençuri »dhe mend qiejt,* [50a] dhe mbi ujëra »bazove fort dheun,*[50b] më mbështet »mbi gurin,[50c] Krisht, të porosive që na »dhe,* o njeridashës, sepse* veç teje »tjetër të shenjtë s'ka.[50d]

U kape që fëmijë ti* prej dashurisë së Zotit;* mblidhje bashkëmoshatarët e tu pra* dhe i bëje shpirtërisht si kor, i sistemoje drejt,* me urtësi i nxirrje* nga çdo zakon, at', fëmijëror.

Nga dashuria për urti* fort i goditur,[51] arrin ti* në qytetin e lum të Konstandinit* dhe, porsi bletar dhe bletë, mbledh[52] të lartat nga çdo gjë,* nga fjalët, duke lënë* gjërat pa vlerë, hyjmendës at'.

Anijen tënde, shpirtin tënd,* i lum, me Kryqin si velë* e drejtove me sukses, lehtësisht ti* dhe arrite të lundrosh dhe të përshkosh të frikshmin det,* dallgët e jetës, kështu* në port të shenjtë, të qet' dole.

Hyjlindësore

Ai që para jetëve* prej Atit lindi pashprehshëm,* më në fund nga barku yt doli, nënë* Virgjëreshë, dhe ma hyjnizoi pra natyrën krejt* dhe mblodhi bashkësitë* e oshënarëve madhërisht.

Kanuni i shën Llambadhit:
Si to logo su Kírie

Duke u qetësuar në male dhe duke u fshehur në shpella, more hir hyjnor, o i lumuri hyjmendës.

Duke u lartësuar me anën e përulësisë dhe duke u bërë me krahë përmes dashurisë, u shpërngule drejt prehjes mendore, o atë.

O ati ynë hyjprurës, bashkëjetove me vetëpërmbajtje, prandaj u arratise nga ligësia e armikut.

Hyjlindësore

Lypim që të çlirosh nga çdo kërcënim ata që përikin te ti, që linde Krishtin, Perëndinë tonë.

Zbritësore: Tus sus imnologus

O Zonjë dhe nën' e Perëndisë

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV Tin sofian që Logon

Le të gjitha të prishshmet, kënaqësit'* që ka jeta, kur ende ishe i ri,* dhe shkove gatishmërisht* pas atij që të ftonte ty,* o oshënar; dhe, siç e dëgjove, në supin tënd,* o atë, more kryqin,[37] dhe trete me agjërim* trupin tënd, ndaj mirë të tregon qart' bariun* e deleve që i ka* Krishti,[53] Zoti i tërëmir',* Athanas shenjt* dhe oshënar;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Urtësinë[54] dhe Fjalën e zure ti* brenda barkut pa farë, pa djegie krejt;* e linde për rruzullin* sundimtarin e Gjithësis';* mban në pëqi atë që në dorë çdo gjë e mban,*[55] pra Krijimtarin[55a] si dhe ushqyesin botëror;*[55b] ndaj, e Tërëshenjta Virgjëreshë, të lutem,* kur unë do rri kundrejt* faqes së Krijimtarit[56] tim,* të shpëtohem* nga çdo mëkat;* Zonj' e pastër dhe virgjëresh',* atëher' ndihmë dhe mbrojtje* ti më dhuro,* sepse, o e himnuar, mundesh të bësh sa do.[57]

Ode IV
Kanuni i shën Athanasit
Irmosi: Si mu iskís Kírie

»**T**i je, o Zot,* forca për mua, fuqia »je,* ngazëllimi* si dhe Perëndia im, »ti që s'e le* gjirin atëror*[57a] dhe e vi»zitove mjerimin ton';[57b] ndaj thërras »te ti* së bashku me profetin* Aba»kum: Njeridashës,* lavd pushtetit, »fuqis' sate, Zoti im.

Duke e bërë mendjen sundues të pasioneve[58] dhe duke u udhëzuar me punë të perëndishme, përshkove ti rrugën e mirë,[59] dhe mposhte besërisht intrigat dhe pusitë e demonëve, duke zgjedhur më të mirën si i mençur.

Pasi u vure nën zgjedhën e lehtë të Zotit,[14] i formuar me frikën e hyjshme, dhe si u pastrove në trup dhe në shpirt, u bëre bazë dëlirësie dhe mençurie, majë vetëpërmbajtjeje, vulë papasionshmërie dhe ikonë dashurie, o Athanas.

Meqë kungove me arsimin tonë dhe me të jashtmin, me plot filozofi e ndave të përshtatshmen dhe të dobishmen e secilit, duke u fortifikuar me drejtësi, urtësi, përulësi, mençuri dhe

burrëri,[60] dhe duke u dalluar në karizmat e tjera.

Hyjlindësore

Zoti i hipur frikshëm në shpina keruvike si në fron[61] të zjarrtë, banoi në mitrën tënde, o e Dëlirë, dhe me marrje mishi hyjnizoi esencën njerëzore, siç na mëson i lavdëruari ndër oshënarë, Athanasi, o e vetmja e tërëhimnuar.

Kanuni i shën Llambadhit:
Isakíkoa Kírie

Duke u bërë erëmirë më Krishtin[62] me anën e virtyteve të tua të hyjshme, buron miro shërimesh, o i hyjfrymëzuar.

Duke u fshehur për shumë vjet, o i fortlumur, shfaqesh prej Perëndisë për lavdinë e tij.[63]

Duke pasur tani sarkofagun e lipsaneve të tua, o Llambadh, nxjerrim shërimet prej tij, duke të mburrur.

Hyjlindësore

Të përgjërohemi, o e pacenuar, ty që zure Perëndinë pa farë, që të ndërmjetosh gjithmonë për shërbëtorët e tu.

Zbritësore: Tin aneksihníaston

Të pagjurmësuarin

Ode V
Kanuni i shën Athanasit
Irmosi: Ina ti me aposo

»Pse, o Zot, më ke zmbrapsur* nga »fytyra jote,[63a] o shkëlqim pa perë»ndim,* edhe u mbulova* un' i mjeri »prej territ të huaj krejt,* por, të lyp, »drejt dritës së porosive[63b] që the, »kthemë* edhe udhët e mia drejtoji »ti.[63c]

U duke si magnet, duke tërhequr me ëmbëlsinë e fjalëve të tua drejt mësimdhënies dhe dëgjimit të këshillimeve ata që dëshironin përgjithnjë të shikonin dhe të soditnin fytyrën tënde të nderuar dhe të hijshme.

Duke iu bindur ligjeve hyjnore dhe urdhërimeve të Bërësit, u shfaqe ligjvënës murgjish, kanun tepër i përpiktë, trajner të pamendësh, drejtues të humburish dhe ndriçues i atyre që ishin në errësirë,[64] o i kënduar.

Duke qenë model i virtyteve dhe enë e karizmave të Shpirtit të Shenjtë,[65] ndërtove punishten e hyjshme dhe të hijshme, duke ekspozuar çdo jetesë dhe sjellje që u përshtatet murgjve.

Hyjlindësore

Asnjë gojë që ligjëron, nuk mundet të të psalë siç të ka hije, o e Tërëhimnuar, sepse je më e lartë se Keruvimet

dhe se çdo krijesë; prandaj së bashku me Athanasin e hyjshëm lyp nxehtësisht Zotin për të gjithë ne.

Kanuni i shën Llambadhit:
O tu fotós horigós

I ndezur si llambadhe përherë me vezullime hyjnore, fekse dritë të shkëlqyer terapish, duke i ndriçuar besimtarët që lavdërojnë këtë kujtimin tënd, o oshënar.

Duke treguar punë sipas emrit tënd, u bëre llambadhe e ndezur prej zjarrit hyjnor të Shpirtit, e cila djeg lëndën e mëkatit.

O oshënar, gufon miro kundërmuese nga thesaret e pashteruara, nga burimet hyjnore, duke flakur çdo erë të keqe të pasioneve, për lavdinë e Perëndisë[63] sonë.

Hyjlindësore

Të thërresim ty, që linde Krishtin, Krijuesin e të gjithave:[66] Gëzohu, o e Dëlirë; gëzohu, ti që na linde dritën;[67] gëzohu, ti që mbajte Perëndinë e panxënshëm.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI
Kanuni i shën Athanasit
Irmosi: Ilásthití mi Sotír

»Jan' shum' mëkatet që kam,* ndaj »le të të vijë keq, o Zot, për mua; lu»tem, më nxirr* nga fundi i vrereve, »sepse thirra fort te ti*[67a] dhe dëgjomë »mua,* Perëndia i shpëtimit tim.[67b]

U vra dëshira në mish* me lodhjet e tua,[46] dhe e kryqëzove veten, o at',* për botën[68] dhe veset; rrije pran' Perëndisë ti*[34] me himnim pareshtur,* lot dhe kreshmë, lutje, përkushtim.

Ke qenë ti kryetar* në Malin e Athosit për murgjit dhe model, karakter* për punë virtyti; ndaj stolise kështu atje* gjithë manastiret,* vendet e të pamartuarve.

I ëmbël ishe, i drejt,'* i mirë, i butë dhe i dhembshur, i përulur, me hir* në sjellje, plot simpati, edhe imitoje ti* Krishtin në moral pra,* përdëllyes, i afrueshëm.

Hyjlindësore

U duke si Moisi* i ri, edhe bëre si një tjetër tendë[69] madrën, o at'* i tërënderuar; si e shumëfishove ti* përmes lodhjes, djersës,* ia kushtove nënës së Zotit.

Kanuni i shën Llambadhit:
En aviso ptesmaton

Kur përshkove shtrëngatën e jetës ti,* i drejtuar, at', me flladet që nga Shenjti Shpirt,* arrite në limane[70] lart,* ku ka prehje të plot', oshënar me nam.

Prototipi i murgjve u bëre ti,* veset që ka trupi, oshënar, i thaje krejt* në qetësi, prandaj shkretin'* e Ilias[71] e shfaqe si pikturim.

Thellësia e lotëve, o shenjtor,* për të tër' demonët shkatërrim u bë, i lum,* i gjithëpasur dhe ndriçim,* pra për grigjën që përherë të nderon.

Hyjlindësore

Ti në bark mbajte Fjalën e dhembshur fort,* që çliroi njerëzit me gjakun krejt të tij* nga prishja, ndaj më denjëso* për mëshirën edhe përdëllimin tënd.

Zbritësore: Tin thian taftin

Këtë të kremte e lusim sot

Kontaqi
Ting. Tërth. IV Ti ipermaho

Si spektatorit të shkëlqyer të esencave* që s'kanë lëndë* dhe mësuesit praktik vërtet,* të thërret ty grigja jote, o shenjt hyjfolës:* Lutu pa pushim te Zoti, të çlirohemi* nga çdo ngasje dhe peripeci ne që me zë* ty të themi pra:* G'zohu, o atë Athanas.

Shtëpia

Kur more nga lart paradoksalisht thirrjen tënde, trashëgove jetë të pavdekshme, sepse, pasi kalove mbi dhé me trup jetë të patrupësh, u bëre i pamposhtur nga pasionet; prandaj të mburrim, o atë:
Gëzohu, o lavdia e hijshme e murgjve; gëzohu, o përmendore e shkëlqyer mençurie.
Gëzohu, o tipari i qartë i burrërisë; gëzohu, o shenjë e mençurisë së tërurtë.
Gëzohu, o kanun i barabartë drejtësie të saktë; gëzohu, ti që me mendje rregullove vrullet e punëve të tua të duhura.
Gëzohu, o mendje që shijon mendime të parrëfyeshme; gëzohu, ti që studiove besërisht mbarë Krijesën.
Gëzohu, ti përmes të cilit u turpëruan demonët; gëzohu, ti me anën e të cilit çdo pasion u vra.[46]
Gëzohu, o liman i atyre që janë në shtrëngatën e jetës; gëzohu, o shpëtimtar i atyre që të thërrasin me besë: G'zohu, o atë Athanas.

Sinaksari

Më 5 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë oshënar dhe hyjprurës Athanasi në Athos.

Vargje: Është i madh Andoni, fillim i etërve,/ ndërsa Athanasi i hyjshëm, fund i perëndishëm.
Ndonëse ishte i fundit në kohëra,/ Athanasi i tejkaloi edhe të vjetrit në mundime.
Athanasit dhe gjashtëshes së nxënësve/ u zgjidhen kisha trupash me zgjidhje kishe.[72]
Dhe në të pestën, Mendje drejtonin Athanasin në qytet Perëndie.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Llambadhi.
Vargje: Duke vaditur me vaj llambën,/ Llambadhi ishte gati kur u afrua Dhëndri.[45]

Neomartiri i shenjtë oshënar Qipriani, që u martirizua në Konstandinopojë në vitin 1679, mbaron me shpatë.
Vargje: Qipriani, i flakëruar nga dashuria,/ i konsideronte pa dyshim torturat si shijime.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Kanuni i shën Athanasit
Irmosi: Theú sigatávasin

»Dikur zjarri kishte turp* në Babi»lonë, kur bashkëzbriti pra Zot*[72a] »brenda furrës; ndaj Djemtë,* si në »lëndinë, me këmb' të lumura fort* »kërcenin pra duke psalur: O Perëndi* »dhe Zot i etërve tanë, i bekuar je ti.[72b]

Pothuaj në tërë Krijesën rendi zëri[73] i sjelljes sate dhe i sukseseve të tua, o atë, dhe arrite në lartësi të famshme; sepse Perëndia të lavdëroi[74] dhe të bëri të dëgjuar te të gjithë.

O atë, duke imituar mësuesin tënd, u bëre furnitor i të varfërve, mbrojtës i vejushave, kujdestar i jetimëve, ngushëllim i shpejtë i të trishtuarve, liman i të rrezikuarve, përkrahje e të padrejtësuarve.[75]

Duke të ditur si yll mbarëbotëror, ndriçues[12] të paperëndueshëm murgjish, ndihmëtar në nevoja,[76] përikje të madhe mëkatarësh, të vë përpara ty, o i tërënderuar, si ndërmjetës dhe ndërhyrës te Zoti Krisht.

Hyjlindësore

Shërbyesi yt, ngaqë donte të shikonte lavdinë e parrëfyeshme të Birit tënd dhe Perëndisë,[77] o Hyjnënë, pasi mori kryqin e tij[37] të çmuar, shkoi pas gjurmëve të tij[78] jetëprurëse dhe hyjnore.

Kanuni i shën Llambadhit:
O tin káminon pale

Kur shove krejtësisht kaminat përvëluese të pasioneve me vesën e

vetëpërmbajtjes, o i lumur, thërrisje: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[79]

Me llambadhet dritërrezatuese të dhuntive që janë brenda teje, shkëlqen zemrat e atyre që këndojnë besërisht: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[79]

I përulur në zemër, i lartë në sjellje dhe në çudi u tregove, o atë, duke kënduar: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[79]

Hyjlindësore

Ti që banove në mitër dhe linde prej Virgjëreshe, ti që plaçkove Hadhin dhe i ndriçove kombet, i bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[79]

Zbritësore: Uk elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII
Kanuni i shën Athanasit
Irmosi: Eptaplasios káminon

»E dogji furrën shtatë her'* në Kalde »një tiran i saj* me mani për Djemtë* »që nderonin Perëndin';*[79a] por, kur »të shpëtuar krejt* i pa nga një fuqi »më e fort',* thirri ky kështu:*[79b] Po »Çlirimtarin Ndërtues,* o Djem, ju ta »bekoni;*[79c] priftërinj, ta himnoni;*[79d] »ju popull, lartësojeni pra për gjithë »jetët.

Duke triumfuar si një i ri kundër autoriteteve dhe pushteteve të errësirës,[16] o Athanas, u bëre mësues tepër i madh dhe udhëzues shpëtimtar, duke zbuluar komplotet, kurthet dhe djallëzitë e tyre, dhe duke ruajtur grigjën tënde pa fatkeqësi nga çdo krim i demonëve.

Edhe pse lëvizje mbi tokë si njeri, e kishe vendin me të vërtetë në qiej,[80] meqenëse u duke i barabartë me engjëj[13] në jetesë, dhe zbatoje sjelljen e tyre; tok me ta tani këndon: O priftërinj, bekojeni;[79d] popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Sot u mblodhëm që të të mburrim, siç të ka hije, dhe të nderojmë arkivolin e lipsaneve të tua, duke kërkuar çlirim pasionesh, ndjesë mëkatesh, zgjidhje nga çdo fatkeqësi dhe peripeci, përmes uratave të tua; dhe kremtojmë besërisht dhe me ngazëllim kujtimin tënd përjetë.

Hyjlindësore

Sikurse më përpara Ilia banoi në Karmel,[81] kështu edhe ti vetë dëshiroje të rrije në Malin e Athosit, që, duke qetësuar veten, të ishe tok me Perëndinë;[82] dhe, meqenëse shkël-

qeve me pamje të perëndishme, u dallove shërbëtor i Hyjlindëses së qashtër, duke i thirrur "Gëzohu" së bashku me kryeengjëllin.[83]

Kanuni i shën Llambadhit:
Ton en kamino tu pirós

Me zbulime të frikshme dhe shenja të trembshme u njohe tek ata që nuk dinin, o atë hyjmendës; dhe megjithëse u fshehe për shumë vjet, u shfaqe duke na buruar miro shërimesh, o i tërëlumur.

I ujitur nga burimet e shpëtimit,[84] na gufon hir të pashterur, o i lumur, dhe na shpëton nga rreziqet, pësimet dhe trishtimet ne që kremtojmë kujtimin tënd të shenjtë.

Me mendje të pastër u solle mbi tokë si engjëll dhe u bashkove me engjëj kur u çlirove nga mishi, duke thirrur: Himnojeni njeridashësin dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Të vetëmlindurin që lindi perëndishëm para jetëve nga Ati[11] dhe në fund në mish prej Virgjëreshës, himnojeni, o vepra, si Zot dhe përmbilartësojeni në jetë.[85]

Zbritësore: Pedhas evajís

Djemat e dënuar

Ode IX
Kanuni i shën Athanasit
Irmosi: Eksesti epí tuto

»U shtang dhe u shastis qielli me »të,*[85a] u habitën dhe anët e bo»tës mbar', se Perëndi* trupërisht u »duk[85b] te të vdekshmit ne* dhe, Zo»një, barku yt u bë* më i gjerë se qiejt, »se çdo vend;* Hyjlindëse e Virgjër,* »rreshtimi engjëllor si* dhe njerëzor »të madhështojnë ty.

Si kreve mençuri dhe dëlirësi,* sjellje autentike jetese ti me pastërti* si pa mish mbi dhé, drejt banesës lart* në qiell rende dhe ke gaz* tok me oshënarët e tërë pra* dhe bashkë me të drejtët;* i përgjërohesh Krishtit* për ne të gjithë, atë Athanas.

Meqë e madhështove mbi tokë shum'* Zotin tënd dhe përmes teorisë dhe veprimtaris'* e lëvdove mjaft në gjymtyrë[86] ti,* zëmadh u shfaqe, dhe kudo,* o hyjprurës, je bërë dritëplot',* sepse di dhe armiku* vërtet ta respektojë* virtytin edhe ta nderojë pra.

U numërove tok me kor, oshënar,* me ushtritë pa trup u bashkove ti, edhe kërcen* bashkë me të zgjedhurit mbarë, se* kungove hyjnizim vërtet,* jetë të pavdekshme, o Athanas;* me ta, me shenjtët, atë,* pra pa ndër-

prerje lypi* për grigjën tënde Krishtit, Zotit tënd.

Hyjlindësore

Meqë je, Zonjë, tempull me shenjtërim,* sepse një nga Trinia e mbajte ti, ngriti një kish'* edhe manastir të pacen, të thjesht'* për lavdin edhe nderin tënd* shërbëtori yt, Athanasi shenjt;* në të, me ndërmjetimet* e tua pa ndërprerje,* dhuroje aleancën tënde pra.

Kanuni i shën Llambadhit:
Ton ek Theú Theón Logon

Ai që lindi për ne prej Virgjëreshës në shpellë,* o shën Llambadh hyjprurës, na zbulon* neve besnikëve brenda në shpell',* ku ish fshehur fort hyjshëm, me drit' llambadhesh nga i Shenjti Shpirt* pra kutinë e shenjt' të lipsaneve, që jep shërim.

Me asketizëm garove, duke kryer sakt' ndeshjen,*[59] hyjprurës shën Llambadh i tërëlum,* si shkele kurthet e djallit armik* dhe, o atë, drejt rrugës së qiellit na udhëzon pra ne;* të nderojmë me mall, se nga prishja na çliron gjithnjë.

Hyjlindësore

Kursemë, o Zot,[87] kursemë, kur të vish për gjykim ti,* mos më dëno në zjarr, mos më qorto* në zemërimin tënd;[88] ty pra të lyp* Virgjëresha, o Krisht, që të kish në bark dhe kore engjëjsh lart* dhe së bashku rreshtime shenjtorësh, oshënarësh tok.

Zbritësore: Apas jijenís

Gjithë njerëzit

Dërgimësore
Ton mathitón oronton se

O Athanas, nga vendet lindore linde* porsi ndriçues fort i shkëlqyer, fekse* vend perëndimor me vezullim që kish* tërë virtyti yt me hir;* mos i pusho ndërmjetimet* drejt Zotit tonë për botën.

Hyjlindësore

O tërëmbretëreshë e tërëmirë,* siç lutet Athanasi yt fort i çmuar,* pra pa dëme grigjën tënde ruaje* nga çdo sulm dhe çdo kundërshtim;* kjo përgjithnjë të himnon ty,* si mbrojtjen e gjithë botës.

Lavdërime
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

Vdekja, Krisht, e oshënarit tënd është e çmuar vërtet* para teje;[89] nga këmba ja* shërbëtori yt gufon* dhe pas vdekjes, porsi burim,* gjak që së-

mundje të ndryshme larg i flak* si dhe i shporr frymët e dinakëris',*[16] kundër të cilave,* kur jetonte ende, kish luftuar fort,* madje gjer në gjak,[90] prandaj* dhe doli fitimtar.

(2x)

Zoti u tregoi njerëzve, o Athanas fort i lum,* si burim mrekullish dhe lum'* me dhurata varrin tënd,* që lipsanin tënd brenda mban;* dhuroi ky te të verbrit plot shikim,* lebrën e rëndë pastroi, dha çlirim* te rob'rit nën pushtet* frymësh të papastra, dhe iu dha logjik',* ekuilibër, mençuri,*[91] o i tërurti shenjt.

Ki gëzim, lavd i asketëve, o yll i murgjve, shkëlqim,* krenari për barinjtë ti,* atë Athanas; në tend'* bashkë me oshënarët je;* ki gaz, burim, gurr' e dashurisë pra,* e mençurisë, banesë e Trinis';*[92] ki gaz kandil, ndriçim* dallueshmërie dhe kanun i drejt'* për virtyt, o përmendore, prototip i gjall'.

Lavdi

Ting. Tërth. II Hristú ton ierarhin

Le ta lavdërojmë të gjithë sinonimin e pavdekësisë, i cili asketizoi me burrëri dhe me trimëri në Athos; dhe mblodhi këtë grigjë, dhe me mall ngriti shtëpi për Zotin dhe ia dedikoi Nënës së Perëndisë; tek ajo ndërmjeton për ne që me besë kremtojmë kujtimin e tij.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[36] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me oshënarin tënd dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji Tipiket dhe Odet III dhe VI e shën Athanasit. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Apostull oshënari (E shtuna e javës 27: Gal. 5.22-6.2). Gjithashtu Ungjill oshënari (E enjtja e javës 4 Matth: 11.27-30). Kungatore* Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] Eks. 13.21-22; 19.9; Ligji i Dytë 31.15; Urt. Sol. 18.3
[2] Matth. 5.15; Mark 4.21; Lluk. 8.16; 11.33
[3] Vep. 17.25
[4] Matth. 25.15-18
[5] Hebr. 4.12
[6] Rom. 8.6-7
[7] I Kor. 12.4
[8] Matth. 13.44
[9] Joan 4.48; Vep. 2.19,22,43; 4.30; 5.12; 6.8; 7.36; 14.3; 15.12; Rom. 15.19; II Kor. 12.12; Hebr. 2.4
[10] I Kor. 6.17
[11] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[12] Fil. 2.15

[13] Lluk. 20.36
[14] Matth. 11.29
[15] Rom. 2.6-7,10
[16] Ef. 6.12
[17] Num. 14.19 etj.
[18] Ef. 6.11,13
[19] Ps. 35(36).9
[20] II Kor. 11.29
[21] Ps. 101(102).20; Këngа 6.10
[22] Joan 10.11-14
[23] Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 8.2; Hebr. 9.2
[24] Eks. 13.21-22; 14.24; 16.10; 19.9; 34.5; Num. 9.15; 11.25; Ligji i Dytë 31.15; Urt. Sol. 18.3; Is. 19.1
[25] Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; II Kron. 6.41; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
[26] Jez. 1.13-26
[27] Eks. 16.33; Hebr. 9.4
[28] Jez. 44.1-4
[29] Matth. 3.2 etj.
[30] Urt. Sol. 7.26
[31] Ps. 92(93).1
[32] Eks 14.21 etj.
[33] Eks. 17.10-13
[34] III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
[35] II Kron. 18.18; Dan. 7.10
[36] Joan 15.1
[37] Matth. 16.24; Mark 8.34; 10.21; Lluk. 9.23; 14.27
[38] Ps. 142(143).2
[39] Lluk. 7.48-50
[40] Lluk. 15.22-24
[41] Lluk. 18.14
[42] Lluk. 23.42-43
[43] Matth. 9.13; Mark 2.17; Lluk. 5.32
[43a] Eks. 14.15-15.21
[44] Dan. 7.9-22
[45] Matth. 25.1-8
[46] Gal. 5.24; Kol. 3.5
[47] Joan 10.15-18
[48] Sirak 17.32; Lluk. 24.49
[49] I Tim. 3.16
[50] I Tim. 4.10
[50a] Ps.32(33).6
[50b] Ps. 135(136).6
[50c] Ps. 39(40).3
[50d] I Mbret. [Sam.] 2.2
[51] Fja. Urt. 8.17; Urt. Sol. 8.2
[52] Fja. Urt. 6.8a-8c
[53] Joan 21.15-17
[54] I Kor. 1.24,30
[55] Hebr. 1.3
[55a] Heb. 1.2
[55b] Ps. 110(111).5 etj.
[56] Rom. 14.10
[57] Urt. Sol. 12.18; Mark 1.40
[57a] Joan 1.18
[57b] II Kor. 8.9
[58] Ps. 50(51).14; IV Makk. 1.7,13,30; 16.1
[59] II Tim. 4.7
[60] Urt. Sol. 8.7; IV Makk. 1.6,18
[61] Jez. 10.1
[62] II Kor. 2.15
[63] Rom. 15.7; II Kor. 4.15; Fil. 1.11; 2.11
[63a] Ps. 42(43).2; 73(74).1
[63b] Fja. Urt. 6.23
[63c] Ps. 5.9; 118(119).5
[64] Rom. 2.19-20
[65] I Kor. 12.4-11
[66] Joan 1.3
[67] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[67a] Jona 2.2
[67b] I Kron.16.35; Ps.17(18).47; 50(51).14; 87(88).2
[68] Gal. 6.14
[69] Eks. 33.7 etj.
[70] Ps. 106(107).29-30
[71] III [I] Mbret. 19.4-8
[72] Joan 2.19-21
[72a] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
[72b] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2.27-28
[73] Ps. 18(19).5

[74] Joan 13.32
[75] Jov 29.12-13; 31.17,21
[76] Ps. 45(46).2
[77] Eks. 33.18; Ligji i Dytë 5.24
[78] I Petr. 2.21
[79] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[79a] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 19-22
[79b] Dan. 3.31-33
[79c] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,27-28
[79d] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[80] Fil. 3.20
[81] III [I] Mbret. 18.42
[82] Matth. 17.4; Mark 9.5; Lluk. 9.33
[83] Lluk. 1.28
[84] Is. 12.3
[85] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[85a] Jer. 2.12
[85b] I Tim. 3.16; Kol. 2.9
[86] I Kor. 6.20
[87] Neh. 13.27
[88] Ps. 37(38).2
[89] Ps. 115(116).6
[90] Hebr. 12.4
[91] Mark 5.15; Lluk. 8.35
[92] Joan 14.23

MË 7 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i shën Thomait në Maleó dhe i martires së shenjtë Kiriakia.

Tipikon

Nëse bie të dielën, shërbesa e oshënarit lihet, pra të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të martires. Lavdi i martires. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i martires. Tani Hyjlindësore ngjallësore (në Tingullin e Lavdisë, si zakonisht, pra)* Zoti Krisht, bërësi. *Përlëshoret: ngjallësore, e martires dhe Hyjlindësorja ngjallësore (në Tingullin e Përlëshores së mëparshme, si zakonisht, pra)* Misteri i fshehur.

Të dielën, në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i martires. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e martires, dhe Ndenjësoret e saj. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore, e martires dhe Hyjlindësorja e saj (e shën Parashqevisë, sipas Jineqes akutísthite:* Martire bukurvirgjëresh',* me forc' nga Kryqi zotëror* u përforcove si trime* dhe arrogancë tiranësh* munde, o Kiriaki, në gar';* more pra çmim fitoreje,* ti fort e admirueshme* dhe e tërurtë prej Krishtit;* lyp për sa me mall të mburrin. *Hyjlindësore:* E arta temjanic', Mari,* e pastër krejt, u bëre ti* en' e Trinisë që s'mbahet;* ishe pëlqyer nga Ati,* Biri fushoi fill në ty,* ndërsa Shpirti i Tërëshenjt'* me përmbiardhjen përmbi ty,* o Zonjë, ty të tregoi,* Perëndilindëse plot lavd). *Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të martires (e shën Parashqevisë:* Je në avllitë e Zotit *etj. shih fq. 218). Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e martires. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e martires dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Apostulli i martires dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore e së dielës.*

NË MBRËMËSORE

Thirrtore të shenjtorit
Ting. I Ton uranion tagmaton

Të njohëm si një ndriçues të hyjshkëlqyer ty* që feks, o atë, botën;*[1] përmes rrezesh mendore,* terrin e trazirës, dinakërin'* e demonëve pa-

këson;* kujtimin tënd dritëprurës pra besërisht* e kremtojmë, o i lumi shenjt.

Nga nisja ishe në jetë me pasuri, pushtet,* i shquar, por e veshe* skimën e murgjërisë* me oshënarí, o atë Thoma;* imitove pra varfërin'* e Krishtit[2] të mishëruar për ne, ndaj ky* me dhunti të pasuroi fort.

Me shtyllë zjarri dhe dukshëm të ka drejtuar ty,* o atë, Perëndia*[3] në liman qetësie,* gji me papasionshmëri, në shpëtim;* lutja jote buroi uj',* u fali dritë të verbërve, dha shërim* te të çalët, që të ecin drejt.

Të shenjtores
Ting. II Ote ek tu ksilu se

Rrije* para podiumeve,* edhe predikoje, dëshmore dhe athlofore, me forc'* Krishtin që denjoi kryqëzimin vullnetarisht;*[4] si u vure në pranga e në gjithë torturat,* rende lart te qielloret me gëzim, hare,* dhe u numërove me koret* martirike që nga fillimi,* dhe shijon lavdinë e përjetshme[5] ti.

Nuse* e përzgjedhur ti vërtet* u tregove, o Kiriaki, pra për Dhëndrin Fjal' që mbi dhé* është shfaqur; shndriteshe me bukuri veprash,* siç do Zoti, me lavd, hir atletizmi të hyjshëm;* ndaj në dhomë qiellore ke banuar lart,* ku, duke kërcyer përherë* si martire dhe virgjëreshë,* na kujto të gjithë ne që të kujtojm'.

Dole* degë kaq e bukur ti* që nga rrënja mjaft e lavdishme[6] dhe solle, o Kiriaki,* fryt shpëtimi, pra arritjet në atletizim;* në Hir vyshke krejt bimët, shkurret e ateizmit,* ndaj me mall nderojm' kujtimin tënd të hyjshëm mjaft* dhe tani kutin' e lipsanit* po e përqafojmë dhe hirin* e shërimeve e marrim ne prej saj.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Nga e djathta e Shpëtimtarit qëndroi virgjëresha, athlofore dhe martire, e veshur me pamposhtmëri, falë virtyteve, e stolisur[7] me vajin e dëlirësisë dhe me gjakun e atletizimit; dhe i thërriste duke mbajtur me ngazëllim llambën:[8] "Në erën e miros sate vrapova,[9] o Krisht Perëndi, sepse u plagosa prej dashurisë sate unë;[10] mos më nda, o Dhëndër përmbiqiellor". Me përgjërimet e saj dërgona nga lart mëshirat e tua, o Shpëtimtar i tërëfuqishëm.

Tani *Hyjlindësore*
Triímeros anestis Hristé

E virgjër e himnuar fort,* fuqi armiqsh ti mposhte krejt,* kriminelë* dhe mjeranë jan' ata;* ktheje në gaz trishti-

min e popullit tënd, jepna* mëshir', që të shpëtuar të psalim.

ose Kryqhyjlindësore

Kur shihte lart të varur në dru* Hyjlindësja, që s'kish qortim,* jetën tonë,*[11] po thërriste me vajtim* si nënë: O im Bir edhe Perëndia im Zot,* shpëtoji sa të përhimnojn' me mall.

Pasvargjet e Oktoihut

Lavdi *Ting. II*

Në qytetin e Perëndisë sonë, në malin e tij të shenjtë,[12] atje fushoi shenjtorja, pasi ruajti të pafikur llambën.[8] Le ta dëgjojmë mburrjen e virgjëreshës: O virgjëri, tempull Perëndie! O virgjëri, lavdi martirësh! O virgjëri, shoqëruese engjëjsh![13]

Tani *Hyjlindësore*

Gjith' shpresën time e besoj te ti, o nën' e Perëndisë, ruajmë nën strehën tënde.

ose Kryqhyjlindësore
Ote ek tu ksilu se

Vajzë,* po lotoje me vajtim* dhe pësoje dhimbje të shumta, rënkoje thellë në shpirt,* kur po kryqëzohej Biri yt dhe Perëndi;* fort e shenjtë e pacen, thoshe: "Mjer', Bir i ëmbël,* si padrejtësisht po vuan, varesh përmbi dru,* ti që dheun mbarë e mbush plot?".*[14] Ndaj të lypim, Zonjë, me besë,* zbute pra atë me dhembshuri për ne.

Përlëshore
Ting. IV Tahí prokatálave

Si kroje me rrjedhje plot, o Kiriaki virgjëresh',* martire e Krishtit, je, vadite Kishën e tij, garove shkëlqyeshëm;* me vezullim çudirash,* athlofore, ndriçove* sa ishin në manin', terrin pagan, ndërmjeto pra* guximshëm te Zoti të shpëtojmë, e urta ti.

Lavdi *dhe* Tani

Hyjlindësorja e zakonshme

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme,
Kanunet e Oktoihut dhe
dy të shenjtorëve:

Ode I
Kanuni i shenjtorit
Ting. II Dhefte laí

Pasi në shpirt* prite ndriçimin e Hirit të shenjt',* i lavdëruar, le ti mjegullën e veseve si një tjetër Egjipt[15] pra,* dhe jetën qiellore more me çdo virtyt.

Atë, në jet'* ishe i shquar; pa masë, trofe* kundër barbarësh kishe ngritur; dhe, pasi me oshënarí murg u bëre,* hordhinë e demonëve, pra, e plagose rënd'.

Luftoje fort* me asketizëm ndaj keqdashësit,* me aleancë tok me Zotin Shpirt Hyjnor ti, o oshënar, e përule,* ndaj more rreth fitoresh pra që nga qielli.

Hyjlindësore

Vetëm ti, Vajz',* linde si zure në bark Perëndi,* kur ky u bë i nxënshëm falë mirëdashjes, sado nuk mbahej askund krejt;* kërko prej tij që të shpëtojmë sa të himnojm'.

Kanuni i shenjtores që ka Akrostihidhë: "Duke u ngazëlluar, të duartrokas besërisht, o martire. Josif".
Ting. dhe Irmos I njëjti

Me ngazëllim,* le të kërcejm' në të hyjshmin kujtim* të athlofores dhe martires, duke thirrur: O shpëtimtar Krisht i dhembshur,* me lutjet e saj botën tënde shpëtoje ti.

Lavdi yt, Zot,* shkëlqeu shën Kiriakinë me nam,* o njeridashës, ndaj u arratis nga terri, politeizmi, mashtrimi,* dhe feksi te të gjithë dritë shërimesh kjo.

Vdekje a zjarr* a torturim s'llogarite aspak,*[16] që Krishtit, Dhëndrit tënd Zot të pavdekshëm, t'i pëlqeje, martire e shenjtë;* prandaj u denjësove krejt për lavdi që s'vdes.

Hyjlindësore

Kishe në bark* Krishtin, shkaktarin e pavdekësis',* kështu frenove ti, o e Dëlirë, rrymë vdekjeje; kur Hadhi Zotin* e pa vullnetarisht të vdekur,[4] u tremb me tmerr.

Ode III
Kanuni i shenjtorit: Steréoson imás

Për hir të përgjërimit tënd, u përkul* pra Zoti, nga prangat me dor' profeti* të çliroi dhe të dha fuqi* të ecje drejtas arenës së lodhjeve.

Ai që, o i tërëlum, mirësisht* kish dashur dikur që Izraeli* të kalonte me një shtyll' shkretin',*[3] të udhëzon me shtyll', zjarr, se të pa fisnik.

Hyjlindësore

Të quajmë pra ne vërtet mal hyjnor*[17] dhe shtambë të manës,[18] dhe temjanicë* ari[19] dhe të këndshmin mbretëror* pallat, e Virgjër, për Zotin ton' Perëndi.

Kanuni i shenjtores I njëjti

Martire, Fjala, Zoti, për vete ty* të mori për nuse, si të dëlirë* të paprishshme me shkëlqim në shpirt,* me bukuri, se të deshi me mirësi.

Kur vyshke bukurit' e jashtme gjithsej,* tregove te Krishti, që njeh të fshehtat,[20] bukurin' e brendshme; ndaj ai,* o shën martire, me ty u fejua pra.

Martire virgjëreshë, mbive si deg'* e bukur, e hyjshme nga rrënj' e shenjtë;*[6] solle fryte pra të bukura,*[21] që të shkaktuan shijimin që s'plaket ty.

Hyjlindësore

Urtin' enipostate të Perëndis'*[22] e linde, e Virgjër, ndaj më çliro ti* nga e keqja e dinakut djall,* e vetmja krejt pa cen, me ndërmjetimin tënd.

Irmosi: Steréoson imás

»**F**orcona, sigurona, o Zot, në ty,* pra »ti që ke vrarë me dru mëkatin,*[23] »edhe frikën tënde na e mbill* në »zemrat tona, që të lavdërojnë ty.

Ndenjësore e shenjtorit
Ting. IV Epefanis símeron

I pëlqyer ishe ti* përpara Zotit* me pun' të hyjnueshme,* me jetë fort të pastër pra,* për trashëgim engjëllor kështu* u denjësove, Thoma shenjt i tërëlum.

Lavdi *I shenjtores*
I njëjti Tahí prokatálave

O e tërëfamshme, në mes të martirëve je,* zambak me aromë në lëndina[24] ke lulëzuar, shndritur, o Kiriaki,* me pastërti për Krishtin;* nga hyjdija e fekse* dritën hyjnore, zmbrapse dëm mashtrimi me duhmë,* kujtimin tënd, o martire, pra e kremtojmë ne.

Tani *Hyjlindësore*

Kur shterpa dëgjoi përshëndetjen dhe zërin tënd* në veshët e saj dhe, si e paranjohu kjo ardhjen tënde, çuditej fort;* me përshëndetjen ndjeu,* mori vesh, Virgjëreshë,* se i kërcente foshnja brenda mitrës, kështu pra* kuptoi se Zoti mishërohej në barkun tënd.[25]

ose Hyjlindësore

Kur ty nëna jote e pacen të pa përmbi Kryq* të ngjitesh, thërriste me vajtim nënor pra, o Fjalë e Perëndisë, Zot:* O sa çudi e huaj,* e re është, im Bir, kjo?* Si, jeta e të gjithave,[26] ke lidhje me vdekjen?* Se do, si i dhembshur, që të ngjallësh të vdekurit.

Ode IV
Kanuni i shenjtorit: Isakíkoa Kírie

Me zjarr të hyjshëm vetëpërmbajtjeje dogje gjemba mëkati dhe shndrite shkëlqim çudish, o atë.

Meqenëse pastrove sytë e shpirtit tënd nga balta e pasioneve, hape bebet që nuk shihnin, o i lumur.

E bëre të huaj veten tënde për zhurma tokësore, o hyjprurës, dhe fitove qetësi të përmbidheshme.

Hyjlindësore

O Zonjë që s'njohe dasmë dhe zure në mënyrë të pashprehshme Perëndinë, çlirona gjithë ne nga ngasjet dhe shtrëngimet.

Kanuni i shenjtores I njëjti

Qëndroje në tribunë, o Kiriaki, duke u gjykuar padrejtësisht dhe duke e vështruar Gjykatësin e drejtë.[26a]

I dhe në tortura gjymtyrët e trupit, dhe me rrjedhjet e gjakut mbyte armiq pa mish, o Virgjëreshë.

Kur ishe në tortura, mbete e paepur, o Kiriaki, dhe poshtërove vetullën e lartësuar.[27]

Hyjlindësore

O Virgjëreshë e tërëdëlirë, çliroji nga çdo keqtrajtim i keqdashësit ata që të njohin me të vërtetë si nënën e Perëndisë.

Ode V
Kanuni i shenjtorit:
O tu fotós horigós

E kishe besërisht si udhëheqës nëpër shkretëtira Ilia thesvitin,[28] i cili të shfaqej natën dhe të mësonte misteret hyjnore, o atë oshënar.

Banove në malin Maleó si një tjetër Karmel,[29] o i urtë, duke shijuar vizione hyjnore dhe çudibërje, dhe duke marrë në mënyrë paradoksale hir, o Thoma.

Hyjlindësore

O e pacenuar, shëroje zemrën time të plagosur nga sulmet e keqdashësit, si e dhembshur që mbajte në bark parrëfyeshëm të mbërthyerin mishërisht mbi Kryq.

Kanuni i shenjtores I njëjti

Meqenëse shpirtin tënd të pastër e tregove tempull të tërëvërtetë Perëndie, o Kiriaki, vithise tempuj idhujsh duke thirrur Krishtin, i cili të përforcoi.

I ngrite duart dhe mendjen drejt Krishtit, o Kiriaki e lavdëruar, dhe me tërmet të frikshëm i shtange ateistët

që ulën kokën në dhé dhe s'mundën të shikonin.

Perëndia i të gjithave të inkurajon nga lart me zë të gjallë, që të durosh me mendim trim torturat e të paligjëve dhe të veshësh kurorën e fitores.

Hyjlindësore

Zgjidhe, o e pacenuar e thjeshtë, mallkimin e stëretërve,[30] kur e linde pa vullnete mishi[31] atë që u dha të gjithave qenie[32] qartësisht me vullnetin e tij[33] hyjnor.

Ode VI
Kanuni i shenjtorit:
En aviso ptesmaton

Në shkreti të paujë banove ti,* oshënar, nga Zoti pra kërkove ujë mjaft* me përgjërim si shi i madh,* që ai të buronte në të, o at'.

Prej vendlindjes larg kishe ikur porsi* Abrahami fort i drejt'[34] qëmoti, o Thoma,* pran' Perëndisë shkove pra* dhe fushove në tokë të butësh[35] ti.

Ishe murg ti vërtet; pas varrimit tënd* me fuqin' e Shpirtit,[36] o Thoma, buron dhunti,* shërime[37] për sa vuajnë* edhe kanë nevojë, o atë shenjt.

Hyjlindësore

Brenda barku që s'njohu dasmë aspak,* me dëshir' banoi Zoti që vullnetarisht* bën çdo gjë;[33] si i dhembshur fort* denjëson për shëndet të sëmurët pra.

Kanuni i shenjtores I njëjti

Tejkalove, e tërëfamshme, çdo kusht* natyror ti gjatë ndeshjes sate mbi natyr';* plagose me mundim të madh* djallin që e plagosi keq Evën[38] pra.

Thave fundin e politeizmit krejt,* o e tërëthjeshtë, me pikim nga gjaku yt,* buron ti det kurimesh pra* për sa po të afrohen me besë ty.

Në tribun' rrije, teksa po kishin turp* bisha nga ti, e paprishshmja shqerr' plot lavd, urti,* dhe të nderuan, Kiriaki,* meqë po adhuroje drejt Krishtin tënd.

Hyjlindësore

Meqë kishe në bark Zotin mbret, denjo* ti si mbretëreshë me hyjhir, për mbretërin'* e qiejve[39] lart sa vrapojn'* pranë teje, o strehë e njerëzve.

Irmosi: En aviso ptesmaton

»Një avushë mëkatesh po më »rrethon,* ndaj thërras un' mirësinë »tënde që s'ka fund,* e cila s'gjurmë»sohet dot;* lutem, nxirrmë nga pri»shja, o Zoti im.[40]

Kontaqi
Ting. II Ta ano zitón

Na mblodhi tani* martirja e Jisuit Krisht,* që ne t'i këndojm',* t'i mburrim trimërit' e saj,* mundjet e hyjnueshme që ka hequr se, sipas emrit, kjo* burrërore në mend u shfaq* dhe zonjë mendimesh dhe pasionesh pa vend.

Shtëpia

O krishtdashës, falej herezia e papastër dhe me emër të keq e paganëve, kur në gjithë dheun mbizotëronte dhe përhapej mashtrimi i idhujve, ndërsa kishte një mbret besëkeq dhe çnjerëzor më shumë se të gjithë njerëzit; sepse turmat i bindeshin zërit të tij tepër të pabesë, kur ai kërcënonte ata që nuk i përkuleshin fesë së tij të rreme, t'i vriste me vdekje të rëndë dhe të mjerë;[41] por martirja e Krishtit shpërfilli urdhrat dhe kërcënimet e tiranëve ateistë dhe, pasi shpalli në mes të stadiumit Krishtin Perëndi, shkeli fort armikun; ndaj u shfaq me të vërtetë zonjë mendimesh dhe pasionesh pa vend.

Sinaksari

Më 7 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë oshënar Thomai në Maleó.

Vargje: Siç do të thoshte Moisiu, i hape krahët, o atë,/ dhe si një shqiponjë[42] fluturove lart drejt qiellit.
Në të shtatën, vdekja e zezë rrëmbeu Thomanë e mençur.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë Kiriakia.
Vargje: Kiriakia arrin dhe vdes përpara prerjes,/ por, sipas dëshirës, mbaron me shpatë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Peregrini dhe i atyre që ishin me të, Llukiani, Pompiu, Isihi, Papiu, Satornini dhe Gjermani.
Vargje: Tok me të gjashtët zbriti në fund Peregrini,/ që prej andej të peshkonte si gjah kurorë atletizmi.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirëve të shenjtë Efstathi, Polikarpi dhe Evangjeli.
Vargje: Para qëndrueshmërisë së zemrës së Efstathit/ edhe zjarri që bubulonte u duk si ujë i qetë.[43]
Kështu, o kasap shfrytëzoji vullnetet e tua,/ meqë do që të më therësh shpejt mua, Polikarpin.
Evangjeli, e kishte si ungjillëzim për kurorën hyjnore/ mbarimin e hyjshëm nga shpata.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Kanuni i shenjtorit: Ikonos hrisís

O atë Thoma, duke u dhënë me anën e fuqisë së Krishtit shikimin të verbërve, ecjen e mirë të çalëve,[44] çlirimin të shqetësuarve dhe shërimin të sëmurëve, thërrisje: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[45]

O atë i tërëlumur, i tërëpasur, e mbarove qetësisht jetën tënde, duke shkëlqyer nga mospasja, duke u stolisur me vetëpërmbajtje dhe duke i psalur me kataniks zemre Zotit: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[45]

Hyjlindësore

O Virgjëreshë e thjeshtë, e bekuar, e dëlirë, që s'njohe dasmë, ringritje e atyre që bien, çlirim i atyre që mëkatojnë, shpëtomë mua plangprishësin, shpëtomë duke i thirrur Birit tënd: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[45]

Kanuni i shenjtores I njëjti

O virgjëreshë, mendja jote, e ndriçuar nëpërmjet dashurisë për Perëndinë, u shfaq e pakthyeshme, teksa qëndroje në mes të kaminës dhe nuk digjeshe[43] aspak dhe i psalje Krijuesit tënd: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[45]

Përpara kamina nuk i flakësoi fare Tre të Rinjtë, as martiren; sepse ajo, duke u lutur, qëndronte në mes e patundur, pranonte vesë hyjnore[43] dhe thërriste me himnim: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[45]

O Kiriaki virgjëreshë martire, me shpatën e guximit tënd vrave armikun e së vërtetës, sepse dëshirove ta trashëgoje lavdinë e përjetshme dhe thërrisje: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[45]

Hyjlindësore

I vetmi Perëndi, vetëm barkun tënd e gjeti të pastër, dhe trupëzohet dhe njihet si njeri që e shpëton njeriun; prandaj, duke të ditur si arsyen e të mirave, psalim: E bekuar je ti që kishe në bark Perëndi në mish.

Ode VIII
Kanuni i shenjtorit:
Ton en kamino tu pirós

Përderisa me fre vetëpërmbajtjeje nënshtrove tërësisht pasionet e vrullshme të shpirtit, ngjave me engjëjt e palëndët[13] duke thirrur: Himnojeni, o vepra, Zotin dhe përmbilartësojeni në jetë.[46]

O i tërëlumur, duke gjurmësuar jetën e hyjnueshme të Ilia Thesvitit, u ngjite

në mal[29] që të komunikoje me Perëndinë, duke pastruar me kreshmë mendjen dhe duke psalur: Bekojeni Krishtin në jetë.

Hyjlindësore

Meqenëse je burim i gjallë, sepse linde ujin e jetës,[47] vadite shpirtin tim që u tret prej flakërimit të mëkatit, o Hyjlindëse e virgjër, që të të lavdëroj në gjithë jetët.

Kanuni i shenjtores I njëjti

U njohe, o Kiriaki, si nuse e Krishtit, e stolisur[7] me bukuritë virgjërore; prandaj ai të denjësoi siç e meritoje për dhomat qiellore ty që e përhimnon në jetë.

Sikurse Danieli, u hodhe në mes të bishave duke lavdëruar Krishtin dhe e ndryshove qartësisht egërsinë e tyre[48] me anën e Shpirtit Hyjnor, o e virgjër; prandaj të lavdërojmë në gjithë jetët.

Meqë Zotit, si i dhembshur, i vjen keq kur drejtohesh si shqerrë për therje nga malli për Qengjin[49] Perëndi,[50] dërgon engjëj që të të zgjidhin nga trupi para prerjes me shpatë.

Hyjlindësore

Perëndia i përmbiqenshëm mori prej teje, o Virgjëreshë, substancë sipas nesh dhe u shfaq si foshnjë ai që para jetëve ishte bashkë me Atin dhe Shpirtin; pra të lavdërojmë si nënën e tij.

Irmosi: Ton en kamino tu pirós

»Atë që zbriti në kamin',* që të ishte »tok me Djemtë e hebrenjve,* Perë»ndinë që ktheu në vesë flakë dhe »zjarr,*[43] himnojeni vepra, se është »Zot,* përmbilartësojeni pra në gji»thë jetët.[46]

Ode IX
Kanuni i shenjtorit:
Ton ek Theú Theón Logon

U varfërove në shpirt, atë, ndaj more në qiell* dhe me të zgjedhurit të tërë tok* pra mbretërinë,[51] i mbushur me lavd* që nuk shprehet dhe pret denjësisht shpërblimet për mundimin tënd,* o Thoma, pra me besë dhe mall të lumërojmë ty.

Burojn' lumenj me shërime për sa vijnë me besë* pranë kutisë së lipsanit tënd,* mbysin pasionet e shpirtit edhe* zhdukin dhimbjet trupore, Thoma i lumur ndërmjetues pra,* për ata që gjithnjë besërisht të lumërojnë ty.

I shoqëruar me grigja të shkëlqyera, atë,* feks me ndriçim mendor që s'perëndon* sa ta festojnë kujtimin

me bes';* shndriti dhe denjësoji të gjejnë pra shpëtim besnikërisht* nëpërmjet ndërmjetimit tënd, o asket i madh Thoma.

Hyjlindësore

Përmbi të gjithë shkëlqen, o Hyjhirplote e pastër,* lavdin e mrekullive që ti bën,* mjegullën dhe errësirën që kan'* veset edhe trishtimet i flak, shtrin dritë gazi mendërisht* mbi ata që, si nënën e Zotit, ty të madhështojn'.

Kanuni i shenjtores I njëjti

Me besë shumë të fort' te Perëndia, martire,* ke shmangur me mendim trim ti çdo sulm,* bishat me zjarrin dhe dhimbjet plot tmerr* të torturës së trupit; prandaj me mallëngjim dhe me besim* të lëvdojmë, e virgjër, si dhe të lumërojmë ty.

Për Dhëndrin tepër të bukur rregulloje stolisjen* tejet të hijshme që kish shpirti yt,* ruajte pra virgjërinë pa cen* dhe si prikë ia solle torturat e gjymtyrëve atij,* Kiriaki, o martire e tërëfamshme me lavdi.

O Kiriaki, trupi yt shumë i vuajtur, vajzë,* nën dhé pra ësht' varrosur, por buron* lumë shërimesh për sa me besim* i afrohen, dhe flak ndotje vesesh, dhe mbyt sulme, egërsi,* tinëzi pra demonësh, hyjnuse shenjte me lavdi.

Kujtimi yt fort i shenjtë, o martire, si diell* lindi për ne; largon, o Kiriaki,* retë e veseve, dhe na ndriçon* ne të gjithë që, o virgjëreshë, me besim dhe gaz vërtet,* të nderojmë me zell dhe të lumërojmë plot me mall.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë e tërëshenjtë, ne, me llambadhet* tepër të ndritshme prej atij që ti* linde në mish mbi mendim, marrim drit'* me besim, dhe nga terri i veseve, nga çdo peripeci* dhe rrezik pra shpëtojmë, të dimë si Hyjlindëse.

Irmosi: Ton ek Theú Theón Logon

»Ta madhështojmë me një zë, o bes-
»nikë, me himne* Fjalën e Perëndisë,
»Zotin[52] Krisht,* që parrëfyeshëm mo-
»ri për ne* mish nga Nëna e virgjër, e
»shenjtë; vjen të rinovojë pra* krejt
»Adamin që, kur hëngri,[38] ra në prishje
»mizorisht.

Dhe të tjera si zakonisht

CITIME

[1] Fil. 2.15
[2] II Kor. 8.9

[3] Eks. 13.21-22; 14.24; Num. 14.14; Urt. Sol. 18.3
[4] Matth. 20.19; Joan 10.17
[5] II Tim. 2.10
[6] Tov. 5.14; Rom. 11.26
[7] Ps. 44(45).10
[8] Matth. 25.4-10
[9] Kënga 1.3-4
[10] Kënga 2.5; 5.8
[11] Ligji i Dytë 28.66
[12] Ps. 47(48).2
[13] Matth. 22.30; Mark. 12.25; Lluk. 20.36
[14] Ef. 1.23; 4.10
[15] Eks. 12.34-42 etj.
[16] Vep. 20.23-24
[17] Ps. 2.6 etj.; II Petr. 1.18
[18] Eks. 16.33; Hebr. 9.4
[19] Hebr. 9.4
[20] Ps. 43(44).22
[21] Joan 15.5
[22] I Kor. 1.24
[23] I Petr. 2.24
[24] Kënga 2.1
[25] Lluk. 1.39-44
[26] Joan 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
[26a] Ps. 7.12; II Tim. 4.8
[27] Fja. Urt. 24.36 (Mas. 30.13); Is. 10.12
[28] III [I] Mbret. 19.4-8
[29] III [I] Mbret. 18.42
[30] Gjen. 3.16-19
[31] Joan 1.13
[32] Joan 1.3
[33] Urt. Sol. 12.18
[34] Gjen. 12.1-4; Hebr. 11.8
[35] Matth. 5.5
[36] Rom. 15.13,19
[37] I Kor. 12.9,28
[38] Gjen. 3.1-6
[39] Matth. 3.2 etj.
[40] Jona 2.7
[41] IV Makk. 9.5
[42] Ligji i Dytë 32.11
[43] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
[44] Matth. 11.5; Lluk. 7.22
[45] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[46] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[47] Joan 4.10-14; Apok. 21.6
[48] Dan. 6.16-18
[49] Is. 53.7; Vep. 8.32
[50] Joan 1.29,36; I Petr. 1.19
[51] Matth. 5.3; Lluk. 6.20
[52] Joan 1.1

MË 8 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martirit të madh e të shenjtë Prokop.

Tipikon

Nëse bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të martirit. Lavdi i martirit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i martirit. Tani Hyjlindësore ngjallësore (në Tingullin e Lavdisë, si zakonisht, pra)* Virgjëresh' e panusëruar. *Përlëshoret: ngjallësore, e martirit dhe Hyjlindësorja ngjallësore (në Tingullin e Përlëshores së mëparshme, si zakonisht, pra)* Gëzohu, o der' e Zotit.

Të dielën, në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i martirit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e martirit, dhe Ndenjësoret e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani*; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore, e martirit dhe Hyjlindësorja e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të martirit. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e martirit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e martirit dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Apostulli i martirit dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore e së dielës.*

NË MBRËMËSORE

Thirrtore

Ting. I Ton uranion tagmaton

Ishe veçuar nga barku nënor fort urtësisht,* Prokop, prej Perëndisë,*[1] ndaj nga qielli kishe* ti si Pavli ftesën[2] kur more vesh* për pësimet me dashje pra* të Krishtit;[3] si predikues vërtet, zelltar* u dallove për të, o martir.

Urtë, ishe pajisur me armatimin mistik;* me shenjën fitimtare,* me triumfin e Krishtit* zhduke, o Prokop hyjmendës, guxim,* arrogancë keqdashëse,* armiqësore; statujë druri përdhé* hodhe dhe luftove gjer në gjak.

Te Zoti mbret qiellor më përpara solle drejt* repartin ushtarak pra* tok me gratë besnike;* po ashtu me ndërmjetimin tënd ti* dhe tani silli Krishtit tënd* sa e kremtojmë kujtimin tënd me kushtim,* bukuria e martirëve.

Thirrtore të tjera
Ting. IV Édhokas simíosin

Si një yll i ndritshëm fort nga Lindja linde dhe llamburit* botën, skajet e saj, Prokop,* me shenja hyjnore, pra* me çudi vërtet ti,* me durim në dhimbje dhe me shkëlqime në trofet'* e madhërishme; ndaj panairit tënd* të tërëndritur dhe kremtues e festojmë sot plot gëzim,* athlofor dhe martir me nam,* ndërmjeto për të gjithë ne.

Trupi yt, kur shqyhej, o i tërëlumur, dhe prishej keq* brenda zjarrit, dhe mbyllej thell'* në burg, dhe kalonte ky* në çdo lloj torture* dhe prej shpatës pritej, ty të shkaktonte mbretërin'* në qiell, ku po kërcen me plot hare,* Prokop, o trofeprurës dhe i urtë që shoqërohesh lart* tok me engjëj, o athlofor* me mundime të shumta pra.

Solle te Krijuesi një kor që atletizoi mir'* dhe hyjnisht në besim, Prokop* hyjmendës, me ta dhe ti* tok u numërove,* me grupim martirësh, kur burrërisht e shkele posht',* i admirueshëm fort, keqdashësin;* prandaj të lumërojmë si ushtar që s'mundesh, që s'mposhtesh dot,* si diamant trim dhe luftëtar* për besimin që kemi ne.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Shkëlqeu sot kujtimi yt i lavdëruar, o Prokop shumëtriumfues, duke na ftuar ne kremtimdashësit për mburrjen dhe lavdërimin e Krishtit, Perëndisë sonë; kështu, duke rendur pranë kutisë së lipsaneve të tua, marrim karizma shërimesh[4] dhe Krishtin Shpëtimtar, që të kurorëzoi, e përhimnojmë në jetë, duke e lëvduar pa pushim.

Tani *Hyjlindësore*
Triímeros anestis Hristé

Ja syt' e zemrës sime i shtrij* te ti,[5] o Zonjë, mos shpërfill* psherëtimen* time hidhur; pra në or'* kur do gjykojë Biri yt botën, atëherë* për mua ndihmë, streh' e ngrohtë ji.

ose Kryqhyjlindësore

Kur shihte që po varej në dru,* Hyjlindësja që s'kish qortim,* jetën tonë,*[6] po thërriste me vajtim* si nënë: O im Bir edhe Perëndia im Zot,* shpëtoji sa të përhimnojn' me mall.

Pasvargje
Ting. IV Os jeneon en mártisin

O Prokop, që nga qielli* ftesa jote u bë mu si* ftesa e shën Pavlit,[2] pra predikuesit* në mbarë kombet;[7] si shndrite mendërisht, le terr idhujtar,* dhe ndriçues me lavdi* për besnikët

u bëre ti;* me shkëlqim hyjnor* nga luftimet e tua të nderuara feks tërësit' e botës,[8] mburrje martirësh dhe krenari.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

Me përmbajtje frenove krejt* hove mishi më parë ti,* drejt atletizimit pastaj me burrëri* shkove, pasi me fuqi nga Shpirti[9] nuk e kurseve hiç* trupin, o i tërëlum,* shën Prokop; ndaj durove fort* çdo lloj dhimbjeje* dhe çdo shpikje torturash, pra vrapove i kurorëzuar lart për në kore plot me triumf dhe gaz.

Varg: Te shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

Përmes rrymës së gjakut tënd,* çdo fuqi kundërshtare ti* krejt e zhyte si gjeneral që s'mposhtet dot* i armatosur me kryqin; dhe gufove me mbushulli* shi shërimesh, rrjedhje pra* nga burimi i Krishtit Zot,* Shpëtimtarit[10] tënd;* i vadit ti të gjithë sa i zuri flaka e pësimit, shenjt i hyjfrymëzuar, që admirojm'.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Prokopit

Hartofilaks

O martir me shpirt trim Prokop, duke shkëlqyer me llamburitjet mistike të Trinisë së përmbindritshme, je përëndi nga "vendosja", sepse u hyjnizove me "kungim"; prandaj ata që besërisht kremtojnë festën tënde dritëprurëse, shpëtoji me ndërmjetimet e tua nga ngasjet e shumëllojshme.

Tani *Hyjlindësore*

O tu paradhoksu thávmatos

O karrocë që ke formë zjarri,[11] je agimi mistik,* që në bot' solle diellin* me shkëlqim pa perëndim;* ki gaz, meqë guaskë je* me ngjyr' porfiri, sepse me gjakun tënd,* për tërëmbretin e Gjithësis' mantel* leve; ki gaz, ki gaz,* o e gjithëpacenuar, mbrojtja je* për gjith' shpresëplotët që të ftojnë besërisht.

ose Kryqhyjlindësore

"Ç'është pamja që po shfaqet, o Zot, para syve të mi?* Ti që mbarë Krijesën mban,* si u vare mbi një dru,* vritesh ti që kudo jep jet'?!".*[11a] Me vaj kështu thoshte duke qarë keq* Perëndilindësja, kur e pa* njeriun-Perëndi* që prej saj shkëlqeu krejt pashprehimisht,* ndërsa qe mbërthyer ky në Kryq si kriminel.

Përlëshore

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Kur u kape nga qielli në besim të sakt',* me zemër ndoqe pas Krishtin

me gaz si Pavli,[2] Prokop,* bukuria e dëshmorëve, martir i madh;* ndaj me fuqin' e kryqit ti* triumfove me lavd, turpërove kështu beljarin;* sa të mburrin me mall, shpëtoji pa plagë pra prej ligësisë së tij.

Dhe të tjera si zakonisht

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme, dy Kanunet e Oktoihut dhe ai i shenjtit. (Nëse do, psal dhe Zbritësoret Ja gojën e çel tani).

Kanuni i shenjtit, poezi e Theofanit:
Ting. IV
Ode I
Thalasis to erithreon

Shkëlqime* me pasuri prej Shpirtit janë derdhur përmbi ty;* sa mburrin festën tënde plot me nder,* dritëprurëse, o Prokop,* çliroji nga çdo mjegullim i vesës dhe i ngasjes, o martir.

Je ftuar,* Prokop, pra jo nga njerëzit, por që nga qielli,* si Pavli që më parë Krishti Zot* e kish kapur[2] në rrjetë si gjah;* dhe dëshmitar të mirëfilltë të pësimit të tij të ka bër'.

Shkëmbeve,* Prokop, shenjt i tërurtë, mençurisht një mbretëri* të vdekshme me atë që rron gjithnjë,* mbret të vdekshëm me mbret që s'vdes pra;* ai të dha ty mbretëri që s'prishet fare në përjetësi.

Hyjlindësore

E mbajte* në bark, e përhimnuar, Zotin - nga natyra ky* ish Bërësi - na hyjnizoi pra* kur vërtet u bashkua me ne* mbi mend; lyp pa pushim atë, që të ndriçojë sa të psalin ty.

Ode III
Uk en sofia

Të shfaqet Krishti* mu në mes të një kryqi çuditërisht,* dukshëm të mëson ai,* se dhembshurisht bashkëzbriti te ne,* në atletizim pra të fton, të fitosh lavdi.

E ngrite veten* përmendore dhe kishë për Shenjtin Shpirt;*[12] kishe zell hyjnor në frym'*, martir Prokop, hodhe poshtë pra ti* dhe statuja pa shpirt, dhe tempuj demonësh tok.

Me rrjepjen tënde* nxore bashkë këmisha lëkure ti,*[13] dhe u veshe me stoli* pavdekësie,[14] martir shën Prokop;* zhveshe intrigantin mashtrues fort pra kështu.

Hyjlindësore

Çliromë mua* nga çdo sulm kundërshtar pra, prej gjarprit[15] djall,* e dëlira nënë ti* dhe Virgjëreshë; ma ndrit zemrën nur;* me besim të lavdëroj ty që s'ke cen aspak.

Irmosi: Uk en sofia

»S'mburremi fare* për fuqi, urtësi, »as për pasuri,* por për ty,[16] o urtësi* »enipostate e Atit, o Krisht*[17] njeri- »dashës, se, përveç teje, s'ka tjetër »shenjt.[18]

Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotír

Prej qiellit të fton,* o i urti Prokop, ty,* si Pavlin që më parë, Jisui drejt besës;*[2] se parapa ky bukurinë e hyjshme që kishe ti* brenda zemrës, pra* me burrëri fort garove,* duke shpallur gjer',* i tërëlumur, sa hoqi* kur erdhi te njerëzit.

Hyjlindësore

Ti shpresë je për ne* të krishterët, e virgjër,* ti, Zotin që ke lindur mbi mendje e fjalë,* lyp pa pushim, Hyjlindëse, tok me forcat e sipërme,* të na japë ndjes'* mëkatesh, ndreqje jetese* neve, pra çdokujt* që të lëvdon ty me besë* gjithnjë dhe me mall të madh.

ose Kryqhyjlindësore

Kur shihte përmbi dru* qengjin[19] edhe bariun*[20] të varur dhe të vdekur keq, shqerra pa njollë* po thoshte duke qarë, duke bërtitur si nënë kjo:* Biri im dhe Zot* i përmbimirë, si unë* mundem ta duroj* pra bashkëzbritjen mbi mendje,* pësimin tënd vullnetar?[3]

Ode IV
Eparthenta se idhusa

Kur tirani mendjemadh krenohej me pushtetin e pabesimit, e dërrmove përdhé me anën e lartësimeve të hyjshme drejt Perëndisë, duke thirrur ti: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

O Prokop, kur ishe mbyllur në burg, të shfaqej Çliruesi, duke të mbushur me guxim, duke të shkëlqyer me dritë, dhe duke të dhënë emër të përshtatshëm me prokopinë tënde.

Ata që mbuloheshin prej errësirës së pabesisë, sapo panë qartë fytyrën tënde të shkëlqyer prej Hirit hyjnor, morën dritën e besimit përmes shenje aprovimi hyjnor.

Hyjlindësore

Mua që rëndohem nga gjumi i dembelizmit, më ngri drejt agimit e pendimit falë ndërmjetimit tënd të pa-

fjetur, o Zonjë, dhe shpëtomë ti, e vetmja që e pate Shpëtimtarin kur ishe shtatzënë.

Ode V
Asevís uk ópsonte

Me dritën e fjalëve të tua, i solle Krishtit ushtri hyjbindëse, që me gjak martirizimi trashëgoi së bashku me ty, o Prokop, mbretërinë e palëkundur.[21]

Gratë, nga senatore, u shfaqën kunguese me senatin e sipërm, pasi mohuan epërsinë e origjinës, dhe preferuan të vdisnin për ty, o Fjalë e pavdekshme.

Ato që aspiruan mbretërinë tënde, o i shumëmëshirshëm, duke u flakëruar prej zjarrit të hyjnueshëm në shpirt, shpërfillën trupin që digjej dhe rripej pa kursim.

Hyjlindësore

Pasi u ngjize, linde Perëndi Emanuel,[22] i cili u bë mish[23] për rigatimin e vdekatarëve, o e Tërëshenjtë e pacenuar; atij përgjëroju përherë, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Ode VI
Thiso si metá fonís

O Prokop* martir, po rridhte mjalt' gjuha jote, pra* mësim vërtet si pik' mjalti,* që nga hidhërimi i ateizmit* i çlironte* sa rendnin pranë teje të bindur krejt.

O martir,* kur e fitove besën e mirë ti* si nën', nxjerr nënën, që në mish* të kish lindur, nga besim bosh; e sjell pra* përmes ndeshjes* tek ati qiellor, se e thjeshtë ish.

O martir,* tirani, duke rrjepur me hekura* fytyrën tënde, nuk tundi* forcën e mendimit tënd, se kish bazë* dashurinë* e Krishtit që duroi pësim në mish.

Hyjlindësore

Kishe ti* pashprehimisht në mitër, o Virgjëresh'* e tërëshenjtë, të shenjtin* mbi të shenjtët, që shenjtëron besnikët* përgjithmonë,* dhe korin martirik lidh me engjëjt lart.

Irmosi: Thiso si metá fonís

»Do flijoj* me zë himnimi,[24] Kisha »thërret te ti,* o Zot, sepse, përmes »gjakut,* që nga brinja jote për për»dëllim rrjedh,* u pastrua* nga çdo »pisllëk prej gjakrash demonësh kjo.

Kontaqi
Ting. II Ta ano zitón

Prej zellit hyjnor* të Krishtit Zot po digjeshe* dhe ruheshe ti* nga kryqi i

fortçmueshëm;* arrogancën edhe tërbimin e armiqve vithise posht',* ngrite Kishën plot nder, Prokop;* na shndrite në besë me prokopi.

Shtëpia

O Fjalë e parapanisshme, më jep gojë mençurie mua që dua ta himnoj ushtarin tënd Prokop; sepse, o Krishti im, e ke pasurinë e dhembshurisë në detin e pafund të gjykimeve të tua; dhe unë, pasi të pastrohem nga errësira e shpirtit dhe pasi të fshij çdo njollë të mendjes, të bëhem tempull shenjtërimi, përmes veprash të hyjshme, dhe t'i këndoj denjësisht martirit, që e ngriti Kishën dhe na shndriti në besë me prokopi.

Sinaksari

Më 8 të të njëjtit muaj, kujtimi i martirit të madh e të shenjtë Prokop.

Vargje: Prokopi u duk kur ulte qafën, se thoshte:/ Le të pritet, sepse nuk i flijoj mashtrimit.

Në të tetën ditë, prenë kokën e Prokopit guximtar në luftë.

Në të njëjtën ditë, shën Theodhosia, nëna e shën Prokopit, mbaron me shpatë.

Vargje: Duke qenë nënë triumfuesi,/ rendi të ishte athlofore nga shpata.

Të Dymbëdhjetë Gratë Senatore mbarojnë me shpatë.

Vargje: Shpata vrau dymbëdhjetë gra,/ që i konsideronin si plehra[25] lavditë e tokës.

Martirët e shenjtë Antiohi, Nikostrati, Avdhau dhe Sava mbarojnë me shpatë.

Vargje: Nikostrati thotë: Do ta duroj prerjen si Antiohi,/ vallë nuk kam edhe unë kokë?

Meqë një herë inkurajoi veten në pësim,/ Avdhau e ka gëzim vuajtjen[26] prej shpatës.

Oshënar Theofili, që asketizoi në Malin e Shenjtë të Athosit, mbaron në paqe.

Vargje: Përderisa Theofili trim deshi Perëndinë,/ tashmë është tok me të dashurin lart.

Hieromartiri i ri shën Anastasi, nga Shën Vlashi i Igumenicës, i cili u martirizua në Konstandinopojë në vitin 1743, mbaron me shpatë.

Vargje: Për Anastasin u pleks kurorë e dyfishtë/ kur me gjakra e stolisi priftërinë.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
En ti kamino

Kur dërrmoheshe në qafë me peshë plumbi, o martir, nuk e ndieje, sepse aspirove ta mbaje mbi qafë zgjedhën tepër të lehtë[27] të atij që komunikoi me ne nga dhembshuria.

Meqë more nga lart hir shërimesh,[4] o martir, flak sëmundje dhe dëbon frymë të liga, duke thirrur: I bekuar je, o Perëndia im dhe Zot.

Kur pranoje si breshëri plagët e keqdashësve, o i lumur, dhe duke duruar ndërsa flakëroheshe nga zjarri, e dogje pabesinë, duke thirrur: I bekuar je, o Perëndia im dhe Zot.

Hyjlindësore

Lind përmbi mendje prej Vajze të paprishur Fjala, që me anën e fjalës i krijon të gjitha, se do që t'i çlirojë nga pamendësia ata që lavdërojnë bashkëzbritjen e tij vullnetare.

Ode VIII
Hiras ekpetasas

O martir, kur përflakeshe me llambadhe frikshëm, shpoheshe mizorisht me biza, pritje rrjepje në traumat e tua kronike dhe kishe dhimbje tepër të forta, thërrisje: Bekojeni, ju gjithë veprat e Zotit, Zotin.[28]

Me të djathtën tënde shuplakove faqet e errëta të demonëve, o i lumur, sepse ia tregove gjykatësit që bënte padrejtësi, të digjej tërësisht nga qymyret, duke i kundërshtuar dhe duke thirrur: Të gjitha ju, o vepra, bekojeni dhe himnojeni Zotin.[28]

O i tërëlumuri Prokop i lavdishëm, duke pasur themel[29] gurin e paçarë, Krishtin,[30] megjithëse i rënduar çnjerëzisht me gurë, ngazëlloheshe, se ky gur të lehtësonte për hare pa rëndesë, kur po thërrisje: Të gjitha ju, o vepra, bekojeni dhe himnojeni Zotin.[28]

Hyjlindësore

O Vajzë, siç profetizove, ja tek të lumërojnë të gjitha gjeneratat ty,[31] meqë linde Perëndi të lumur, i cili i bën të lumur ata që ndjekin besërisht urdhrat e tij dhe thërrasin: Të gjitha ju, o vepra, bekojeni dhe himnojeni Zotin.[28]

Irmosi: Hiras ekpetasas

»Duke* ngritur duart, Danieli mbylli »gojët e luanëve në grop';*[32] dhe »shuan forcën e zjarrit krejt,* kur u »ngjeshën me virtyt Djemtë,*[33] pra »miqtë e shpresëtaris',* tok duke »thirrur me gaz: Bekoni,* ju gjithë »veprat e Zotit, pra Zotin ton'.[28]

Ode IX
Lithos ahirótmitos orus

Kur arrite fundin që deshe, përkule qafën bujarisht krejt* pra për hir të Zotit dhe kur, o martir* Prokop, u godite ti me shpatë,* u bë karrocë gjaku yt;* hipe mbi të dhe rende drejt atij.

Na gufon lumenj me kurime, burim u bëre me çudira,* flakët e pasioneve ti pushon* dhe mbyt dhe kolona djallëzore* me forc', i admirueshëm* dhe me pushtet hyjnor nga Shenjti Shpirt.[9]

O Prokop, sa kryen me plot gaz kujtimin tënd të tërëshenjtë,* nga çdo kërcënim i sëmundjeve,* nga gjithë rreziqet ti çliroji* me përgjërimin tënd hyjnor* drejt Perëndisë Zot, Krijuesit.

Hyjlindësore

Vajzë, linde ti për ne dritë nga barku yt krejt dritëprurës,* Bërësi i diellit, yjeve[34] ësht'* si edhe i Gjithësisë mbarë,*[35] të cilit lutju pa pushim,* Zonjë, të shndritë sa të përhimnojn'.

Irmosi: Lithos ahirótmitos

»Si një gur i prerë pa dorë nga mali »yt i palatuar,* Virgjëresh', u pre porsi »gur[36] qosheje,*[37] pra Krishti, i cili i »bashkoi* natyrat krejt të kundërta;[38] »ndaj me gëzim të madhështojmë ty.

Dërgimësore
Fos analíoton Loge

Ftesën e kishe si Pavli* nga qielli,[2] përparoje* në të, Prokop, sipas emrit;* kore martirësh te Zoti* i solle ti, dhe me ta ndërmjeton te Krishti* për ne që të lavdërojmë.

Hyjlindësore

Shtetin tënd, Fjalë, forcoje* në luftë kundër barbarësh,* fitore mbretërve jepu* me ndërmjetimet e Zonjës* Hyjlindëse, që si mbrojtje për të krishterët* e dhe, dhurove si strehë.

Lavdërime Idhiomele
Ting. II I Bizantit

O athlofor Prokop, lavdia madhështore e martirëve, ke guxim para Perëndisë dhe qëndron përjetësisht pranë fronit të tij;[39] përderisa përparoje në të, ndërmjeto që të kenë prokopi të gjithë në udhë të hyjpëlqyeshme dhe në punë të hyjshme, duke qenë pëlqyer prej tij, dhe duke të lumëruar ty.

Ting. III I Gjermanoit

Në moshë të re, sikurse Pavli i mrekullueshëm, pranove nga të shumëlartat karizmën[2] hyjnore, dhe rrëzove me armatimin e Kryqit arrogancat e

armikut të frikshëm; o krenaria e martirëve, athlofor Prokop, përgjëroju Zotit për ne, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Ting. IV I Qiprianit

I këndohet himnim Perëndisë nga buzë prej balte, me rastin e kujtimit tënd, o Prokop i shumëvuajtur; sepse u tregove ushtar i saktë i fjalës së besimit,[40] kur çnderove në arenë fytyrat e idhujve; dhe tani u bazove në dritën e Triadhës, duke shkëlqyer mendjet tona me ndërmjetimet e tua.

Ting. Tërth. I

O martir i Krishtit, sot Kisha, pasi u stolis me arritjet e tua, dëfren dhe, duke mburrur denjësisht kujtimin tënd triumfal, thërret me lavdërim: Gëzohu, ti, që e kishe zili Pavlin, ngrite kryqin e Krishtit[41] dhe dërrmove kurthet[42] e kundërshtarit; gëzohu, mburrja e martirëve dhe përforcimi i mbretërve, o Prokop shumëtriumfues; mos pusho së ndërmjetuari për ne te Zoti, se ke guxim, o bukuria e athlorëve.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Kur e pranove ftesën nga Perëndia sikundër Pavli,[2] o martir Prokop, dhe kishe prokopi më Zotin, duke i besuar Kryqit, turpërove burrërisht keqbesimin e tiranëve dhe egërsinë e torturave; prandaj rezistove deri dhe në gjak kundër mëkatit,[43] duke luftuar kundër armiqsh të padukshëm, dhe ndërmjeton pa pushim te Çlirimtari dhe Perëndia, që t'i dhurohet botës paqe dhe shpirtrave tanë përdëllimi i madh.[44]

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, priti lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Nëse do, Dhoksologjia e Madhe.

Në Liturgji, Tipiket dhe Odet III dhe VI të Kanunit të shenjtit. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Kungatore:* Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] Jer. 1.5; Gal. 1.15
[2] Vep. 9.3-6; 22.6-10; 26.12-18
[3] Matth. 20.18; Mark. 10.33-34; Lluk. 18.32-33; Joan 10.15,17
[4] I Kor. 12.9,28
[5] Ps. 122(123).2
[6] Ligji i Dytë 28.66
[7] I Tim. 2.7; II Tim. 1.11
[8] Fil. 2.15
[9] Lluk. 4.14; Rom. 15.13,19
[10] Is. 12.3

[11] Jez. 1.13-26
[11a] Joan 10.28; 17.2
[12] I Kor. 3.16; 6.19; II Kor. 6.16
[13] Gjen. 3.21
[14] I Kor. 15.53-54
[15] Gjen. 3.1-5; II Kor. 11.3;
Apok. 12.9; 20.2
[16] I Mbret. [Sam.] 2.10; Jer. 9.23(22)
[17] I Kor. 1.24,30
[18] I Mbret. [Sam.] 2.2;
II Mbret. [Sam.] 7.22
[19] Is. 53.7; Joan 1.29,36; I Petr. 1.19
[20] Joan 10.11,14; Hebr. 13.20;
I Petr. 2.25
[21] Hebr. 12.28
[22] Is. 7.14
[23] Joan 1.14
[24] Jona 2.10
[25] Fil. 3.8
[26] Vep. 5.41
[27] Matth. 11.29-30
[28] Ps. 102(103).22; Dan. kap. 3
Lutja e Azarias 34
[29] I Kor. 3.11
[30] I Kor. 10.4
[31] Lluk. 1.48
[32] Dan. 6.16-18
[33] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
[34] Gjen. 1.16; Ps. 135(136).7-9
[35] Joan 1.3
[36] Zah. 9.16; Dan. 2.34-35,44-45
[37] Is. 28.16; Ef. 2.20; I Petr. 2.6
[38] Rom. 5.10-11; II Kor. 5.18-19;
Ef. 2.17-18
[39] III [I] Mbret. 17.1; 18.15;
IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
[40] I Tim. 4.6
[41] Matth. 10.38; 16.24; Mark 8.34; 10.21;
Lluk. 9.23; 14.27
[42] Ps. 123(124).7
[43] Hebr. 12.
[44] Num. 14.19 etj.

MË 10 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i neomartirit të shenjtë dhe të lavdëruar Nikodhimi në Berat.

NË MBRËMËSORE

Thirrtore
Ting. IV Os jeneon en mártisin

As uri, as mundim, as burg* si as jeta, as vdekja pra* dhe as fshikullim s'mundën, Nikodhim martir,* që forcën tënde ta ndajn' nga dashuria e Bërësit;*[1] i patundur mbete ti* derisa e mbarove mir'* atletizmin tënd,* garat dhe, o i lum, rri me kurorë pranë Zotit tënd Krijues, i shumëpasur me çdo lavdi.

(2x)

S'e mohove hiç Zotin[2] tënd,* por më shumë e deshe ti,* se iu binde fjalëve të hyjnueshme* që po të thoshin ty etërit e Athosit, o i lum;* ndaj vrapove me fuqi,* o i urti shën Nikodhim,* në atletizim;* dhe keqbërësin trimërisht e mposhte pra kërcen me kor martirësh dhe me kurorë fitoreje.

(2x)

O tri herë i lum atlet* tepër trim, që si trëndafil* me aroma dhe kundërmim ke mbirë ti,* bir i Vithkuqit, te Perëndia kokën e shenjtë, fort* të nderuar, si flijim* e ofrove; në tendë pra* lart në qiell rri* tok me kore martirësh si i ngjashëm me ta; bashkë na kujtoni në ndërmjetim ne që ju himnojm'.

(2x)

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Si yll i saposhfaqur lindi sot në qiellin e Kishës panairi i shumëlavdishëm i martirit oshënar, Nikodhimit, i cili i shkëlqen me dritë zemrat e shpresëplotëve. Ejani pra, o kremtimdashës, le të festojmë shpirtërisht duke i thënë: Gëzohu, ti që në kohët e fundme garove tepër fuqishëm dhe e turpërove mashtrimin kundër Perëndisë; gëzohu, filiz i shqiptarëve dhe lavdi e hyjshme e Skitit të këndshëm të Athosit; dhe tani në qiej, duke qëndruar pranë Krishtit që u ngjit në qiej, mos pusho së përgjëruari për ne që me mallëngjim nderojmë këtë kujtimin tënd të shenjtë.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit[2a] pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy

fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier; atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës dhe Leximet

Këndimi i profecisë së Isaias
(43.9-14)

Këto thotë Zoti: "Gjithë kombet u mblodhën së bashku dhe do të mblidhen arkondë nga ato. Kush do t'i njoftojë këto? Ose *gjërat* që nga fillimi kush do t'ju njoftojë? Le t'i sjellin dëshmitarët e tyre, dhe le të drejtohen, dhe le të dëgjojnë, dhe le të thonë të vërteta. Bëhuni dëshmitarët e mi dhe unë dëshmitar", thotë Zoti Perëndia, "dhe fëmija im që zgjodha; që të njihni dhe të besoni, dhe të kuptoni se unë jam. Përpara meje nuk u bë Perëndi tjetër, dhe pas meje nuk do të jetë. Unë *jam* Perëndia dhe veç meje nuk është ndonjë që shpëton. Unë lajmërova dhe shpëtova, talla dhe nuk ishte në mes jush i huaj. Ju, dëshmitarë për mua dhe unë, Zoti, Perëndia, ende nga fillimi, dhe nuk ka njeri që të shpëtojë nga duart e mia. Do të bëj, dhe kush do ta kthejë mbrapsht këtë?". Kështu thotë Zoti, Perëndia, që ju çliron, i Shenjti i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë, dhe në Zot është paga e tyre, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë prej dore Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë si armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë Krijesën për mbrojtje armiqsh. Do të veshë *si* korracë drejtësi, dhe do të veshë *si* helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë *si* mburojë të pamposhtur oshënarí, dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me të bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm te qëllimi predha rrufesh dhe, si nga një hark i plotë rrethi, nga retë do të hidhen në shenjë, dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmbytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie, dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligjësi, dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur; mësoni, o gjykatës të anëve të dheut; vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që

jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinastí nga i Shumëlarti.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(4.7-15)

I drejti, nëse do të arrijë të vdesë, do të jetë në prehje; se pleqëria e çmuar nuk *është* pleqëria shumëvjeçare, as u mat me numër vitesh. Dhe thinjat janë mençuri te njerëzit dhe mosha e pleqërisë *është* jetë e panjollosur. Meqë u bë i pëlqyeshëm te Perëndia, u dashurua; dhe, ndërsa jetonte në mes mëkatarësh, u transferua. U rrëmbye, që e keqja të mos ndryshonte mençurinë e tij ose dinakëria të mos mashtronte shpirtin e tij; sepse joshja e së keqes errëson të mirat, dhe ëndja e dëshirimit e ndryshon mendjen e patëkeq. Duke u përsosur në pak kohë, mbushi vite të gjata. Se shpirti i tij ishte i pëlqyeshëm në Zot, prandaj vrapoi nga mesi i ligësisë. Por popujt, duke parë dhe duke mos kuptuar, as duke mos vënë në mendje një gjë të tillë; sepse *ka* hir dhe mëshirë ndër të zgjedhurit e tij dhe mbikëqyrje ndër oshënarët e tij.

Në Liti Idhiomele
Ting. I

Trimin e kurorëzuar në atletizëm, të fortin dhe të pamposhturin në asketizëm, që e lavdëroi Athosin me ndeshje murgjërore dhe që e hijeshoi dheun atëror me gjakra në gara, o besnikë, duke u mbledhur sot, le ta mburrim duke thënë: Gëzohu, o atë shumë i shenjtë, o Nikodhim, vërtet sinonimi i fitores, i shkëlqyer prej asketizmit dhe i purpurt prej atletizmit, ti tani rri pranë Krishtit dhe ndërmjeton për ne që të lartësojmë.

I njëjti

Ia dhe veten sjelljes së hyjduhur nëpërmjet garave asketike, o atë martir oshënar, Nikodhim i lavdëruar; dhe, pasi u shpërngule nga toka ilirike dhe shkove me nxitim në Athos, në fund e vulose jetën me dëshmi të hyjkurorëzuar; dhe, meqë kishe sukses në të dyja, more rrethin e dyfishtë nga e djathta e Zotit;[3] sepse, meqë qortove urtësisht mashtrimin e pushtuesve, fitove guxim para Krishtit, të cilin e lyp pa pushim për ne që të nderojmë, o i lumur.

Ting. II

Ejani, o besnikë, ta nderojmë me himne neomartirin oshënar të Krishtit, Nikodhimin; se u tregua lavdia e Ilirisë dhe krenaria e Skitit në Athos; u shfaq bir oshënar i Malit të Shenjtë dhe martir i fuqishëm i Shqipërisë; ai pra, si

luftoi për besën e mirë, e turpëroi mashtrimin e pushtuesve dhe mori guximin nga Perëndia, ndaj dhe ndërmjeton për ne që e kryejmë të kremten e tij.

Ting. III

Kur u ndeze në zemrën tënde nga malli dhe dashuria për Krishtin, o Nikodhim, synove të shkoje në stadiumin e martirizimit; sepse, pasi u mbështete në mësimet e Akakit, e gjete Zotin përkrahës si dhe nënën e tij të pacenuar, të cilët e përforcuan dobësinë e natyrës sate njerëzore, o i lumur; prandaj dhe i bazove mbi gur këmbët e tua dhe i drejtove hapat e tu.[4]

Ting. IV

Shkëlqen sot kujtimi yt si yll i ndritshëm nga Lindja, o martir oshënar, Nikodhim i lavdishëm, sepse, si more mbi supe kryqin e Krishtit,[5] fitove mbi tërë fuqinë e djallit dhe e pohove shpresëtarinë para tiranëve, besimet e të cilëve i argumentove si mite dhe gjepura, dhe nuk i llogarite fare kërcënimet, torturat dhe fshikullimet; ndaj, duke shpresuar ti për të mirat, ta prenë kokën e hyjshme dhe fluturove me shenjtërim drejt qiellit.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Ejani, të gjithë besëmirët, të mbledhur sot ta mburrim neomartirin e Krishtit, sepse, si i hyjdëshiruar, i zmbrapsi të gjitha të këndshmet e tokës dhe, si i pamposhtur, u bashkëkryqëzua me Krishtin[6] dhe pësoi me anën e asketizmit dhe atletizmit; Skiti i Shën Anës i shpall të tëra ushtrimet që kreu në vëllazërinë e shenjtë të Analipsit të Zotit, ndërsa qyteti i Belegradit* keqtrajtimet e martirizimit dhe shtrëngimet që vuajti i pasuri tri herë; me ngazëllim le t'i thërrasim duke thënë kështu: O oshënar dhe martir i Jisuit, mos pusho së ndërmjetuari për ne që besërisht kremtojmë kujtimin tënd në këtë shtëpinë tënde.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlind'se e virgjër, dhe të lavdërojmë ne besnikët, siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Pasvargje
Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu mjaft, o martir oshënar,* u shfaqe se në gara edhe asketizim*

* *Një nga emërtimet e vjetra të Beratit*

në kohët e fundit fortturpërove djallin e lasht',* e tregove emrin të përshtatshëm drejt;* trofe të dyfishtë pra* për fitore i ngrite lart,* kështu plagose,* Nikodhim trim, satanin keq,* e kënaqe mjaft* Zonjën e botës tërësisht;* veten e dorëzove në një jetë me saktësi* në Athos, në trashëgimin e saj, që nëna e vet e mbron,* e ruan fort Skitin* që mban emrin e saj, pra të Shën Anës me lavdi.

Varg: I drejti si palmë do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet.

G'zohu; stolise mendjen me hir,* dhe shenjtërove trupin bashkë me shpirtin tënd* me luftë të fortë tok me asketizim, o i urt',* dhe kështu fitove të dyfishtin rreth;* me tre vjet porsi një murg,* me tri ditë mundim pastaj* për Shën Trininë* i pëlqyer u bëre ti;* ndaj atdheu yt* mburret si edhe vendi ku* u përgatite, dhe ky është Skiti i hirshëm krejt,* pra i Shën Anës, stërgjyshes së Krishtit tonë, Zot Shpëtimtar;* për ta mos pusho ti,* at', së luturi, lavdi ilirike, Nikodhim.

Varg: I lumur ai burrë që ka frikë Zotin.

G'zohu, se pjesëmarrës në gaz* je me martirët lart në qiell, se kishe mall* për të, dhe durove dallgë tmerresh, dhe çdo kërcënim* dhe burgim të errët; por gëzoheshe* teksa kamxhikoheshe* dhe të shtynin në keqtrajtim,* edhe shpërbëhej* trupi yt përmes gjakut tënd* që po rridhte çurk',* sapo kokën ta prenë ty;* ndaj i kurorëzuar, o i lumur, drejt Dhëndrit Zot* rende, atë dëshiroje, dhe përgjërohesh për gjithë ne* që tok e nderojmë* pra, kujtimin tënd të hyjshëm me zemër dhe me shpirt.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

O i diamantë në shpirt, atlet i fortë dëshmor Nikodhim, u tregove lavdia e tërë Ilirisë si dhe mburrja e krenaria e Malit të Shenjtë; se, kur e ngrite kryqin e Krishtit[5] si armë, dhe i more uratat e atyre që asketizonin atje, e shkele luanin dhe dragoin,[7] kryetarin e errësirës, djallin;[8] sepse, meqë pive potirin e martirizimit[9] që ta paratregoi Hyjlindësja dhe për të cilin të parapërgatiti vetë Zoti, u bëre i sinqertë për ta me anën e atletizmit dhe asketizmit tënd, dhe ndërmjeton për ne që të nderojmë, o i lumur.

Tani *Hyjlindësore*

Virgjëresh' e panusëruar që zure trupërisht Perëndinë pa tregim, nën' e Perëndisë së lartë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu, o e gjith'panjollëshme, ti që u fal të gjith've paqësim mëkatesh, prit lutjet tona tani dhe lutu që të shpëtohen shpirtrat tanë.*

Përlëshore
Ting. I Tu lithu sfrajisthentos

Lavdi për Ilirinë dhe mburrje athonite* nder për oshënarë martir Nikodhimin e lëvdojmë;* siç duhej kish bër' asketizim,* pastaj vërtet garoi burrërisht* si Hyjlindësja e kish udhëzuar pra,* me Birin e saj së bashku.* Lavd Krishtit që të lavdëroi ty,* lavd Zotit që u shfaq te ti,* lavd atij që të paprishur e bëri lipsanin tënd.

Hyjlindësore

Gabrieli kur të tha, Virgjëreshë, gëzohu,[10] bashkë me zërin mishërohej Zot' i Gjithësisë[11] te ti, arka e shenjtë, siç tha David i drejtë.[12] U rrëfeve më e gjerë se qiejtë, duke mbajtur krijuesin tënd. Lavdi atij që ndenji te ti. Lavdi atij që lindi prej teje. Lavdi atij që na çliroi me lindjen tënde.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotír

Himnojnë etërit* kremtimdashës në Athos* kujtimin e të urtit, e shën Nikodhimit,* dhe kryesisht ata që janë në Skitin e Shenjtes An';* ngazëllohet tok* Berati dhe Shqipëria,* është vendi kjo* i athloforit të Krishtit,* që po ndërmjeton për ne.

Lavdi

Të mposhti marrëzi* më par', u konvertove,* pastaj erdhe në vete, se malli i hyjshëm* të shndriti; ndaj gatishmërisht rende te porti shpëtimtar,* e pastrove krejt* shpirtin me lot, o hyjmendës;* dhe vrapove prap',* edhe e derdhe ti gjakun* me shpatë, o Nikodhim.

Tani *Hyjlindësore*

U shfaqe, Virgjëresh',* qartë mbrojtëse, ndihmë* për ne të dobëtit, se na ke trashëgim ti,* se ishe nënë Perëndie përmbi mendje, o çudi* paradokse krejt,* e pashpjegueshme është* për ne njerëzit* po gjithashtu dhe për engjëjt,* nderohet me heshtje pra.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV Tahí prokatálave

Pran' Zotit mbret Perëndi, hyjmendës, rri hijesisht;* ke veshur stoli prej gjaku dhe me kore martirësh e oshënarësh tok* me ngazëllim këndon, psal* melodinë e shenjtë* dhe të nderuar; ndaj me përgjërimet e tua* çlirona, o Nikodhim, nga çdo ngasje dhe rrezik.

Lavdi

Kujtimi yt me lavdi sot ka shkëlqyer më fort* se rrezet e diellit gjith' Ilirinë; dhe tërësitë e Athosit* po i gëzon; të mburrin* ty pra mbrojtësin tonë,* o Nikodhim martir murg, ndjesë fajesh ne lypim* ta marrim nga Zoti me uratat e tua pra.

Tani *Hyjlindësore*

Në kohë me mish përmbi mendje e mbajte në bark* ti Zotin Krisht Perëndinjeri që është përtej çdo jete, çdo moti pra;* ndaj, e pacen, të gjithë* të himnojmë vërtet ty,* veçanërisht porsi Perëndilindëse, themi* me zë: Denjësona në amshim për lavdi krejt ne.

Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. Tërth. IV To prostahthén

Të armatosën uratat e Akakit* të hyjshëm, more* prej tij si një armë shkopin,* dhe vrapove drejt udhës* së martirizimit;* pohove, o trim, Jisuin Zot që më par'* mohove në konvertim ti*[2] edhe pastaj,* përmes prerjes së kokës sate, për në qiej vrapove; ndaj me mall thërrasim ne:* Sinonim me triumf, ki gaz.

Lavdi

Duke qëndruar pran' fronit të Trinisë* tok me rreshtime* të hyjnueshme martirësh,* oshënarësh dhe koresh* fort hyjnore shenjtësh,* shijon dritë, o i lum, që s'ka perëndim,* përherë kungon lavd mbi mend,* që s'shprehet dot,* ndaj kujtona ne gjithë që kremtojm' kujtimin tënd me devotshmëri, o Nikodhim,* dhe himnojmë triumfin tënd.

Tani *Hyjlindësore*

Malin e hyjshëm të palatuar,[13] fronin* me pamje zjarri* të Tër'mbretit[14] ta himnojmë,* pra Marjamën, pallatin* e gjithëkulluar* të Fjalës, tryezën,[15] llambën me drit' si ar,*[16] dhe urën që çon drejt jetës,* shkallën e shenjt',* qiellore,[17] Hyjlindësen, le t'i thërrasim, o besimtarë, pra: Ki gaz, nuse* krejt e panusëruar je.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

I drejti si palmë do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet.
Varg: I lumur ai burrë që ka frikë Zotin.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e athloforit.
Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.
Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

Ejani, o shpresëplotë, le ta mburrim sot kujtimin e përvitshëm të oshënarit neomartir; sepse erdhi panairi i përbashkët për ne, murgjit e këtushëm dhe të krishterët e trevave të Belegradit, se Nikodhimi hyjnor që lavdërohet, ka guxim të ndërmjetojë pranë Krishtit Zot për ne dhe për mbarë botën.

Kanunet i Hyjlindëses dhe i shenjtit.

Ode I
Kanuni i Hyjlindëses, poezi e Theofanit të Nikesë, "Të Shkruarit".
Ting. IV
Irmosi: Anikso to stoma mu

»Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej »Shpirtit[18] Shenjt'* dhe këngë do t'i »këndoj nënës së madhe mbi fron;*[19] »dhe do ta kremtoj* me valle buzëqe»shur,* me zë do t'i shpall kudo gjithë »çudit' e saj.*

Ti pesëshen e dyfishtë, shqisat m'i urtëso, o Zonj,'* tregoji si instrumente me dhjet' tela përmes* hirit tënd, sepse* e linde urtësinë*[20] mbi kohë, të thur melodi dhe himnim për ty.

Ai që më parë nga mosqenia nxori çdo gjë në bot',* e Tërëpanjollë, engjëll i vullnetit të madh,*[21] erdhi dhembshurisht* prej teje dhe, si grisi* kodikun, na fali pra zgjidhjen e fajeve.[22]

Të njohim si re të gjallë[23] reflektimi të Atit Zot,*[24] si lindjen e dritës që na e ka shndritur shëmtin'* dhe na hoqi lart,* o Zonjë, ne të gjithë* drejt qiejve dhe drejt Parajsës me plot hare.

U shfaqe stoli pa krahasim për forcat e sipërme,* për gjithë Krijesën, e dëlirë si dhe hyjnën';* hyjnizove pra* natyrën njerëzore,* përmes Birit tënd vetëm ti vrave Hadhin posht'.

Kanuni i shenjtit që ka Akrostihidhë: "Nikolla të këndon ty, Nikodhimin".
Ting. Tërth. IV
Armatilatin Faraó

Çmime fitoreje të dha ty lart nga qielli, atlet oshënar,* Zoti i çdo gjëje,* ndaj u mbushe me të sipërmen hare; tani më mbush* me të pra nëpërmjet lutjeve të tua, i lum tri her',* që ta mburr kujtimin tënd, Nikodhim.

U bëre fli i shenjtë, holokaust pra për Zotin Krisht që në mish* ka pësuar shumë,*[25] se mbarove udhën e atletit me fuqi; me gaz* fluturove drejt qiellit ku çdo zë engjëllor plot hir,* fort i këndshëm psal dhe këndon himnim.

E ndiqje Krishtin, o i lum, dhe, si u bëre imitues i tij,* përmes tij durove* me gatishmëri mundimet me fuqi në

trupin tënd;* ndaj tani me martirët dhe oshënarët gëzon në shpirt,* o shën Nikodhim, nder i Shqipëris'.

Hyjlindësore

Shtëpia jote fort e hyjshme shfaqet plot me mrekulli, dhe gjithnjë* hir hyjnor shërimesh* kjo buron si krua për të gjithë, o Hyjlindëse;* ndaj me mall dhe me besë të mburrim, të lumërojmë ne,* o e Tërëpanjollë pa qortim.

Zbritësore: Anikso to stoma mu

Ja gojën e çel tani

Ode III
I Hyjlindëses
Irmosi: Tus sus imnologus

»O Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim »i pasosur jetësor,* ti siguroji gjith' »ata që të këndojnë plot me zell;* dhe »lart në q'ell ku mbretëron kurorëzoji »me[26] çdo lavdi.*

U mundën fort kushtet e natyrës dhe ligjet e sferës humbën krejt,* o nën' pa cen e Virgjër, përmes shtatzënisë sate pra* përmbi mendim, se mori qenie mishi Zoti që pamje s'kish.

Të pa Solomoni shtrat pa cen, që e mbronin fort gjashtëdhjet' të urt',*[27] atje po shtrihej Perëndi që mori shtesë, Zonjë; pra* me vdekatarët ky u shoqërua[27a] kur na u bë njeri.

Nga gjaku yt i dëlirë mori, u vesh pra me purpur Fjala Zot* e Perëndisë pa trazim, hyjnisht mbështolli bukur ky* krejt lakuriqësinë e natyrës adamiane[28] pra.

Je bër' enë e Hyjnis' që s'mbahet, qyteti frymor i Perëndis',*[29] ku u realizuan të mëdhat' e njohjes që s'shprehet,* mistere që nga jeta s'u dëgjuan,[30] Vajzë pa cen, qortim.

I shenjtit: O stereosas kat' arhás

U shfuqizua çdo fjalim,* çdo marrëzi e tiranit* shum' të frikshëm, athlofor, përmes fjalës* së nderuar që the; tërë mjetet për torturat pra* i përgatit dhe shpatat;* si i tërbuar maniak u bë.

Me një vendim që s'kthehej mbrapsht* në Malin Athos ti shkove,* dhe durove keqtrajtimin e mishit* nën presion të agjërimit, me mundim dhe agripni,* o Nikodhim hyjprurës,* pa u lëkundur pra në moral.

Banove si bir drite[31] ti* në tendat, vendet e Malit;* kishe emrin e përshtatshëm, i urtë,* siç me vepër e tregove mjaft vërtet, u shfaqe pra,* o Nikodhim, fitues* kundër mashtrimi të humburish.

Hyjlindësore

Në barkun tënd plot me nderim* si shi mbi lëmsh[32] pra fushoi,* Virgjëreshë, Krijimtar; na freskoi* gjithë ne të shkrirët mjaft nga vapa e mëkateve* me një freski prej Hirit,* na bëri mirë i dhembshuri.

Zbritësore: Tus sus imnologus

O Zonjë dhe nën'

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

I forcuar nga forca e Bërësit,* Nikodhim, e vithise çdo kurth, vendim* të djallit të lig, dinak;* ligjërisht u ushtrove ti,*[33] se drejt lavdis' së ardhme shikoje, i tërëlum,* kur me durim pësoje tortura të frikshme tmerr;* ndaj gatishmërisht ndiqje xhelatët, dhe kokën* e ule, e kreve pra* fundin tënd; të thërresim ne,* duke lypur* përulësisht:* Ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi

Përmes gjakut të tij purpurin e vet* e ngjyrosi atleti mirë, kështu* u soll i stolisur nur* me pësime drejt Krishtit Zot,* i feksur me shkëlqimin nga lavdi tridiellor* dhe sa e lumërojnë, besnikë, i shndrit me hir.* Ndaj, kur i kremtojmë ditën edhe kujtimin* e shenjtë me plot nderim,* shpejt fitojmë shëndet, shërim* nga sëmundjet,* thërrasim pra:* Ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Tani *Hyjlindësore*

Malin e tëreshenjtë[34] le ta himnojm'* dhe Parajsën mendore, kthimin e mir'* të Evës dhe arkën,[35] pra* edhe portën[17] e qiellshme,* të ndritshmen re[36] dhe ferrën që digjej, por s'prishej dot,*[37] thesarin, pasurinë e madhe të rruzullit;* falje e mëkateve të lashta për ne ësht',* shpëtimi nga krimi yn'* u punua përmes asaj.* I thërrasim* me përmallim:* Ndërmjeto te Zoti, yt Bir,* që ndjesë shkeljesh të jepet* me dorën plot,* tek ata që i falen lindjes sate me bes'.

Ode IV
I Hyjlindëses
Irmosi: O kathímenos en dhoksi

»Ti që rri midis lavdisë, përmbi fro-
»nin[37a] e hyjëshëm, nga një re e lehtë[23]
»erdhe, o Jisu i përjetëshëm dhe na
»shpëtove me dorën jetëdhënëse; të
»thërresim pra: Nder dhe lavdi gjithë-
»një mbi ty.*

Përderisa burove si krua rrëke të gjallë pavdekësie, nektarin e ëmbël rrjedhartë të dhembshurisë, freskon ata që digjen në etje ti, parajsa me të vërtetë e tërëkëndshme, o Zonjë.

Ty, kandilin dritartë me karizma të shtatëshkëlqyera,[16] të zgjodhi Dielli Krisht nga tërë gjinia dhe, kur zbriti, të mori nuse pa burrë për rigatimin e mishit të të vdekshmëve.

Lind ti mbajtësin e tërë Krijesës, i cili posaçërisht i lidhi skajet dhe i bashkoi të kundërtat; me anën tënde bashkëkërcejnë të sipërmet me të poshtmet, dhe të gjitha të lëvdojnë si Zonjën shkaktare të këtyre.

Ti ke qenë, o Vajzë, punishtja e bashkimit të dy natyrave përmbi mendje, fjalë dhe konceptim, prej së cilës u thur Zoti i të gjithave, jo përmes ndryshimi, por përmes bashkimi, pasi veshi mishërimin.

I shenjtit: Si mu iskís Kírie

Dëshiroje, si dre i etur në burime,[38] ta mbaroje me martirizim jetën; prandaj ti vetë u shfaqe në stadium dhe nuk dështove në qëllim, duke i thirrur pa pushim Zotit të të gjithave: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

Dëfre tani, o mitropolia e Belegradit, e mbushur me dhurata hyjnore të Perëndisë, meqë fitove në gjirin tënd thesar të pashterur, të madhin ndër athloforë, Nikodhimin, dhe e ngazëlluar thirri Krishtit: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

Arriti shkëlqyeshëm kujtimi i hyjshëm i Nikodhimit, i oshënarit martir, dhe ndriçon si pishtar Skitin e Shën Anës me përhapjen e çudive, me anën e të cilave dëbohet prishja e demonëve dhe zmbrapsen kolonat e armiqve.

Hyjlindësore

Si do të mundem të rrëfej denjësisht përdëllimet e tua të panumërta, o Zonjë, të cilat si ujë e freskuan plotësisht shpirtin tim të flakëruar si mos më keq përgjithmonë? Oh, po providencën dhe mirëbërjen tënde që vetë e shijova me bollëk?!

Zbritësore: Tin aneksihníaston

»Të pagjurmësuarin plan perëndor,* »që po mishërohet i larti Zot* prej »Virgjëreshës,* Abakumi si profet e »pa dhe tha me zë të madh:* O Zot i »fuqishëm, lavdi më ty.*

Ode V
I Hyjlindëses
Irmosi: Eksesti ta símpanta

»Të gjith' i habite ti me një çudi dhe »një lavdi,* ti, o Virgjëresh' e pamar-

»tuar;* Zotin e jetës që[39] mbretëron lart
»në q'ell si një bir e mbajte në pëqi,*
»dhe shpëtim që lartazi* u dhurove
»besnikëve.*

O e Tërëpaqortueshme e thjeshtë, je fuqia dhe himnimi im,[40] mbështetja e fortë e së vërtetës, rithirrja e mirëqenies, në të cilën e besoj gjithë shpresën time dhe shijimin e jetës.

Je tendë[41] e hirthurur, që fshehe në mitër në një hipostazë pa ndryshim natyrën e panxënshme të Hyjnisë; me anën tënde Perëndia u tregua te të gjithë mishprurës dhe vdekatar i përmbisubstancshëm.

Je det i ëmbël, por i pashkelur, që vithisi tërësisht treshet e hipura tok me Faraonin mendor, dhe shpëtoi Izraelin[42] e ri në qytet qiellor dhe liman të qetë.

"Përmbilartësohesh bukur[43] dhe çuditshëm në stoli", o nusja e Këngës, të thërret[44] i dashuruari pas të mirave; nëpërmjet teje, o Zonjë, e bëri fisnike natyrën e të vdekshmëve dhe e shpëtoi nga dora e keqbërësit.

I shenjtit: Ina ti me aposo

O Nikodhim, kur arrite me shikim ngazëllimi në podiumin e tiranit, nuk u dhe fare llogari[45] dredhisë, manisë dhe egërsisë së tij, por shikoje të ardhmen dhe lavdinë që qëndron përjetësisht, o martir.

O Nikodhim, si fli që i ofrohej tërësisht Krishtit, duroje plagosjet tepër të hidhura në trupin tënd, dhe pësove vdekje përmes shpate; dhe u shpërbleve me kurorë si martir fitimtar.

O Nikodhim, i veshur dukshëm me rrobë shpëtimi dhe me këmishë hareje[46] të ngjyrosur me anën e gjakut tënd të nderuar, me ngazëllim flutorove i kurorëzuar drejt mandrës së shenjtorëve.

Hyjlindësore

O e Tërëdëlirë, ushtritë e Fuqive të sipërme të lumërojnë, ndërsa gjithë gjeneratat e njerëzve të lavdërojnë;[47] sepse vetëm nëpërmjet teje, pasi u bashkuam me qielloret, ne tokësorët himnojmë Birin tënd.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI
I Hyjlindëses
Irmosi: Tin thian taftin

»Këtë të kremte e lusim sot, për Zo-
»njën edhe nënën Hyjlindëse, gjithë
»hyjmendësit,* eni trokisni pra duar-
»të*[48] dhe lavdëroni Zotin që lindi prej
»asaj.*

E shpallim Fjalën dhe urtësin'[20] e parajetshme, Birin e Atit që fushoi realisht* pra me esencën në barkun tënd;* me rigatim shkëlqimi na hyjnizoi ne.

Ai që male ndërtoi, me një shenjë të tregoi ty mal mendor dhe hijeplot[49] me lavd* përmes virtytesh; latoi pra* mish nga ky mal,[13] kur bëhej për ne njeri, o Zonj'.

Stërnëna, kur u kafshua, mori helm prej gjarpri, humbi gjinin',[50] por, e Dëlirë, çdo krijim* me shtatzënin' tënde pa shpjegim,* në një mënyr' të mirë pra hyjnizohet ky.

Shikoj dhe shpall mrekulli që janë më tej mendjes, dijes, o Zonjë e tërëkulluar, si* mban të panxëshmin pa rrjedhje ti,* dhe si krijesë bëhet Krijuesi Krisht Zot.

I shenjtit: Ilásthití mi Sotír

Mentalitetin mishor*[51] e vure nën shpirtin tënd, o Nikodhim, kur asketizim* në Athos ushtrove përmbi mendje; u bëre pra* tip oshënarie,* shembull gare, o i lumur krejt.

Atdheu i Iliris,'* me çmimet e tua mjaft të hyjshme, pasurohet, si dhe* me ndjesën nga asketizmi Mali i Athosit,* se sa të nderojnë,* i shpëton këtu edhe atje.

O Nikodhim oshënar* martir, ke fituar mbi të ligun brenda Kishës së shenjt';* në Skit pra e ngrite përmendoren, i lum tri her',* kundër tij, triumfin,* kur jetove porsi engjëll ti.

Hyjlindësore

E linde Zotin në mish,* Adamin e ri,[52] pra Krishtin Perëndin' e botës së tër',* i cili me ne u shoqërua;[27a] shpëtoji, Zonj'* e gjithëdëlirë,* nga rreziqet sa të ftojnë ty.

Zbritësore: Tin thian taftin

Këtë të kremte

Kontaqi
Ting. Tërth. IV Ti ipermaho

Le ta lëvdojmë* sot ne mbrojtësin e hyjshëm* të vendit tonë,* kryesisht pra të beratasve,* të Vithkuqit tok, martirin, shën oshënarin,* triumfuesin; ta mburrim me psalmim, himnim*[53] perëndishëm, se u bë fitimtar i madh;* t'i thërresim ne:* G'zohu, o Nikodhim i lum.

Shtëpia

U duke, o Nikodhim oshënar, i urtë, i trilumur, engjëll ndër njerëz dhe vdekatar ndër të patrup; se, meqë më parë u errësove rastësisht, pa mendje, tashmë u ndriçove prej dashu-

risë së sinqertë; prandaj ne, të ngazëlluar nga lavdia jote, të themi me zë të lartë këto fjalë:

Gëzohu, o lastar i Illirisë,/ gëzohu, o çështje e Athosit vërtet.
Gëzohu, shijimi i madh i oshënarëve,/ gëzohu, lavdia hyjnore e martirëve.
Gëzohu, krenaria e Skitit të stërnënës së Perëndisë,/ gëzohu, mbrojtja e tij, e dërguar prej Zotit.
Gëzohu, se pësove lodhjet e asketizmit,/ gëzohu, se durove mundimet e garës.
Gëzohu, se zgjodhe më të mirat,/ gëzohu, se arrite më të mëdhatë.
Gëzohu, se të prenë me shpatë,/ gëzohu, se u stolise me kurorë.
G'zohu, o Nikodhim i lum.

Sinaksari

Më 10 të të njëjtit muaj, kujtimi i neomartirit oshënar Nikodhimi.
Vargje: Nikodhimin e gjakosur, Hiri që krijon fitore,/ e bën gati për shpatë.
Në të dhjetën, shpatë e mprehtë vret Nikodhimin.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i dyzet e pesë martirëve të shenjtë që u vranë në Nikopojën e Armenisë.
Vargje: U gjet prej Perëndisë një ushtri[54] e re,/ që me guxim rreshtohet edhe në mes të zjarrit.

Zjarr vrau në të dhjetën nikopojanët tejet të fuqishëm.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Vianor dhe Siluan.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Apolloni nga Sardhe.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i dhjetë mijë Etërve të shenjtë, të cilët Theofili, episkopi i Aleksandrisë, ia dha përmes zjarrit vdekjes së dhunshme për presviterin Isidor.

Në të njëjtën ditë, mbledhja e Shën Joan Theologut në Beatet.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënar Andonit, në Lavrën e Shpellave të Kievit.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
I Hyjlindëses
Irmosi: Uq elátrefsan

»Nuk u faleshin krijesave hyjmendë»sit,[55] por Kryetarit[56] lart,* dhe kërcë»nimin me zjarr* e shkelën me trimëri, »psalnin me brohori:* Zot, lavdi më »ty, o Perëndi i etërve,* ti je vetëm i »bekuar.[57]*

Fenomeni i huaj i shtatzënisë sate lartësohet më sipër se çdo mendje;

sepse, pasi u përshkrua trupërisht i paafrueshmi dhe i papërshkruari nga natyra, i shkroi haptas në libër jete[58] shërbëtorët e tu, o Perëndilindëse e Tërëshenjtë.

Oratorí profecifolëse u mbushën në ty, o Hyjnuse, se, meqë linde zbukuruesin e botës, i stolise të gjithë dhe i ndriçove, o e Tërëkulluar, shpëtimi i të vdekshmëve.

Kishe në bark Fjalën e barasvlershme me Atin dhe me Shpirtin, i cili është një hipostazë në dy esenca, o Zonjë e bekuar, e përhimnuar dhe e mirë, shpëtimi i të vdekshmëve.

Të konceptojmë si fund që nuk arrijmë ta shohim, dhe lartësi që s'rrëfehet, që me lindjen tënde hyjnore e lartësove natyrën e njerëzve, o nënë virgjëreshë, Zonjë e përhimnuar, e bekuar, shpëtimi i të vdekshmëve.

I shenjtit: Theú singatávasin

Drejtove mendjen drejt qëllimit të thirrjes së sipërme,[59] o athlofor, dhe nuk e zbute kur rrethoheshe prej torturash të panumërta, por, duke duruar plagë, psalje: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.[57]

Mitropolia e Belegradit krenohet për trofetë e tua, duke të treguar si mbrojtës, çlirues dhe ruajtës, o i urtë; dhe thërret me ngazëllim: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.[57]

O hyjmendës, i gjete si pasuri qiellore të përhershmet dhe lavdinë e paprishur, ndërsa në vend të torturave, gjete shijim që nuk kalon, brenda të cilit kori i shenjtorëve himnon përherë: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.[57]

Hyjlindësore

Ja ku u mbush tani parathënia hyjnore e Davidit të shenjtë: Me të vërtetë bëjnë litani për fytyrën tënde,[60] o Hyjnënë e dëlirë, poseduesit e pasurisë së Hirit,[61] dhe e bekojnë Perëndinë e etërve tanë.[57]

Zbritësore: Uq elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII
I Hyjlindëses
Irmosi: Pedhas evajís

»Djemtë* e dënuar për t'u djegur,
»prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit
»Krisht, si simbol në lashtësi;*[62] dhe
»si një veprim tani,* dhe tërë botën
»po e mbledh për këng' e lavdërim:*
»Himnojeni ju veprat e Zotit* dhe e
»lartësoni përmbi të gjitha jetët.[63]*

U duke, o Hyjnuse, thesari hyjnor i çdo dëlirësie, tenda e hyjfortifikuar e virgjërisë, zambaku tepër erëkëndshëm i mbjellësit të Krijesës dhe tempulli i shenjtë; prandaj ty, Virgjëreshën, të himnojmë dhe të përmbilartësojmë në gjithë jetët.[63]

Mbaje në mitër zjarrin e Hyjnisë pa u djegur si ferra,[37] duke zgjidhur me lindjen tënde, o e Tërëpaqortueshme e tërëhimnuar, borxhin dhe detyrën e Evës;[50] prandaj ty, Virgjëreshën, të himnojmë dhe të përmbilartësojmë në gjithë jetët.[63]

Fjala e tërëpërsosur më mori të tërin në hipostazë pa rrjedhje, pa trazim dhe pa përzierje; më hyjnizoi të tërin përmes bashkimit plotësisht më të mirë; prandaj ty, Virgjëreshën, të himnojmë dhe të përmbilartësojmë në gjithë jetët.[63]

Pasi kungoi natyrën tonë nga mali, nga Hyjnëna e panusëruar, mjeshtri shfaqet[49] tani si foshnjë gjiri që mbahet nga duart nënore; pra na ngriti të gjithë, që ta himnojmë dhe ta lavdërojmë nënën e tij si Hyjlindëse të vetme.

I shenjtit: Eptaplasios káminon

Lutja jote e gjatë u ngjit te Perëndia, nga ku more, kur luteshe natën, atë që kërkoje besërisht: Kur u shfaq mbretëresha dhe Zonja e të patrupëve, të dorëzoi kanë të mbushur, që pive gatishmërisht, si shenjë atletizmi, o i lavdishëm i lumur.

Pranë Perëndisë të kemi mbrojtës tepër të flaktë; tani të vëmë për hirin tonë para Tërëmbretit dhe Bërësit të Krijesës: Përgjërohu, o i urtë, duke ndërmjetuar me anën e guximit tënd martirik për ata që të himnojnë dhe këndojnë besërisht: O popull, përmbilartësojeni në gjithë jetët.

O i lavdëruar, e kreve hyjmendërisht luftën dhe e turpërove me trimëri armikun, dhe, meqenëse more si fitimtar kurorë qiellore, tani bashkëgëzohesh me kore engjëllore, tok me të cilat thërret pa pushim: Priftërinj, bekoni;[64] popull, lartësoni në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Mendjen time të vdekur, të varrosur e të rënë ngjalle, lartësoje, ngrije ti që u dhe jetë të vdekurve përmes Birit tënd jetëprurës, meqë linde vërtet vetë jetën, o Mari Perëndilindëse, e përmbibekuar, e përmbilavdishme dhe hirplote.

Zbritësore: Pedhas evajís

Djemat e dënuar për t'u djegur

Ode IX
I Hyjlindëses
Irmosi: Apas jijenís

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazë-
»llim te drit' e Shpirtit Shenjt',* eni
»lavdërojeni;* engjëjt e q'ellit eni
»kremtojeni* këtë të shenjtë panair
»të kryezonjës Mari* dhe thërrisni:*
»Ti je më e lumura,* Virgjëresh' e ku-
»lluar Hyjlindëse.*

Je për Fjalën si karrocë e ndritshme fort, me pamje mu si zjarr,* me mjaft emra, me lavdi,* karrocë Mendjesh pa lëndë,[14] plot flori,* pa krahasim, mbështetje krejt hyjnore; më trego* si karrocë* papasionshmërie pra,* dhe të mençur për Birin, Hyjlindëse.

Ty të bëri si një qiell të ri[65] më sipër se çdo qiell pra;* u shpëtoi Forcave* të larta, kur i tëri në barkun tënd* ka zbritur parrëfyeshëm ai që ësht' përtej* pra çdo gjëje,* s'u largua prej shtëpis'* dhe natyrës së Atit, Hyjnuse Zonj'.

Zonjë, pastërtinë tënde pa njollë deshi Dielli gazmor,* ty të mori nuse pra* me një mendim që s'shprehet, për rinovim* natyre që kish vdekur; ndaj me mall të mburrim fort* besërisht ne* dhe të lavdërojmë ty,* porsi shkak për kungimin hyjnor në Zot.

O e Tërëpaqortueshme, ma pusho trazirën që më vjen* brenda zemrës nga veset,* lëvizje mishi ndali dhe ma mbështet* për një vizion pa lëndë shpirtin, dhe mendime kot,* negative* kthe në papasionshmëri,* denjësomë për jetën e ardhshme pra.

I shenjtit: Eksesti epí tuto

Ti përgjëroju Krishtit Zot pa pushim* me martirët edhe oshënarët, se ne të kremtojm'* ditën dhe kujtimin plot dritë, nder,* që nga ndikimi djallëzor* të shpëtojmë si dhe nga çdo rrezik,* nga çdo trishtim, i hyjlum,* që me gaz të të mburrim,* të të himnojmë, oshënar me nam.

Qyteti i Beratit ku kreve drejt,* o i urtë, mbarimin e lum, me gaz po lavdëron* ditën dhe kujtimin tënd, tok me të* dhe Shenjti Mal, o atë, ku* në fillim jetove porsi asket,* o oshënar hyjmendës,* shën Nikodhim, dhe bëre* për garën tënde përgatitje ti.

U duk liman shpëtimi lipsani yt* dhe burim jetësor për besnikët, o shën Nikodhim,* kopsht, lëndin' mendore plot gjelbërim;* sa marrin pjesë me besim* dhe me mall nga ky, përfitojnë leht'* çlirimin nga sëmundjet,* shëndet në shpirt, në trup tok;* detyrimisht të lavdërojmë pra.

Hyjlindësore

Ke kryer mrekulli kur po lindje ti,* o modeste, Gatuesin tënd dhe Zot; bëje tani* pra për mua një tjetër mrekulli:* Shpëto të dëshpëruarin,* mua, siç të lutet martiri yt,* i hyjshmi Nikodhim pra,* shërbyesi yt si dhe* i Birit tënd, o nënë Virgjëresh'.

Zbritësore: Apas jijenís

Gjithë njerëzit

Dërgimësore
Jinekes akutísthite

Më parë u ushtrove mir'* në asketizëm dhe pastaj* kreve drejt udhën[66] e hyjshme* të garës krejt martirike;* ndaj lart në qiej rende ti* dhe qëndron pranë Krishtit Zot,* o atë Nikodhim i lum,* dhe përgjërohesh për ne pra* që ngrohtësisht të lëvdojmë.

Tjetër E ngjashme

Sot kori i martirëve* të rinj dhe oshënarëve,* o Nikodhim i hyjurtë,* tok për kujtimin tënd ka gaz;* etërit athonitë pra* që të kishin vëlla atje,* bashkëkremtojnë me hare* me patriotët e tu tok* në vendin e Shqipërisë.

Hyjlindësore

E arta temjanic',[67] Mari,* e pastër krejt, u bëre ti* en' e Trinisë[68] që s'mbahet;* ishe pëlqyer nga Ati,* Biri fushoi fill në ty,* ndërsa Shpirti i Tërëshenjt'* me përmbiardhjen pra mbi ty,* o Zonjë, ty të tregoi* Perëndilindëse plot lavd.

Lavdërime
Ting. IV O eks ipsistu klithís

Pastrove shqisat e mendjes sate dhe pe* masën e mëkatit tënd, o atë oshënar,* prandaj në tendat e Athosit* vrapove shpejt ti,* dhe e gërvishte këtë me lot e vaj,* dhe shkëlqeve me asketizëm, dhe deshe fort* të lash tok shpirtin dhe trupin tënd,* ta zbutësh Zotin* e Gjithësisë, të vetmin sundimtar,* o shën i lumur,* triumfues, bir ngushëllimi;[69] lyp Krishtin tënd Shpëtimtar* të shpëtojë, të ndiejë* sa të mburrin; të lëvdojmë ne.

Për garën tënde të hyjshme u gatite* ti me asketizëm siç do Perëndia Zot;* Perëndilindësen mbrojtëse* e gjete, prite* prej saj një shenjë që aprovonte qart'* çfarë deshe; ndaj nuk pushoje së luturi* të zbutej Zoti me mirësi* dhe të pajtohej;* vërtet kjo ndodhi kështu atje në Skit,* në Malin Athos* dhe u bëre i denjë pra për vizitën e tij, o shenjt,* meqë asketizove,* Nikodhim, tre vjet me zjarr në shpirt.

Të lau më parë bërja e virtytit* përmes asketizmit, fitove dëshirë, zell* dhe, duke pasur, o oshënar,* uratën, shkopin* e shën Akakit, ti shkove me guxim* drejt tiranit shumë keqdashës dhe, kur atë* e kritikove, pësove keq* tortura shumë* si i dënuar, dhe vdekje me dhunim;* dhe lart u ngjite* me kurorë te Krishti, o oshënar dhe atlet me nam,* që për sa të nderojnë,* pra të lutesh pranë Zotit tënd.

Para pësimit tënd, therjes fort të çmuar,* Skiti i Shën Anës të pati murg dhe ai* me Shqipërinë, atdheun tënd,* të kanë mbrojtës* të flaktë dhe ndërmjetues, thon' me zë:* Ki gaz, mburrja jonë e shquar, neomartir* dhe oshënar, o shën Nikodhim* i Kishës sonë,* selvi e madhe, e bukur dhe e drejt'* për Malin Athos,* si dhe për Ilirinë, se je burim i kristaltë ti,* që gufon ujë jete,* që e pim', kjo lutja jote ësht'.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Sot Nikodhimi oshënar dhe martir, meqë ngriti trofe fitoreje kundër armikut, fitoi me triumf mbi kolonën e demonëve, pasi jetoi me asketizëm në Athos dhe mbaroi si atlet në Belegrad dhe turpëroi plotësisht pabesinë e pushtuesve; prandaj, në kujtimin e tij të lavdërueshëm, Iliria mbarë kremton, pasi u stolis me gjakrat e tij atletike; dhe Athosi bën sot panair, pasi u shenjtërua me djersët e tij asketike dhe rrjedhat e lotëve. Pra, o sinonim i fitores me shumë çmime, mos pusho së ndërmjetuari për ne dhe për të gjithë sa me mallëngjim po kremtojnë kujtimin tënd të hyjshëm dhe të respektuar.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, priti lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i shenjtit, Odet III dhe VI. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Apostullin kërkoje në 2 shtator (Rom. 8.28-39), ndërsa Ungjillin të Premten e Javës së Tretë të Mattheut (10.32-36; 11.1). Kungatore:* Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] Rom. 8.35
[2] Matth. 10.32-33
[2a] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[3] Urt. Sol. 5.16
[4] Ps. 39(40).3
[5] Matth. 16.24; Mark 8.34; Lluk. 9.23
[6] Gal. 2.20
[7] Ps. 90(91).13
[8] Ef. 6.11-12

[9] Matth. 20.22-23; Mark 10.38-39
[10] Lluk. 1.28
[11] Urt. Sol. 8.3
[12] Ps. 131(132).8
[13] Dan. 2.34-35
[14] Jez. 1.13-26
[15] Eks. 25.29; 39.18; 40.20;
Lev. 24.6; Hebr. 9.4
[16] Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22;
Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
[17] Gjen. 28.12-17
[18] Ps. 44(45).2; 118(119).131; Jez. 3.27
[19] Ps. 44(45).10
[20] I Kor. 1.24
[21] Is. 9.6
[22] Kol. 2.14
[23] Is. 19.1
[24] Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3
[25] I Petr. 4.1
[26] I Petr. 5.4
[27] Kënga 3.7
[27a] Baruh 3.38
[28] Gjen. 3.10,21
[29] Ps. 45(46).5; 47.2,9; 86(87).3;
Matth. 5.35; Hebr. 12.22; Apok. 3.12
[30] Joan 9.32
[31] Joan 12.36; Ef. 5.8; I Thes. 5.5
[32] Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6
[33] I Tim. 1.8
[34] II Petr. 1.18
[35] Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2;
II Kron. 6.41; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
[36] Eks. 13.21-22; 16,10; 19.9; 34.5;
Num. 9.15; 11.25; Ligji i Dytë 31.15;
Urt. Sol. 18.3; Is. 19.1
[37] Eks. 3.2-3
[37a] II Kron. 18.18; Is. 6.1; Dan. 7.9
[38] Ps. 41(42).2
[39] Rom. 9.5
[40] Ps. 117(118).14
[41] Eks. 25.8 etj.
[42] Eks. 14.27-29 etj.
[43] Fja. Urt. 29.29 (31.29)
[44] Kënga 5.9; 6.1 (5.17)
[45] Vep. 20.24
[46] Is. 61.10
[47] Lluk. 1.48
[48] Ps. 46(47).2
[49] Abak. 3.3
[50] Gjen. 3.1-19
[51] Rom. 8.6-7
[52] I Kor. 15.45
[53] Ef. 5.19; Kol. 3.16
[54] Gjen. 32.1
[55] Dan. 3.15-18
[56] Rom. 1.25
[57] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2, 22-28
[58] Fil. 4.3; Apok. 3.5; 13.8; 20.15
[59] Fil. 3.14
[60] Ps. 44(45).13
[61] Ef. 2.7
[62] Dan. 3.25
[63] Ps. 102(103). 22; Dan. kap. 3
Lutja e Azarias 34
[64] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[65] II Petr. 3.13
[66] II Tim. 4.7
[67] Eks. 30.1-3; Hebr. 9.4
[68] Joan 14.23
[69] Vep. 4.36

MË 11 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martires së madhe Efimia e tërëfamshme dhe i Ollgës,* mbretëreshë e shenjtë dhe e barabartë me apostujt.

Tipikon

Nëse bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore dhe 6 të shenjtoreve. Lavdi i martires. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i martires. Tani ngjallësore (në Tingullin e Lavdisë, si zakonisht, pra)* Zoti Krisht, bërësi. *Përlëshoret: ngjallësore, të shenjtoreve dhe Hyjlindësorja e tyre.*

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e martires. Himne Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e martires. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e martires. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe të shenjtoreve. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e martires, dhe Ndenjësoret. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore, të shenjtoreve dhe Hyjlindësorja e tyre. Lavdërimet: 3 ngjallësore, 3 të martires dhe 2 të mbretëreshës. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e martires. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, të shenjtoreve dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Apostulli i martires dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore e së dielës.*

* *Poezi e përkthyesit*

NË MBRËMËSORE

Pas Qëndrimit të Parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)

Thirrtore të martires
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

O çudi paradoksale krejt, shqerra e Krishtit buron* derdhje gjaku, sado në varr* shtrihet, por kështu po ndodh* me fuqinë e Shpirtit Shenjt,*[1] se imitoi kjo vdekjen e atij* vullnetarisht,[2] me mundim, atletizim;* kur marrim gjakun ne* për pastrim dhe larje shpirtrash, sjellim himn,* lavd, gjithnjë drejt Perëndis' së tërë gjërave.

Ndale vrulle bishash si më par' profeti shën Daniel,*[3] dhe guxove me shenjtin hir* kundër zjarri lehtësisht;*[4] dhe tortura të ndryshme krejt* ti prite; ndaj more për fitoren pra* rrethin, kurorën që s'vyshket,[5] por qëndron;* dhe drejt të dashurit* shkove lart me gaz, martire me mjaft lavd,* të lëvdojm', të lumërojm', vërtet je zëmadhe.

Vë në kokën tënde dogmën e besimit kor Etërish* të hyjnueshëm, dhe këtë* qart' e përqafon, se mban,* o e tërëkënduar fort,* besën hyjnore të palëkundur dot* edhe zmbraps çdo herezi; ndaj turpëron* mbrojtësit e këqij* të gënjeshtrës, o e lavdëruar mjaft,* pra të lumërojmë ne, si dhe të mburrim ty.

Thirrtore të mbretëreshës
Të ngjashme

Le të përhimnojmë, o besnikë, në çdo kohë dhe vend* krenarinë e rusëve,* se ajo mbi gjithë ne* porsi yll në mëngjes ndriçon,* dhe nga veriu na sjell freskim me hir* neve që digjemi prej pasioneve;* ndaj panair të madh* le të bëjmë tok me ngazëllim, hare,* Krishtin ta falënderojmë pra që na e dha.

Le të të lëvdojnë mbretërit e gjithë, o Perëndi,*[6] se dëgjuan atë që tha* mbreti dhe profeti yt,* se do sjellin sunduesit,* pra perandorët, dhurata në Sion,*[7] që mendërisht është Kisha[8] jote, Zot;* është një nga ata* Ollga që bashkoi fiset në atdhe,* solli paqe pra, dhe ty t'i dha përmes nipit.

Kishe titull, "madhëri" në shtet, por më e madhe ti je* brenda vendit të qiellit* tok me engjëjt në oborr,* në pallatin e Krishtit mbret,* Zotit të zotave[9] që të dha pushtet* mbi tokë, meqë çdo autoritet* jepet prej tij[10] mbi dhé;* të lëvdojmë, se administrove drejt* gradën tënde, hape udh' për Krishtin në Veri.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Nga e djathta e Shpëtimtarit qëndroi virgjëresha, athlofore dhe martire, e veshur me pamposhtmëri, falë virtyteve, e stolisur[11] me vajin e dëlirësisë dhe me gjakun e atletizimit; dhe i thërriste duke mbajtur me ngazëllim llambën:[12] "Në erën e miros sate vrapova,[13] o Krisht Perëndi, sepse u plagosa prej dashurisë sate unë;[14] mos më nda, o Dhëndër përmbiqiellor". Me përgjërimet e saj dërgona nga lart mëshirat e tua, o Shpëtimtar i tërëfuqishëm.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë

lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur, që shkëlqeu prej Atit[15] pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës, i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier. Atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës dhe Leximet

Këndimi i profecisë së Isaias
(43.9-14)

Këto thotë Zoti: "Gjithë kombet u mblodhën së bashku dhe do të mblidhen arkondë nga ato. Kush do t'i njoftojë këto? Ose *gjërat* që nga fillimi kush do t'ju njoftojë? Le t'i sjellin dëshmitarët e tyre, dhe le të drejtohen, dhe le të dëgjojnë, dhe le të thonë të vërteta. Bëhuni dëshmitarët e mi dhe unë dëshmitar", thotë Zoti, Perëndia, "dhe fëmija im që zgjodha; që të njihni dhe të besoni, dhe të kuptoni se unë jam. Përpara meje nuk u bë Perëndi tjetër dhe pas meje nuk do të jetë. Unë Perëndia dhe veç meje nuk është ndonjë që shpëton. Unë lajmërova dhe shpëtova, talla dhe nuk ishte në mes jush i huaj. Ju, dëshmitarë për mua dhe unë, Zoti, Perëndia, ende nga fillimi, dhe nuk ka njeri që të shpëtojë nga duart e mia. Do të bëj, dhe kush do ta kthejë mbrapsht këtë?". Kështu thotë Zoti, Perëndia, që ju çliron, i Shenjti i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve *janë* në dorë Perëndie dhe nuk do t'i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën, dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre dhe ecja nga ne dërrmim, por ata janë në paqe; sepse, edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre *është* plot pavdekësi; dhe pasi do të edukohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata, dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë, dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojë në ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të, do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij, sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë dhe në Zot është paga e tyre, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë prej dore Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë si armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë Krijesën për mbrojtje armiqsh. Do të veshë *si* koracë drejtësi, dhe do të veshë si helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë *si* mburojë të pamposhtur oshënarí dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me të bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm te qëllimi predha rrufesh dhe, si nga një hark i plotë rrethi, nga retë do të hidhen në shenjë dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmbytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligjësi dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur, mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinastí nga i Shumëlarti.

Në Litinë e martires Idhiomele
Ting. I

Ejani, të gjithë shpresëplotët, le ta himnojmë me lavdërime kujtimin e përvitshëm të Efimisë së tërëfamshme, duke thënë: Gëzohu, o athlofore dhe martire që shfuqizove arrogancat e tiranëve dhe qortove marrëzinë e heretikëve; gëzohu, rritja më e mirë e Kalqedonisë dhe bazamenti i palëkundur i orthodhoksëve; gëzohu, ti që për hirin e Dhëndrit tënd e konsumove me anën e torturave freskinë e trupit, ndërsa e shkëlqeve shpirtin me rrezet e Shpirtit; gëzohu, ti që ndërmjeton përgjithmonë për ata që me besim dhe mallëngjim kremtojnë kujtimet e tua.

Ting. II

O çudi paradoksale! Ndonëse qe e vdekur në varr, martirja si e gjallë mbajti në sarkofag me duart e saj të çmuara tomosin tonë, ndërsa atë të heretikëve e shkeli me këmbë, duke e poshtëruar mendimin e tyre të rënë dhe blasfeminë, ndërsa fuqizonte besimin e drejtë dhe autentik të besimtarëve, të cilët shpallnin Krishtin një

në hipostazë, por të dyfishtë në natyrë dhe vullnet. Me ndërmjetimet e saj, o Krisht Perëndi, dhuroju paqe Kishave të tua dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.[15a]

Ting. III

O martire, kush do t'i rrëfejë, siç i meriton, luftërat e atletizmit dhe të besimit,[16] që i garove për Krishtin, në natyrën e pafuqishme të femrës? A kush do të arrijë të thotë me hollësi avantazhet e virtyteve të tua dhe shumicat e mrekullive të tua, o Efimi e tërëfamshme? Apo qëndrueshmërinë e dogmave të drejta dhe stabilitetin e përhershëm të orthodhoksisë? Prandaj ta besuan Etërit e hyjshëm dogmën e besës, meqë ishe e zellshme për të dhe e ruan gjithnjë të pandryshuar, dhe ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Ting. IV

Duke parë sot panair martirik që kryhet mbi dhé, le të dëfrejmë në shpirt dhe le të kërcejmë duke u ngazëlluar; sepse na mblodhi bashkë Efimia e nderuar me anën e bariut të mirë dhe të hyjnueshëm të Kishës; dhe, pasi na e vuri përpara veten e saj, i lejon çdokujt të nxjerrë si ujë shenjtërimin; ndaj, le të afrohemi me besim dhe mendje pa hezitim, duke mos dyshuar aspak, që të nxjerrim pa kursim nga sarkofagu i shenjtë shërimin e sëmundjeve, duke kërkuar prej Krishtit Perëndi falje dhe përdëllimin e madh.[15a]

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Sot Efimia e tërënderuar, nusja e panjollshme e mbretit përmbiqiellor, na mbledh për gosti shpirtërore; prandaj ejani, të gjithë kremtimdashësit, le të dëfrejmë mistikisht në banketin e saj të tërërespektuar dhe të shkëlqyer, pasi të pastrohemi në mendje dhe të ndriçohemi me rrobat e hijshme të Shpirtit të Shenjtë; sepse ajo, si pëllumbeshë e dëlirë, me bukurinë[17] e virgjërisë, kur u martua me Birin, e mori brenda saj si banuese gjithë Trininë e Shenjtë, Atin dhe Birin[18] dhe Shpirtin e Shenjtë, një Perëndi, për të cilin atletizoi meqë e dëshiroi fort dhe e kërkoi; ndaj edhe mbretëron së bashku me të[19] përjetësisht në tendat qiellore.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër, dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Pasvargje të martires
Ting. II Ote ek tu ksilu se

V'llezër,* le të nxjerrim pasuri* që s'mbaron, që derdhet tani falas nga lipsani i shenjt',* është para nesh e tërëfamshmja, pas ejani,* se na shfaqet pra qartas; ndaj ne le t'i pastrojmë* buzët, shpirtin edhe zemrën, dhe me mallëngjim* besërisht ta mburrim të gjithë,* ta kurorëzojmë me himne* fort të hyjshme dhe ta lumërojm' atë.

Varg: **Duke duruar, durova duke pritur Zotin dhe më vuri re.**

Para* podiumi tiranik* besëkeqësh, ti me durim po qëndroje si kudhër fort* pa dërrmim[20] nga dhimbjet, o e bukur, virgjëresh'* dhe martire, dhe shpallje se ish Zot i përsosur* Krishti, që ka marrë mish në dy natyra dhe* dy vullnete; ndaj hedh në këmbë* tomosin që vun' heretikët,* duke mbajtur tonin me gatishmëri.

Varg: **Dhe siguroi mbi gur këmbët e mia dhe drejtoi hapat e mi.**

Gjith' ne* e lëvdojmë besërisht* dhe e lumërojmë me këngë të hyjshme dhe melodi* panairin tënd së bashku, se na ftoi tash* kryeprifti, bariu bizantin; këtë strehë* ruaje dhe mbroje, dhe çlirona nga çdo dëm* përmes ndërmjetimit tënd, vajzë,* Efimi, martire e Krishtit,* o e tërëfamshme, trime plot guxim.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Ti që je e stolisur me virtyte si me lule dhe e ndriçuar në mendje, ti që hedh miro në zemrat e shprësëplotëve dhe që linde nga Lindja si yll i shkëlqyer dhe me anën e përmbiardhjes së Shpirtit të Shenjtë bëre mbledhjen e Etërve të hyjshëm, mos pusho së ndërmjetuari për ne para Zotit, o Efimi e tërëfamshme, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[21] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me athloforen dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Përlëshore e martires
Ting. III Thias písteos

Na gëzove fort* ne orthodhoksët,* turpërove krejt* besëkëqijtë,* Efimi e bukurvirgjër në Krishtin Zot,* se miratove sa Etërit mirësisht* gjatë Sinodit të katërt i bën' dogma;* o martire plot me famë, lyp Krishtin Perëndi* të na dhurohet neve përdëllim i madh.[16a]

Lavdi *Përlëshore e mbretëreshës*
E ngjashme

Ollgë mbretëresh',* të përhimnojmë* dhe çuditemi,* si kishe gjetur* brenda territ idhujtar dritën, Zotin Krisht?*[22] Vërtet fryn Shpirti i Shenjtë ku do ai,*[23] të barabartë bën gra me apostujt pra;* ndërmjeto për kombin tënd, por edhe për ne nga lart,* ku ësht' qyteti qiellor krejt permanent.[24]

Tani *Hyjlindësore*

Ty që ndërmjetove për shpëtimin e gjindjes son', të përhimnojmë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, se duke denjuar pësimin e Kryqit me trupin që mori prej teje Biri yt dhe Perëndia ynë, na çliroi prej prishjes si njeridashës.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësore e martires
Ting. I Ton tafon su Sotír

Vrapoi, o Krisht Zot,* nusja, shqerra pas teje,*[13] pas Dhëndrit qiellor, e plagosur prej mallit;*[14] e kish llambadhen fort të ndezur me vajra[12] virtytesh pra;* na çliro të gjith'* me ndërmjetimet e saj ti,* si i dhembshur fort,* nga lloj-lloj ngasjesh, rreziqesh,* na jep përdëllimin tënd.

Lavdi *Ndenjësore e mbretëreshës*
E ngjashme

Ti shtetin tënd të madh* shpirtërisht e lërove,* dhe fenë e vërtetë, të shenjtë e mbolle,* dhe nipi yt shën Vladimiri i madh, sipas historis',* kultivoi drejt* besën dhe Zoti e rriti,*[25] Ollgë; solli pra* shumicë frytesh,[26] shenjtore,* që Kishën e shndrisin fort.

Tani *Hyjlindësore*

Ti shpresë je për ne* të krishterët, e virgjër,* ti, Zotin që ke lindur mbi mendje e fjalë,* lyp pa pushim, Hyjlindëse, tok me forcat e sipërme,* të na japë ndjes'* mëkatesh, ndreqje jetese* neve dhe çdokujt* që të lëvdon ty me besë* gjithnjë dhe me mall të madh.

Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësore e martires
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Shumë sharje mbushën krejt* faqen e heretikëve* dhe u turpëruan keq* hordhit' e tyre me çnderim,* kur pan' në duart e tua të çmuara fort* tomosin ton', ndërsa i tyri ish* poshtë dhe nën këmbët e tua pra;* kështu qortonte tomosi i drejtë* besimin fals,

marrëzin' e tij,* thërriste: Krishti* me dy natyra* dhe vullnete ka lindur.

Lavdi *Ndenjësore e mbretëreshës E ngjashme*

Me çuditje fort në shpirt,* të admirojmë, o e lum,* si u bëre pra fillim* i krishtërimit[27] në Rusi* dhe i ofrove Jisuit më pas një popull* mjaft të madh porsi udhëçelëse,* ndaj, o e kënduar, të lusim sot:* Edhe për ne drejtoje lutjen tënde* drejt Krishtit tënd tërëmbretit,* të na çlirojë* prej çdo mëkati,* o ndriçuese Ollga.

Tani *Hyjlindësore*

Josifi u çudit gjë përmbi natyrën kur pa, dhe atëherë merrte vesh këtë shiun përmbi lëmsh[28] në zënien tënde të pafarshme, o Hyjlindëse, ferrën që në zjarr ish e padjegshme;[29] shkopin e Aaronit që zuri rrënjë e lulëzoi.[30] I fejuari yt ruajtës dëshmoi e u thërriste priftërinjve: Virgjëresha lindi dhe pas lindjes mbetet prapë e virgjër.*

Pas Polieleit, Ndenjësore e martires
Ting. Tërth. IV
To prostahthén mistikós

Ne virgjëreshën e Krishtit le ta mburrim* me mall, me lavde* psalmikisht në festën e saj,* ditën shumë të shquar*[31] të së tërëfamshmes;* sepse u tregua mbrojtja e dogmave* të Etërve; pas mbarimit* - oh, sa çudi! -* e qortoi Eftihin, Dhioskorin tok të sëmurët keq në dogmën për Krishtin* që himnojmë me lavdërim.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

O e kulluar, ty të falënderojmë,* të madhërojmë* dhe të falemi gjithmonë,* lindjen tënde himnojmë,* o hirplote; themi* me zë pa pushim: Shpëtona, e Virgjër krejt* e tërëmëshirshme, Vajzë,* se je e mir';* na rrëmbe nga hetim tmerrues fort demonësh, në or' shqyrtimi të mos kemi turp,* shërbëtorët e tu pra ne.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV

Proqimeni Ting. IV

Duke duruar, durova duke pritur Zotin dhe më vuri re.

Varg: I drejti si palmë do të lulëzohet.

Ungjilli (kërkoje të Hënën e Javës së pesëmbëdhjetë të Mattheut: Mark. 5.24-34)

Psalmi 50

Lavdi. Me ndërmjetimet e athlofores. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

Nga e djathta e Shpëtimtarit
(Kërkoje në Lavdi e Thirrtoreve të Mbrëmësores)

Kanunet: I Hyjlindëses (shih fq. 11), i martires dhe i mbretëreshës.

Ode I
Kanuni i martires
Ting. IV
Anikso to stoma mu

Do çel gojën time dhe me shpirt do mbushet,[32] dhe melodi,* dhe këng' athlofores së Jisuit Krisht do t'i psal* dhe do shfaqem un'* të shpall me hijeshi nur* luftimet dhe mundjet, të cilat duroi fort.

Na hidh pa kursim dhunti shërimesh[33] neve që me besim* vrapojmë drejt kishës sate, o e thjesht,' dhe me mall* dhe prej thellësis'* së zemrës të kërkojmë* dhe bëjm' panair për kujtimin tënd me hare.

Sipas shën apostullit hyjnor pra tempull u bëre ti,* ku brenda pëlqeu të banonte Krishti yt Zot;* gjithashtu në të* ky eci,[34] meqë ishe,* martire, e pastër në shpirt dhe me plot triumf.

Hyjlindësore

Nuk fshehim avushën e mëshirës sate,[35] o Zonja jon',* dhe kroin që nuk shteron të mrekullive që bën,* mirëbërjet pra* si det, që mbi të gjithë* na derdh ti sipas përdëllimit tënd aq të madh.

Kanuni i mbretëreshës
që ka Akrostihidhë:
"Psal mbretëreshën në tokë
edhe në qiell. Ju."
Ting. dhe Irmosi i njëjtë

Po psal mbretëreshën, mburrjen për çdo sllav dhe për gjithë ne;* prej mbretit të madh Zot,[36] Krisht, unë kërkoj frymëzim,* të më çelë pra* si buzët edhe gojën,* i varfër jam edhe në gjuh',[37] edhe në talent.

S'e di unë nga ku të filloj të pleks lavdërim për ty,* shenjtoren që hape derën për Jisuin tënd Krisht,* që të hynte ky*[38] në mbretërinë tënde,* ta shndriste, ta ngrohte, se ishte e ftohur keq.

Adami qe pararendësi yn,' por na shkaktoi dëm,* se Eva e joshi në mëkatin tepër të madh;*[39] mirëpo u bë* stërmbesa e saj nëna* e kombit të saj kolosal për besim të drejt'.

Lavdishëm nderojmë ne shenjtoren dhe pararendësen,* sepse pas Prodhromit kështillonte shtetin e saj:* Shpejt pendohuni,* afron pra mbretëria* e qiejve,[40] Krishti ka ardhur, shpëtimi yn'.[41]

Hyjlindësore

Me këngë lavdie psalim lartësimin tënd, o Mari,* të mburrim, se nëpërmjet përulësisë së thell'*[42] u tregove ti* si tërëmbretëreshë* që rri psalmikisht në të djathtën e Birit tënd.[11]

Zbritësore: Anikso to stoma mu

Ja gojën e çel tani *(shih fq. 12)*

Ode III
Kanuni i martires: Tus sus imnologus

Si mes stadiumit po garonte martirja e Krishtit me durim?* Oh! Si e shtangu kjo tiranin me një rezistenc' të fort',* se kishte burrëri në torturime njerëzish mizorisht.

Kujtimin tënd, o e tërëfamshme martire, gjithnjë e mburrim fort,* o Efimi, me këngë lavdërimi; kemi pasuri* kutinë e lipsanit tënd të respektuar, të hyjshëm krejt.

E mposhte me trimëri krejt gjarprin e madh dhe mendor,[43] modeste ti;* se të forcoi hir nga Ati, Biri[44] edhe Shenjti Shpirt,* nga Shën Hyjnia Trinisore, pra natyra që s'ka trazim.

Hyjlindësore

Siç kemi detyrë ta himnojmë të gjithë Marinë e dëlir',* të vetmen Zonjë virgjëresh' gjithnjë, se na u bë qendra* e jetës dhe shpëtimit, falë qashtërsisë së skajshme kjo.

Kanuni i mbretëreshës I njëjti

Banesë e ngrite shpirtin tënd për Trininë e Shenjtë,[18] Ollgë, pra* e bëre si pallat luksoz me lavd për tërëmbretin Krisht* që ish pa krahasim më i shkëlqyer se çdo pallat mbi dhé.

Reale në mendje, pozitive në punë, u shfaqe në drejtim,* o Ollgë ose Elgë, gjatë qeverisjes sate pra,* por më e famshme mbete se drejtove veten drejt Krishtit mbret.

E bëre familjen tënde gati të priste Çliruesin Krisht, Zot,* kështu shën Vladimiri, nipi yt, ia solli Perëndis'* të tërë kombin tënd që më përpara rrinte në terr dhe hi.[45]

Hyjlindësore

Të falemi, Zonjë e kulluar, se linde Shpëtuesin Jisu,*[41] që na mësoi se sundimi mbi pasionin vlen më shum'* se çdo sundim mbi popullin; kështu shën Ollga besonte fort.

Zbritësore: Tus sus imnologus

O Zonjë, dhe nën' e Perëndisë

Ndenjësore e martires
Ting. IV O ipsothís en to stravró

Si deshe Dhëndrin tënd,* pra Krishtin, llambadhen* e rregullove mir'* me hir, hijeshi nur,* e tërëfamshme; shndrite me virtyte shkëlqim,* hyre brenda dasmës tok me të,*[12] kur kurorën për ndeshjen ti* e pranove prej këtij;* na çliro nga rreziqet* ne që festojmë drejt kujtimin tënd* fort të nderuar* me besë dhe me respekt.

Lavdi *Ndenjësore e mbretëreshës*
E ngjashme

E barabarta me* apostujt e shenjtë* na mblodhi gjithë ne* të bëjmë kremtim sot* dhe panair gazmor e shpirtëror pasurisht.* Mbretëreshë Ollgë, si gosti* e ke vënë përpara nesh* tërë jetën tënde pra* me arritje të shumta;* ndaj sjellja jote drejt na udhëzon,* je për ne shembull* në rrugën e Krishtit Zot.[46]

Tani *Hyjlindësore*

Për te Hyjlindësja* të rendim tani tok* ne mëkatarët,* dhe t'i biem në gjunjë,* nga zemra thellë t'i thërrasim plot me pendim:* Zonj' e dhembshur, na përkrah se po* shkatërrohemi nga mori* shkeljesh; ndaj nxito ti shpejt* ndihmëtare pra bëhu,* shërbyesit e tu mos i largo* të zbrazët, shpresë të vetme të kemi ty.

Ode IV
Kanuni i martires: Tin aneksihníaston

U pasurove me thesarin e vërtetë që nuk mund ta zhdukë molë dhe kalbësi,[47] o modeste e bukurvirgjër, sepse nuk e fshehe në dhé,[48] por e shpërndave te nevojtarët.[49]

Shoqëria e Etërve u shtang vërtet, u mbush me ngazëllim kur po shihte në duart e tua, o e thjeshtë, tomosin orthodhoks, ndërsa te këmbët, të huajin.

U mbushën shumë me turp të madh të gjithë rreth Dhioskorit dhe Eftihit, që u sëmurën keq, të cilët, o martire Efimi e tërëfamshme, i munde përfundimisht.

Hyjlindësore

Mendje qiellore u çuditën kur e kuptuan misterin që u bë vërtet mbi ty, o Perëndilindëse; prandaj marrakoten, turbullohen shumë të të ofrojnë himn denjësisht.

Kanuni i mbretëreshës I njëjti

Është e kuptueshme se ai që shijoi se fjala e Zotit është e mirë,[50] t'ia

shpallë të afërmit atë; kështu dhe Ollga thërriste: Kthehuni[51] nga veprat e vdekura[52] drejt Perëndisë së gjallë.[53]

Rri, o Ollgë, në të djathtën e përmbimbretëreshës së tërëshenjtë, e cila qëndron në të djathtën[11] e Birit të saj, Sunduesit[54] të qiellit dhe të dheut, të të dukurave dhe të padukurave.[55]

E imitove mbretëreshën e parë të të krishterëve, emrin e së cilës more në pagëzim; ndikimin që pati ajo mbi birin e saj, kishe edhe ti mbi nipin tënd.

Hyjlindësore

Shkakun e çlirimit tonë nga skllavëria e të ligut dhe e kalimit në mbretërinë e lirisë të njohim ty, nënën e të Fortit, të nënshtruesit të armikut.[56]

Zbritësore: Tin aneksihníaston

Të pagjurmësuarin

Ode V
Kanuni i martires:
Eksesti ta símpanta

O e tërëfamshme, preferove pjesën e mirë, duke shpërfillur gjithçka të jetës, lavdi dhe pasuri, sepse një gjë nevojitet; e dëbove përkujdesjen dhe trazirën e të shumtëve, meqë e kishe zili Marinë.[57]

O ngjarje kolosale, e huaj! Një e vdekur në varr, si e gjallë bën çudi më të mëdha nga sa mundet njeriu, duke buruar rrjedhje gjaku si shenjë më e madhe se të drejtët jetojnë.[58]

Meqë je së bashku me Ndërtuesin tënd në qiell, o e tërëfamshme, lutu për ata që besërisht lavdërojnë kujtimin tënd të hyjshëm, o Efimi, martirja e Krishtit, për hirin e të cilit derdhe gjakun tënd si fli.

Hyjlindësore

O Zonjë e panusëruar, me të vërtetë në ty përfundon parathënia e profetëve; sepse zure në mitrën tënde Fjalën e panisshme të Atit, siç paraprediko shoqëria e tyre hyjnore.

Kanuni i mbretëreshës I njëjti

Ëndrra dhe dëshira jote e zjarrtë u realizua, o shën Ollgë, sepse kombi yt u kthye në devotshmëri dhe i ofroi Perëndisë shumicë të madhe shenjtorësh; së bashku me ta ndërmjeto për ne.

Në jetën e mëparshme qeverise me zgjuarsi, madje edhe me dinakëri; por hiri i pagëzimit të ndryshoi, dhe mençurinë e vure kundër satanit dredharak, ndaj e mposhte me triumf mashtrimin.

Nënë paqeprurëse ke qenë për vendin tënd të jashtëzakonshëm në përmasa; dhe pastaj u bëre dritëprurëse për të sipas emrit tënd të krishterë, o Ollgë-Elenë e shenjtë.

Hyjlindësore

Ëmbëlsi pikon[59] emri yt kur shqiptohet nga nevojtari, o nënë e dhembshur e Shpëtimtarit tonë, si dhe nëna jonë, meqë ai është i parëlinduri mes vëllezërve të shumtë.[60]

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI

Kanuni i martires: Tin thian taftin

E tërëthjeshta, të rrjedhshmet, gjithë tokësoret shihte si lule, bar[61] që vyshket pra; kështu* dhe i përbuzi si plehra kot,* që të fitonte Krishtin[62] që deshi fort vërtet.

O vajz', dragoin e madh[43] që po krenohej fort, e shembe edhe e mbyte kur po rridhte çurg* gjaku yt; është ai që ngre* me tinëzi intrigë, komplote kundër nesh.

Ne, duke parë lipsanin tënd të shumëhyjshëm të jetë mes nesh si kënaqësi, dëfrejm',* kemi hare shpirtërore pra* dhe nxjerrim shenjtërim me shëndet dhe çdo kurim.

Hyjlindësore

Të gjithë na befason me lindjen tënde, Virgjëreshë e tërëshenjtë dhe hyjnuse; o!,* si linde pa burr' më parë pra,* edhe pas lindjes mbete pa prishje përsëri!

Kanuni i mbretëreshës I njëjti

Të lavdërojmë, o mburrja e Veriut shpresëtar, aurora boreale që na ndrit* pa perëndim, dhe te dielli* i drejtësisë[63] ti ndërmjeton për çdo besnik.

O pasuri dhe thesar virtyti, kishe qenë shembull për nipin tënd, shën Vladimirin mbret;* dhe ky i madhi model e kish,* Elenë, Kostandinin e madh mes mbretërish.

Ke mposhtur ti me triumf botësunduesin dhe frymët e errësirës djallëzore[64] krejt;* sepse pas emrit në pagëzim* shkëlqeve gjithë dritën e Krishtit, dritës son'.[22]

Hyjlindësore

Ësht' detyrim të të lartësojmë, Zonjë e dëlirë, me mburrje dhe me lavdërime ne,* se u çliruam nga skllavëri,*[65] kur Biri yt fitoi mbi vdekjen[66] me triumf.

Zbritësore: Tin thian taftin

Këtë të kremte e lusim sot

Kontaqi Ting. II

Luftëra në atletizëm, luftëra në besim[16] kreve me zjarr për Krishtin, Dhëndrin tënd; dhe tani, siç ndodhi me herezitë, ndërmjeto që edhe tërbimi i armiqve të nënshtrohet nën këmbët e mbretërve tanë, me anën e Perëndilindëses, ti, e tërëfamshme, që more prej gjashtëqind e tridhjetë Etërve hyjprurës dogmën dhe e ruan.

Shtëpia

Cilën nga ndeshjet a cilën nga arritjet dhe çfarë nga virgjëria a çfarë nga paqortueshmëria e jetës sate të të admirojë më parë njeriu? Sepse ti dëfreve Atin, se u martove me Birin, pasi e stolise shkëlqyeshëm veten tënde përmes Shpirtit; kush ka aftësi për këto? Kush do të mundet tani të flasë sa virtyte të shkëlqejnë rreth e rrotull pa pasur perëndim? Sepse, si nga Lindja, pasi linde prej varrit, feks në të gjitha dhe rrezaton në tokë, në det dhe në çdo kontinent, si dhe i shenjtëron dhe i aromatizon anët e botës; prandaj të besuan tomosin, pasi e more prej gjashtëqind e tridhjetë Etërve hyjprurës dogmën dhe e ruan.

Sinaksari

Më 11 të të njëjtit muaj, kujtimi i martires së madhe, të shenjtë dhe të tërëfamshme Efimia.

Vargje: Gjyko me anën e dogmave, o martire, edhe pse e shtrirë,/ duke miratuar besimin për të cilin atletizove me mall.

Në të njëmbëdhjetën, Efimia siguron dogmën çuditshëm.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i mbretëreshës së shenjtë e të barabartë me apostujt Ollga.

Vargje: E madhe ishe në mbretëri tokësore, Ollgë,/ e madhe je dhe në atë qiellore.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë presviter Kindheu.

Oshënar Leoni në Mandër, mbaron me paqe.

Martirët e shenjtë Markiani dhe Martirokliu mbarojnë, i pari me thikë, tjetri i qëlluar me shigjeta.

Oshënar Nikodhimi që asketizoi në krahinën e manastirit të shenjtë të Vatopedhit dhe që u bë përmes filozofisë sipas Krishtit mësuesi i Grigor Palamait të hyjshëm, mbaron në paqe.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit të shenjtë Nektari në Vriulla të Efesit.

Me ndërmjetimet e tyre, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Kanuni i martires: Uk elátrefsan

Me lehtësi duroje ashpërsinë e torturave, o martire e tërëfamshme, me mendje tepër të qëndrueshme, duke marrë nga lart përkrahje hyjnore,[67] prandaj psalje: O Zot dhe Perëndi i Etërve, je i bekuar.[68]

Shqerra e tërëfamshme dhe virgjëresha e bukur i ftoi të gjithë për gostinë e saj; prandaj dëfreni duke bërë panair, dhe thirrni: O Zot dhe Perëndi i Etërve, je i bekuar.[68]

Ti qortove marrëzinë e Eftihit që pësoi fatkeqësi në besim, si edhe të Dhioskorit të vështirë, o martire e tërëfamshme, duke kënduar: O Zot dhe Perëndi i Etërve, je i bekuar.[68]

Hyjlindësore

Lutem, o e tërëpaqortueshme, zbute Birin tënd dhe mos më shpërfill, o modeste, mua që derdh ngrohtësisht lutje e lot dhe thërras: O Zot dhe Perëndi i Etërve, je i bekuar.[68]

Kanuni i mbretëreshës I njëjti

E realizove parathënien e mbretit profet, o perandoreshë, meqë në fuqinë e Perëndisë, mbretit të mbretërve dhe Zotit të zotave,[9] dëfreve[69] duke psalur: O Zot dhe Perëndi i Etërve, je i bekuar.[68]

Dhe zemrën tënde, o e hyjfrymëzuar, që të bëje të drejtat e Zotit,[70] ndaj të shpërbleu me mbretërinë e qiejve;[71] pra tok me sa u bënë mbretër në Perëndi[72] je edhe ti që psalje: O Zot dhe Perëndi i Etërve, je i bekuar.[68]

Ejani, o kremtimdashës, të lartësojmë gruan që mbretëroi përmes Zotit;[73] na mblodhi të gjithë në panair, që për hirin e saj ta lëvdojmë Perëndinë që e lëvdoi atë që psalte: O Zot dhe Perëndi i Etërve, je i bekuar.[68]

Hyjlindësore

Nënën e Perëndinjeriut ta mburrim, o besnikë; falë virtytit të zemrës së saj të tërëqashtër, u bë qyteti i tij, pra i mbretit të madh,[74] të cilin e madhështojmë duke thirrur: O Zot dhe Perëndi i Etërve, je i bekuar.[68]

Zbritësore: Uk elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII
Kanuni i martires: Pedhas evajís

O Efimi, qëndrove tepër burrërisht para podiumeve të tiranëve që bënin

paligjësi, dhe Krishtin e predikoje Perëndi dhe njeri, të dyfishtë në vullnete dhe njëkohësisht në natyra, dhe thërrisje: Himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në jetë.[75]

Shpërfille lëndë tokësore, sepse kishe mall për Dhëndrin tënd, Krishtin, gjurmët e të cilit ndoqe,[76] o martire; ndaj ngazëllohesh tani me të, duke thirrur: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[75]

Mpihem kur sjell ndërmend dhimbjet e tua të frikshme dhe mundjet që durove në trup femëror, nga dashuria e shumtë për Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, për të vetmin Perëndi trihipostat, o martire e tërëfamshme.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë, ti vetëm u tregove gji i qetë i të dimëruarve dhe strehë në të cilën shpëtojmë, kur përikim ne që jemi në tallazin e jetës; prandaj, siç të detyrohemi, të himnojmë dhe të lavdërojmë në gjithë jetët.

Kanuni i mbretëreshës I njëjti

Ëmbëlsi pikojnë malet[59] dhe madje stepat e vendit tënd, o shenjtore, sepse solle paqe dhe qetësi, bashkove kombin tënd, ishe paqeprurëse, u bëre bijë e Perëndisë;[77] ndaj të lumërojmë duke thirrur: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[75]

Që t'i shërbeje Zotit, o mbretëreshë, pastrove zemrën tënde, dhe u lave me pagëzimin si pararendësja e familjes sate dhe e kombit tënd, i cili ngazëllohet në panairin tënd, duke thirrur melodikisht: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[75]

I psali profeti Perëndisë: "Do të të sjellin mbretër dhurata".[7] Ja pra, që shenjtorja ia ofroi të afërmit dhe popullin e saj dhuratë Krishtit, jo si shtypëse e trashëgimisë[78] që thërret: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[75]

Hyjlindësore

E bekuar je në mes të grave,[79] ndaj të lumërojnë të gjitha gjeneratat;[80] përmes teje dhe kryesisht me anën e Birit tënd, mbretër mbretërojnë[73] si Ollga, duke thirrur: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[75]

Zbritësore: Pedhas evajís

Djemat e dënuar për t'u djegur

Ode IX

Kanuni i martires: Apas jijenís

S'ka fuqi mendim as fjal' njerëzore
të rrëfejë hollësisht* pra nderimet
dhe lavdin'* që more, o martire, që
pa mbarim* të mbretërosh me Krishtin,[19] të fitosh si short trofe* denjësisht krejt,* edhe të shijosh dëfrim*
të pacen lart, o e tërëfamshmja ti.

O e tërëfamshme, ishe e lyer pra
me miro mendërisht,* që ka Shenjti
Shpirt, Hyjnor* dhe aromatizon përgjithnjë çdo shpirt* dhe trup të shpresëplotëve që me besim të vijn,'* si
dhe shqisat* që dëbojn' armikun
larg* që lëshon duhmë dhe është
djallëzor.

Bëjmë me respekt, siç duhet, ne panair me gaz dhe admirim* dhe me hijeshi, me hir* në kishën tënde, ku sot
u mblodhëm tok* me anën e drejtimit
kaq bujar, me mjeshtërin'* e bariut
fort të mirë, për atë* lype Zotin, o e
tërëfamshme pra.

O Trini pa nisje, ruaj dhe mbro sa të
theologojnë ty,* se ke ndërmjetuese* përjetësisht dhe tok me martiret
lart,* rreth lavdit të shkëlqimit tënd,
të bukurvirgjrën, pra* Efiminë;* besërisht dëfrejmë ne* duke kryer kujtimin e saj me mall.

Hyjlindësore

Zonjë e dëlirë, zë të ofrojmë duke
thirrur ne me mall:* Për të Shumëlartin Zot* je fron i zjarrtë,[81] ki gaz; ki
gaz, pallat* i Krishtit; të profetizoi mal
me pjellori* shën Davidi;*[82] je shpëtim për shpirtat tan';* ki gaz, o hijeshi
e apostujve.

Kanuni i mbretëreshës I njëjti

Llambë brenda dimrit rus të paganëve ke qenë, mbretëresh',* dhe tani
nga qielli* gëzohesh duke parë se
kombi yt* e përqafon besimin përsëri
dhe sjell fryte;* po njësoj ti* ndërmjeto për gjithë ne* që kremtojmë kujtimin tënd plot me gaz.

Je ndriçim, pishtar, Elenë, për besën,
sepse kishe dhembshuri,* përkujdesje, dashuri,* por s'kishe epitet
"mirëbërëse"* nga lajkatarët kot;[83]
s'tiranizove popullin,* por shërbeje*
si tha Zoti dhe si do,* o e lumur, e pasur në shpirtin tënd.

Hyjlindësore

Urdhrin qiellor që erdhi me anë engjëlli, e prite krejt* duke thënë: "Ja
unë* jam shërbëtorja para të Lartit
Zot".*[42] Nga rang i ulët pra u ngjite
në nivel të lart',* mbretëresha* je,
se tërëmbretin Krisht* na e linde, si
Ollga besonte fort.

Zbritësore: Apas jijenís

Gjithë njerëzit

Dërgimësore e martires
Epesképsato imás

Sado kishe vdekur ti,* burove miro, gjak jetik,* sepse jeton[84] në Zot të gjall';*[53] dhe në pëqi, o Efimi,* pllakat[85] e dogmave vërtet* të Krishtit tënd i ke dhe i mban, ndaj të lavdërojm'.

E mbretëreshës E ngjashme

U tregove mbretëresh'* që porosin' e Zotit tënd* t'ia shpallje, t'ia njoftoje[86] ti* fisit dhe popullit tënd rus,* o e kënduar në çdo vend,* shenjtore arkondeshë, në dhé dhe në qiell lart.

Hyjlindësore

Perëndia, Zoti yn,'* të dha forc', ndihmë dhe strehim*[87] në pikëllim, peripeci* që përballojmë; ndaj të gjith'* ne na çliro nga çdo trishtim,* nga çdo nevojë,[88] o e dëlirë, e Virgjër krejt.

Lavdërime
Të martires
Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu, martire me virgjëri* për Krishtin, linde ti prej Lindjes si yll me hir,* dhe mbarë planetin shndrit bukuri përmes hijeshis'* transparente qartas, që kish shpirti yt;* me të miratove krejt* besën, dogmën e Etërve,* që ish e hyjshme,* mbylle gjuhën plot blasfemi* të Eftihit dhe* Dhioskorit të marrë keq;* ki gaz, që nga lipsani yt i shenjtë pikon rrëke* gjaku pastrues për njollat, përmes fuqisë së Krishtit Zot;*[89] ai i jep botës* faljen, ndjesën, përdëllimin e madh,[16a] si Shpëtimtar.

Bashkë të vijmë dhe të dëfrejm'* me ngazëllimin shpirtëror, të kremtojmë tok* edhe me të thellin gaz, duke par' këtë panair,* që për athloforen bëhet me lëvdim;* sepse kryelartësi,* arrogancë tiranësh kjo* i mposhti, se kish* forcën që Shenjti Shpirt i dha,*[90] kundër tyre pra* një trofe ngriti madhërisht;* vajzën e bukurvirgjër, sinonime me famë pra* le ta lëvdojmë me këngë melodikisht, dhe me përgjërim* t'i lypim ne Krishtit* t'i dhurojë përdëllimin e madh[15a] krejt rruzullit.

More dy dogma brenda në varr,* martire, dorazi: një ish nga besëkëqij* dhe tjetra e saktë ish, se e formuluan mjaft mir'* Etërit që kishin frymëzim nga lart;* k'të mbajte, por tjetrën ti* drejt e shkele fuqishëm pra,* si gënjeshtare,* kundër Zotit, dhe tërësisht* turpërove keq* heretikët; ndaj

gjithë ne* të mburrim besërisht dhe kemi gaz në kujtimin tënd,* të mbledhur sot prej eprorit të hyjshëm të bizantinëve;* prandaj Shpëtimtarin* lype ti që përdëllimi i madh[15a] t'na jepet pra.

Të mbretëreshës Të ngjashme

Ollgë, i qeverise me mend,* me përkujdesje qytetarët e tu, kështu* të vuri ty tërëmbreti Krisht në të djathtën e tij,* siç thot' Shenjti Shkrim mu në Ungjill hyjnor;*[91] u bëre pra mbretëresh'* dhe sipas Perëndisë Zot;*[72] e kishe shpresën* si Psalmisti te Krishti yt,*[92] dhe s'dështove dot,* se në fund u ndriçua drejt* populli yt, ndaj ke hare në qiell përjetësisht* në Perëndi; si Estera, perandoresha e madhe pra,* s'kërkoje dëfrim ti,* në kurorë prej diamantesh, porse në Perëndi.[93]

Ollgë, si Solomoni, dhe ti* kërkove mendje, urtësi të gjykoje drejt* vërtet kombin kolosal, dhe ai të dha me bollëk* çdo të mirë, çdo gjë,[94] ndaj më Perëndin'* dëfreje[95] dhe luteshe:* "Mbretëreshës, pra mua, Zot,* më jep gjykimet,* ligjin tënd edhe nipit tim,* birit të tim bir,* drejtësi edhe mençuri";* dhe lutjen e dëgjoi dhe të ngriti mbi çdo sovran;*[94] pra edhe ne dëshirojmë të na dhurojë logjikë, mend,* të mos mëkatojmë,* që ta kemi përdëllimin e madh[15a] dhe faljen tok.

Ollgë, gëzohu se je fillim,* aparkë,[96] fli i fisit tënd, kombit tënd vërtet;* Ungjilli të ka si frytin e parë plot ëmbëlsi*[97] në Rusin' e ftohtë, ndaj po të nderojm';* tani që mbarojmë pra* himnin tonë të varfër krejt,* falënderimin* po ta shprehim përzemërsisht,* se ti si e mir'* na ke bërë të denjë ne* për himnin tënd, që ngjan me dy të hollat që gruaja* e ve i hodhi në arkë, në tempull, plot devocion, me shpirt;*[98] edhe lypim Krishtin* që të shenjtëroi, që neve të na japë hir.

Lavdi *I martires*
Ting. Tërth. IV

Çdo gjuhë le të lëvizë për lavdërimin e Efimisë së tërëfamshme; çdo gjini dhe çdo moshë, të rinj dhe virgjëresha,[99] le ta kurorëzojmë me mburrje martiren e virgjër të Krishtit; sepse, pasi u forcua si burrë ligjërisht, dhe hodhi poshtë dobësinë dhe brishtësinë e femrës, me anën e luftërave atletike[100] e rrëzoi përdhé armikun tiran, dhe, përderisa u stolis me kurorë qiellore dhe të hyjnueshme, kërkon nga Dhëndri Perëndi, që të na dhurohet përdëllimi i madh.[15a]

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, priti lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji: Tipiket, dhe nga Kanuni i martires Ode III dhe i mbretëreshës Ode VI. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Kungatore* Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] Lluk. 4.14; Rom. 15.13,19
[2] Matth. 16.23; 20.18; Mark. 8.31; 10.33-34; Joan 18.11
[3] Dan. 6.18
[4] Dan. 3.21-23
[5] I Petr. 5.4
[6] Ps. 137(138).4
[7] Ps. 67(68).30
[8] Hebr. 12.22-23
[9] I Tim. 6.15; Apok. 17.14; 19.16
[10] Rom. 13.1
[11] Ps. 44(45).10
[12] Matth. 25.1-10
[13] Kënga 1.4
[14] Kënga 2.5; 5.8
[15] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[15a] Num. 14.19 etj.
[16] I Tim. 6.12
[17] Kënga 2.10,13; 5.2; 6.9(8)
[18] Joan 14.23
[19] II Tim. 2.12
[20] Jov 41.16
[21] Joan 15.1
[22] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[23] Joan 3.8
[24] Hebr. 13.14
[25] I Kor. 3.6
[26] Joan 15.5
[27] Rom. 16.5; I Kor. 16.15
[28] Gjyk. 6.37-38; Ps. 72(73).6
[29] Eks. 3.2-5
[30] Num. 17.23; Hebr. 9.4
[31] Ps. 80(81).4
[32] Ps. 118(119).131
[33] I Kor. 12.9,28,30
[34] Lev. 26.11-12; Ezek. 37.27; II Kor. 6.16
[35] Ps. 39(40).11
[36] Ps. 46(47).3 etj.
[37] Eks. 4.10; 6.30
[38] Apok. 3.20
[39] Gjen. 3.6-24
[40] Matth. 3.2
[41] Is. 49.6; Vep. 13.47; Hebr. 2.10
[42] Lluk. 1.38
[43] Gjen. 3.4; II Kor. 11.3; Apok. 12.9,14-15; 20.2
[44] II Tim. 2.1
[45] Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
[46] Gjen. 18.19; Vep. 18.25-26 etj.
[47] Matth. 6.19-20; Lluk. 12.33
[48] Matth. 25.18
[49] II Kor. 9.9
[50] Hebr. 6.5
[51] I Petr. 2.25
[52] Hebr. 6.1; 9.14
[53] Jis. N. 3.10; I Tim. 3.15 etj.
[54] I Kron. 29.11; Est. 4.17b; Ps. 102(103).19; Urt. Sol. 12.16
[55] Kol. 1.16
[56] Lluk. 11.22
[57] Lluk. 10.38-42
[58] Urt. Sol. 5.15
[59] Amos 9.13; Joel 4(3).18
[60] Rom. 8.29
[61] Is. 40.6-7; Jak. 1.10-11; I Petr. 1.24
[62] Fil. 3.8
[63] Mal. 4.2(3.20)
[64] Ef. 6.12
[65] Gal. 5.1

[66] II Tim. 1.10; Hebr. 2.14
[67] I Makk. 12.15; 16.3; II Makk. 8.20
[68] Dan. Kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[69] Ps. 20(21).2
[70] II Esd. 7.10; Ps. 118(119).112
[71] Matth. 5.19 etj.
[72] Apok. 5.10
[73] Fja. Urt. 8.15
[74] Ps. 47(48).3; Matth. 5.35
[75] Dan. Kap. 3 Lutja e Azarias 34
[76] I Petr. 2.21
[77] Matth. 5.9
[78] I Petr. 5.3
[79] Lluk. 1.29
[80] Lluk. 1.48
[81] Ezek. 1.13-26
[82] Ps. 67(68).16
[83] Lluk. 22.25
[84] Matth. 22.32-33; Mark 12.26-27; Lluk. 20.37-38
[85] Eks. 31.18
[86] Ps. 2.6-7
[87] Ps. 45(46).2
[88] Ps. 106(107).6
[89] II Kor. 12.9; II Petr. 1.16
[90] Lluk. 4.14; Rom. 15.13,19
[91] Matth. 25.33
[92] Ps. 72(73).28; 77(78).7
[93] Est. 4.17ee -17ff
[94] III [I] Mbret. 3.5-15; II Kron. 1.7-12
[95] Ps. 62(63).12
[96] Eks. 22.29 etj.
[97] Rom. 16.5; I Kor. 16.15
[98] Mark 12.42-44; Lluk. 21.2-4
[99] Ps. 148.12
[100] II Tim. 2.5

TË DIELËN PAS DATËS 12 (13-19) KORRIK

Kujtimi i Etërve të Shenjtë të Sinodit IV Ekumenik, të cilët u mblodhën në Kalqedoni.

NË MBRËMËSORE

Thirrtore:
6 ngjallësore dhe 4 të Etërve:
Ting. Tërth. II Olin apothémeni

Fjalë, që s'përshkruhesh dot,* as nuk kuptohesh, u bëre* mish[1] për ne, të shpalli ty* kori i nderuar i etërve të urt';* njeridashës, të tha* Perëndi perfekt krejt* dhe njeri në dy natyra e vullnete, energji,* një në hipostazë, të vetmin ty;* prandaj ne, duke ditur qart'* se ti je një Zot, Perëndia pra,* bashkë dhe me Atin dhe Shpirtin, po të falemi me bes',* i lumërojmë dhe Etërit* që të predikuan drejt.

O të tërëfamshmit ju,* i shkatërruat Honorin,* Sergjin, Dhioskorin tok* me Eftihin si dhe Nestorin kaq mjeran;* si barinj nxorët drejt* grigjën e Jisuit* nga greminat e dyfishta, duke shpallur fort me zë* se një hipostazë kish Krishti Zot* sado që dy natyra kish,* dhe me energjit' vetëm na u shfaq;* ne atij i falemi si njeri dhe Perëndi perfekt* bashkë me Atin dhe Shpirtin pra* dhe ju lumërojmë tash.

Shpallën drejt hyjprurësit* me një zë se s'u krijua* kurrë energjia pra* as vullneti tërëhyjnor i Krishtit Zot,* që u bë varfanjak*[2] dhe më mori mua,* krejt njeriun; bërjen e vullnetit dhe të energjis',* mishit ia dhan' dhe shmangën çdo trazir'* dhe ndarje hipostaze larg* urtësisht të lumurit; ne lëvdojm'* me një mendje Krishtin, i cili lavdëroi fort ata* që besëmirët festojmë tok* çdo vit me kremtim dhe gaz.

Etërit hyjprurës sot* unanimisht predikuan* Shën Triadhën që s'u bë,* s'u krijua, pra një Zot Perëndi, Hyjni;* shfaqën te gjithë ne* qartë dhe siç duhej* thjeshtësinë e natyrës që ësht' një; në çdo mënyr'* thanë se s'ka Krishti fund as fillim* dhe ka një energji, vullnet* të përbashkët; ndaj i himnojmë tok,* meqë imituan apostujt[3] dhe ungjillin, që këta* e shkruan, na e mësuan drejt* neve krejt që i festojm'.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Trumbetat mistike të Shpirtit, Etërit hyjmbajtës, le t'i himnojmë sot, ata që kënduan në mes të Kishës melodi harmonike theologjie, një Triadhë pa asnjë ndryshim në substancë dhe hyjni, rrëzuesit e mashtrimit dhe mbrojtësit e orthodhoksëve, që ndërmjetojnë gjithmonë te Zoti, që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës*

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Gjenezës
(14.14-20)

Sapo dëgjoi Abrahami se u robërua Loti, vëllai i tij, numëroi ata që kishin lindur në shtëpinë e tij, *pra* treqind e tetëmbëdhjetë *veta,* dhe shkoi prapa tyre deri në Dan. Dhe u hodh mbi ta natën, ai dhe shërbëtorët e tij bashkë me të, dhe i goditi e i ndoqi deri në Hoval, që është në të majtë të Damaskut. Dhe e ktheu gjithë kalorësinë e sodomëve dhe Lotin, vëllanë e tij, dhe gjithë plaçkat e tij, dhe gratë, dhe popullin. Dhe doli mbreti i sodomëve në takim me të, pasi ky u kthye nga therja e Holodhogomorit dhe e mbretërve që ishin me të në luginën e Saviut (kjo ishte fushë mbretërish); dhe Melkisedeku, mbreti i Salimit, nxori bukë dhe verë; dhe ishte prift i të Shumëlartit. Dhe e bekoi Abrahamin dhe tha: I bekuar *qoftë* Abrahami prej Perëndisë së Shumëlartë, i cili ndërtoi qiellin e dheun, dhe i bekuar *qoftë* Perëndia i Shumëlartë, i cili të dorëzoi armiqtë e tu *që të jenë* të nënshtruar te ti.

Këndimi i Ligjit të Dytë
(1.8-11; 15-17)

U tha Moisiu bijve të Izraelit: "Shikoni, e dorëzova para jush dheun; pasi të futeni, trashëgoni dheun, për të cilin Zoti iu betua etërve tanë, Abrahamit, dhe Isaakut, dhe Jakovit, se do t'ua jepte atyre dhe farës së tyre pas këtyre. Dhe iu fola juve në atë kohë, duke thënë: 'Nuk do të mundem t'ju sjell unë vetëm. Zoti, Perëndia ynë, ju shumoi, dhe ja jeni sot si yjet e qiellit për sa i përket numrit. Zoti, Perëndia i etërve tanë, ju shtoftë juve, si jeni, një mijë herë, dhe ju bekoftë, sikundër ju foli juve'. Dhe mora prej jush burra të urtë, dijetarë dhe të mençur, dhe i vura që të udhëheqin mbi ju, kryemijësha dhe kryeqindësha, dhe kryepesëdhjetësha, dhe kryedhjetësha, dhe prokurorë te gjykatësit tuaj. Dhe i porosita gjykatësit tuaj në atë kohë, duke u thënë: 'Dëgjoni midis vëllezërve tuaj dhe gjykoni drejt midis burrit dhe midis vëllait të tij dhe midis prozelitit të tij. Nuk do të njohësh fytyrë në gjykim. Sipas të voglit dhe sipas të madhit do të gjykosh. Nuk do të ulësh fytyrë njeriu, sepse gjykimi është i Perëndisë".

Këndimi i Ligjit të Dytë
(10.14-18; 20-21)

U tha Moisiu bijve të Izraelit: Ja, i Zotit, Perëndisë sate *është* qielli dhe qielli i qiellit, dheu dhe të gjitha sa janë në të. Por Zoti parapëlqeu që t'i dojë etërit tanë, dhe zgjodhi nga të gjitha kombet farën e tyre pas këtyre, ju, në këtë ditë. Dhe do rrethpritni zemërngurtësinë tuaj, dhe qafën tuaj nuk do ta ashpërsoni më; sepse Zoti, Perëndia juaj, ky Perëndi perëndish dhe Zot zotash, Perëndia i madh, i fuqishëm dhe i frikshëm, i cili nuk admiron fytyrën, që nuk do të marrë dhuratë, që bën gjykim për prozelit, dhe jetim, dhe të ve, dhe e do prozelitin, ka për t'i dhënë atij bukë dhe veshje. Zotin, Perëndinë tënd do ta kesh frikë dhe atë vetëm do të adhurosh, dhe tek ai do të ngjitesh dhe në emrin e tij do të betohesh. Ai *do të jetë* krenaria jote dhe ai *do të jetë* Perëndia yt, që të bëri gjëra të mëdha dhe të lavdishme, këto që i panë sytë e tu.

Pasvargje ngjallësore

Lavdi *Ting. III*

Jeni bërë, o Etër të Shenjtë, ruajtës të saktë traditash apostolike;[4] sepse, meqenëse dogmatizuat orthodhoksisht njëqenshmërinë e Trinisë së Shenjtë, rrëzuat sinodikisht blasfeminë e Ariosit; bashkë me të, pasi kritikuat si kundërshtarë të Shpirtit Makedhonin, dënuat Nestorin, Eftikun dhe Dhioskorin, edhe Savelin, edhe Sevir Aqefalin; lutemi që të ruani jetën tonë pa njollë brenda besimit, që të shpëtojmë nga mashtrimi i tyre.

Tani *Hyjlindësore*

Pa farë prej Shpirtit Shenjt pas vullnetit t'Atit zure të Birin e Perëndis', që lindi prej Atit pa nënë para jetëve. E linde për ne trupërisht pa atë dhe e rrite si foshnjë, prandaj mos pusho së ndërmjetuari që të shpëtohen shpirtrat tanë prej rreziqeve.*

Përlëshore ngjallësore

Lavdi *Përlëshore e Etërve Ting. Tërth. IV*

I përmbilavdëruar je, o Krisht Perëndia yn', që i themelove mbi dhé si yje Etërit tanë dhe me anën e tyre u hoqe udhën të gjith've te besa e vërtetë, i shum'mëshirshëm, lavdi më ty.*

Tani *Hyjlindësore*

Ti që linde për ne prej Virgjëreshës dhe durove kryqëzim, o i mir'; që

plaçkove vdekjen me vdekje dhe rrëfeve ngjalljen si Perëndi, mos i zhvështro ata që gatove me dorën tënde; trego njeridashjen tënde, o mëshirplot'; prit Hyjlindësen që të lindi, të ndërmjetojë për ne dhe shpëto, o Shpëtimtari ynë, një popull të dëshpëruar.*

NË MËNGJESORE

Shërbesa e Mesnatës si zakonisht. Në Mëngjesore, Stihologjia e zakonshme ngjallësore dhe Kanunet: Ngjallësor në 4, i Hyjlindëses në 2 dhe të dy të Etërve në 8:

Ode I

Kanuni i parë i Etërve
që ka Akrostihidhë: "Përhimnoj
dërrmuesit e aftë të mashtrimit";
ndërsa në Hyjlindësore: "Filothe"
(i cili e bëri kur u rithirr në fronin e
Konstandinopojës në vitin 1369).

Ting. I
Su i tropeuhos dheksiá

Dua që tani të përhimnoj* sa aftësisht e dërrmuan mashtrimin, Zot;* hirin tënd pra fuqiplot dhe qiellor* thërras dhe energjinë tok,* se vërtet e djathta si dhe fuqia e Atit je.[5]

Na çliruan Etërit e urt'* të gjithë ne nga mashtrimi, se shkuan pas* fjalëve të hyjshme që profetët than'* dhe ligjit ungjillor; ndaj qart'* na mësuan ç'është e njohur dhe jo rreth Perëndis'.

Nga fillimi kori profetik* dhe bashkë grupi i hyjshëm apostolik* një Zot Perëndi trihipostat me forc'* të plotë na mësuan fort;* pra këtë qart' na e zbuluan Etërit plot me nder.

Etërit hyjprurës me besim,* duke u bindur në ligje hyjnore[6] krejt,* na mësuan Bërësin e Gjithësis'*[7] që s'njihet në esencë dot,* veç sa shohin mir'[8] e kuptojnë vetëm nga energjit'.

Hyjlindësore

Dritën trishkëlqyese në bark* e zure, o Zonjë, pra me veprim hyjnor;* o e mirë, shndriti zemrat tona nur,* se të himnojmë besërisht,* meqë je shpëtim i përjetshëm, lavd edhe dritë ti.

Kanuni i dytë
Ting. Tërth. IV
Armatilatin Faraó

Dikur u mblodh kundër Eftihit grupi besimtar i Etërve,* dhe caktoi Zotin* Shpëtimtar se dy natyra ka që s'ndahen dot vërtet;* ata ndoqën me ngulm, qartazi mësimet e atit ton',* shën Kirilit fort të hyjnueshëm.

Numri prej gjashtëqind e tridhjet' burrash fort besnik' vithisën drejt* hilen e Eftihit,* herezinë e Sevirit edhe thanë: Shpallim ne,* duke shkuar pas fjalëve të Kirilit të lumur pra,* se Jisui Krisht dy natyra ka.

Qoft' i anatemuar çdokush që s'shpall Krishtin, Fjalën e Atit Zot,* me dy energjitë,* dy natyrat; se kështu vendosi drejt i katërti* nga Sinodet e Etërve fort të shenjtë me mençuri;* le t'i lumërojmë të gjithë pra.

Hyjlindësore

Rreth teje thanë gjëra të lavdishme[9] brez pas brezi,[10] o e dëlir',* që në bark e mbajte* Fjalën Perëndi[11] dhe mbete e kulluar, o Mari,* o Hyjlindëse; ndaj ne të gjithë të lartësojmë ty,* që pas Perëndis', mbrojtja jonë je.

Zbritësore: Anikso to stoma mu

Ja gojën e çel tani *(shih fq. 12)*

Ode III
Kanuni i parë: O monos idhós

Burimi i par' për çdo të mir',* shën Hiri që nga Shpirti vjen,* ju ka zgjeruar, o zëmëdhenj plot lavd* porsi lumenj, dhe rrëmbyet fort mashtrim* dhe vaditët çdo besnik* me rrëke besimi drejt,* predikime profetësh, apostujsh tok.

Të urtë dhe trima me lavdi,* rrëzuat Sergjin, Pirron krejt,* që kishin qenë mbrojtësit plot me tmerr* të herezisë, dhe Pavlin, Petron e* Theodhorin; Kishën pra* e mbështetët me dogmat* e apostujve edhe të Etërve.

Hyjprurësit shpallën energjin'* të bashkëpafillim, pa mot,* të një Hyjnie pa nisje; thanë se* në dy natyra një Bir ësht', Krishti Zot,* na mësuan si krijes'* energjinë e atij* që u mor, dhe që është krijim qartas.

Hyjlindësore

Sa duam të shohim vezullim* nga Hiri që prej Shpirtit vjen,* shkëlqim hyjnor që kurrë nuk perëndon,* të rendim shpejt drejt burimit të Hirit,* se u jepet përmes tij* besimtarëve çdo gjë,* mirësi: ky ësht' Nëna e Bërësit.

Kanuni i dytë: O stereosas kat' arhás

Ju që kënaqeni pa turp* me fjalën bosh të Sevirit,* pra të mbushur plot me helm vdekjeprurës,* turpërohuni gjithnjë të tërë dhe largohuni* nga Kisha mu si ujqit,*[12] qentë[13] rrëmbyes pa përdëllim.

Ithtarët dhe besnikët, ne,* e adhurojm' Shpëtimtarin,* Gjithëbërësin,[7] me dy energjitë* edhe dy vullnetet, dy esencat që nuk ndahen kurr';*

zmbrapsim përfundimisht drejt* çdo kurth, mashtrim të Sevirit pra.

Ejani le të zmbrapsim fort* mashtrimin e Theodhorit,* të Sevirit si dhe të Dhioskorit,* të Jakovit, të Eftihit tok; t'u psalim himn hyjnor* Etërve shpresëtarë* që bën' Sinodin e katërt pra.

Hyjlindësore

Më sipër se çdo Keruvim* dhe Serafim u tregove,* o Hyjlindëse, se ti vetëm prite* Perëndi të pacenuar brenda barkut, e dëlir';* o e panjollë, me himn* të lumëron çdo besnik plot hir.[10]

Zbritësore: Tus sus imnologus

O Zonjë dhe nën' e Perëndisë

Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore

Ndenjësore
Ting. IV Tahí prokatálave

O Etër të lumur hyjfolës, u shfaqët mbi dhé* ndriçues,[14] shkëlqyes krejt të fortë të së vërtetës, se shkritë herezit',* fjalët e shumta boshe,* blasfemitë; shpërndatë* rrëmujë dhe trazira pra nga famëkëqijtë;* dhe, si hierarkë, ndërmjetoni që të shpëtojm'.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

O Zonjë, pranoji shpejt lutjet që ty të ofrojm',* blatoji këto te Biri yt edhe Perëndia, o e panjollshmja Vajz';* nga çdo rrezik, nevojë* sa te ti rendin, ngriji;* kurthet dhe arrogancat e armiqve të pafe,* që kundër nesh armatosen, mposhti, e pastër krejt.

Ode IV
Kanuni i parë: Oros se ti háriti

Duke studiuar[15] ligjet e Shpirtit,[6] i pranuat ligjet atërore që ju dërguan nga Roma, o të urtë, dhe, pasi i shqyrtuat me dritën e Shpirtit, mbështetët mirë Kishën.[16]

O besnikë, le të kurorëzojmë bukur me himne mbledhjen e hyjshme të hyjprurësve, sepse na e predikuan hapur Fjalën e mishëruar Perëndi,[1] njëkohësisht dhe njeri me energjitë e përshtatshme dhe vullnetet.

O të tërurtë, Honorin që dikur fryhej shumë për fronin dhe autoritetin e Romës së vjetër, e shkatërruat mirë, dhe pas mbarimit e mohuat atë si të padenjë për pushtetin dhe kryesinë.

Hyjlindësore

Meqenëse linde, o Virgjëreshë, Fjalën enipostate të Perëndisë, dritën e

vërtetë,[17] lutem: Çeli sytë e shpirtit tim dhe bëmë pjesëtar të lavdisë së atjeshme, sepse ti je ndërmjetuese pranë tij dhe prijëse.

Kanuni i dytë: Si mu Hristé Kírios

Na thua, o Sevir i pamend dhe kokëbosh: Fjala e pafillim, drita dhe Biri i Atit, është një natyrë e përbërë? Por, duke thënë kështu, njofton dhe një tjetër natyrë, meqë mishi dhe Fjala nuk janë një esencë por dy, o mjeran.

Mësuesi dhe kryetari i aleksandrianëve, kur tha një natyrë të Fjalës, shtoi se ishte natyra e njerëzisë së mishëruar pa fare ndryshim dhe trazim, duke na mësuar fuqishëm të dyja natyrat dhe vullnetet neve që duam të mendojmë orthodhoksisht.

Gjithë ne shpresëplotët shpallim dy natyra pa përzierje të Krishtit, duke qortuar absolutisht tërë besimin e rremë të Eftihit dhe të Dhioskorit të pamend, se ndjekim "termin" e Etërve të Shenjtë dhe fjalët e Kirilit të hyjshëm.

Hyjlindësore

O Hyjnënë e kulluar, je karrocë kerubike,[18] vend dhe banesë e Fjalës atërore të Perëndisë,[11] i cili veshi mish nga mitra jote e pacenuar; prandaj, duke u falur, e lavdërojmë pa pushim të mishëruarin prej teje me dy substanca.

Zbritësore: Tin aneksihníaston

Të pagjurmësuarin

Ode V

Kanuni i parë: O fotisas ti elampsi

O hyjprurës, Krishti ju tregoi ligjvënës[19] që udhëhiqni si Moisiu[20] në mënyrë të përkryer Izraelin e ri,[21] pasi hodhët në fundin e tmerrshëm të humbjes, si ai, Faraonin tepër armiqësor.[22]

Sa i bukur dhe i shkëlqyer është Sinodi i Etërve! Sepse duke mësuar Jisuin e thjeshtë dhe të kombinuar si Perëndi dhe njeri, u predikon gjithë anëve se energjitë e tij janë të dyfishta.

Përderisa i konsideruan si dhuratë hyjnore shkrimet nga Roma, mbi to mbështetën pirgun e shpresëtarisë mësuesit e urtë, kur i shpallën të dyfishta energjitë dhe natyrat e Krishtit.

Pavli, Petroja dhe Theodhori së bashku me Pirron, Sergjin dhe Honorin u shqyrtuan dhe u zbuluan se bënin trazim shumë të turpshëm të natyrave të Krishtit për shkak të konfuzionit të energjisë.

Hyjlindësore

E tëra, o Vajzë, je drita dhe shkëlqimi, meqë u bëre tempull i dritës[23] së paperënduar; prandaj të lutem, ndriçoji bebet e shpirtit tim me anën e dritës sate, o Hyjlindëse.

Kanuni i dytë: Ina ti më aposo

O Sevir i paligjshëm, mos i ngatërro frikshëm natyrat e Krishtit; sepse tërë Mësuesit besnikë dhe të fortlumur ua ekspozuan të gjithëve Krishtin, duke e shpallur në dy substanca dhe në një person.

Fjala e parajetshme e Atit e mori për vete qartë natyrën e njerëzisë, duke dashur, si njeridashës, të na mëshirojë ne të humburit; prandaj e shpall unë atë në dy esenca dhe vullnete.

Sinodi i katërt mposhti Servirin dhe Dhioskorin që blasfemonin Krishtin, kur vërtetoi tomosin e Leonit, kryetarit të Romës, i cili caktonte shumë mirë të pandara të dyja natyrat e Shpëtimtarit.

Hyjlindësore

Duke pasur guxim nënor para Birit tënd, o e Tërëkulluar, të përgjërohemi të mos e shpërfillësh përkujdesjen tonë farefisnore; sepse ne të krishterët të vëmë para Zotit vetëm ty si zbutje dashamirëse.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI
Kanuni i parë: Splahnon Ionán

Mbledhja boshe tmerr* foli për trazim të ri,* të huaj vërtet, pra të natyrave* të Jisuit Zot;* ngatërroi kjo dy energjitë në një* krejt absurde; e dëboi larg këtë grupim,* jashtë* mandrës së hyjnueshme,*[24] tërësia mbar' e orthodhoksëve.

Mbledhja plot mashtrim,* që të shmangte herezin',* Nestorin e frikshëm që po fuste keq* dy bij, në humner'* nga gremina rrëshqiti, në dogma pa vend:* Dogmatisi ngatërrimin e natyrave* edhe* të vullneteve, porse* u zbulua prej Etërve fort hyjnor'.

Krishtin, që më par'* Etërit e shpallën fort* si Bir të njëqenshëm dhe me Shpirtin Shenjt* dhe me Atin tok,* te të gjith' e mësoi përmes energjish* nga Hyjnia shoqëria e Mësuesve;* njohën* si të hyjshëm një vullnet,* energji pas secilës natyrës pra.

Futën mbrojtësit* e mashtrimit shumë keq* edhe, duke dashur, me vullnetet tok* dhe persona pra;* e mendonin vullnetin si hipostatik.* Fare mirë Etërit i demaskuan drejt,* tho-

në* nga natyra ky e ka* energjin' e përshtatshme në ekzistenc'.

Hyjlindësore

Ti u bëre, Zonj',* derë për rrëzim hyjnor,* burim dritësimi që nuk perëndon;* tërësia mbar'* e Hyjnisë fushoi[25] pashprehshëm në ty,* brenda mitrës sate, fort e paqortueshme,* ndaj jep* lavdin si dhe energjin'* natyrore te gjithë sa kanë hall.

Kanuni i dytë: Ilásthití mi Sotír

Për Krishtin folën dikur* dy letrat që ia dërgoi shën Kirili Sukensit, pra* eprorit të Lindjes; dhe këto demaskojnë drejt* hilen e Sevirit,* predikojnë Fjalën besërisht.

Kirili shpall, predikon* se Krishti ka dy natyra dhe dy energji, zmbraps kështu* Sevirin e marrë heretik; ndaj të gjithë ne* mbajm' me këmbëngulje* mësimdhëniet e Kirilit shenjt.

Hyjlindësore

Të shpall ty çdo besimtar,* Mari, si të virgjër dhe Hyjlindëse me dëlirësi,* me lavd absolut, kështu mbyll gojën me nam të keq* të Nestorit si dhe* marrëzin' e Dhioskorit tok.

Zbritësore: Tin thian taftin

Këtë të kremte

Kontaqi
Ting. Tërth. IV

Predikimi i apostujve dhe dogmat e Etërve forcuan një besim në Kishë, e cila, duke u veshur me këmishën e së vërtetës që u end prej theologjisë së sipërme,[26] cakton drejt[27] dhe lavdëron misterin e madh të shpresëtarisë.[28]

Shtëpia

Le të dëgjojmë Kishën e Perëndisë, e cila thërret me predikim të lartë:[29] "I eturi le të vijë tek unë dhe le të pijë;[30] kana që mbaj, është kana e urtësisë;[31] këtë pije e përzjeva[32] me fjalë të vërteta; nuk derdh ujë kundërshtimi,[33] por pohimi, nga i cili, duke pirë Izraeli i tanishëm,[21] sheh Perëndinë të flasë: 'Shikoni, shikoni se vetë unë jam dhe nuk ndryshova;[34] unë jam Perëndia i parë, unë, edhe pas këtyre, dhe veç meje s'ka tjetër absolutisht'.[35] Prandaj ata që marrin pjesë, do të ngopen dhe do të himnojnë misterin e madh të shpresëtarisë".[28]

Sinaksari i ditës dhe pastaj:

Në të njëjtën ditë, kujtojmë gjashtëqind e tridhjetë Etërit hyjprurës të Sinodit të Shenjtë të Katërt Ekumenik në Kalqedoni.

Vargje: O yje dritëprurës qielli me-

ndor,/ me rrezet tuaja ma shkëlqeni mendjen.

Me ndërmjetimet e Etërve tanë të shenjtë, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VIII

Kanuni i parë: Se noitín Theotoke

O Zot, meqenëse më parë kore theologësh të konceptuan ty si Birin e Perëndisë dhe njeri, në botë të predikuan të dyfishtë në vullnet dhe në energji, o njeridashës, duke siguruar dyshen e natyrave të dyfishta.

U dukët stoli të ndritshme të Kishës, sepse, pasi pritët mirë statutet e apostujve, na mësuat të gjithëve ne fjalën e besës,[36] një Zot trinisor, krijues, veprues, me vullnet të tërëfuqishëm.

Kur kuptuat Perëndinë si dritë[23] të pakrijuar dhe jetë të pavdekshme,[37] madje më lart se ato, na e shpallët mirë atë të gjithëve, pasi njohët veçoritë natyrore të përbashkëta dhe të pandara si më të ulëta se natyra.

Si rrufe hyjnore prej drites së hyjshme ju dërgoi në botë Krishti që himnonit Perëndinë e lëvdueshëm dhe të tërëpushtetshëm, duke djegur plotësisht krijuesit e mashtrimit dhe duke ndriçuar Kishën mbarë, o të lumur.

Hyjlindësore

Kur më parë doli nga mitra jote, Krishti shkëlqeu dritë të paperënduar dhe shpëtoi botën i përmbilartësuari; atij përgjëroju, o Hyjnënë, të ndritë sytë mendorë të zemrës sime të errësuar.

Kanuni i dytë: Theú sigatávasin

Duke pohuar Krishtin në dy natyra dhe energji pa ngatërrim e pa ndryshim, zmbrapsim gabimin e Sevirit; prandaj atij që duroi pësimin me marrjen e mishit, i thërrasim: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[38]

Dimë se ishte një qenie ai që ishte mbi dru dhe në gjirin e Atit;[39] ishte Perëndi si në më të lartat ashtu edhe në varr, meqë ishte bashkuar me mish; atij i këndojmë me një zë, duke thirrur: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[38]

O besëmirë, duke urryer zbrazjen e Ariosit, prerjen e "perëndisë së vogël", gjithashtu dhe përzierjen e Savelit, të armiqve të Trinisë, i thërrasim Triadhës: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[38]

Triadik

Të deklarojmë duke theologuar orthodhoksisht Zotin e të gjithave,[40]

Atin vetëm të një Biri të vetëmlindur[41] si dhe duke ditur një Shpirt të drejtë, të bashkëqenshëm dhe të bashkëpërjetshëm që del prej teje.[42]

Zbritësore: Uk elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII
Kanuni i parë: En kamino Pedhes

Etërit e drejtuar nga doktrina hyjnore e apostujve dhe profetëve si nga pikënisja për sulm, predikuan duke thënë: Një është Zoti i të gjithave[40] në hipostazë, Krishti, i dyfishtë në natyrë edhe në energji.

Etërit e Kishës, që të internojnë mirë çdo mashtrim të pacipë dhe blasfemi, thanë qartë se Zoti kishte së bashku energji dhe vullnet esencial të pakrijuar, ndërsa nga ana tjetër, të krijuara, si njeri dhe Ndërtues.

O Etër, me fjalën hyjnore si shpatë[43] në duar, i shtangët mirë armiqtë e besimit të saktë, pasi thatë siç duhej se ishin të dyfishta energjia, vullneti dhe të gjitha natyroret e Shpëtimtarit, sikurse edhe natyrat.

Hyjlindësore

E tëra, o Vajzë, e tëra je e bukur,[44] e tëra me pamje drite, dritëprurëse dhe hyjprurëse, e tëra e vetme dhe e shkëlqyer; prandaj ndriçomi sytë e zemrës sime mua që marr si frymë lavdinë tënde, dhe që u plagosa nga malli[45] për të.

Kanuni i dytë: Eptaplasios káminon

Le të turpërohen fytyrat[46] dhe le të mbyllen gojët e atyre që nuk shpallin një Bir në dy natyra pa ndarje, pa ndryshim dhe pa ngatërrim; sepse të gjithë ne besnikët bashkërisht besojmë se Krishti vepron dhe do sipas njërit dhe tjetrit, pra si Perëndi dhe si njeri, mirëpo jo në persona, por sipas të dyja natyrave.

Ju që vutë si epitet për veten tuaj emrin e Jakov Kentonit, na sqaroni nëse në kolimvithër u pagëzuat në emrin e tij më parë; ndaj, pasi u distancuat nga Krishti për hirin e tij, flisni me vete si ai, dhe bëni qartas paturpësi.

Sinodi i katërt në Kalqedoni mposhti të tmerrshmit, Dhioskorin, Eftihin dhe Sevirin, kur përfundimisht e flaku jashtë mashtrimin e tyre gjembor, që ngatërronte esencat e Shpëtimtarit të Kishës së hyjshme,[47] të Krishtit Zot; duke besuar me orthodhoksi së bashku me Sinodin pra, le t'i urrejmë këta.

Triadik

Trininë e tridritshme, që shkëlqen lavdinë unike nga një natyrë trihipostate, prind pa fillim, Fjalë të bashkënatyrshme me Atin dhe Shpirt të bashkëqenshëm që bashkëmbretëron, o djem, bekojeni; priftërinj, përhimnojeni;[48] popull, përmbilartësojeni në gjithë jetët.

Zbritësore: Pedhas evajís

Djemat e dënuar

Ode IX
Kanuni i parë: Típon tis agnís

Duke* pasur Krishtin brenda jush,* i cili foli më përpara hyjnoret[49] krejt,* tani qashtërisht* ju me të pastrin bashkoheni,* o të lumur; mbështetni pra Kishën[16] ton',* që me mundime shumë,* vërtet me djersë, e formuat drejt.

Shembull* dhe kanun u bëtë ju* për Kishën mbarë hyjnore, o të pasur fort;* të theologojm'* drejt mishërimin e Krishtit Zot* na mësuat, pasi zmbrapsët pra tani* profetikisht fjal' boshe* rreth një Hyjnie që s'u bë kurrë.

Zgjidhët* çdo problem të herezis',*[50] o Etër, mir' na mësuat profetikisht[51]* ndryshimin e madh* të energjisë, dhe shtuat ju* denjësisht: Është kjo gjithëbërëse,* pa krijim, natyrore,* e plotfuqishme, e pandarë krejt.

Shpallët:* "Meqë Perëndia është'* i mirë, e kungojmë përmes ndriçimeve* dhe akteve tok* pra vetëm, dhe nuk afrohet dot* në natyrë",[52] kështu deklaruat fort* si gojë Perëndie;*[53] ju lumërojmë, mirëbërës pra.

Hyjlindësore

Ti je* në himnimin tim kuror'* prej ari, përfundim i hyjshëm, që po tani,* pra pas kthimit tim* nga ikja, Birit tënd ia kam dhën',* e Dëlirë, kushtim dhe falënderim,* se je shkak për të mirat;* mbyll odën un', e thjesht', që të himnoj.

Kanuni i dytë: Eksesti epi tuto

Seviri djallëzor Kishën e dëlir'* të Jisuit Krisht shpoi, e priti pra ky denjësisht* me vendim prej Etërve shpresëplot'* dënim për blasfemi që tha* dhe për fjalët boshe, e mori drejt;* u nxor nga kolektivi* i Etërve mësues,* mjerani jashtë tyre pra u hodh.

Pse ngatërron natyrat e Krishtit Zot,* dhe kështu fut trazim dhe përzierje tok, meqë bashkon* Kryqin, varrin, dhembjen ti me Hyjnin'* që

s'ka pësim, të Fjalës Krisht* pra të vetëmlindurit të Atit,* të Perëndisë?[41] Ndiejmë,* Sevir, pra neveritje* për blasfemin' e madhe, o mjeran.

Hyjlindësore

Ke lindur nga e Virgjra, o Krijimtar,* hidhe posht' arrogancën dhe vetullën dhe çdo vendim,* mendjen që kan' njerëz besëkëqij,* keqdashës; ndërsa na mbështet* tërësin' besnike pa hiç tundim* si Perëndi, na ngri lart* dhe bririn,[54] pra forcona* me besë, të të madhështojmë ne.

I gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.

Më të nderuarën.

Zbritësore: Apas jijenís

Gjithë njerëzit

Dërgimësore ngjallësore dhe të Etërve: Jineqes akutísthite

Sot kemi festë, panair* për Etërit e hyjshëm fort* gjatë kujtimit të tyre;* me lutjet që bëjnë, lypim,* popullin tënd, i dhembshuri* Zot, çliroje[55] nga çdo dëmtim* prej herezive; denjëso* të gjith' ne të të lëvdojmë,* pra Atin, Birin dhe Shpirtin.

Hyjlindësore

E tërëpaqortueshme,* pashprehur linde Perëndi* në dy vullnete, natyra,* ndërkoh' në një hipostazë;* ky me dëshirë gjer në Kryq*[56] për ne u varfërua krejt,* dhe na dhuroi pasuri*[2] hyjnie në ngjalljen e tij* që prej së vdekurish poshtë.

Lavdërime: 5 ngjallësore dhe 3 të Etërve: Ting. Tërth. II Olin apothémeni

Etërit e hyjshëm fort,* pasi formuan çdo shkencë* shpirtërore dhe pastaj,* kur menduan bashkë me Shpirtin Tëreshenjt,*[57] shkruan hyjnisht[58] të gjith'* me një shpirt Simbolin* qiellor dhe të nderuar; në të na mësojnë ne* qartas krejt se Fjala ësht' gjithashtu* tok pa fillim si Ati prind* dhe njësoj substancën e ka ai.* Etërit me lavde, të tërëpasur dhe në të vërtet'* hyjmendës, shkojn' pas mësimeve* dukshëm të apostujve.

Varg: I bekuar je, o Zot, Perëndia i etërve tanë.

Pasi pritën plot shkëlqim* mendor, me hyjfrymëzim pra,* shpallën çdo hyjthënie tok* që diktoi Shpirti. Folën me fjalë shkurt* dhe me mjaft mençuri* dogma ungjillore* dhe tradita bese kryetarët, predikuesit* e

Jisuit, Zotit, të lumurit,* se kishin marrë që nga lart* qartësisht zbulimet e dogmave.* Ndaj edhe këta u ndriçuan dhe u denjësuan fort,* dhe paraqitën besimin ton',* që Hyjnia na mëson.

Varg: Mblidhjani atij oshënarët e tij.

Mblodhën çdo eksperienc'* nga Pimantika dhe vunë* po tani në akt inat* krejt të drejtë, siç duhej;[59] ndaj dëbuan fort* ujqit prishës, të rënd'*[60] dhe kështu i flakën* me hobe prej Shpirtit Shenjt larg[61] tërësis' së Kishës pra,* sepse kishin rënë për vdekje keq,* sëmundje kishin pa shërim.* Po kështu barinjtë e shenjtë bën'* porsi shërbëtorë vërtet të Krishtit tonë, Perëndi,*[62] dhe njohës mjaft të hyjnueshëm,* predikues të fshehtash.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*
I Gjergjit të Nikomedhisë

Kori i Etërve të shenjtë, mbledhur prej anëve të dheut, dogmatizoi një substancë dhe natyrë të Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; edhe misterin e theologjisë ia dorëzoi me fuqi Kishës. Ata, duke i lavdëruar me besë, le t'i lumërojmë duke thënë: O ushtri e hyjshme, luftëtarë hyjfolës të rreshtimit të Zotit, yje shumëndriçuese të kupës së qiellit mendor, kështjella të parrëzueshme të Sionit mistik, lule erëkëndshme të Parajsës, gojë të tërarta të Fjalës, mburrja e Kishës, lavdia e botës, ndërmjetoni pa pushim për shpirtrat tanë.

Tani

E përmbibekuar.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të parë të Etërve. Pas Hyrjes, Përlëshore ngjallësore, e Etërve dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e Paturpëruar. *Kungatore* Lavdëroni.

CITIME

[1] Joan 1.14
[2] II Kor. 8.9
[3] I Thes. 1.6
[4] I Kor. 11.22; II Thes. 2.15
[5] I Kor. 1.24
[6] I Esd. 8.90
[7] Joan 1.3; Kol. 1.16
[8] Matth. 13.16; Lluk. 10.23
[9] Ps. 86(87).3
[10] Lluk. 1.48
[11] Joan 1.1
[12] Vep. 20.29
[13] Apok. 22.15
[14] Fil. 2.15
[15] Ps. 118(119).77,97
[16] Vep. 15.41
[17] Joan 1.9
[18] Ezek. 1.13-26; 10.1
[19] Eks. 24.12 etj.
[20] Eks. 3.10 etj.
[21] Rom. 9.6-7

[22] Eks. 14.27 etj.
[23] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[24] II Makk. 6.4; IV Makk. 4.11
[25] Kol. 2.9
[26] Joan 19.23
[27] II Tim. 2.15
[28] I Tim. 3.16
[29] Fja. Urt. 9.3
[30] Joan 7.37
[31] Fja. Urt. 9.1-2
[32] Fja. Urt. 9.5
[33] Num. 20.13; 27.14;
Ligji i Dytë 32.51; 33.8;
Ps. 80(81).8; 105(106).32
[34] Mal. 3.6
[35] Is. 44.6
[36] I Tim. 4.6
[37] Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4;
I Joan 1.2; 5.12,20
[38] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[39] Joan 1.18
[40] I Kron. 29.11; Est. 4.17b;
Urt. Sol. 12.16;
Ps. 102(103).19
[41] Joan 1.14,18; 3.16,18; Hebr. 11.17;
I Joan 4.9
[42] Joan 15.26
[43] Ef. 6.17
[44] Kënga 4.7
[45] Kënga 2.5; 5.8
[46] Jer. 7.19
[47] Ef. 5.23
[48] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[49] Hebr. 1.1; II Petr. 1.21
[50] psh. III [I] Mbret. 18.22-40
[51] psh. III [I] Mbret. 22.11-17
[52] Eks. 33.18-20
[53] Jer. 15.19
[54] I Mbret. [Sam.] 2.1,10 etj.
[55] Ps. 27(28).9
[56] Matth. 16.23; 20.18;
Mark 8.31; 10.33-34; Joan 18.11
[57] Vep. 15.28
[58] Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10
[59] Ps. 4.5
[60] Vep. 20.29
[61] I Mbret. [Sam.] 17.49-51
[62] Rom. 1.1 etj.

MË 17 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martires së madhe e të shenjtë Marina.

Tipikon

Nëse bie të dielën e Etërve, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Etërve dhe 3 të martires. Lavdi i Etërve. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Leximet e Etërve. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i martires. Tani ngjallësore* (Zoti Krisht Bërësi). *Përlëshoret: ngjallësore, e Etërve, e martires dhe Hyjlindësorja e saj.*

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e martires. Himne Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e Etërve. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, një i Etërve dhe një i martires. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Ndenjësorja e Etërve, e martires dhe Hyjlindësorja e saj. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Etërve, dhe Sinaksari i ditës dhe i Etërve. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore, e Etërve, e martires dhe Hyjlindësorja e saj. Lavdërimet: 2 ngjallësore, 3 të Etërve dhe 3 të martires. Lavdi i Etërve. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit, 4 nga Ode III e Etërve dhe 4 nga Ode VI e martires. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Etërve, e martires dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Apostulli i martires dhe Ungjilli i Etërve. Kungatore e së dielës [dhe* Në kujtim të përjetshëm*].*

NË MBRËMËSORE

Thirrtore
Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu thávmatos

O çudi paradoksale krejt! Vajzë pa fare qortim* dhe e butë, e uli posht'* vetullën që lart u ngrit*[1] të atij që kish thën': "Do zhduk* dheun dhe detin",[1a] se triumfoi kjo* mbi djallëzitë e tij; ndaj, o fuqi,* o hir që Kryqi ka,* qartësisht dhe haptas na mbështetën ne* në lëngim, sëmundje dhe çdo dobësi e ankth.

(2x)

O Marinë e lavdishme fort, martire, ti denjësisht* në banesa në qiell lart*[2] po banon edhe je tok* me rreshtime të virgjra pra* dhe me ushtri

martirike; sa me bes'* kujtimin tënd e kremtojn' dhe me kushtim* nën strehën tënde vijn,'* përmes ndërmjetimit tënd shpëtoji krejt* dhe ndjes', përdëllim të madh[3] kërkoji Zotit tënd.

(2x)

O Marinë famëmadhe, as shijim, as kënaqësi,* as dhe hiret që bota jep,* as rini me bukuri* dhe as zjarr në tortura tmerr* s'të ndanë fare nga dashuria ty* për Krishtin; se dëshirove hijeshi* përmbi mendim, që ka* Dhëndri i nderuar, e arrite pra* si e denjë, o martire hyjlumtuese.

(2x)

Lavdi *Ting. II*

Me zë ngazëllimi[4] dhe me psalme brohoritjeje[5] le ta përhimnojmë martire Marinën, sepse vithisi përtokë mashtrimin e idhujve dhe armikun kundërshtar burrërisht e shkeli në këmbët e saj;[6] kështu pra, pasi mbaroi, fluturoi në qiej me kurorë në kokë, duke thirrur: Kam shumë mall për ty, o Dhëndri im, dhe, meqenëse kam dashuri për ty, ia dorëzova zjarrit mishrat e mia për hirin tënd; ndaj do të fushoj në banesa të amshuara,[2] ku është shtëpia e atyre që dëfrejnë.[7]

Tani *Hyjlindësore*

Gjith' shpresën time e besoj te ti, o nën' e Perëndis', ruajmë nën strehën tënde.

Në Liti Idhiomele
Ting. I

E mbështetur në pohimin e Krishtit si mbi gur të fortë,[8] o Marinë e tërëfamshme, armikun vrasës e fundose në kaos dhe u shpërbleve me kurorën e vyer të fitores.

I njëjti

U numërove me brigada të sipërme, o Marinë e lavdëruar, e tërëthjeshtë, kur le botën dhe dëshirove shumë Krishtin, duke kërkuar për ne përdëllimin e madh.[3]

Ting. II

Si alabastër miroje ia ofrove gjakun tënd Dhëndrit tënd Krisht,[9] o Marinë martire athlofore, e admirueshme dhe e pamposhtur, dhe more si shpërblim prej tij kurorë të paprishshme;[10] prandaj dhe armikun e keq që nga fillimi[11] e shkele me këmbët e tua të bukura, me anën e thirrjes së emrit shpëtimtar[12] të Krishtit Shpëtimtar; kështu pra, u denjësove për dhomë qiellore si virgjëreshë dhe dëshmore e Krishtit, o shumëtriumfuese.

Ting. IV

E lavdërojmë, o Krisht njeridashës, dhembshurinë tënde të shumtë dhe mirësinë që na u bë; sepse edhe gra shfuqizuan mashtrimin e manisë idhujtare me forcën e Kryqit tënd; nuk ia kishin frikën tiranit, shkelën djallëzorin[6] dhe arritën të vinin pas teje; në erën e miros sate vrapuan,[13] dhe ndërmjetojnë për shpirtrat tanë.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

I joshur nga bukuria jote virgjërore, mbreti[14] i lavdisë,[15] Krishti, të mori si nuse të paqortueshme me bashkim pa cen; sepse, duke i dhënë bukurisë sate fuqi në vullnetin e tij,[16] të tregoi të pamposhtur kundër armiqsh dhe pasionesh; dhe, përderisa durove në plagosje të hidhura e tortura tepër të ashpra, me rreth të dyfishtë të kurorëzoi dy herë dhe të vendosi në të djathtën e tij të stolisur si mbretëreshë;[17] atij përgjëroju, o martire virgjëreshë, Marinë e tërëfamshme, që t'u japë himnuesve të tu shpëtim, jetë dhe përdëllim të madh.[3]

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlind'se e virgjër, dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Pasvargje
Ting. II Ote ek tu ksilu

Nusen* e Jisuit Krisht me bes',* o miq të martirëve, ejani ta nderojmë, sepse* shën Marina si martire e qëndrueshme* kish garuar për Zotin e të gjithave;[18] trupin* e stolisi me këmish' të virgjër dhe mbi të* kish gjak gare si rrobë ari;* ndaj, e zbukuruar me rrethin* e dyfishtë, pranë mbretit rri tani.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

Është* e shkëlqyer krejtësisht* dhe vërtet e madhe arritja, fitorja jote, sepse* me natyrë frikacake që përkulet leht',* zhduke malin e madh, dragoin[19] që nuk shikohet,* mendjen djallëzore shumë, porsi një harabel*[20] pa vlerë e munde, Marinë,* dhe vërtet e shkele,[6] kërcen pra* tashmë tok me engjëj admirueshëm.

Vargj: Duke duruar, durova duke pritur Zotin dhe më vuri re.

Fjala* përmbi dhé pra na u shfaq,* dhe ti u tregove vërtet nuse e përzgjedhur për të,* duke shndritur bukur me veprim të hyjshëm krejt,* me hir vyshke, Marinë, bimët e ateizmit,* ndaj nderojm' me mall kujtimin tënd të

shenjtë fort,* edhe përqafojmë kutinë* e lipsanit, dhe marrim hirin* e shërimeve prej saj me gaz tani.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Nga e djathta e Shpëtimtarit qëndroi virgjëresha, athlofore dhe martire, e veshur me pamposhtmëri, falë virtyteve, e stolisur[17] me vajin e dëlirësisë dhe me gjakun e atletizimit dhe i thërriste duke mbajtur me ngazëllim llambën:[21] "Në erën e miros sate vrapova,[13] o Krisht Perëndi, sepse u plagosa prej dashurisë sate unë;[22] mos më nda, o Dhëndër përmbiqiellor". Me përgjërimet e saj dërgona nga lart mëshirat e tua, o Shpëtimtar i tërëfuqishëm.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[23] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me athloforen dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Përlëshore

Shqerra jote, o Jisu

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Misteri i fshehur

[Ose Përlëshore tjetër:
Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

U fejove me Krishtin Fjal', o Marinë, vajz'* e lavdëruar; le çdo lidhje tokësore, kështu* ti garove si e bukur virgjër me shkëlqim,* edhe e shkele me fuqi* kundërshtarin e padukshëm[6] që pe, o athlofore;* ndërsa, shenjte, tani për botën buron dhuratat e shërimeve pra.

Tani *Hyjlindësore*

Gëzohu, o der' e Zotit e pashkuar;[24] gëzohu, o mur dhe mbrojtje e atyre që ikin te ti; gëzohu, o liman i padimëruar dhe e pamartuar; ti që linde trupërisht bërësin tënd dhe Perëndi, mos resht së ndërmjetuari për ata që përhimnojnë dhe adhurojnë Birin tënd.*/

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme, Kanunet: i Hyjlindëses (shih. fq. 11) [në do; ndryshe e Oktoihut] dhe të dy të shenjtores:

Ode I
Kanuni i parë që ka Akrostihidhë:
"Këndoj me melodi nusen martire
të virgjër të Krishtit" .
Poezi e Theofanit.

Ting. Tërth. IV
Igrán dhiodhéfsas

Përqark Perëndisë kërcen me gaz,* mbushesh me shkëlqime prej këtij, pra më jep ndriçim* dritëprurës, virgjëresh' e bukur,* me ndërmjetimet e tua, të lutem ty.

Përdore logjikë të urtë, vajz',* mençurisht, kështu shpërfille paqëndrueshmërin'* e çdo gjëje që rrjedh, prishet, ndaj drejt* u denjësove, martire, për dritën lart.

Martire e thjeshtë, po vij te ti* si një lutës; ndaj me përgjërimin tënd më shpëto,* athlofore, nga çdo tmerr në jetë,* ma qetëso pra furtunën e veseve.

Me hir dhe urti[25] ishte ndritur fort* mendja jote, o Marinë, kish forc' hyjnore krejt,* që jep Shpëtimtari; ndaj s'kish frikë* nga kërcënimet që bënin tiranët kot.

Hyjlindësore

Tregove ti udhën e jetës[26] qart',* kur në mitër kishe, si e zure, jetën në mish;* qe esenciale, ndaj dërrmove,* Hyjnënë, prangat e vdekjes,[27] na dhe çlirim.

Kanuni i dytë, Akrostihidha e të cilit është në Oden IX: "Josif".

Ting. IV
Thalasis to erithreon

E feksur* me shndritje martirike plot lavd, ti kërcen hyjnisht* rreth Perëndisë, hyjnizohesh pra,* dhe përmes ndërmjetimit tënd jep* ndriçim te përhimnuesit e tu, e gjithëfamshme plot me hir.

E virgjër,* martire dhe hyjmendëse, me atletizmin tënd* lërove arën shpirtërore mir';* ndaj kallirin e ndeshjes e bën,* e ruan fort për bujkun që të frymëzoi me fuqin' e tij.

Ngjyrose* me gjakun tënd mantel të purpurt, u stolise pra* me hijeshi, në mbretëritë lart* ku banon si e virgjër me lavd,* martire shën Marinë, dhe me dritësim hyjnor shkëlqen ti nur.

Me forcën* e Shpirtit[28] tërëbërës, o martire plot me lavd,* e fuqizuar krejt, me burrëri* përmes mundjesh armikun tiran* të fort', sado krenohej, e përkule dhe e mposhte nën këmbë.[6]

Hyjlindësore

Hyjnënë,* u bëre en' që mbajte Hirin e hyjnueshëm,* të dëshiroi pra Marina ty,* prapa teje kjo virgjërisht* u soll kështu[29] te Biri yt, o e pacen, Perëndilindëse.

Ode III
Kanuni i pare:
Uq estin ájios os o Theós

O e tërëpasur, nuk të ndanë nga dashuria hyjnore as zjarr, as fshikullime, as teh shpate,[30] as mizorí tiranësh, as vdekje, as egërsi bishash.

O e tërëlavdëruar e gjithëlumur, ke qenë kullë e palëkundur dhe e patundur shpresëtarie në kohë peripecie, pasi vure mbështetëse në gurin e besimit.[8]

Ke qenë virgjëreshë ndër martire, u bëre e pamposhtur ndër virgjëresha, o dëshmore e tërëpasur, kur u martove me Krishtin, i cili të dha kurorë të dyfishtë.

O e bukurvirgjër, rrjedhat e gjakrave të tua, duke u derdhur, shuan absolutisht tërë mashtrimin e idhujve, dhe i sollën Dhëndrit tënd një bashkësi martiresh.

Hyjlindësore

Të forcuar prej Hirit, të besojmë me një mendje si Perëndilindëse, sepse linde, kur u bë mish, atë që u jep të gjithëve ekzistencën;[31] dhe ripërtërite botën.

Kanuni i dytë: Efrénete epí si

Modeste, e deshe ti* pësimin e atij që kurrë s'pëson,* por që është vrar' për ne,* pra, martire, vdes me martirizim.

Meqë deshe të arrish,* të përfitosh dhunti të madhe krejt pra,* si në tjetër trup duron* dhembje mishi, tërëmodeste ti.

Me pikat e gjakut tënd,* martire shën Marinë, shove krejt zjarr* ateizmi, e vadit* ti moralin pra të besnikëve.

Kur shfaqe, dëshmore, forc',* qëndresë martirike krejt me durim,* theve keq stërkëmbësin*[6] pra me thembra shumë të bukura.[32]

Hyjlindësore

Vërtet edhe kryesisht* besnikët si Perëndilindëse ty* të nderojn', se linde Zot* që, e paqortueshme, mish u bë.

Irmosi: Efrénete epí si

»Dëfrehet në ty,[33] o Krisht,* dhe të »thërret pra Kisha jote me gaz:* »Streha, përforcimi im* dhe fuqia »ime je ti, o Zot.[34]

Ndenjësore
Ting. IV Kateplaji Iosíf

**Ne besnikët të lëvdojm',* sepse armikun tiranik* me guxim e shtype

krejt* me këmbë,[6] meqë kishe forc'* nga Kryqi dhe burrëri në bes' na u bëre;* çdo fuqi armike e shkele fort,*[35] ndaj, o e kënduar, nga lart more* për kokën një kurorë, o Marinë,* ti shën martire e Krishtit;* atij, vajz', lypi* që të shpëtojmë* sa kujtimin tënd kryejm'.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Josifi u çudit, që përmbi natyrën kur pa, dhe at'herë merrte vesh k'të shiun përmbi lëmsh[36] në zënien tënde të pafarshme, o Hyjlindëse, ferrën që në zjarr ish e padjegshme,[37] shkopin e Aaronit që zu rrënj' e lulëzoj;[38] i fejuari yt ruajtës dëshmoi e u thërriste prift'rinjve: Virgjëresha lind dhe pas lindjes mbetet prapë e virgjër.*

Ode IV
Kanuni i parë: Si mu iskís Kírie

Me të vërtetë jeta jote u bë siç i duhet Perëndisë, u duk shumë e dëshiruar prej engjëjve, ndërsa u shfaq e paafrueshme nga ushtria e demonëve dhe nga shërbëtorët e tyre të egër, sepse i thërrisje Krishtit: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

O martire e kënduar dhe e tërëpasur, pasi luftove në tokë dhe durove dhimbje të përkohshme, tani në qiej merr shpërblimet e pafundme nga Zoti, duke thirrur me engjëj përjetë: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

Tani për ty ngazëllohet krenaria e virgjëreshave, tani dëfren bashkësia e martireve, tani edhe shumica e shpresëplotëve të mbledhur kërcejnë me hare, duke i thirrur Zotit me zëra të pareshtur: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

U paraqite e tëra, vajzë e bukur[39] dhe e panjollshme; u duke e tëra si nuse e gjithëpaqortueshme për të dashuruarin pas stolisjes së shpirtrave; sepse, përmes flakërimi zjarri torturash, o e tërëlumërueshme, u shfaqe më e ndritshme, duke i kënduar Krishtit: Lavdi fuqisë sate, o njeridashës.

Hyjlindësore

O Hyjnuse, vetëm ti mbete e kulluar edhe pas lindjes, sepse vetëm ti ke lindur Fjalën enipostate, Birin e bashkëfronshëm me Atin, i cili u mishërua prej teje; dhe ti mban në prehër të panxënshmin nga asnjë gjë, i cili posedon pushtetin e të gjithave.[40]

Kanuni i dytë: Eparthenta se idhusa

E shkëlqyer nga llamburitje martirizimi dhe e veshur me kurorë paprishjeje,[10] qëndron me gëzim pranë

Krishtit,[41] Dhëndrit tënd, o Marinë, martire e tërëfamshme.

Me qëndrueshmëri martirike, kur e zmbrapse atë që me mashtrim i vuri stërkëmbëse Evës së parë,[42] e rrëzove dhe e tregove si të pafuqishëm, dhe, duke u ngazëlluar, thërrisje: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Keqdashësit, duke të shqyer si ujqër ty, shqerrën e panjollshme, të bënë, o martire, me anën e plagosjes flijim dhe therore të hyjshme, të patëmetë dhe të plotë të Perëndisë.[43]

Duke ndjekur gjurmët[44] hyjnore të Bariut,[45] për hirin e tij durove pësimin vullnetar, dhe fushove në mandër qiellore, ku janë rreshtimet e martireve, o dëshmore.

Hyjlindësore

Ti që u shfaqe si e tërëpaqortueshme dhe e vetmja më e shenjtë se Kerubimet, shpëtona nga çdo peripeci shpirtrat neve që po të himnojmë me besë, o Virgjëreshë hyjnuse pa cen.

Ode V

Kanuni i parë: Ina ti me aposo

O vajzë, tejkalove udhën shumë të vështirë të atletëve në stadium, sepse malli hyjnor i dha krahë dobësisë femërore, duke treguar haptazi se mendja është sundimtar i pësimeve,[46] o martire.

Pikat e gjakrave të tua që pikonin, thurën mantelin e çmuar dhe këmishën e ngazëllimit[47] të pacen, o martire; me të e veshur, tani në qiej qëndron pranë Dhëndrit tënd mendor, o hyjmendëse.

Në prangat e uratave të tua, o vajzë, e lidhe gjarprin[48] fodull, dhe e përule përtokë vetullën ish-të ngritur;[1] sepse Gjithëshikuesi si i mirë kryen, siç di ai, dëshirën e atyre që e kanë frikë.[49]

Fjala, Dhëndri Krisht, të stolisi me kurora të hyjshme lavdie[50] vërtet shumë të lartë; sepse të pa që garoje për të dhe që duroje fuqishëm flakën e zjarrit dhe dhimbjet e torturave, o e lavdishme.

Hyjlindësore

Duke parë ne, o e tërëpaqortueshme, të pastrohet me lindjen e virgjërisë sate natyra e vdekatarëve nga mallkimi i mëparshëm,[51] e lavdërojmë atë që lindi prej teje nga dhembshuria, o e vetmja e dëlirë; atij përgjëroju që të shpëtojmë, o Virgjëreshë.

Kanuni i dytë: Si Kírié mu fos

Duke u afruar fuqishëm te drita e madhe, u bëre dritë dhe ndriçon ata

që e kremtojnë kujtimin tënd dritëprurës.

"Kënaqem si e virgjër vetëm me bukuritë e tua; duke të dashur ty, o Zot, therem me shpatë", thërriste Marina.

O martire, rrjedhjen e ateizmit të besëkëqijve e thave me rrëketë e gjakrave që u derdhën padrejtësisht, dhe shove zjarr mashtrimi.

Ia solle Perëndisë gjithë veten tënde, duke bërë me bojërat e gjakrave më të shkëlqyer të kuqen e ndrojtjes së virgjërisë.

Hyjlindësore

Ndaloi rrjedhja e prishjes, sepse Virgjëresha ka lindur pa prishje atë që çliroi nga prishja natyrën e prishur të njerëzve.

Ode VI

Kanuni i parë: Ilásthití mi Sotír

U duke si bukuri* pa njoll', që për Krishtin ish veçuar, dhe burim i kristalt',* edhe kopsht frutdhënës shumë, nuse e pastër krejt* dhe Parajs' që s'vidhet,* o Marinë e lavdishme fort.

Një vashë plot hijeshi* pas teje kish ardhur, se vrapoi, Zot, drejt erës që kan'* aromat e tua;[13] imitoi pësimin tënd* të pacen dhe plot nder,* duke bërë pra ajo durim.

Martire plot me triumf,* durove si burrë luftëra, me bujë zhduke[52] atë* që fort mburrej kot pa mend më parë; u bëre pra* Zonjë sipas emrit,* o Marinë, me forc' prej Kryqit.

Hyjlindësore

Mari, banesa e shenjt',* e pastër, e respektuar krejt e Krijimtarit unik* që bëri gjithçka,[53] dhuromë lot dhe pastrim në shpirt,* ti që s'ke qortim hiç,* dhe dëgjoje lutjen time, Zonj'.

Kanuni i dytë: Thiso si metá fonís

Thave krejt* me mbytje gjaku det bese false ti,* teksa ujite mir' Kishën* plot me nder të Krishtit; o athlofore* shën Marinë,* për virgjëreshat je mburrje, krenari.

Pa lagie* kalove tej shtrëngatën,[54] torturat pra* pa u fundosur; spirancën* në liman të qetë e hodhe thellë,* e kënduar,* shijon pra qetësin' e vërtetë lart.

Një dinak* përndjekës urdhëroi që pa mëshir'* të rrihesh dhe të dërrmohesh* me shkopinj ti, shqerra e Zotit, ndërsa* ishe shtrirë* me mendjen e drejtuar te Krishti yt.

Qëmenat'* për Krishtin, diellin që

nuk perëndon,* o virgjëreshë, mëngove* dhe në shpirt me shndritjet e tij shkëlqeve,* athlofore,* drejt dritës së përjetshme pra shkove ti.

Hyjlindësore

Ësht' në bark,* në Vajzë virgjëreshë pa burrë kurr'* Ndërtuesi që mbështolli* me shpërgënj, me mjegullën,[55] siç vet' deshi,* detin mbarë;* do mbështillet si foshnjë pashprehshëm krejt.

Irmosi: Thiso si metá fonís

»Do flijoj* me zë himnimi,[56] Kisha »thërret te ti,* o Zot; sepse përmes »gjakut,* që nga brinja jote për për»dëllim rrjedh,* u pastrua* nga çdo »pisllëk prej gjakrash demonësh kjo.

Kontaqi
Ting. III I Parthenos símeron

Ishe e stolisur nur* me bukuri virgjërore,* e kurorëzuar ti* me plagë martirizimi* dhe me gjak nga atletizmi ishe spërkatur;* shndrite pra* me mrekullira shërimesh kështu,* o martire shën Marinë,* me besë more çmim për fitore në gar'.

Shtëpia

O martire e virgjër dhe e thjeshtë, përderisa u dogje që nga fëmijëria nga dashuria e zemrës sate për Dhëndrin Krisht, rende si sorkadhe e etur në burime që rridhnin[57] pareshtur; dhe, meqë ruajte veten gjatë atletizmit, arrite vërtet në dhomën e paprishshme të Ndërtuesit tënd si nuse e lavdëruar, e stolisur, e zbukuruar, e kurorëzuar, fitimtare, llambadheprurëse, e lulëzuar; dhe gjete nusërore të paprishshme dhe si ar more çmim për fitore në gar'.

Sinaksari

Më 17 të të njëjtit muaj, kujtimi i martires së madhe e të shenjtë Marina.
Vargje: Një dorë xhelati të pret, Marinë, me shpatë,/ por dora e Zotit të kurorëzon me hir hyjnor.
Në të shtatëmbëdhjetën, Marinës i prenë kokën.

Kujtimi i martirëve të shenjtë Sperati dhe Veronika.
Vargje: Veronika po e përzien gjakun e qafës/ me gjakrat e grykës sate, o Sperat.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Kanuni i parë: Pedhes Evreon

O Marinë, drita e paafrueshme[58] e shkëlqeu denjësisht shpirtin tënd dhe

feksi shumë me llambadhe drite, kur thërrisje: I bekuar je, o Zot Perëndi, në jetë.[59]

Me të vërtetë u ngjite drejt lartësie hyjnore, sepse e kishe të lartë moralin tënd, dhe banove në nusërore[60] të shkëlqyer, duke thirrur: I bekuar je, o Zot Perëndi, në jetë.[59]

O Marinë hyjprurëse, u dallove nuse autentike e Zotit dhe, porsi martire e pamposhtur, i thërret: I bekuar je, o Zot Perëndi, në jetë.[59]

Hyjlindësore

S'ka më arkond nga Juda, por mbaroi, sepse prej teje lindi pashprehshëm Zoti, shpresa e kombeve,[61] të cilin e bekojnë të gjitha gjeneratat, fiset dhe gjuhët.[62]

Kanuni i dytë: En ti kamino

Meqenëse digjeshe prej zjarrit hyjnor, s'doje t'ia dije për zjarrin kur flakëroheshe; prandaj ti gjithmonë hedh si shi mbi besimtarët rrjedhje terapish të hyjshme, duke tharë ndikim pasionesh, o athlofore Marinë.

Tirani, duke u përpjekur që të të frikësonte me tortura të shumëllojshme, e gjeti shpirtin tënd vërtet më të fortë se guri, sepse thërrisje: I bekuar je në tempullin e lavdisë sate, o Zot.[63]

Ti i solle si prikë Dhëndrit një bashkësi dhe popull që besuan te Perëndia, të cilët e zmbrapsën errësirën e mashtrimit me çudibërjet e tua dritëprurëse.

Hyjlindësore

O Vajzë, e vetmja virgjëreshë, Fjala e pastër, Krishti, që lavdëroi Marinën me çudi, të deshi ty si të pastër dhe të paprishshme; dhe, kur mishërohej prej teje, e rigatoi njeriun.

Ode VIII

Kanuni i parë: Musikón organon

Duke pasur të qëndrueshëm moralin, i duroje fort ndeshjet, dhe u kurorëzove me rrethe fitoreje, duke kënduar: Zotin himnojeni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[64]

O Marinë, Fjala Perëndi,[65] Dhëndri i frymëve, hijesoi për ty në qiej dhoma[66] nusëroreje mistike; duke parë drejt atij, thërret: Zotin himnojeni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[64]

Meqë stoliseshe me virtyte të llojllojshme, u bëre e vyer për dhurata më të shumta, duke parë kulmin e të dëshiruarave dhe duke thirrur: Zotin himnojeni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[64]

U shfaqe, o athlofore, shkak shpëtimi për shumë veta, dhe i solle Krishtit

bashkësi martirësh, duke kënduar tok me ta: Zotin himnojeni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[64]

Hyjlindësore

O Hyjlindëse, virgjëreshë e pacen, me anën tënde na u dha zbutje; sepse vetëm ti shpagove dhe ktheve borxhin, kur zure Zotin dhe Perëndinë e të gjithave[18] për shpëtimin e të gjithëve.

Kanuni i dytë:
Hiras ekpetasas Dhaniíl

Ruajte për Perëndinë si trup të virgjër, ashtu edhe shpirt të virgjër dhe i solle si prikë të tërëçmuar atletizmin tënd të kënduar, o e lavdishme, dhe hyre në nusërore mendore,[60] duke kënduar: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.[66a]

Duke u shërbyer fjalëve të një tirani keqdashës, të marrët, të vyer për zjarr, të vunë ty të gjallë në zjarr; mirëpo nuk u dogje nga zjarri, sepse freskoheshe[67] nga dashuria e Dhëndrit, o hyjprurëse, dhe e lavdëroje.

Qëndroje para tribunës, duke shpallur Krishtin Perëndi të pavdekshëm, që duroi kryqëzimin, vrau mashtrimin dhe u jep jetë të pavdekshme besimtarëve[68] që thërrasin: Gjithë veprat, himnojeni Zotin.[64]

Hyjlindësore

O e Tërëdëlirë, u duke më e lartë se qiejt, kur linde Perëndi qiellor, që tërë brumin e njerëzve e bëri qiellor, dhe e hijesoi kujtimin e nderuar të Marinës; atij i thërrasim: Gjithë veprat, himnojeni Zotin.[64]

Irmosi: Hiras ekpetasas Dhaniíl

»Duke* ngritur duart, Danieli mbylli »gojët e luanëve në grop';*[69] dhe shu»an forcën e zjarrit krejt*[70] kur u ngje»shën me virtyt Djemtë,* pra miqtë e »shpresëtaris',* tok duke thirrur me »gaz: Bekoni,* ju gjithë veprat e Zotit, »pra Zotin ton'.[66a]

Ode IX
Kanuni i parë: Éfrikse pasa akoí

Vole vërtet me aftësi* në Parajsën e shijimit,[71] Marinë, ti* martire për Jisun',* përjetësinë, jetën që s'prishet dot,* se tejkalove shpat' që vringëllohej[72] për ty pa dëm,* se shndritje larg dhe fort* përmes gjaku martirik, virgjëreshë nur.

Dogji, martire, çdo mendim* tokësor që donte lëndën, pra malli yt* hyjnor; të shfaqi ty* të fortë, ty që shndritje më parë nur* me vezullimin virgjëror, Marinë, dëshmore pra,* modeste plotësisht;* me besim të lumërojmë të gjithë ne.

Nuse e zgjedhur, grise krejt* dorëshkrimin e mëkatit[73] tim, zgjidhe pra* prangat e fajeve*[74] me ndërmjetimin tënd ti që rri tani, qëndron* pran' Dhëndrit Krisht[41] të shumëdhembshur, edhe shpërndaje larg* dhe mjegullën që kam* nga pasionet, o martire me hijeshi.

Ja ku tërbimi aq me tmerr* i keqdashësit u ndal, se garuan fort* vasha të reja krejt,* natyrën femër kishin harruar pra* dhe me triumf fituan kundër tij; rimëkëmbën drejt* dhe troç tani rrënjën* e stërnënës në fillimin e njerëzis'.[42]

Hyjlindësore

Jetën e pjekur unë korr,* dhe nuk kam dëmtim prej drurit të dijes[75] hiç,* e tërëpacen, se* e linde Krishtin, drurin e jetës[76] son',* që te të gjithë bën të njohur hyrjen e jetës lart;* o e dëlirë fort;* ndaj të shpallim me besim si Hyjlindëse.

Kanuni i dytë: Lithos ahirótmitos

Mburret për shpërgënjt' dhe trofeun tënd mjaft qyteti yt, martire,* pra Antiokia, edhe Kisha lart,* që ka plot të parëlindur[77] bashkë,* ka shpirtin tënd të hyjshëm krejt,* dhe me të drejtët tok dëfren ajo.

Engjëj panë dhe u çuditën me garën tënde për besimin,*[78] o martire, si me natyr' femre pra* e ke turpëruar rëndë djallin,* që në Parajs' më parë keq* vrau[51] stërnënën tënde,[42] o Marin'.

Si një virgjëreshë e aftë dhe athlofore aq e bukur* plekse ligjshëm rreth[79] drejtësie, kuror',*[80] kur shkele me mish atë që s'ka mish;*[6] u bëre fitimtare pra,* o shën Marinë, famëmadhe vajz'.

Ti je dallëndyshe mendore dhe shqerrë fare e paprishur,* pëllumbeshë me ngjyrë ari, që ka* dy krahë[81] përmes martirizimit,* drejt Zotit fluturoi pra,* ku dhe u preh;[82] ty të lëvdojmë ne.

Si zambak, Marin' athlofore, ke lulëzuar në lëndinat*[83] e martirizimit dhe, si trëndafil,* aromën e virgjërisë mbaje;* aromë e hyjnueshme* je ti për Dhëndrin tënd të hijshëm pra.

Hyjlindësore

Linde për ne dritë[84] nga mitra që s'njihte burrë, Virgjëreshë;* me ndriçim prej saj e shkëlqyer hyjnisht* u bë dritë shën Marina që kish* gaz sipas emrit të asaj*, o nën' e virgjër dhe Hyjlindëse.

Irmosi: Lithos ahirótmitos orus

»Si një gur i prerë pa dorë nga mali »yt i palatuar,* Virgjëresh', u pre porsi »gur[85] qosheje,* [86]pra Krishti, i cili i ba- »shkoi* natyrat krejt të kundërta;[87] »ndaj me gëzim të madhështojmë ty.

Dërgimësore
O uranón tis astris

E bukurvirgjra nuse,* Marin', martire për Jisun',* popullin tënd dhe qytetin* çliroji duke lypur ti* te Perëndia, që krejt ne* të shmangim prishje, rrezik, tmerr.

Hyjlindësore

Ti o kështjell' e florinjtë, me dymbëdhjetë fortesa, o fron i ndritshëm si dielli, ku rri si mbret i madh Krishti. Ti, o çudi e mahnitshme, si mban e i jep gji Zotit?*

Lavdërime
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Shkove, o e lavdishme fort,* me moral burrëror dhe shpirt* të pësosh tortura të shumëdhimbshme tmerr;* bëre dhe idhujt e grekëve si pluhur, Marinë pra,* dhe armikun, tiranin'* turpërove kur mburrej troç,* se do vinte ky* përmbi yjet lart fronin,[88] athlofore, dhe ndriçove fise, popuj, si prototip, shembull për krejt ne.

(2x)

Pra dragoin[48] që ish i keq* nga fillimi[11] dhe zhveshi krejt* Evën përmes shkeljes më par',[89] e vrave ti* nëpërmjet Kryqit, martire e lëvduar, pasi me bes',* me luftime plot respekt* fort e lidhe, se kishe forc'* Krishtin;[90] lutju pra* të shpëtojnë nga prishja dhe rreziqet sa kujtimin tënd plot nder përgjithnjë me bes' e festojnë drejt.

Si një prikë të çmuar fort* bashkësinë e shenjtë pra* Dhëndrit tënd ia solle, kur me besimin tënd* bëre çudi dhe besoi se më sipër se çdo dënim,* shtrembërim edhe çdo zjarr* që të digjte u shfaqe ti* përmes Krishtit tënd,* që nga qielli ty të dha fitoren perëndishëm, athlofore dhe virgjëreshë me nam dhe nder.

Tani *Ting. Tërth. II*

Pasi tejkalove udhë atletizmi, u arratise nga mendimi prindëror, o Marinë e tërënderuar dhe, nga njëra anë, si virgjëreshë e mençur hyre[60] llambëprurëse[91] në avllitë e Zotit[92] tënd; ndërsa, nga ana tjetër, si martire trimëreshë more hir të dëbosh nga njerëzit çdo sëmundje; dhe ne që të himnojmë, çlirona nga dhembjet

shpirtërore me anën e përgjërimeve të tua pranë Perëndisë.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[23] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me athloforen dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Nëse do, bëje Dhoksologjinë e Madhe.

Në Liturgji, Tipikët dhe nga Kanuni i shenjtores Odet III dhe VI. Kungatore Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] Fja. Urt. 24.36 (Mas. 30.13); Is. 10.12
[1a] Is. 10.13-14
[2] Joan 14.2
[3] Num. 14.19 etj.
[4] Ps. 41(42).5
[5] Ps. 32(33).3
[6] Rom. 16.20
[7] Ps. 86(87).7
[8] Ps. 39(40).3; Matth. 7.24; 16.18; Lluk. 6.48
[9] Matth. 26.7; Mark 14.3; Lluk. 7.37
[10] I Kor. 9.25
[11] I Joan 3.8
[12] Joel 3.5; Vep. 2.21; Rom. 10.13
[13] Kënga 1.3-4
[14] Ps. 44(45).12
[15] Ps. 23(24).7-10
[16] Ps. 29(30).8
[17] Ps. 44(45).10
[18] I Kron. 29.11; Urt. Sol. 12.16; Ps. 102(103).19
[19] Apok. 12.3-17; 13.2,4; 16.13; 20.2
[20] Jov. 40.29(24)
[21] Matth. 25.4-10
[22] Kënga 2.5; 5.8
[23] Joan 15.1
[24] Jez. 44.1-4
[25] Vep. 7.10
[26] Ps. 15(16).11; Fja. Urt. 16.17; Vep. 2.28
[27] Ps. 106(107).14; 115(116).7 (116.16); Naum 1.13; Jer. 37(30).8
[28] Lluk. 4.14; Rom. 15.13,19
[29] Ps. 44(45).15
[30] Rom. 8.35,39
[31] Joan 1.4
[32] Gjen. 3.15
[33] Est. 4.17 ff
[34] Ps. 17(18).2
[35] Lluk. 10.19
[36] Gjyq. 6.37-38; Ps. 72(73).6
[37] Eks. 3.2-5
[38] Num. 17.23; Hebr. 9.4
[39] Kënga 4.7
[40] Est. 4.17b
[41] III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
[42] Gjen. 3.1-6
[43] Lev. 1.3 etj.
[44] I Petr. 2.21
[45] Matth. 26.31; Mark 14.27; Joan 10.11,14; Hebr. 13.20; I Petr. 2.25
[46] IV Makk. 1.7,13,30; 16.1
[47] Is. 61.10
[48] Apok. 12.9,14,15; 20.2
[49] Ps. 144(145).19
[50] I Petr. 5.4
[51] Gjen. 3.16-19
[52] Ps. 9.7

[53] Joan 1.3
[54] Eks. 14.21-22
[55] Jov 38.8-9
[56] Jona 2.10
[57] Ps. 41(42).2
[58] I Tim. 6.16
[59] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[60] Matth. 25.10
[61] Gjen. 49.10
[62] Dan. 3.4 etj.
[63] Dan. 3.(53)
[64] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[65] Joan 1.1
[66] Joan 14.2
[66a] Ps. 102(103).22;
Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[67] Dan. 3.21-23;
Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
[68] Joan 6.33; 10.28; 17.2; Vep. 17.25;
Rom. 2.7
[69] Dan. 6.18
[70] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
[71] Gjen. 2.15; 3.23-24
[72] Gjen. 3.24
[73] Kol. 2.14
[74] Fja. Urt. 5.22
[75] Gjen. 2.9,17
[76] Gjen. 2.9; 3.22,24; Fja. Urt. 3.18;
Apok. 2.7; 22.2,14,19
[77] Hebr. 12.23
[78] I Tim. 6.12
[79] II Tim. 2.5
[80] II Tim. 4.8
[81] Ps. 66(67).14
[82] Ps. 54(55).7
[83] Kënga 2.1
[84] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[85] Zah. 9.16; Dan. 2.34-35,44-45
[86] Is. 28.16; Ef.2.20; I Petr. 2.6
[87] Rom. 5.10-11; II Kor. 5.18-19;
Ef. 2.17-18
[88] Is. 14.13
[89] Gjen. 3.8-14
[90] II Kor. 12.9; II Petr. 1.16
[91] Matth. 25.1
[92] Ps. 83(84).3; 95(96).8; 99(100).4

MË 20 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i profetit të shenjtë e të lavdëruar Ilia thesviti.

Tipikon

Nëse bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të profetit. Lavdi i profetit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i profetit. Tani ngjallësor* (Zoti Krisht Bërësi). *Përlëshoret: ngjallësore, e profetit dhe Hyjlindësorja e tij.*

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e profetit. Himne Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e profetit. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore dhe pas Polieleit Ndenjësoret (pas Polieleit) e profetit. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i dyti i profetit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e profetit, Ndenjësorja dhe Hyjlindësoria e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani*; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore, e profetit dhe Hyjlindësorja e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të profetit. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e profetit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e profetit dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Apostulli i profetit dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore e së dielës.*

NË MBRËMËSORE

Thirrtore

Ting. I Ton uranion tagmaton

Ti që shpërngule Ilian thesvit nga toka lart* me një karroc' të zjarrtë,*[1] Fjalë tepër e dhembshur,* na shpëto me ndërmjetimin e tij* ne që me besë të lëvdojm',* dhe që kujtimin e tij të nderuar fort* dhe të hyjshëm e kremtojm' me gaz.

(2x)

Jo në tërmet por në fllad të leht' pe me frymëzim* prezencën e Hyjnisë,*[2] i hyjlumi Ilia;* kjo të shndriste ty qëmoti, ndërsa* rendje çuditërisht në q'ell* në katër kuaj i hipur, pra në karroc,'*[1] o shenjtor i admirueshëm.[3]

(2x)

Ti priftërinjtë e turpit i there me një shpat',*[4] me zell hyjnor i ndezur;*[5]

përmes gjuhës e mbajte* qiellin, të mos e hidhte mbi dhé* shiun,[6] dhe Eliseun shenjt,* i urt', Ilia, e mbushe me hir hyjnor* të dyfishtë përmes zhgunit tënd.[7]

(2x)

Lavdi

Ting. Tërth. II I Bizantit

Ejani, bashkësia e orthodhoksëve, të mbledhur sot në kishën e tërërespektuar të profetëve hyjfolës, le të këndojmë psalmikisht melodi harmonike për Krishtin, Perëndinë tonë, që i lavdëroi; dhe me hare dhe ngazëllim[8] le të thërrasim: Gëzohu, o engjëll tokësor dhe njeri qiellor, Ilia emërmadh; gëzohu, o Elise i tërënderuar, që more prej Perëndisë hir të dyfishtë.[7] Gëzohuni, o ndihmës të zjarrtë, mbrojtës dhe mjekë të shpirtrave dhe të trupave të popullit krishtdashës; çlironi nga çdo sulm kundërshtar, peripeci dhe nga rreziqet e shumëllojshme ata që besërisht bëjnë kujtimin tuaj të gjithëfestuar.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit[9] pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier; atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i ditës dhe Leximet

Këndimi i III Mbretërve

(17.1-24)

U bë fjalë Zoti drejt Ilias profet dhe tha drejt Ahaavit: "Rron Zoti, Perëndia i fuqive, Perëndia i Izraelit, para të cilit qëndrova pranë, nëse do të ketë në këto vite vesë dhe shi, veçse nëpërmjet fjalës së gojës sime". Dhe u bë fjalë Zoti drejt Ilias: "Shko këtej drejt Lindjes dhe fshihu në përroin Horath, që është mbi faqen e Jordanit; dhe do të jetë të pish ujë nga përroi dhe unë do t'i porosit korbat që të të ushqejnë atje". Dhe bëri Ilia sipas fjalës së Zotit, dhe u ul në përroin Horath, mbi faqen e Jordanit; dhe korbat i sillnin atij bukë në mëngjes dhe mish në mbrëmje, dhe pinte ujë nga përroi. Dhe u bë pas *disa* ditësh dhe u tha përroi, sepse nuk u bë shi mbi dhé; dhe u bë fjalë Zoti drejt Ilias, duke thënë: "Ngrihu dhe shko në Sarepta të Sidhonës, ja se kam porositur atje një grua të

ve, që të të ushqejë". Dhe u ngrit dhe shkoi në Sarepta dhe erdhi në portën e qytetit. Dhe ja atje një grua e ve mblidhte dru; dhe thirri Ilia pas saj dhe i tha: "Merr, pra, për mua pak ujë në enë dhe do të pi". Dhe shkoi që të merrte. Dhe thirri Ilia pas saj dhe tha: "Do të marrësh, pra, për mua një copë bukë në dorën tënde". Dhe tha gruaja: "Rron Zoti, Perëndia yt, nëse është tek unë një petull, përveç miell në shtambë sa *mban* një pëllëmbë dhe pak vaj në poçe; dhe ja po mbledh dy shkarpa dhe do të hyj *në shtëpi* dhe do ta bëj këtë për veten dhe për fëmijët e mi, dhe do të hamë dhe do të vdesim". Dhe tha Ilia drejt saj: "Ki guxim; hyr dhe bëj sipas fjalës sate, por më bëj *një* petull të vogël dhe do të ma nxjerrësh më përpara, ndërsa për veten tënde dhe për fëmijët e tu do të bësh në fund, sepse këto thotë Zot*i*: 'Shtamba e miellit nuk do të soset dhe poçja e vajit nuk do të pakësohet gjer në *atë* ditë që do të japë Zot*i* shi mbi faqen e tokës''. Dhe shkoi gruaja dhe bëri, dhe hante ajo dhe ai dhe fëmijët e saj. Dhe shtamba e miellit nuk u sos dhe poçja e vajit nuk u pakësua sipas fjalës së Zotit, të cilën foli në dorën e Ilias. Dhe u bë pas këtyre, dhe u sëmur biri i gruas, zonjës së shtëpisë, dhe sëmundja e tij ishte tepër e fortë, derisa nuk mbeti frymë brenda tij. Dhe tha drejt Ilias: "Ç'*është midis* meje dhe teje, o njeri i Perëndisë? U fute drejt meje që t'i kujtosh *te Zoti* mëkatet e mia dhe të vdesësh birin tim?". Dhe tha Ilia drejt gruas: "Ma jep birin tënd". Dhe e mori nga kraharori i saj dhe e çoi mbi trapazan, në të cilin ai rrinte atje, dhe e vuri në gjumë mbi shtratin e tij. Dhe thërriti fort Ilia dhe tha: "Mjerë, o Zot, dëshmitar i vejushës, tok me të cilën unë banoj, ti ke keqtrajtuar që të vdesësh birin e saj". Dhe fryu te djaloshi tri herë dhe thërriti Zotin dhe tha: "O Zot, Perëndia im, le të kthehet, pra, shpirti i këtij djaloshi tek ai". Dhe u bë kështu dhe djaloshi thërriti me zë. Dhe e zbriti nga trapazani në shtëpi dhe ia dha nënës së tij, dhe Ilia tha: "Shih, jeton biri yt". Dhe gruaja tha drejt Ilias: "Ja tek e njoha se ti *je* njeri i Perëndisë dhe *është* fjalë e vërtetë Zoti në gojën tënde".

Këndimi i III Mbretërve

(18.1,17-40,42,44-45 dhe 19.1-10,15-16)

U bë fjalë Zoti drejt Ilias në vitin e tretë, duke thënë: "Shko dhe tregoje veten tek Ahaavi dhe do të jap shi mbi faqen e tokës". Dhe u bë kur Ahaavi pa Ilian, dhe tha Ahaavi drejt Ilias: "Ti je pikërisht ai që shtrembëron Izrae-

lin?". Dhe Ilia tha: "Nuk e shtrembëroj unë Izraelin, por ti dhe shtëpia e atit tënd, kur ju braktisët Zotin, Perëndinë tuaj, dhe shkove prapa Vaalit. Dhe tani dërgo, mblidh drejt meje të tërë Izraelin në malin Karmel, edhe profetët e turpit, katërqindepesëdhjetë dhe profetët e pyjeve katërqind që hanë *në* tryezën e Jezavelës". Dhe dërgoi Ahaavi në tërë Izraelin dhe mblodhi të gjithë profetët në malin Karmel. Dhe Ilia u afrua drejt të gjithëve dhe u tha: "Deri kur do të çaloni ju në të dy gjunjët tuaj? Nëse Zot është Perëndia, shkoni pas tij; nëse *është* Vaali, shkoni pas tij". Dhe nuk u përgjigj fjalë populli. Dhe tha Ilia drejt popullit: "Unë kam mbetur fare vetëm si profet i Zotit; dhe profetët e Vaalit *janë* katërqindepesëdhjetë burra dhe profetët e pyllit katërqind; le të na japin dy qe, dhe le të zgjedhin për veten e tyre njërin dhe le të copëtojnë dhe le të vënë mbi dru dhe të mos vënë zjarr mbi *të*. Dhe unë do ta bëj kaun tjetër dhe zjarr nuk do të mbi *të*. Dhe thërrisni në emrin e perëndisë suaj dhe unë do të thërras në emrin e Zotit, Perëndisë sim dhe do të jetë, Perëndia që do të dëgjojë në zjarr, ai *do jetë* Perëndi". Dhe u përgjigj tërë populli dhe thanë: "E mirë *është* fjala që fole". Dhe Ilia u tha profetëve të turpit: "Zgjidhni për veten tuaj një viç dhe bëni të parët, dhe do të thërrisni në emrin e perëndisë suaj dhe zjarr mos vini mbi *të*". Dhe morën viçin dhe bënë dhe thërrisnin në emrin e Vaalit që nga mëngjesi gjer në mesditë, dhe thanë: "Na dëgjo, o Vaal, na dëgjo ne"; dhe s'ishte zë dhe s'ishte audiencë; dhe vraponin shumë në altarin që bënë. Dhe u bë mesditë dhe u tall me ta Ilia thesviti dhe tha: "Thërrisni me zë të madh, se është perëndi, sepse i është dërdëllitje atij". Dhe u bë, kur koha erdhi që të ngjitej therorja dhe s'kishte zë, dhe foli Ilia thesviti drejt profetëve të neveritjeve, duke thënë: "Largohuni që nga tani, dhe unë do ta bëj holokaustin tim". Dhe tha Ilia drejt popullit: "Ejani drejt meje". Dhe erdhi i gjithë populli drejt tij. Dhe mori Ilia dymbëdhjetë gurë, sipas numrit të fiseve të Izraelit, siç foli Zoti tek ai, duke thënë: "Izrael do të jetë emri yt''. Dhe ndërtoi gurët në emër Zoti dhe shëroi altarin e shkallmuar krejtësisht, dhe bëri *një* det që mbante dy masa fare përreth altarit. Dhe stivoi drutë e çara mbi altarin që bëri, dhe copëtoi holokaustin, dhe vuri përsipër drutë e çara, dhe i stivoi mbi altar, dhe tha: "Më merrni katër shtamba uji dhe derdh*i*ni mbi holokaust dhe mbi drutë e çara''; dhe kështu bënë. Dhe tha: "Bëjeni për së dyti''. Dhe e bënë për së dyti. Dhe tha: "Bëjeni për së treti''.

Dhe e bënë për së treti. Dhe ecte uji rreth altarit, dhe detin e mbushën me ujë. Dhe thirri fort Ilia drejt qiellit, dhe tha: “O Zot, Perëndia i Abrahamit dhe Isaakut dhe Izraelit, më dëgjo; o Zot, më dëgjo sot në zjarr, dhe le të njohë i gjithë ky popull se ti je Zot, Perëndia i Izraelit dhe unë *jam* shërbëtori yt, dhe për ty kam bërë këto vepra, dhe ti e ktheve zemrën e këtij populli mbrapa’’. Dhe ra zjarr prej Zotit nga qielli dhe hëngri plotësisht holokaustet dhe copat e drutë e çara, dhe ujin *që ishte* në det, dhe gurët, dhe dheun e lëpiu zjarri. Dhe ra i gjithë populli mbi faqen e tij dhe thanë: “Me të vërtetë Zoti, Perëndia, ky *është* Perëndia”. Dhe tha Ilia drejt popullit: “Kapni profetët e Vaalit, askush nga ata të mos shpëtojë”. Dhe i kapën ata dhe Ilia i zbret në përroin Kison dhe i theri atje. Dhe Ilia i tha Ahaavit: “Zëri i këmbëve të shiut. Lidhe karrocën tënde dhe zbrit, që të mos të arrijë shiu”. Dhe Ilia u ngjit mbi Karmel dhe u përkul mbi tokë dhe vuri fytyrën e tij midis gjunjëve të tij dhe u lut drejt Zotit. Dhe qielli u errësua me re dhe erë, dhe u bë shi i madh. Dhe shkoi Ahaavi deri në Iezráel. Dhe i njoftoi Ahaavi Jezavelës, gruas së tij, të gjitha sa bëri Ilia; dhe dërgoi Jezavela drejt Ilias dhe tha: “Nesër do ta vras shpirtin tënd si një nga ata”. Dhe Ilia u frikësua. Dhe u ngrit dhe iku sipas shpirtit të tij dhe vjen në Virsaveé, në dheun e Judës, dhe la shërbëtorin e tij atje. Dhe ai shkoi në shkretëtirë në udhë dite, dhe erdhi dhe u ul poshtë rathmenit dhe fjeti gjumë atje poshtë bimës; dhe ja dikush e preku dhe i tha: “Ngrihu dhe ha”. Dhe pa mirë Ilia dhe ja, afër kokës së tij *ishte një* petull elbi dhe poçe uji. Dhe u çua dhe hëngri dhe piu dhe, pasi u kthye, fjeti. Dhe u kthye engjëlli i Zotit për së dyti dhe e preku dhe i tha atij: “Ngrihu, ha, sepse *është* e shumtë udha nga ti”. Dhe u ngrit dhe hëngri dhe piu dhe eci në fuqinë e kësaj ngrënieje dyzet ditë dhe dyzet net deri në malin Horev dhe hyri atje në shpellë dhe ndenji atje. Dhe ja fjalë Zoti drejt tij dhe tha: “Çfarë *ke* ti këtu, Ilia?”. Dhe Ilia tha: “Pata zell zellshëm për Zotin e tërëpushtetshëm, sepse të lanë bijtë e Izraelit; altarët e tu i gërmuan tërësisht dhe profetët e tu i vranë me shpatë, dhe kam mbetur unë fare vetëm, dhe kërkojnë shpirtin tim ta marrin”. Dhe tha Zoti drejt tij: “Shko, ktheu në udhën tënde dhe do të arrish në udhën e shkretëtirës së Damaskut; dhe Eliseun, bir Safati, do ta krezmosh në profet në vendin tënd”.

Këndimi i III Mbretërve

(19.19-21 dhe
IV Mbretërve 2.1,6-14)

U bë *një* ditë dhe Ilia gjen Eliseun, bir Safati, dhe ky lëronte në qe. Dhe iku Ilia drejt tij dhe hodhi gëzofin e tij mbi të. Dhe braktisi Eliseu qetë, dhe rendi pas Ilias dhe i shërbente atij. Dhe u bë që, kur ngrinte Zot*i* Ilian në tërmet si në qiell dhe shkoi Ilia dhe Eliseu në Galgal. Dhe Ilia i tha Eliseut: "Rri, pra, këtu, sepse Zot*i* më ka dërguar deri në Jordan". Dhe Eliseu tha: "Rron Zot*i* dhe rron shpirti yt, nëse do të të lë". Dhe shkuan të dy; dhe *erdhën* pesëdhjetë burra, bij të profetëve, dhe qëndruan përballë nga larg, dhe të dy qëndruan mbi Jordan. Dhe mori Ilia gëzofin e tij dhe e mbështolli dhe goditi ujin, dhe u nda uji këndej dhe andej dhe kaluan të dy në shkretëtirë. Dhe u bë që, kur po kalonin dhe Ilia tha drejt Eliseut: "Kërko, çfarë do që të bëj për ty, para se të ngrihem nga ti?". Dhe Eliseu tha: "Le të bëhen, pra, mbi mua të dyfishta *sa janë* në shpirtin tënd". Dhe Ilia tha: "Ashpërsove të kërkosh. Në qoftë se do të më shikosh të merrem nga ti lart, do të jetë kështu; ndërsa, nëse nuk *do të më shikosh,* nuk do të bëhet". Dhe u bë kur ata po ecnin dhe flisnin, dhe ja një karrocë zjarri dhe kuaj zjarri, dhe ndanë mes dyve dhe u mor lart Ilia në tërmet si për në qiell. Dhe Eliseu po shihte dhe thërriste: "O atë, o atë, karrocë Izraeli dhe kalorës i tij!". Dhe nuk e pa më; dhe kapi Eliseu rrobat e veta dhe i grisi në dy çarje. Dhe ngriti gëzofin e Ilias që ra nga lart mbi Eliseun. Dhe u kthye Eliseu dhe qëndroi në buzë të Jordanit. Dhe mori gëzofin e Ilias, i cili ra mbi të nga lart dhe goditi ujin dhe nuk u nda. Dhe tha: "Ku *është* Perëndia e Ilias afo?". Dhe goditi ujërat dhe u ndanë këndej dhe andej dhe Eliseu kaloi.

Në Liti Idhiomele
Ting. I I Gjermanoit

Ilia zeloti[5] dhe sunduesi i pasioneve[10] u shfaq sot shëtitës në ajër,[1] duke u lartësuar në mësues misteresh për shpëtimin mbarëbotëror. O lavdi e plotë, për të cilën u bë i vyer profeti që fluturoi lart, bukuria e jashtëzakonshme e profetëve! Sepse ai me anën e arritjeve u tregua engjëll në trup dhe njeri pa mish. Atij, duke e lavdëruar, le t'i themi: Na ndihmo, o i urtë, në ditën e gjyqit.

I njëjti

O besnikë, le ta nderojmë sot me mënyrë davidiane profetin e Zotit, Ilia thesvitin, zelotin[5] e përmbishkëlqyer;

sepse ai me gjuhë e fërkoi qiellin si hekur, dhe tokën pjellore e bëri jopjellore. O çudi! Njeriu prej balte nuk la qiejt të jepnin shi.[6] O çudi! Njeriu i prishshëm u vesh me paprishje[11] dhe vrapoi lart në qiej me karrocë të zjarrtë,[1] duke i dhuruar Eliseut të dyfishtë Hirin nëpërmjet gëzofit;[7] qortoi mbretër[12] dhe shkatërroi me zi buke[13] popull të pabindur; poshtëroi rëndë tërë priftërinjtë e turpit,[14] dhe ringjalli përmes fjale birin e vejushës;[15] me ndërmjetimet e tij, o Krisht, Perëndia ynë, ruaji në paqe mbretërit tanë orthodhoksë dhe dhuroju trofetë e fitores kundër barbarëve.

I njëjti I Gjermanoit

Le të lavdërojmë të gjithë me këngë shpirtërore profetët e Krishtit; sepse Ilia thesviti u bë vrapues në qiell[1] dhe Eliseu priti të dyfishtë Hirin nga Perëndia me anën e gëzofit;[7] dhe u dalluan si ndriçues të hijshëm për kozmosin,[16] duke ndërmjetuar pa pushim për shpirtrat tanë.

Ting. II I Joan Monakut

Lindën në planet dy ndriçues të tërëndritshëm,[16] Ilia dhe Eliseu. Njëri me fjalë hyjnore mbylli pika qiellore[6] dhe qortoi mbretër,[12] dhe me karrocë të zjarrtë u ngjit në qiej;[1] ndërsa tjetri shëroi ujëra që vrisnin bij[17] dhe, kur mori të dyfishtë hirin,[7] eci mbi rrjedhat e Jordanit;[18] dhe tani që kërcejnë së bashku me engjëj, ndërmjetojnë të shpëtojnë shpirtrat tanë.

I njëjti I të njëjtit

Karroca zjarrprurëse, që të lartësoi në qiej porsi me tërmet,[1] të dha ty hir fryme zjarri, o Ilia thesvit, që të mos shikosh vdekje, derisa[19] të shpallësh fundin e të gjithave;[20] prandaj eja pranë nesh dhe jepna njohjen mistike të arritjeve të tua.

Lavdi

Ting. IV I Arsenit

O Ilia thesvit, i hipur në karrocë të zjarrtë, u ngrite dhe u shpërngule[1] në vend me pamje drite, dhe poshtërove rëndë profetët e turpit;[14] ti që lidhe me fjalë qiellin,[6] po ashtu zgjidhi shkeljet[21] tona nëpërmjet ndërmjetimeve të tua drejt Zotit, dhe shpëtoji shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Nga çdo lloj rreziku ruaji shërbëtorët e tu, o Hyjlindëse e bekuar, që të të lavdërojmë ty, shpresën e shpirtrave tanë.

Pasvargje
Ting. IV O eks ispsistu klithís

Ish shenjtëruar nga zënia brenda barkut,*[22] engjëlli në mish pra dhe mendja e zjarrtë flak',* njeriu mbiqiellor, prodhrom* hyjshëm dhe rendës* përpara ardhjes së dytë të Krishtit,*[20] baza e profetëve, i lavdëruari* Ilia mblodhi krishtdashësit* në shpirt, të bëjmë* ne për kujtimin e tij të shenjt' kremtim,* pra panairin.* O Zot, popullin tënd të qet' ruaje nga çdo shqetësim,* nga çdo dëm prej dinakut,* siç Ilia ndërmjeton për ne.

Varg: Mos prekni të krezmuarit e mi, dhe në profetët e mi mos bëni dinakëri.

Kur Izraeli i tërë kurvëronte* larg pra Perëndisë, dhe tretej prej mallit fort* për idhujt, e pa Ilia[23] shenjt,* profet i mençur* dhe qiellmendës, u ndez në shpirt me zjarr;* ndaj me zell,[5] mbështolli ky retë, e thau dhen'* dhe mbylli qiejt kur foli, tha:* "Nuk do të bjerë* në tokë asnjë pik', veçse kur do them* fjalë me gojë".*[6] Ky tani bën gosti, se jep pa kursim hir që s'shprehet dot* te ne që e lëvdojmë* me besim dhe me gëzim të madh.

Varg: Ti je prift në jetë sipas rendit të Melhisedekut.

Ti në Jordan çave ujërat,[24] shikues* gjërash dhe misteresh që nuk shprehen; dogje krejt* idhujt, mashtrimin e tyre pra,* me fjalën tënde* të hyjshme si me rrufe;[25] qortove rënd'* mbretin, bërës paligjësie,[12] dhe priftërinjt'* shkelës i vrave,[4] dhe dogje plot* flijim me lutje;*[26] tani me zjarrin e ndërmjetimit tënd* shuaj qymyret* e përflakta të hallit dhe të pësimeve, derteve,* që ka populli yt pra,* o Ilia, o profet me nam.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O profet, predikuesi i Krishtit, asnjëherë nuk ndahesh nga froni i madhërisë[27] dhe je pranë çdo të sëmuri përgjithmonë; duke celebruar në më të lartat, bekon kozmosin, duke u lavdëruar gjithkund; kërko zbutje për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[28] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me profetin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Përlëshore
Ting. IV Tahí prokatálave

Ilia, prodhrom i dytë i pranisë mbi dhé*[20] të Krishtit dhe engjëll pra në

mish, që kanë profetët bazë, ky emërmadh,* kur Eliseut, shenjtit,* i dërgoi nga lart hir,*[7] flak, zmbraps sëmundjet, lebrën e pastron,[29] ndaj buron, jep* shërime dhe lehtësim te sa e nderojn' atë.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Misteri i fshehur prej jete[30] dhe i panjohur ndër engjëjtë[31] u shfaq[32] ndër të dheshmit me anën tënde, o Hylindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier; dhe denjoi Kryq për ne duke dashur, me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtrat tanë.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së pare, Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotír

Ndriçues me shkëlqim,* karrocier flakëprurës*[1] dhe engjëll brenda mishit, që fryn zell hyjnor[5] je,* dhe zmbraps besim të keq, qortues të paligjësh,[12] ndërsa kulm,* korife profet* kështu të shpallim me një zë,* hyjshikues ty,*[33] Ilia shenjt, ndaj na ruaj,* i lumur dhe emërmadh.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Na ngri, se ramë ne* në humner' dëshpërimi,* në tmerre, në trishtime dhe shkelje, o Vajzë;* shpëtim për mëkatarët je, ndihmë, mbrojtje me plot fuqi;* ndaj dhe na shpëton* ne shërbëtorët e tu, ti,* Zonjë shën Mari,* o enë e respektuar* e Zotit Krisht Perëndi.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
E ngjashme

Me një virtyt kulmor* u familjarizove* me Zotin,[34] se mbi dhé rrojte jet' qiellore,* i lumur, dhe si kishe jetën e Hirit, me fryrje pra* bir të vdekur ti* e ngjall[15] dhe mbetesh pa prishje,* më i fort' madje* se vdekja,[1] o shën Ilia* i hyjfrymëzuar krejt.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Je nën' e Perëndis'* dhe u duke pas lindjes* vërtet e virgjër prapë, të njohim të gjithë* sa po përikim me plot mall* te mir'sia dhe hiri yt,* se të kemi ty ne mëkatarët si mbrojtje,* dhe për ne ti je* shpëtim në ngasje, e vetmja* e fortpaqortueshme.

Kanune: i Hyjlindëses (shih fq. 11) dhe të dy të profetit:

Ode I
Kanuni i parë i Joan Monakut që ka Akrostihidhë, përveç Hyjlindësoreve: "Himnoj duke kërcyer çuditë e Ilias".
Ting. II
Ásomen to Kirio

Meqenëse dëshiruam të këndojmë fuqinë e frymëzjarrtë të çudive të Ilias, e kemi ftuar denjësisht forcën e gjuhës së nderuar në formë zjarri të Shpirtit.[35]

Zbutu, o hyjprurës, dhe çele, përmes energjisë së Shpirtit që është në ty, ngushtësinë dhe mjerimin e gjuhës pa rrugëdalje, dhe forcoje për himnin e mrekullive të tua.

O Fjalë, u ndan të përmbinatyrshmet atyre që binden në urdhrat e tu të nderuar, dhe nënshtron dyert e shiut[6] me anën e Shpirtit, duke e bërë të fuqishme fjalën.

Hyjlindësore

O e vetmja e bekuar, thesari i pastër dhe i hyjshëm i dëlirësisë, pastromë nga balta e ndotur e pasioneve, duke kërkuar faljen e shkeljeve të mia.

Kanuni i dytë që ka Akrostihidhë: "O Ilia i lumur, jepmë hir të hyjnueshëm. Josif".

Ting. Tërth. IV
Armatilatin Faraó

Ngjall shpirtin tim të vdekur keq si birin e vejushës[15] dhe më ndriço* me virtyt të hyjshëm,* udhëzomë pra drejt jetës[36] dhe tregomë pjesëtar* në shijim të amshuar, i lum, Ilia, se dua fort* që të të shijoj ty me gaz të madh.

Kur linde, ati yt e mori vesh çudinë fort të madhe, vërtet* një mister, të pa pra* të mbështillesh me shpërgënj prej flake, të ushqehesh ti* me zjarr; ndaj, o i lum, më çliro nga zjarri që nuk ka fund* përmes përgjërimeve të tua.

U madhështove përmes prirjes drejtas Zotit, kishe zellshëm vërtet* zell për Perëndinë,*[5] o i lum, gjithnjë; ndaj më forco se tashmë mbushem plot* me një zell të hyjnueshëm, që vullnetin hyjnor ta bëj,* të të lavdëroj i shpëtuar pra.

Hyjlindësore

E mishërove Perëndin' e përmbiqenshëm, Vajzë krejt pa qortim,* dhe u shfaq për ne ky* porsi ne, njeri; shum' lyp atë të më shpëtojë pra* edhe të më çlirojë nga çdo dënim mua, më fajtor,* o e fortdëlirë, se çdo njeri.[37]

Zbritësore: Anikso to stoma mu

Ja gojën e çel tani *(shih fq. 12)*

Ode III
Kanuni i parë:
Tis písteos en petra me

Profet, sa i shkëlqyer ishte gostiari!* Me korbat ky shpesh bënte dëfrim ushqimi;*[38] ky vetëm mbush çdo kafshë me mirësi;[39] i thërrasim gjithë ne: Je Zoti ynë ti* dhe nuk ka të shenjtë veç teje, Perëndi.[40]

Për nder, hir, vlen Bamirësi, kujdestari,* që bëri një të ve, një profet ushqyes* për njëri-tjetrin me providenc' pashprehshëm,[41] të gjithë i thërrasim pra: Je Zoti yn'* dhe nuk ka të shenjtë veç teje, Perëndi.[40]

O mbyllësi* i reve, që shi t'mos derdhnin* edhe pse lindin shira, për Serafthinë* që s'kish ushqim, ke bër' mbetjet[6] mjaft të pakta që të spërkasin pa kursim,[41] thërrisje pra* se: Nuk ka të shenjtë veç teje, Perëndi.[40]

Hyjlindësore

Ti vetëm nga të gjithë që nga fillimi* ke qen' e denjë për të mëdha, dhurata* mbinatyrore, se të panxënshmin dot Zot prej botës kishe në bark edhe mish i dhe;* me bes' si Hyjlindëse të nderojmë pra.

Kanuni i dytë: Uranias apsidhos

Priftërinjtë e turpit i there si të këqij,*[4] o i lavdëruar, meqë po digjeshe nga një zell* për Zotin;[5] ndaj të thërras:* Nga zjarri tmerr i përjetshëm*[42] dhe, profet, nga punët e turpit rrëmbemë ti.

Si ndërmjetës të madh pranë Perëndisë të vë,* mundet, o i lumur, të më shpëtojë nga çdo mundim;*[43] le të të vijë keq ty* për lutjen time të thjeshtë,* mua që të lutem pra, mos më shpërfill aspak.

Zoti yn' gjithëbërës të madhëroi, profet;* më par' të ushqeu me zog,[38] Ilia me lavd dhe nder;* ti përgjëroju atij* që ta kungoj me shijimin* e përjetshëm dhe dritësimin e ardhshëm tok.

Hyjlindësore

Vajzë, portë e pashkelur që drejt Zotit na çon,*[44] lutem, më çel dyer pendimi, duke pastruar ti* pisllëkun tim shpirtëror,* pra fajet, o e hyjhirshme,* me mëshirën tënde, që hedh me bollëk si shi.

Zbritësore: Tus sus imnologus

O Zonjë dhe nën' e Perëndisë

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Si profet i ndriçimit hyjnor vërtet,*[45] ti profetë trillimi i mposhte krejt,*[42] qortove njëkohësisht* të paudhin mbret Ahaav* dhe e mësove, o fortzëmadh, t'mos i falej hiç* Vaalit,[12] dhe kërkove me lutje burim nga lart;*[46] ndaj dhe me karrocë të përflaktë u more* në ajër, Ilia shenjt,* karrocieri drejt Zotit tënd;*[1] të thërrasim* me zë pra ne:*Ndërmjeto te Zoti yt Krisht* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Hyjlindësore

Ty të shpall si të lum çdo brez njerëzor,*[47] si të vetmen që linde ti Perëndi* në mish pafarisht, edhe* si të virgjër, sepse në ty* Hyjnia e përzjarrtë fushoi, dhe mënd si foshnj'* Ndërtuesin dhe Zotin; gjinia e engjëjve,* gjithë njerëzia tok lëvdojm' lindjen tënde* të tër'shenjtë denjësisht* dhe me një zë thërrasim pra,* duke lypur* për ndërmjetim:* Lutju Zotit Krisht Perëndi* të na dhurojë ky ndjesë* të fajeve,* se i falemi lindjes sate pa cen me bes'.

Ode IV
Kanuni i parë:
Isaqíkoa Kírie tin akoín

O profet, u shfaqe qartazi prerësi i rrënjëve të së keqes dhe mbjellësi[48] i virtytit, prandaj të nderojmë.

Një vejushë ushqyese të tallte ty për vdekje me fjalë, duke shpejtuar ngjalljen e fëmijës, o profet.[15]

Sinjalizove qartas lavdinë e Trinisë me fryrjen e trefishtë, duke ia dhuruar nënës të ngjallur birin.[15]

Hyjlindësore

Si hardhi plot me fruta, o e Dëlirë, kishe në bark bistak, që t'u buroje të gjithëve verën e shpëtimit.

Kanuni i dytë: Si mu iskís Kírie

O Ilia i mrekullueshëm, ti që ishe vetinternuar më përpara për shkak të kërcënimit të një gruaje,[49] Perëndia ul zellin tënd të flaktë, dhe të dërgon drejt një vejushe, që të ushqehesh;[41] prandaj të përgjërohem, shpirtin tim që ka uri, ushqeje me karizma të perëndishme.

Më mbulojnë re të rënda mëkatesh, dimëroj në shtrëngata jete dhe fryjnë keqas kundër shpirtit tim frymët e ligësisë.[50] O profet hyjfolës, bëhu për mua kapiten, duke më drejtuar në gji shpëtimi.

O Ilia i lumur, duke iu përgjëruar Zotit të lavdisë,[51] i cili heq sëmundjet e

të gjithëve, më jep fuqizim shpirti, shëndoshje trupi; dhe udhëzomë të vrapoj tej pa dëm mes skandaleve të jetës, sepse të vë përpara ty si mbrojtësin tim të mirë.

Hyjlindësore

Tok me të gjitha Fuqitë qiellore, me të gjithë profetët, atletët, apostujt dhe oshënarët, o Zonjë e tërëpaqortueshme, lyp që të arrij shpëtimin unë që mëkatoj shumë dhe që të çlirohem nga dënim i ardhshëm.

Zbritësore: Tin aneksihníaston

Të pagjurmësuarin

Ode V
Kanuni i parë: O tu fotós horigós

Ligji atëror[52] të tregoi si ndërmjetues të tërëvërtetë, çudibërës që ndryshoje natyra elementesh,[6] dhe që digjje me rrjedha fli,[26] o oshënar Ilia.

Si adhurues i së vërtetës turpërove shkëlqyeshëm, o oshënar i tërëlumur Ilia, profetët e turpit,[14] duke paraqitur disi, por qartë, fuqinë e Trinisë.[53]

Duke mësuar fjalën e Hirit,[54] o Ilia, priftërinjtë e barrëve i there me duart e tua të pafajshme,[4] i stolisur me zellin si me rrobë gjer në këmbë.[55]

Hyjlindësore

Të thërresim ty që linde Krishtin, Krijuesin e gjithçkaje:[56] Gëzohu, o e kulluar; gëzohu, ti që na linde dritën;[45] gëzohu, ti që mbajte Perëndinë e panxënshëm.

Kanuni i dytë: Ina ti me aposo

Duke u ndezur prej zellit të besimit,[5] pengoje retë që sillnin shi;[6] por të lutem, o Ilia, me ndërmjetimet e tua të hyjshme vadit me shira hyjnore shpirtin tim, që u shkri nga flakërimi i kënaqësive, dhe shpëtomë.

I treguar si prift, o profet i tërëpasur, me duart e tua të pafajshme there priftërinjtë e barrëve që bënin të pavenda;[4] por, të lutem, ruajmë pa dëm nga çdo mëkat i pavend.

U bëre i çuditshëm, o profet, duke djegur përmes thirrjeve të hyjnueshme flijimet, se veproje me besim;[26] prandaj të lyp pa pushim të ndezësh në zemrën time mallin hyjnor, që të flakërojë pasionet e mia lëndore.

Hyjlindësore

Fjala e përmbisubstancshme zbriti mbi ty si shi;[57] atij përgjëroju, o Vajzë e tërëpaqortueshme, që të më hedhë tani pika të pastra kataniksi, që të

lajnë çdo njollë të të këqijave të mia të panumërta.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI
Kanuni i parë: Ávisos amartimaton

U bërë ikonë shpresëtarie dhe jete autentike, mbjellës dëlirësie dhe imitim engjëjsh, o Ilia i mrekullueshëm hyjprurës.

Pasi të frikësoi inat gruaje të ulët profetvrarëse, të largon, o Ilia[49] i mrekullueshëm, ty që arrite të lidhësh[16] dhe të zgjidhësh burim shirash.[46]

Pasi u gjunjëzove, ngrite lart sytë e mendjes, duke bërë zgjidhje me anën e përgjërimit të hyjshëm dhe i dehe kanalet e tokës.[46]

Hyjlindësore

O e panusëruara Perëndilindëse Mari, një ferrë në Sina, që komunikonte me zjarr pa u djegur,[58] të parashkruan ty, o nënë, të gjithmonë-virgjër.

Kanuni i dytë: Ilásthití mi Sotír

Për mua të vijë keq,* pa mendje fajtova shumë dhe çliromë, o Shpëtimtar,* nga gjithë ndëshkimet që më presin atje, se ke* nënën e pacen krejt* dhe Ilian e madh, që luten.

Më mbaj të pastër në shpirt* si mbjellës dëlirësie; si zelltar, Ilia,[5] ma mbush* me zell të hyjnueshëm logjikën, t'i zmbraps me forc'* sulmet e së keqes,* të fitoj lavdi përjetë lart.

Ha vetëm një ngrënie ti,* kreshmon pra, por tejkalon një udh' dyzetditore[59] me hir,* përkrahje hyjnore, ndaj të lyp, o hyjprurës shenjt,* më forco, të kem un'* vet'përmbajtje ndaj çdo faji pra.

Hyjlindësore

O porta e Perëndis',* për shpirtin tim të përulur çel të hyjshmet hyrje, kështu* do futem në to me lavdërim,[60] o Hyjlindëse,* zgjidhjen e mëkatit* do ta marr me ngazëllim, hare.

Zbritësore: Tin thian táftin

Këtë të kremte

Kontaqi
Ting. II

O profet dhe parashikues i punëve të mëdha të Perëndisë, Ilia emërmadh, që me fjalën tënde ndalove retë ujërrjedhëse,[6] ndërmjeto për ne te njeridashësi i vetëm.

Shtëpia

Profet Ilia, kur pa paligjësinë e shumtë të njerëzve dhe njeridashjen e pafund të Perëndisë, trazohej i inatosur dhe i drejtoi të dhembshurit fjalë të pamëshirshme, duke bërtitur: "Zemërohu kundër atyre që të mohuan, o Gjykatës[61] tepër i drejtë".[61a] Mirëpo nuk e nxiti fare dhembshurinë e të Mirit për të dënuar ata që e shpërfillën, sepse gjithmonë pret pendimin e të gjithëve njeridashësi i vetëm.

Sinaksari

Më 20 të njëjtit muaj, kujtimi i ngjitjes zjarrprurëse në qiej i profetit të lavdëruar e të shenjtë Ilia thesviti.
Vargje: Mbajti shi[6] duke sjellë poshtë zjarr tri herë Ilia,[62]/ por çan rrymë[24] duke vrapuar lart.
Rreth të njëzetës, u rrëmbeve lart me karrocë, o kalorës Ilia.[1]

Me ndërmjetimet e tij të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Kanuni i parë: Vatos en ori pirí

Meqenëse veshe fuqinë e planifikuar prej Hyjnisë[63] paradoksalisht, me një ushqim mbarove garën e udhës së gjatë dyzetditore, o Ilia i mrekullueshëm; prandaj në Horev,[59] duke kërcyer, psalje: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[64]

Një fllad i butë dhe shumë i lehtë të tregoi Zotin, o Ilia,[2] që kishe zell për Perëndi të tërëpushtetshëm,[5] jo erë e dhunshme, jo tërmet as zjarr që frikëson;[65] prandaj i psalim Jisuit të butë: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[64]

U bëre i denjë për shfaqje Perëndie[2] dhe për profeci,[66] porsi Moisiu[67] i madh, duke krezmuar përmes Shpirtit profetë dhe mbretër, o Ilia[68] i mrekullueshëm; dhe, përderisa u bëre shikuesi i lavdisë së Krishtit në Thavor,[33] thërret: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[64]

Hyjlindësore

Kur banoi në mitrën tënde përmbinatyrshëm Fjala i tërëmirë e Atit Perëndi, na rigatoi dhe na denjësoi për jetën në Eden, o e pacenuar; prandaj, duke t'u falur si Hyjlindëse të gjithë besimtarët, këndojmë: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[64]

Kanuni i dytë: Theú sigatávasin

Duke dhembshuruar thellë një popull që po humbej, me zellin e besës[5] dhe me thirrjet hyjnore zbrite zjarr që

dogji fli, o oshënar;[26] prandaj të përgjërohem: Çliromë dhe shpëtomë nga flaka e amshuar.[42]

U denjësove të vëzhgoje në malin Thavor fytyrën e Perëndisë;[33] atij lyp, o profet, të mos i shikojë mëkatet e mia, që në ditën e Gjyqit ta shoh me shpirt të paakuzuar fytyrën e tij.

Duke ecur në udhën e jetës, pësoj shumë ngatërresa. O mbrojtësi im i mirë, më qeveris me mbrojtjen tënde, duke më mbështetur mua që lëkundem me dëshirë dhe prirem drejt kënaqësish mishi, o Ilia.

Hyjlindësore

Të himnoj, o e Tërëhimnuar e hyjhirshme, dhe madhështoj lehoninë tënde të dëlirë; ndihmomë mua që dimërohem nga dallgët e jetës, dhe jepi kataniks pastrues ndotjesh shpirtit tim të përulur.

Zbritësore: Uq elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII
Kanuni i parë:
Éfrikse pedhon evajón

Me qortim profeti, Ahaavi shkëlqyeshëm gjeti katastrofën e hijshme të fisit,[69] si shpagim neveritjeje për vrasje të fëlliqur;[70] ndërsa thesviti nga mendja zjarrfrymëse[5] këndonte një himn për hir të Jetëdhënësit: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[71]

Binte nga qielli shi për ty, si shërbëtor i shkëlqyer i Perëndisë që ishe, dhe dy herë pesëdhjetë që të sulmonin, o Ilia, i shkrumbonte,[72] sepse perëndishëm thërrisje himnin për atë që posedon jetën e përjetshme: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[71]

Hyjlindësore

Lastari përmbihyjnor i Virgjëreshës, Krishti, meqë ishe mbjellës dëlirësie, të tregoi mistin e mishërimit hyjnor në Thavor, pasi të tregoi në mishin e vet dritën e pakuptueshme të Hyjnisë,[33] kur thërrisje: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[71]

Kanuni i dytë: Eptaplasios káminon

Të njohim si enë që mbante Shpirtin Hyjnor, engjëll në tokë, i cili frynte zell të hyjshëm,[5] që zmbrapste besë të keqe, që qortonte mbretër,[12] krezmonte profetë[68] dhe priste me thikë priftërinj turpi,[4] o Ilia; prandaj të thërrasim: Çlirona nga turpi i ardhshëm.

O Ilia i hyjfrymëzuar, karrocë zjarri të mori prej dheut ty[1] që flakërohe-she nga zelli hyjnor;[5] ndaj të lyp të më lehtësosh mendjen time nga të gji-tha të këqijat mbi tokë, me karrocën katërkuajshe[1] të virtyteve të tua; dhe përgjëroju Perëndisë dhe mbretit të të gjithave,[73] që të arrij te stacioni qiellor.

Me fjalë të gjallë mbylle qiellin që hidhte shi;[6] tani me fjalën tënde shpir-tërore, lutem, o i shenjtë, më çel dyert e pendimit, duke i dërguar shpirtit tim shira kataniksi, dhe shpëtomë teksa thërras: O priftërinj, bekojeni;[74] o po-pull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Triadhik

Duke adhuruar Trininë në një Hyjni, të barabartë në fuqi, të bashkënde-ruar, të bashkëqenshme, të bashkë-fronshme, lavdërojmë Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, agim pa perëndim, pushtet të bashkëmbretëruar, dhe këndojmë me një zë: O priftërinj, be-kojeni;[74] o popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Hyjlindësore

O Zonjë e përmbishenjtë, pasi lindi prej teje, Emanueli u shfaq duke vënë ligj shpresëtarie dhe duke na mësuar pendim;[75] atij tani lypi që të më hapë portat e drejtësisë[60] dhe të më shpë-tojë mua që thërras: O priftërinj, be-kojeni;[74] o popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Zbritësore: Pedhas evajís

Djemat e dënuar

Ode IX
Kanuni i parë: I ton pro iliu fostira

Si mbi dhé kish ecje që njerëz* nuk arritën dot ta shtrembërojn'* me pallto të lëkurtë rrjedhjet në Jordan* i kaloi thesviti,[24] dhe në ajër porsi karrocier* mbaroi lart në qiell shpejt* udhën e huaj[1] përmes Shenjtit Shpirt.

Me zell shpresëtar ishte ndezur,*[5] ndaj me karro që dukej si zjarr* thesviti ngrihet;[1] dhe mbi Eliseun shenjt* hedh lëkurën, qimushin,[76] se s'shpëtoi dot nga ky ai*[77] dhe të dyfishtë bën kështu* nxënësin për-mes Hirit[7] krejt hyjnor.

I sprovuar ish, hyjshikues,* ky the-svit;[2] me Moisiun sheh* sa syri pra s'i pa dhe s'i dëgjoi vesh* edhe zem-ra e mëkatarëve dhe e dhelindurve* s'mendoi;[78] në Thavor pra ky* pa të Tërëfuqishmin Zot[79] në mish.[33]

Hyjlindësore

Asgjësove, Vajzë, vendimin* tej të lasht', të prerë,[80] ndreqe pra* stërnënën;[80a] shkaku je ti që gjinia jon'* prap' me Zotin u familjarizua,[34] edhe urë je* drejt Perëndis', Ndërtuesit;* të madhërojmë me respekt të madh.

Kanuni i tjetër:
Eksesti epí tuto o uranós

U denjësove, sa mundej pra e pe*[67] Perëndinë në fllad krejt të lehtë,[2] se trupin më par'* me ushtrim e bëre të hollë mjaft,* o i lavdishëm; ndaj të lyp* më shkëlqe me shndritjet e hyjshme nur,* që përmes lutjes sate* çdo majmëri mendore* të ma hollosh, të feks' pendim tek un'.

Qëmoti në mes çave Jordanin krejt* me qimush, e kalove,[24] i pasur fort; thaje pra drejt* derdhjen e mëkateve që kam bër'* që janë aq tmerruese,* o profet hyjfolës, dhe më dërgo* nga lart çdo dit' te shpirti* lot, shira prej pendimit,* të më shkaktojn' përroin plot shijim.[81]

I mir' je, ndaj me lutjen tënde më nxirr* nga shtrëngimi trupor dhe çdo devijim në shpirt, profet* fort i lavdëruar me nder dhe hir;* nga çdo sëmundje më çliro,* nga armiq pa ligj, nga skandale pra* të ndryshme që ka jeta;* shpëtomë nga Gjehena,*[82] dënimi i përjetshëm, të thërras.

Tek Eliseu le hirin e dyfisht'* shpirtëror, se kështu kishte lypur fort,[7] teksa rrëmbim* lart të merrte;[1] tok me të pa pushim* kërko t'i japë qielli* mbretit falje fajesh, fitore tok,* se pasuri të ka ty,* pra mbrojtës para Zotit,* se s'turpërohesh edhe je plot lavd.

Hyjlindësore

O Zonjë që s'ke fare qortim, përfill* shërbëtorët e tu, si e mirë, fjalët që thon';* vazhdimisht kërko pra nga Bërësi,*[56] t'i japë mbretit ton' trofe,* forcë shpirtërore si dhe kungim,* të marrë, Virgjëreshë,* dhe pjesë në shkëlqimin* e mbretërisë së hyjnueshme.

Zbritësore: Apas jijenís

Gjithë njerëzit

Dërgimësore
Fos analíoton Loge

S'të asgjësoi ty fare* drit' që të shfaqi drejtues* në një karrocë të zjarrtë* me katër kuaj,[1] se poshtë* zjarr zbrite me gjuhë balte,[26,62] kështu, Ilia,* të gjitha shirat i thave.[6]

Hyjlindësore

Me ndërmjetimet e tua,* Hyjlindëse virgjëreshë,* që linde Birin tënd, dritën,*[45] lypi të më dhembshurojë,* prej territ prush të amshuar të më shpëtojë;*në ndihmën tënde besim kam.

Lavdërime
Ting. Tërth. IV Ti imás kalésomen

Kur, i mrekullueshmi shën profet,* përmes jetës së dëlir', virtytit, tok me Perëndin'* u bashkove edhe more* që prej tij pushtet dhe forc',* Krijesën e ndryshove siç mendove fill,* siç deshe mbylle dyert e shiut me fjal';*[6] nga lart zjarr hoqe[26] dhe zhduke krejt* sa kishin besim të rremë bosh;*[62] kërko dhe lyp* të shpëtojnë shpirtrat tanë pra.

(2x)

Zell, profet, për Zotin të digjte ty,*[5] mbretër të paligjshëm pra qortove shumë rreptësisht;*[12] vrave priftërinjt' e turpit* nxehtësisht;[4] çuditërisht* në ujë ndeze zjarr,[26] burove dhe ushqim* pa fare kultivim,[41] dhe rrjedhat në Jordan* në mes i ndave me zhgunin tënd,* Ilia[24] i mrekullueshëm;* kërko dhe lyp* të shpëtojnë shpirtrat tanë pra.

Kur mbi dhé në vete tregove troç* jetën qiellore, o profet, vërtet, ringjalle ti* duke fryrë një të vdekur,*[15] se po pasuroheshe* me jet' enipostate, mbete më i fort'* se vdekja; hipe në karrocë zjarri ti,* u ngrite lart në eter me lavd,* Ilia[2] i mrekullueshëm;* kërko dhe lyp* të shpëtojnë shpirtrat tanë pra.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Majat e profetëve dhe ndriçuesit e tërëshkëlqyeshëm të kozmosit, Ilian dhe Eliseun, le t'i nderojmë, o besnikë, me himne, dhe le t'i thërrasim ngazëllueshëm Krishtit: O Zot i dhembshur, nëpërmjet përgjërimeve të profetëve të tu jepi popullit tënd falje mëkatesh dhe përdëllimin e madh.[83]

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, priti lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Dhoksologjia e Madhe.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i parë i shenjtit Ode III dhe i dyti Ode VI. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Kungatore* Ngazëllohuni, o të drejtë, në Zotin; të drejtëve u ka hije lavdërim. Aliluia.

CITIME

[1] IV [II] Mbret. 2.1,11; Sirak 48.9

[2] III [I] Mbret. 19.12
[3] IV [II] Mbret. 2.12
[4] III [I] Mbret. 18.40
[5] III [I] Mbret. 19.10,14;
IV [II] Mbret. 10.16; Sirak 48.1-2
[6] III [I] Mbret. 17.1,7; Sirak 48.2-3;
Jak. 5.17
[7] IV [II] Mbret. 2.9-14; Sirak 48.12
[8] Lluk. 1.14
[9] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[10] IV Makk. 1.7,13,30; 16.1
[11] I Kor. 15.53-54
[12] III [I] Mbret. 18.18; II Kron. 21.12-15
[13] III [I] Mbret. 18.2; Sirak 48.2
[14] III [I] Mbret. 18.27
[15] III [I] Mbret. 17.17-23; Sirak 48.5
[16] Fil. 2.15
[17] IV [II] Mbret. 2.19-22
[18] IV [II] Mbret. 2.14
[19] Lluk. 2.26
[20] Mal. 4.4; Matth. 11.14; 17.10-11;
Mark. 9.11-12
[21] Matth. 16.19; 18.18
[22] Jer. 1.5; Sirak 49.7
[23] II Kron. 21.11-13
[24] IV [II] Mbret. 2.8
[25] Sirak 48.1
[26] III [I] Mbret. 18.33-38; Sirak 48.3
[27] III [I] Mbret. 17.1
[28] Joan 15.1
[29] IV [II] Mbret. 5.1-15
[30] Ef. 3.9
[31] I Petr. 1.12
[32] Kol. 1.26
[33] Matth. 17.1-3; Mark. 9.2-4;
Lluk. 9.28-31
[34] Ef. 2.19
[35] Vep. 2.3-4
[36] Apok. 7.17
[37] I Tim. 1.15
[38] III [I] Mbret. 17.4-6
[39] Ps. 144(145).16
[40] I Mbret. [Sam.] 2.2
[41] III [I] Mbret. 17.8-16
[42] Matth. 18.8; 25.41; Jud. 7
[43] Hebr. 5.7; Jak. 4.12
[44] Jez. 44.1-4
[45] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[46] III [I] Mbret. 18.42-45
[47] Lluk. 1.48
[48] Sirak 49.7; Jer. 1.10
[49] III [I] Mbret. 19.2-3
[50] Ef. 6.12
[51] I Kor. 2.8; Jak. 2.1
[52] II Makk. 6.1; 7.2; III Makk. 1.23; 16.16
[53] III [I] Mbret. 18.34
[54] Lluk. 4.22; Vep. 14.3; 20.32
[55] Urt. Sol. 18.24; Sirak 27.8
[56] Joan 1.3
[57] Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6
[58] Eks. 3.2-5
[59] III [I] Mbret. 19.5-8
[60] Ps. 117(118).19
[61] Rom. 11.2
[61a] Ps. 7.12; II Tim. 4.8
[62] III [I] Mbret. 18.38;
IV [II] Mbret. 1.10,12
[63] Lluk. 24.49
[64] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[65] III [I] Mbret. 19.11
[66] III [I] Mbret. 18.41
[67] Eks. 33.18-23
[68] III [I] Mbret. 19.15-16; Sirak 48.8
[69] III [I] Mbret. 22.35-40;
IV [II] Mbret. 9.30-37
[70] III [I] Mbret. 20(21).17-24
[71] Ps. 102(103).22;
Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[72] IV [II] Mbret. 1.10,12
[73] Est. 4.17b
[74] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[75] Matth. 4.17; Mark 1.15
[76] IV [II] Mbret. 2.13
[77] IV [II] Mbret. 2.6

[78] I Kor. 2.9
[79] II Mbret.[Sam.] 5.10 etj.
[80] Gjen. 3.16-19
[80a] Gjen. 3.4-6
[81] Ps. 35(36).9
[82] Matth. 23.33
[83] Num. 14.19 etj.

MË 22 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i miroprurëses së shenjtë dhe të barabartë me apostujt Maria Magdalena.

NË MBRËMËSORE

Thirrtore
Ting. I Panéfimi mártires

I solle ti miro Krishtit Zot* që ish vënë në një varr,* dhe jepte frymë,[1] pra ngjalljen,[2] te të vdekurit të tër';* kur e pe e para,* o Mari hyjprurëse,[3] iu fale[4] e lotuar me gaz dhe mall; prandaj fort lyp atë* të dhurohet përdëllim i madh,*[5] paqe, hir te shpirtrat tanë me bollëk.

Kur pe të mbërthyer Krishtin tënd,* Magdalenë,[6] qaje shum',* thërrisje: "Ç'ësht' kjo që shihet? Jeta[7] si po vdes në Kryq?* Ndërsa sheh Krijesa,* tundet,[8] errësohen dhe ndriçuesit[9] me frikë dhe me çudi". Prandaj fort lyp atë* të dhurohet përdëllim i madh,*[5] paqe, hir te shpirtrat tanë me bollëk.

Mari e lëvduar, mençurisht* ishe mbushur plotpërplot* me dijeni të vërtet', kur ishe afër Bërësit,*[10] e tërëkënduar;* bashkëzbritjen e tij pra, pësimin predikove te popujt drejt; prandaj fort lyp atë* të dhurohet përdëllim i madh,*[5] paqe, hir te shpirtrat tanë me bollëk.

Lavdi
Ting. Tërth. II I Anatoliut

O Mari Magdalenë, meqenëse e pe e para ngjalljen[3] hyjnore të shkakut të parë të të mirave, që hyjnizoi dhembshurisht natyrën[11] tonë, u tregove dhe ungjillore e parë,[12] duke u thirrur apostujve: Largojeni topitjen dhe merrni kurajë,[13] dhe ejani të vëzhgoni Krishtin e ngjallur, që i jep kozmosit përdëllimin e madh.[5]

Tani *Hyjlindësore*

Askush që përik tek ti, nuk largohet i turpëruar nga ti, o e Virgjër Hyjlindëse e kulluar, por kërkon Hirin dhe merr dhuratën sipas interesit dhe kërkesës.*

ose Kryqhyjlindësore
Triímeros anestis Hristé

Sapo të pa të varesh mbi Kryq,* vajtonte e dëlira krejt* porsi nënë,* duke thënë: Biri im,* o Perëndi dhe Zot, o fëmijë fort i ëmbël,* si po duron pësim të turpshëm ti?

Pasvargje
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

O modeste, miroprurëse, kur Krishti ynë u shfaq,* ndiqje gjurmët e tij[14] me zell;* me gatishmëri në shpirt* i shërbeje[15] drejt dhe s'e le* madje kur vdiq, o e tërëfamshmja ti;* porse, si shkove, i solle dhembshurisht* miro[16] si edhe lot;* ndaj kujtimin tënd të tërëhyjshëm pra* e kremtojm' me panair, shenjtore plot lavdi.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i saj dhe në skajet e botës fjalët e saj.

O Mari tërëshkëlqyese, modeste, kishe mjaft mall* jet'[7] të shihje në varr, si vdiq,* edhe brenda natës[17] pra* edhe engjëj dëgjove qart':* "Siç paratha Krishti Zot u ngjall",[18] kështu* fole te nxënësit e atij me nxit,* zmbrapse prej shpirtit tënd* zymtësinë dhe në vend të qarjes fill* more ngazëllim, hare,[19] që s'shprehet dot aspak.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

Ne besnikët në kujtimin tënd me gaz sot mburrim atë* që tani të lëvdoi ty,* të mbimirin Zotin tënd;* pa pushim ndërmjeto, e thjesht'* dhe miroprurëse, të fitojmë ne* lavdin' përjetë,[20] shkëlqimin që e kan'* gjithë shenjtorët[21] lart;* meqë, hyjlumtuese, guxim ti ke* para Krishtit përgjithnjë, lyp të shpëtohemi.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Bizantit

Maria Magdalena, pasi i shërbeu si nxënëse me besueshmëri Krishtit[15] Perëndi, që u varfërua vullnetarisht me varfërinë time nga dhembshuria[22] hiperbolike, kur e pa të tendoset mbi dru dhe të mbyllet në varr, duke hedhur rrjedha lotësh, thërriste: "Ç'pamje e huaj? Ai që ngjall të vdekurit, si llogaritet si i vdekur? Ç'miro t'i sjell atij që më çliroi nga era e keqe e demonëve?[23] Ç'lot të derdh për atë që i ndryshoi stërnënës sime rrobën e lotëve?''.[24] Por mbreti i Gjithësisë, kur u shfaq si roja e kopshtit, me anën e freskimit të fjalëve të tij zhduku vapën, sapo i tha asaj: "Sapo të shkosh, thuaju me zë të lartë vëllezërve të mi ungjillëzime ngazëllimi; ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj,[25] që t'i jap botës përdëllimin e madh''.[5]

Tani *Hyjlindësore*

Qielloret të himnojnë, o nënë hirplote e panusëruar, edhe ne e lavdërojmë lindjen tënde të pagjurmësuar; o Hyjlindëse, ndërmjeto të shpëtojnë shpirtrat tanë.

ose Kryqhyjlindësore
Ti imás kalésomen ájii

Sapo delja pa qengjin[26] përmbi dru* duke dashur, dhe tek rrinte shtrirë, po thërriste fort* me vajtime, lot si nënë:* Biri im, ç'pamje po shoh?* E huaj është; vritesh ti që ndan si Zot* tër' jetën te të gjithë edhe ngjalljen jep* te njerëzit.[7] Unë lavdëroj,* himnoj bashkëzbritjen tënde pra,* të shumtë fort,* Zoti im, i dhembshur, Perëndi.

Përlëshore
Ting. I Ton tafon su Sotír

E ndiqje, o Mari* Magdalenë e thjeshtë,* atë që nga e Virgjra për ne lindi, Krishtin,*[10] dhe ruaje të drejtat, ligjet e tij;[27] ndaj kremtojmë ne* sot kujtimin tënd* të tërëshenjtë, të mburrim* besërisht me mall,* e barabart' me apostujt* edhe miroprurëse.

Dhe Hyjlindësore

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme, Kanunet e Oktoihut dhe i shenjtores që ka Akrostihidhë: "Këndoj Maria Magdalenën me mallëngjim". I Theofanit.

Ting. Tërth. IV
Ode I
Igrán dhiodhefsas

Me derdhje ndriçimesh të hyjshme plot,* me një zbukurim të hyjshëm nur je stolisur ti;* ndaj, Mari, shkëlqeje zemrën time* me ndërmjetimet e tua, sepse ka terr.

Si Fjala e Atit të dha çlirim* nga e keqja, frymët pra,[23] dhe të shenjtëroi qart',* nxënëse të kish; ndaj me karizmat* e Shpirtit të Tërëshenjtë[28] u mbushe ti.

U mbushe me rrjedha që japin jet',* prej burimit pa kursim, prej Zotit që na u shfaq* përmbi dhé nga dhembshuria edhe* i thau rrymat e turbullta, fajin ton'.

Hyjlindësore

Si nënën e Bërësit natyror* të himnojmë, Vajzë, që pajtimin me Perëndin'* ti solle në natyrën kundërshtare* të njerëzisë, Hyjlindëse Zonj' pa cen.

Ode III
Uranias apsidhos

Deshe shkakun e parë pra të të mirave ti,* që e hyjnizoi natyrën tonë me simpati,* Mari, ndaj ndoqe atë* gatishmërisht,[10] si iu binde* porosive, ligjit të tij të hyjnueshëm.

Ti e para në varrin e Çlirimtarit Jisu* shkove dhe pe ngjalljen e tij hyjnore me gaz, o vajz';*[3] ndaj ungjillore ke qen',* kështu u shfaqe dhe thirre:* U ngjall Krishti,[12] duart trokisni me ngazëllim.

Hyjlindësore

Fjala, Krishti, u bë mish nga gjaku yt i dëlir',* e tërëkulluar, me pasuri mirësie[29] pra;* dhe më shpëton, sepse zgjidh* dënim të lashtë;[30] kërkoji* pa pushim që grigja që ke ta shpëtojë ky.

Irmosi: Uranias apsidhos

»Perëndi që apsidë bërë në q'ell si »çati,*[31] ti që je ndërtues i Kishës,[32] »mirë më siguro* në dashurinë që »ke;* je maja e çdo dëshire,* njeri-»dashës, edhe mbështetja për çdo »besnik.

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

I shërbeve, Mari Magdalenë, mir' * Fjalës Zot, që i varfër u bë[22] për ne* nga një dhembshuri pa fund,* i shërbeve si nxënëse* vërtet[10] e qartas dhe, kur po varej në Kryq, e pe;*[6] dhe pe në varr të vihej,[33] vajtoje me lot dhe zë;* të nderojmë pra, dhe panairin tënd bëjmë* me bes', miroprurëse,* dhe thërrasim të gjithë tok,* e kënduar,* me lavd të madh;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Hyjlindësore

Ty të shpall si të lum çdo brez njerëzor,*[34] si të vetmen që linde ti Perëndi* në mish pafarisht, edhe* si të virgjër, sepse në ty* Hyjnia e përzjarrtë fushoi, dhe mënd si foshnj'* Ndërtuesin dhe Zotin; gjinia e engjëjve,* gjithë njerëzia tok lëvdojn' lindjen tënde* të tër'shenjtë denjësisht* dhe me një zë thërrasin pra* duke lypur* për ndërmjetim:* Lutju Zotit Krisht Perëndi,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve,* se i falemi lindjes sate pa cen me bes'.

ose Kryqhyjlindësore

Nëna jote e virgjër, Jisu, të pa* mbi një Kryq, ndaj vajtonte me lot, me zë,* thërriste: O Biri im* fort i ëmbël, mjer'! Si mbi dru* padrejtësisht të varën ty bijtë me ligësi* të Izraelit, mosmirënjohësit krejt vërtet;* por si përdëllyes i pëson, Perëndi ti,* im Bir, meqë s'mban mëri,* se i shumëmëshirshëm je;* vuan siç do* në mish, i mir',* që krijimin tënd ta çlirosh* prej skllavërisë së tmerrshme*

të vrasësit;*ndaj himnoj bashkëzbritjen tënde, o Fjalë Krisht.

Ode IV
Isakíkoa Kírie

Duke pasur mendjen pa shqetësime nga kotësia e botës, i shërbeve atij që erdhi ta shpëtonte tërë kozmosin[35] prej mashtrimit.

Elarë me anën e lotëve, arrite shpejt në varrin e jetës,[3] dhe pe një engjëll që shpallte ngjalljen e Krishtit,[18] o Mari.

Zemra jote u bë e paqortueshme në të drejtat[36] e Krishtit, dhe e dëshirove vetëm atë, të bukur në hijeshi,[37] o e admirueshme.

Hyjlindësore

Pa e marrë vesh më zuri gjumë mëkati, për shkak të përtacisë, o Vajzë; ngrimë[38] për pendim me përgjërimin tënd të pafjetur.

Ode V
Ina ti me aposo

Stërnëna, duke parë se shkelet prej këmbëve të grave të shenjta me moral burrërie ai që e mashtroi me fjalë[39] dhe e flaku qëmoti nga Parajsa,[40] ngazëllohet përjetësisht së bashku me to.

O Mari Magdalenë e thjeshtë, e plagosur nga aspirata e dashurisë[41] së ëmbël të atij që u fryn jetë[1] të gjithëve, i cili vdiq dhe në varr u shtri, i sjell miro dhe i hedh aroma[16] lotësh.

O e lavdishme, pas pësimit hyjnor dhe ngjalljes së frikshme të Shpëtimtarit, si nxënëse e Fjalës, rend duke shpallur gjithkund fjalën e respektuar dhe zë për jetë shumë veta të mashtruar nga injoranca.

Hyjlindësore

O Vajzë e tërëshenjtë, ai që deshi nga mirësia dhe përdëllimi i pafund të lindë prej teje, më rimëkëmb mua që rashë në greminat e ndërlikuara të mëkatit; atij përgjëroju që të çlirohen nga çdo dëm ata që të himnojnë me besim.

Ode VI
Ilásthití mi Sotír

Freskove dhe thave krejt* me fjalën që the topitjen, vapën zjarr të nxënësve ti,* kur thirre e thjeshtë, jeta, Krishti,[7] u ngrit,[12] u shfaq,* dielli i hijshëm* shndriti, feksi me shkëlqim dhe gaz.

Ja seç shkëlqeu, Mari,* kujtimi yt dritëprurës, feks sa të himnojnë në të* me besë edhe flak errësirë demo-

nësh larg,* influenc' dinake,*[42] o e denj' për admirim dhe lavd.

Hyjlindësore

Je zbutje që s'preket dot,*[43] kandil me një pamje drite,[44] shenjtërore[45] nur mendërisht* dhe urë që çon drejt Perëndisë sa të himnojm',* po kështu të njohim* dhe si fort pa cen Hyjlindëse.

Irmosi: Ilásthití mi Sotír

»Jan' shum' mëkatet që kam,* ndaj »le të të vijë keq, o Zot, për mua; lu»tem, më nxirr* nga fundi i vrereve, »sepse thirra fort te ti*[46]dhe dëgjomë »mua,* Perëndia i shpëtimit tim.[46a]

Kontaqi
Ting. IV O ipsothís en to stavró

Kur Zoti mbi esenc'* në mish mbi dhé erdhi,* të mori nxënëse* vërtet, se të gjithë* dëshirën për këtë e kishe, ndaj bëre qart'* mjaft shërime, miroprurëse;* dhe tani që ke shkuar lart,* nëpër qiej, vazhdimisht* lutesh te Krishti ynë,* e barabartë me apostujt ti,* dhe ndërmjeton fort* për botën përherë pra.

Shtëpia

O modeste, Krishti, drita e botës,[47] përderisa pa të pafjetur syrin e besimit dhe të pashkëputur dashurinë e mallit, ty ta shfaqi të parën veten e tij, pasi u ngrit prej varrit,[3] kur erdhe shpejt[17] me miro[16] dhe iu afrove të paafrueshmit me lot; dhe ai, duke të shpërblyer, të dhuron energjinë hyjnore të Shpirtit, dhe të zbulon vendimin e ngjitjes drejt Atit[4] të pafillim; dhe të dërgon që t'i lajmërosh ungjillëzimet hyjnore të ngjalljes së tij te mistet[12] e frikësuar;[13] prandaj, duke pasur guxim tepër të madh pranë tij, ndërmjeton fort për botën përherë pra.

Sinaksari

Më 22 të të njëjtit muaj, kujtimi i miroprurëses së shenjtë dhe të barabartë me apostujt Maria Magdalena.
Vargje: Maria, së cilës i the "Mos më prek",[4]/ të prek me prekje të palëndëta, o Krishti im.
Në të njëzet e dytën, Maria Magdalena mbylli sytë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martires së shenjtë oshënare Markela në Hios.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Pedhes Evreon

O miroprurëse, dëbove sëmundje të llojllojshme, ngaqë kishe Fjalën që

bashkëpunonte me ty; atij tani i qëndron afër[48] duke thirrur: I bekuar je, o Zot Perëndi, në jetë.[49]

Ti vetëm para të tjerave e pe[3] jetën tonë, Krishtin,[7] të ngjallur, dhe e mendove si kopshtar,[25] duke thirrur: I bekuar je, o Zot Perëndi, në jetë.[49]

Hyjlindësore

Ndalove rrymën e vdekjes, kur nxure dhe linde Perëndinë e pavdekshëm, për hir të të cilit, o e Dëlirë, këndojmë të gjithë: I bekuar është fryti i barkut tënd, o e tërëkulluar.[50]

Ode VIII
Eptaplasios káminon

Jeta jote, o Magdalenë, ishte e shkëlqyer në pamje, duke shndritur me llamburitjet e punëve të virtytshme të predikimit hyjnor, me prirjet drejt Hyjnisë dhe me vezullimet e dashurisë për Ndërtuesin, për hir të të cilit këndon së bashku me engjëj: O priftërinj, bekoni;[51] popull, përmbilartësoni në gjithë jetët.

O e lavdëruara Mari, qëndron afër Kryqit, duke parë therjen e padrejtë[6] të atij që zbrazi veten[52] nga përdëllimi i parrëfyeshëm dhe, e zhytur në rënkime dhe lot, thërrisje: Çfarë është kjo çudi e huaj? Si vritet dhe vdes ai që vrau vdekjen, ai që është jetë nga natyra?[7]

Hyjlindësore

O e Tërëdëlirë, me një zë të lavdërojmë si nënën e Perëndisë dhe më të lartë nga krijesat, sepse në ty u zhduk dënimi që erdhi nga Adami,[30] dhe u familjarizua esenca e zmbrapsur e njerëzve,[40] e cila këndon melodikisht: O priftërinj, përhimnoni;[51] popull, përmbilartësoni në gjithë jetët.

Irmosi: Eptaplasios káminon

»E dogji furrën shtatë her'* në Kalde »një tiran i saj* me mani për Djemtë* »që nderonin Perëndi;*[53] por, kur të »shpëtuar krejt* i pa nga një fuqi më »e fort',* thirri ky kështu:* Po Çlirim»tarin Ndërtues,* o Djem ju, ta beko»ni;*[54] priftërinj, ta himnoni;*[51] ju po»pull, lartësojeni pra për gjithë jetët.

Ode IX
Eksesti epí tuto

Drejt gazit të hyjnueshëm në Parajs'* u shpërngule tani në një gjerësi me lehtësi,* drejt banesash mbibotërore[55] pra,* që jan' mendore, o Mari;* ku ka zë të pastër nga sa kremtojn'*[56] shkëlqyeshëm atje lart,* brigada oshënarësh;* ndaj, miroprurëse, të lumërojm'.

Asgjë nuk preferove sa jan' mbi dhé* më shum' se dashurinë e Krishtit Zot, meqenëse* ishe e plagosur nga bukurit'* e tij[41] pra vetëm, krejt e thjesht',* dhe nga llamburitjet që shndrit ai* dhe, duke ndjekur gjurmët* e tij,[14] me zë thërrisje:* Të madhështoj, të plotmëshirshmin ty.

Arrite hyjnizim që krijon hyjni* dhe shijon ti përroin e Hirit,[57] prej Zotit pret* për mundimet pra një shpërblim të madh;* me koret e apostujve* je e numëruar, o Magdalen',* o nxënëse e Fjalës,* sa të nderojn' me mall plot,* me përgjërimin tënd pra ruaji.

Hyjlindësore

Si nëna e atij që pësoi keq* për ne, o Virgjëreshë Hyjlindëse, ti më shpëto* nga pasionet shpirtprishëse, më zgjidh* nga prangat e mëkateve*[58] si e dhembshur; shpirtin tim që u lodh* nga influenc' demonësh,* e mirë, ëmbëlsoje* të të himnoj ty që s'ke hiç qortim.

Irmosi: Eksesti epí tuto

»U shtang dhe u shastis qielli me »të,*[59] u habitën dhe anët e botës »mbar',* se Perëndi* trupërisht u »duk[60] te të vdekshmit ne* dhe, Zo»një, barku yt u bë* më i gjerë se qiejt, »se çdo vend;* Hyjlindëse e Virgjër,* »rreshtimi engjëllor si* dhe njerëzor »të madhështojnë ty.

Dërgimësore
Jineqes akutísthite

Mari me emër zotëror,* o nxënëse e Krishtit tënd,* tok me Marinë e Virgjër,* të vetmen nënë të Zotit,* dhe gjithë miroprurëset* përgjëroju pareshtur pra* Zotit, të kryqëzuarit,* për ne që ty të nderojmë,* o miroprurëse, me mall.

Dhe shërbesa që mbetet si zakonisht.

CITIME

[1] Gjen. 2.7
[2] Joan 11.25
[3] Mark 16.9
[4] Joan 20.17
[5] Num. 14.19 etj.
[6] Joan 19.25
[7] Joan 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
[8] Matth. 27.51,54
[9] Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
[10] Matth. 27.55; Mark 15.40-41; Lluk. 8.2-3
[11] II Petr. 1.4
[12] Mark. 16.11
[13] Joan 20.13
[14] I Petr. 2.21
[15] Lluk. 8.3
[16] Mark. 16.1; Lluk. 23.55-24.1
[17] Joan 20.1
[18] Matth. 28.5; Lluk. 24.4-7

[19] Matth. 28.8
[20] II Kor. 4.17; II Tim. 2.10; I Petr. 5.10
[21] Ps. 109(110).3
[22] II Kor. 8.9
[23] Mark. 16.9; Lluk. 8.2
[24] Gjen. 3.16
[25] Joan 20.14-17
[26] Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32; I Petr. 1.19
[27] Ps. 104(105).45 etj.
[28] I Kor. 12.4,11
[29] Rom. 2.4
[30] Gjen. 3.16-19
[31] Gjen. 1.7-8; Is. 40.22
[32] Ef. 2.20-21
[33] Matth. 27.61; Mark 15.47; Lluk. 23.55
[34] Lluk. 1.48
[35] Joan 12.47
[36] Ps. 118(119).80
[37] Ps. 44(45).3
[38] Rom. 13.11
[39] Gjen. 3.4-5
[40] Gjen. 3.24
[41] Kënga 2.5; 5.8
[42] Ef. 6.12
[43] Lev. 16.2 etj.
[44] Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
[45] Eks. 15.17 etj.
[46] Jona 2.2
[46a] I Kron. 16.35; Ps. 17(18).47; 50(51).14; 87(88).2
[47] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[48] III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
[49] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[50] Lluk. 1.42
[51] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[52] Fil. 2.7
[53] Dan. 3.19
[54] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 27
[55] Joan 14.2
[56] Ps. 41(42).5
[57] Ps. 35(36).8
[58] Fja. Urt. 5.22
[59] Jer. 2.12
[60] I Tim. 3.16; Kol. 2.9

MË 24 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martires së madhe
e të shenjtë Kristina.

NË MBRËMËSORE

Thirrtore
Ting. IV Édhokas simíosin

Zoti mendjen tënde të dëlirë kur e shkëlqeu nur* përmes dijes së hyjshme krejt,* nga terri i thellë tmerr* të çliron, se është* diell drejtësie[1] vërtet, martire e hyjlum;* ndaj i dërrmove idhujt e ligësis',* Kristinë, dhe ikonizove me durim edhe me fuqi* qart' pësimet e Krishtit tënd,* o e virgjër me lavd të madh.

Si në mish durove dhimbjet, u shpërngule gëzueshëm* drejt shijimit pa dhimbje hiç;* atje duke qenë ti,* e stolisur bukur* si një nuse shumë e zgjedhur, fort e çmuar pra* për mbretin Krisht, o e tërëfamshmja nur* Kristinë, na kujto ne që me bes' kujtimin tënd po festojm'* që të gjejmë mëshirë, hir* dhe çlirim nga çdo dert a tmerr.

O martire, shqyerjet mishore si zbukurime nur* i mbuloje si nuse ti;* mantelin e purpurt, petk,* që me gjak u lye,* me shkëlqim e veshe dhe rri tash pranë Dhëndrit tënd,* pran' Krishtit Zot, e stolisur me ndriçim,* me vezullim hyjnor,[2] Kristinë, dhe shijon hyjnizim gjithnjë* plot gëzim me dëshmoret lart* si edhe me të virgjra tok.

Lavdi
Ting. II I Anatoliut

Si alabastër miroje ia ofrove[3] gjakun tënd Dhëndrit tënd Krisht, o Kristinë martire athlofore, e admirueshme dhe e pamposhtur, dhe more shpërblim prej tij kurorë të paprishshme;[4] prandaj, atë që vdiq nga kafshimet e gjarpërinjve helmues, e ngrite të gjallë me fjalën tënde nëpërmjet thirrjes së Shpirtit të Tërëshenjtë; ndaj të denjësoi për dhoma qiellore Jisui njeridashës dhe Shpëtimtari i shpirtrave tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Shpëto prej rreziqesh shërbëtorët e tu, o Hyjlindëse, se të gjithë përikim te ti pas Perëndisë, si në një kështjellë të patronditur e nën mbrojtje.*

ose Kryqhyjlindësore
Ote ek tu ksilu se

Vajzë,* po lotoje me vajtim* dhe pësoje dhimbje të shumta, rënkoje thellë në shpirt,* kur po kryqëzohej Biri yt dhe Perëndi,* fort e shenjtë e pacen, thoshe: "Mjer', Bir i ëmbël,* si padrejtësisht po vuan, varesh përmbi

dru,* ti që dheun mbarë e mbush plot".*[4a] Ndaj të lypim, Zonjë, me besë,* bëje që të jet' i dhembshur ky me ne.

Pasvargjet e Oktoihut

Lavdi

Ting. II I Gjergjit

Vërtet ti e tregove veprimtarinë si të përshtatshme me emrin tënd krishtprurës, kur me anën e pastërtisë sate virgjërore u martove me Krishtin përmes mirëdashjes së Atit dhe bashkëpunimit të Shpirtit; dhe me mundjet e forta të martirizimit shkëlqeve tepër, më shumë se rrezet diellore; prandaj, si flijim i pastër[5] dhe i patëmetë,[6] iu ofrove trapezës qiellore, duke u kënaqur përjetë me koret e virgjëreshave dhe martireve; tok me to, o Kristinë sinonime me Krishtin, kërko që t'u dhurohet atyre që të nderojnë paqe dhe përdëllim i madh.[7]

Tani *Hyjlindësore*

Ote ek tu ksilu se

Ki gaz,* se të pa dikush dikur,* një që po shikonte[8] në Shpirtin Hyjnor, të pa portë, der'* krejt të mbyllur, që shkaktari i të gjithave* e kaloi i vetmi,[9] o dëgjim i shkëlqyer* dhe çudi paradoksale; ki gaz, mbrojtje, streh'* mjaft e fortë për të krishterët,* shtambë ari je që kish manën,*[10] dhe përikje për shërbyesit e tu.

ose Kryqhyjlindësore

Kur pe* që po varej përmbi dru,* ti, o e kulluar, bistaku i pjekur me ëmbëlsi,* që pa kultivim në mitër e ke mbajtur, Vajz',* me vajtime thërrisje dhe me klithma: O im Bir,* mirëbërës Krisht, piko musht dhe me të dehje* vesesh do të hiqen, kështu pra* dhembshuria jote do shfaqet* përmes meje që të linda, Zoti im.

Përlëshore

Shqerra jote

ose

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

E le, o e lavdishme, mashtrimin atëror,* dhe llamburitjen e hyjshme të besës prite në shpirt,* dhe me Krishtin u martove si e virgjër krejt* bukur, prandaj garove fort* dhe armikun e vithise; lyp pa pushim tani pra,* që të na mëshirohen shpirtrat, Kristinë, o martire zëmadhe ti.

Dhe Hyjlindësore

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme,
Kanunet e Oktoihut dhe e shenjtores
që ka Akrostihidhë: "Të këndoj,
o vajzë, ty që ke emrin e Krishtit.
Josif".

Ting. Tërth. IV
Ode I
Igrán dhiodhefsas

Ki gaz, athlofore, u shfaqe ti* plot lavdi, Kristinë, o martire e Krishtit Zot* Shpëtimtar, dhe tërë besën boshe* si dhe mashtrimin e atit i zhduke krejt.

Siç shohim keqdashësin mjaft të çar'* para këmbësh vajze athlofore, t'i psalim himn* ne të gjithë Shpëtimtarit tonë,* që e tregoi atë fitimtare krejt.

E ke dëshiruar me pastërti* që të shihje hijeshinë bukur të Dhëndrit tënd* fort të pastër, veten e stolise* nur, athlofore, me plot trimëri të shenjt'.

Hyjlindësore

E zure ti Fjalën e Atit Zot* që me mish mbi fjalë u bashkua, nën' e dëlir';* si e dëshiroi fort Kristina,* fitoi lavdin e martirizimit pra.

Ode III
Si i to steréoma

I shtrive drejt qiellit,* o e lavdishme fort, sytë lart* dhe mendjen tok,* dhe përmes krijesash* njohe Bërësin tënd ti pra.

Besimin te Zoti Krisht,* si pasuri që nuk vidhet dot,* e kishe ti,* o e thjeshtë, ndaj le* varfërinë e idhujve.

Një himn me falënderim* Bërësit, Krishtit, i psalje mir'* e lidhur tmerr* në një dru, martire,* kur duroje fort rrjepje ti.

Hyjlindësore

Stuhin' e mendimeve* krejt ma pusho, Zonjë e dëlir',* ti që në bark* kishe Krishtin, ndal krejt* çdo mërzitje të shpirtit tim.

Irmosi: Si i to steréoma

»Ti je përforcim për ne* që po përi»kim te ti, o Zot;*[11] je drit' për sa* ja»në errësuar;*[12] ndaj dhe shpirti im »të himnon.

Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotír

Modeste, gjakun tënd* mu si një alabastër* me miro Dhëndrit tënd Krisht ia solle[3] me plot mall* dhe, o e admirueshme, si shpërblim more prej atij*

hir shërimesh[13] ti,* kuror' që s'prishet;[4] dëbon pra* nëpërmjet fuqis'* së Shpirtit[14] gjithë kolonat,* hordhit' e demonëve.

Hyjlindësore

Ti shpresë je për ne* të krishterët, e virgjër;* ti, Zotin që ke lindur mbi mendje e fjalë,* lyp pa pushim, Hyjlindëse, tok me forcat e sipërme,* të na japë ndjes'* mëkatesh, ndreqje jetese* neve, pra çdokujt* që të lëvdon ty përherë* me besë si dhe me mall.

ose Kryqhyjlindësore

Kur shihte përmbi dru* qengjin[15] edhe bariun*[16] të varur dhe të vdekur keq, shqerra pa njollë* po thoshte duke qarë, duke bërtitur si nënë kjo:* Biri im dhe Zot* i përmbimirë, si unë* mundem ta duroj* pra bashkëzbritjen mbi mendje,* pësimin tënd vullnetar?[17]

Ode IV
Isakíkoa Kírie

Shijoje fshikullimet duke u kënaqur me vizione hyjnore të Dhëndrit tënd dhe duke parë bukurinë e tij, o martire sinonime me Krishtin.

Përderisa nuk e duronte mallëngjimin tënd për Krishtin, ati yt mizor dhe tepër ateist të kërcënonte me plagosje torturash, o Kristinë.

Thirrje, o martire, gjatë vuajtjes: U ngjita pas teje[18] e plagosur prej mallit e dashurisë sate;[19] më trego fitimtare.

Fytyra jote, e ndriçuar nga shkëlqimet e trimërive të tua që shkaktonin stolisje, rrezatonte bukuri dhe ngazëllim lavdie të perëndishme.

Hyjlindësore

I lavdëruari i profetëve, Isaia, qëmoti të quajti shkop që mbante lule,[20] Zotin, o Perëndilindëse, nënë gjithmonë e virgjër.

Ode V
Orthrízontes voomen si Kírie

Meqë u bëre si engjëll në trup, o martire, të ushqenin engjëj qiellorë me ushqim engjëjsh.[21]

O Kristinë, nuk mohove gurin e jetës,[22] prandaj, pasi armiq të lidhën në gurë, të hodhën në ujëra.

U rrëmbeve drejt lartësie, kur si turtulleshë fluturove me krahët e Shpirtit Hyjnor dhe u prehe[23] afër Ndërtuesit.

Hyjlindësore

Mua që u bëra i vdekur për shkak të mëkatit,[24] më ringjall, o Virgjëreshë e

dëlirë, që kishe në bark jetën e pamëkatshme.

Ode VI
Tin dhéisin ekheó

Prej ëmbëlsis'* së të dashurit u josh* zemra jote, athlofore; drejt erës* së mirë pra* që pësimet e tij kan',* vrapoje[25] duke i thirrur: Nga malli yt* po digjem fort, ndaj therem keq,* Tërëmbret, për shkak të dashuris' për ty.

Kur prindi yt* pa që Atin qiellor*[26] ti e deshe, o martire, tregoi* mendim barbar,* në dënime të ndryshme* pra ty të vuri, se qe besëkeq ai;* natyrën, kushtin atëror* e shpërfilli me plot injorancë ky.

Porsi zambak,* trëndafil i mermë, ti* lulëzove në livadhe[27] martiresh,* pikon mjaft hir* mirosh, ndaj i lëshove* aroma zemrës së çdo besimtari pra,* dëshmore me emër Krishti,* o e thjesht', shoqërohesh me engjëjt shenjt'.

Hyjlindësore

Hyjfolësit,* pra profetët, thellësin'* e misterit tënd e kishin kuptuar;* profetikisht* parathanë, e Virgjër,* fort të ndriçuar prej Shenjtit Shpirt që nga larg,* se do të bëheshe ti nën'* e vërtetë për Zotin e Gjithësis'.[28]

Irmosi: Tin dhéisin ekheó

»Do derdh lutjen* para Zotit Perë»ndi* dhe atij do t'ia tregoj hidhë»rimet* që kam;[29] sepse* shpirti im »është mbushur* me çdo të keqe dhe »jeta po shkon në Hadh;*[30] pra si Jo»nai lutem un':* Jetën time nga prish»ja, ti ngrije, Zot.[31]

Kontaqi
Ting. IV O ipsothís en to stavró

Si pëllumbeshë nur* u njohe, me pamje* prej drite, krahët ti* i kishe prej ari,*[32] në qiej lart u prehe,[23] o Kristinë e thjesht';* festën tënde të lavdishme pra* e kremtojmë, i falemi* arkivolit besërisht* me lipsanet e tua* nga ku buron vërtet për çdo njeri* shërim të hyjshëm për shpirtin dhe trupin tok.

Sinaksari

Më 24 të të njëjtit muaj, kujtimi i martires së madhe e të shenjtë Kristina.
Vargje: Kristinën, nusen e paqortueshme, e bashkoi/ me Krishtin Dhëndër gjaku i martirizimit.
Më njëzet e katërtën, Kristina u qëllua me shtiza të mprehta.

Në të njëjtën ditë, martirët e shenjtë Kapitoni, Imeneu dhe Hermogjeni mbarojnë me shpatë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i apologjetit të shenjtë Athinagora.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit të shenjtë Theofil detari.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i neomartirit të shenjtë Athanasi nga Kiosi i Azisë së Vogël.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Boris dhe Gljeb, princër rus.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VIII
Pedhes evreon

Duke qenë në kontakt me zjarr që buçiste, i thërrisje himn mirëbërësit të të gjithëve, i cili freskonte[33] zemrën tënde: I bekuar je, o Zot, Perëndi, në jetë.[34]

Meqë dëshiroje shumë të gjeje vetëm Perëndinë, nuk u interesove për gjymtyrët që digjeshin, nuk e mohove Krishtin,[35] o virgjëreshë që këndoje: I bekuar je, o Zot, Perëndi, në jetë.[34]

Me shirat e gjakrave të tua thave rrjedhat e manisë së idhujve; dhe tani, o martire e virgjër, hedh si shi dete shërimesh, duke pushuar flakërimin e pasioneve.

Hyjlindësore

Përderisa tejkalove, o Virgjëreshë, ligjet e natyrës në zënien tënde hyjnore, ishe përmbinatyrshëm e mbarsur me Perëndi; dhe thërrisje: I bekuar je, o Zot, Perëndi, në jetë.[34]

Ode VIII
Eptaplasios káminon

Me qeverisje hyjnore tejlundrove pa dëmtim det të trazuar ngasjesh dhe torturash, pasi mbyte gjarprin[36] në fund të luftërave të tua, o martire; prandaj në limanet e qeta të Parajsës arrite duke thirrur: O priftërinj, bekojeni;[37] popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Me gara jetike e vrave gjarprin e tmerrshëm, me këndimet e lutjeve të tua vure në gjumë bisha të egra dhe mbete jashtë dëmit të tyre, o Kristinë, duke psalur për Ndërtuesin: O Djem, bekojeni;[38] priftërinj, përhimnojeni;[37] popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

O martire athlofore, të vdekurin nga kafshimet e gjarpërinjve helmues e ngrite me fjalë të gjallë, sepse Krishti, pasi shkeli vdekjen përmes varrimit hyjnor, dëgjon lutjet e tua; drejt tij thërret pa pushim: O priftërinj, bekojeni;[37] popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Hyjlindësore

O gjithmonë e virgjër, përkrahja e fortë e shpresëplotëve, çliromë nga mashtrimi i dragoit[39] tinëzar që më lufton tmerrshëm dhe nxitohet të më poshtërojë; sepse ti je udhëzimi i pagabueshëm i atyre që të kanë besim, që thërrasin pa pushim: O popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Irmosi: Eptaplasios káminon

»E dogji furrën shtatë her'* në Kalde »një tiran i saj* me mani për Djemtë* »që nderonin Perëndi;*[40] por, kur të »shpëtuar krejt* i pa nga një fuqi më »e fort',* thirri ky kështu:* Po Çlirim»tarin Ndërtues,* o Djem, ju ta beko»ni;*[38] priftërinj, ta himnoni;*[37] ju po»pull, lartësojeni pra për gjithë jetët.

Ode IX
Kirios Theotokon

U denjësove, pra pe* Krishtin, Dhëndrin tënd ti,* e lavdëruar, e ndritshme përmes stolish* martirizimi; dëshmore Kristinë, plot triumf.

Kish bukuria jote* hijeshi, e deshi* pra Krishti Zot, më i bukuri se çdokush;*[41] për nusërore në qiell të denjësoi ty.

Me kore që nuk kan' trup* vajzë, u bashkove* dhe u rreshtove me grupe atletësh; ndaj lyp* të Tërëdhembshurin, e lavdishme, gjithnjë për ne.

U shfaq më e shkëlqyer* se çdo diell festa,* kujtimi yt, dhe dëfren sa po të nderojn',* Kristinë, me llamburitje dhuntish nga Shpirti Shenjt.

Hyjlindësore

Mir'dashëse e Virgjër,* shpirtin tim që vuan* nga fajet, ma mirëso si edhe më çliro* me ndërmjetimin tënd pra prej flakëve në amshim.

Irmosi: Kirios Theotokon

»Hyjlindëse të themi,* të pohojmë ne »që* shpëtuam, o e kulluar e virgjër, »me ty,* me koret e të patrupve të ma»dhështojmë tok.

Dërgimësore
En Pnévmati to ieró

U bëre, o Kristinë vajz',* en' e vlefshme,[42] e çmuar* për Zotin, të nderojmë ne* siç e kemi detyrë;* sepse vërtet ishe mburrje* për martirët, të kan' lavd* të virgjrat, edhe u shfaqe* prej Perëndisë mjeke ti* me bollëk kurimesh pra* për foshnjat dhe për fëmijët.

Hyjlindësore

Lëvdojnë lindjen tënde lart* rreshtat e të patrupve,* se mbushe vetëm ti

me gaz* tokësoret; besnikët* të mburrim pra me himnime* edhe me dhoksologji;* për sa jan' në errësirë* linde ti si në mëngjes,* duke sjellë drit',[12] agim,* e paqortueshmja Zonjë.

Lavdërime Idhiomele
Ting. IV I Bizantit

Lavdërojmë, o Krisht, dhembshurinë tënde të shumtë dhe mirësinë që na u bë; sepse edhe gra asgjësuan mashtrimin e manisë së idhujve me anën e fuqisë së Kryqit[43] tënd, o njeridashës; nuk ia kishin frikën tiranit, shkelën dinakun dhe arritën të vijnë pas teje;[44] vrapuan në nuhatjen e miros sate,[25] duke ndërmjetuar për shpirtrat tanë.

I njëjti

Martirja, pasi braktisi pasuri atërore dhe pasi dëshiroi fort dhe sinqerisht Krishtin, gjeti lavdi dhe pasuri qiellore;[45] dhe, e fortifikuar me armatimin e Hirit, me armën e Kryqit e shkeli tiranin; prandaj engjëjt, duke admiruar garat, thoshin: Ra armiku, i mundur nga një grua; dëshmorja u tregua e kurorëzuar, dhe Krishti mbretëron në jetë si Perëndi, ai që i jep botës përdëllimin e madh.[7]

I njëjti

O Krisht, fuqia e Kryqit tënd[43] bëri mrekulli, sepse edhe martire Kristina garoi në ndeshje atleti; ndaj, si hodhi poshtë dobësinë e natyrës, rezistoi trimërisht kundër tiranëve; kështu, pasi mori çmimet e fitores, ndërmjeton për shpirtrat tanë.

I njëjti

O martire Kristinë, duke mbajtur Kryqin në duar si armë të fuqishme, besimin si parzëm,[46] shpresën si mburojë dhe dashurinë si hark, fitove burrërisht mbi ndëshkimet e tiranëve, asgjësove perëndishëm dinakëritë e demonëve dhe, pasi ta prenë kokën, kërcen në Krisht, duke ndërmjetuar pa pushim për shpirtrat tanë.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

I joshur nga bukuria jote virgjërore, mbreti[46a] i lavdisë[47] Krisht të mori si nuse të paqortueshme me bashkim pa cen; sepse, duke i dhënë bukurisë sate fuqi në vullnetin e tij,[48] të tregoi të pamposhtur kundër armiqsh dhe pasionesh; dhe, përderisa durove në plagosje të hidhura e tortura tepër të ashpra, me rreth të dyfishtë të kurorëzoi dy herë, dhe të vendosi në të djathtën e tij të stolisur si mbretëreshë;[2] atij përgjëroju, o martire virgjëreshë, Kristinë e tërëfamshme, që t'u japë himnuesve të tu shpëtim, jetë dhe përdëllim të madh.[3]

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlind'se e virgjër, dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

ose Kryqhyjlindësore
Heris askitikón

O Krishti im, ti je pa mëkat,* por si shpagim dhe çmim denjove që të ofrosh* për ne gjakun tënd[49] të pacen, të tërëfamshëm mbi dhé,* se do që të gjithë të arrijn' shpëtim;*[50] ndaj, duke të parë ty* nëna jote të ngulur lart* në Kryq, vajtonte* duke çjerrë keq nofullat,* duke thënë: Bir,* qengj i tër'paqortueshëm,*[15] do botën ta çlirosh me gjakun tënd[49] fort të çmuar ti;* si perëndove nga sytë e mi, o diell pa perëndim,* që jep te të gjithë* paqe,[51] dritë[52] dhe mëshirë të madhe,[7] Shpëtimtar?

Pasvargjet e Oktoihut

Lavdi
Ting. I I Qiprianit

U numërove së bashku me rreshtimet e sipërme, kur le botën, dhe e aspirove Krishtin, o e lavdëruara Kristinë e tërëfamshme, duke kërkuar për ne përdëllimin e madh.[7]

Tani *Hyjlindësore*

Meqë pranon lutjet e mëkatarëve dhe nuk shpërfill rënkimin e të pikëlluarve, ndërmjeto tek ai që lindi nga barku yt i dëlirë, që të shpëtohemi, o Hyjlindëse e virgjër.

ose Kryqhyjlindësore
Panéfimi mártires

"Një shpat' e përshkoi, o im Bir* zemrën time, Zoti im,* e shqeu siç paratha qëmoti shenjti Simeon,*[53] por, të lutem, ngjallu* edhe lavdëroje tok me ty dhe nënën tënde, pra shërbëtoren tënde ti që s'vdes",* Virgjëresha tha kështu, kur pa* përmbi Kryq të ishte varur Krishti yn'.

Dhe shërbesa e Mëngjesores që mbetet. Në Liturgji, Apostulli dhe Ungjilli i 4 dhjetorit.

CITIME

[1] Mal. 4.2(3.20)
[2] Ps. 44(45).10
[3] Matth. 26.7; Mark 14.3; Lluk. 7.37
[4] I Kor. 9.25
[4a] Ef. 1.23; 4.10
[5] Mal. 1.11
[6] Lev. 1.3 etj.

[7] Num. 14.19 etj.
[8] I Mbret. [Sam.] 9.9,11,18; 16.4;
I Kron. 29.29
[9] Ezek. 44.1-2
[10] Eks. 16.33; Hebr. 9.4
[11] Ps. 70(71).3
[12] Ps. 111(112).4; Lluk. 1.79; Rom. 2.19
[13] I Kor. 12.9,28,30
[14] Rom. 15.13
[15] Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32;
I Petr.1.19
[16] Matth. 26.31; Mark 14.27;
Joan 10.11,14; Hebr. 13.20;
I Petr. 2.25
[17] Matth. 20.18; Mark 10.33-34;
Lluk. 18.32-33; Joan 10.15,17
[18] Ps. 62(63).9
[19] Kënga 2.5; 5.8
[20] Is. 11.1
[21] Ps. 77(78).25; Urt. Sol. 16.20
[22] I Petr. 2.4
[23] Ps. 54(55).7
[24] Ef. 2.5
[25] Kënga 1.4
[26] Matth. 6.9,14,26.32; Lluk. 11.2
[27] Kënga 2.1
[28] I Kron. 29.11; Est. 4.17b;
Urt. Sol. 12.16; Ps. 102(103).19
[29] I Mbret. [Sam.] 1.15; Ps. 141(142).3
[30] Ps. 87(88).4
[31] Jona 2.6-7
[32] Ps. 67(68).14
[33] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
[34] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[35] Apok. 3.8
[36] Gjen. 3.4; II Kor. 11.3;
Apok. 12.9,14-15; 20.2
[37] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[38] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 27
[39] Apok. 12.4-17; 13.2-4; 16.13; 20.2
[40] Dan. 3.19
[41] Ps. 44(45).3
[42] Vep. 9.15
[43] I Kor. 1.18
[44] Matth. 4.19 etj.
[45] Ef. 1.18; 3.16; Kol. 1.27
[46] I Thes. 5.8
[46a] Ps. 44(45).12
[47] Ps. 23(24).7-10
[48] Ps. 29(30).8
[49] Ef. 1.7
[50] I Tim. 2.4
[51] Joan 14.27; Gal. 1.3; Ef. 2.17;
II Thes. 3.16
[52] Joan 1.4,9
[53] Lluk. 2.35

MË 25 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i fjetjes së shën Anës, nëna e Perëndilindëses së Tërëshenjtë.

Tipikon

Nëse bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të shenjtores. Lavdi i shenjtores. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i shenjtores. Përlëshoret: ngjallësore dhe e shenjtores.*

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e shenjtores. Himne Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e shenjtores. Në Mëngjesore, në Perëndi është Zoti, *Përlëshoret: ngjallësore (2x) dhe e shenjtores. Ndenjësoret: nga dy ngjallësore dhe (në vend të Hyjlindësoreve) të shenjtores. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i shenjtores. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtores dhe Ndenjësorja e saj (1x). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret* Ja gojën e çel tani; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore dhe e shenjtores. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të shenjtores. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

*Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e shenjtores. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtores dhe e kishës. Kontaqi i shenjtores (*Me bes' u kërkojm'*). Apostulli i shenjtores dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore e së dielës.*

NË MBRËMËSORE

Thirrtore
Ting. I Ton uranion tagmaton

Duke kremtuar kujtimin e paraetërve* të Krishtit, Joakimit* edhe Anës, të drejtët,*[1] pra të hirshmit dhe të shenjtët, lëvdojm'* pa pushim me këndim mistik* Zotin e dhembshur, i shfaqi ndërmjetës qart'* të përhershëm për shpëtimin ton'.

Ish-shterpa pa pjellori që kish lindur Virgjëresh',* pra nisjen e shpëtimit* të gjinisë son', iku* sot përtej drejt jetës[2] edhe kërkon* kjo nga Krishti që, dhe ata* që e himnojnë me besë, të marrin hir* dhe dhurim, ndjesën e fajeve.

Duke kremtuar kujtimin pra të të drejtëve*[1] të përhimnojmë ty, Krisht,* që shpërngule çuditshëm* Anën për në jet'[2] të hyjshme pa fund* nga një jet' e përkohshme krejt,* se nënë qe

e Hyjlindëses që pa far'* virgjërisht të lindi përmbi mend.

Të tjera
Ting. i njëjti
O tu paradhoksu thávmatos

Shih një panair ndriçues nur* dhe një ditë plot gaz* hijesisht për rruzullin;* është' fjetja e lavdërueshme, edhe për nder* të Anës që mburrim ne,* nga lindi Vajza që jetën[3] e kish në bark;* pra arka frymore ish,* që mbajti[4] Fjalën e panxënshme asgjëkund,* zgjidhja e mërzitjes, shkaku* i gëzimit për të gjith',* që mëshirën e madhe*[5] te të tërë besimtarët jep.

O çudi paradoksale krejt,* Ana që në bark kish* mrekullisht të qashtrën Vajz',* të vetmen në mes të grave, të bekuarën,*[6] burimin e jetës son',*[3] prej jetës plot me mjerime shpërngulet lart* drejt jetës[2] që s'ka mbarim,* pasi u ngrit e lavdishmja drejt qiejve* që nga toka, dhe dëfrehet* tok me bashkësi engjëjsh;* ne tani e kremtojmë* panairin e asaj të shenjt'.

Bëjnë panair me hijeshi,* me kushtim të madh sot* koret e besnikëve* në Shpirtin Hyjnor për fjetjen tënde plot me nder,* na erdhi me çdo shkëlqim,* dhunti edhe hir shërimesh;[7] po djeg, shkrumbon* hordhi djallëzore krejt* me frymë brenda në ajër,[8] dhe e ndriçon* mendjen e çdokujt që të psal* me besim dhe e himnon* ikjen tënde me plot nder,* Anë mjaft e admirueshme.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. IV I Anatoliut

Ata që nga barku i pafrytshëm nxorën shkopin[9] e shenjtë, Hyjlindësen, prej nga lindi si diell shpëtimi në botë Krishti, Perëndia,[10] çifti i shenjtë, bashkëmoshatarët e shenjtë, Joakimi dhe Ana, pasi u shpërngulën në tenda qiellore tok me bijën e tyre, Virgjëreshën e tërëpacenuar, kërcejnë me engjëj, duke bërë ndërmjetim për botën. Edhe ne, si u mblodhëm bashkë me ta, shpresëtarisht himnojmë duke thënë: Ju që nëpërmjet hyjfëmijës dhe së tërëkulluarës Mari u bëtë gjyshërit e Krishtit, ndërmjetoni për shpirtrat tanë.

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës dhe Leximet

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë, dhe në Zot *është* paga e tyre, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë prej dore Zoti,

sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë *si* armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë Krijesën për mbrojtje armiqsh. Do të veshë *si* koracë drejtësi, dhe do të veshë *si* helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë *si* mburojë të pamposhtur oshënarí, dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me të bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm te qëllimi predha rrufesh, dhe si nga një hark i plotë rrethi nga retë do të hidhen në shenjë, dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të përmbytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie, dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligjësi, dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur; mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinastí nga i Shumëlarti.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve *janë* në dorë Perëndie dhe nuk do t'i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën, dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre, dhe ecja nga ne dërrmim, por ata janë në paqe; sepse, edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre *është* plot pavdekësi; dhe pasi do të edukohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë, dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojë në ta Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të, do të kuptojnë të vërtetën, dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij; sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit

(4.7-15)

I drejti, nëse do të arrijë të vdesë, do të jetë në prehje; se pleqëria e çmuar nuk *është* pleqëria shumëvjeçare, as u mat me numër vitesh. Dhe thinjat janë mençuri te njerëzit, dhe mosha e pleqërisë *është* jetë e panjollosur. Meqë u bë i pëlqyeshëm te Perëndia, u dashurua dhe, ndërsa jetonte në

mes mëkatarësh, u transferua. U rrëmbye që e keqja të mos ndryshojë mençurinë e tij ose dinakëria të mos mashtrojë shpirtin e tij. Sepse joshja e së keqes errëson të mirat dhe ëndja e dëshirimit e ndryshon mendjen e patëkeq. Duke u përsosur në pak kohë, mbushi vite të gjata. Se shpirti i tij ishte i pëlqyeshëm nga Zoti, prandaj vrapoi nga mesi i ligësisë. Por popujt, duke parë, dhe duke mos kuptuar, as duke mos vënë në mendje një gjë të tillë; sepse *ka* hir dhe mëshirë ndër të zgjedhurit e tij dhe mbikëqyrje ndër oshënarët e tij.

Në Liti Idhiomele
Ting. I

Ana e tërërespektuar, që e lindi me hijeshi nisjen e shpëtimit tonë, sot shpërngulet nga toka. Ejani, pra, kremtimdashës dhe krishtdashës, pasi të marrim lulet e këngëve, le t'i thërrasim: O Anë e mençur, i lumur është barku yt që mbajti nënën e Fjalës Perëndi, dhe gjinjtë e tu, me të cilët e mënde,[11] janë të bukur;[12] sepse ajo, meqë lindi pa farë Jetëdhënësin,[3] u meritua të mbretërojë së bashku me të; dhe tani ai, pasi të zhvendosi drejt jete[2] hyjnore pa mbarim, të vlerësoi të banosh dhe të ngazëllohesh tok me nënën e tij; prandaj, ne që kryejmë besërisht kujtimin tënd, të përgjërohemi të ndërmjetosh së bashku me të, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Ting. II

Ejani, të gjithë miqtë e virgjërisë dhe të dashuruarit pas dëlirësisë, ejani ta kremtojmë fjetjen e respektuar të Anës; sepse lindi mrekullueshëm burimin e jetës,[3] Marinë hyjbijë, prej së cilës lindi Çlirimtari që ndriçon[13] dhe shenjtëron[14] shpirtrat tanë.

I njëjti

Cila bashkësi e të mbledhurve arrin me devotshmëri në kishën e tërënderuar të Paraetërve, duke thirrur: "Bashkëngazëllohuni, sot, o gjini e njerëzve, sepse Ana nga dheu zhvendoset drejt Zotit dhe qëndron pranë tij,[15] duke kërkuar të na jepet ndjesë neve që me besim kremtojmë fjetjen e saj".

Ting. IV

Ejani, të gjithë shpresëplotët, le të festojmë me ngazëllim sot kujtimin e Stëretërve të drejtë[1] Joakimi dhe Ana, sepse na lindën nënën e Shpëtimtarit, Marinë e paqortueshme; prandaj le t'u thërresim: O çift i zgjedhur dhe i shenjtë, dyshe e hyjshme dhe e hyjnderuar, lyp Krishtin Perëndi, që lindi

si diell nga mesi[15a] juaj, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. I

O dyshe e lumur, ju u ngritët më shumë se gjithë prindërit, sepse nxorët si filiz atë që është më lart se e gjithë Krijesa; me të vërtetë je i lumur, o Joakim, që ke qenë ati i një vajze të tillë; mitra jote është e lumur, o Anë, sepse linde nënën e jetës sonë; të lumur janë gjinjtë me të cilët mënde[11] atë që i dha gji ushqyesit të çdo fryme, të cilin, kërkojmë nga ju të lumurit, ta lypni që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Pasvargjet
Ting. Tërth. I Heris askitikón alithós

G'zohu, o dallëndyshe në shpirt,* që na mësove pra pranverën e Shenjtit Hir,* që mirë dhe pa qortim mençurisht jetove mbi dhé,* që, modeste, nxore rrethin virgjëror* me dhimbje; na linde ti* të panjollshmen, Hyjlindësen;* shqerrë e çmuar,* në bark kishe mëshqerrën[16] Zonj'* që na lindi qengj* që fshin shkeljet e kozmosit;*[17] vetëm ajo me fjalë lindi[18] Fjalën pa burrë hiç,* o Anë, gjyshja e Zotit që të shpërnguli nga toka lart;* atij përgjëroju* që të jepet përdëllimi i madh[5] te shpirtrat tan'.

Varg: Ngazëllohuni, o të drejtë, në Zotin; të drejtëve u ka hije lavdërimi.

G'zohu, e dashur fort prej Hyjnis',* e zgjedhur dhe e çmuar, dyshe plot shenjtërim;* ju shndritët shkëlqim me Hirin Hyjnor, përshtatët aq mir'* shfaqjet krejt Ligjore, lindët pra atë* që lindi Jisuin Krisht,* kryetarin e jetës son',*[19] o Joakim, shenjt* i hyjzënë, me Anën tok,* të hyjnueshme,* të nderuar absolutisht;* o llamba, lindët llambën që s'kish hije, si pasuri* e patët hirin, Hyjlindësen e pacen, ndaj tok me këtë* ju lypni të jepet* te ne përdëllim, mëshirë e madhe[5] dhe shpëtim.

Varg: Të lumur janë të gjithë ata që i kanë frikë Zotit.

G'zohu, o tokë plot me bekim,* që lulëzove të hyjmbirën për rruzullin;* në Ligjin e Perëndis' pa pushim studioje[20] me zell* dhe disi përshkrove Hirin te të gjith';* nga prangat e shterpësis'* u largove kur linde ti,* edhe ndryshove* përmes vdekjes çdo prishje, dëm;* u shpërngule pra* drejt shkëlqimit të hyjshëm lart;* o Anë, paranënë e hyjlumur e Krishtit Zot,* që në bark kishe Hyjlindësen dritëprurëse, llambën[21] nur;* me të përgjëroju* që të jepet përdëllimi i madh[5] te shpirtrat tan'.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. IV

Eja, mbarë Krijesa, le ta mburrim me cimbale psalmikisht[22] Anën hyjmendëse, që nga mitra e saj lindi malin[23] e hyjnueshëm, dhe e cila ka shkuar sot në male mendore dhe tenda Parajse; dhe le t'i thërrasim: I lumur është barku yt, që mbajti me të vërtetë atë që mbajti brenda në bark dritën e botës;[13] dhe janë të bukur gjinjtë e tu që mëndën[11] atë që i dha gji Krishtit, ushqyesit të jetës sonë;[3] atij lypi që të çlirohemi nga çdo trishtim e sulm i armikut dhe të shpëtohen shpirtrat tanë.

Përlëshore
(një herë tani,
dy herë në Mëngjesore)
Ting. IV Tahí prokatálave

O Anë hyjmendëse, kishe Hyjnënën në bark;* kjo ish e dëlirë dhe në bark kish jetën,[3] ndaj drejt mbarimi në qiell lart* je e zhvendosur tashmë* me hare në banesat* ku janë sa dëfrejnë[24] me lavd; gjithnjë e lumur,* kërkon për sa të himnojnë ndjesën e shkeljeve.

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. III Tin oreótita

Ana me plot lavdi,* e respektuar fort,* e hyjshmja krejtësisht,* që vlen për mburrje, nder,* nga jet' e paktë përmbi dhé u ngrit drejtas jete që s'vdes;[2]* dhe kërcen me engjëj lart* tok me bijën e saj pa cen,* është kjo Hyjlindësja,* Perëndia e kishte nën';* pareshtur ndërmjeton të shpëtojmë* sa me besim e lumërojmë.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotír

Si Perëndia do,* mbajte urdhrat e Ligjit,*[25] në Izrael i ke tejkaluar gjith'[26] nënat;* të vetmen Virgjëresh' gjithnjë në bark kishe, Hyjlindësen,* Anë, pra stërnën'* e zgjedhur e Zotit tonë,* më e lartë je* se çdo i drejtë;[26] nga toka* në shën nusërore[27] shkon.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Psalmi 50 dhe Kanunet:
I Hyjlindëses (shih fq. 11)
dhe i shenjtores:

Ting. IV
Ode I
Anikso to stoma mu

O Anë e tërëfamshme, kërko falje mëkatesh, ndjes',* çlirim nga e keqja si dhe korrigjim jete tok* dhe ndriçim hyjnor* për mua që lëvdoj sot* kujtimin tënd fort dritëprurës me çdo shkëlqim.

Atë që në bark e kishte jetën,[3] hyjshëm e linde ti,* drejt jete[2] lart në amshim pra u zhvendose me gaz* që nuk shprehet dot;*[28] shkëlqim që s'përëndon kurr',* o Anë e hyjthirrur, ti po shijon në lavd.

Drejt gazit që pa far' e ka lindur bija e saj Mari,* e tërëdëlira, iku Ana, hir Zoti pra;* pranë tij ajo* qëndron[15] dhe me guxim shum'* gjithnjë ndërmjeton të shpëtojmë të tërë ne.

Hyjlindësore

Nga ti shndriti dielli i drejtësisë[29] për tërë ne* dhe dheun mbar' feksi me hyjdije, o e dëlir';* dhe shpërndau krejt* çdo mjegull' ateizmi,* e fortpaqortueshme, Zonjë e tërëlum.

Zbritësore: Anikso to stoma mu
(shih fq. 12)

Ja gojën e çel tani

Ode III
Uq en sofia

Vajzën që zuri* Krishtin që mban të gjitha, e zure ti* dhe e linde; Krishtin kjo* e kish në bark përmbi mendje, logjik',* fjetjen tënde pra e lëvdojmë, o Anë, ne.

Me lavdërime* ne kremtojmë kujtimin tënd[1] plot me lavd,* Anë e hyjthirrur pra,* se linde ti të dëlirën Hyjnën',* që përtej çdo mburrjeje dhe çdo nderimi ësht'.

Si u bashkua* Joakimi i famshëm si dielli* me shën Anën, hënën pra,* na lindën rrezen që sjell virgjëri;* përmes saj agim nga Hyjnia shkëlqeu nur.

Hyjlindësore

Të kemi mbrojtje* të sigurt, o Hyjnënë, dhe përmbi ty* i besojmë shpresat ne,* prandaj shpëtojmë; përikim te ti* edhe gjejmë strehë, edhe kështu ruhemi.

Zbritësore: Tus sus imnologus

O Zonjë dhe nën' e Perëndisë

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

E lavdishme shum' Anë, u bëre ti* nën' e nënës së Bërësit, Zotit Krisht,*

se paepur ruaje* porositë e tij[25] me zell;* kur vdiqe, u shpërngule lart drejt jetës[2] që nuk vdes,* vërtet në dritën pa perëndim; ndaj kujtimin tënd* dritëprurës dhe plot shenjtërim e kremtojmë* në Shpirt dhe ndriçohemi* përgjithmonë, thërrasim ne* pra me një zë* si dhe me mall:* Ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Ode IV
O kathímenos en dhoksi

Duke studiuar të shkruarat në Ligj,[20] i zbatove dhe u bëre nëna e nënës së ligjvënësit; prandaj të detyrohet tani gjithë Krijesa, dhe kremton kujtimin tënd me ngazëllim.

O Anë, i lumur është me të vërtetë barku që mbajti[11] atë që mbajti brenda barkut dritën e botës;[3] dhe gjinjtë e tu janë të bukur,[12] sepse mëndën[11] atë që i dha gji, Krishtit, ushqimit tonë.

Përderisa jetove paqortueshëm, linde vajzën Perëndilindëse që kishte paqortueshëm në bark Fjalën e Atit; drejt tij me lavdi ike duke u hyjnizuar me kungime vërtet të nderuara krejtësisht.

Hyjlindësore

Barku i Virgjëreshës u tregua vërtet si duaj lëmi, duke pasur kallirin[30] e pakultivuar, me të cilin ushqehet tërë Krijesa, duke thirrur: O Krisht i gjithëpushtetshëm, lavdi fuqisë sate.

Zbritësore: Tin aneksihníaston

Të pagjurmësuarin

Ode V
Asevís uk ópsonte

Në tokë kishe brenda barkut qiell, atë që vërtet lindi Bërësin e qiellit, i cili sot të zhvendos me lavdi drejt qielloreve, o Anë e lavdëruar.

Me mendje të palëndët kërcen gëzueshëm së bashku me rreshtat e palëndët, duke u mbushur me llamburitje që jep pasuri; kujtona ne që të kujtojmë besërisht.

O e lavdëruar, e mbirë prej rrënjës së Jeseut, nxjerr lastar dukshëm, shkop të gjelbëruar, të Dëlirën që nxori lulen[9] e pavyshkur, Jisuin, Çlirimtarin tonë.

Hyjlindësore

Përika afër teje, së vetmes strehë të fortë të besnikëve; përmbi ty vë

shpresën e shpëtimit tim; o e Tërëshenjta Zonjë Perëndilindëse, mos më shpërfill.

Zbritësore: Eksesti ta símpanta

Të gjith' i habite ti

Ode VI
Thiso si metá fonís

Ana tok* me Joakimin, shenjtët, stërprindërit* e Perëndisë Jisu Zot,* denjësisht me këngë sot të himnohen* dhe të mburren,* si të stolisur bukur me drejtësi.

Ana ësht'* më lart se çdo lëvdatë, se kish në bark* atë që është fill më lart* se të gjitha mburrjet, kështu qëndron pra* brenda korit,* që e formojnë sipër shenjtorët tok.

Plot shkëlqim* dhe dritëprurës është kujtimi yt,* dhe rrezaton llamburitje* shpëtimtare, Anë, te sa në bot' jan',* o e mençur,* e mbushur me karizma të llojllojshme.

Hyjlindësore

Prej Anës* ke lindur, mbretëreshë e botës mbar',* që linde Mbretin e botës,* dhe e virgjër mbete pas lindjes, dhe je* më e lartë* se Keruvimet dhe s'ke qortim aspak.

Zbritësore: Tin thian taftin

Këtë të kremte e lusim sot

Kontaqi
Ting. II Ta ano zitón

Me bes' u kërkojm'* stërprindërve të Krishtit Zot* përkrahje ne që* kujtimin e të cilëve* e kremtojmë nur, që nga çdo dert, të gjithë pra të çlirohemi,* se thërresim: Ji me ne, Zot,*[31] që, siç deshe mirë, i lëvdove ata.

Shtëpia

Le të mblidhemi profetikisht të gjithë që ta himnojmë,[32] siç i ka hije, shpërnguljen e tërëshenjtë të parardhëses së Krishtit; sepse sot ngazëllohet, pasi u shpërngul nga jeta e përkohshme, duke bërë me hare udhëtimin drejt përmbiqielloreve; dhe, duke qenë nëna e Perëndilindëses së vërtetë sigurisht, thërret besërisht: "Shpirti im madhëron Zotin,[33] sepse linda nënën e tij në tokë". Le të jetë me ne pra ai që, siç deshi mirë, i lëvdoi ata.

Sinaksari

Më 25 të të njëjtit muaj, kujtimi i Fjetjes së shën Anës, nëna e Perëndilindëses së Tërëshenjtë.

Vargje: Mbaron nëna e vajzës nënëvirgjëreshë,/ shpëtimi i nënave shtatzëna.
Në të njëzet e pestën, vdiq Ana që lindi me vështirësi.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i 165 Etërve të Shenjtë, që u mblodhën në Sinodin e Pestë Ekumenik dhe vithisën dogmat e Origjenit.
Vargje: Fjalët e Origjenit janë fjalët e beliarit,/ të cilat i rrëzuan falësit e Fjalës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Sakti, Maturi, Atali dhe Vlandhina.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i nënës sonë oshënare dhjakoneshë Olimbiadha.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i nënës sonë oshënare Efpraksia.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
O dhiasosas en pirí

O Anë, meqë linde nënën e jetës së vërtetë,[3] u shpërngule drejt jetës[2] së vërtetë, duke thirrur besërisht: O Zot i përhimnuar, Perëndi i etërve, je i bekuar.[34]

O Anë, që u bëre nëna e nënës së Çlirimtarit, vrapove nga toka drejt qiellit lart, duke u stolisur me virtyte dhe duke thirrur me lavdërim: O Perëndi i etërve, je i bekuar.[34]

Ike drejt jetës pa mbarim, drejt gjerësisë tepër të bollshme të Parajsës së shijimit,[35] drejt dritës së paperënduar, o hyjprurëse, duke thirrur: O Perëndi i etërve, je i bekuar.[34]

Hyjlindësore

O e Tërëpaqortueshme, e stolisur me zbukurimet e virtyteve, linde Fjalën Krisht, të bukurin përmbi bijtë e dhelindurve,[36] i cili i stolis me bukuri të hijshme ata që e himnojnë.

Zbritësore: Uq elátrefsan

Nuk u faleshin

Ode VIII
Pedhas evajís

Nëna e Perëndilindëses së vetme ishte shterpë, por tani është gjyshja e Krishtit; pasi e zhveshi rrobën e vdekjes,[37] si atë të sterilizimit, thërret në vendin e të gjallëve:[38] Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[39]

Krishti të mikpriti ngazëllueshëm, pasi të ngriti dyert[40] e sipërme, sepse linde portën që ai e tejkaloi dhe e tregoi të mbyllur pas kalimit,[41] o Anë e

admirueshme hyjmendëse; prandaj të nderojmë në gjithë jetët.

Përderisa e bëje shenjtërisht jetën, u bëre nëna e së gjithmonëvirgjrës së shenjtë, e cila lindi Fjalën e tërëshenjtë, që na jep shenjtërim dhe çlirim,[14] o Anë e admirueshme hyjmendëse; prandaj të nderojmë në gjithë jetët.

Hyjlindësore

O Zonjë Perëndilindëse, tani më udhëzo drejt gjiri pa dallgë me flladet e Shpirtit mua që shtrëngohem prej shumë rreziqesh dhe rrezikoj nga shtrëngata e mëkatit, sepse je liman i të krishterëve; prandaj të nderojmë në gjithë jetët.

Zbritësore: Pedhas evajís

Djemat e dënuar

Ode IX
Eva men to tis parakoís

Eva, për shkak të sëmundjes së mosbindjes tmerr*[42] si banues kishte marr' mallkim;*[43] por ti u zgjidhe nga mallkimi* i shterpësis', kur kishe në bark atë* që lindi bekimin, Hyjnënën e dëlir';* e admirueshme, me të kërcen.

Shenjten tokë[44] të pakultivuar kurr', vërtet* si një tok' e lindi barku yt;* edhe ajo pa farë lindi* kallirin, pra ushqyesin botëror* dhe Zotin, që të zhvendosi fort urtësisht,* Anë, për një shijim që s'ka mbarim.

Jeta e paprishshme pa trishtim të priti ty,* o e tërëfamshme, pas fundit;* merr tani pjesë në dru jete,*[45] dëfren dhe me të shenjtën ushtri pa trup,* me koret dhe bashkësit' e të drejtëve;*[46] të lumërojmë pra të gjithë ne.

O e tërëthjeshtë, lindi sot kujtimi yt* për ne më fort se çdo diell lart;* me dritë, pasuri dhuratash* na hijeson, na preh, asgjëson terrin* e veseve, të pasioneve, na çliron;* ruajna pra sa e kremtojm' atë.

Hyjlindësore

Zonja e të gjithave, Mari, çliromë pra* mua, skllavin e mëkateve*[47] të ndryshme, meqë Çlirimtarin* e çdokujt[48] e ke lindur; ai me një shenj'* hyjnore na ka çliruar prej robëris'* së shkeljes dhe të tëra fajeve.

Zbritësore: Apas jijenís

Gjithë njerëzit

Dërgimësore
Tis mathités sinélthomen

Le ta himnojm' detyrimisht* shën Anën e hyjftuar,* se pa shpresuar kish

në bark* Hyjlindësen, Marinë;* u shfaq sipas mishit fisi,* gjyshja e Çlirimtarit* Zot, Krishtit tonë, që hyjnisht* sot e ka marrë në më të lartat pra,* ku ajo për ne ndërmjeton, për paqen* e botës mbar' me bijën tok,* të Virgjrën e dëlirë.

Lavdërime

Ting. I Ton uranion tagmaton

Duke kremtuar kujtimin e mirë, të himnojm',* Krisht, që tani habitshëm* Anën e ke zhvendosur* drejt lavdie pa mbarim nga një jet'* e përkohshme, se nëna qe* e virgjëreshës dhe nënës Hyjlindëse,* që pa far' mahnitshëm të lindi.

(2x)

Duke kremtuar kujtimin e shenjtë të Anës* edhe të Joakimit,* të të ndershmëve pa cen,* pra të paraetërve zotëror',* Çlirimtarin lëvdojm' gjithnjë,* Krishtin e dhembshur, i cili i çoi lart* në një jet'[2] që s'plaket e s'prishet.

Tani po çohen lart tok shpirtrat e të drejtëve,* të shenjtëve, i Anës* si dhe i Joakimit,* ku ka rreshta engjëjsh, kore pa lënd',* bashkësi me shenjtorë pra,* tenda të drejtësh[49] edhe një kremtim me gaz;*[50] me besim t'i lumërojm', mburrim.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. II

Ejani, të gjithë miqtë e virgjërisë dhe të dashuruarit pas dëlirësisë, ejani ta kremtojmë fjetjen e respektuar të Anës; sepse lindi mrekullueshëm burimin e jetës,[3] Marinë hyjbijë, prej së cilës lindi Çlirimtari që ndriçon[13] dhe shenjtëron[14] shpirtrat tanë.

Dhoksologjia e Madhe

*Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i shenjtores Ode III dhe VI. Kontaqi i shenjtores (*Me bes' u kërkojm'*). Kungatore:* Ngazëllohuni, o të drejtë, në Zotin; të drejtëve u ka hije lavdërimi. Aliluia.

CITIME

[1] Fja. Urt. 10.7
[2] Joan 5.24; I Joan 3.14
[3] Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
[4] Eks. 25.9-15; Ligji i Dytë 10.1-2; Hebr. 9.4
[5] Num. 14.19 etj.
[6] Lluk. 1.29
[7] I Kor. 12.9,28,30
[8] Ef. 6.12
[9] Is. 11.1
[10] Is. 49.6; Vep. 4.12; 13.47; II Tim. 2.10; Hebr. 2.10; 5.9
[11] Lluk. 11.27
[12] Kënga 4.10
[13] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[14] I Kor. 1.30

[15] III [I] Mbret. 17.1; 18.15;
IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
[15a] II Kron. 6.9; Vep. 2.30; Hebr. 7.5
[16] Num. 19.2; Ligji i Dytë 21.3
[17] Is. 53.7; Joan 1.29,36; I Petr. 1.19
[18] Lluk. 1.30-31
[19] Vep. 3.15
[20] Jis. N. 1.8; Ps. 1.2; 118(119).70
[21] Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.4;
Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
[22] Ps. 150.5
[23] Abak. 3.3; Dan. 2.34-35
[24] Ps. 86(87).7
[25] Gjen. 26.5 etj.
[26] Fja. Urt. 29(31).29
[27] Matth. 25.10
[28] I Petr. 1.8
[29] Mal. 4.2 (3.20)
[30] Kënga 7.3
[31] Is. 8.9
[32] P.sh. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 59-64
[33] Lluk. 1.46
[34] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[35] Gjen. 2.15; Joel 2.3; Jez. 28.13; 31.9
[36] Ps. 44(45).3
[37] Gjen. 3.21
[38] Ps. 114(115).9
[39] Ps. 102(103).22;
Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[40] Ps. 23(24).7,9
[41] Jez. 44.1-2
[42] Gjen. 3.1-6
[43] Gjen. 3.16
[44] Eks. 3.5
[45] Gjen. 2.9; 3.22-24;
Apok. 2.7; 22.2,14,19
[46] Ps. 31(32).11; 67(68).3; 96(97).12
[47] Joan 8.34; Rom. 6.6,20
[48] Joan 8.36; Gal. 5.1
[49] Ps. 117(118).15
[50] Ps. 41(42).5

MË 26 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i hieromartirit të shenjtë Hermolau dhe i atyre që ishin me të, Hermipi dhe Hermokrati, si dhe i martires oshënare Parashqevia.

Tipikon

Nëse bie të dielën, shërbesa e shenjtorëve lihet, pra të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të martires. Lavdi i martires. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i martires. Tani Hyjlindësore ngjallësore (në Tingullin e Lavdisë, si zakonisht, pra)* Zoti Krisht, bërësi. *Përlëshoret: ngjallësore, e martires dhe Hyjlindësorja e saj.*

Të dielën, në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i martires. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e martires, dhe Ndenjësoret e saj. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret Ja gojën e çel tani; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore, e martires dhe Hyjlindësorja e saj. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të martires. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e martires. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e martires dhe e kishës. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Apostulli i martires dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore e së dielës.*

NË MBRËMËSORE

Thirrtore
Të shenjtorëve
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

Hermola martir atlet, ti dëshirove thellë, hyjnisht* jetë me shumë përkushtim,* kur u bëre prift i shenjt'* i të Tërëpushtetshmit Zot,* Krishtit Jisu pra; nga terri ateist* shpëtove popuj me fjalët që u the* plot me respekt në hir;* dhe me gjak dëshmorësh kur u leve krejt,* drejt mbitokësoreve, o i hyjlum, shkove.

Hermola martir atlet, ty frika e të paudhëve* të kish bërë të fshiheshe*[1] pra njëherë, por me gaz* athloforit Pandelejmon* ti i zbulon krejt të fshehurin mister,*[2] hyjdijen, besën e drejtë[3] plotësisht;* dhe me gatishmëri* kur zbulohesh, vdes për Krishtin Perëndi,* që nga mirësia preferoi çdo pësim.

Shën Hermipin, Hermolaun, Hermokratin t'i mburrim ne* me lëvdata hyjnisht, me zell* le të bëjmë panair* në kujtimin e tyre tok;* u bën' martirë për Zotin besërisht,* pasi garuan çuditshëm; vranë pra* dinakun dhe u lan'* me pastrim që asnjëherë s'ndotet dot* dhe që nuk fëlliqet më nga njollat e dyta.

Të martires
Të ngjashme

O çudi paradoksale krejt! E urta Parashqevi,* ke garuar gatishmërisht,* ndaj vithise burrërisht* Antoninin, tërbimin tmerr* që kish, e thjeshtë, u denjësove pra* për çmimet, rrethet për thirrjen që nga lart;*[4] shërbyesit e tu* ne që plot besim të nderim, na kujto* para Zotit, që gjithnjë të mëshirohemi.

O e tërëfamshme, o martire e hyjlum e Krishtit,* si me shpirt deshe Zotin tënd,* plagët e torturave* i durove me trimëri;* duke u rrjepur në brinjë me kamxhik,* i përballove tërë mundimet tmerr* për dashurin' e tij,* përfitove pra kurorat prej këtij,* ndaj dhe ne të mburrim ty me lavdërim dhe nder.

O martire oshënare e lëvduar krejt, kush ka forc'* të rrëfejë sa çmime ke* për mundimet që hoqe,* burrërin' e habitshme pra,* për butësinë, e thjeshtë, plot durim,* që e tregove ti në martirizim?* Ishe porsi pa mish,* o Parashqevi, je shoqe engjëjsh lart,* enë e Ngushëllimtarit, nuse e mbretit.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O martire virgjëreshë Parashqevi e tërëlavdëruar, për ata që kremtojnë, siç e meriton, atletizmin tënd, kërko të çlirohen nga ngasjet dhe shtrëngimet, si dhe nga gjyqi i ardhshëm me anën e ndërmjetimeve të tua te Perëndia, o e tërëkënduar.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit[5] pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier; atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës.

Pasvargjet e martires
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Me moral burrëror shkove* me dëshir' të pësosh mundim,* llojshmëri torturash, dhe bëre pluhur krejt* idhujt dhe sa adhuronin grekët; se kundërshtarin djall* që po mburrej se më lart* se çdo yll do vendoste fort* fronin,[6] e ke vrar'* me fuqinë e Kryqit; para këmbëve të tua ky u ça si i tallur, si harabel pa vler'.[7]

Varg: Duke duruar, durova duke pritur Zotin, dhe më vuri re.

Me kujdes prej Hyjnisë lart,* shpejt një engjëll tregoi qart'* porsi gjethe pllakën e rëndë, gjithashtu* fllad me freski, djegien tmerr nga zjarri, siç ndodhi pra dikur,* atëherë[8] me vegim* të të katërtit që iu shfaq* Djemve në kamin';*[9] ndaj thërrisje me ta: Nderoj me gaz pra emrin tënd aq të himnuar, Zot, ke mëshirë të madhe[10] ti.

Varg: Dhe siguroi mbi gur këmbët e mia dhe drejtoi hapat e mi.

Duke pasur ti dritësim* shpirtëror, pastërti në trup,* pa qortim u shfaqe gjithnjë, se deshe fort* Dhëndrin; ndaj shkove pas gjurmëve[11] të miros[12] mendore drejt,* o e thjesht', Parashqevi* e kënduar; tani për ne* ndërmjeto dhe lyp* Shpëtimtarin e çdokujt, që të japë zgjidhje fajesh te sa bëjnë kujtimin tënd me besim dhe mall.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Ejani, të gjitha anët e tokës, le të formojmë me duartrokitje kor shpirtëror dhe le ta lavdërojmë martiren e virgjër të Krishtit, duke thënë: Gëzohu, o Parashqevi oshënare dhe e hyjnderuar; gëzohu, ti që prite mirë martirizimin; gëzohu, o e barazvlefshmja me martirët dhe bashkëbanorja në tendat e oshënarëve, tok me të cilët përgjërohu që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[13] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me athloforen dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Përlëshore e shenjtorëve

Dëshmorët e tu

ose
Ting. III Tin oreótita

Shenjtorë, sinqerisht* ju i shërbyet drejt* në priftëri atij* që ju dha çdo të mir';* mbaruat udhën e martirizimit

me gaz, Hermola* i hyjnueshëm dhe tok* o Hermip edhe Hermokrat,* bazament me tri shtylla*[14] jeni bërë për Kishën[15] ton';* ndaj lypni pa pushim të shpëtojmë* ne dhe të gjithë prej çdo dëmi.

E martires
Ting. I

Zellin tënd, si e bëre të përshtatshëm me emrin tënd, e trashëgove për banim besimin tënd të bërë sipas kuptimit e quajtjes sate, o Parashqevi athlofore; ti hedh para nesh shërime dhe ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Gabrieli kur të tha, Virgjëreshë, gëzohu,[16] bashkë me zërin mishërohej Zot' i Gjithësisë[17] te ti arka e shenjtë, siç tha David i drejtë.[18] U rrëfeve më e gjerë se qiejtë, duke mbajtur krijuesin tënd. Lavdi atij që ndenji te ti. Lavdi atij që lindi prej teje. Lavdi atij që na çliroi me lindjen tënde.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësore e martires
Ting. IV O ipsothís en to stavró

Si deshe Krishtin aq* të bukur, stolise* me virgjëri shpirtin* me lloj-lloj mundimesh* edhe shtrëngimesh; dhe u fejove me të,* si një nuse pa qortim, pa njoll',* ndaj ky të denjësoi ty* lart për nusëroren pra;* ndërmjeton prej andej ti,* e tërëfamshmja shën Parashqevi,* për sa me besë* dhe mall të nderojmë tok.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Nuk do pushojmë, pra* Hyjlindëse, kurrë* ne të pavyerit* të flasim për forcat* që ke, se, po të mos qëndroje para nesh ti* duke ndërmjetuar, kush nga ne* do shpëtonte nga çdo dëmtim?* Cili na ka ruajtur* gjer tani pra të lirë?* Ndaj s'do largohemi aspak nga ti,* se shërbëtorët* e tu i shpëton gjithnjë.

Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësore e martires
Ting. I Ton tafon su Sotír

Si shqerrë e panjoll',* e dëlirë, u lidhe* me Zotin mistikisht me një jetë modeste,* pasi stolise veten me bukurinë e garës ti;* hir kurimesh[19] pra* ke marrë dhe me fuqinë* që Shën Shpirti jep*[20] shëron të gjitha sëmundjet,* martire Parashqevi.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Je nën' e Perëndis'* dhe u duke pas lindjes* vërtet e virgjër prapë, të njohim të gjithë* sa po përikim me plot mall* te mir'sia dhe hiri yt,* se të kemi ty ne mëkatarët si mbrojtje,* dhe për ne ti je* shpëtim në ngasje, e vetmja* e fortpaqortueshme.

Kanunet e Hyjlindëses (shih fq. 11) dhe të shenjtorëve.
Në vend të Irmoseve (pas Odeve III, VI, VIII dhe IX) mund të psalen Zbritësoret (të plota) Ja gojën e çel tani *(shih fq. 12).*

Ode I
Kanuni i shenjtorëve që ka Akrostihidhë: "Me himne lavdëroj dhimbjet e Hermolaut. Josif".
Ting. Tërth. IV
Ásomen to Kirio

Me himn ta mburrim ditën* e lavdishme fort, të tërëfamshme qart'* dhe dritëprurëse që* Hermolau ka, Krishtin ta madhërojm'.

Lavdin e ke të madh fort,* Hermola i tërëfamshëm; shërbëtor* i zellshëm zjarr i Zotit,*[21] Perëndisë së madh,[22] u tregove ti.

Ke përfunduar luftën* aq të ligjshme[23] edhe shkele arroganc'* që kishin të paudhët,* i kënduar kudo, Hermola martir.

O Hermola, u shfaqe* mjaft i pasur, ngaqë kishe si thesar* që s'humbet Krishtin, Zotin* pra, që zemrat e varfra i pasuron.

Hyjlindësore

Krishtin ma bë të butë,* Virgjëresh' e tërëpaqortueshme;* në ditën e gjykimit,* nga dënimi i frikshëm çliromë ti.

Kanuni i martires që ka Akrostihidhë: "Me himne lavdëroj vajzën e tërëfamshme". I Theofanit.
Ting. IV
Thalasis to erithreon

Martire* e tërëfamshme, neve që himnojm' kujtimin tënd* drit'prurës, përmes lutjes sate lyp* të na jepet prej Zotit Krisht hir* dhe ndjesë fajesh, o Parashqevi e fortkënduar me lavdi.

U shfaqe* si bukuri martirësh, kur me armën, Kryqin pra* makinacion armiku hodhe poshtë fort,* ashpërsin' e tiranëve tok* dhe predikove besën mirë gjatë mundjes atletike ti.

Tirani,* që frikshëm adhuronte idhujt dhe statujat kot,* mendoi se do mund-

te çdo durim,* rezistenc', forc' që kishe gjithnjë,* por arroganca që kish, përmes fjalës sate mjaft të urt', u mund.

Hyjlindësore

O Zonjë,* nga gjaku yt i pacenuar lindet Fjala Zot,* si mori mish me shpirt; dhe ne që ram'* e rrëshqitëm, si djalli dinak* mashtrues na kafshoi,[24] ky na rigatoi me pushtet hyjnor.

Ode III

Kanuni i shenjtorëve: Si i to steréoma

Me forcën e Shenjtit Shpirt*[20] të fortë krejt, gjithëbërës, at',* mposhte, i urt',* i forcuar, forcën* e të fortit[25] në djallëzi.

I tërëfuqishmi Zot,* o shenjt, të njohu sepse me fjal'* të hyjshme krejt* bëre ti të gjithë* pra të njohur mjaft nga ai.[26]

I urtë, prej shpirtit tënd* jepje mësim për Krijuesin,* e njohu pra* shën Pandelejmoni,* dhe garoi siç ligji do.[23]

Hyjlindësore

E fortpaqortueshme,* frika, shtrëngata e shkeljeve,* mendimet tmerr* ma sulmojnë zemrën* pa mëshir', ndaj çliromë ti.

Kanuni i martires: Efrénete epí si

Forconte mjaft dobësin'* Hyjnori Shpirt, e shfaqte plot hijeshi* dhe tregonte qartazi* drit', përsosmërin' që kish shpirti yt.

Me forcën e Krishtit[27] tënd* e përforcuar, fshikullim me kamxhik* çnjerëzisht durove ti,* si diamant i fortë, martire pra.

Meqë deshe Perëndin',*[28] në stadium durove ti me fuqi* çdo tortur' të hidhur tmerr,* si edhe shpërndarjen e trupit tënd.

Hyjlindësore

O nënë e Perëndis',* për sa mbi dhé pra janë, vetëm ti je* shkaku pra për çdo të mir'* të përmbinatyrshme; gëzohu,[16] Zonj'.

Irmosi: Efrénete epí si

»Dëfrehet në ty,[29] o Krisht,* dhe të »thërret ty Kisha jote me gaz:* Streha, »përforcimi im* dhe fuqia ime je ti, o »Zot.[30]

Ndenjësore e shenjtorit

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Meqë jetën e kishe me shenjtërim,* presviteri i Zotit Krisht Çlirimtar* u shfaqe dhe feksje nur* sa çdo her' vinin besërisht;* në fund shkëlqeve

hyjshëm me dritë martiri ti* dhe llamburite botën; prandaj të himnojmë ne,* duke e kremtuar ditën tënde, kujtimin* e shenjt', dritëprurës plot* me besim, Hermola i lum,* athlofor pra,* të lumërojm';* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi

I martires

Nga shpërgënjtë nënorë veten e dhe,* e dhurove te Krishti përjetësisht;* atij, Shpëtimtarit pra* të çdokujt[31] i pëlqeve mjaft;* me forcë, arrogancë tiranësh e shkele krejt* si burrë ti vërtet i durove torturat tmerr;* ndaj, si përgatiti për ty Krishti kurora,* të futi me lavd në dhom',* nusërore[32] në qiell ku* admirohesh,* Parashqevi;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të shpall si të lum çdo brez njerëzor,*[33] si të vetmen që linde ti Perëndi* në mish pafarisht, edhe* si të virgjër, sepse në ty* Hyjnia e përzjarrtë fushoi, dhe mënd si foshnj'* Ndërtuesin dhe Zotin; gjinia e engjëjve,* gjithë njerëzia tok lëvdojn' lindjen tënde* të tër'shenjtë denjësisht* dhe me një zë thërrasin pra* duke lypur* për ndërmjetim:* Lutju Zotit Krisht Perëndi,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve,* se i falemi lindjes sate pa cen me bes'.

Ode IV

Kanuni i shenjtorëve: Isakikoa Kírie

Ecjet e tua, me sukses nga Shpirti Hyjnor, shkelën udhëtimet e keqbërësit dhe u dukën te shumë veta si rrugë e drejtë.[34]

O Hermola i admirueshëm, u bëre prift tepër i hyjnueshëm dhe martir absolutisht i vërtetë, prandaj të gjithë të lavdërojmë.

Pasi i kundërshtove të paligjshmit me moral të fortë, more kurorë martirizimi, meqë atletizove burrërisht, o tepër i hyjshëm.

Hyjlindësore

O e Hyjhirshme, porsi fron me pamje zjarri[35] e mban Zotin; atij përgjëroju të shpëtojmë ne që rrezikojmë nga shtrëngata mëkati.

Kanuni i martires:
Eparthenta se idhusa

Përderisa u kungove me shërime, karizma[19] dhe vizione, o e lavdëruar, çdo

herë u buron hire të hyjshme atyre që të mburrin besërisht dhe rendin te kisha jote.

Meqenëse vërtet s'kishe fare rrudhë dhe njollë, dhe përfitove shenjtërim[36] trupi, pe engjëj, bashkë me të cilët thërrisje: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

O shenjë e habitshme! Sepse, kur u ikonizua dita e frikshme e pësimit shpëtimtar, me trup femëror pe Kryqin, kallamin, kurorën dhe sfungjerin.

Hyjlindësore

Pa martesë ti ke lindur, o Virgjëreshë, edhe mbas lindjes mbete pra përsëri e virgjër; ndaj me zëra që nuk pushojn', "O Zonjë, gëzohu[16] fort", të thërresim pa ngurrim besërisht.

Ode V
Kanuni i shenjtorëve:
O ek niktós agnosias

I udhëhoqe drejt drite ata që mbaheshin në natë mashtrimi, dhe si pagë e more mbarimin nëpërmjet gjakut.

Ushtarët e Krishtit,[37] Hermipi, Hermolau i shenjtë së bashku me Hermokratin, lavdërohen me fjalë të hyjshme.

Të tre martirët, që atletizuan së bashku për Trininë e nderuar, tani ngazëllohen në qiej tok me mijëra engjëj.

Hyjlindësore

Ne, duke të pasur si mbrojtje, përikje dhe përkrahje të sigurt, o Virgjëreshë, le të çlirohemi me anën tënde nga çdo shtrëngim.

Kanuni i martires: Si Kírié mu fos

O e thjeshtë, luftove dhe e vrave tiranin, duke e shpallur Krishtin para tribunave mençurisht me oratori të tërurta.

Duke pasur mendje të fortë dhe moral të paepur, i turpërove keq të gjitha adhurimet e idhujve përmes argumentesh biblike.

U denjësove për dhomë mendore dhe nusërore, duke kërcyer perëndishëm me virgjëreshat e urta,[32] o Parashqevi e kënduar.

Hyjlindësore

Je arm' që s'thyhet dot* dhe të vëm' ndaj armiqve pra;* të kemi ty, o Hyjnuse,* si spirancë dhe shpresë[38] shpëtimi për të gjithë ne.

Ode VI
Kanuni i shenjtorëve:
Tin dhéisin ekheó

Ushtari trim,* Hermolau dhe me të* Hermokrati dhe Hermipi treguan* fill një mendim* të qëndrueshëm: Shpa-

llën* një Perëndi vetëm, Zotin përmbi çdo gjë;*[39] dhe, kur për Krishtin vdiqën tok,* ata morën kurora prej qiellit.

Për veten ju* dhe për hir të Perëndis'* fort të kuq e lyet petkun me pika* nga gjaku pra* që u derdh; ndaj qëndroni,* o athloforët e Zotit, pran' Krishtit[40] ton,'* pra mbretit të gjith' jetëve,*[41] dhe me çdo Fuqi lart lypni tok për ne.

Përmes teje* e mësoi mistikisht* besën drejt Pandelejmoni, i madhi* në Shpirt Hyjnor;* si garoi pas ligjit,*[23] u bë për ty, Hermola, shkak që të luftosh* porsi martir; për ne të gjith'* me të lyp Krishtin, Zotin e çdo gjëje.

Hyjlindësore

Më tund shtrëngat'* shkeljesh pa mas', më dërgon* përgjithnjë në fundin e dëshpërimit,* por ti arri,* dhe tendose pra dorën* drejt meje, Vajzë, ma jep që të hedh çengel* në portin plot me qetësi* të pendimit, të ndjesës së fajeve.

Kanuni i martires: Thiso si metá fonís

Zhduke fill* në një çast me prezencën e engjëllit,* hyjnisht pra Zoti Krisht, pllakën* që mbi gjoks të vun' rëndë dhe nga duart* gozhdët, vajzë,* e tërëthjeshtë plot lavd, e pastër krejt.

Si Theklën* e re të lavdërojm', se të gjithëve* u predikove dhe shndrite* me fjalim të hyjshëm mjaft veta edhe* rregullove* për besimin hyjnor ateistë pra.

Rrodhën drejt,* Parashqevi, lavdi për martirët, vajz',* grupime dogmash hyjnore* që nga buzët mjaltë the, dhe mësove* te të gjithë * ti njohjen e të gjithave me guxim.

Hyjlindësore

O çudi,* që je krejt më e re pra se çdo çudi!* Se Virgjëresha në mitër,* duke zën' pa burr' Krishtin Zot, i cili* mban në dorë* tër' Gjithësinë,[42] nuk e ngushtoi dot.

Irmosi: Thiso si metá fonís

»Do flijoj* me zë himnimi,[43] Kisha »thërret te ti,* o Zot, sepse, përmes »gjakut* që nga brinja jote për për»dëllim rrjedh,* u pastrua* nga çdo »pisllëk prej gjakrash demonësh kjo.

Kontaqi
Ting. IV Epefanis símeron

Gjetëm, o e tërëthjesht','* porsi klinikë* shpirtërore kishën pra* që ke;

besnikët, gjithë ne,* në të me zë të nderojmë ty,* Parashqevi oshënare martire nur.

Shtëpia

Kur zëri i Dhëndrit të ftoi ty si nuse, të stolisi me kurorë paprishjeje,[44] o Parashqevi hyjmendëse e tërëlavdëruar; dhe të radhiti, siç e meritoje, së bashku me martirët e nderuar, tok me të cilët, duke dëfryer, na kujto ne që festojmë të kremten tënde dhe që u mblodhëm brenda kishës sate; sepse, duke qëndruar tani në të, të ofrojmë nga shpirti himnet, Parashqevi oshënare martire nur.

Sinaksari

Më 26 të të njëjtit muaj, kujtimi i hieromartirëve të shenjtë, Hermolau, Hermipi dhe Hermokrati.

Vargje: Hermipi, Hermolau dhe Hermokrati/ i turpëruan guximshëm ata që adhuronin Hermesin.

Në të njëzet e gjashtën, Hermolaut i prenë kokën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënares martire të shenjtë të Krishtit Parashqevia.

Vargje: Me luftëra e rregullove veten si dhomë të dëlirë/ për banimin e Perëndisë,[45] o modeste.

Parashqevinë e vrau bakër në të njëzet e gjashtën.

Kujtimi i martires së shenjtë Oreozila.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënarit Ignat Stironi; dhe i përurimit të kishës së Kryeengjëllit Gabriel, matanë në Halde; si dhe i shenjtorëve Apioni dhe Jerusalema.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Jeronti.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar omologjet Moisi hungarezi.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Kanuni i shenjtorëve: I ek tis Iudheas

I shkëlqyer prej ndriçimit pa perëndim të besimit të hyjshëm, o oshënar, e udhëzove drejt drite hyjdijeje[46] shumicën e atyre që shpëtonin dhe që këndonin: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.[47]

Duke menduar tok si vëllezër Hermokrati i madh dhe Hermipi i hyjnueshëm, o Hermola i tërëlumur, bashkë me ty pinë pijen e martirizimit,[48] duke psalur: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.[47]

Iu afrove qenies më të skajshme nga të dëshiruarat, duke u hyjnizuar me

“vendosje”, dhe tani, duke u ngazëlluar tok me martirë, i thërret Zotit, o Hermola: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.[47]

Duke u djegur nga mallëngjimi i Trinisë së Përmbiperëndishme, o martirë të lavdëruar, shuat absolutisht zjarrin e ateizmit me pikat e gjakrave, duke psalur: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.[47]

Hyjlindësore

O Virgjëreshë e tërëshenjtë që linde Perëndi mishprurës, shpëtoje nga çdo mëkat dhe shtrëngim popullin tënd që thërret: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.[47]

Kanuni i martires:
En ti kamino avramiei

E ruajtur prej Zotit, o martire, para tribune të pabesësh ti pranove me durim të digjeshe në sqetulla dhe psalje qetësisht me zë: I bekuar je, o Perëndia im dhe Zoti im.

Zjarri, pasi nuk të dogji fare, më tepër dogji të paudhët, o vajzë; ndërsa Krishti të ruajti të padëmtuar, sikurse qëmoti shpëtoi nga zjarri që buçiste të Rinj të patrembur me anë të dorës së pushtetshme.[49]

Thërrisje duke predikuar: Vërtet demonët, statujat prej druri dhe perënditë që qartë nuk ndërtuan as tokë dhe as qiell, le të humbasin;[50] teksa Krishti Zot është gatuesi i të gjithave.

Hyjlindësore

Ti që je tenda* e shenjtë dhe hyjnore e Zotit lart,*[51] ki gëzim, se përmes teje u jepet gaz,* o Hyjlindëse, atyre që* thon’: E bekuar midis grave ti je,[16] o e panjollshmja Vajz’.

.

Ode VIII
Kanuni i shenjtorëve:
Eptaplasios káminon

Hermolau i hyjshëm, duke u ndriçuar hyjnisht, i ofroi fli të pagjakshëm atij që nga dhembshuria u flijua për ne si dele;[52] dhe, sapo u ther vullnetarisht për të, u soll si flijim i mirëpritur,[53] duke thirrur: O popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Duke qenë i vdekur përmes mosbesimit të mëparshëm, Pandelejmoni afrohet; dhe, pasi korri jetën me nxitjen tënde të respektuar dhe me thirrjen jetëbërëse të Krishtit, e ringjalli të vrarin dhe u ngjit drejt lartësie martirizimi, duke e lavdëruar me ty, o Hermola i trilumur, Shpëtimtarin në jetë.

Hermolau i hyjshëm, Hermipi i tërëmadh dhe Hermokrati, diamantet e forta, nuk kursyen mish,[54] nuk iu flijuan statujave; dhe i sollën Zotit veten e tyre si flijim të mirëpritur,[53] duke thirrur: O priftërinj, bekojeni;[55] popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Duke u përforcuar prej Krishtit, Hermolau hyjmendës u zbulonte besnikëve mister të fshehur nga gjeneratat,[2] kur ishte i fshehur nga frika e armiqve;[1] dhe, kur u shfaq, shpalli Fjalën Perëndi[56] që dukshëm u ther për të gjithë; dhe vdiq dhe jeton së bashku me martirët në gjithë jetët.

Hyjlindësore

Ty, pallatin e hijshëm mbretëror dhe banesën e hirshme të Tërëmbretit, o Zonjë e tërëshenjtë, të himnojmë duke u lutur: Na trego tempuj të atij që lindi prej teje[45] ne që u pastruam nga çdo e keqe kundërshtare dhe thërrasim pa pushim: O popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Kanuni i martires:
Hiras ekpetasas Dhaniíl

Faktove se nuk ishin perëndi, por fantazma gënjeshtare demonësh, dhe i rrëzove krejtësisht dhe i bëre pluhur përfundimisht, o martire, duke kënduar pa pushim me ngazëllim: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.[57]

Me ardhjen tënde u tund tempulli, ra përdhé Apolloni dhe u hodhën larg statuja druri me anën e energjisë së Kryqit të pacenuar, përmes të cilit, pasi u fortifikove mistikisht, thërrisje me shumë guxim: Gjithë veprat, himnojeni Zotin.[57]

O Krisht, meqenëse u plagos prej bukurisë dhe mallit tënd,[58] Parashqevia e dëlirë duronte djegien e zjarrit, duke thirrur: Tani që po atletizoj qëndrueshëm, do të vrapoj pa mbarim pas teje në erën e miros sate hyjnore,[12] duke e bekuar emrin tënd të hyjshëm.

Hyjlindësore

Vetëm ti në të gjithë brezat, o Virgjëreshë e pacenuar, u tregove nënë Perëndie; ti u bëre banesa e Hyjnisë, o e tërëpaqortueshme, duke mos u djegur prej zjarrit të dritës së paafruar; prandaj të gjithë të bekojmë, o Mari hyjnuse.

Irmosi: Hiras ekpetasas Dhaniíl

»Duke* ngritur duart, Danieli mbylli »gojët e luanëve në grop';*[59] dhe shu»an forcën e zjarrit krejt,*[8] kur u ngje»shën me virtyt Djemtë,* pra miqtë e »shpresëtaris',* tok duke thirrur me

»gaz: Bekoni,* ju gjithë veprat e Zotit,
»pra Zotin ton'.[57]

Ode IX
Kanuni i shenjtorëve:
Éfrikse pasa akoí

Duke pohuar Krishtin tënd,* po qëndroje fort përballë armiqve[60] ti,* se i pohoi ky* Pilatit pra pohimin e mirë[61] drejt,* o i kënduar fort; dhe, kur të çuan për therje keq,* e shenjtërove dhen'* me gjak, ndërsa i ndriçove me shpirt qiejt.

Si një llambadhe e trefisht',* që po ndizej flak' nga zjarri i Shenjtit Shpirt,*[62] kështu ju dukeshit,* shën Hermola, Hermip i lavdishëm fort* dhe Hermokrat; dhe ngazëllonit zemra besnikësh nur* me hir hyjnor, flaknit,* të kënduar, mjegullën e së keqes bes'.

Le t'i këndojmë gjithë ne* me një gojë të shkëlqyer, me gaz në shpirt,* martirët athlofor'* të Krishtit, të stolisur me lavd hyjnor* si rrobë hijshëm, që tani lëvizin me nder të madh* në qiellore lart* dhe burojnë mrekulli si lumenj bollshëm.

Krisht, diell që nuk perëndon,* mos largo prej nesh mëshirat e tua,[63] Fjal',* me shenjtin ndërmjetim* nga shën Pandelejmoni, Hermipi tok* dhe Hermolau dhe nga luftëtarët pra bashk' me ta;* si të na dhembshurosh,* na çliro nga çdo e keqe si zakonisht.

Hyjlindësore

O Shpëtimtar, kursemë ti*[64] që ke lindur dhe pas lindjes le lindësen* pa prishje, kur do rrish* që t'i gjykosh pra veprat[65] e mia drejt,* mos e vër re paligjësinë time, mëkatet, se* ti je i dhembshur fort,* përdëllyes, njeridashës, i miri Zot.

Kanuni i martires:
Lithos ahirótmitos orus

Ke shkëmbyer jetën që shkon, rrjedh pra të përkohshmen me të ardhmen,* fort nxitoje ta shihje ti bukurin'* e pabër' të Dhëndrit tënd Jisui,* martire bukurvirgjëresh',* ndaj përfitove një kuror' pa cen.

O Parashqevi, ti nga qiejt dëgjove zë hyjnor, kërkesat* që i bëre, i miratoi, e thjesht',* martire; edhe mbarove udhën*[66] gatishmërisht, ndaj rende lart* drejt Krishtit, kur pren' kryen tënd plot lavd.

Për të gjithë sa vijn' me bes' si zjarr në të shenjten kishën tënde,* o Parashqevi, prej Jisuit kërko* dhuratë: fitoren mbi armiqtë* tok ndjesën e mëkateve* edhe çlirimin nga çdo dert a hall.

Hyjlindësore

Më supreme se Keruvimet u shfaqe, më lart se çdo qiell;* engjëllin kumtar të vendimit të madh*[67] e linde, Mari e virgjër pa cen;* me Atin ësht' tok pa fillim,* do vijë ky gjykues për krejt ne.[65]

Irmosi: Lithos ahirótmitos

»Si një gur i prerë pa dorë nga mali »yt i palatuar,* Virgjëresh', u pre por»si gur[68] qosheje,*[69] pra Krishti, i cili i »bashkoi* natyrat krejt të kundër»ta;*[70] ndaj me gëzim të madhështoj»më ty.

Dërgimësore
Jineqes akutísthite

Martire bukurvirgjëresh',* me forc' nga Kryqi zotëror* u përforcove si trime* dhe arrogancë tiranësh,* munde, Parashqevi, në gar';* more pra çmim fitoreje,* ti fort e admirueshme* dhe e tërurtë prej Krishtit;* lyp për sa me mall të mburrin.

Hyjlindësore

E arta temjanic',[71] Mari,* e pastër krejt, u bëre ti* en' e Trinisë[45] që s'mbahet;* ishe pëlqyer nga Ati,* Biri fushoi fill në ty,* ndërsa Shpirti i Tërëshenjt'* me përmbiardhjen përmbi ty,* o Zonjë, ty të tregoi,* Perëndilindëse plot lavd.

Lavdërime
Ting. I Ton uranion tagmaton

Je në avllitë e Zotit[72] me virgjëreshat tok* pra me të urta,[32] vajzë,* o martire e thjeshtë;* more nga atje dhe hir të shërosh* çdo sëmundje[19] dhe të dëbosh* çdo frymë[73] plot ndyrësi nga ata që vijn'* pranë teje me besim dhe mall.

(2x)

Forcë tiranësh pa fe krejt e theve, virgjëresh',* edhe mbështetjen tënde* e besove te Zoti;* ndaj s'të frikësuan rrahje me plumb,* me çekiçë, si dhe as zjarr,* as rrjepje mishi, e thjeshtë, dhe as kazan* në valim, as shpatë therjeje.

Me asketizëm më parë e trete mishin tënd,* pastaj forcove mendjen* përmes atletizimit;* ndaj si shpatë bakri që u bë lart,* pra në qiell, të pa çdokush;* si ar në furr' u sprovove[74] me çdo mundim,* o martire bukurvirgjëresh'.

Lavdi *Ting. II*

Në qytetin e Perëndisë sonë, në malin e tij të shenjtë,[75] atje fushoi shenjtorja, pasi ruajti të pafikur llambën.[32]

Le ta dëgjojmë mburrjen e virgjëreshës: O virgjëri, tempull i Perëndisë! O virgjëri, lavdi martirësh! O virgjëri, shoqëruese e engjëjve![76]

Tani *Hyjlindësore*

Gjith' shpresën time e besoj te ti, o nën' e Perëndisë, ruajmë nën strehën tënde.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanunet, Ode III e shenjtorëve dhe Ode IV e martires. Kontaqi Mbrojtje e paturpëruar. *Apostulli dhe Ungjilli i 4 dhjetorit. Kungatore* Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] Joan 19.38; 20.19
[2] Kol. 1.26
[3] I Tim. 3.16
[4] Fil. 3.14
[5] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[6] Is. 14.13
[7] Jov 40.29
[8] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
[9] Dan. 3.24-25
[10] Num. 14.19 etj.
[11] I Petr. 2.21
[12] Kënga 1.4
[13] Joan 15.1
[14] Gal. 2.9
[15] I Tim. 3.15
[16] Lluk. 1.28
[17] Urt. Sol. 8.3
[18] Ps. 131(132).8
[19] I Kor. 12.9,28
[20] Lluk. 4.14; Rom. 15.13,19
[21] Hebr. 3.5
[22] Ligji i Dytë 7.21 etj.
[23] II Tim. 2.5
[24] Gjen. 3.1-7
[25] Matth. 12.29; Mark 3.27
[26] Gal. 4.9
[27] II Kor. 12.9; II Petr. 1.16
[28] Lluk. 11.42; Rom. 8.39; I Joan 2.5; 3.17; 5.3
[29] Est. 4.17ff
[30] Ps. 17(18).2
[31] I Tim. 4.10
[32] Matth. 25.10
[33] Lluk. 1.48
[34] Is. 40.3; Matth. 3.3; Mark 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23
[35] Ezek. 1.13-26
[36] Ef. 5.27
[37] II Tim. 2.3
[38] Hebr. 6.18-19
[39] Rom. 9.5
[40] III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
[41] Ps. 144(145).13; I Tim. 1.17
[42] Est. 4.17b
[43] Jona 2.10
[44] I Kor. 9.25
[45] Joan 14.23
[46] II Kor. 4.6
[47] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[48] Matth. 20.22; Mark 10.38
[49] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23-24
[50] Jer. 10.11
[51] Ps. 45(46).5
[52] Is. 53.7; Joan 1.29,36; I Petr. 1.19
[53] Lev. 19.5; Sirak 35(32).6; Is. 56.7
[54] I Makk. 13.5
[55] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[56] Joan 1.1

[57] Ps. 102(103).22;
Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[58] Kënga 2.5; 5.8
[59] Dan. 6.18
[60] Matth. 10.32; Lluk. 12.8
[61] I Tim. 6.12-13
[62] Matth. 3.11; Lluk. 3.16
[63] II Mbret. [Sam.] 7.15; I Kron. 17.13;
Ju. 13.14; II Makk. 6.16;
Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 11
[64] Neh. 13.22
[65] Dan. 7.9-14; I Petr. 4.5; Vep. 10.42;
Apok. 4.2
[66] II Tim. 4.7
[67] Is. 9.6
[68] Zah. 9.16; Dan. 2.34-35,44-45
[69] Is. 28.16; Ef. 2.20; I Petr. 2.6
[70] Rom. 5.10-11; II Kor. 5.18-19;
Ef. 2.17-18
[71] Hebr. 9.4
[72] Ps. 83(84).3 etj.
[73] Matth. 10.8; Mark 16.17
[74] Urt. Sol. 3.6
[75] Ps. 47(48).2
[76] Matth. 22.30; Mark. 12.25;
Lluk. 20.36

MË 27 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martirit të madh e të shenjtë Pandelejmon shëruesi.

Tipikon

Nëse bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të martirit. Lavdi i martirit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i martirit. Tani ngjallësore (në Tingullin e Lavdisë, si zakonisht, pra)* Virgjëresh' e panusëruar. *Përlëshoret: ngjallësore, e martirit dhe Hyjlindësorja e tij.*

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e martirit. Himne Triadike. Trishenjti. Përlëshorja e martirit. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore. Pas Polieleit, Ndenjësoret (pas Polieleit) e martirit. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i martirit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e martirit, dhe Ndenjësoret e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret I shenjt' Izrael; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore dhe e martirit. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të martirit. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e martirit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e martirit dhe e kishës. Kontaqi Përmbi malin ndrove fytyrën. *Apostulli i martirit dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore e së dielës.*

NË MBRËMËSORE

Pas Qëndrimit të Parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)

Thirrtore
Ting. IV O eks ipsistu klithís

Pandelejmon, kishe emrin denjësisht krejt,* shtrive njeridashjen mbi çdo njeri me kujdes,* duke treguar shërim, kurim* shpirtrash dhe trupash;* ndaj atëherë u pasurove fort,* more quajtjen e përshtatshme me sjelljen fill,* e gjete si një shpërblim, dhunti* për bes' të saktë* dhe për virtyt, o martir; u shfaqe pra* si i pamposhtur,* një ushtar me kurorë i Perëndisë;[1] atë lyp shum,'* t'i shpëtojë, t'i feksë* shpirtrat tanë dhembshurisht me hir.

(2x)

Ti që pranove karizmën e shërimit,*[2] më fort se çdo gjë preferove të saktën bes';* shpresëtarinë nënore ti* e ndoqe, ndërsa* urreve besën e keqe të atit;* atëherë lavdin hyjnor të dhuroi ty* avusha e llamburitjeve,* Zot dritëdhënës,* bujar, dhurues, pra Fjala Perëndi* si paranjohu* me hyjdije më parë, Pandejlemon, dhe shkëlqimin tënd* që me jetë besimi* e tregove te të gjith', i urt'.

(2x)

Ti nga burimet pa lëndë të shpëtimit*[3] hirin e shërimeve[2] të hyjshme e nxjerr gjithnjë,* merr me bollëk, e shpërndan atë* te sa ofrohen,* i tërëlumur; shkëlqena tërë ne* që me besë plot po kremtojm' panairin tënd* të lavdëruar, të shenjtë krejt* dhe dritëprurës,* shndritna me hirin hyjnor, përdore qart'* emrin, kuptimin* që ky ka, mirësinë, me imitimin e Zotit Krisht;* përgjëroju t'u jepet* kjo himnuesve të tu të gjith'.

(2x)

Lavdi

Ting. Tërth. II I Bizantit

Shkëlqeu sot kujtimi i respektuar i anargjendit, që fton besëmirët për dëfrim mistik dhe që udhëzon bashkësitë e kremtimdashësve për panair festiv; sepse na erdhi mjek çudibërës që shëron sëmundjet e të gjithëve, Pandelejmoni, atleti i fortë; dhe ndërmjeton shumë te Zoti, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur, që shkëlqeu prej Atit[4] pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier. Atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës. Leximet

Këndimi i profecisë së Isaias
(43.9-14)

Këto thotë Zoti: "Gjithë kombet u mblodhën së bashku dhe do të mblidhen arkondë nga ato. Kush do t'i njoftojë këto? Ose *gjërat* që nga fillimi kush do t'ju njoftojë? Le t'i sjellin dëshmitarët e tyre, dhe le të drejtohen, dhe le të dëgjojnë, dhe le të thonë të vërteta. Bëhuni dëshmitarët e mi dhe unë dëshmitar", thotë Zoti Perëndia, "dhe fëmija im që zgjodha;

që të njihni dhe të besoni, dhe të kuptoni se unë jam. Përpara meje nuk u bë Perëndi tjetër dhe pas meje nuk do të jetë. Unë Perëndia dhe veç meje nuk është ndonjë që shpëton. Unë lajmërova dhe shpëtova, talla dhe nuk ishte në mes jush i huaj. Ju, dëshmitarë për mua dhe unë, Zoti, Perëndia, ende nga fillimi dhe nuk ka njeri që të shpëtojë nga duart e mia. Do të bëj, dhe kush do ta kthejë mbrapsht këtë?". Kështu thotë Zoti, Perëndia, që ju çliron, i Shenjti i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve *janë* në dorë Perëndie dhe nuk do t'i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën, dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre, dhe ecja nga ne dërrmim, por ata janë në paqe; sepse, edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre *është* plot pavdekësi; dhe pasi do të edukohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata, dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojë në ta Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të, do të kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij, sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë, dhe në Zot *është* paga e tyre, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë prej dore Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do të marrë si armatim zellin e tij dhe do të mobilizojë me armë Krijesën për mbrojtje armiqsh. Do të veshë *si* koracë drejtësi, dhe do të veshë *si* helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë *si* mburojë të pamposhtur oshënarí dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me të bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm te qëllimi predha rrufesh, dhe, si nga një hark i plotë rrethi nga retë, do të hidhen në shenjë, dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohet kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do

të përmbytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie, dhe si stuhi do t'i ajrojë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligjësi, dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur, mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinastí nga i Shumëlarti.

Në Liti Idhiomele
Ting. I I Bizantit

Garove në një përpjekje të mirë, dhe mbarove udhën[5] e martirizimit tënd, o martir Pandelejmon; prandaj kërcen me engjëj në më të lartat, pasi ke marrë mbretëritë e sipërme, të vyera për mundimet e tua; ndërmjeto, o mjek i tërëlumturuar, që të na dhurohet përdëllimi i madh.[6]

Ting. II I Anatoliut

Pa argjend ua jep hirin njerëzve, o Pandelejmon, martir i lavdëruar, dhe dëbon frymë dinake me thirrjen e Krishtit,[7] dhe u dhurove të verbërve shikimin si shërbëtor i tij i sinqertë; ndërmjeto, o mjek i tërëlumturuar, që t'i dhurohet botës paqe e qëndrueshme, dhe atyre që kanë mall për ty përdëllim i madh.[6]

I njëjti I të njëjtit

E hodhe poshtë mashtrimin e atit, o i tërëlavdishëm, dhe, pasi pranove me mençuri fjalët e nënës, dhe fryte më shumë se ari, sipas zërit të Zotit,[8] dhe u tregove një mjek i shkëlqyer, o Pandelejmon martir i nderuar; dhe, duke ecur me hir në udhë, gjete një fëmijë të vogël të dergjur përdhé që e kishte kafshuar gjarpri dhe, pasi iu lute dhe iu përgjërove shumë Perëndisë, menjëherë e ngrite fëmijën dhe e shqeve zvarranikun e egër; prandaj kujtona dhe ne që me besë kremtojmë kujtimin tënd.

I njëjti I të njëjtit

Meqenëse e dëshirove thellë besimin e nënës shpresëplote, e korrigjove keqbesimin e atit, sepse i mbështetur në mësimdhëniet e Hermolaut, kështu kreve edhe pagëzimin, o Pandelejmon, martir i lavdëruar i Perëndisë përdëllyes, kuruesi i të sëmurëve dhe dëbuesi i pasioneve; ndërmjeto që të çlirohen nga peripeci ata që me besë kryejnë kujtimin tënd të vyer gjithmonë për respekt.

Ting. Tërth. I I Gjermanoit

Kujtimi i plotdritshëm i martirit shkëlqen si diell në anët e botës, dhe pa pushim u jep besëmirëve shërime

si pishtar drite, duke zmbrapsur sëmundje dhe duke kuruar pasione; sepse i përgjërohet përgjithmonë Pandelejmoni Krishtit, që t'u dhurohet shpirtrave tanë përdëllimi i madh.[6]

Lavdi

I njëjti I Bizantit

Ejani, o kremtimdashës, le ta mburrim të gjithë me një mendje athloforin e Krishtit, i cili luftoi mirë për besimin e drejtë dhe mori çmimin e fitores, ndriçuesin e rruzullit,[9] yllin e Kishës, i cili feks përherë; prandaj le t'i themi duke thirrur: O Pandelejmon, martir i lavdëruar, bëhu shpëtim i shpirtrave[10] dhe i trupave tanë, dhe strehë e palëkundur, duke ndërmjetuar te Zoti për ne pandërprerë, që të shpëtojmë.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlind'se e virgjër, dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Pasvargje

Ting. I Ton uranion tagmaton

Është detyrë për miqt' e martirëve ta bëjn'* me lavdërim kujtimin[11] e shën Pandelejmonit;* ish përdëllimtar, e kish pra zili* mirësinë dhe dhembshurin'* unike, që kishte Krishti mbi konceptim,* mori hir të hyjshëm mjaft prej tij.

Varg: I drejti si palmë do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet.

Filozofove ti Hirin vullnetarisht lirshëm,* studiove me praktikën* që e gjete si bazë,* o i lum, për teorin' e vërtet';* mirëbërës u bëre pra* për të sëmurët e ndryshëm me dhimbje tmerr,* pate Krishtin si ilaç hyjnor.

Varg: I mbjellë në shtëpinë e Zotit, në oborret e Perëndisë do të lulëzojë.

Kush denjësisht t'i rrëfejë arritjet me mundim,* martir, që i durove,* o shën Pandelejmon trim?* Tërë shpikjet e torturave pra,* të paafta i shfaqe qart'* përpara mallit për Krishtin që kishe ti,* si shpërblim ky të lëvdon tani.

Lavdi

Ting. Tërth. IV I Bizantit

Pasi deshe shpresëtarinë nënore, e korrigjove keqbesimin e atit; pasi u mobilizove[1] te mjeku i shpirtrave, e ushtrove veten mjekësisht; dhe me hir hyjnor, duke pasur sukses në të dyja, u dallove si shfarues pësimesh

dhe shërues shpirtrash; dhe, përderisa e ke fuqinë në mundime dhe këmbënguljen në ndërmjetime, o Pandelejmon, martir i Krishtit, përgjërohu pa pushuar të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Qielloret të himnojnë, o nënë hirplote e panusëruar, edhe ne e lavdërojmë lindjen tënde të pagjurmësuar; o Hyjlindëse, ndërmjeto të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Përlëshore
Ting. III

O Pandelejmon, afthlofor i shenjtë dhe shërues, ndërmjeto te Perëndia mëshirues, që t'u falë shpirtrave tanë ndjesë mëkatesh.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Ty që ndërmjetove për shpëtimin e gjindjes son', të përhimnojmë, o Hyjlindëse Virgjëreshë. Se duke denjuar pësimin e Kryqit me trupin që mori prej teje Biri yt dhe Perëndia ynë, na çliroi prej prishjes si njeridashës.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret
Ting. I Ton tafon su Sotír

Ti ndreqe me kushtim* besën boshe të atit,* kur deshe shpres'tarinë e nënës; ndaj more* prej Zotit Perëndi të tërëpushtetshëm hir të shërosh,*[2] o Pandelejmon,* martir me plot lavd, sëmundje* njerëzish në hall,* që të afrohen me besë,* me vrap, me të nxehtin mall.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Ti shpresë je për ne* të krishterët, e virgjër,* ti Zotin që ke lindur mbi mendje e fjalë,* lyp pa pushim, Hyjlindëse, tok me Forcat e sipërme,* të na japë ndjes'* mëkatesh, ndreqje jetese* neve, pra çdokujt* që të lëvdon ty me besë* gjithnjë dhe me mall të madh.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV O ipsothís en to stavró

Të lavdërojmë ne* të gjithë besnikët* si athlofor, ushtar* mjaft trim, të pamposhtur* të Krishtit,[1] fort i urtë, i kënduar, martir,* bukuria e dëshmorëve;* dhe me besë kujtimin tënd* aq të shenjtë e kremtojm',*

mburrim melodikisht tok* luftimet e nderuara me lavd* dhe Shpëtimtarin,* pra Krishtin, e madhështojm'.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Kush do të mundet pra* të thotë shumicën,* Zonj' pa qortim aspak,* që kam, breshërinë* e pavend të mendimeve pra ndotjen që kam?* Kush do të rrëfejë ligësin',* kryengritje armiqsh pa mish,* të padukshëm, që luftojn'* kundër meje, e mira ti?* Me ndërmjetimin tënd dhuro, më jep* çlirim, shpëtim, ndjes'* për gjithë këto dhe hir.

Pas Polieleit, Ndenjësore
Tingulli i njëjtë Epefanis símeron

O Pandelejmon atlet,* kremton sot bota* ndeshjen dhe luftimin tënd* të respektuar dhe lëvdon* atë që ty të tregoi qart'* mbrojtjen e nxeht', jetëdhënësin, Krishtin pra.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Nënë virgjëresh', duart* e tua pa cen* shtriji dhe mbulona ne* që ty të kemi krejt besim* dhe që thërrasim te Biri yt:* Krisht, jep mëshirat e tua te gjithë ne.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

I drejti si palmë do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet.
Varg: I mbjellë në shtëpinë e Zotit, në oborret e Perëndisë do të lulëzojë.

Ungjilli i së martës, java e dymbëdhjetë e Llukait (21.12-19).
Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e athloforit. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II

O Pandelejmon, mjek i hyjnueshëm, përgjëroju tani Krishtit përdëllyes, që të më çlirojë nga pasione dhe të më mëshirojë.

Kanunet: i Hyjlindëses dhe i shenjtit.

Ode I
Kanuni i Hyjlindëses, që ka
Akrostihidhë alfabetike të përmbysur.
I Theofanit.
Ting. II
Irmosi: En vithó katéstrose poté

»Mbar' ushtrin' e mbretit Faraon*
»shtriu forca mbi çdo armë dhe ar-
»mik,* thellë mbyti në det dikur.*[12]

»Kur u mishërua pra Fjala, fshiu më-
»katin e tërëkeq, dinak,* Zoti i lëvdu-
»ar, se u lavdërua plot me lavdërim.[13]

Të ka zgjedhur Perëndia ty* midis gjithë grave si të bukur shum',* të panjollshme, me hire plot;*[14] dhe në barkun tënd të panjoll' banoi, o e panjollshme; lutju atij,* të shpëtojmë ne himnuesit e tu nga çdo njoll' krimesh pra.

Sipas Psalmit rri si mbretëresh'* në të djathën e atij, i cili prej* barkut tënd na ndriçoi, pra* mbretit;[15] lutju ti, që të më tregojë në krah' të djathtë në atë dit',* kur çdokush do të shpaguhet sipas veprave të tij,[16] o Vajz'.

Qe natyra jonë djerre keq* përmes çdo gabimi, por, e Virgjra ti,* përtërite atë të gjith',* shiun qiellor kur e linde; ndaj, lutem, shfaqe krejt pra frytdhënëse* brazdën[17] e tër' shpirtit tim djerr, o Hyjnuse dhe Hyjlindëse.

Kanuni i shenjtit, që ka Akrostihidhë: "Këndoj Pandelejmonin, martirin e tërëshkëlqyer". I Theofanit. Tingulli dhe Irmosi i njëjtë

Ish-të vdekurin e ngrite ti,* si gatishmërisht i erdhe Krishtit Zot,* para përsosmëris' madje* në Jisu; tani më ngjall, o i fortpasur përmes lutjes që bën, sepse,* o Pandelejmon, jam vrarë nga kafshimi i mëkateve.

Si yll linde, kishe në rini* mençuri hyjmendëse porsi një plak;* hijesinë për shpirtit tënd* e fitove, o martir, dhe e shtove mbi bukurinë e trupit tënd;* ndaj iu shfaqe fort i bukur Fjalës tepër të lëvduar Zot.

Kur për botën vdiqe,[18] veshe ti* Krishtin përmes banjës pra në pagëzim,*[19] o i lumur; u bëre mjet,* instrument hyjprurës si edhe enë për energjinë e Shenjtit Shpirt,* dhe shëroje krejt sëmundjet dhe lëngatat e të gjithëve.

More ti për veten si mikesh'* urtësinë, pjesëmarrëse këtë* gjatë jetës e bëre,[20] pra* u nderove prej kësaj, u stolise nur me kurorën prej hireve,*[21] o i lumur, duke shndritur me shkëlqime nga një lavd hyjnor.

Hyjlindësore

Kur e linde Krishtin, o e thjesht',* me bekim, natyrën e mallkuar keq* nga mosbindja ndaj Bërësit,*[22] e kurorëzove dhe e çlirove prej prishjes,[23] o e tërëdëlir';* ndaj të gjithë besimtarët me gëzim të lumërojmë ty.

Zbritësore: Horí Israíl

»I shenjt' Izrael shkoj Detin e Kuq si
»mbi një tok', me këmbë të palagura[24]
»dhe armiqtë me kuaj u panë ndër

»valët të mbytur të shkatërruar.[12] Pra »me gaz këndonte populli: O Perëndi, »o Zot i madh, nder dhe lavdi më ty.[13]*

Ode III
I Hyjlindëses
Irmosi: Eksínthisen i érimos

»Ululëzua si zambak* shkretëtira,[25] »Kisha e gjith' kombeve që shter- »që ish,* me pranin' tënde, Perëndia »im;* në të u sigurua zemra ime fort.[26]

Nga barku yt del Bërësi,* kur më veshi mua[19] pra, o e gjithëpanjollshmja Vajz',* edhe dha një stoli paprishjeje* te ne të zhveshur krejt prej shkeljesh,[27] mangësish.

Elinde Fjalën Perëndi,* që ësht' mbi çdo lavd, o Zonjë; lutju përgjithmonë ti*, që ta ket' përdëllimin shpirti im,* i zymtë nga çdo epsh dhe ligësi mjerisht.

Shëro plagët e shpirtit tim,* o e pacenuar; zemrën time të mjerueshme,* të helmuar me helm nga gjarpri[28] djall* mjekoje me ilaç të fort' dhe më shpëto.

I shenjtit I njëjti

Dëgjove fjalët e Shpirtit,* ndaj u bëre tok' e mirë dhe pjellore; prite pra* farën shumë të çmuar,[8] linde ti* shpëtim[29] për shpirtrat, o i lum tri herë fort.

Mentalitet si rezultat* të kafshimit nga dragoi ti e vrave; shpirtin tënd* e ringjalle me një hyjfrymëzim,* rilinde, rri pran' mbretit të të gjithave.

Ndryshove urdhrin e pafé* të tiranëve dhe rende për te Krishti dhe, pasi* e fitove në vend të çdo gjëje,* u bëre, o hyjmendës, një tregtar[30] i madh.

Besimin e së ëmës drejt* fort e deshe dhe urreve ateizmin atëror* të trazuar; se, si i mençur thell',* e zgjodhe më të mirën, i lavdishmi shenjt.

Hyjlindësore

Në duar mban, Hyjlindëse* Virgjëreshë, Zotin që me shenj' hyjnore mban gjithçka,* Universin; atë tani ti lyp,* nga çdo rrezik pra të çlirohen shpirtrat tan'.

Zbritësore:
Tokson dhinatón ishténisen

»Harku* i të fortëve u tret* dhe të »dobësuarit janë ngjeshur me plot »fuqi;*[31] ndaj në Zotin u sigurua* ze- »mra ime[26] pa u tundur dot.

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Predikove besimin tek ati yt,* nga padija, nga fundi, e nxore krejt;* për Krishtin me trimëri,* o i famshmi Pa-

ndelejmon,* martirizim pësove pa frik' nga tiranët ti,* pra nga mentaliteti pa fe; turpërove mjaft* arrogancën pa forc' të demonëve, kështu* prej Zotit ke marrë hir,* që sëmundjet në shpirt dhe trup* t'i shërosh krejt,*[2] o emërmadh;'* ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Urtësinë[32] dhe Fjalën e zure ti* brenda barkut pa farë, pa djegie krejt;* e linde për rruzullin* sundimtarin e Gjithësis';* mban në pëqi atë që në dorë çdo gjë e mban,*[33] pra Krijimtarin[34] si dhe ushqyesin botëror;*[35] ndaj, e Tërëshenjta Virgjëreshë, të lutem,* kur unë do rri kundrejt* faqes së Krijimtarit[36] tim,* të shpëtohem* nga çdo mëkat;* Zonj' e pastër dhe virgjëresh'* atëher' ndihmë dhe mbrojtje* ti më dhuro,* sepse, o e himnuar, mundesh të bësh sa do.[37]

Ode IV
I Hyjlindëses
Irmosi: Elílithas ek Parthenu

»Ke ardhur nga një e virgjër jo si »ndërmjetues, jo si engjëll, por vetë »Zoti i mishëruar, dhe më shpëtove[38] »mua, njeriun e tërë; pra ty të thërras: »Lavdi fuqisë sate, o Zot.

O Zonjë, hidh si shi mbi mua pikë kataniksi, e cila largon gjithë vapën[39] e zemrës sime dhe ndalon përmbytjet dëmtuese të plogështisë sime.

Mos më shpërfill mua që u plagosa nga shpata e epshit dhe jam i dergjur, i vrarë, o e pacenuar; por shëromë me shtizën dhe gjakun e Birit tënd dhe Perëndisë sonë, që u kryqëzua.

Ti që je pasuruar me zotërimin e gjithë Krijesës, mua që u varfërova keq, më denjëso për hir të hyjshëm, që të të madhështoj ty, si mbrojtësen time të mir', o e tërëpaqortueshme.

I shenjtit I njëjti

Meqë u pickove nga mallëngjimi i Zotit, ua shpërndave pasurinë të varfërve,[40] dhe e stërvite veten për atletizim;[41] atë vërtet e kalove tërësisht, duke parashikuar shpresat e përjetshme.

Ia ofrove Perëndisë flijimin e himnimit,[42] meqenëse i neverite qartësisht adhurimet e idhujve, dhe e shkele gjithë tërbimin e të pabesëve, o athlofor.

Duke luftuar kundër atyre që ishin plagosur nga xhelozia dhe smira, o martir, u kundërvure fuqinë e pa-

mposhtur dhe fitove duke triumfuar mbi tiraninë besëkeqe.

O Pandelejmon, ai që mbahej në prehrin e plakut Simeon,[43] me anën e fjalëve të një të moshuari të kapi për jetë, për dije hyjnore si dhe për shpëtim dhe çlirim vetash të shumtë.

Hyjlindësore

Të reja dhe virgjëresha vrapuan pas teje,[44] duke të parë ty të re dhe virgjëreshë si dhe nënë; sepse vetëm ti i bashkove pashprehshëm të dyja në një, o Hyjnuse.

Zbritësore: Isakíkoa tin éndhokson

»Kam dëgjuar[45] planin tënd për të »shpëtuar njerëzit, o Krisht Perëndi. »Linde mbi dhé prej Virgjëreshës, që »të na shfaqësh dritën e ungjillit tënd, »Zoti i fuqishëm, lavdi më ty.*

Ode V
I Hyjlindëses
Irmosi: Mesitis Theú

»U bërë ndërmjetës mes Perëndisë »dhe njerëzve, o Krisht[46] Perëndi; se»pse nëpërmjet teje, o Zot, e kemi bla»timin tonë nga natë paditurie tek Ati »yt[47] i ndritshëm qysh në fillim.

Ti që linde udhën e jetës,[48] o e pacenuar, udhëhiqmë në udhë të drejtë[49] mua që tani rrëzohem pa mend edhe në të përpjeta, edhe në gremina rëniesh të thella.

Pasi e bëra veten të huaj me mendje mosmirënjohëse ndaj Perëndisë, jetova si plangprishës, duke u endur më kot në një vend të largët[50] pasionesh; por kthemë, shpëtomë me përgjërimet e tua, o e Virgjër.

Me rrëketë e tua jetëburuese vaditmë mua shërbëtorin tënd, që digjem nga flaka[39] e mëkateve dhe flakërohem nga sulmet e demonëve, o Virgjëreshë e pacenuar.

I shenjti: O fotismós

Me ngazëllim u fute nën luftërat e martirizimit i fortifikuar me fuqi hyjnore; dhe me durim të qëndrueshëm, duke hequr torturat, thërrisje me hare: Perëndi tjetër, veç teje nuk di unë.[51]

Duke qenë në krye ndeshjesh atletike, me fuqi hyjnore fitove mbi tiraninë e pafe të ateistëve, mbi maninë e besëtytnisë, pasi u veshe me Krishtin,[19] shpallësin e garave.

Duke pasur rezistencën rinore dhe shtatin e fortë të shpirtit, çdo traumatizëm e pësove fuqishëm dhe me moral burrëror, o martir, duke u përforcuar me hirin e Kryqit hyjnor.

Athlofori, përmes mësimdhënies qiellore, zmbrapsi llomotitjen e turbullt të të mashtruarve, dhe u bë shkak shpëtimi paradoksal për shumë veta, i përforcuar me bashkëpunimin e Krishtit.[52]

Hyjlindësore

Fjalët dhe enigmat e të urtëve[53] dhe parathëniet e profetëve të paraikonizonin ty, o e lavdëruar përmbi të gjitha, se do bëheshe dukshëm lindëse Perëndie në fund; sepse, ndonjë tjetër të kulluar, veç teje, nuk njohim.

Zbritësore: O tu fotós dhiatmiksas

»O Zot i madh që ndriçove errësirën e vjetër në dritë,[54] veprat të lavdëroj»në,[55] o Krisht. Me dritën tënde udhët »tona drejtonaji.[56]*

Ode VI
I Hyjlindëses
Irmosi: En aviso ptesmaton

»Një avushë mëkatesh po më rre»thon,* ndaj thërras un' mirësinë të»nde që s'ka fund,* e cila s'gjurmë»sohet dot;* lutem, nxirrmë nga pri»shja, o Zoti im.[57]

Mos më shfaq mua gaz të demonëve*[58] në gjykimin që do bëhet në të ardhmen, Zonj',* por lutu te gjykatësi,* Biri yt, të më shohë me mirësi.

Me mendimet si dhe me veprimtarin'* djallëzore, të paligjshme që kam, Zot, të nxeh;* pra sjell për të të zbutur ty* nënën tënde; shpëtomë, më mëshiro.

Prej dënimit shpëtomë mua, o Zonj',* se prej mjaft mëkatesh jam vetëdënuar rënd',*[59] se linde ti gjykatësin,* o e famshme, pra Zotin e Gjithsësis'.

I shenjtit I njëjti

Poshtërove statujat mashtruese,* e shfarose djallëzinë që po ngrihej lart* kur bëje mrekulli, çudi* dhe shëroje habitshëm, i urt' hyjnisht.

Përmes zjarrit dhe ujit kalove[60] ti* dhe, kur u tendose mbi një rrotë, zhduke krejt* çuditërisht të çmendurit,* në shkëlqim me kurorë u shfaqe pra.

Arrogancë tiranësh ke mposhtur krejt* dhe torturat fort të padurueshme në trup;* me hir, hyjmendës, me fuqi* shpirtërore ke bër' atletizmin tënd.

Hyjlindësore

Në pëqirin tënd mban atë që përmban* rrethin tokësor, si Perëndia,[61] e Dëlir';* ka formë trupi, edhe pse* nuk përshkruhet në formë hyjnore dot.

Zbritësore: En to thlívesthé me

»Nëpër hidhërime i thirra Zotit lart
»në q'ell, dhe ma priti lutjen Perëndia
»i shpëtimit tim.[62]*

Kontaqi Ting. Tërth. I

Meqë ishe imitues i Përdëllimtarit dhe meqenëse more prej tij hirin e terapive,[2] o athlofor dhe martir i Krishtit Perëndi, me uratat e tua shëroji sëmundjet tona shpirtërore, duke dëbuar përgjithnjë skandalet e armikut nga ne që thërrasim pa pushim: Shpëtona, o Zot.[63]

Shtëpia

Kujtimin e anargjendit, atletizimin e trimit, shërimet e besnikut le t'i himnojmë besërisht, o krishtdashës, që të marrim mëshirë,[64] madje ata që i baltuan, si unë, tempujt e tyre;[65] sepse jep kurimin e shpirtrave bashkë me atë të trupave; prandaj, le të nxitojmë, o vëllezër, që ta kemi sigurisht në zemrat tona atë që çliron nga mashtrimi ne që thërrasim pa pushim: Shpëtona, o Zot.[63]

Sinaksari

Më 27 të të njëjtit muaj, kujtimi i martirit të madh e të shenjtë Pandelejmon shëruesi.

Vargje: Është i përzier me qumësht gjaku i kokës sate,/ për hir të së cilës Krishti derdh gjak të përzier me ujë,[66] o martir.
Në të njëzet e shtatën, Pandelejmoni mori si short një shpatë.

Kujtimi i nënës sonë oshënare Anthusa omologjete, që qe në manastirin tepër të shenjtë të Mantineut.

Pesëdhjetë e tre martirët e shenjtë nga Thraka, mbarojnë në det.

Oshënar Manueli mbaron me paqe.

Në të njëjtën ditë, i verbri që u shërua prej shën Pandelejmonit, mbaron me shpatë.
Vargje: Pasi gjeti një i verbër ndriçim llambash trupore,[67]/ pa dhe një agim shpirtëror përmes shpate.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorë dhe të barabartë me apostujt Gorasdhi.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorë Gjermani i Alaskës.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
I Hyjlindëses
Irmosi: Antítheon próstagma

»Urdhër i kundërperëndishëm i një ti»rani të paligjshëm[68] bëri që flaka të

»brambullonte lart, ndërsa shtriu për »Djemtë shpresëplotë vesën[69] e Shpir- »tit Krishti, që është i bekuar dhe i për- »mbilavdëruar.[70]

Duke qenë, o Zonjë, fuqia ime, himnimi dhe shpëtimi i sigurt,[71] dhe përkrahja, dhe muri i paluftueshëm, lufto gjithnjë demonët që më luftojnë,[72] duke kërkuar që të më vrasin.[73]

O Virgjëreshë, hyjnizove njeriun, duke trupëzuar Perëndi prej gjakut tënd virgjëror; prandaj çliromë me ndërmjetimet e tua mua që ndotem tepër nga pasionet dhe prishem fort[74] nga tinëzitë e armikut.[75]

Furra parashfaqte lindjen tënde, o e tërëpaqortueshme, sepse nuk dogji Djemtë,[69] sikurse as mitrën tënde zjarri i pakufizueshëm; prandaj, të lyp, shpëtoje shërbëtorin tënd nga zjarri i amshuar.[76]

I shenjtit: Ikonos hrisís

O i gjithëkënduar, duke garuar ligjërisht[77] dhe përderisa fitove mbi armikun, u bëre liman i tërëqetë për ata që dimërohen në det dhe dritë për ata që janë në errësirën[78] e jetës, të cilëve u mësove të këndojnë: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[70]

I lumur je dhe do të jetë mirë për ty[79] tani, o tepër i lum, që e fitove shpresën tënde të lumur[80] dhe të pasur tri herë, e cila është depozituar[81] për ata që besërisht i thërrasin Zotit: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[70]

O i lumur, të pritën si bashkëkërcimtar shpirtra shenjtorësh, kore të drejtësh dhe rende engjëjsh pa trup; sepse, pasi ta prenë qafën me shpatë, psal melodikisht i ngazëlluar: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[70]

Hyjlindësore

Shpata, që më përpara na ndau nga druri i jetës, tani, duke u kthyer,[82] mikpret ata që u shënuan me gjakun[83] që doli nga brinja e Birit tënd,[66] o e Tërëpaqortueshme, e bekuar, që mbajte në barkun tënd Perëndi në mish.

Zbritësore: Avramiei poté

»Në Babilonë në zjarr* djemtë abra- »mianë* e shkelën flakën përvëlue- »se,*[69] këndonin pra besërisht:* O »Perëndi edhe Zot, je i bekuar.[70]*

Ode VIII
I Hyjlindëses
Irmosi: Káminos poté pirós

»Dikur një furrë në Babilonë i ndan- »te energjitë me urdhër hyjnor, duke »shkrumbuar kaldenjtë, ndërsa i ve- »sonte besimtarët[69] që psalnin: Beko- »jeni Zotin, gjithë ju vepra.[55]

Ki zili të mirat, duke u larguar nga të këqijat me zell për punë të hyjnueshme, o shpirti im, duke pasur Hyjnënën, mbrojtjen e paturpëruar të të gjithëve, që ndërmjeton për ty si përdëllyese dhe njeridashëse.

O Hyjlindëse, zgjidhe njeriun nga prangat e dënimit të vjetër;[84] prandaj të lyp që të zgjidhësh çdo lidhje të së keqes[85] së zemrës sime, o e papërlyer, duke më lidhur me dashurinë e hyjnueshme të Gatuesit.

Ti që linde rrezatimin e lavdisë së Atit,[86] zemrën time të zymtë nga poshtërsi shkeljesh ngazëlloje, o Hyjlindëse, dhe tregomë pjesëmarrës lavdie të përhershme, që të të lavdëroj me besë.

I shenjtit: Ton en kamino tu pirós

Çmprehtësinë e shikimit shpirtëror të të atit e shëron aftësia e zgjuarsisë sate, e cila ua rikthen dritën atyre që me besim e me vrap afrohen, dhe udhëzon drejt Krishtit Shpëtimtar, o i tërëlumur.

Kur u there për Krishtin, u transferove drejt jetës së amshuar[87] dhe u duke i hyjquajtur, i nderuar me epitetin hyjnor të Krishtit, o hyjmendës, duke përmbilartësuar Krishtin në jetë.[70]

Meqë e hodhe poshtë llomotitjen oratorike dhe të vështirë të sofistëve, me thirrjen e Krishtit pret rrënjët e pasioneve të dhimbshme, duke shëruar ata që përmbilartësojnë Krishtin në jetë.[70]

Hyjlindësore

Të dimë si burim të kthjellët pavdekësie, o Perëndilindëse, sepse linde Fjalën e Atit të pavdekshëm, që çliron nga vdekja të gjithë ata që e përmbilartësojnë në jetë.[70]

Zbritësore: I en Vaviloni pedhes

»Tre Djemtë në Babilonë* me një zell »qiellor të përdjegur,* tiranin[68] s'e »përfilln' aspak.* E shkelën zjarrin »burrërisht* edhe të vesuar[69] prej qe»llit* të këndonin me zë të madh:* »Zotin, që të gjitha krijesat e Zotit, »bekojeni.[55]*

Ode IX
I Hyjlindëses
Irmosi: Anarhu jenítoros

»Bir prindi pa nisje, Perëndi dhe Zot »te ne u shfaq* me lavdi nga e Virgjra »që të ndriçojë sot* gjith' të errësu»arat[88] edhe të mbledh' në një* të »shpërndarat;[89] ndaj madhështojmë »Hyjlindësen* e himnuar fort edhe me »nam.

Adami shijoi ngrënie që nuk duhej dhe kështu* voli vdekje nga druri me hidhërim në shpirt;*[22] por kur në një dru u gozhdua fëmija yt,* na buroi, Zonj', ëmbëlsin' e pavdekësis';* o e pacen, të lëvdojmë pra.

Ti je mbretëreshë, meqë linde mbretin, Zotin Krisht,* mbi logjikë, i cili shpërbëri, o Mari,* mbretërit' e Hadhit; atij lutju vazhdimisht,* të na denjësojë ne që të nderojmë, Vajz',* pra për mbretërin' e sipërme.

Ji, Zonj', mirëbërëse për zemrën time që u ul,* që përmbytjet e epshit e keqtrajtuan mjaft,* se e tëra je ti e mirë, të mirin pra* linde; edhe futmë në dyer pendimi, që* jan' të mira, dhe shpëtomë pra.

I shenjtit I njëjti

Me gaz u shpërngule për në kulmin e dëshirave;* kur atje ti fushove, u denjësove pra* që ta përfitosh vërtet fundin e lumur fort,* o i tërëlum, dhe qëndron tok me Zotin tënd*[90] në një jetë që nuk ka mbarim.

Arrite dëshirën, plotësove mallëngjimin tënd,* kur pikonte akoma gjaku i ngrohtë mjaft,* që u zbraz për Krishtin, i lumur fort, dhe u derdh* për atë; kurorat e ndeshjeve plot mundim* me gëzim i more prej atij.

Si qëmoti Danieli, mbylle gojë bishash tmerr*[91] dhe frenove luanët që kishin hapur goj',* se e palogjikshmja natyrë di të nderoj',* o i famshëm fort, çdo virtyt të martirëve,* ndaj të lumërojmë mbledhur ne.

Të jep Krishti, të dhuron ty mirësi si pasuri,*[92] se na fal një thesar me shërime, dhe të bën* sipas emrit tënd përdëllyes për çdo njeri* në shtrëngim, liman mjaft të qetë, përkrahje, ndihm',* mbrojtje, o martir me nam të madh.

Hyjlindësore

O e tërëpaqortueshme, kur prite si shtëllung'* shiun mbiqiellor,[93] brenda barkut tënd pa cen* na e linde; se ambrozinë ai dhuron* te sa e himnojnë me besë dhe shpallin fort* se Hyjlindësja pa njollë je.

Zbritësore: O tokos su áfthoros

»Pas lindjes qëndrove virgjëreshë dhe një Perëndi prej gjirit tënd i mi»shëruar mbi dhenë na u shfaq[94] edhe »me njerëz u shoqërua;[95] pra, të ma»dhështojmë të gjithë, o Hyjlindëse.*

Dërgimësore
Tis mathités sinélthomen

O i tërurtë, je lavdi* hyjnor për shenjtët anargjend'* dhe për të hyjshmit

martirë,* Pandelejmon, o mburrja* e të krishterëve; jepi* mbretit sukses, fitoret* nga qielli; në botën mbar'* fale paqen, shpëtimin, pra tek ata* që ty të himnojnë, shenjtor, me besë;* për ne të gjithë ndërmjeto* ti me Hyjlindësen tok.

Lavdërime
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

Duke imituar përdëllimin e Jisuit Zot qart',* more, Pandelejmon, emër* të përshtatshëm me mënyr'* që vërtet ke; se gjithë ne* na mëshiron si i mirë, dhe na jep* shërim, shëndet të dyfishtë, na ushqen,* o i lavdishëm fort,* dhe na udhëzon, i tërëpasur, drejt* në të hyjshmen dije fort të ndritshme të Krishtit.[96]

(2x)

Është punë përkujdesjeje nga sipër, ç'ndodhi me ty:* U tregua mjaft haptazi* se, kur po mësoje qart'* si kurohet pësim trupor,* si mjek i aftë, i gatshëm shfaqeshe;* me fjalë Hiri[97] shëroje çdo njeri,* duke çliruar krejt* sa vraponin afër teje nga çdo terr,* nga çdo errësirë që përmban mashtrimi pra.

Ti i kundërvure bukuris' së trupit tënd bukuri* shpirtërore me plot sukses,* edhe hijeshis' në mish* pjekuri në arsye, mend;* dhe i habite, martir, sa shihnin pra,* kur po shkëlqeje me mrekulli, çudi,* sepse ndriçoheshe* me besim dhe hir, se more pasuri* mençuri prej plaku qysh në lulen e rinis'.

Lavdi
Ting. IV I Bizantit

Sot shkëlqeu kujtimi i athloforit. Ejani, o besëmirë, le të dëfrejmë shpirtërisht dhe ta kurorëzojmë atë me këngë; sepse me fuqinë e Kryqit triumfoi burrërisht kundër armikut të padukshëm; dhe, duke mos u frikësuar nga tortura të panumërta të tiranëve, e priti ligjërisht çmimin[77] e thirrjes së sipërme,[98] dhe tani ngazëllohet përjetë së bashku me engjëj; ndaj, o Pandelejmon, martir i Krishtit, mjek i të sëmurëve dhe liman i të dimëruarve, mos pusho së ndërmjetuari te Perëndia mëshirues, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Nga çdo lloj rreziku ruaji shërbëtorët e tu, o Hyjlindëse e bekuar, që të të lavdërojmë ty, shpresën e shpirtrave tanë.

Dhoksologjia e Madhe.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i shenjtit Ode III dhe VI. Kontaqi i Metamorfozës. Kungatore Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] II Tim. 2.3
[2] I Kor. 12.9,28
[3] Is. 12.3
[4] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[5] II Tim. 4.6
[6] Num. 14.19 etj.
[7] Mark. 16.17
[8] Matth. 13.8; Mark 4.8; Luk.8.8
[9] Fil. 2.15
[10] I Petr. 1.9
[11] Fja. Urt. 10.7
[12] Eks. 14.27-28; 15.19
[13] Eks. 15.1,21
[14] Kënga 4.7
[15] Ps. 44(45).10
[16] Matth. 25.31-33
[17] Ps. 64(65).11
[18] Gal. 6.14
[19] Gal. 3.27
[20] Urt. Sol. 8.2
[21] Fja. Urt. 1.9; 4.9
[22] Gjen. 3.1-19
[23] Rom. 8.20-21
[24] Eks. 14.21-22
[25] Is. 35.1
[26] I Mbret. [Sam.] 2.1
[27] Gjen. 3.7
[28] Gjen. 3.1-6; II Kor. 11.3; Apok. 12.9,14,15; 20.2
[29] Is. 26.18
[30] Matth. 13.45-46
[31] I Mbret. [Sam.] 2.4
[32] I Kor. 1.24,30
[33] Est. 4.17b
[34] Hebr. 1.2
[35] Ps. 110(111).5 etj.
[36] Rom.14.10
[37] Urt. Sol. 12.18; Mark 1.40
[38] Is. 63.9
[39] Lluk. 16.24
[40] Matth. 19.21; Mark. 10.21; Lluk. 18.22
[41] I Tim. 4.7
[42] Lev. 7.12(2) etj.
[43] Lluk. 2.28
[44] Kënga 1.4
[45] Abak. 3.1
[46] I Tim. 2.5
[47] Is. 26.9
[48] Joan 14.6
[49] Ps. 106(107).7
[50] Lluk. 15.13
[51] Is. 26.13
[52] Mark. 16.20
[53] Fja. Urt. 1.6
[54] Gjen. 1.1-3
[55] Ps. 102(103).22; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[56] Ps. 5.9; Fja. Urt. 20.24; Sirak 37.15
[57] Jona 2.6-7
[58] Sirak 18.31
[59] Tit. 3.11
[60] Ps. 65(66).12
[61] Is. 40.22
[62] Jona 2.3
[63] Ps. 105(106).47; Matth. 8.25; 14.30
[64] Hebr. 4.16
[65] I Kor. 3.16-17; 6.19; II Kor. 6.16
[66] Joan 19.34
[67] Matth. 6.22; Lluk. 11.34
[68] Dan. 3.4-6
[69] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23-26
[70] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[71] Ps. 117(118).14
[72] Ps. 34(35).1
[73] Ps. 36(37).32

[74] Ef. 4.2
[75] Ef. 6.11
[76] Matth. 18.8; 25.41; Juda 7
[77] II Tim. 2.5
[78] Rom. 2.19
[79] Ps. 127(128).2
[80] Tit. 2.13
[81] Kol. 1.5
[82] Gjen. 3.24
[83] Eks. 12.7,23
[84] Gjen. 3.16-19
[85] Is. 58.6
[86] Hebr. 1.3
[87] Matth. 25.46; Joan 5.24; I Joan 3.14
[88] Is. 9.2; 42.16; Matth. 4.16
[89] Is. 56.8
[90] III [I] Mbret. 17.1; 18.15;
IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
[91] Dan. 6.18
[92] Ef. 2.7
[93] Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6
[94] I Tim. 3.16
[95] Baruh 3.38
[96] II Petr. 3.18
[97] Lluk. 4.22; Vep. 14.3; 20.32
[98] Fil. 3.14

MUAJI GUSHT

QË KA 31 DITË

1 GUSHT

Dalja e Kryqit të Çmuar, kujtimi i Shtatë Djemve të shenjtë Makkabenj, i mësuesit të tyre Eleazar dhe i nënës së tyre Solomona,* si dhe kujtimi i Elesës, i martires së shenjtë.**

Tipikon

*Nëse bie të dielën, lihet shërbesa e shën Elesës. Të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, 3 të Kryqit dhe 3 të Makkabenjve. Lavdi i Kryqit (*Me simbolin që qëmoti*). Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje.* O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi si dhe Tani i Mujorit. Përlëshoret: ngjallësore, e Makkabenjve dhe e Kryqit.*

Shërbesa e Mesnatës e së dielës. Në Mëngjesore, Ndenjësoret ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, i Kryqit dhe i Makkabenjve. Pas Odes III, Kontaqi i Kryqit. Ndenjësoret: e Makkabenjve dhe e Kryqit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret Një kryq vijosi me shkop*; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore, e Makkabenjve dhe e Kryqit. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të Kryqit (në*

---

* *Shih historinë e Makkabenjve në II Makk. 6.18-7.42; dhe më hollësisht IV Makk. kap. 5-18.*

** *Poezi e përkthyesit*

dy të fundit me Vargje a: Lartësoni Zotin, Perëndinë ton', dhe faljuni nënkëmbëzës së këmbëve të tij. *b:* Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut). *Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. *Dhoksologjia e Madhe [dhe shërbesa e Faljes së Kryqit].* Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit, 4 nga Ode III e Kryqit dhe 4 nga Ode VI e Makkabenjve. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Kryqit, e Makkabenjve dhe e kishës. Kontaqi Ti që u ngrite. *Në vend të Trishenjtit,* Kryqit tënd i falemi, o Zot. *Apostulli dhe Ungjilli i së dielës.* Të meriton. *Kungatore* Lavdëroni *[dhe* U shënua mbi ne drita e fytyrës sate, o Zot. Aliluia.*]* Pamë dritën.

NË MBRËMËSORE

8 Thirrtore
Të Kryqit të Çmuar
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Si burim shenjtërimi, hir,* mbrojtje, ndihm' të përbashkët tok,* le ta puthim Kryqin e Çmuar me kushtim;* se vë në gjumë pasione dhe ndërpret ky sëmundje krejt* dhe çliron nga çdo mjerim,* dhimbje vuajtësit dhe u jep* besëmirëve* si det rrjedha çudish, meqë ata nderojnë dhe i falen formës së tij me besë dhe mallëngjim.

Ne pra njerëzit vuajtës* nëpër dallgët e jetës son',* që nga turbullimet si valë tundemi,* le të përikim me besë si në barkë shpëtimi fill* tek i çmuari dru, Kryq,* edhe dallgët dhe frymët tok* do pushohen krejt,* do të çahen pasionet; do arrijmë në një gji shpëtimi pa valë, me hare dhe me ngazëllim.

Shndriti më fort se dielli* Kryqi i tërëshenjtë pra,* dhe lëshon si rreze çudi dhe hedh te ne* predha shërimesh; o njerëz, që në terrin e tmerreve* gjithnjë mbahemi, të vijm'* afër tij dhe do marrim gaz* dritëdhënës, hir* për kurime,[1] dhunti ne, duke madhëruar Zotin që në të me mish u mbërthye mjaft dhembshurisht.

Të shenjtorëve
Ting. I Panéfimi mártires

Çatinë e Ligjit që ish pra* përmbi shtatë shtylla[2] lart,* s'e tundi dot tirania, se duruan burrërisht* çdo tërbim të marrë* të përndjekësit, kur dhanë trupin te xhelatë, vëllezërit e rinj fisnikë fort,* që me trimëri i ruanin* porosit' që Moisiu dha hyjnisht.

Kur mendjen vërtet e ngritën lart,* më lart sesa duken posht',* të Rinjtë

plot besë, trimëri, u prisnin mishin keq* dhe gjymtyrët, bashkë* me hyjmendësen të ëmën, se nga shpresat po përforcoheshin; tani i morën k'to,* shkuan fill në gji stëratëror,* pra të Abrahamit,[3] ku me gaz prehen.

Të Rinjt' e tërurtë dhe me ta* i gjithëhyjnueshmi* Eleazar dhe hyjmendësja, pra nëna me guxim,* si u armatosën* me rininë shpirtërore edhe nxitën shpirtin qëndrueshëm, marshuan me guxim* drejt armikut për hir të besës* dhe të ruajtjes së Ligjit atëror.

Të martires së virgjër
Të ngjashme

Martire Elesë me lavdi,* të himnojmë besërisht,* se deshe Krishtin më shumë se çdo gjë në jetë ti,* ndaj i dedikove* shpirtin; zemrën, mendjen, forcën tënde,[4] të dëlira i ruajte; pra, përgjërohu sot* të dhurohet paqe, përdëllim,* oshënare, dhe mëshir' te shpirtrat tan'.

Martire e virgjër me lavdi,* u tregove si një gur* që e shpërbënte shtrëngata atërore mu si shkrumb;* ndaj e admiroi* qëndrueshmërinë tënde guri, dhe u ça të të mbronte, por i ngurtësuari,* ati yt, u shfaq pa dhembshuri,* më i keq se gjërat që nuk kanë shpirt.

Lavdi *I shenjtorëve*
Ting. Tërth. IV I Joan Monakut

Makkabenjtë e shenjtë i thoshin tiranit: "Për ne, o Antiok, njëri është mbret, Perëndia, nga i cili u bëmë, dhe drejt të cilit kthehemi; na pret një tjetër botë, më e lartë se kjo që duket, dhe e përhershme; vendi ynë është Jerusalemi i fuqishëm dhe i pashkatërrueshëm, ndërsa panairi është shoqërimi me engjëjt". O Zot, me ndërmjetimet e tyre mëshirona dhe shpëtona.

Tani *I Kryqit*
I njëjti

Me simbolin që qëmoti Moisiu e parafiguroi te vetja e tij, rrëzoi me triumf Amalikun,[5] dhe Davidi melodist, duke thirrur, urdhëroi që t'i falemi, pra nënkëmbëzës sate,[6] domethënë Kryqit tënd të çmuar, o Krisht Perëndi; sot ne mëkatarët i falemi me buzë të padenja, duke të himnuar ty që pranove të gozhdohesh në të dhe të thërrasim: O Zot, bashkë me kusarin, bëna të denjë për mbretërinë tënde.[7]

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës.

Pasvargje të Kryqit
Ting. I Ton uranion tagmaton

Ejani, o kremtimdashës, në daljen e Kryqit* dhe, duke bërë festë,* të dëfrejm' duke thirrur* pa ngurrim, me besë: Kryq zotëror,* përmes Hirit të Krishtit ton'* të lartësuar mbi ty, shenjtërona ne,* na nxjerrt' forca jote nga çdo dëm.

Varg: Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë, dhe faljuni nënkëmbëzës së këmbëve të tij.

Ecjet për qiell krejt neve Kryqi na hijeson,* që dashurisht me frikë* po i falemi thellë* dhe atij që u mbërthye mbi të;* dhe me koret e Forcave* pa lënd' i Çmuari bashkë na numëron* ne që e himnojmë plot me mall.

Varg: Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

Ne që i falemi Kryqit të Çmuar me besim,* i falemi pra Zotit* të mbërthyer përmbi të,* dhe pastrohemi në buzë, në shpirt* me një shenjë që bën ai;* dhe me shkëlqimet e tij krejt mendore, ne* kemi gaz kur e himnojm' atë.

Lavdi *I martires së virgjër*
Ting. Tërth. IV

Linde, o Elesë, sipas premtimit hyjnor, të cilin e mori e ëma jote besëmirë; dhe, e rritur prej saj në edukatë dhe këshillim Zoti,[8] përmbushe atë që kishte taksur, pra iu dedikove Dhëndrit të pavdekshëm dhe u ngjite në fund në qiell si nuse e panjollshme, e bardhë;[9] lutju në nusëroren e sipërme[10] për ne që të himnojmë.

Tani *I Kryqit*
I njëjti

Zëri i profetit tënd Moisi u plotësua, o Perëndi, kur thoshte: "Do të shikoni jetën tuaj të varur përballë syve tuaj".[11] Sot Kryqi lartësohet dhe rruzulli nga mashtrimi është çliruar. Sot ngjallja e Krishtit përurohet dhe anët e dheut ngazëllohen duke të ofruar himn me cimbale davidiane[12] dhe duke thënë: Punove shpëtim në mes të dheut, o Perëndi,[13] Kryqin dhe Ngjalljen, me të cilat na shpëtove, o i mirë dhe njeridashës; o Zot i tërëfuqishëm, lavdi më ty.

Përlëshore e shenjtorëve
Ting. I

Të ardhtë keq për dhimbjet e shenjtorëve, të cilët pësuan për ty,[13a] o Zot, dhe shëroji gjithë dhimbjet tona, o njeridashës, të lutemi.

E martires së virgjër
Ting. IV Tahí prokatálave

Ke mbirë prej shterpës si lule me plot hijeshi,* Elesë zëmadhe, dhe urreve fort ateizmin që kishte ati yt;* shndrite, o oshënare, në Kithirë, në ishull,* ku u martirizove, pra kështu u lëvdove* edhe na buron tani dhunti të hyjnueshme.

E Kryqit
Ting. I

O Zot, shpëtoje popullin tënd dhe bekoje trashëgimin tënd;[14] dhuroju shpresëtarëve fitore mbi barbarët dhe ruaje shtetin tënd me anën e Kryqit tënd.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësore e Kryqit
Ting. I Ton tafon su Sotír

Festo, natyrë mbar',* njerëzore, kërce ti* mistikërisht, se druri i Kryqit u vu sot* përpara nesh, klinikë është pa lek' për sa plot me mall* dhe me përkushtim* rendin drejt tij dhe lëvdojnë* njeridashësin* Krisht që mbi të u mbërthye,* dhe marrin bekim dhe hir.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësore e Kryqit
Ting. IV Epefanis símeron

Është shkak hareje sot* dalja e Kryqit,* sepse shenjtëron shpirtrat* dhe trupat tanë tok, meqë* ne po i falemi me besim;* ky është dru shpëtimtar i të gjithëve.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Kanunet: e Kryqit, e shenjtorëve dhe e martires së virgjër.

Ode I
Kanuni i Kryqit që ka Akrostihidhë:
"Të gjithë e himnojmë drurin
që duhet t'i falemi". Poezi e Josifit.
Ting. Tërth. IV
Irmosi: Armatilatin Faraó

»Qëmoti e përmbyti Faraonin me ka»rrocat çuditërisht* shkopi moisiak* »kur në formë kryqi e goditi detin që »u nda;* Izraelin që ikte më këmbë, »ky e shpëtoi krejt,* ndaj një këngë »psalte për Perëndin'.[15]

Të gjithë Kryqit zotëror, jet'prurës me besim t'i falemi sot,* me mendim të pastër* dhe me predispozicion; ësht'

para nesh edhe dhuron* te sa vijnë pran' tij shenjtërim, ndriçim shpëtimtar, lavdi* edhe përdëllim bashkë me këto.

Jetëdhuruesi Kryq, duke qenë para nesh i shfaqur, lëshon* lavd me pamje drite,* hirin; ndaj le t'i afrohemi të marrim ne ndriçim,* ngazëllim tok, shpëtim, falje shkeljesh, duke i sjellë himn* dhe dhoksologji Perëndisë Zot.

Është përpara pamje mjaft e huaj për sa e shikojn', Kryqi pra,* druri i fortçmuar;* si burim nxjerr hiret shpirtërore dhe pushon çdo faj,* zgjidh sëmundje edhe përforcon etikën e njerëzve* që me shpirt i falen dhe sinqerisht.

Një shkop që priste det, simbolizonte mjaft trofeun që Kryqi ka;* ne me të lundrojmë* pa rrezik me bes' në ujin që s'ka qëndrueshmëri,*[15a] jetën, dhe evitojmë të gjitha rrymat e fajeve,* na mbush qetësia e hyjshme pra.

Kryqhyjlindësore

"O Biri im, u shmanga nga çdo dhembje, kur të linda pra pa shpjegim;* si tani e tëra* jam e mbushur me mundim, kur të shikoj të varesh keq* mbi dru si kriminel, ty që vare dheun që s'ka themel?",*[16] thoshte duke qar' e Dëlira krejt.

Kanuni i shenjtorëve.
Poezi e Andreas së Kretës.
Ting. I
Odhín epiníqion

Për ne ndërmjetoni gjithnjë të shpëtojmë të tërë, të Rinj, shenjt' të tërurtë; ligjërisht i ruajtët dogmat pra* që Moisiu dha, zilepsët vdekjen e Krishtit.

Kush pa, kush dëgjoi luftimet që shfaqën qëndrueshëm bijt' e Solomonës plot me forcë; ruajtën Ligjin pra,* ndërsa garonin me një shpirt, një mendje tok ata.

Kur gatishmërisht po nxitnin njëritjetrin, thërrisnin të shtatë bijtë shenjt' të Solomonës që kish nder: Të garojm'* krejt ligjshëm[17] për traditën atërore, të vdesim.

Hyjlindësore

Në bark kishe nxjerrë bistakun e pjekur pashprehshëm, u shfaqe pra hardhi jet'prurëse për Kishën e Krishtit ton'* dhe na dëfren të gjithë, nënë e Jisuit Zot.

Kanuni i martires së virgjër
që ka Akrostihidhë: "Psal unë
lavdinë e atletes së dëlirë. Ju."

Ting. Tërth. IV
Igrán dhiodhefsas

Porsi Isaaku ke lindur ti,* o Elesë, mburrje virgjërore, si nëna kish* një zbulesë qiellore[18] që tha:* U përdëlleve, të jesh me fëmijë pra.

Si shën Samueli që po ashtu* lindi me vullnet hyjnor, në jetë erdhe dhe ti;* dhe si Ana, nëna e tij, nëna* të përkushtoi te Zoti[19] ty gjithashtu.

A ka pra ndonjë që me saktësi* do të mundë të rrëfejë zellin dhe dashurin',* që ti kishe për Jisuin, Krishtin,* dhe i tregoje me lutje dhe agjërim?

Kryqhyjlindësore

Lavd je dhe e para e virgjër krejt,* dhe pas teje kori virgjëror nur u soll me nder* për në tempullin e tërëmbretit*[20] të kryqëzuar, Mari, mbretëresha jon'.

Zbritësore: Stavrón haraksas Mosís

»Një kryq vijosi me shkop* Moisi »profeti,* dhe Det' i Kuq u ça më dysh »dhe Izraeli shkoj përtej,* pastaj pra»që e bashkoj* me të njëjtin shkop »dhe kryq përsipër valëve,* dhe for»cat edhe qerret Faraonit ia mbyti; pra »Krishtin këndojmë si* Perëndi dhe »Zot[15] me brohori dhe gaz.*

Ode III
I Kryqit
Irmosi: O stereosas kat' arhás

»Ti që formove në fillim* me mençu»ri dhe mend qiejt,*[21] dhe mbi ujëra »bazove fort dheun,*[22] më mbështet »mbi gurin,[23] Krisht, të porosive që na »dhe,* o njeridashës, sepse* veç teje »tjetër të shenjtë s'ka.[24]

I falem Kryqit dhe po marr* të mirat mbarë krejt dukshëm;* me gaz tërë Gjithësia feston nur,* duke shndritur përmes Hirit të atij që përmbi të* vullnetarisht[25] u ngrit lart,* pra Perëndisë Krisht, Zotit ton'.

Duke shkëlqyer tërësisht* me llamburitjet e Kryqit,* me ndriçim, ne që i kemi besim pra,* le të shmangemi nga terri i mëkatit, duke thën'* me zë: O Zot i dhembshur,* drit' për të gjithë,[26] lavdi më ty.

Të përqafojmë me besim,* të përhimnojmë, o Kryq, ty,* dhe kërkojmë forcën tënde; çlirona* krejt nga kurthet e armikut[27] dhe drejt gjiri shpëtimtar* na udhëhiq të gjithë* ne që të psalim me shpirt dhe mall.

Kryqhyjlindësore

Sapo pa jetën[28] përmbi Kryq* që kishte vdekur, s'duronte* Virgjëresha,

kishte dhembje të brendshme,* ndaj e thjeshta tundej duke thirrur: Vaj, o Biri im,* çfarë të bëri turma* e të paudhëve që s'ka ligj?

I shenjtorëve:
Lithon on apedhoqímasan

Djem që kishit mbirë besërisht dhe u rritët bashkë* sipas Ligjit, duke u edukuar të gjith'* nga shën Eleazari,* vendimet e Antiokut mbret* krejt pra i shkelët në dhé,* ndërsa garonit ligjërisht[17] me zell.

"O tiran, nxito", thërrisnin Djemtë e Abrahamit,* "bëj ti çfarë do, mos na ki inat aspak më,* s'i bindemi hiç ligjit* që nxore, më shumë preferojm'* torturat dhe çdo mundim;* malli i Perëndisë na pushton".

"Prapa të mos mbetet sot askush në të mirën luftë,* të mos bëhet pre i maniakut, se dragoi*[29] i urtë është", nxitnin* kështu njëri-tjetrin shenjtët bij* të Solomonës së lum,* "le të mos bëhemi ushqim i tij".

Hyjlindësore

Në Sina, në mal, u paranjohe ferr' që nuk digjej,[30]* ndërsa Danieli të pa si mal të hijshëm,* nga ky u pre pa dorë,*[31] u pre Krishti i papreri kurr',* pra guri[32] i jetës son',* është një Bir prej teje, o Hyjnën'.

I martires së virgjër:
Uranias apsidhos

U kushtove te Krishti më shumë se tek yt at',* se kështu tha Zoti; sado na ka urdhëruar pra* t'i duam prindërit ne,*[33] por, kur ata na pengojnë,* kemi detyrim që ta duam më fort atë.[34]

Nëpërmjet dashurisë u bëre ti krejt e denj'* për Jisuin;[33] kori plot lavd i gjasht' virgjëreshave* si anëtare të ka;* në nusërore hyn, futesh* me të pestat vajzat e urta, të virgjra tok.[10]

Ëmbëlsia dhe hiri e mbushnin tejet me gaz* zemrën e shërbyeses sate, kur po dëgjonte kjo* pas vdekjes sate himnim* nga engjëjt edhe shikonte* drit' për dyzet ditë në varrin tënd virgjëror.

Kryqhyjlindësore

Lavdi ty të përket, Zonjë mbretëreshë, dhe nder;* ti je shembull për çdo të virgjër që dëshiron me ty* të vijë pas Birit tënd,* të rendë pra pas aromës* që lëshon ai,[35] i mbërthyer mbi dru për ne.

Zbritësore: Ravdhos is tipon

»Shkopi një herë si një simbol i mi»sterit na u shfaq,* se filizat na tre»guan priftërinë,*[36] edhe për Kishën

»beronjë ja ku mbiu edhe lulëzoj*
»Kryqi tani për forcë dhe për siguri.*

Kontaqi i Kryqit
Ting. IV O ipsothís en to stavró

Ti që u ngrite përmbi Kryq krejt me dashje,*[25] shtetit të ri të themeluar prej teje,* dhuroji kurdoherë hir, o Krisht Perëndi;* jepi popullit fuqi dhe gaz;* shtetit edhe të[37] gjithëve* fali mundje dhe triumf* në çdo luft' mbi armiqtë;* gjithnjë të paçim bashkëluftëtar, *armë për paqe, trofe që nuk mposhtet dot. (*)

Ndenjësore
E shenjtorëve
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Si u rritët, të Rinj fort të urtë ju,* me besim, turpëruat krejt burrërisht* në luft', në martirizim* kërcënime tirani mbret,* se ishit luftëtarë të Ligjit dhe shkuat tok* pas atit, dhe me nënën hyjmendëse bëtë gar';* ndaj fituat përmes vdekjes jetën në qiell* vërtet, ngazëlloheni* në amshim, shenjtë Makkabenj* me durim plot,* guxim në shpirt;* ndërmjetoni te Zoti Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tuaj të shenjt' me mall.

Lavdi *I martires së virgjër*
I njëjti To prostakthén mistikós

Sapo mbarove, të pritën me himnime,* me dritë engjëj,* se jetove me kreshmime* si pa mish pra në tokë,* me lutje pareshtur,* e ndezur në asketizëm prej dashuris'* së skajshme për Krishtin, Dhëndrin* fare pa cen;* ndaj kërcen brenda qiellores kish'[38] të mbretit[20] dhe në shkëlqimet e shenjtorëve;*[39] ty të lyp, na kujto atje.

Tani *I Kryqit*
Ting. Tërth. II

Kryqi yt, o Zot, u shenjtërua sepse me të bëhen shërime për ata që sëmuren në mëkate; me anën e tij biem para teje, mëshirona.

Ode IV
I Kryqit
Irmosi: Si mu iskís, Kírie

»Ti je, o Zot,* forca për mua, fuqia »je,* ngazëllimi* si dhe Perëndia im, »ti që s'e le* gjirin atëror*[40] dhe e vizi»tove mjerimin ton',[41] ndaj thërras te »ti* së bashku me profetin* Abakum: »Njeridashës,* lavd pushtetit, fuqis' »sate, Zoti im.

Ja tek shfaqet para Kryqi shpëtimtar, streha e fortë, rimëkëmbja e njerëzve, arma e paluftueshme e besimit; duke shenjtëruar, ndriçon me hir zemrat e të gjithëve që i afrohen besërisht.

O i Përmbimirë, duke qenë para, në mes të të gjithëve, ruajtësi i madh i shpresëplotëve, Kryqi i Çmuar, në të cilin u lartësove në mes të dheut[42] vullnetarisht, pra me dëshirë,[25] shenjtëron botën që i falet atij dhe dëbon kolonat e demonëve.

Qielli dëfren bashkë me tokën mbarë;[43] athloforë, martirë, apostuj, shpirtra të drejtësh tani ngazëllohen me hare, duke parë të jetë para, në mes, druri, dhurata e jetës, i cili i shpëton të gjithë dhe shenjtëron besimtarë me hir.

Kryqhyjlindësore

"Të linda, o Bir, nga mitra virgjërore; dhe, duke të parë tani të varesh në dru, çuditem dhe nuk konceptoj dot lartësinë e misterit dhe thellësinë e gjykimeve të tua të shumta", thërriste e Tërëkulluara, të cilën e lumërojmë me zëra të pareshtur si nënën e Perëndisë.

I shenjtorëve: En Pnévmati provlepon

Dëfre, o Eleazar, duke parë sot nxënësit e tu të hyjshëm të garojnë besërisht për ligje dhe urdhra atërorë, dhe të demaskojnë me fjalë të urta maninë e persekutorit Antiok.

Ngazëllohu, o Solomonë, duke parë të shtatë degët t'i pjekin tok frytet e Ligjit, nga të cilat, duke vjelë Kisha e paqortueshme, si nënë na ushqen përditë ne, trashëgimtarët e adhurimit në Hir.

Kërceni, o patriarkë, duartrokisni duke parë ruajtësit e Ligjit të luftojnë fort besërisht për adhurimin sipas Ligjit, dhe të sprovohen me lloj-lloj traumash, se mos ndoshta devijonin nga zakonet atërore.

Hyjlindësore

Të himnojmë, o Virgjëreshë, hyjnuse e thjeshtë, si hyjnënë dhe mur të besëmirëve; sepse ti e ngrite natyrën e rënë[44] dhe e përtërite ikonën,[45] duke lindur e vetme Perëndi, që është para Adamit.

I martires së virgjër: Isakíkoa Kírie

Argjendashja s'të kapi dot, o oshënare, ndonëse ati ishte i pasur shumë; ti pasuroheshe me virtyte, e dedikuar te dhënësi i të gjithave.

Veprove sipas fjalës zotërore, duke bërë lëmoshë sipas emrit tënd, o Elesë, dhe duke depozituar thesare në qiell, në amshim, ku nuk prishen kurrë.[46]

Ditë-natë nuk largoheshe nga kreshmët dhe lutjet e adhurimit[47] të të dashurit; kështu sikur u çmaterializove dhe je me të patrup në qiell.

Kryqhyjlindësore

I larti zbriti, i plotfuqishmi u zbraz,[48] i pushtetshmi u shfaq i dobët si foshnjë dhe si i kryqëzuar, o e Përmbishenjtë, që të më lartësojë, të më mbushë dhe të më forcojë.

Zbritësore: Isakíkoa Kírie

»Kam dëgjuar, o Zoti Krisht,* si e rre»gullove këtë mister të madh,* i kup»tova veprat që ke bër'* dhe të lav»dërova, Perëndia im.[49]*

Ode V
I Kryqit
Irmosi: Ina ti me aposo

»Pse, o Zot, më ke zmbrapsur* nga »fytyra jote,[50] o shkëlqim[26] pa perë»ndim?* Edhe u mbulova* un' i mjeri »prej territ të huaj krejt;* por, të lyp, »drejt dritës së porosive[51] që the, »kthemë* edhe udhët e mia drejtoji »ti.[52]

Brohoritni, o kombe, këndoni, kërceni dhe psalni, o fise, për Perëndinë[53] që na dha Kryqin si mbështetje të patundur. Me vënien e tij përpara, të tërë ne besimtarët ngazëllohemi duke shijuar të mirat nëpërmjet tij.

Të rrethojnë gjithë ushtritë mendore, o Kryq i tërëshenjtë, dhe ne vdekatarët, duke të prekur sot me buzë balte, nxjerrim me mallëngjim shenjtërim dhe bekim, duke e lavdëruar atë që u mbërthye në ty.

O Zot i dhembshur, shëroji pasionet kronike të shpirtit tim, dhe shpëtomë mua që i falem Kryqit tënd të çmuar; me fuqinë e tij çdo pengesë zmbrapset, dhe ne mbetemi të paprekur nga të këqijat.

Kryqhyjlindësore

Duke parë në Kryq atë që lindi prej teje përmbi mend nga mirësia, o e Tërëpaqortueshme, u trondite përbrenda dhe thoshe: Mjerë, o Bir hyjnor! Si vuan për të gjithë?[54] I falem dhembshurisë sate, o Zot.

I shenjtorëve:
Tin sin irinin dhos imín

O Krishtdashës, le të kemi zili të shtatë Djemtë, të cilët i ushqeu sipas Ligjit Moisiu dhe i ndihmoi Eleazari për përparim në ligjin atëror, me anën e fesë së mirë.

Të Rinjtë thërrisnin: Mos mendo, o Antiok, persekutues i besimtarëve, se zjarri yt, duke u ndezur, do t'na frikësojë; madje ther, o tepër i paudhë; pra, bëj çfarë të duash.

Të Rinjtë, martirët e qëndrueshëm të Krishtit, duke i thirrur njëri-tjetrit "Le

të garojmë ligjërisht”,[17] i siguronin dogmat e Moisiut, që të mos preknin ushqimet e fëlliqura.

Hyjlindësore

O Krisht, i vetmi i dhembshur, paqësona, sepse ty të përgjërohen nëna jote e pacenuar së bashku me shenjtorët që garuan për zakonet atërore dhe për Ligjin e Moisiut.

I martires së virgjër: Fótison imás

Në torturë e sipër, ti lavdëron Zotin me gëzim, ashtu si apostujt dikur, sepse gjithashtu e konsideron si gëzim vuajtjen për emrin e tij.[55]

“Ëndërr është toka, dhe të mirat e saj lule që vyshket[56] shpejt, ndërsa ai që bën vullnetin e Zotit mbetet përjetë”,[57] i thërrisje atit, o oshënare.

E tërëpasura Elesë, mohove atin tënd të pasur me gjëra të kota dhe të varfër në shpirt; dhe kështu gjete thesar në qiej,[46] i cili s’prishet.

Kryqhyjlindësore

Afër Kryqit, Perëndilindësja vajtonte duke thënë: Nga brinja jote e shpuar, o im Bir, buroi miro mendore; pas aromës sate vrapoi[35] Elesa.

Zbritësoret: O trismakáriston ksilon

»O dru i lumur tri herë, përmbi të cilin »u nde pra mbret i lartë Zoti Krisht,* »se prej teje u rrëzua djalli gjarpër,*[44] »i gënjyer tmerrësisht prej Zotit të »mbërthyer mbi kryq,* q’u fal shpir- »trave* përdëllim dhe paqe[58] për- »gjithnjë.*

Ode VI
I Kryqit
Irmosi: Ilásthití mi Sotír

»Jan’ shum’ mëkatet që kam,* ndaj »le të të vijë keq, o Zot, për mua; lu- »tem, më nxirr* nga fundi i vrereve, »sepse thirra fort te ti,*[59] dhe dëgjo- »më mua,* Perëndia i shpëtimit tim.

Kur Kryqi mbi dhé u ngul,* posht’ ranë demonët, dhe tani, duke e parë këtë* përpara të jetë me lavdi, po e puthim fort,* prej simptomash faji,* pra nga rëniet, çohemi me gaz.

Çlirohemi nga çdo tmerr* tani që po përqafojmë plot me gaz, hare, Kryqin tënd,* që na e dhurove si një mur të pathyeshëm;* edhe të himnojmë* ty, pra mbretin, Zotin, Perëndin’.

O njerëz, të vijmë pran’,* të nxjerrim ndriçim për zemrën, shpirtin; po qëndron para nesh* vet’ Kryqi i Zotit, edhe shihet që jep pra ky* te të gjithë Hirin* dhe dhuratat e mëdha, shpëtim.

Hyjlindësore

Forcona, o e Dëlir,'* të bëjmë kreshmim nga çdo e keqe, sigurona ti pra* gjithnjë të largohemi nga punët dinake[60] krejt* dhe nga ligësitë;* mbrojtje je për tërë njerëzit.

I shenjtorëve: Ton profitin Ionán

E ndërtoi urtësia e Zotit tempullin,* e mbështeti në shtat' shtylla[2] mendore, me logjikë, ruajtës* të Ligjit, Djemtë i parashkroi pra.

Solomona plot urti lindi Shtatë djem, bij pra,* dhe i rriti mirë Eleazari dijetar; hyjnori Hir,* kur me fuqi luftuan, u dha kuror'.

Antiokut i thot' vargu me shtatë degë tok,* duke qenë mes torturash: Ti, o gjykatës, pse vonon? Ndëshko,* ther edhe bëj shpejt çfarë mendon dhe do.

Hyjlindësore

Si një bir, që atë nuk e kish mbjell', e linde ti,* dhe si mbete e dëlirë, siç ishe para lindjes? Zoti di,* që bën gjithçka ashtu siç pra do ai.[61]

I martires së virgjër:
Tin dhéisin ekheó

Të thyen keq* dhëmbët ati yt me gur',* se s'duron që të pohosh Krijimtarin;* por ti kështu* thyen dhëmbët e gjarprit* që e kafshoi qëmoti stërnënën ton'*[44] edhe na hodhi mizorisht* brenda barkut të Hadhit porsi ushqim.

Lavdi ti ke* para Atit qiellor,* se te ky të ka pohuar Jisui,* sepse më par'* e pohove te njer'zit,*[62] ndaj të himnojnë dhe engjëj, se tok me ta* i psalje Perëndisë pra,* dhe kur s'kishe më dhëmbë në gojë ti.

E ngrite lart,* ngjalle pra të vdekurin,* të helmuarin prej gjarprit, se s'ishe* në gjendjen pra* të Adamit pas rënies,*[44] por më përpara, përmes bindjes te Krishti;* dragoi[29] s'të mashtroi ty,* kishe forcën që dha Zoti fillimisht.

Kryqhyjlindësore

Të psalim ty,* o Perëndilindëse,* kryetare e virtytit të shenjtë;* të kemi ne* ngushëllim në trishtime,* se je e dhembshur dhe di ç'është vuajtja,* sepse pësove rëndë ti,* kur të shpoi shpat' zemrën[63] në kryqëzim.

Zbritësore: Notiu thirós en splahnis

»Në barkun e bishës në det, profeti »shën Jona kish hapur duart në form' »kryqi* dhe pësimin e Krishtit para»tregonte qart'sisht,* pra i triditshmi »jasht' u hodh[64] dhe ngjalljen e për»mbinatyrëshme e paralajmëroj* të

»Jisujt[65] të mbërthyer përmbi Kryq për »ne,* që na e ndriti Krijesën me ngri»tjen prej varreve.*

Kontaqi
Ting. II Ta ano zitón

O ju të tërurt',* të shtatë shtyllat e urtis'*[2] së Zotit, kandil* me shtatë drita[66] prej Hyjnis',* Makkabenj martirë aq të mëdhenj përpara dëshmorëve,* lypni tok me ta Perëndin'* e çdo gjëje, të shpëtojmë sa ju himnojm'.

Shtëpia

O Sion, lavdëroje nxehtësisht Perëndinë tënd, sepse me të vërtetë i përforcoi shulat e portave të tua dhe i bekoi bijtë e tu;[67] sepse ata, si ushtri triumfuese, kolonë vërtet trimëreshë dhe me moral të lartë, rezistuan hyjmendërisht kundër intrigave të besëkëqijve. Meqë shijoni kurorat fitimtare të Sionit qiellor[68] dhe jeni pranë fronit hyjnor,[69] duke përgjëruar pa pushim për të gjithë, kërkoni që të shpëtojmë sa ju himnojm'.

Sinaksari

Muaji gusht, që ka 31 ditë. Dita ka 13 orë dhe nata 11 orë.

Më 1 të të njëjtit muaj, Dalja e Kryqit të Çmuar dhe jetëbërës, kujtimi i Shtatë martirëve të shenjtë Makkabenj: Avimi, Andoni, Juriu, Eleazari, Efsevonai, Ahimi dhe Markeli, si dhe i nënës së tyre Solomona dhe i mësuesit të tyre Eleazari.
Vargje: Para Krishtit, Eleazari, duke pranuar i pari zjarr,/ vuri para të tjerëve gjurmë atletizmi.
E kam triumfuese të parë dhe para Theklës/ Solomonën, të cilën e flakëron zjarr para Krishtit.
Vegla shtrembërimi, zjarr dhe rrota e dërgojnë/ shtatëshen e djemve nga e shtata drejt të së tetës.
Në të parën, dogjën Solomonën dhe shtatë bijtë e saj.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënares martire Elesa, që garoi në ishullin e Kithirës.
Vargje: Kurthi u dërrmua dhe ti shpëtove,[69a] duke u ngjitur/ e bardhë, e lulëzuar[69b] nga shkretia[69c] e Kithirës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i Nëntë Martirëve të shenjtë, që garuan në Pergë të Pamfilisë: Leondini, Ati, Aleksandri, Kindheu, Mnisitheu, Qirjako, Mineu, Katuni dhe Efkleu.
Vargje: Nëntëshja nga Pamfilia u pre me shpatë,/ duke kërkuar një fis, atë të martirëve.

Në të njëjtën ditë, shën Papa i Ri, mbaron pasi u fut në thes, u mbyll në shportë dhe u hodh në det.

Vargje: Thesi fshehu Papën, dhe shporta thesin, dhe rryma shportën;/ dhe Papa është afër Perëndisë.[69]

Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë Eleazar, mbaron pasi u flakërua në kokë.
Vargje: Eleazari, kur u dogj në kokë, iku/ duke u bërë më i fortë se rryma shpirtdëmtuese.

Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë Qiriku mbaron me shpatë.
Vargje: Kur xhelati tha: "Nuk do të pritesh nëse do të flijosh",/ Qiriku, duke përkulur kokën, tha: "Nuk flijoj".

Në të njëjtën ditë, martiri i shenjtë Theodhori mbaron me shpatë.
Vargje: Theodhorin e sulmon një mall hyjnor,/ të arrijë dhurata të dëshirueshme përmes shpate.

Në të njëjtën ditë, shën Poliefkti mbaron pasi u fut në pleh kafshësh.
Vargje: Poliefkti e kishte si ndëshkim/ katedrën e Jovit, pra them plehun.[70]

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Mini, Mineu edhe të tjerët në Viglendi, afër katër Portave të bakërta.
Vargje: Mini, duke pasur tani si bashkëbanues Mineun,/ banon atje ku nuk ka fare mani.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorë Timothe Çudibërësi, episkop i Prokonisit (ose Prikonisit).
Vargje: Timotheun, flijuesin e Prokonisit, Perëndia e nderoi më parë,/ por e nderon dhe tani me mrekullibërje.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
I Kryqit
Irmosi: Theú sigatávasin

»Dikur zjarri kishte turp* në Babilo»në, kur bashkëzbriti pra Zot,*[71] bre»nda furrës, ndaj Djemtë* si në lëndi»në me këmb' të lumura fort* kërce»nin pra duke psalur: O Perëndi* dhe »Zot i etërve tanë, i bekuar je ti.[72]

Ai që është përtej moteve, tregohet në kohë i veshur me mish, dhe shëron nga mirësia njëkohësisht pësimet tona kronike të trupit si dhe të shpirtit; dhe tashmë na shenjtëron me anën e Kryqit të tij të hyjshëm.

Himnojmë, lavdërojmë, madhështojmë dhe i falemi pushtetit tënd, o Zot, sepse na dhe neve, shërbëtorëve të tu, Kryqin e hyjshëm, si shijim të pasosur dhe ruajtës të shpirtrave dhe të trupave tanë.

Në ditën e shqyrtimit, mos më trego, o Zot, të dënuar për shkak të këqijave; mos më hidh të turpëruar larg fytyrës sate,[73] por le të të vijë keq, shpëtomë

si i përmbimirë me Kryqin tënd të çmuar.

Hyjlindësore

Ngushtësinë e mendjes sime zgjeroje me ndërmjetimin tënd, o Zonjë që ngushtësove tërë intrigat e armikut; dhe përmes udhës së ngushtë[74] më përcill që të ec unë drejt gjerësisë[75] së jetës, o nënë e Perëndisë.

I shenjtorëve: Tus en kamino

Zelltarët e Ligjit atëror, ruajtësit e paepur me një mendje të traditës, pohonin me plot besim një Perëndi, duke e bashkuar besërisht dhe duke e ndarë me shpresëtari në tri hipostaza.

Martirët i thërrisnin gjykatësit mashtrues: Pse këmbëngul pra, o tiran? Ne pohojmë një Perëndi, dhe kemi atdhe Jerusalemin e sipërm,[68] që na rriti ne.

Thonë: Nuk do të hamë të molepsurat, nuk do të flijojmë, as nuk do të gjunjëzohemi në tokë; ne pohojmë përherë një Perëndi edhe ia kemi frikën atij, nga i cili u bëmë dhe drejt të cilit rendim.

Hyjlindësore

Gëzohu, o e Tërëhimnuar, muri dhe ngazëllimi i të gjithëve; gëzohu, shpresa e anëve të dheut; gëzohu, bukuria e vdekatarëve dhe hijesia e engjëjve, o e pacenuar; sepse ti kishe në mish gjatë shtatzënisë Perëndinë e vetëm.

E martires së virgjër: I ek tis Iudheas

E varur nga flokët, u shkëpute nga toka dhe, duke mbajtur plagë[76] prej atit si e stolisur me medalje të shkëlqyera, u ngjite në mbretërinë e qiejve, duke thirrur: Të gjitha ju, o veprat e Zotit, himnojeni Zotin.[77]

S'kishe fuqi fizike, si vajzë e dobët, mirëpo e turpërove me rezistencë atin tënd të fuqishëm; sepse kishe mbrojtje Krishtin, o Elesë, duke psalur: Të gjitha ju, o veprat e Zotit, himnojeni Zotin.[77]

S'kishte njerëz në ishullin ku asketizove, o oshënare, por shenjtërimi yt si magnet tërhoqi shumë besimtarë, që mbetën në vendin tënd, duke e popullluar dhe duke psalur: Të gjitha ju, o veprat e Zotit, himnojeni Zotin.[77]

Kryqhyjlindësore

Është e denjë të të falënderojmë,[78] o Hyjnënë, se mitra jote u bë enë e Hyjnisë; dhe kështu u tregove më e gjerë se qiejt, duke mbajtur Krishtin që u kryqëzua, për të cilin thërrasim: Të gjitha ju, o veprat e Zotit, himnojeni Zotin.[77]

Zbritësore: Éknoon próstagma

»Urdhër të çmendur dha tirani besë-
»lig, e tundi popullin,* botën e tmerroj
»me blasfemi dhe paudhësi,* po të tre
»Djemat nuk i tronditi dot*[79] tërbimi i
»egër as furra me zjarr,* dhe kur po
»frynte era vesëprurëse,[71] këndonin
»brenda mu në zjarr:* I përhimnuar je,
»Perëndi dhe Zot i madh,* përjetë i
»bekuar.[72]*

Ode VIII
I Kryqit
Irmosi: Eptaplasios káminon

»E dogji furrën shtatë her'* në Kalde
»një tiran i saj* me mani për Djemtë*
»që nderonin Perëndi;*[80] por, kur të
»shpëtuar krejt* i pa nga një fuqi më
»e fort',* thirri ky kështu:*[80a] Po Çli-
»rimtarin Ndërtues,* o Djem ju, ta be-
»koni;* [72] priftërinj, ta himnoni;*[81] ju
»popull, lartësojeni pra për gjithë jetët.

Dikur Eliseu i hyjshëm nxori jashtë lumit hekurin përmes një druri,[82] duke të paraikonizuar nga larg, o Kryq i tërërespektuar; sepse nga fundi i mashtrimit, pasi u ngritëm përmes teje në besim të sigurt, sot denjësohemi të të shikojmë, dhe të të falemi besërisht në gjithë jetët.

Jakovi të sinjalizon tepër fort nga larg në bekime,[83] o Kryq i tërërespektuar, ndërsa ne që në hir u denjësuam të të shikojmë, vijmë afër të gjithë me besim, pa ngurrim; dhe psalim duke vjelë pasurisht bekim, dritë, shpëtim dhe zgjidhje shkeljesh.

Duke u veshur me të bardha përmes veprash të virtytshme, le të vijmë me ngazëllim[84] pranë Krishtit, duke thirrur: O Zot i tërëmirë, nëpërmjet Kryqit tënd të hyjshëm e të tërëlartë, ngrina bririn neve, popullit tënd[85] që ka emrin tënd, të Krishtit, që të himnohet pushteti yt besërisht dhe me paqe të thellë në gjithë jetët.

Kryqhyjlindësore

"Tani, duke të parë të varesh si një qengj pa të keq,[86] dhe të gozhdohesh në Kryq nga të paudhët, o Biri im i parapafillim, vuaj nga vajet dhe vështirësohem prej dhimbjeve nënore", thërriste e Tërëdëlira, të cilën e himnojmë hyjmendërisht me zëra të paheshtur në gjithë jetët.

I shenjtorëve: Ton en sofía

Na vezullojnë me rrezet e arritjeve ndriçuesit mendorë, ruajtësit e zakoneve atërore dhe shpallësit e urdhrit të Moisiut, që feksin në botë si shtatë yje.[87]

Ata që dolën të shkëlqyer sipas Ligjit të Perëndisë dhe turpëruan dekretet e Antiokut, thërrisnin guximshëm: Ne,

o Antiok, as bisha, as shpata, as zjarr, as fshikullime nuk do të na ndajnë fare nga Perëndia.[88]

Ata që e zbukuruan fronin e Moisiut dhe i ruajtën kanunet atërore, duke shkëlqyer në botë si shtatë yje,[87] i errësuan kështu yjet, planetët, pasi u hijeshuan me besimin.

Hyjlindësore

U dallove, o Mari, si thesari i mirëdashjes atërore, shtëpia e pranisë së Birit dhe banesa e Shpirtit të Shenjtë, duke ikonizuar në veten tënde shfaqjen e Trinisë.

I martires së virgjër:
Ton vasilea ton uranón

Dëfre, o vajzë e pastër, Elesë famëmadhe; u shpërngule nga vendi yt në vend të shkretë, që të ishe më afër shoqërisë së Krishtit, pa shpërqendrime.

Ëndje shkaktohet nga arritjet e tua asketike; u bashkove me Dhëndrin që nga këtu, dhe përsosmërisht në qiell, ku ndërmjeton të vijmë dhe ne.

Le të kërkosh nga i Tërëmiri të na mëshirojë, që të shpërngulemi dhe ne nga vendi ynë i përkohshëm te vendi i ardhshëm[89] që mbetet, ku shkëlqen me lavd.

Kryqhyjlindësore

I panxënshmi Zot, u kufizua në barkun tënd, o e Tërëshenjtë, që të më nxjerrë nga gropa e mëkatit në gjerësinë[75] e qiellit përmes Kryqit; të himnoj me mirënjohje.

Zbritësore: Evlojite Pedhes

»E bekoni Djema,*[72] si Trinia nga nu»mëri, Atin q'ellor, të vetëmin Zot,* »himnoni* Fjalën që mbi dhenë zbri»ti*[90] dhe e bëri vesë zjarrin e furra»ve,*[71] dhe e lartësoni ju Shpirtin e »Tërëshenjtë,* që u dhuroi që të gjith'»ve jetën.*

Ode IX
I Kryqit
Irmosi: Eksesti epí tuto

»U shtang dhe u shastis qielli me »të,*[91] u habitën dhe anët e botës »mbar', se Perëndi* trupërisht u duk[92] »te të vdekshmit ne* dhe, Zonjë, bar»ku yt u bë* më i gjerë se qiejt, se »çdo vend;* Hyjlindëse e Virgjër,* rre»shtimi engjëllor si* dhe njerëzor të »madhështojnë ty.

I Tërëmir', shërove dërrmimin tim,* kur dikur të mbërthyen me gozhdë tmerr, o tërëmbret,* këmbët, duart mbi Kryq dhe shpuan keq* dhe brinjën tënde, si të dhan'* uthull edhe vrer ty

pra, gazi im,* hareja për të gjithë,* lavdia, ëmbëlsia* si dhe çlirimi i përjetshëm[93] tok.

I bukur më shum' se ari me safir,*[94] Kryq hyjnor, dhe i ndritshëm si dielli, je në një vend,* pra përshkruhesh qartë, por përgjithnjë* rrethohesh dukshëm prej ushtrish* që janë mendore, edhe shkëlqen* me rrezet e fuqisë* së hyjshme tërësitë* e sferës mbarë me lavdi dhe hir.

Mbështetje për të humburit dhe drejtor,* dhe për të dimëruarit port është Kryqi i shenjt',* lavd për Krishtin, forcë atletësh tok,* pushtet apostujsh, profetësh,* për të tërë është përikje pra;* të gjithë, duke parë* atë në mes të jetë,* ta puthim me devotshmëri dhe mall.

Kryqhyjlindësore

"Nga barku atëror para jetëve* linde,[95] dhe un' të linda pa prishje krejt dhe si, o Bir,* ty të shqyen njerëzit prishës keq* dhe brinjën tënde shpojn' me shtiz'* edhe të mbërthejnë aq çnjerëzisht* dhe duart si dhe këmbët?", thërriste e Dëlira,* të cilën madhështojmë denjësisht.

I shenjtorëve: Tin fotoforon nefelin

Fëmijët e Solomonës,* zelltarët e Moisiut,* që mir' u rritën sipas Ligjit dhe vdiqën për Ligjin,* nxënësit e Eleazarit, kur zhvareshin, thërrisnin: Antiok,* pse vonon, pse ngurron dhe pse s'vepron pra* sa mendon ti kundër nesh?

Përbuzën krejt marrëzinë* e Antiokut ushtarët* e Ligjit, pra garonin fort në tortura me plot zell,* zili për njëritjetrin, nxitnin veten e tyre dhe vraponin shpejt* të rrëmbenin mundimet edhe çmimet,* vdekjen dhe jo jetën pra.[96]

Si pra në Olimpiadë* fituese, Solomona,* me trimëri dhe burrëri, kur pa bijtë të therur,* nuk u lëkund në shpirt, porse thërriste: O Antiok, dëgjo, më shto* mua bashkë me bijtë, nëse ka hir* në armiq, qoftë disi.

Hyjlindësore

E Virgjër, thuaj si lind ti* dhe si del qumësht nga gjinjtë,* si mënd ushqyesin e botës, e linde pa atë,* i cili ish pa nënë lart, i vetmi nga Ati[97] Zot, na thuaj si?* Si ai di, si deshi mirësisht pra,* po kështu u bë çdo gjë.

I martires së virgjër: Kirios Theotokon

Rastisi, oshënare* dita jote, festa,* me panairin e Kryqit që aq deshe ti;* për Krishtin tënd që mbi të u var, hoqe çdo mundim.

Ësht' nder për ne të thurim* lavdërim për ty, himn;* lyp, ndërmjeto që të kemi disi trimëri,* ta kemi shembull kushtimin dhe heroizmin tënd.

Je tashmë në hare, gaz* si e parëlindur*[98] në qiell nëpër shkëlqim, shenja pra për këtë* ish drita pas vdekjes, se dhe jetën e kishe drit'.

Kryqhyjlindësore

U shfaqe shpëtimtare* përmes ndërmjetimit* te Biri yt fort i mir', se arriti për ne* deri në Kryq,[99] Zonjë; Shpëtimtari i vetëm ësht'.

Zbritësore: Mistikós i Theotoke
dhe
O dhiá vróseos tu ksilu

»O Hyjlindëse, parajsë mistike je,* »se pa lërim lulëzove Zotin Krisht,* që »mbolli përmbi dhé jetëprurësin Kryq* »që po lusim me besë,* se ky po lartë»sohet* dhe me anën e tij të madhë»shtojmë sot.*

»Mallkim i vjetër i stërgjyshit,*[100] që »rrodhi prej helmimit të gjarpërit,*[44] »e shkatërroi Kryqi i[101] Zotit Krisht, »bekimi erdhi prapë për njerinë me »Mari Hyjlindësen,* që na lindi Jisunë »Çlironjësin, të gjitha pra fuqitë e lav»dërojnë në qiellin.*

Dërgimësore

E shenjtorëve:
Ton mathitón oronton se

Le t'i himnojmë bijtë e Solomonës* dhe të Eleazarit, pra Makkabenjtë;* kanë zëmëdhenjt' kuror', se hodhën tej* tmerr, tërbim të dragoit djall,*[29] që nga fillimi i keq ësht';*[102] dhe adhuronin pas Ligjit.

E martires së virgjër E ngjashme

Elesa, oshënare, martire ka lavd,* me dy kurora drite e zbukuruar:* një për garë, tjetër për asketizim,* se Perëndia pra na dha* jo frymë frike, por force* me dashuri,[103] mençuri tok.

E Kryqit E ngjashme

Për Kishën tonë është stolisje Kryqi,* rojë i tërë kozmosit është Kryqi,* plagë për demonët është Kryqi pra,* engjëjt e kanë Kryqin lavd,* mbretër e kan' Kryqin forcë,* edhe besnikët mbështetje.

8 Lavdërime
Të Kryqit
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Të bërtasim me brohori,*[104] të këndojmë melodikisht,* duke puthur Kryqin e Çmuar, dhe atij* le t'i thërrasim: O Kryq i tërëlumur, na shenjtëro* me fuqinë tënde ti* shpirtrat, trupat; dhe ruajna* ne që besërisht* po të

falemi, nga çdo lloj dëmtimi, nga armiqtë, kundërshtarët, nga gjithë plagët dhe traumat.

Këtu ejani, nxirrni ju* rrjedha Hiri që s'kan' mbarim,* që prej Kryqit dalin, se ja përpara nesh* drurin e shenjtë e shohim ne të gjithë; burimi pra* plot karizma është ky* që vaditet me ujë, gjak* që i rrodhi posht'* Krishti[105] Zot i të gjithave që mbi këtë u ngrit vullnetarisht dhe na lartësoi ne njerëzit.

Kryq, për Kishën je bazament,* dritë dhe lavd për murgjit mbar',* o i fortnderuar, shpëtim dhe krenari* për priftërinjtë; të falemi, kështu marrim sot shkëlqim* si në zemër dhe në shpirt* përmes Hirit të shenjt', hyjnor,* të Jisuit Zot,* që mbi ty u gozhdua dhe vithisi çdo pushtet të tinëzarit dhe zhduku nëmën e lashtë krejt.[106]

Të shenjtorëve Idhiomele
Ting. I

Nëna e shumëvuajtuar triumfuese, duke thirrur bashkë për luftëra djemtë e saj, thoshte: "Ndiqni thinjat abrahamiane, që të kungoheni me therjen e Isaakut".[107] Por ata paraprinin atë që udhëzonte, përcillnin atë që këshillonte kur shikonin tortura për ndëshkimet njëra pas tjetrës. Me uratat e tyre, o Perëndi, mëshirona.

Ting. IV

Shtatë shtylla[2] të zgjedhura, që u latuan nga një gur me arsye, e treguan të palëkundshëm pirgun e Ligjit. Me anën e tyre bëje me mirëdashje, o Shpëtimtar, që të ruhen në paqe shpirtrat tanë.

Ting. Tërth. I

Ruajtësit e Ligjit, bijtë e Solomonës, duke garuar në stadium, thërrisnin drejt Antiokut: Ne, o Antiok, durojmë për hir të ligjeve atërore; nuk do të na ndajë as zjarr, as shpatë, as bisha, as kamxhikë,[88] por do të vdesim së bashku, tok me nënën plakë dhe mësuesin atë, duke jetuar dhe duke u ngazëllyer tok në jetë pa mbarim.

Të martires së virgjër
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Varg: Duke duruar, durova duke pritur Zotin dhe më vuri re.

Asketizmi, o virgjëresh',* kishte prishur njeriun tënd* të përjashtëm, mirëpo përtëriti nur* të brendshmin;[108] dhe, kur në fund u vra i jashtmi nga ati yt,* nuk u vrave, siç na tha* Zoti ynë,[109] dhe provë jan'* mrekullit' që bën;* përgjërohu që, sipas emrit tënd, të përdëllehemi dhe ne, athlofore plot lavd edhe me nam.

Varg: Dhe siguroi mbi gur këmbët e mia dhe drejtoi hapat e mi.

O Elesë e tërëlum,* e kënduar kudo me lavd,* famëmadhe, vajzë e pastër mençurisht,* në nusërore në qiell, tok me Dhëndrin[10] e frymëve* ngazëllohesh ti pa cen,* e panjollshme; ndaj na kujto* kur tani mbarojm'* himnin tënd, që dhe ne të gjejmë forcë shpirtërore, dhe në gjyq pra në fund mëshirë të madhe,[110] hir.

Lavdi *I shenjtorëve*
Ting. IV

Ejani, o besnikë, të shohim luftën e ngritur kundër Makkabenjve si dhe burrërinë e tyre; sepse një mbret tiran, ndonëse pushtoi tërë kombet, mbizotërohej në të kundërt nga një plak, shtatë të rinj dhe një grua. Prandaj, me uratat e tyre, o Perëndi, mëshirona.

Tani *I Kryqit*
I njëjti

O Zot, që bëre aleancë me Davidin tepër të butë,[111] që të nënshtronte të huajin,[112] lufto së bashku me mbretin tonë besnik, dhe me armën e Kryqit vithisi armiqtë tanë; o i dhembshur, trego te ne mëshirat e tua të lashta[113] dhe le të njohin me të vërtetë se ti je Perëndi, dhe se, duke pasur besim në ty, fitojmë kur ndërmjeton si zakonisht nëna jote e pacenuar, që të na dhurohet përdëllimi i madh.[110]

Dhoksologjia e Madhe dhe, pas plotësimit të saj, bëhet Hyrje me Kryqin e Çmuar dhe pastaj falja e tij sipas rendit të së Dielës së Tretë të Kreshmëve të Mëdha. Kur bëhet falja, psalim këtë Idhiomele:

Ting. II

Ejani, o besnikë, le t'i falemi drurit jetëbërës, në të cilin Krishti, mbreti i lavdisë, duke i shtrirë duart vullnetarisht, na lartësoi te lumërimi i lashtë ne që më parë armiku, duke na vjedhur përmes kënaqësisë,[44] na ka bërë të jemi të internuar larg Perëndisë;[114] ejani, o besnikë, le t'i falemi drurit, nëpërmjet të cilit u denjësuam t'i dërrmojmë krerët e armiqve[115] të padukshëm. Ejani, të gjitha fiset e kombeve, të nderojmë me himne Kryqin e Zotit. Gëzohu, o Kryq, që je çlirimi absolut i Adamit të rënë;[44] më ty mbretërit tanë tepër besimtarë mburren, se me forcën tënde nënshtrojnë me fuqi popull ismailit; të krishterët, duke të puthur tani me frikë, lavdërojnë Perëndinë që u gozhdua në ty, duke thënë: O Zot, që u kryqëzove në të, mëshirona si i mirë dhe njeridashës.

Dhe të tjera si zakonisht dhe Përlëshorja: O Zot shpëtoje popullin tënd. *Në Liturgji, [Tipiket dhe nga Kanunet, Ode III e Kryqit dhe Ode VI e Makkabenjve ose] Antifonet e së Dielës së Tretë të Kreshmëve të Mëdha. Pas Hyrjes, Përlëshoret: E Kryqit, e shenjtorëve, e martires së virgjër dhe e kishës. Kontaqi* Ti që u ngrite *(kërkoje pas Odes III). Në vend të Trishenjtit,* Kryqit tënd i falemi, o Zot, dhe ngjalljen tënde të shenjtë e lavdërojmë. Të meriton. *Kungatore* U shënua mbi ne drita e fytyrës sate, o Zot. Aliluia. Pamë dritën.

CITIME

[1] I Kor. 12.9,28
[2] Fja. Urt. 9.1
[3] Lluk. 16.22
[4] Ligji i Dytë 6.5; Matth. 22.37; Mark. 12.30; Lluk. 10.27
[5] Eks. 17.12-13
[6] Ps. 98(99).5
[7] Lluk. 23.39-42
[8] Ef. 6.4
[9] Kënga 8.5
[10] Matth. 25.1-12
[11] Ligji i Dytë 28.66
[12] Ps. 150.5
[13] Ps. 73(74).12
[13a] Fil. 1.29
[14] Ps. 27(28).9
[15] Eks. 14.15-15.21
[15a] Ps. 123(124).4-5
[16] Jov 26.7
[17] II Tim. 2.5
[18] Gjen. 18.10; Rom. 9.9; Gal. 3.18; 4.23
[19] I Mbret. [Sam.] 1.5-28
[20] Ps. 44(45).15-16
[21] Ps. 32(33).6
[22] Ps. 135(136).6
[23] Ps. 39(40).3
[24] I Mbret. [Sam.] 2.2
[25] Matth. 16.23; 20.18; Mark. 8.31; 10.33-34; Joan 18.11
[26] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[27] Ps. 30(31).5
[28] Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
[29] Apok. 12.3-17; 13.2-4; 16.13; 20.2
[30] Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
[31] Dan. 2.34-35
[32] Ps. 117(118).22; I Pjetr. 2.3-4
[33] Eks. 20.12; Ligji i Dytë 5.16; Sirak 3.3,8; I Tim. 5.8
[34] Matth. 10.34-37
[35] Kënga 1.4
[36] Num. 17.16-28; Hebr. 9.4
[37] Ps. 20(21).2
[38] Apok. 11.19; 14.17; 16.17
[39] Ps. 109(110).3
[40] Joan 1.18
[41] II Kor. 8.9
[42] Ps. 73(74).12
[43] Ps. (95(96).11; Is. 44.23; 49.13
[44] Gjen. 3.1-7
[45] Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
[46] Matth. 6.19-21; Mark. 10.21; Lluk. 12.33-34; 18.22
[47] Lluk. 2.38
[48] Fil. 2.7
[49] Abak. 3.1-2
[50] Ps. 42(43).2; 73(74).1
[51] Fja. Urt. 6.23
[52] Ps. 5.9, 118(1119).5
[53] Ps. 65(66). 1-3
[54] Joan 11.50; 18.14
[55] Vep. 5.41

[56] Jak. 1.11
[57] I Joan 2.17
[58] Lluk. 24.36; Joan 14.27; 20.19,21,26; Gal. 1.3; Ef. 2.17; II Thes. 3.16
[59] Jona 2.2
[60] I Thes. 5.22
[61] Ps. 113(114).11; 134.6; Jov 23.13; Urt. Sol. 12.18; Mark. 1.40
[62] Matth. 10.32; Lluk. 12.8
[63] Lluk. 2.35
[64] Jona kap. 2
[65] Matth. 12.40
[66] Eks. 25.37; 38.17 [37.23]; Num. 8.2
[67] Ps. 147.1-2
[68] Gal. 4.26
[69] III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
[69a] Ps. 123(124).7
[69b] Kënga 8.5
[69c] Kënga 3.6
[70] Jov 2.8
[71] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
[72] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,27-28
[73] Ps. 50(51).13
[74] Matth. 7.13-14
[75] II Mbret. [Sam.] 22.20; Ps. 17(18).20; 118(119).45
[76] Gal. 6.17
[77] Ps. 102(103).22; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[78] II Thes. 1.3
[79] Dan. 3.4-12
[80] Dan. 3.19-22
[80a] Dan. 3.31-33
[81] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[82] IV [II] Mbret. 6.5-6
[83] Gjen. 48.14-15
[84] Ps. 99(100).2
[85] Ps. 148.14; Sirak 47.5
[86] I Petr. 1.19
[87] Fil. 2.15
[88] Rom. 8.35
[89] Hebr.13.14
[90] Dan. 3.25
[91] Jer. 2.12
[92] Kol. 2.9; I Tim. 3.16
[93] Hebr. 9.12
[94] Ps. 118(119).127
[95] Ps. 109(110).3
[96] Fil. 1.21
[97] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[98] Hebr. 12.23
[99] Fil. 2.8
[100] Gjen. 3.19
[101] Gjen. 3.16
[102] I Joan 3.8
[103] II Tim. 1.7
[104] Ju 14.9
[105] Joan 19.34
[106] Gjen. 3.16-19
[107] Gjen. 22.1-12
[108] II Kor. 4.16
[109] Matth. 10.28; Lluk. 12.4
[110] Num. 14.19 etj.
[111] Ps. 131(132).1
[112] I Mbret. [Sam.] 17.4-51
[113] Ps. 88(89).50
[114] Gjen. 3.24
[115] Gjen. 3.15; Ps. 67(68).22

MË 2 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i Transferimit të lipsanit të shën Stefanit, kryedhjak dhe martir i parë.

Tipikon

Nëse bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të martirit (3 të parat, duke përsëritur të parën). Lavdi i martirit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i martirit. Tani ngjallësor (në Tingullin e Lavdisë, si zakonisht, pra)* Zoti Krisht bërësi. *Përlëshoret: ngjallësore, e martirit dhe Hyjlindësorja ngjallësore* (Misteri i fshehur).

*Të dielën në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe i martirit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e martirit, dhe Ndenjësoret e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret e Metamorfozës (*I shenjt' Izrael); *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore dhe të martirit. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të martirit (në dy të fundit, me Vargje a:* I drejti si palmë do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet. *b:* I mbjellë në shtëpinë e Zotit, në oborret e Perëndisë do të lulëzojë). *Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e martirit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e martirit dhe e kishës. Kontaqi Përmbi malin ndrove fytyrën. *Apostulli i martirit dhe Ungjilli i së dielës. Kungatore e së dielës.*

NË MBRËMËSORE

Thirrtore
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Përmes Hirit të Shenjtit Shpirt* u ndriçove në mendje ti* dhe u duke engjëll nga pamja, o Stefan;*[1] sepse shkëlqimi i brendshëm u përhap nëpër trupin tënd* dhe lavdin' e shpirtin tënd* u zbulonte shikuesve,*[1] ke arritur pra* të kesh shfaqjen e dritës, kur u çelën për ty qiejt,[2] o fillim edhe krenari e martirëve.

Porsi shkallë për ngjitjen lart,* për në qiell, u bë për ty* breshëri e fort' gurësh,[3] mbi të cilët pra* je ngjitur dhe ke soditur Zotin ton' që qëndronte pran',* në të djathtë të Atit,*[2] dhe të jepte kurorë ty* sipas emrit tënd* me të djathtën e tij; dhe pranë tij ti

po qëndron[4] si bukurmundës, si majë, kulm i atletëve.

Duke shndritur me mrekulli,* me çudi[5] edhe dogma bashk',* shove tër' Këshillin[6] e të paligjve, shenjt,* duke u vrarë prej tyre përmes hedhjes së gurëve*[3] tek po luteshe për ta,* pra për faljen e vrasësve;*[7] imitove ti* kështu zërin e Shpëtimtarit tënd,[8] në duart e të cilit jepje, o shën Stefan, shpirtin tënd[7] të shenjt'.

Dhe Idhiomele
Ting. II I Anatoliut

U tregove i pari ndër dhjakë dhe i pari ndër martirë, o Stefan i tërëshenjtë, sepse u bëre udhë për shenjtorët dhe i çove Zotit shumë dëshmorë; prandaj qielli u hap te ti dhe Perëndia t'u shfaq;[2] atij përgjëroju që të shpëtohen shpirtrat tanë.

I njëjti I të njëjtit

Martirin e parë dhe shërbyesin trim të Krishtit, kryedhjak Stefanin, le ta nderojmë denjësisht, sepse, duke qëndruar në mes të të paligjve, ai pa Birin në të djathtë të Atit.[2]

I njëjti I të njëjtit

Veshe shenjtëri, o Stefan i lumur, dëshmor i parë dhe dhjak i parë, shok i engjëjve; le të të vijë keq dhe ndërmjeto për ne te Zoti Shpëtimtar i pamëkatshëm.

Lavdi
Ting. II I të njëjtit

U shfaqe i pari midis martirëve dhe dhjakëve, o Stefan i lumur, zbukurimi i atletëve, krenaria e besimtarëve, lavdia e të drejtëve; meqë qëndron pranë fronit të Krishtit[4] tërëmbret, kërko që të marrin ndjesën e fajeve dhe të denjësohen për mbretërinë e qiejve ata që kremtojnë kujtimin tënd të respektuar.

Tani *Hyjlindësore*

Ndryshim i të hidhëruarve, çlirim i të sëmurëve je, o Hyjlindëse Virgjëreshë; shpëto qytetin dhe popullin, o paqja e atyre që luftohen, qetësia e atyre që jan' në dimër, mbrojtje e vetme e besnikëve.*

Pasvargjet e Oktoihut

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Gëzohu në Zot, o kurorëprurës Stefan, imitues i Jisuit,[8] sepse u bëre edhe martiri i parë i Krishtit, mbretit tonë, edhe shfuqizove mashtrimin e judenjve të paligj; ndërmjeto për ne te Perëndia.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[9] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me athloforin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Tani përlëshoje. *Dhe menjëherë Paraklisi (*O Zot, dëgjo lutjen time *etj.). Pas Trishenjtit në fund të Paraklisit*

Përlëshore
Ting. IV Tahí prokatálave

Kuror' mbreti kryen tënd kurorëzoi me hir* për garat që ke duruar fort për Krishtin Zot, o atlet dhe martir i par';* se manin' e judenjve* e qortove dhe më pas* pe Shpëtimtarin tënd pra në të djathtë të Atit;*[2] atij për shpirtrat tanë gjithnjë përgjëroju ti.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

NË MËNGJESORE

Stihologjia e zakonshme.
Kanunet: të Oktoihut dhe i shenjtit që ka Akrostihidhë: "Me këngë do ta kurorëzoj mirë të parin e martirëve. I Theofanit".
Ting. Tërth. IV

Ode I
Armatilatin Faraó

Stefan i tërëpasur dhe kuror' martirësh, shndrite plot me lavdi* përmes llamburitjesh* rrezatuese të Shpirtit, atletizmit plot fuqi* dhe arritjeve mbi mendje; pra, meqë me një rreth në kok'* pranë Zotit je,[4] feks sa të himnojn'.

Pasi u bëre nisja e vrapuesve dhe kulm me rreth martirik,* ti u denjësove* ta shikosh atë që shpalli garat të të jepte ty* me të djathtën jet'-prurëse një kuror' të hyjthurur lart,* o Stefan me lavd, i mahnitshëm mjaft.

O Shpëtimtar, e vetmja pasuri, thesar me mirësi, dhembshuri,* prej gjirit të dheut* shfaqe si thesar të çmuar pasuri që s'ka mbarim,* kamje, pasje që s'humb, xhevahir që s'vidhet, Stefanin, pra* shenjtin dhe martirin e parë krejt.

O i dalluar midis tërë dhjakëve, martir i parë, Stefan,* dukshëm ti shkëlqeve* me një pamje engjëllore;[1] me himnim prej engjëjve* denjësisht u nderove vërtet pas fshehjes, i dal' në pah;* mburrje dhe lavdi për dëshmorët je.

Hyjlindësore

Porsi banesë virgjërore, enë pastër-

tie, tempull i gjall'* prej dëlirësisë,* linde Fjalën Zot hyjnor të Atit që më par' s'kish mish,* porse u trupëzua për ne, Hyjnënë krejt pa qortim;* Zonjë e Krijesës së tërë je.

Ode III
O stereosas kat' arhás

I hyjshëm, folës fort i shenjt'* dhe theolog u tregove,* kur me turm' hebrenjsh u ballafaqove,* u qortoje ateizmin sigurisht, mentalitet* që kishin kundër Zotit,*[10] Stefan, martir i shkëlqyeshëm.

Le të nderojmë me himnim,* të gjith' me një zë të hyjshëm* pra të parin dhjak, Stefanin, martirin* po të parë të Jisuit Krisht, një mik të engjëjve;* ky me shkëlqim u shfaqi* nisjen e udhës dëshmorëve.

Zbulohet një thesar që qe* i fshehur nën dhé pra dhe mbush* botën me aromë, erë të hyjshme,* me dhurata pasurisht, i shquari i dhjakëve* edhe i pari midis* tërë martirëve, dhe zëmadh.

Më denjëso, Stefan i lum,* që panairin tënd plot nder* ta himnoj dhe t'i ndjek gjurmët e tua,*[11] si me energjin' e jetës, që ti shpalle mençurisht,* ta ngjallësh mendjen time* pra që ka vdekur prej fajeve.

Hyjlindësore

U duke portë mendërisht,*[12] për lindjen nga lart,[13] o Vajzë,* që u shfaq mbi tokë, o Virgjëreshë;* se drejt nesh nëpërmjet teje hyri Fjala me qëllim* të gjithë t'i shpëtojë* prej marrëzisë, e krejt pacen.

Irmosi: O stereosas kat' arhás

»Ti që formove në fillim* me mençuri »dhe mend qiejt,*[14] dhe mbi ujëra ba»zove fort dheun,*[15] më mbështet mbi »gurin,[16] Krisht, të porosive që na dhe,* »o njeridashës, sepse* veç teje tjetër »të shenjtë s'ka.[17]

Ndenjësore
Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

I shkëlqyer nga drita e Shpirtit, gjithashtu* përmes urtis' së vërtetë i lartësuar, Stefan,* errësove mjegullnajën e judenjve ti;* mposhte kështu në stadium* me atletizimin tënd armikun, kuror' u shfaqe* për martirë, ndaj ndërmjeto pranë Zotit të na mëshirojë shpirtrat.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

O Hyjlindëse, mbrojtje e paluftueshme,* e flaktë, shpresë e sigurt që s'turpëron kurrë je,* strehë, mur, li-

man për sa përikin pra te ti;* Birit tënd, Krishtit Perëndi,* përgjëroju tok me engjëjt paqen t'i japë botës,*[18] përdëllimin e madh,[18a] shpëtimin, o e dëlira Virgjëreshë gjithnjë.

Ode IV
Si mu iskís Kírie

Na buroi sot rrjedhë miroje, doli krua kundërmimi, na zhyti lumë të mirash të hyjshme dhe përrua shijimi,[19] pra i pari i martirëve, i kënduari, i mbushuri me besim, me fuqi[20] hyjnore dhe me Hir.

Në qytetin mbretëror u shfaq si e hyjshme, tepër e hijshme dhe e shënuar dita e martirit të parë, e cila është plot dritë dhe ngazëllim vërtet shpirtëror, duke ruajtur fuqinë e Kishës së respektuar dhe duke dëbuar arrogancën e barbarëve.

O Stefan i lumur, e more denjësisht trashëgiminë e mirë dhe fushove atje ku është Krishti tërëmbret; se u shfaqe dhjak i tij, duke bërë fuqitë e shenjave dhe çudive,[5] dhe duke u dhënë të sëmurëve shërimin.

Shtylla[21] e patundur, e bazuar fort, e papërkulur e Kishës[22] u lartësua nga toka deri në qiell, duke ndriçuar tërë skajet me shkëlqim shpresëtarie, Stefani i madh, predikuesi i së vërtetës, me të vërtetë shkëmbi i atletizmit.

Hyjlindësore

O Çlirues i të gjithëve, u bëre ti nga e Virgjra Adam i ri për hir të të parit[23] dhe të stërnënës, edhe shpëtimtar kundër vdekjes, jetë me të vërtetë e pavdekshme; prandaj të lumërojmë duke e ditur denjësisht si Perëndilindëse atë që të lindi.

Ode V
Ina ti me aposo

Meqenëse demaskove me këmbëngulje[10] Këshillin[6] e kotësisë[24] vërtet të hebrenjve të paligjshëm, o Stefan hyjfolës, duke u mbuluar nga ata me hedhjen e gurëve,[3] si fitimtar u lartësove në shpirt drejt qiejve.

O Stefan i lavdishëm, i hyjfrymëzuar, u zbulove te bota si i bukur, si agim, duke larguar mjegull dhe duke dëbuar fantazma demonësh, si dhe duke shëruar pësime të sëmurësh dhe plagë sëmundjesh shpirtërore.

Duke u ngazëlluar mendërisht së bashku me engjëj, o i lumur, me të vërtetë shenjtëron skajet e kozmosit nëpërmjet ardhjes dhe hirit tënd, duke lëshuar kundërmim me miro shpirtërore dhe duke çliruar nga rreziqe dhe zalisje.

Hyjlindësore

Duke pasur guxim nënor para Birit tënd, o e Tërëkulluar, të përgjërohemi, të mos e shpërfillësh përkujdesjen tonë farefisnore, sepse ne të krishterët të vëmë para Zotit vetëm ty si zbutje dashamirëse.

Ode VI
Ilásthití mi Sotír

Ti në predispozicion* ke qen' imituesi i engjëjve, fitove kështu* fytyr' engjëllore,[1] o i lum; siç me ta gëzon* dhe shëtit së bashku,* ne që të himnojmë, na shpëto.

O i hyjzënë, i lum,* fuqia e fjalëve të tua plot me hyjfrymëzim* si zë bubullime i tronditi vërtet veshët* dhe i errësoi* pamjet e gjith' të paudhëve.

U denjësove dhe pe* lavdinë e Atit[2] dhe shkëlqimin e saj[25] që ësht' me të,* i tërënderuari hyjfolës, Stefan i shenjt';* ky të lajmëronte* për arritjen tënde rreth plot drit'.

Hyjlindësore

Ivetmi Bir[26] Zot që ësht'* përpara çdo jete, o Hyjnënë, i padukshmi, u lind* në fund pra të ditëve[27] prej teje; u duk në mish,* si i parëlindur,*[28] Perëndia i shpëtimit tim.[29]

Irmosi: Ilásthití mi Sotír

»Jan' shum' mëkatet që kam,* ndaj »le të të vijë keq, o Zot, për mua; lu»tem, më nxirr* nga fundi i vrereve, »sepse thirra fort te ti*[30] dhe dëgjo»më mua,* Perëndia i shpëtimit tim.[29]

Kontaqi Ting. Tërth. IV

I pari u mbolle mbi tokë nga bujku[31] qiellor, o i tërëfamshëm; i pari derdhe mbi dhé gjakun për Krishtin, o i lumur; i pari veshe prej tij rrethin e fitores në qiell, si pararojë atletësh, o i kurorëzuar, i parëtriumfuari i martirëve.

Shtëpia

Duke parë lulet e Parajsës ta mbushin me erën e tyre të mirë e të këndshme tërë sferën, habitem me pamjen e tyre të huaj; sepse në acar dimri lulëzojnë më shumë - kjo gjë është e pazakonshme në lule - si martiri i parë, që mbiu i pari dhe u bë dera e atyre që garojnë ligjshëm[32] dhe lulëzojnë në ngricën e mundimeve, ai që u tregoi atyre që duan të garojnë një udhë ku nuk humb, kryetari i mirë i stadiumit, i cili shkëlqeu me anën e dhimbjeve, i kurorëzuari, i parëtriumfuari i martirëve.

Sinaksari

Më 2 të të njëjtit muaj, kujtimi i Transferimit të lipsanit të shën Stefanit, kryedhjak dhe martir i parë.
Vargje: Ke, o Sion, shumë gjëra të hyjshme dhe të huaja,/ jepi qytetit të Konstandinit lipsanin e Stefanit.
Në të dytën, u bë zhvarrosja e lipsanit të Stefanit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i gjetjes së lipsaneve të martirëve të shenjtë Maksimi, Dhadha dhe Kintiliani.
Vargje: Duke nxjerrë toka tre të vdekur jetëprurës,/ gjan sikur i thotë qiellit: Ti fshihi dhe kiji ata.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i përurimit të kishës së hyjshme të apostullit të shenjtë dhe ungjillor Joan Theologu, afër Kishës së Madhe tepër të shenjtë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Foka dhe i mbretit Justinian në Apostujt e Shenjtë, i cili la kujtim të devotshëm.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Theú sigatávasin

Rrjedhja e gjakrave të tua i hapi portat qiellore dhe të tregoi ty shpallësin e garave, duke qëndruar pranë teje[2] dhe duke ofruar kurorat drejt teje që thërrisje: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[33]

Si bisha e rrëmbyen[34] me pëllëmbë të fëlliqura hyjvrasësit hyjshfaqësin, dhe e vrisnin atë[3] që po lutej për ata që e vrisnin[7] me vrull, i cili psalte: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[33]

Ligjshëm i demaskove shkelësit[10] ti, o tepër i ligjshëm, imituesi i Shpëtimtarit,[8] dhe i tregove si hyjluftues;[10] kur goditeshe me gurë nga ata,[3] psalje: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[33]

Hyjlindësore

O e dëlirë, pa martesë linde në kohë të pakohshmin; e linde me marrje mishi, o Virgjëreshë, Fjalën Zot pa mish më parë; atij i këndojmë melodikisht me një zë, duke thirrur: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[33]

Ode VIII
Eptaplasios káminon

Duke ndriçuar me llamburitje të përmbinatyrshme, o i tërëshkëlqyer, tregoje edhe pamjen e fytyrës sate si të barabartë me engjëjt,[1] kur u përhap Hiri që ishte fshehur në shpirtin tënd pasurisht, o Stefan; prandaj thërrisje: O priftërinj, bekojeni;[35] popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

O Stefan kurorëprurës, me pikat e gjakrave të tua hiqi traumat e shpirtit tim dhe shenjat e plagëve të mëkatit; sepse, duke përikur drejt përkrahjes dhe predispozicionit tënd të dhembshur dhe krishtimitues,[8] thërras: O priftërinj, bekojeni;[35] popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Mbi kokën tënde të nderuar, o i lavdëruar, sipas emrit tënd vendosi kurorën e hireve[36] Gjykatësi i pakorruptueshëm, të cilin e predikove besërisht si Ndërtues, Perëndi dhe mbretin e të gjithave,[37] duke thirrur ti pa ndërprerje: O priftërinj, bekojeni;[35] popull, përmbilartësojeni në gjithë jetët.

E dorëzove shpirtin tënd[7] në duart[38] e Ndërtuesit, sepse ushtritë e qiejve të pritën me ngazëllim si shok ty që më parë ishe në tokë si i barabartë me engjëjt;[39] dhe tani, i rreshtuar në koret e tyre, thërret pa ndërprerje: O priftërinj, bekojeni;[35] popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Hyjlindësore

O e Tërëkulluar, u bëre banesë drite[40] pa perëndim, sepse linde dritë për ata që janë në errësirë dhe hije,[41] dhe shndrit anët e botës me hir hyjdijeje; për atë besimtarët këndojmë melodikisht pa pushim: O Djem, bekoni; priftërinj, përhimnoni;[35] popull, përmbilartësoni në gjithë jetët.

Irmosi: Eptaplasios káminon

»E dogji furrën shtatë her'* në Kalde
»një tiran i saj* me mani për Djemtë*
»që nderonin Perëndi;*[42] por, kur të
»shpëtuar krejt* i pa, nga një fuqi më
»e fort',*thirri ky kështu:*[43] Po Çlirim-
»tarin Ndërtues,* o Djem ju, ta beko-
»ni;*[44] priftërinj,[35] ta himnoni;* ju po-
»pull, lartësojeni pra për gjithë jetët.

Ode IX
Eksesti epí tuto o uranós

Shkëlqyeshëm, Stefani, martir i par',* u tregoi dëshmorëve rrugë pra që kurrë s'humb* që në qiej çon, është ky fillim* për atletizëm martirik;* shpirtërisht të gjithë na fton në gaz* hyjnor të marrim pjesë* në dritë, në kungime,* në shoqërin' e shenjtërimit pra.

Zilepsje butësinë e Krishtit, shenjt,*[8] të dha forc' dashuria e tij, imitove kështu* zërin e tij, thoshe: Mos llogarit* mëkatin që bëjn' vrasësit* dhe, o Zot i mir', prite shpirtin tim*[7] dhe për shijim që s'shprehet* në mbretërinë tënde* hyjnore denjësomë mua ti.

I bukur me fytyr' engjëllore[1] qe* dhe i mbushur me besë,[20] urti[45] si dhe me

vezullim* llamburitjesh plot lavd hyjnor dhe hir;* ndaj ligjëroje hyjshëm fort* me një goj' hyjfolëse mu si lum'* oratorik i shenjtë,* fitove trashëgimin* e sipërm, o i hyjlumtuar pra.

Si u kurorëzove me hir si rreth,*[36] i rrethuar nga kor martirik qëndron pran' Krishtit[4] Zot,* shpallësit të ndeshjeve; ndaj ti lyp* për ne që sinqerisht kremtojm'* panairin tënd dritëprurës, nur* vërtet, edhe çlirona,* dëshmor, nga çdo rrezik, dert,* të vyer bëna të të vijmë lart.

Hyjlindësore

Hyjnënë, virgjëreshë pa cen aspak,* pra si mbrojtja e gjith' të krishterëve, me dhembshuri,* nga rreziqet, ngasjet çliroji ti* shërbyesit e tu në hall,* në shtrëngim, që vuajnë dhembje plot* të tmerrshme nga mëkati* dhe fshikullohen dhimbshëm,* dhe prej pësimeve pra prehi ti.

Irmosi: Eksesti epí tuto o uranós

»U shtang dhe u shastis qielli me »të,*[46] u habitën dhe anët e botës »mbar',* se Perëndi* trupërisht u »duk[47] te të vdekshmit ne* dhe, Zo»një, barku yt u bë,* më i gjerë se »qiejt, se çdo vend;* Hyjlindëse e »Virgjër,* rreshtimi engjëllor si* dhe »njerëzor të madhështojnë ty.

Dërgimësore
Ton mathitón oronton se

I pari i martirëve bëri udhë,* në mes të tërë dhjakëve qe i shquar,* pra Stefani, plot me hir i mbushur krejt* për në qytetin mbretëror* ja transferohet, dhe hirin* e çdo shërimi buron ky.

Hyjlindësore

Në bark ke mbajtur Krishtin që mori mish, trup,* prej gjakut tënd të çmuar, sado qëndrojnë* pranë tij me shumë tmerr rreshtimet lart* pa pasur forcë, Virgjëresh',* ta shohin lavdin që ka pra* esenca e tij që s'thuhet.[48]

Lavdërime
Ting. IV Édhokas simíosin

Si u bë një engjëll tokësor, martiri i par' Stefan,* ndërsa ngjitej në qiell lart,* në ajër, u mor dhe pa,* sa e kish të mundur,* lavdin e hyjnueshëm[2] dhe mësoi mistikisht* misteret përmbi mend të Triadhës Zot* të paarritshëm; shpall pra forcën tënde që nuk kuptohet dot,* o Jisu i pushtetshëm krejt,* Shpëtimtari i shpirtrave.

(2x)

Kur pra u riktheve, o martir i parë me plot lavdi,* na u shfaqe i bukur nur,* stolisur me rreze, drit'* dhurëtish hyjnore* dhe shërimesh;[49] ndaj hijeson

besnikët mbarë ti* përmes çudive të tua, o Stefan,* që bën për ne që me besim himnojm' Jisu Njeridashësin,* duke thënë: I fortë krejt* je, shpëtimi për shpirtrat tan'.

Si kallam i çmuar fort që shkruan shpresëtarinë shpejt,* gjuha jote[50] u shfaq; me të* ndriçove të gjithë ne,* o martir i parë,* me doktrinën tënde, dhe na riktheve në besim* nga injoranca; ndaj panairin tënd* çdo vit e bëjmë pra, lëvdojmë dhe himnojmë ne luftërat* që i bëre, Stefan zëmadh,* i kënduar kudo me nam.

Lavdi

Ting. IV I Joan Monakut

Stefani, aparka[51] e mirë e martirëve, plot me hir dhe fuqi,[20] që bënte çudi dhe mrekulli të mëdha në popull,[5] qëllohej me gurë prej të paligjve;[3] por shkëlqeu si engjëll[1] dhe soditi lavdinë tënde në të djathtë[2] të Fuqisë,[4] o Zot, që u mishërove për ne; dhe në Shpirtin e Hirit[52] merrej lart në qiej. Dhe për këtë, i shoqëruar bashkë me koret e engjëjve, ndërmjeton që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Nga çdo lloj rreziku ruaji shërbëtorët e tu, o Hyjlindëse e bekuar, që të të lavdërojmë ty, shpresën e shpirtrave tanë.

Pasvargjet e Oktoihut

Lavdi

Ting. Tërth. I I Qiprianit

O apostull, martir i parë dhe kryedhjak, porta e martirëve, lavdia e të drejtëve, krenaria e apostujve, duke qëndruar në stadium, ti pe qiej të hapur dhe Birin e Perëndisë të qëndronte në të djathtë të Atit[2] të padukshëm; prandaj, si shkëlqeve në fytyrë si engjëll,[1] thërrisje me hare për ata që të qëllonin me gurë: "Mos ua llogarit atyre këtë mëkat". Dhe tani kërko për ata që me aspiratë të mburrin, ndjesë mëkatesh dhe përdëllim të madh.[18a]

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlind'se e virgjër, dhe të lavdërojmë ne besnikët siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Dhe të tjera si zakonisht.

Në Liturgji Kontaqi i Metamorfozës (Përmbi malin ndrove), *Kungatore* Në gjithë dheun.

CITIME

[1] Vep. 6.15
[2] Vep. 7.55-56
[3] Vep. 7.58-59
[4] III [I] Mbret. 17.1; 18.15;
IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
[5] Vep. 6.8
[6] Vep. 6.13
[7] Vep. 7.60
[8] Lluk. 23.34
[9] Joan 15.1
[10] Vep. 7.51-53
[11] I Petr. 2.21
[12] Jez. 44.1-2
[13] Lluk. 1.78
[14] Ps. 32(33).6
[15] Ps. 135(136).6
[16] Ps. 39(40).3
[17] I Mbret. [Sam.] 2.2
[18] Joan 14.27
[18a] Num. 14.19 etj.
[19] Ps. 35(36).9
[20] Vep. 6.5,8
[21] Gal. 2.9
[22] I Tim. 3.15
[23] I Kor. 15.45
[24] Ps. 25(26).4
[25] Hebr. 1.3; Urt. Sol. 7.26
[26] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[27] Vep. 2.17; Hebr. 1.2
[28] Matth. 1.25; Lluk. 2.7
[29] I Kron. 16.35;
Ps. 17(18).47; 50(51).14; 87.2
[30] Jona 2.2
[31] Lluk. 8.5
[32] II Tim. 2.5
[33] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[34] Vep. 7.57
[35] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[36] Fja. Urt. 1.9
[37] Est. 4.17b
[38] Lluk. 23.46
[39] Lluk. 20.36
[40] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[41] Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
[42] Dan. 3.19
[43] Dan. 3.31-32
[44] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 27
[45] Vep. 6.3,10
[46] Jer. 2.12
[47] Kol. 2.9; I Tim. 3.16
[48] Is. 6.2
[49] I Kor. 12.9,28
[50] Ps. 44(45).2
[51] Eks. 22.29; 35.5
[52] Hebr. 10.29

MË 6 TË TË NJËJTIT MUAJ

Metamorfoza e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht.

Tipikon

Nëse bie të dielën, bëhet vetëm shërbesa e së kremtes, nuk thuhet asgjë nga ngjallësoret.

NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Thirrtore
Ting. IV Édhokas simíosin

Ejani, o qiellmendës, të ngazëllohemi pasi të ndryshohemi me ndryshimin më të mirë sot, duke ngjarë me Krishtin besërisht, dhe duke u ngritur nga toka drejt kulmit më të lartë të virtyteve; nga mirësia, Shpëtimtari i shpirtrave tanë, duke e ndërruar fytyrën në Thavor, e ndriçoi njeriun e shëmtuar.

(2x)

O miq të dëgjimeve dhe të pamjeve të gjërave përmbimendore, le të vëzhgojmë mistikisht Krishtin që shkëlqeu me rreze hyjnore; dhe le ta dëgjojmë zërin e Prindit, i cili e shpalli Bir të dashur atë që feksi në Thavor dobësinë njerëzore dhe u buroi ndriçim shpirtrave tanë.

Tani çdo sistem tokësor dhe përmbitokësor le të aktivizohet për himnimin e Krishtit, Perëndisë sonë, që mbizotëroi mbi të vdekurit dhe të gjallët;[1] sepse, duke e ndryshuar fytyrën hyjnisht, paraqet me vete në Thavor kryetarët dhe predikuesit e Ligjit dhe të Hirit, si deshi nga mirësia ai, Shpëtimtari i shpirtrave tanë.

Lavdi *dhe* **Tani**
Ting. Tërth. IV

Mjegullën e Ligjit[2] e pasoi reja e ndritshme e Metamorfozës; duke qenë brenda saj, Moisiu dhe Ilia u denjësuan për lavdinë e përmbishkëlqyer dhe i thoshin Perëndisë: Ti je Perëndia ynë, mbreti i jetëve.[3]

Pasvargje
Ting. II Ikos tu Efrathá

Sot Krishti, në malin e Thavorit, kur e ndryshoi natyrën e errësuar të Adamit, e hyjnizoi pasi e shkëlqeu.

Varg: **Të tutë janë qiejt dhe jotja është toka.**

Duke rrezatuar me dritën e virtyteve, le të shkojmë në malin[4] e shenjtë,[5] që të shohin Metamorfozën hyjnore të Zotit.

Varg: **Thavori dhe Hermoni në emrin tënd do të ngazëllohen.**

Dielli, edhe pse hijeson dheun, prapë perëndon, por Krishti, si shkëlqeu me lavdi në mal, e ndriçoi fort botën.

Lavdi *dhe* Tani
I ngjashëm

Në Thavor, Moisiu dhe Ilia panë Perëndinë e mishëruar nga një Vajzë virgjëreshë, për çlirimin e vdekatarëve.

Përlëshore

Ndrove fytyrën përmbi malin.

NË MBRËMËSOREN E MADHE

Nuk lexohet Psaltiri.

Thirrtore Idhiomele
Ting. IV I Kozma Monakut

Para Kryqit tënd, o Zot, një mal imitonte qiellin, një re shtirej si tendë; kur po ndërroje fytyrën dhe dëshmoheshe prej Atit, ishin të pranishëm Petroja bashkë me Jakovin dhe Joanin; sepse kishin për të qenë me ty edhe në kohën e dorëzimit tënd, që, pasi të kishin parë mrekullitë e tua, të mos frikësoheshin nga pësimet e tua, të cilave na denjëso t'u falemi me paqe sipas përdëllimit tënd të madh.[6]

(2x)

Para Kryqit tënd, o Zot, pasi i more Nxënësit e tu në një mal të lartë, ndërrove fytyrën para tyre, duke i ndritur me rreze fuqie, duke dashur të tregosh nga njëra anë me njeridashje, nga ana tjetër me pushtet, shkëlqimin e Ngjalljes, për të cilën na denjëso në paqe, o Perëndi, si i mëshirshëm dhe njeridashës.

(2x)

Në një mal të lartë kur ndërrove fytyrën, o Shpëtimtar, duke pasur korifenjtë e Nxënësve, shkëlqeve me lavdi, duke deklaruar se ata që u dalluan për lartësinë e virtyteve, do të denjësohen edhe për lavdinë e përëndishme. Dhe duke biseduar me Krishtin, Moisiu dhe Ilia tregonin se ai mbizotëron[1] mbi të gjallët[7] dhe të vdekurit;[8] dhe që ai që foli qëmoti përmes profetëve dhe Ligjit, ishte Perëndi. Dhe për të dëshmonte zëri i Atit nga reja e ndritshme, duke thënë: "Dëgjojeni atë". Ai me anën e Kryqit e plaçkoi Hadhin dhe u dhuron të vdekurve jetën e amshuar.[9]

Mali, dikur i errësuar dhe i tymosur,[10] ku qëndruan këmbët e tua, o Zot,[11] tani është i çmuar dhe i shenjtë; sepse një mister të mbuluar para jetëve,[12] në fund ua shfaqi Metamorfoza jote e frikshme Petros, Jakovit dhe Joanit; ata, duke mos duruar rrezen e fytyrës

sate dhe shkëlqimin e rrobave të tua, ranë të rënduar me fytyrë përdhé; dhe duke u shtrënguar nga shtangia, habiteshin duke parë Moisiun dhe Ilian të flisnin me ty për ato që kishin për të ndodhur te ti; dhe një zë prej Atit dëshmonte duke thënë: Ky është Biri im i dashur, që më pëlqeu, dëgjojeni atë që edhe i dhuron botës përdëllimin e madh.[6]

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. II I Anatoliut

Duke paraikonizuar ngjalljen tënde, o Krisht Perëndi, atëherë merr tok me vete tre Nxënësit e tu, Petron, Jakovin dhe Joanin, kur u ngjite në Thavor; teksa po të ndërrohej fytyra, o Shpëtimtar, mali Thavor mbulohej nga drita; Dishepujt e tu, o Fjalë, hodhën veten e tyre në sipërfaqen e tokës, duke mos duruar të shikonin fytyrën e padukshme; engjëjt shërbenin me drojë dhe tmerr, qiejt u frikësuan, toka u drodh kur pa mbi dhé Zotin e lavdisë.[13]

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës dhe Leximet

Këndimi i Eksodit
(24.12-18)

Tha Zot*i* drejt Moisiu*t*: "Ngjitu drejt meje në mal dhe qëndro atje; dhe do të të jap pllakat e gurta, ligjin dhe porositë që i shkrova që t'u vë ligj atyre". Dhe si u çua Moisi*u* dhe Jisu*i*, që i qëndronte pranë, u ngjitën mbi malin e Perëndisë; dhe pleqve u tha-në: "Rrini të qetë këtu, derisa të kthehemi drejt jush; dhe ja, Aaron*i* dhe Or*i* *janë* me ju; nëse dikujt do t'i ndodhë gjykim, të shkojnë tek ata". Dhe u ngjit Moisi*u* dhe Jisu*i* në mal, dhe e mbuloi reja malin; dhe zbriti lavdia e Perëndisë mbi malin Sina dhe e mbuloi atë reja gjashtë ditë; dhe e thirri Zot*i* Moisiun në ditën e shtatë nga mesi i resë; dhe pamja e lavdisë së Zotit *ishte* si zjarr që digjte mbi majën e malit përballë bijve të Izraelit; dhe Moisi*u* hyri në mes të resë dhe u ngjit në mal dhe ishte atje në mal dyzet ditë dhe dyzet net.

Këndimi i Eksodit
(33.11-23; 34.4-6,8)

Foli Zot*i* drejt Moisiu*t* ballë për ballë, siç do të flasë dikush drejt mikut të vet, dhe *Moisiu* ikte në kamp, ndërsa shërbyesi, i riu Jisu, biri i Naviut, nuk dilte nga tenda. Dhe tha Moisi*u* drejt Zotit: «Ja ti më thua: "Nxirre këtë popull", por ti nuk më zbulove atë që do ta dërgosh bashkë me mua; dhe ti më the: "Të di më shumë se të gjithë, dhe ke hir pranë meje". Prandaj, nëse kam gjetur hir para teje, ma shfaq veten

tënde hapur që të të shoh, që të gjej hir para teje dhe që të njoh se *është* populli yt ky komb i madh». Dhe thotë: «Unë vetë do të shkoj para teje dhe do të të preh». Dhe *Moisiu* thotë drejt tij: «Në qoftë se ti vetë nuk do të ecësh së bashku, mos më nxirr nga këtu; dhe si do të jetë e njohur vërtet se kam gjetur hir pranë teje, unë dhe populli yt, veçse nëse do të ecësh ti tok me ne? Dhe do të lavdërohem edhe unë edhe populli yt më shumë se të gjitha kombet, sa janë mbi dhé». Dhe tha Zot*i* drejt Moisiut: «Dhe këtë fjalë që the, do të ta bëj, sepse ke gjetur hir para meje, dhe të di më shumë se të gjithë». Dhe *Moisiu* thotë: «Më paraqit veten tënde». Dhe *Zoti* tha: «Unë do të kaloj përpara teje me lavdinë time dhe do të thërras me emrin tim: "Zot përballë teje"; dhe do të mëshiroj atë që do të mëshiroj, dhe do të dhembshuroj atë që do të dhembshuroj». Dhe tha: «Nuk do të mundesh të shikosh fytyrën time, sepse nuk do ta shikojë njeri fytyrën time, dhe do të jetojë». Dhe tha Zot*i*: «Ja vend pranë meje, qëndro sipër gurit; dhe kur të kalojë lavdia ime, dhe do të të vë në vrimën e gurit dhe do të mbuloj me dorën time mbi ty, derisa të kaloj; dhe do ta heq dorën dhe atëherë do të shikosh të prapmet e mia, ndërsa fytyra ime nuk do të shikohet nga ti». Dhe si u gdhi, Moisi*u* u ngjit në malin Sina, ashtu siç e urdhëroi Zoti. Dhe zbriti Zot*i* në re dhe i qëndroi pranë atje, dhe thirri me emrin e Zotit; dhe kaloi Zot*i* para fytyrës së tij dhe thirri: «Zot Perëndia *është* i dhembshur dhe përdëllyes, zemërgjerë dhe i shumëmëshirshëm dhe i vërtetë». Dhe, duke nxituar, Moisi*u* u përkul mbi tokë dhe u fal.

Këndimi i III Mbretërve
(19.3-9, 11-13, 15-16)

Në ato ditë Ilia vjen në Beersevë, tokë e Judës, dhe la shërbyesin e tij atje. Dhe ai shkoi në shkretëtirë një ditë udhë, dhe erdhi dhe u ul nën një kedër dhe u shtri dhe fjeti atje poshtë pemës. Dhe ja dikush e preku dhe i tha: "Ngrihu dhe ha". Dhe hodhi sytë dhe ja afër kokës së tij një kulaç i pjekur elbi dhe një enë uji; dhe u ngrit dhe hëngri dhe piu; dhe si u kthye, fjeti. Dhe u kthye engjëlli i Zotit për së dyti, dhe e preku dhe i tha: "Ngrihu, ha, sepse *është* e shumtë udha *që do të bëhet* prej teje"; dhe u ngrit dhe hëngri dhe piu; dhe eci me forcën e kësaj ngrënieje dyzet ditë dhe dyzet net deri në malin Horev. Dhe u fut atje në shpellë dhe ndenji atje; dhe ja *u bë* fjalë Zoti drejt tij dhe tha: "Do të dalësh nesër dhe do të qëndrosh para Zotit në mal; ja do të kalojë Zot*i*".

Dhe ja *u bë* erë e madhe, e fortë që shpërbënte male dhe dërrmonte gurë para Zotit; nuk *ishte* Zot*i* në erë; dhe pas erës, tërmet; nuk *ishte* Zot*i* në tërmet; dhe pas tërmetit zjarr; nuk *ishte* Zot*i* në zjarr; dhe pas zjarrit një zë flladi të lehtë, dhe atje *ishte* Zot*i*. Dhe u bë, sapo Ilia dëgjoi, mbuloi fytyrën e tij me gëzofin e tij, dhe doli dhe qëndroi poshtë shpellës. Dhe tha Zot*i* drejt tij: "Ec, kthehu në udhën tënde dhe do të arrish në udhën e shkretëtirës së Damaskut, dhe do ta krezmosh Eliseun, birin e Safatit, në profet në vendin tënd".

Në Liti Idhiomele
Ting. II

Ti që me dritën tënde e shenjtërove të gjithë sferën, ndërrove fytyrën në mal të lartë, o i mirë, kur u tregove Nxënësve të tu pushtetin tënd, se çliron botën nga shkelja; prandaj të thërrasim: O Zot i dhembshur, shpëtoji shpirtrat tanë.

I njëjti

O Krisht Perëndi, që ndërrove fytyrën me lavdi në malin e Thavorit dhe u tregove disi Nxënësve të tu lavdinë e Hyjnisë sate, shkëlqena dhe ne me dritën e njohjes sate,[14] dhe na drejto në udhën e porosive të tua,[15] si i vetmi i mirë dhe njeridashës.

I njëjti

Krishti, drita para diellit, duke u endur me trup mbi tokë, dhe pasi kreu hyjshëm para Kryqit gjithçka të ekonomisë së frikshme, sot në malin e Thavorit tregon disi tipin e Trinisë mistikisht; sepse, pasi solli me vete veç tre Nxënësit e zgjedhur, Petron, Jakovin dhe Joanin, dhe pasi fshehu pak marrjen e mishit, ndërroi fytyrën para tyre, duke shfaqur hijeshinë e bukurisë fillestare, megjithëse jo të plotë, nga njëra anë duke i informuar, nga ana tjetër duke i kursyer, se mos humbisnin së bashku me shikimin edhe jetën; por e shihnin me sa mundeshin, meqë kishin sytë truporë; dhe solli majën e profetëve, Moisiun dhe Ilian, të cilët dëshmonin analogjikisht Hyjninë e tij, dhe se ky është vezullimi i vërtetë i esencës atërore,[16] i cili sundon mbi të gjallët dhe të vdekurit.[1] Prandaj edhe një re si tendë i mbuloi, dhe zëri i Atit nga lart prej resë dëshmonte për më tepër me tingëllim, duke thënë: "Ky është ai që pa rrjedhë linda nga barku para eosforit,[17] im Bir i dashur, të cilin e dërgova[18] të shpëtojë ata që pagëzohen në Atin dhe Birin dhe Shpirtin e Shenjtë,[19] dhe pohojnë besërisht se një është pushteti i Hyjnisë, i pandarë; atë dëgjojeni". Pra, ti vetë, o Krisht Perëndi njeridashës, shkëlqena dhe ne me dritën e

lavdisë sate të paafrueshme,[20] dhe tregona trashëgimtarë të denjë të mbretërisë sate[21] të pambarim, si i përmbimirë.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Ejani të ngjitemi në malin e Zotit dhe në shtëpinë e Perëndisë sonë,[4] dhe të vëzhgojmë lavdinë e Metamorfozës së tij, lavdinë si e të vetëmlindurit prej Atit;[22] nga drita le të marrim dritë dhe, pasi të bëhemi të lartësuar në shpirt, le ta himnojmë Triadhën e njëqenshme në jetë.

Tani *I njëjti*

O Krisht, të dëshmuan bërësin dhe përmbushësin e Ligjit dhe të profetëve,[23] duke të parë në re gjatë Metamorfozës sate, Moisiu hyjshikues[24] dhe Ilia, karrocieri me eksperiencë dhe qiellvrapues i padjegur;[7] bashkë me ta denjësona dhe ne për ndriçimin tënd, o Zot, që të të himnojmë në jetë.

Pasvargje Idhiomele
Ting. I

Ai që bisedoi qëmoti me Moisiun mbi malin Sina me anën e simboleve, duke thënë "Unë jam ai që është",[25] sot në malin Thavor, kur ndërroi fytyrën para Nxënësve, tregoi bukurinë fillestare të ikonës,[26] pasi e mori mbi vete esencën njerëzore; dhe pasi i shfaqi si dëshmitarët e një hiri të tillë Moisiun dhe Ilian, i bënte pjesëmarrës të ngazëllimit, të cilët paralajmëronin Ngjalljen e lavdishme dhe shpëtimtare nëpërmjet Kryqit.

Varg: Të tutë janë qiejt dhe jotja është toka.

Duke paraparë në Shpirt ardhjen tënde, të Birit të vetëmlindur,[22] drejt njerëzve përmes mishit, Hyjati David nga larg bashkëfton për ngazëllim Krijesën dhe thërret profetikisht: "Thavori dhe Hermoni në emrin tënd do të ngazëllohen".[27] Sepse, pasi u ngjite në këtë mal tok me Nxënësit e tu, o Shpëtimtar, kur ndërrove fytyrën, natyrën e errësuar në Adam, e ke bërë të shkëlqejë përsëri, pasi e ndryshove në lavdinë dhe shkëlqimin e Hyjnisë[28] sate; prandaj të thërrasim: O Bërës i të gjithave, Zot, lavdi më ty.

Varg: Thavori dhe Hermoni në emrin tënd do të ngazëllohen.

Të parët e apostujve, kur e panë pakrahasueshmërinë e dritëderdhjes sate dhe paafrueshmërinë[20] e Hyjnisë mbi malin e Metamorfozës, o Krisht pa fillim, u ndryshuan me ekstazën hyjnore; dhe, pasi shkëlqyen rreth e rrotull me re të ndritshme, dëgjonin një zë atëror që e siguronte misterin

e trupëzimit tënd; se një je edhe pas mishërimit, Bir i vetëmlindur[22] dhe Shpëtimtar i botës.[29]

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. II

Petros, Jakovit dhe Joanit, Nxënësve të tu eprorë, ua tregove disi sot, o Zot, në malin Thavor lavdinë e fytyrës sate hyjnore; sepse shihnin rrobat e tua të shkëlqenin si drita dhe fytyrën tënde më shumë se dielli; dhe duke mos duruar ta shikonin pafundësinë e ndriçimit tënd, binin përdhé duke mos mundur fare të vëzhgonin, sepse dëgjonin një zë që dëshmonte nga lart: Ky është Biri im i dashur, që erdhi në botë për të shpëtuar njeriun.

Përlëshore
Ting. i Rëndë

Ndrove fytyrën përmbi malin, o Krisht Perëndi; ndrite si një Mesi për dishepujt, ashtu siç merrnin vesh; ndrit edhe mbi ne mëkatarët dritën tënde të përjetshme, me lutjet e Shën Marisë, dritëdhënës, lavdi më ty.*

(3x)

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Duke shfaqur, Shpëtimtar,* se do ndryshohen njerëzit* në lavdinë tënde krejt,* kur për së dyti do të vish*[30] frikshëm në mal, në Thavor, nd'rrove pamje; me ty* flisnin Moisiu, Ilia tok;* thirre tre nga Nxënësit që, kur pan',* o Zot, lavdinë tënde, u shtangën* pra nga ndriçimi yt; shndriti fort* dhe shpirtrat tanë* ti që atëher'* dritën tënde e fekse.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
E ngjashme

Në Thavor, në mal, Jisu,* ndërrove pamjen, dhe një re* që ndriçonte dhe qe shtrir'* si tendë, Nxënësit e tu* krejt i mbuloi; ndaj ulën shikimin përdhé,* se s'duronin fare shkëlqimin tënd,* që po nxirrte lavdi që s'ka afrim,* që dilte prej fytyrës sate, o Krisht,* Zot Shpëtimtar pa fillim; shndriti* dhe shpirtrat tanë* ti që atëher'* dritën tënde e fekse.

Lavdi *dhe* Tani
I njëji

Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. IV O ipsothís en to Stavró

Ti tok me Nxënësit* përmbi mal u ngjite* dhe në lavd atëror* shkël-qeve; pran' teje* qëndronin Moisiu me Ilian, sepse* Ligji dhe profetët të shërbejn'* pra si Zotit, dhe Ati yt* Bir të thirri, dhe kështu* birërin' natyro-re* ky e pohoi; edhe ne atë* e përhim-nojmë* me ty dhe me Shenjtin Shpirt.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

Thavori dhe Hermoni në emrin tënd do të ngazëllohen.
Varg: **Të tutë janë qiejt dhe jotja është toka.**

Ungjilli. Psalmi 50

Lavdi. Me ndërmjetimet e apostujve. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II

Ti që me dritën tënde e shenjtërove të gjithë rruzullin, ndërrove fytyrën në mal të lartë, o i mirë, kur ua trego-ve Nxënësve të tu pushtetin tënd, se çliron botën nga shkelja; prandaj të thërrasim: O Zot i dhembshur, shpëto-ji shpirtrat tanë.

Kanunet
Ode I
Kanuni i parë, që ka Akrostihidhë:
"Krishti lëshoi në majë dritë
të pafundme fytyre".
Poezi e Kozma Monakut.
Ting. IV
Irmosi: Horí Israíl

»I shenjt' Izrael shkoi Detin e Kuq si »mbi një tok', me këmbë të palagura »dhe armiqtë me kuaj u panë ndër »valë të mbytur të shkatërruar.[31] Pra »me gaz këndonte populli: O Perëndi, »o Zot i madh, nder dhe lavdi më ty.[32]*

U tha miqve Krishti[33] fjalë me jet',*[34] dhe për mbretërinë hyjnore, kur li-gjëronte, tha:* Do ta njihni në mua* Atin,[35] kur një dritë* që s'afrohet do ta shndrit un';* me gaz atëher' do psalni ju:* Le t'i këndojmë Zotit ton', se u lëvdua fort.[32]

Do hani fuqin' e kombeve ju,*[36] kur më i shkëlqyer se dielli do të shfa-qem pra,* o miq Nxënës;[33] do keni* admirim, çudi, lavd* përmes pasuris' së tyre;*[36] me gaz atëher' do psalni ju:* Le t'i këndojmë Zotit ton', se u lëvdua fort.[32]

Si shndriti pak sot në mal, në Tha-vor,* siç premtoi Krishti te Nxënë-sit,[37] tipin, shembullin* e ndriçimit të Zotit* ky i zhveshi; lavd pra* dhe shkëlqim hyjnor i mbushën;* me gaz

atëher' ata psalnin:* Le t'i këndojmë Zotit ton', se u lëvdua fort.[32]

Kanuni i dytë që ka Akrostihidhë: "Moisiu pa fytyrë Perëndie në Thavor". Poezi e Joan Damaskinoit. Ting. Tërth. IV Igrán dhiodhefsas

Kur pa Moisiu profetikisht* në re dhe në shtyllë zjarri lavdin e Zotit pra,* teksa në det ishte,[38] po thërriste:* Le t'i këndojm' Perëndis', Çlirimtarit ton'.

Pasi u mbulua me trup si gur',* trup të hyjnizuar, hyjshikuesi Moisi* e pa të padukshmin[24] dhe thërriste:* Le t'i këndojm' Perëndis', Çlirimtarit ton'.

Mbi malin Ligjor si dhe në Thavor* Moisiut shenjt iu shfaqe, pra në të lashtin rast* brenda territ[2], por tani në dritë* të paafrueshme[20] që ka Hyjnia lart.

Zbritësore: Stavrón haraksas Mosís

»Një kryq vijosi me shkop* Moisi »profeti*[39] dhe Det' i Kuq u ça më dysh »dhe Izraeli shkoj përtej,* pastaj pra- »që e bashkoj* me të njëjtin shkop »dhe kryq përsipër valëve* dhe forcat »edhe qerret Faraonit ia mbyti,[31] pra »Krishtin këndojmë si* Perëndi dhe »Zot me brohori dhe gaz.[32]*

Ode III
Irmosi: Tokson dhinatón isthénise

»Harku i të fortëve u shthur edhe u »forcua fuqia e të pafuqishmëve,[40] »prandaj pra u sigurua zemra ime »përmbi Zotin lart.[41]*

Veshe,* o Krisht, krejt Adamin at',* ndreqe pra natyrën e errësuar qëmoti keq;* e ndriçove, e hyjnizove* me ndryshimin e fytyrës ti.

Krishti,* Izraelin në shkreti* me një re, me shtyllë me pamje zjarri e prin— te[42] drejt;* por pra sot në drit' shkëlqeu* në Thavor, në mal, mistikërisht.

Kanuni tjetër: Uranias apsidhos

Lavdi që hijesonte në Tendë më parë, shum'* shoqërohej me Moisiun,[43] pra shërbëtorin tënd;*[44] Metamorfoza në mal* e kish simbol, kur shkëlqeu* në Thavor pashprehshëm, o Zot edhe Perëndi.

Fjal', Zot i vetëmlindur,[22] i tërëlartë, me ty* kulmi i apostujve në Sina u ngjit, pra në mal,* o njeridashës unik;* qëndruan tok Moisiu* dhe Ilia, si shërbëtorë të Perëndis'.[44]

Sado Zot je i tëri, u bëre njeri i tër'* kur bashkove me njerëzinë gjithë Hyjninë pra* në hipostazën e marr';* në dy esenca e panë* në Thavor, në mal, Moisiu, Ilia tok.

Zbritësore: Ravdhos is tipon

»Shkopi njëherë si një simbol i mi-
»sterit na u shfaq,* se filizat na tre-
»guan priftërinë,*[45] edhe për Kishën
»beronjë ja ku mbiu edhe lulëzoj*
»Kryqi tani për forcë dhe për siguri.*

Ndenjësore
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Në Thavor, në mal, o Zot,* ndërrove krejt fytyrën ti* mes të urtit Moisi* dhe të Ilias plot me mend* tok me Jakovin dhe Petron edhe Joanin;* Petroja që ndodhej atje, të tha:* "Mirë ësht' të bëjmë tri tenda ne,* një për Ilian, një për Moisiun* dhe një për ty Krishtin Zot". Shndriti* dhe shpirtrat tanë,* ti që atëher'* dritën tënde e fekse.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Ode IV
Irmosi: Isakíkoa tin éndhokson

»Kam dëgjuar planin tënd për të
»shpëtuar njerëzit, o Krisht Perëndi.*
»Linde mbi dhé ti prej Virgjëreshës,*
»që të na shfaqësh* dritën e ungjillit
»tënd,* Zoti i fuqishëm, lavdi më ty.*

U duke kur po hipje në re me zjarr, mjegull dhe stuhi, o Krisht Perëndi,[2] kur formoje në Sina Ligjin në germa;[46] lavdi fuqisë sate, o Zot.

Shkëlqeve parrëfyeshëm në Thavor, o Krisht Perëndi, që ta sigurosh ekonominë tënde të lavdëruar si i qenë para jetëve, dhe që vure vetë hipjen tënde mbi re.[47]

Duke biseduar me ty, Zotin Krisht, qëndruan pranë si skllevër ata te të cilët fole në avull zjarri, mjegull[2] dhe fllad tepër të lehtë;[48] lavdi fuqisë sate, o Zot.

Shpallnin fort daljen në Kryqin tënd, duke qenë të pranishëm në Thavor Moisiu që të pa më parë në zjarr dhe në ferrë,[49] edhe Ilia i lartësuar me karrocë të përflaktë,[7] o Krisht.

Kanuni tjetër: Ek sarkós su volidhes

O Zot që ruajte pa cen ferrën kur kungonte me zjarr,[49] i tregove pak mish që shkëlqente hyjnueshëm Moisiut që këndonte: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

U fsheh nën rreze Hyjnie dielli lëndor, sapo të pa në Thavor të ndërrosh fytyrën, o Jisui im; lavdi fuqisë sate, o Zot.

U duke, o Zot, si zjarr i palëndët që s'digjte materialin e trupit, kur Moisiut, Ilias dhe apostujve u shfaqe se ishe një nga të dyja, në dy natyrat e përsosura.

Zbritësore: Isakíkoa Kírie

»Kam dëgjuar, o Zoti Krisht,* si e rre-
»gullove këtë mister të madh,* i kup-
»tova veprat që ke bër'* dhe të lav-
»dërova, Perëndia im.[50]*

Ode V
Irmosi: O tu fotós dhiatmiksas

»O Zot i madh që ndriçove errësi-
»rën e vjetër, në dritë[51] veprat të lav-
»dërojnë[52]. O Krisht, me dritën tënde
»udhët tona drejtonai.[53]*

Përballë teje u përkulën orët, sepse, sapo deshe me mirësi, o Krisht, të ndryshosh pamjen njerëzore, dielli, drita që rend në lartësi, para teje la dritën.

Ndërsa dëgjonin Nxënësit në malin e shenjtë Thavor, Moisiu dhe Ilia thërrisnin: Ja Shpëtimtari, Krishtin që qëmoti e paralajmëruam[54] si Perëndi.

Natyra e pandryshueshme, që u bashkua me atë njerëzoren, u shkëlqeu parrëfyeshëm apostujve, duke zhveshur pak dritën e Hyjnisë jolëndore që kishte me vete.

O Krisht, sapo Nxënësit të panë ty, dritën e përjetshme, të shkëlqesh me lavdinë atërore,[55] të thërrisnin: Në dritën tënde drejtoji udhët tona.[53]

Kanuni tjetër: Ina ti me aposo

Gjuha oratorike nuk mund t'i thotë madhështitë e tua; sepse ti që posedon jetë dhe sundon mbi vdekje, vure pranë vetes në malin Thavor Moisiun dhe Ilian, që të dëshmonin Hyjninë tënde.

O Krisht, që me duar të padukshme gatove njeriun[56] sipas ikonës sate,[26] tregove disi bukurinë tënde fillestare në krijim; jo si në ikonë, por ti vetë je në esencë Perëndia, që u bëre edhe njeri.

Pasi u përzjeve pa trazim në malin Thavor, ku i shtange Moisiun, Ilian dhe të parët e Nxënësve, na tregove pak qymyr Hyjnie, që shkrumbon mëkate[57] dhe ndriçon shpirtra.

Zbritësore: O trismakáriston ksilon

»O dru i lumur tri herë, përmbi të cilin
»u nde pra mbret i lartë Zoti Krisht,*
»se prej teje u rrëzua djalli gjarpër*[58]
»i gënjyer tmerrësisht prej Zotit të
»mbërthyer mbi Kryq,* q'u fal shpir-
»trave* përdëllim dhe paqe[59] për-
»gjithmon'.*

Ode VI
Irmosi: En to thlívesthé me

»Nëpër hidhërime i thirra Zotit lart
»në q'ell* dhe ma priti lutjen* Perë-
»ndia i shpëtimit tim.[60]*

Dritën më të fortë se rrezet diellore lart* e shkëlqeu Krishti* në Thavor dhe na ndriçoi ne.

E ndërrove pamjen, Krisht, si u ngjite në Thavor,* dhe shkëlqeve dritë,* çdo mashtrim e errësove pra.

Perëndi të njohën, Krisht, të lavdishmit Nxënës ty,* ndaj u gjunjëzuan* me habi të madhe në Thavor.

Kanuni tjetër: Ilásthití mi Sotír

Oh! Sa i frikshëm, i madh* na qenka spektakli që u shfaq! Shkëlqeu në qiell lart* një diell i lëndët, por mbi dhé, në Thavor, në mal,* mendërisht i pashoq* shndriti Dielli i drejtësis'.[61]

Hyjninë tënde kur pa* në mal, në Thavor pra, Moisiu thirri: Ka ardhur qart'* Jisui Zot, Krishti, e vërteta, dhe iku krejt[62]* si u dobësua* Ligji,[63] hija që e kish ai.[64]

Paratregonte mjaft qart'* Jisuin Krisht, që ndërronte pamjen, shtyllë zjarri,[42] ndërsa* një re Hirin që ka Shpirti, ky hijesoi[43] thell',* në mal hodhi hije,* në Thavor me lavd dhe dukshëm fort.

Zbritësore: Notiu thirós en splahnis

»Në barkun e bishës në det, profeti »shën Jona kish hapur duart në form' »kryqi* dhe pësimin e Krishtit para»tregonte qart'sisht;* pra i triditshmi »jasht' u hodh[65] dhe ngjalljen e për»mbinatyrëshme e paralajmëroj* të »Jisujt[66] të mbërthyer përmbi Kryq për »ne,* që na e ndriti Krijesën me ngri»tjen prej varreve.*

Kontaqi
Ting. i Rëndë
Epí tu orus metemorfothis

Përmbi malin ndrove fytyrën dhe Nxënësit e tu panë lavdinë tënde sa mundnin, o Krisht Perëndi; që, kur të shikojnë të kryqëzohesh, ta kuptojnë pësimin vullnetar[67] dhe t'i lëçitin botës se ti je me të vërtetë agullimi i Atit.[16]*

Shtëpia

Çohuni, o të ngathët, mos jini gjithmonë të zvarritur poshtë; o mendime që e kërrusni drejt tokës shpirtin tim, ngrihuni dhe lartësohuni në lartësi ngjitjeje hyjnore; le të vrapojmë së bashku me Petron dhe bijtë e Zevedheut, dhe me ta le të arrijmë në malin Thavor, që të shikojmë tok me këta lavdinë e Perëndisë sonë, dhe të dëgjojmë një zë që dëgjuan nga sipër dhe predikuan agullimin e Atit.[16]

Sinaksari

Më 6 të të njëjtit muaj, kujtimi i Metamorfozës hyjnore të Zotit dhe

Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht.
Vargje: Thavori u lavdërua më shumë se çdo vend i dheut,/ meqenëse pa të shkëlqente me lavdi natyrë Perëndie.
Më të gjashtën, Krishti ndërroi pamje burri.

E atij është lavdia dhe pushteti në jetë. Amin.

Ode VII
Irmosi: Avramiei poté

»Në Babilonë, në zjarr,* djemtë ab»ramianë* e shkelën flakën përvë»luese,*[68] këndonin pra besërisht:* »O Perëndi edhe Zot, je i bekuar.[69]*

Apostujt, të rrethuar nga derdhja e dritës së lavdisë së paafrueshme në malin Thavor, o Krisht, thirrën: O Perëndi i etërve, je i bekuar.[69]

Apostujt, duke u kënaqur nga era e fortë e tingëllimit hyjnor, nga reja vesëhedhëse dhe nga lavdia jote, o Krisht, psalnin: O Perëndi i etërve, je i bekuar.[69]

Petroja, sapo të pa kur shkëlqeje në dritë të paafrueshme në malin Thavor,[20] o Krisht, thirri: O Perëndi i etërve, je i bekuar.[69]

Bijtë e Zevedheut, duke qenë tok me Krishtin, kryetarin e jetës,[70] sapo rrezatoi dritë pamjeje, gjëmuan:[71] O Perëndi i etërve, je i bekuar.[69]

Kanuni tjetër:
Pedhes Evreon en kamino

Tani gjëra të padukshme iu shfaqën apostujve, Hyjnia në mish[72] që shkëlqente në malin Thavor, teksa ata thërrisnin: I bekuar je, o Zot, Perëndi, në jetë.[69]

Apostujt, të habitur prej tmerrit të shkaktuar nga hijesia e mbretërisë hyjnore në malin Thavor, u frikësuan dhe thërrisnin: I bekuar je, o Zot, Perëndi, në jetë.[69]

Të padëgjuarat u dëgjuan, se pa atë lindi Bir' i Virgjëreshës dhe dëshmohet nga q'elli me lavdi prej Atit si Perëndi dhe si njeri, gjith' ai për gjithë jetët.*

Duke qenë që më përpara Bir i dashur në esencë, nuk u bëre me "vendosje" Bir i të Tërëlartit; dhe kontaktove pa ndryshim me ne që thërrasim: I bekuar je, o Perëndi, në jetë.[69]

Zbritësore: Éknoon próstagma

»Urdhër të çmendur dha tirani besë»lig, e tundi popullin,* botën e tmerroj »me blasfemi dhe paudhësi;* po të tre »Djemtë nuk i tronditi dot*[73] tërbimi »i egër as furra me zjarr;* dhe kur po

»frynte era vesëprurëse,[68] këndonin »brenda mu në zjarr:* I përhimnuar je, »Perëndi dhe Zot i madh,* përjetë i »bekuar.[69]*

Ode VIII
Irmosi: I en Vaviloni Pedhes

»Tre Djemtë në Babilonë me një zell »qiellor të përdjegur* tiranin[73] s'e »përfillën aspak. E shkelën zjarrin »burrërisht edhe të vesuar[68] prej »q'ellit* të këndonin me zë të madh: »Zotin, që të gjitha krijesat e Zotit, »bekojeni.[74]*

Ai që mban me shenjë çdo gjë, me këmbë të pacenuara u ngjit në malin Thavor, ku, pasi shkëlqeu në fytyrë më shumë se dritësim dielli, të shquarit e Ligjit dhe të Hirit i tregoi të këndonin: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.[74]

Drita[75] e paperënduar dhe e pashoqe, vezullimi i Atit,[16] kur u shfaq parrëfyeshëm mbi malin Thavor në lavdinë e paafrueshme, pasi hijesoi Krijesën, i hyjnizoi njerëzit që këndonin: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.[74]

Moisiu dhe Ilia, duke qëndruar me seriozitet të hyjshëm në malin Thavor dhe duke parë haptazi karakterin e hipostazës[16] hyjnore, Krishtin që shkëlqeu në lavd atëror, këndonin: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.[74]

Moisiu u lavdërua në fytyrë dikur përmes zëri hyjnor në stuhi;[76] por Krishti vishet me dritë dhe lavdi si me rrobë,[77] sepse, duke qenë bërësi i dritës, shkëlqen ata që këndojnë: Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.[74]

Nxënësit, duke parë në Thavor Krishtin të vishet nga reja dritëlindëse, dhe pasi ranë përmbys mbi tokë, feksën në mendje dhe e himnonin atë së bashku me Atin dhe Shpirtin. Bekojeni, gjithë veprat e Zotit, Zotin.[74]

Kanuni tjetër: Eptaplasios káminon

O Zot, kur dëgjuan të dëshmoheshe prej Atit, dhe duke mos duruar të shikonin llamburitjen e fytyrës sate, se ishte më e fortë se shikimi njerëzor, Nxënësit e tu ranë përtokë duke kënduar me frikë: O priftërinj, bekojeni;[78] o popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Je mbreti tepër i bukur i mbretërve dhe Zoti i sunduesve gjithkund, pushtetar[79] i lumur që banon në dritë të paafrueshme,[20] nga i cili Nxënësit, pasi u habitën, thërrisnin: O Djem, bekojeni; o priftërinj, përhimnojeni;[78] o popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Meqenëse zotëron qiellin, mbretëron mbi tokë[80] dhe ke pushtetin e të nëndheshmeve, o Krisht, qëndruan pranë

teje nga dheu apostujt, nga qielli Ilia thesviti[7] dhe nga të vdekurit Moisiu,[8] të cilët këndonin me një zë: O popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Përkujdesje që lindin përtaci, u braktisën në tokë me përzgjedhjen e apostujve, sapo të ndoqën pas,[81] o njeridashës, nga dheu drejt vendit hyjnor të lartësuar; prandaj, kur përfituan denjësisht theofaninë tënde, këndonin: O popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Zbritësore: Evlojite Pedhes

»E bekoni Djema*[69] si Trinia nga nu»mëri, Atin q'ellor, të vetmin pra Zot;* »himnoni* Fjalën që mbi dhenë zbri»ti*[82] dhe e bëri vesë zjarrin e furra»ve,*[83] dhe e lartësoni ju Shpirtin e »Tërëshenjtë,* që u dhuroi që të gjith'»ve jetën.*

Ode IX
Irmosi: O tokos su áfthoros

»U shfaq e paprishme lindja jote; nga »barku yt doli Perëndia,* kur mbi tokë »u duk me mish[72] edhe u shoqërua me »vdekatarët;*[84] të madhështojmë* të »gjith', o Perëndilidëse.

Të shndritur me derdhje të re drite, plot tmerr menjëherë po shikonin* njëri-tjetrin dhe ranë përdhe barkas dhe iu falën pra mbretit, Zotit* të Gjithësisë,*[85] të tre shën apostujt, Nxënësit.

Nga reja dërgohej zë buçitës prej Zotit, çudin' e siguronte,* sepse Ati i dritave[86] thërriste tek apostujt: Këtë dëgjoni,* im Bir i dashur* ky ësht'; më pëlqeu tërësisht.

Kur gjëra të huaja dhe paradoksale i panë[87] shërbëtorët* e Jisuit[88] Fjal', dhe dëgjuan zërin atëror në Thavor, thërrisnin:* Ky Shpëtimtar Krisht* krejt ësht' shfaqja e të Parit pra.

Ikona e saktë e të Qenit[89] je, vula e tij[90] që nuk ndryshohet,* nuk lëviz, o Bir Fjalë, urtësi dhe krah, e djathta e më të Lartit,* forca;[91] me Atin,* o Bir, dhe me Shpirtin ju himnoj.

Kanuni tjetër: Éfrikse pasa akoí

O Krisht, që dukshëm ta tregosh* zbritjen tënde prap', të dytë mistike krejt,* si ti, i Larti Zot,* do rrish, do shfaqesh, mes perëndish do jesh,*[92] Ilias, Nxënësve dhe Moisiut u shndrite nur* pashprehshëm; ndaj të gjith'* me besim të madhështojmë, o Shpëtimtar.

Ejani, binduni tek un':* Si të ngjitemi, o popuj, në mal[4] hyjnor*[5] dhe qiellor, pa lënd',* të rrimë në qytet Zoti[93] që jeton,*[94] dhe mendërisht të shohim

ne Hyjninë pa lëndë krejt* të Atit, të Shpirtit* që shkëlqen në Bir të vetëm[22] me plot lavdi.

Krisht, më tërhoqe ti me mall,* më ndryshoi dashuria hyjnore krejt;* me zjarr të palëndët,* shkrumboji pra mëkatet që bëra un';* më denjëso, i mirë, të më mbushë shijimi yt,* dhe të kërcej me gaz,* dy pranit' e tua t'i madhështoj kështu.

Zbritësore: Mistikós i Theotoke
dhe
O dhiá vróseos tu ksilu

»O Hyjlindëse, parajsë mistike je,* »se pa lërim lulëzove Zotin Krisht,* që »mbolli përmbi dhé jetëprurësin Kryq* »që po lusim me besë,* se ky po lartë»sohet* dhe me anën e tij të madhë»shtojmë sot.*

»Mallkim i vjetër i stërgjyshit,*[95] që »rrodhi prej helmimit të gjarpërit,*[96] »e shkatërroi Kryqi i[97] Zotit Krisht; be»kimi erdhi prapë për njerinë me Mari »Hyjlindësen,* që na lindi Jisunë Çli»ronjësin; të gjitha pra fuqitë e lavdë»rojnë në qiellin.*

Dërgimësore
Fos analíoton Loge

Dritë që kurrë s'ndryshohesh,* pra Fjalë[75] prej dritës, Atit,* në dritën tënde të shfaqur* sot në Thavor pamë Atin* që s'lindi, e pamë dritë[98] dhe Shpirtin dritë,* që çdo krijesë shkëlqen fort.

(3x)

Lavdërime
Ting. IV O eks ipsistu klithís

Përpara Kryqit të çmuar dhe pësimit,* more sa i zgjodhe nga shenjtët dishepuj ti;* u ngjite, Zot, në Thavor, në mal,* deshe t'u shfaqje* lavdinë tënde pra; kur të pan' ata* të ndërroje pamjen, më shumë se dielli* të shndritje, ranë përmbys, sepse* ishin habitur* prej forcës sate; kështu thërrisnin fort:* Drita[75] pa kohë* dhe shkëlqimi i Atit,[16] o Krisht je, vullnetarisht* mish u duke, por s'kishe* as ndryshim, si edhe as ndërrim.

(2x)

Fjal' Perëndi[99] që përpara jete ti je* dhe që veshe dritë si rrobë,[77] ndërrove krejt* fytyrën para apostujve* të tu dhe shndrite* më shumë se dielli; qëndruan pran'* tok Ilia me Moisiun, të shfaqnin pra* Zot[1] mbi të gjallët,[7] të vdekurit,*[8] dhe lavdëronin* ekonomin' tënde që s'rrëfehet dot* si dhe mëshirën,* bashkëzbritjen e madhe, përmes së cilës shpëtove krejt* botën tonë që humbej* prej mëkateve dhe fajeve.

Pasi, Zot, linde nga reja virgjëro-re*[100] dhe u bëre mish,[101] në Thavor, mal, ndërrove krejt* fytyrën dhe u rrethove plot* me re të ndritshme,* kur ishin pranë apostujt, Nxënësit;* zëri atëror qartë të deklaroi ty* Bir të njëqenshëm të dashur fort,* të bashkëfronshëm;* ndaj i habitur tha Petroja kështu:* "Ësht' gjë e mirë* që të jemi këtu", se nuk dinte çfarë po thoshte ky,* o Jisu njeridashës,* mirëbërësi i shpirtrave.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. I I Bizantit

I mori Krishti Petron, Jakovin dhe Joanin në mal të lartë veç, dhe ndërroi pamje para tyre dhe shkëlqeu fytyra e tij si dielli, ndërsa rrobat e tij u bënë të bardha si drita; dhe u dukën Moisiu dhe Ilia, duke biseduar bashkë me të; dhe një re e ndritshme i hijesoi, dhe ja një zë prej resë që thoshte: Ky është Biri im i dashur që më pëlqeu, dëgjojeni atë.

Dhoksologjia e Madhe.
U jepet vëllezërve dhe vaj i shenjtë.

Në Liturgji Antifonet:
Antifoni I

Varg a): I madh *është* Zoti dhe i lavdishëm fort në qytetin e Perëndisë sonë.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg b): Duke përgatitur male në fuqinë e tij.

Me ndërmjetimet.

Varg c): Ai që vishet me dritë si rrobë.

Me ndërmjetimet.

Varg d): Malet do të ngazëllohen prej fytyre Zoti.

Me ndërmjetimet.

Lavdi *dhe* Tani

Me ndërmjetimet.

Antifoni II

Varg a): Themelet e tij *janë* në malet e shenjta.

Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që ndërrove fytyrën në malin Thavor, ne që të psalim aliluia.

Varg b): I do Zoti portat e Sionit më shumë se të gjitha tendat e Jakovit.

Shpëtona.

Varg c): Të lavdëruara u folën për ty, o qytet i Perëndisë.

Shpëtona.

Varg d): "O nënë Sionë", do të thotë njeri; dhe njeri lindi në të.

Shpëtona.

Lavdi *dhe* Tani

O i vetëmlindur.

Antifon III

Varg a): **Mëshirat e tua, o Zot, do t'i psal përjetë.**

Ndrove fytyrën përmbi malin.

Varg b): **Do të lavdërojnë qiejt të çuditshmet e tua, o Zot.**

Ndrove fytyrën përmbi malin.

Varg c): **Lum populli që di brohoritje.**

Ndrove fytyrën përmbi malin.

Varg d): **O Zot, në dritën e fytyrës sate do të ecin, dhe në emrin tënd do të ngazëllohen tërë ditën.**

Ndrove fytyrën përmbi malin.

Hyrtore

Thavori dhe Hermoni në emrin tënd do të ngazëllohen. Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që ndërrove fytyrën në malin Thavor, ne që të psalim aliluia.

Pas Hyrjes, Përlëshorja dhe Kontaqi i së kremtes. Trishenjti. Në vend të Të meriton, Të padëgjuarat u dëgjuan *(kërkoje në Oden VII). Kungatore:* Në dritën e lavdisë së fytyrës sate, o Zot, do të ecim në jetë; aliluia. *Në vend të* Pamë dritën, *Përlëshorja.*

Sipas traditës, poshtë ikonës së Zotit Krisht vendosen rrush të pjekur dhe pas Uratës mbrapa Amvonit - pikërisht para Emri i Zotit qoftë i bekuar - *psalen: Përlëshorja e së kremtes, Lavdi dhe Tani Kontaqi i së kremtes; dhe lexohet nga prifti Urata e Rrushit (shih Uratoren e Vogël).* Emri i Zotit *etj. Në mensë, "ngushëllim" (d.m.th. hahet peshk).*

CITIME

Metamorfoza: Matth. 17.1-9; Mark 9.2-9; Lluk. 9.28-36

[1] Rom. 14.9
[2] Eks. 20.21; Ligji i Dytë 5.22(19); Sirak 45.5
[3] I Tim. 1.17; Apok. 11.15
[4] Mik. 4.2; Is. 2.3
[5] II Petr. 1.17-18
[6] Num. 14.19 etj.
[7] IV [II] Mbret. 2.11; Sirak 48.9
[8] Ligji i Dytë 34.5-6
[9] Joan 10.28; 11.25-26; 17.2; I Joan 5.11
[10] Eks. 19.18-19; 20.18; Ligji i Dytë 5.22(19)
[11] Ps. 131(132).7
[12] Kol. 1.26
[13] I Kor. 2.8; Jak. 2.1
[14] II Kor. 4.6
[15] Ps. 118(119).35
[16] Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3
[17] Ps. 109(110).3
[18] Joan 5.36; 6.57; 7.29; 8.42; 10.36; 11.42; 17.3,8,18
[19] Matth. 28.19
[20] I Tim. 6.16
[21] Jak. 2.5
[22] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[23] Matth. 5.17
[24] Eks. 33.18-23; 34.6
[25] Eks. 3.14

[26] Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6;
Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
[27] Ps. 88(89).13
[28] Baruh 4.24
[29] I Joan 4.14
[30] I Kor. 15.51-52
[31] Eks. 14.21-30; 15.19
[32] Eks. 15.1,21
[33] Lluk. 12.4; Joan 15.14-15
[34] Joan 6.68
[35] Matth. 11.27; Joan 14.9
[36] Is. 61.6
[37] Joan 1.51-52
[38] Eks. 14.19-20
[39] Eks. 14.16
[40] I Mbret. [Sam.] 2.4
[41] I Mbret. [Sam.] 2.1
[42] Eks. 13.21-22; Urt. Sol. 18.3
[43] Num. 11.24-25; Ligji i Dytë 31.15-16
[44] Eks. 4.10; 14.31; Num. 12.7-8;
Ligji i Dytë 3.24; Jis. N. 1.2;
I Kron. 16.40; Hebr. 3.5
[45] Num. 17.16-28; Hebr. 9.4
[46] Eks. 24.12; Lev. 26.46
[47] Ps. 103(104).3
[48] III [I] Mbret. 19.11-12
[49] Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
[50] Abak. 3.1-2
[51] Gjen. 1.1-3
[52] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[53] Ps. 5.9; Fja. Urt. 20.24; Sirak 37.15
[54] Ligji i Dytë 18.15; Vep. 3.22
[55] Joan 17.5
[56] Gjen. 2.7-8,15;
Ps. 118(119).73; 138(139).5;
Jov 10.8-9; II Makk. 7.23
[57] Is. 6.6-7
[58] Gjen. 3.1-7
[59] Lluk. 24.36; Joan 14.27; 20.19,21,26;
Gal. 1.3; Ef. 2.17; II Thes. 3.16
[60] Jona 2.3
[61] Mal. 4.2 (3.20)
[62] Joan 14.6
[63] Rom. 8.3
[64] Kol. 2.17; Hebr. 8.5; 10.1
[65] Jona kap. 2
[66] Matth. 12.40
[67] Matth. 16.23; 20.18;
Mark 8.31; 10.33-34; Joan 18.11
[68] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 23-28
[69] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2, 27-28
[70] Vep. 3.15
[71] Mark 3.17
[72] I Tim. 3.16
[73] Dan. 3.4-12
[74] Ps. 102(103).22;
Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[75] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[76] Eks. 34.28-29
[77] Ps. 103(104).2
[78] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[79] I Tim. 6.14-15; Apok. 17.14; 19.16
[80] I Kron. 29.11
[81] Matth. 4.20-22; Mark 1.16-20; Lluk. 5.11
[82] Dan. 3.25
[83] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
[84] Baruh 3.38
[85] III Makk. 2.2; Jov 5.8
[86] Jak. 1.17
[87] Lluk. 5.26
[88] I Kor. 4.1
[89] Eks. 3.14
[90] Joan 6.27
[91] I Kor. 1.24
[92] Ps. 81(82).1
[93] Hebr. 12.22
[94] Jis. N. 3.10 etj.
[95] Gjen. 3.19
[96] Gjen. 3.1-7
[97] Gjen. 3.16
[98] I Joan 1.5; Apok. 22.5
[99] Joan 1.1
[100] Is. 19.1
[101] Joan 1.14

Në Mbrëmësore, nuk lexohet Psaltiri (përveç të shtunën në mbrëmje). Hyrje. Në çfarëdo dite të bjerë, në vend të Proqimenit të ditës, Proqimeni i Madh: Ting. i Rëndë

Perëndia yn' në qiell dhe në dhé të gjitha sa deshi i bëri.

Varg a): **Në daljen e Izraelit nga Egjipti, e shtëpisë së Jakovit nga një popull barbar.**
Perëndia yn' në qiell.

Varg b): **Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa.**
Perëndia yn' në qiell.

Varg c): **Ç'është me ty, o det, që ike, dhe me ty, o Jordan, që u ktheve mbrapa?**
Perëndia yn' në qiell.

E DIELA PAS METAMORFOZËS

Tipikon

Të shtunën në Mbrëmësore, lexohet Psaltiri. Thirrtoret 6 ngjallësore dhe 4 Paskremtore. Lavdi Ejani të ngjitemi *(kërkoje në Liti). Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje.* O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore (1x) dhe e së kremtes (1x).*

Shërbesa e Mesnatës e së dielës. Në Mëngjesore, pas Perëndi është Zoti, *Përlëshore e Tingullit (2x) dhe e së kremtes (1x). Ndenjësoret ngjallësore, por, në vend të Hyjlindësoreve, Paskremtoret. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe një i së kremtes. Pas Odes III, Ndenjësore Paskremtore (1x). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret* Një kryq vijosi me shkop; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore dhe Paskremtore (1x). Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 (Pasvargjet) Paskremtore. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e së kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e së kremtes dhe e kishës. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i së dielës. Të meriton. *Kungatore* Lavdëroni. Pamë dritën.

MË 8 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorë Emiliani, episkop i Kizikit.

NË MBRËMËSORE

Thirrtore të së kremtes
Ting. IV Édhokas simíosin

Sot apostujve të tu të respektuar, Ilias tok* si edhe Moisiut, Zot,* u shfaqe hyjnin' tënde,* se je Perëndia* pra i Ligjit edhe i Hirit; na çlirove ti* tani nga dora e vdekjes, ndaj me ta* e lavdërojm' ekonominë tënde fort njeridashëse,* o Jisu i fuqishëm krejt,* Shpëtimtari i shpirtrave.

Sot shkëlqeve fort me pamje drite më shum' se dielli* përmbi mal, pra Thavor, o Zot;* tregove te miqt' e tu* se je reflektimi* i lavdisë,[1] edhe prej dhembshurisë veshe ti* esencën e njerëzve; prandaj dhe ne* e lavdërojm' ekonominë tënde fort njeridashëse,* o Jisu i fuqishëm krejt,* Shpëtimtari i shpirtrave.

Sot gëzohen engjëjt qiellor', kremtojnë me njerëzit,* pra festojnë ndriçimin tënd* hyjnor dhe të frikshëm, Krisht,* në Thavor, në mal lart;* në të, njeridashës Zot, shfaqe Moisiun shenjt,* Ilian bashkë me Nxënësit e tu,* pra Petron dhe Jakovin dhe Joanin, që të himnonin ty,*o Jisu i fuqishëm krejt,* Shpëtimtari i shpirtrave.

Të shenjtit
I njëjti O eks ipsistu klithís

Qartë ikonën e Krishtit e nderove,* kur tërbohej fort arroganc' e Leonit mbret* dhe tundte popuj, dhe herezin'* plot ateizëm* që kish një mbret famëkeq, e ngjallte ky,* e qortove haptas atëherë me guxim,* o i tërurtë, kur ishin tok* në mbledhje bashkë* mjaft episkopë; kështu të njohën ty,* i tërëlumur,* si ushtar tepër trim të Zotit,[2] prandaj përgjëroju mjaft* t'i shpëtojë, t'i shndritë* shpirtrat tanë dhe t'u japë hir.

Ti që banon lart në vende qiellore,* kur i besëkeqi tregoi mendim pa bes'* dhe pa fre, dhe të dënoi ty,* fuqinë tënde,* në internim, e durove me hare,* plot gaz atëherë, se njihje Parajsën lart* nga ram' porsi qart' atdheun ton'* unik, të vetëm;* u denjësove krejt të vëzhgosh kështu* ti denjësisht pra* jetën e pacenuar, Krishtin,[3] atij përgjëroju mjaft* t'i shpëtojë, t'i shndritë* shpirtrat tanë dhe t'u japë hir.

Kur deklaroi një ligj barbar të ashpër* një tiran, Leoni mbret që urdhëroi rrept'* që mos iu falni ikonës pra*

të respektuar* të Krishtit, ti atëherë me një gjuh'* mjaft të zjarrtë ia kundërshtove tërurtësisht* hyjnorin ligj, se kalon përtej,* te prototipi* respekti, falja, siç tha dikush dikur;* atë hyjfolës* dhe i tëri hyjnor, i gjithënderuar, u shtang dukshëm* famëkeqi, kjo bisha,* përmes fjalës sate, kryeprift.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. I

Ai që bisedoi qëmoti me Moisiun mbi malin Sina me anën e simboleve, duke thënë "Unë jam ai që është",[4] sot në malin Thavor, kur ndërroi fytyrën para Nxënësve, tregoi bukurinë fillestare të ikonës,[5] pasi e mori mbi vete esencën njerëzore; dhe pasi i shfaqi si dëshmitarët e një hiri të tillë Moisiun dhe Ilian, i bënte pjesëmarrës të ngazëllimit, të cilët paralajmëronin Ngjalljen e lavdishme dhe shpëtimtare nëpërmjet Kryqit.

Pasvargje
Ting. Tërth. II
Triímeros anestis Hristé

Krisht, kur e more ti dhembshurisht* fytyrën e Adamit, pra* e të parit* vdekatar, Adam i dyt'*[6] u shfaqe nga e Virgjra; mbi malin e Thavorit* ndërrove pamje, zhveshe pak hyjnin'.

Varg: Të tutë janë qiejt dhe jotja është toka.

U shtangën kur në mal, në Thavor* e panë, Krisht, ndërrimin tënd* në fytyrë* shefat, njëri pra në Ligj* edhe në Hir i dyti; të falemi me ta ne* bashkë me Atin tënd dhe Shpirtin, Zot.

Varg: Thavori dhe Hermoni në emrin tënd do të ngazëllohen.

Gëzueshëm Krijesa shkëlqen,* Krisht, në ndërrimin tënd në form',* që tregove* në Thavor te Nxënësit* hyjnor', te Moisiu, Ilia tok, kur shndrite* më fort se dielli pashprehshëm, Zot.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. I

Duke paraparë në Shpirt ardhjen tënde, të Birit të vetëmlindur,[7] drejt njerëzve përmes mishit, Hyjati David nga larg bashkëfton për ngazëllim Krijesën dhe thërret profetikisht: "Thavori dhe Hermoni në emrin tënd do të ngazëllohen".[8] Sepse, pasi u ngjite në këtë mal tok me Nxënësit e tu, o Shpëtimtar, kur ndërrove fytyrën, natyrën e errësuar në Adam e ke bërë të shkëlqejë përsëri, pasi e ndryshove atë në lavdinë dhe shkëlqimin e Hyjnisë[9] sate; prandaj të thërrasim: O Bërës i të gjithave, Zot, lavdi më ty.

Përlëshore
Ting. I Tis erimu politis

E përshkrove ndriçimin e ikonës së Fjalës Zot* përmes saktësisë në jetë,* kryeprift Emilian, na the* me besë pikturimin pra trupor* të Krishtit ta nderojmë; dhe prandaj* të nderojmë si atlet ty* si dhe bari të mirë duke thirrur ne:* Lavd pra atij që ty të dha fuqi,* lavde atij që të dha kuror',* lavd atij që dhuron në ty ndjes', falje te të gjithë ne.

Dhe e së kremtes

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Duke shfaqur, Shpëtimtar,* se do ndryshohen njerëzit* në lavdinë tënde krejt,* kur për së dyti do të vish,*[10] frikshëm në mal, në Thavor, nd'rrove pamje; me ty* flisnin Moisiu, Ilia tok;* thirre tre nga Nxënësit që, kur pan',* o Zot, lavdinë tënde, u shtangën* pra nga ndriçimi yt; shndriti* dhe shpirtrat tanë* ti që atëher'* dritën tënde e fekse.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
E ngjashme

Në Metamorfozë, Krisht,* e shfaqe lavdin tënd në mal,* në Thavor, te tre të par'* ndër Nxënës, o Zot, Shpëtimtar;* hyjninë e pandryshuar shkëlqeve; ftove* me një re shkëlqimi Ilian shenjt* që me Moisiun dhe ty kishte* bisedë, ndaj dhe Petroja po thoshte:* "Mir' ësht' të jemi këtu me ty,* i dhembshur". Shndritna* pra shpirtrat, ti që* atëher' për ta fekse.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Kanunet: Një i së kremtes dhe
i shenjtit, që ka Akrostihidhë:
"E psal mrekullueshëm me këngë
Emilianin e madh.
I Theofanit":
Ting. I
Ode I
Su i tropeuhos dheksiá

O hyjmendës dhe i lum, banon* tok me rreshtime përmbitokësore lart,* ndaj shih, atë, denjësoji për shpëtim* sa panairin tënd me mall* dhe me ngazëllim e festojnë si të pëlqyeshëm.

O hyjmendës dhe hyjshfaqës shenjt,* i tëri je i bashkuar me Zotin tënd;* shndrite pra me dritë nga andej krejt ne* që bëjmë panairin tënd* me be-

sim, përmes mësimdhënies sate si i hyjzën'.

Vure mendjen tënde, Kryeprift,* përmes virtytit sovran[11] përmbi vese ti* si ndërmjetës krejt i drejt' mes shpirtit pra* dhe trupit, duke ndarë mir'* të dobishmet, at', te secili me shumë mençuri.

Mist i sakt' për gjëra mbi mendim,* zëmadh, u shfaqe, drejtoje dhe Kishën mir';* ishe i fuqishmi luftëtar për hir* të së vërtetës; thyeje* dhëmbët e luanëve, mbyllje gojët[12] e tyre pra.

Hyjlindësore

Njohim besërisht ne një atë* që lindi barku yt, e paqortueshme;* kishte dy natyra, ish pra Perëndi* edhe njeri mbinatyrisht;* veçorit' i kishte ky për secilën me saktësi.

Ode III
O monos idhós tis ton vrotón

Besnikët të vënë lutës ty,* hyjmendësin, te Krishti Zot,* si fitimtar me çmime për hir të tij,* që e nderove ikonën e këtij;* besën që nga lart u dha,* fort e mbajte, ruajte* predikimin hyjnor, kushtet që ka ky.

Tregove fuqi martirësh ti,* hyjmendës, dhe i lumi shenjt* edhe çnderove vetull besëkëqijsh,* i admirueshëm; pirg pa çarje dot,* pa lëkundje shfaqeshe* dhe ndërmjetës krejt hyjnor* pra për Kishën; qortoje sa s'kishin mend.

Mbret tërëdinaku piu helm,* pra herezinë dhe u ngop;* me fjalën didaktike e prishe drejt,* se zhduket terri me dritë, zhvishet krejt* sofistika plot mendim* dredharak përmes urtis',* me shkëlqimet e saj të hyjnueshme.

Hyjlindësore

Nga shpirti tani me zë të lart'* të shpallim kryesisht Hyjnën'* që linde Perëndinë që mori mish* nga ti, edhe pse s'kish mish dhe midis nesh* ky fushoi,[13] sado që* nuk pësoi ngatërrim,* nuk pranoi ndryshim, Vajz' pa hiç qortim.

Irmosi: O monos idhós tis ton vrotón

»I vetmi që dobësinë njeh* të thelbit »njerëzor, o Krisht,* dhe dhembshu»risht e more si formë ti,*[14] më ngjesh »me forcë nga lart[15] që të thërras:* »Je i shenjtë, Perëndi,* Zoti i lavdisë »je,*[16] mirësi që nuk imagjinohet dot.

Ndenjësore e shenjtit
Ting. III Thias pisteos

Meqë shndritje mjaft* prej Shpirtit Shenjt ti,* shpalle me guxim* ortho-

dhoksinë,* dogmat; dhe fort turpërove mbret shkelës keq,* padrejtësisht pra, i lum, atë oshënar,* të internonin në vende të largëta;* përgjëroju Shpëtimtarit Krisht, Perëndisë Zot,* të madhin përdëllim[17] të na dhurojë pra.

Lavdi *dhe* Tani
I së kremtes
I njëjtë Tin oreótita

Ti u tregove, Zot,* Fjalë e Perëndis',* lart në Thavor, në mal* pra Nxënësve të tu,* siç mundnin, reflektimin tënd hyjnor, lavdin tënd[1] vërtet, Krisht,* kur ndërroje pamje ti;* të ndriçojmë, Jisu, me ta* ne që të himnojmë ty,* o i vetmi që s'ke ndryshim,* me plot forc'; tok me bes' të thërrasim:* Lavd, Jisu, mbretërisë sate.

Ode IV
Oros se ti háriti

O i tërëlumuri, i gjithëpasuri Emilian, arrite të mposhtësh vetullën e keqbërësit, meqenëse me anën e virtytit u familjarizove me atë që mund t'i bëjë të gjitha, të fortin në luftëra;[18] dhe tani thërret: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Vuajte duke u dërguar në internime të largëta, pasi u dallove i qëndrueshëm, o Emilian hyjmendës, më parë me veçori të mira, dhe më vonë hieromartir kryeprift, o i tërëshkëlqyeri hyjprurës.

O i trishkëlqyer, hieromist i mrekullueshëm Emilian, u shfaqe që fëmijë i shenjtëruar ligjërisht, pasi u ndriçove me asketizëm dhe u fortifikove me fjalën e Hirit;[19] dhe i thërrisje Perëndisë: Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Hyjlindësore

O e Pacenuar, banoi në mitrën tënde, të lavdëruar nëpërmjet shkëlqimesh virgjërore, ai që kuptohet përtej çdo krijese, kur kryente mbi dhé misterin e hyjbërjes jetëdhënëse përmbimendore.

Ode V
Theós on irinis

Krishti, përderisa kuptoi me paranjohje hyjnore predispozicionin e shpirtit tënd të madh, e stolisi qartësisht me veçori të mëdha, pasi e lavdëroi me veshje priftërie dhe arritje martirësh, o hieromist i tërërespektuar.

Meqenëse e tërhoqe më përpara Hirin e Shpirtit,[20] burove lumenj mësimdhëniesh për grigjën e Krishtit, o i tërëlumur tepër i hyjshëm; prandaj i turpërojmë hyjkundërshtuesit, pasi

mësuam ta nderojmë ikonën e Krishtit dhe të gjithë shenjtorëve.

O hieromartir, kryeprift i tërëpasur dhe i admirueshëm, meqë më parë e vrave[21] përmes lodhjeve në asketizëm mentalitetin e mishit[22] tënd, e gjallërove mendjen me anën e shkëlqimit të Shpirtit; prandaj, pasi u ndriçove me të dyja, u bëre i pëlqyeshëm para Perëndisë.

Hyjlindësore

O e shenjta e të shenjtëve, Virgjëreshë e kulluar, e linde të shenjtin e të shenjtëve, Krishtin Çlirimtar, që i shenjtëron të gjithë; pra të madhërojmë si mbretëreshën dhe Zonjën e botës, sepse ti linde Ndërtuesin e krijesave.[23]

Ode VI
Splahnon Ionán

Meqë deshe fort* herezinë ta ndalosh,* përhapjen e saj, ece gatishmërisht* drejt rreziqeve;* e qortove, i urtë, me shumë guxim* mendjen pa fe të sovranit, kur i pari ti* nise* fjalën tënde kundër tij,* kur ish mbledhur sinodi hyjmendës krejt.

Kishe mall si zjarr* vetëm për Jisuin Krisht,* hyjnoren drit' doje ta arrije pra* prej tij, hierark* i hyjzënë i Zotit; tregove fuqin'* që martirët krejt e kishin, si më parë ti* fekse* me asketizim, kështu* qartë more kurorë dyfish, atë.

Kishe mendjen lart* tok me Perëndinë Zot,*[24] ndaj shndritej prej vezullimit krejt hyjnor,* oshënar i lum;* dhe lundroje në detin e jetës i qet,'* i drejtuar nga fuqia e të Shenjtit Shpirt;* në gjinj* qiellorë je tani,* ankorove me fllade prej Shenjtes Frym'.

Hyjlindësore

Deshi mirësisht* Përmbiperëndia Zot* natyrën e njerëzve të prishur keq* pra nga gjarpi djall,* nga zilia e tij,[25] ta shpëtonte ai;* ndaj banoi brenda mitrës sate pa ndryshim* edhe* u bë mish,[7] si vetëm ty* të dëlirë të gjeti, Hyjnën' pa cen.

Irmosi: Splahnon Ionán

»Si profeti shën Jona, pasi u gëlltit
»në det prej peshkut të madh, doli
»dhe nuk u nga,[26] gjithashtu tani,
»edhe Fjala e q'ellit Jisuj Shpëtimtar
»shkoj nga gjir' i Virgjëreshës dhe Hyj-
»lindëses, se u mishërua pa pësim
»edhe nënën e la të pac'nueshme.*

Sinaksari

Më 8 të të njëjtit muaj, kujtimi i atit tonë oshënar Emilian Omologjeti, episkop i Kizikut.
Vargje: Meqë e vlerësonte shumë shpirtin,/ Emiliani e la përfundimisht pas dore mishin.
Në të tetën, toka i pranoi kockat e Emilianit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i shën Miron çudibërësit, episkop i Kretës.
Vargje: Mironi i hyjshëm, duke lëshuar miro virtyti,/ i sjell Zotit aromë të këndshme.[27]

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar Theodhosi, igumen i Orove.
Vargje: Përmes jetës u tregove dhënie Perëndie,/ duke e gjetur emrin të përputhur me sjelljen.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Elefteri, Leonidhi dhe i foshnjave që mbaruan me zjarr.
Vargje: Dhe të dy atletëve, që nuk i flijonin mashtrimit,/ mashtruesit u vunë flakën si dënim.

Në të njëjtën ditë, dhjetë Asketë të shenjtë nga Egjipti mbarojnë në paqe.
Vargje: Dhjetë bimët e Egjiptit vdesin;/ ishin të njëjtë në numër me ato dhjetë plagët.[28]

Në të njëjtën ditë, dy Martirët e shenjtë nga Tiroja, mbarojnë duke u zvarritur përdhé.
Vargje: E fërkon tokën çifti që kishte për udhë frikën e Perëndisë,/ zgjedhë besimin dhe rrota gatishmërinë.

Kujtimi i neomartirit të shenjtë Trëndafil, që e kishte prejardhjen nga Zagoria e Magnisisë, por u martirizua në Konstandinopojë në vitin 1680.
Vargje: Trëndafili u shfaq trëndafil i ri,/ që u ngjyros i kuq nga rrjedhat e gjakrave.

Kujtimi i neomartirit të shenjtë Anastas, që u martirizua në Selanik në vitin 1794.
Vargje: Anastasi, kur ua dha trupin torturave,/ gjeti përfundim që nuk ka fare dhimbje.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Se noitín Theotoke

O atë, ishe me të vërtetë lavdi e hijeshuar hierarkësh, sepse, pasi mbretërove mbi pasionet, u duke pirg i parrëzueshëm dhe beden i Kishës, o i admirueshëm, duke e përhimnuar Perëndinë e përmbilavdishëm.

Na u shfaqe David i ri kur i mposhte mësimdhëniet e huaja me hobenë[29]

e fjalëve të tua tepër të suksesshme dhe me shigjetimet e doktrinës, duke e përhimnuar Perëndinë e himnueshëm dhe të përmbilavdishëm, o i tërëkënduar.

O atë, qëndrove shkëlqyeshëm mbi katedër gjyqi për hir të Krishtit, dhe i gufoje fjalët si prej burimi hyjnor; sepse u predikove të gjithëve, meqë dije qartë se falja e ikonave kalon te prototipi.

Hyjlindësore

Në mënyrë të huaj mbetesh e virgjër, duke e lindur Bërësin e të gjithave[30] që prehet mbi fron Keruvik,[31] Perëndinë e himnueshëm e të përmbilavdishëm të etërve,[32] o nënë virgjëreshë e tërëhimnuar, e vetmja e gjithëlumur.

Ode VIII
Thávmatos iperfiús

Nëpërmjet zjarri mendor e dogje si shkarpë lëndën e tërë të herezisë; dhe me thirrje hyjnore there, si Ilia, me shpatën e Shpirtit[33] priftërinjtë e turpit;[34] dhe tani këndon duke dëfryer: Le ta bekojë e tërë Krijesa Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.[35]

U shfaqe i mbushur me hir dhe fuqi të perëndishme, o i tërëlumur, i stolisur me bukuri mençurie të famshme dhe duke ndjekur paepur besën e mirë; me të tani qëndron pranë Zotit dhe thërret: Le ta bekojë Krijesa Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.[35]

Nga lart na mbikëqyr ne himnuesit e tu, o atë hyjmendës shumë i hyjshëm; dhe me lutjet e tua na hijeso udhë të drejtë, dhe dërrmoji tërbimet e herezive, që të këndojmë të gëzuar: Le ta bekojë e tërë Krijesa Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.[35]

Hyjlindësore

S'ka absolutisht njollë në bukurinë tënde,[36] sepse vetëm ti u duke e tërëpacenuar që nga jeta, o e gjithëkulluar, dhe shkëlqeve botën me llamburitje virgjërore dhe dritë dëlirësie; prandaj, duke të përhimnuar, thërrasim: Le ta bekojë e tërë Krijesa Zotin dhe le ta përmbilartësojë në gjithë jetët.[35]

Irmosi: Thávmatos iperfiús

»Furra vesëplotë[37] na tregoi një she»mbull të çudisë që shkeli natyrën; se »ajo s'i dogji Tre Djemat që priti, ashtu »dhe zjarri i qiellit s'e ngau Virgjëre»shën aspak. Pra, le ta himnojm' e le »t'i falemi, e bekoni të gjithë Zotin me »zë të madh dhe e lartësoni përmbi të »gjithë jetët.[35]*

Ode IX
Tipon tis agnís lohias su

Gjete,* i fortadmirueshëm,* hyjpru-
rës, çmim për lodhjet, duke banuar
lart,* në tenda, në q'ell,* porsi i denj',
hieromartir;* me të hyjshmet ushtrit'
e martirëve* po shoqërohesh sipër,*
o Emilian, si kryeprift hyjnor.

Në fjal',* në urti dhe dogma drejt* u
shfaqe i stolisur, o i shkëlqyer krejt;*
prandaj, Emilian* i tërëpasur, të çmu-
arën* kok' ta kurorëzoi Jisui Krisht;*
ky tani, atë, zbutet* se përgjërohesh
pranë tij për ne.

Ngriti* dyer[38] qiellore lart* dhe priti
Zoti shpirtin tënd, Emilian shenjtor;*
në prehje e ka,* në vende çlodhjeje,
oshënar,* sepse është i drejtë Çli-
ruesi;* edhe tani lëviz ti* rreth fronit
pra të tërëmbretit Krisht.

Hyjlindësore

Oh sa* mrekulli përmbi mend bën,*
e fortdëlir' e vetme, Zonjë e virgjër
pra!* Secilit i dhe* që ta kuptojë çu-
din' tënde* fill të re, e kulluar, në
shtatzëni;* ndaj pa pushim, o Zonjë,*
të madhështojmë ty, Hyjlindëse.

Irmosi: Tipon tis agnís lohias su

»Barrën* tënde të kulluar ja* si tip
»e dha një ferr' e zjarrtë që s'digjej
»dot;*[39] kërkojmë tani* të shuash
»furrën e ngasjeve,* se ajo egërso-
»het keq kundër nesh,* që të të ma-
»dhështojmë* gjithmonë pa pushim,
»Hyjlindëse.

Dërgimësore
Tis mathités sinélthomen

Kur kundër Kishës një barbar* u
hodh, Leoni bishë,* si Hadh që s'ngo-
pet, urdhër dha:* "Ikonave të shenj-
ta* ju mos iu falni";* atëher',* o Emi-
lian i lumur,* me forcë e qortove ti*
herezinë pra krejt hyjluftuese* dhe
të neveritshme që kish tirani;* prej
tij durove mjaft shtrëngim* dhe in-
ternime hidhur.

E së kremtes E njëjtë

I more para Kryqit tënd* të parët nga
dishepujt,* o Zot, ndërrove pamje ti*
mbi shenjtin mal, Thavorin,* ku Moi-
siu, Ilia* pranë me tmerr qëndruan;*
si shërbëtorë flisnin qart'* me ty, o
Shpëtimtar Krisht; me ta dhe ne* Atit,
Shpirtit dhe ty të falemi pra,* se për
shpëtimin njerëzor* shndrite prej Vir-
gjëreshës.

Pasvargje të Lavdërimeve
Të së kremtes
Ting. II Ikos tu Efrathá

Shndrite i bardhë, Krisht,* më shu-
më se dëbora,* kur zhveshe pak

esencën* e lavdit tënd që s'preket* përpara Nxënësve të tu.

Varg: Të tutë janë qiejt dhe jotja është toka.

Drita e diellit* që lart vrapon, u hoq, Zot* Krisht Shpëtimtar, përpara* pra këmbëve të tua;* të shfaqi Bërës botëror.

Varg: Thavori dhe Hermoni në emrin tënd do të ngazëllohen.

Deshe që lavdin tënd* te Nxënësit ta shfaqje* në mal; kur me Ilian* dhe Moisiun të pan,'* tmerr kishin, Shpëtimtar, ata.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. I

Të parët e apostujve, kur e panë pakrahasueshmërinë e dritëderdhjes sate dhe paafrueshmërinë[40] e Hyjnisë mbi malin e Metamorfozës, o Krisht pa fillim, u ndryshuan me ekstazën hyjnore; dhe, pasi shkëlqyen rreth e rrotull me re të ndritshme, dëgjonin një zë atëror që e siguronte misterin e trupëzimit tënd; se një je edhe pas mishërimit, Bir i vetëmlindur[7] dhe Shpëtimtar i botës.[41]

Dhe të tjera si zakonisht

CITIME

[1] Hebr. 1.3
[2] II Tim. 2.3
[3] Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
[4] Eks. 3.14
[5] Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
[6] I Kor. 15.45
[7] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[8] Ps. 88(89).13
[9] Baruh 4.24
[10] I Kor. 15.51-52
[11] Ps. 50(51).14
[12] Ps. 57(58).7
[13] Joan 1.14
[14] Fil. 2.7
[15] Lluk. 24.49
[16] I Mbret. [Sam.] 2.2; II Mbret. [Sam.] 7.22; I Kor. 2.8
[17] Num. 14.19 etj.
[18] Ps. 23(24).8
[19] Vep. 14.3; 20.32
[20] Ps.118(119).131
[21] Kol. 3.5
[22] Rom. 8.6-7
[23] Sirak 24.8
[24] Kol. 3.1-2
[25] Urt. Sol. 2.24
[26] Jona 2.1-11
[27] Gjen. 8.21 etj.
[28] Eks. 7.14-12.29
[29] I Mbret. [Sam.] 17.40-50
[30] Joan 1.3; Kol.1.16
[31] IV [II] Mbret. 19.15; Jez. 10.1; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 31
[32] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[33] Ef. 6.17
[34] III [I] Mbret. 18.36-40

[35] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[36] Kënga 4.7
[37] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
[38] Ps. 23(24).7,9
[39] Eks. 3. 2-5
[40] I Tim. 6.16
[41] I Joan 4.14

MË 15 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i Fjetjes së Zonjës sonë të Tërëshenjtë Perëndilindëse dhe të gjithmonëvirgjër Maria.

Tipikon

Nëse bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, pas Kathizmës së parë të Psaltirit, Thirrtoret: 4 ngjallësore dhe 6 të së kremtes. Lavdi dhe Tani i së kremtes. Hyrje. O dritë gazmore. *Leximet. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i së kremtes. Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes (2x).*

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik, Litia e së kremtes, Himnet Triadike, Trishenjti. Përlëshorja e së kremtes. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore dhe, në vend të Hyjlindësoreve, nga një Ndenjësore të së kremtes. Pas Polieleit (Psalmi 44), Ndenjësorja e së kremtes (2x). Bekimtoret. Ipakoia dhe Shkallesat e Tingullit. Proqimeni i së kremtes. Çdo frymë. *Ungjilli i së kremtes.* Ne që pamë ngjalljen. *Psalmi 50 hima. Lavdi etj. të së kremtes. Kanunet: ngjallësor dhe të së kremtes, madje me Irmoset e tyre. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia Ngjallësore. Ipakoia e së kremtes. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e së kremtes, dhe Sinaksari. Zbritësoret e së kremtes. Në vend të* Më të nderuarën, *Ode IX [ngjallësore dhe] e së kremtes bashkë me Madhështimet e saj. Dërgimësoret: ngjallësore dhe e së kremtes (2x). Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të së kremtes (d.m.th. duke përsëritur të parën). Lavdi i së kremtes. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Antifonet e së kremtes, Hyrtorja e së kremtes, por Shpëtona..., që u ngjalle prej së vdekurish. *Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore dhe e së kremtes. Kontaqi i së kremtes. Apostulli dhe Ungjilli i së kremtes. Në vend të* Të meriton, Gjithë gjeneratat; Në ty u mundën kushtet. *Kungatore* Kupë shpëtimi. Pamë dritën.

NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Thirrtore
Ting. II Piis efimión stémasin

Me çfarë buzësh ne të pavlefshmit ta lumërojmë Perëndilindësen, që është më e çmuar se Krijesa dhe më e shenjtë se Keruvimet dhe gjithë engjëjtë, fronin e palëkundshëm të mbretit, shtëpinë në të cilën banoi i Tërëlarti, shpëtimin e botës, shenjtëroren e Perëndisë, e cila në kujtimin e saj të hyjshëm u jep pasurisht besnikëve përdëllimin e madh.[1]

(2x)

Cilat ishin këngët e frikshme, që të ofruan atëherë, o Virgjëreshë, të tërë apostujt e Fjalës, duke qëndruar rreth krevatit tënd dhe duke thirrur me çudi: Ngrihet pallati i Mbretit, lartësohet arka e shenjtërimit.[2] Ngrihuni, o porta, që të hyjë[3] porta e Perëndisë[4] me shumë hare, që kërkon pa pushim për botën përdëllimin e madh.[1]

Çfarë këngësh shpirtërore të të ofrojmë tani ty, o Virgjëreshë? Sepse, në Fjetjen tënde të pavdekshme, e shenjtërove mbarë kozmosin dhe shkove drejt mbitokësoreve, që ta konceptosh bukurinë e të Tërëpushtetshmit dhe që të ngazëllohesh si nënë me të; u shpërngule kur të rrethonin, o e dëlirë, brigada engjëllore dhe shpirtra të drejtësh, tok me të cilët kërko për ne paqe dhe përdëllim të madh.[1]

Lavdi *dhe* Tani

Ting. II I Anatoliut

Ajo që është më e lartë se qiejt, më e lavdëruar se Keruvimet dhe më e çmuar se çdo krijesë, e cila për hir të pastërtisë së tepërt u bë ena e substancës së përjetshme, sot e dorëzon shpirtin e tërëshenjtë në duart e Birit;[5] dhe mbushet me hare ajo dhe së bashku me të Gjithësia, dhe neve na dhurohet përdëllimi i madh.[1]

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efrathá

Bashkësia e Nxënësve, pasi erdhën nga skajet e botës me shenjë të tërëfuqishme, mblidhet që të varrosë nënë Hyjlindëse.

Varg: Ngrihu, o Zot, në prehjen tënde, ti dhe arka e shenjtërimit tënd.

Nusja e Perëndisë, mbretëresha e virgjër, lavdia e të zgjedhurve, krenaria e virgjëreshave shpërngulet drejt Birit.

Varg: I betoi Zoti Davidit një të vërtetë, dhe nuk do ta shkelë.

U mblodh kori i Nxënësve çuditërisht nga skajet e botës, që ta varrosë trupin tënd të hyjshëm dhe pa cen.

Lavdi *dhe* Tani

I ngjashëm

O Zonjë e mirë, ngriji duart e tua të shenjta drejt Birit tënd, Gatuesit shpirtdashës, që t'i dhembshurojë shërbëtorët e tu.

Përlëshore

Në lindjen tënde...

NË MBRËMËSOREN E MADHE

Pas Qëndrimit të Parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)

Thirrtore
Ting. I O tu paradhoksu thávmatos

O çudi paradoksale krejt,* po vendoset në varr* kroi, gurr' i jetës[6] fill;*[7] drejt qiellit shkallë bëhet varri, ndaj dëfre,* ki gaz, o Gjetsemani,* se të ka tempull të shenjtë Hyjlindësja;* besnik', të thërrasim ne* me Gabrielin në krye si gjeneral:* Ti gëzohu,[7] o Hirplotë,* Zoti është tok me ty,*[8] dhe i jep përmes teje* botës mbarë përdëllim të madh.[1]

(2x)

Obobo misteret që i ke!* U tregove, Zonj', fron* i të Tërëlartit Zot;* në qiell nga dheu shkove, e dëlirë, sot;* ka lavdi yt hijeshi,* shkëlqen me hire ndriçimi prej Perëndis'.* Me nënën e mbretit Krisht* drejt lartësisë, të virgjra, ju ngrihuni.* Ti gëzohu,[7] o Hirplotë,* Zoti është tok me ty,*[8] dhe i jep përmes teje* botës mbarë përdëllim të madh.[1]

(2x)

Fjetjen tënde lavdërojnë lart* Fronet, Forcat, si dhe* Autoritetet, tok* Pushtetet[9] dhe Keruvimet, Serafimet, pra* të frikshme; kanë gëzim,* stolisen njerëz për lavdin tënd të hyjshëm,* posht' bien engjëj, mbretër* dhe Kryeengjëj, përkulen, këndojnë pra:* Ti gëzohu,[7] o Hirplotë,* Zoti është tok me ty,*[8] dhe i jep përmes teje* botës mbarë përdëllim të madh.[1]

(2x)

Lavdi *dhe* Tani

Ting. I: Me një shenjë të hyjpushtetshme, apostujt hyjprurës, duke u ngritur lart nga gjithkund prej resh,
Ting. Tërth. I: Pasi arritën në lipsanin tënd të tërëpacenuar dhe jetëzotërues, e puthnin mrekullueshëm,
Ting. II: Ndërsa forcat më të sipërme të qiejve, pasi erdhën së bashku me Zotin e tyre,
Ting. Tërth. II: Të pushtuar nga frika, përcillnin trupin hyjpritës dhe tepër të pastër; dhe paraprinin në mënyrë përmbibotërore, dhe u thërrisnin padukshëm brigadave më të larta: Ja ku arriti hyjbija tërëmbretëresha;
Ting. III: Ngrijini portat,[3] dhe mirëpritni në mënyrë përmbibotërore atë, nënën e dritës[10] së përjetshme;
Ting. i Rëndë: Sepse përmes saj u krye shpëtimi i gjithë gjinisë së vdekatarëve; nuk mundemi ta vëzhgojmë atë, dhe është e pamundur t'i japim një çmim të vyer;
Ting. IV: Sepse superioriteti i saj kapërcen çdo mendim.

Ting. Tërth. IV: Prandaj, o Perëndilindëse e pacenuar, që jeton gjithmonë tok me Birin dhe mbretin jetëprurës, ndërmjeto përherë që t'i ruajë dhe t'i shpëtojë të rinjtë[10a] e tu nga çdo sulm kundërshtar, se e kemi mbrojtjen tënde

Ting. I: Ne që të lumërojmë shkëlqyeshëm në jetë.

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i ditës dhe Leximet

Këndimi i Gjenezës
(28.10-17)

Doli Jakov*i* nga pusi i betimit dhe shkoi në Harran dhe gjeti një vend dhe fjeti aty, sepse perëndoi dielli. Dhe mori një nga gurët e vendit dhe e vuri nën kokën e tij edhe fjeti në atë vend edhe pa një ëndërr. Dhe ja, një shkallë e mbështetur në tokë, maja e së cilës arrinte në qiell, dhe engjëjt e Perëndisë ngjiteshin dhe zbrisnin mbi të, ndërsa Zoti po mbështetej mbi të, dhe tha: "Unë *jam* Perëndia i Abrahamit, atit tënd, dhe Perëndia i Isaakut; mos ki frikë. Toka mbi të cilën ti fle mbi të, ty dhe farës sate do t'ia jap. Dhe do të jetë fara jote si rëra e dheut dhe do të shtrihet në perëndim dhe në jug, dhe në veri, dhe në lindje. Dhe do të bekohen në ty dhe në farën tënde të gjitha fiset e tokës. Dhe ja, unë *do të jem* me ty, duke të ruajtur në çdo udhë ku do të ecësh. Dhe do të të kthej në këtë tokë, sepse nuk do të të braktis, derisa të bëj të gjitha ato që të thashë". Dhe u ngrit Jakov*i* nga gjumi i tij dhe tha: "Se është Zot*i* në këtë vend, kurse unë nuk e dija". Dhe u frikësua dhe tha: "Sa i frikshëm qenka ky vend! Nuk është ky, veçse shtëpi Perëndie, dhe kjo *është* porta e qiellit".

Këndimi i profecisë së Jezekielit
(43.27-44.4)

"Do të jetë që, nga dita e tetë dhe më pas, do të bëjnë priftërinjtë mbi altar holokaustet tuaja dhe ato të shpëtimit tuaj. Dhe do t'ju pranoj", thotë Zot*i*. Dhe më ktheu drejt udhës së portës së jashtme të të Shenjtave, që sheh nga lindja, dhe ajo ishte e mbyllur. Dhe Zot*i* tha tek unë: "Kjo portë do të jetë e mbyllur, nuk do të hapet, dhe askush nuk do të kalojë nëpërmjet saj, se Zoti, Perëndia i Izraelit, do të hyjë përmes saj, dhe do të jetë e mbyllur, sepse ky prijës rri mbi të që të hajë bukë. Ai do të hyjë nga udha e portës së Elamit, dhe nga udha e tij do të dalë". Dhe më futi nga udha e portës *që ishte* drejt veriut, përballë shtëpisë. Dhe pashë, dhe ja plot lavdi *ishte* shtëpia e Zotit.

Këndimi i Fjalëve të Urta
(9.1-11)

Urtësia ndërtoi për vete shtëpi dhe mbështeti shtatë shtylla. Theri viktimat e saj dhe përzjeu në kanë verën e saj dhe përgatiti tryezën e saj. Dërgoi shërbëtorët e saj, duke ftuar me shpallje të lartë mbi kanë, duke thënë: "Ai që është i metë, le të kthehet tek unë". Dhe atyre që ishin të varfër nga mendja, u tha: "Ejani, hani bukën time dhe pini verën që ju kam përzier. Braktisni idiotësinë dhe do të rroni; dhe kërkoni urtësinë, që të jetoni dhe që të arrini mençurinë me dije. Ai që edukon të këqij, do të marrë për vete çnderim dhe, duke kritikuar të pabesin, do të qortojë veten e tij; sepse kritikat për të pabesin *janë* plagë për të. Mos kritiko të këqij, që të mos të urrejnë; kritiko të urtin dhe do të të dojë. Jepi të urtit një shkak dhe do të jetë më i urtë; bëj të ditur tek i drejti dhe do të shtojë të pranojë. Fillim urtësie *është* frika e Zotit, dhe mendim shenjtorësh *është* mençuria. Ndërsa dija e ligjit i përket mendjes së mirë, sepse në këtë mënyrë do të jetosh shumë kohë dhe do të të shtohen vite jete".

Në Liti Idhiomele
Ting. I

U duhej shërbyesve dhe okularëve të Fjalës[11] ta shikonin edhe fjetjen e nënës së tij sipas mishit, që ishte misteri i saj i fundit, që të mos shihnin vetëm ngritjen e Shpëtimtarit nga dheu,[12] por edhe të dëshmonin shpërnguljen e asaj që e lindi; prandaj, pasi tejkaluan nga gjithkund me fuqi hyjnore, arritën në Sion dhe përcillnin më të lartën se Keruvimet, e cila nxitohej për në qiell. Asaj dhe ne bashkë me ta i falemi, sepse ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Ting. II I Anatoliut

Ajo që është më e lartë se qiejt, më e lavdëruar se Keruvimet dhe më e çmuar se çdo krijesë, e cila për hir të pastërtisë së tepërt u bë ena e substancës së përjetshme, sot e dorëzon shpirtin e tërëshenjtë në duart e Birit;[5] dhe mbushet me hare ajo dhe së bashku me të Gjithësia, dhe neve na dhurohet përdëllimi i madh.[1]

I njëjti I Joanit

Nusja e tërëpaqortueshme dhe nëna e dashamirësisë së Atit,[13] e cila u paracaktua nga Perëndia për banesën e vet me bashkim pa përzierje, sot ia dorëzon shpirtin e pacenuar Bërësit dhe Perëndisë. Atë e mirëpresin hyjshëm fuqi të patrup; dhe shpërngulet për në jetë nëna e vërtetë

e jetës,[6] llambadhja e dritës së paafrueshme,[14] shpëtimi i besëmirëve dhe shpresa e shpirtrave tanë.

Ting. III I Gjermanoit

Ejani, të gjithë anët e dheut, le ta lumërojmë shpërnguljen e nderuar të Hyjnënës, sepse e dorëzoi në duart e Birit shpirtin e paqortueshëm;[5] prandaj, në Fjetjen e saj të shenjtë, bota u ringjall duke kremtuar ngazëllueshëm bashkë me të patrupët dhe me apostujt, me psalme e himne dhe me këngë shpirtërore.[15]

Lavdi

Ting. Tërth. I I Theofanit

Ejani, o organizata kremtimdashëse, ejani dhe le të ngremë kor; ejani ta kurorëzojmë me këngë Kishën me rastin e prehjes së arkës së Perëndisë;[2] se sot qielli shtrin gjirin duke pranuar lindësen e atij që nuk nxihet nga asgjëja; dhe dheu, duke dhënë burimin[6] e jetës,[7] stoliset me bekimin dhe hijesinë; engjëj janë në krye bashkë me apostuj, duke parë me frikë të kalojë nga jeta drejt jete atë që lindi kryetarin e jetës;[16] të gjithë le t'i falemi asaj duke lypur: Mos harro, o Zonjë, familjaritetin farefisnor të atyre që besërisht kremtojnë Fjetjen tënde të tërëshenjtë.

Tani *I njëjti*

Këndoni, o popuj, për nënën e Perëndisë sonë, këndoni; sepse sot shpirtin e saj të tërëndritshëm e dorëzon[5] në pëllëmbët e pacenuara të atij që u mishërua prej saj pa farë; tek ai ndërmjeton pandërprerë që t'i dhurohet botës paqe dhe përdëllim i madh.[1]

Pasvargje Idhiomele
Ting. IV

Ejani të përhimnojmë, o popuj, Virgjëreshën e Tërëshenjtë, të dëlirë, nga doli parrëfyeshëm, pasi u mishërua, Fjala[17] e Atit; dhe le t'i themi duke thirrur: E bekuar je ndër gra,[18] i lumur është barku që nxuri Krishtin;[19] meqë e dorëzove shpirtin në duart e tij[5] të shenjta, ndërmjeto, o e pacenuar, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Varg: Ngrihu, o Zot, në prehjen tënde, ti dhe arka e shenjtërimit tënd.

Fjetjen tënde të gjithënderuar, o Virgjëreshë e tërëshenjtë, e dëlirë, e lumërojnë shumicat e engjëjve në qiell dhe gjinia e njerëzve mbi dhé, sepse u bëre nëna e Bërësit të të gjithave,[20] e Krishtit Perëndi; përgjërohemi, mos pusho së lypuri atë për ne që, pas Perëndisë, te ti i kemi vënë shpresat, o Hyjlindëse e tërëhimnuar që s'njohe dasmë.

Varg: I betoi Zoti Davidit një të vërtetë dhe nuk do ta shkelë.

O popuj, le t'i këndojmë sot këngë davidiane Krishtit Perëndi; thotë: "Do të sillen te mbreti të virgjra pas asaj, do të sillen me ngazëllim dhe hare";[21] sepse ajo që ishte nga fara e Davidit,[22] përmes së cilës ne u hyjnizuam, zhvendoset lavdishëm dhe përmbi mendje në duart e Birit të saj dhe Zotit;[5] duke e përhimnuar si nënën e Perëndisë, i thërrasim dhe i themi: Ne që të pohojmë si Hyjlindëse, na shpëto nga çdo peripeci, dhe çliroji nga rreziqet shpirtrat tanë.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. IV

Kur u zhvendose, o Hyjlindëse e virgjër, drejt atij që lindi prej teje pashprehshëm, ishin të pranishëm Jakovi, vëllai i Zotit,[23] dhe hierarku i parë, Petroja, kulmi i tërëçmuar, korifeu i theologëve,[23a] dhe mbarë kori i hyjshëm i apostujve, duke himnuar me theologji të hapura misterin hyjnor dhe të mrekullueshëm të ekonomisë së Krishtit Perëndi; dhe pasi varrosën trupin tënd jetëzotërues dhe hyjpritës, ngazëlloheshin, o e tërëhimnuar; dhe nga lart Fuqitë e tërëshenjta dhe tejet të vjetra të engjëjve, duke u habitur nga çudia, i thoshin njëra-tjetrës të kërrusura: "Ngrini portat tuaja[3] dhe prisni atë që lindi Bërësin e qiellit dhe të dheut;[20] dhe me dhoksologji le ta përhimnojmë trupin e respektuar dhe të shenjtë, që nxuri të padukshmin prej nesh dhe Zotin". Ndaj dhe ne, duke kremtuar kujtimin tënd, të thërrasim, o e tërëhimnuar: Ngrije bririn[24] e të krishterëve dhe shpëtoji shpirtrat tanë.

Përlëshore Ting. I

Në lindjen tënde virgjërinë e ruajte, në fjetjen tënde s'e braktise botën, o Virgjëreshë. Në jetën e qiellit shkon,[25] jetën si linde[7] këtu mbi dhé dhe i shpëton gjithnjë prej vdekjes shpirtrat tanë, o Hyjlindëse.[7]*

(3x)

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Thirre, o David me zë,* ç'është e kremtja që bëjm' sot?* Ësht' për vajzën - thotë ky -* që përhimnova në Psaltir,* në librin tim, si të virgjër, fëmijë, hyjbij';*[26] Krishti, që pa farë e lindi kjo,* në banesa përtej[27] po e zhvendos* edhe prandaj gëzohen në-

nat, bijat,* si edhe nuset e Krishtit;* thërresin: Ki gaz* ti që shpërngulesh* pra për në mbretëri lart.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotír

U mblodh çuditërisht* kori tepër i çmuar,* i urtë i apostujve, që ta varroste* me lavd, fort e himnuara Zonj', Hyjlindëse, trupin tënd* pa cen; psalën tok* shumica engjëjsh, lëvduan* me respekt dhe nder* shpërnguljen tënde, të cilën* me bes' e kremtojmë ne.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Pas Polieleit (Psalmi 44) Ndenjësore
Ting. III Tin oreótita

Në lindjen tënde qe* zënie pa farë hiç,* në Fjetjen tënde qe* vdekje pa prishje krejt,* çudi rastisi në çudi, Hyjlindëse, të dyfishtë;* si, pa njohur burrë kurr', e dëlirë pa cen, jep gji?* Si, nën' Perëndie pra,* nxjerr aroma e vdekur ti?* Me engjëllin kështu tok thërrasim:* Zonjë hirplote, po gëzohu.[8]

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Shkallesa. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

Do ta kujtoj emrin tënd në gjithë brezat e brezave.

Varg: Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do ta dëshirojë mbreti bukurinë tënde.

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Tani. *I njëjti*

Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II I Bizantit

Kur po rregullohej zhvendosja e lipsanit tënd të pacenuar, atëherë apostujt, duke rrethuar shtratin tënd, të shikonin me tmerr; dhe duke vëzhguar trupin, shtangeshin nga habia, ndërsa Petroja të thërriste me lot: "O Virgjëreshë, të shoh qartësisht të jesh e shtrirë në kurriz ti, jeta e të gjithave, në të cilën fushoi shijimi i jetës së ardhshme, edhe shtangem". O e pacenuar, përgjëroju vazhdimisht Birit tënd dhe Perëndisë, që të shpëtojë qyteti yt pa plagë.

Kanunet
Ode I
Kanuni i parë që ka Akrostihidhë:
"Le të bëjnë panair hyjmendësit".
Poezi e zotit Kozma.
Ting. I
Irmosi: Pepiqilmeni ti thia dhoksi

»I zbukuruar me lavd[28] të hyjshëm,* »kujtimi yt i shenjt', i lavdëruar, Vir- »gjëresh',* mblodhi besimtarët mba- »rë për dëfrim tok me Marjamën në »krye me timpan* dhe me kërcime,[29] »t'i psalin* me këng' Birit tënd të ve- »tëm, Zot,* se lavdërisht u lëvdua ky.[30]

(2x)

Rreshtim pa trup që lëviz në qiell,* e rregullonte trupin tënd të hyjshëm në Sion;* befasisht nga çdo skaj pra i botës turma e apostujve erdhi bash- kërisht,* Perëndilindëse pa cen,* dhe pran' teje ndenji; lavdërojm'* me të kujtimin tënd plot me nder.

Kundër natyrës fitove çmime,* o e dëlirë, se në mitër kishe Perëndi;* por e imiton ti Bërësin tënd, Birin, ndaj nënshtrohesh te ligji natyror* për- mbinatyrshëm; kështu pra,* pasi vdes, ringjallesh përsëri,* që në am- shim me tët Bir të jesh.

Kanuni i dytë:
Poezi e Joan Damaskinoit

Ting. IV
Irmosi: Anikso to stoma mu

»Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej »Shpirtit[31] Shenjt* dhe këngë do t'i »këndoj nënës së madhe mbi fron;*[28] »dhe do ta kremtoj* me valle buzë- »qeshur,* me zë do ta shpall kudo »Fjetjen e saj me lavd.*

(2x)

Të reja të virgjra pra me profeteshën Marjama tok* tani brohoritni oden, këngën,[29] ju për varrim;* se e Virgjra Zonj',* Hyjlindësja e vetme,* zhve- ndoset për në përfundim qiellor me lavd.

Si qiell mendor të pritën denjësisht, e dëlirë krejt,* banesa hyjnore qiello- re; ndaj dhe qëndron* afër mbretit Zot* si nuse e stolisur*[28] pa fare qor- tim dhe me plot hijeshi e hir.

Zbritësore: Pepiqilmeni ti thia dhoksi

I zbukuruar me lavd.

Ode III
Kanuni i parë
Irmosi: I dhimiurjiqí qe sinektiqí

»Mbështet në çdo tundim* dhe lë- »kundje Kishën, o Krisht Zot,* urtia, »forca[32] krijuese,* koherente fort e »Perëndisë; ti mban çdo gjë,[33] me-

»që je* vetëm ti i shenjtë krejt* që »në shenjtorë pra prehesh,[34] o Jisu.

(2x)

Meqë të dinin ty* si të vdekshme grua të thjeshtë,* por mbi mend dhe nënë Zoti tok,* pa qortim krejt, tend' hyjpritëse, apostujt zëmëdhenj me nam* plot me lavd, të panë ty* të shndritje; plot tmerr të prekën ty me dor'.

Arriti, preu keq* duart arrogante plot sharje* pra drejtësia, se ruajti* nderin e së ngjallurës Ark' Perëndia;[2] se në të me mish* kishte qenë Fjala[17] Krisht* me lavd dhe dritë Hyjnie përmbi mend.

Kanuni i dytë
Irmosi: Tus sus imnologus

»O Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim »i pasosur jetësor,* ti siguroji gjith' »ata që të këndojnë plot me zell;* dhe »lart në q'ell ku mbretëron kurorëzoji[35] »me çdo lavdi.*

(2x)

Meqë nga një mes i vdekshëm dole, arrite në vdekje, e dëlir';* dhe me natyrën qe përshtatur, por, meqë vërtet linde* ti jetën,[7] u shpërngule drejt enipostates jetes'[25] hyjnisht.

Me shenjë të plotfuqishme rendi shumica e engjëjve nga lart* për në Sion dhe turma theologësh nga çdo cep në bot',* që denjësisht varrimit tënd pra t'i shërbenin, o Zonja jon'.

Zbritësore: I dhimiurjiqí që sinektiqí

Mbështet në çdo tundim

Ipakoia Ting. Tërth. I

Të lumërojnë të gjitha gjeneratat, o Hyjlindëse e virgjër,[36] sepse në ty deshi mirësisht të mbahej Krishti, Perëndia ynë i panxënshëm; të lumur jemi dhe ne që të kemi mbrojtje, sepse ditë-natë ndërmjeton për ne dhe skeptrat e mbretërisë forcohen me përgjërimet e tua; prandaj, duke përhimnuar, të thërrasim: Gëzohu, o Hirplotë, Zoti është me ty.[8]

Ode IV
Kanuni i parë
Irmosi: Risis profitón qe enígmata

»Fjalët dhe enigmat,[37] profecit',* e »shfaqën mishërimin tënd* prej Vir»gjëreshës sate, Krisht,* se do dilte »shndritja* e vetëtimës që dispo»non[38],* për drit' kombesh;[39] të thë»rret me gëzim avusha:* Forcës sate »lavdi, njeridashës Zot.

Shikoni, o popuj, dhe çudituni, sepse mali i shenjtë dhe tepër i dukshëm i Perëndisë ngrihet më lart se malet[40]

qiellore, duke u bërë banues, qiell tokësor, në dhé përmbiqiellor dhe të paprishshëm.

O e Kulluar e pacenuar, vdekja jote u bë kalimi për jetë[25] të amshuar dhe më të mirë; dhe të zhvendosi nga jeta mjerane drejt asaj hyjnore vërtet dhe të parrjedhshme, që ta vëzhgosh me ngazëllim Birin tënd dhe Zot.

U ngritën portat[3] qiellore, engjëjt përhimnuan dhe e priti Krishti thesarin e tij nënor të virgjërisë. Keruvimi[41] u zmbraps para teje me ngazëllim, ndërsa Serafimet të lavdërojnë me hare.

Kanuni i dytë
Irmosi: Tin aneksihníaston

»Të pagjurmësuarin plan perëndor,*
»që po mishërohet i larti Zot* prej Vir»gjëreshës,* Abakumi si profet e pa
»dhe tha me zë të madh:* O Zot i fuqi»shëm, lavdi më ty.*

Që habi ta shikoje qiellin frymor të Tërëmbretit të kalonte poshtë në boshllëqet e tokës. Sa të çuditshme janë veprat e tua![42] Lavdi fuqisë sate, o Zot.

Në shpërnguljen tënde, o nënë e Perëndisë, trupin tënd tejet të gjerë dhe hyjpritës, e mbulonin me frikë dhe hare ushtritë e engjëjve me anën e krahëve të tërëhyjshëm.

Në qoftë se fryti i saj i pakuptueshëm, për hir të të cilit u bë qiell, pësoi vullnetarisht varrim si i vdekshëm,[43] si do ta mohojë varrimin ajo që e kishte në bark pa dasmë?

Zbritësore: Risis profitón qe enígmata

Fjalët dhe enigmat

Ode V
Kanuni i parë
Irmosi: To thíon qe áriton kalos

»O Krisht, do tregoj bukurinë* hyjno»re që s'shprehet, që ka virtyti yt;*
»shkëlqim të bashkëpërjetshëm dhe
»enipostat* ti prej lavdis' së përher»shme ke feksur[44] nur;* nga bark i vir»gjër linde pra* dhe si diell shndrite
»fort* mbi gjith' sa ishin në errësir',
»hije.[45]

(2x)

O Virgjëreshë, si e hipur mbi re, bashkësia e apostujve mblidhej anembanë drejt Sionit, që të të shërbente ty, resë së lehtë,[46] nga e cila Perëndia i Tërëlartë si diell drejtësie[46a] shndriti fort mbi sa ishin në errësirë dhe në hije.[45]

Gjuhë të hyjzëna të burrave theologë, të cilat ishin më të forta se trumbeta, i thërrisnin Perëndilindëses himnin e varrimit, jehonën që kumbonte prej Shpirtit: Gëzohu, o burim pa cen i mi-

shërimit të Perëndisë, i cili ishte jetëzotërues dhe shpëtimtar për të gjithë.

Kanuni i dytë
Irmosi: Eksesti ta símpanta

»Të gjith' i habite ti me një çudi dhe »një lavdi,* ti, o Virgjëresh' e pamar»tuar;* ike nga dheu për në banesa »lart, në amshim dhe drejt jete[25] pa »mbarim,* dhe shpëtim që lartazi* u »dhurove besnikëve.*

(2x)

Le t'u bien trumbetave të theologëve sot, ndërsa gjuha shumëfolëse e njerëzve le ta mburrë tani, le të buçasë ajri duke shkëlqyer nga drita pa masë, dhe engjëjt le ta himnojnë Fjetjen e së Virgjrës.

Ena e zgjedhur[47] shquhej në himne për ty, i tëri i shtangur dhe i hutuar, i tëri i kushtuar Perëndisë, duke qenë me të vërtetë dhe duke u shfaqur i hyjzënë në çdo gjë, o Hyjlindëse e gjithëhimnuar.

Zbritësore: To thion qe áriton kalos

O Krisht, do tregoj

Ode VI
Kanuni i parë
Irmosi: Álion pontojenés

»Zjarri në një peshk të madh,* për»brenda, që lindi në det,* simboli»zonte varrimin tënd të triditshëm, »Krisht;* për të profet* u tregua shën »Jonai[43] qart',* i shpëtuar me një pro»videnc', kujdes, që më parë thirri* »pa dëm: Do flijoj për ty me zë himni, »Zoti im.[48]

(2x)

Mbreti, Zot i Gjithësis,'* të jep gjëra përmbi natyr',* se si në lindje të virgjër ky të kish ruajtur,* mbajti kështu* trupin tënd në varr pa prishje hiç;* edhe me zhvendosjen e hyjnueshme të lëvdoi ty tok* duke falur te ti çmime si Bir te nëna pra.

Si vërtet kandil[49] që shndrit* me zjarrin pa lënd', temjanic'* prej ari[50] me një qymyr hyjnor, shtambë[51] edhe shkop,*[52] arkë të shenjt',*[53] pllakë të hyjshkruar[54] dhe tryez'* që ka bukën,[55] jetën[56] pra, të ka fushuar, o Virgjëreshë,* yt Bir në të shenjtat e të shenjtëve[57] me lavdi.

Kanuni i dytë
Irmosi: Tin thian taftin qe pántimon

»Këtë të kremte e lusim sot, për »Zonjën edhe nënën Hyjlindëse, gjithë »hyjmendësit,* eni trokisni pra duar»të*[58] dhe lavdëroni Zotin që lindi prej »asaj.*

(2x)

Nuk zgjidhi kyçet e virgjëris', kur lindi nga ti jeta;[7] prandaj, si trupi yt me jetë plot* pa cen, kungoi përvojë, dëm,* pra vdekje, o Hyjlindëse Zonjë me lavdi?

Meqë ke qenë, Zonj', tempulli i jetës,[7] përfitove pra jetën e amshuar; dhe përmes* vdekjes kalove drejt jetës[25] lart* ti që e linde jetën[7] enipostate, Zot.

Zbritësore: Álion pontojenés

Zjarri në një peshk

Kontaqi
Ting. Tërth. II Tin en presvies

Atë që ësht' e pafjetur në ndërmjetime,* dhe shpresa që s'lëkundet, s'tundet pra në mbrojtje,* varri dhe vdekja s'e mbajtën, se në jet'* e transferoi si nënë jete[7] Krishti, bujti ky* në mitër gjithnjë të virgjër, të dëlir'.

Shtëpia

Armatose mendjen time, o Shpëtimtari im, sepse guxoj ta përhimnoj murin e botës, nënën tënde të pacenuar; më forco në pirg fjalësh dhe fortifikomë në bedena mendimesh; sepse ti thërret se përmbush kërkesat e atyre që kërkojnë besërisht;[59] prandaj, ti më dhuro gjuhë, shqiptim dhe mendim të paturpëruar, meqë çdo dhënie shkëlqimi dërgohet poshtë prej teje, o dritësjellës,[60] që bujte në mitër gjithnjë të virgjër, të dëlir'.

Sinaksari

Më 15 të të njëjtit muaj, kujtimi i Shpërnguljes së tërënderuar të Zonjës sonë të përmbilavdishme Perëndilindëse dhe të gjithmonëvirgjër Maria.
Varg: S'është çudi të vdesë Vajza që shpëtoi botën,/ përderisa vdiq mishërisht Gatuesi i botës.
Jeton përherë Hyjnëna, megjithëse vdiq në të pesëmbëdhjetën.

Me ndërmjetimet e saj të shenjta, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona si i mirë dhe njeridashës.

Ode VII
Kanuni i parë
Irmosi: Itamó thimó te qe pirí

»Kundërvihej shenjtja dashuri* tek »inati me arroganc'[61] dhe zjarr.*[62] E »freskonte krejt këtë[63]* qeste kundër »mërisë* me hyjfrymëzim në mend.* »Tre zëra si lirë oshënarësh kundër»shtonin fort* instrumentet, veglat,*[64] »mes flakëve:[65] O Perëndia ynë* dhe i »etërve, ti je* plot lavd dhe i bekuar.[66]

Moisiu dërrmoi me inat[67] pllaka të hyjbëra, të hyjshkruara[54] nga Shpirti Hyjnor; por Zoti i tij, si e ruajti pa dëmtim lindësen, tani e vuri të banonte në dhoma qiellore. Ajo dhe ne së bashku, duke kërcyer, i thërrasim Krishtit: O Perëndia ynë dhe i etërve, ti je plot lavd dhe i bekuar.[66]

Me cimbale, buzë të dëlira, kitara muzikore zemre, trumbeta tingëlluese mendjeje të lartë, duke duartrokitur me duar[58] praktike në ditën e shquar emërmadhe[68] të zhvendosjes së Virgjëreshës së kulluar, thërrasim: O Perëndia ynë dhe i etërve, ti je plot lavd dhe i bekuar.[66]

Populli hyjmendës u mblodh, sepse tenda e lavdisë së Perëndisë[69] nga Sioni shpërngulet drejt dhome qiellore, ku ka tingull të pastër të atyre që festojnë, zë ngazëllimi[70] të pashprehshëm prej atyre që i thërrasin me hare Krishtit: O Perëndia ynë dhe i etërve, ti je plot lavd dhe i bekuar.[66]

Kanuni i dytë
Irmosi: Uk elátrefsan

»Nuk u faleshin krijesave hyjmendë-
»sit,[71] por Kryetarit[72] lart* dhe kërcë-
»nimin me zjarr* e shkelën me trimë-
»ri, psalnin me brohori:* Zot, lavdi më
»ty, o Perëndi i etërve,* ti je vetëm i
»bekuar.[66]*

O djelmosha dhe virgjëresha, o pleq, arkondë, mbretër dhe gjykatës, duke nderuar kujtimin e Virgjëreshës dhe Hyjnënës, këndoni:[73] O Perëndi dhe Zot i etërve, je i bekuar.[66]

Le të trumbetojnë me borinë e Shpirtit malet qiellore; le të ngazëllohen tani kodrat dhe le të kërcejnë[74] apostujt e hyjshëm. Mbretëresha shpërngulet drejt Birit, duke dominuar me të përherë.

Zhvendosja e tërëhyjshme e nënës sate të shenjtë dhe pa cen mblodhi brigadat e Fuqive të sipërme përmbibotërore, që të dëfrehen bashkë me ata që të këndojnë ty mbi dhé: O Perëndi, je i bekuar.

Zbritësore: Itamó thimó te qe pirí

Kundërvihej shenjtja dashuri

Ode VIII
Kanuni i parë
Irmosi: Floga dhrosízusan osius

»Engjëlli plot fuqi nga Zoti* Djemve
»u tregoi flakë, zjarr,* që po digjte
»krejt besëkëqij,* por freskonte nur*
»pra oshënarët;[75] burim jetik Hyjli-
»ndësen e bëri* që prishje sjell te vde-
»kja, si dhe jetë te sa po këndojn':*
»"Ne, pra të çliruar, vetëm Bërësin e
»përhimnojmë,* e mbilartësojmë atë
»në gjithë jetët".

(2x)

E gjithë shumica e theologëve ndiqnin pas në Sion arkën e hyjnueshme të shenjtërimit,[53] duke thirrur me fjalë: Ku po ngjitesh tani, o tendë e Perëndisë së gjallë?[76] Mos resht së vëzhguari ata që besërisht këndojnë: “Ne, pra të çliruar, vetëm Bërësin e përhimnojmë, e mbilartësojmë atë në gjithë jetët”.

Duke u larguar, e tërëpaqortueshmja ngriti duart që përqafuan Perëndi në trup, dhe me guxim si nënë i tha të lindurit: Ruaji për jetë ata që për hirin tim i fitove, të cilët të thërrasin: “Ne, pra të çliruar, vetëm Bërësin e përhimnojmë, e mbilartësojmë atë në gjithë jetët”.

Kanuni i dytë
Irmosi: Pedhas evajís

»**D**jemtë* e dënuar për t’u djegur,
»prej zjarrit i ka shpëtuar lindj’ e Zotit
»Krisht, si simbol në lashtësi;*[77] dhe
»si një veprim tani,* dhe tërë botën
»po e mbledh për këng’ e lavdërim:*
»Himnojeni ju veprat e Zotit* dhe e
»lartësoni përmbi të gjitha jetët.[78]*

Kujtimin tënd, o Virgjëreshë e pacenuar, e lavdërojnë Autoritetet, Pushtetet, Fuqitë, Engjëjt, Kryeengjëjt, Fronet, Zotërimet,[9] Keruvimet dhe Serafimet e frikshme, ndërsa ne, gjinia e njerëzve, e himnojmë dhe e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Ai që, duke u mishëruar, banoi në mënyrë të huaj në mitrën tënde të pacenuar, si Bir borxhli e prehu në vetë shpirtin tënd, pasi e priti; prandaj ty, Virgjëreshën, të himnojmë dhe të përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Oh! Çuditë përmbi mendim të së Gjithmonëvirgjrës dhe Hyjnënës! Sepse, kur banoi në varr, e tregoi Parajsë; duke qëndruar pranë tij sot, psalim të gëzuar: Zotin himnojeni, o vepra, dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[78]

Zbritësore: Floga dhrosízusan osius

Engjëlli plot fuqi

Ode IX
Kanuni i parë
Madhështimi që psalet para çdo tropari të Kanunit: Gjithë gjeneratat po të lumërojmë, Hyjlindëse[36] e vetme.*

Irmosi: Neníqinte tis físeos

»**N**ë ty u mundën kushtet e natyrës,*
»o Virgjëreshë që s’ke cen;* lindja
»është e virgjër,* edhe morti fejohet
»me jetën tok;* o Virgjëreshë pas li»ndjes,* që rron pas vdekjes, shpë»tona* ne përgjithnjë,* trashëgimin
»tënd pra, o Hyjlindëse.

(2x)

Po shtangeshin Fuqitë qiellore,* kur shihnin Zotin e tyre* në Sion që

të merret* me një shpirt femëror;[79] i thërriste ky* si Bir asaj që e lindi* pa cen aspak: O e thjeshtë,* eja pra ti,* lavdërohu tok me Birin Perëndi.

Me frikë shihte trupin tënd hyjpritës,* kur po e rregullonte mir'* kori apostolik pra,* dhe thërriste me zë melodik ai:* Drejt Birit tënd ku po shkon ti,* në dhoma sipër, në qiell* gjithnjë shpëto,* o Hyjlindëse, trashëgimin' tënde.[80]

Kanuni i dytë

Madhështimi që psalet para çdo tropari të Kanunit: Engjëjt lart* çuditeshin duke parë* pra Fjetjen e Hyjlindëses.* Si Virgjëresha po ngrihet* nga toka sipër në qiell!

Irmosi: Apas jijenís

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazë»llim te drit' e Shpirtit Shenjt,* eni »lavdërojeni;* engjëjt e q'ellit, eni »kremtojeni* këtë të shenjtë panair »të kryezonjës Mari* dhe thërrisni:* »Ti je më e lumura,* Virgjëresh' e ku»lluar Hyjlindëse.*

Ejani në mal pjellor dhe të shenjtë, pra të Perëndis'[81] së gjall'*[76] në Sion, të kemi gaz* ne duke parë Perëndilindësen;* sepse drejt tendës më të mirë, më të hyjshme nur,* në të Shenjtat* e të Shenjtëve,[57] si nën'* Krishti po e zhvendos me një lavd të madh.

Lavdi

Engjëj lart* çuditeshin...

Ejani, besnik', të shkojmë ne afër varrit të Hyjlindëses* dhe ta përqafojm' me mall;* me zemër, buzë, ballë, sy sinqerisht* ta prekim dhe të nxjerrim me bollëk karizma, hir* për shërime,*[82] si nga një burim gufojn'* përgjithmonë lavd pra edhe çdo bekim.

Tani

Engjëjt lart* çuditeshin...

Prit prej nesh një këng' varrimi, o nënë Perëndie që jeton,*[76] dhe me hirin tënd hyjnor* dhe dritëprurës na hijeson; dhe jep* si çmim te populli krishtdashës paqe, dhe trofe,* forc' te mbreti,* tek ata që psalin tok* faljen edhe shpëtimin e shpirtrave.

Zbritësore: Neníqinte tis físeos

Gjithë gjeneratat

Në ty u mundën

Dërgimësore

Apostuj që u mblodhët, këtu nga anët e dheut, në fshat të Gjetsemanisë, po trupin ju ma varrosni; dhe Perëndi edhe Bir' im, eja dhe merrma ti shpirtin.*

(3x)

Lavdërime
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Qiejt kanë gëzim të madh* dhe Fuqitë e engjëjve* ngazëllohen në Fjetjen tënde me plot lavd* dhe dheu mbarë dëfren, o Virgjëreshë e tërëshenjt',* duke thirrur te ti himn* funeral, se je lindësja e sunduesit* të të gjithave,[83] ti që s'njohe dasmë dhe shpëtove gjindjen tonë prej një vendimi stëratëror.[84]

(2x)

Me një shenjë prej Perëndis',* që ta bënin varrimin tënd,* nga çdo cep i sferës, apostujt e mëdhenj* rendën tok; dhe kur të pan' nga toka sipër të ngriheshe,* të thërrisnin me hare,* si të tha Gabrieli ty:* Mjet që përmbi ty* erdhi mbarë Hyjnia, ki gaz,[8] vetëm ti bashkove tokësoret edhe të lartat në Birin tënd.

Jetën[7] mbajte në barkun tënd,* për në jetë lart shkove ti* përmes Fjetjes sate[25] plot nder, pavdekësi;* po të rrethonin Fuqit', apostujt, engjëjt, profetët tok* Autoritetet, bashk'*[9] me të tërë Krijesën pra,* ndërsa Biri yt* në pëllëmbët e tij pa cen pranonte shpirtin tënd të paqortuar, Hyjnuse, nënë e virgjër krejt.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. Tërth. II

Në Fjetjen tënde të pavdekshme, o Hyjlindëse, nëna e jetës,[7] re i rrëmbenin në ajër apostujt dhe, ndonëse ishin të shpërndarë nëpër botë, qëndruan në një vend, pranë trupit tënd të pacenuar; ata, pasi bënë varrimin me respekt, thërrisnin me melodi thënien e Gabrielit: "Gëzohu, o Hirplotë, Virgjëreshë, nënë e panusëruar; Zoti është me ty".[8] Së bashku me ta përgjëroju atij, si Birit tënd dhe Perëndisë sonë, që të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Dhoksologjia e Madhe

U jepet vëllezërve dhe vaj i shenjtë.

Në Liturgji, Antifonet:
Antifoni I

Varg a): Brohoritini Zotit gjithë dheu.
Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg b): Lavdërojeni atë, himnojeni emrin e tij.
Me ndërmjetimet.

Varg c): Në qytetin e Zotit të fuqive, në qytetin e Perëndisë sonë.
Me ndërmjetimet.

Varg d): U bë në paqe vendi i tij dhe banesa e tij në Sion.
Me ndërmjetimet.

Lavdi *dhe* Tani
Me ndërmjetimet.

Antifoni II

Varg a): I do Zoti portat e Sionit më shumë se të gjitha tendat e Jakovit.

Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, o i çuditshëm ndër shenjtorët, ne që të psalim aliluia.

Varg b): Të lavdishme u folën për ty, qytet i Perëndisë.

Shpëtona.

Varg c): Perëndia e themeloi atë në jetë.

Shpëtona.

Varg d): Shenjtëroi tendën e tij i Shumëlarti.

Shpëtona.

Lavdi *dhe* Tani

O i vetëmlindur

Antifoni III

Varg a): Është gati zemra ime, o Perëndi, është gati zemra ime.

Në lindjen tënde virgjërinë e ruajte, në fjetjen tënde s'e braktise botën, o Virgjëreshë. Në jetën[25] e qiellit shkon, jetën[7] si linde këtu mbi dhé dhe i shpëton gjithnjë prej vdekjes shpirtrat tanë, o Hyjlindëse.*

Varg b): Me çfarë do ta shpërblej Zotin për të gjitha që më shpërbleu?

Në lindjen tënde.

Varg c): Kupë shpëtimi do të marr dhe emrin e Zotit do ta thërras.

Në lindjen tënde.

Hyrtore

Ejani t'i falemi e t'i biem në këmbë Krishtit. Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, o i çuditshëm ndër shenjtorët, ne që të psalim. Aliluia.

Pas Hyrjes, Përlëshorja e Fjetjes dhe Kontaqi i saj. Në vend të Të meriton, Gjithë gjeneratat; Në ty u mundën. *Kungatore* Kupë shpëtimi. Pamë dritën.

CITIME

[1] Num. 14.19 etj
[2] Ps. 131(132).8
[3] Ps. 23(24).7,9
[4] Gjen. 28.17; Jez. 44.1-4
[5] Urt. Sol. 3.1
[6] Ps. 35(36).10; Fja. Urt. 14.27; Jer. 17.13
[7] Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan. 1.2; 5.12,20
[8] Lluk. 1.26-28
[9] Ef. 1.21; Kol. 1.16
[10] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[10a] II Kor. 5.17
[11] Lluk. 1.2; I Kor. 4.1
[12] Mark 16.19; Lluk. 24.50-51
[13] Matth. 3.17; 17.5; Mark 1.11; Lluk. 3.22; II Petr. 1.17
[14] I Tim. 6.16
[15] Kol. 3.16
[16] Vep. 3.15

[17] Joan 1.14
[18] Lluk. 1.29
[19] Lluk. 11.27
[20] Joan 1.3; Kol. 1.16
[21] Ps. 44(45).15-16
[22] Joan 7.42; Rom. 1.3; II Tim. 2.8
[23] Gal. 1.19
[23a] Matth. 16.16; Mark. 8.29
[24] I Mbret. [Sam.] 2.1,10; Ps. 88(89).25; 148.14; Sirak 47.5,11; Lluk 1.69
[25] Joan 5.24; I Joan 3.14
[26] Ps. 44(45).14
[27] Joan 14.2
[28] Ps. 44(45).10,14
[29] Eks. 15.20
[30] Eks. 15.1,21
[31] Ps. 44(45).2; 118(119).131; Jez. 3.27
[32] I Kor. 1.24
[33] Urt. Sol. 7.27; 8.1
[34] Is. 57.15
[35] I Petr. 5.4
[36] Lluk. 1.48
[37] Fja. Urt. 1.6
[38] Abak. 3.4,11
[39] Is. 49.6; Vep. 13.47
[40] Mik. 4.1-2
[41] Gjen. 3.24
[42] Sirak 11.4
[43] Matth. 12.40
[44] Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3
[45] Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
[46] Is. 19.1
[46a] Mal. 4.2
[47] Vep. 9.15
[48] Jona 2.10
[49] Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
[50] Hebr. 9.4
[51] Eks. 16.33; Hebr. 9.4
[52] Num. 17.23; Hebr. 9.4
[53] Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; II Kron. 6.41; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
[54] Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10
[55] Eks. 25.22-29; 39.18; 40.20; Lev. 24.6; Hebr. 9.2
[56] Joan 6.35,48,51
[57] Eks. 26.33 etj.
[58] Ps. 46(47).2
[59] Matth. 7.8 etj.
[60] Jak. 1.17
[61] Dan. 3.13,19
[62] Dan. 3.19,22-23; Lutja e Azarias 22-23
[63] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
[64] Dan. 3.4-5,7,10
[65] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 27
[66] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[67] Eks. 32.19; Ligji i Dytë 9.17
[68] Eks. 12.16 etj.
[69] Eks. 25.8; 26.30; Hebr. 9.2
[70] Ps. 41(42).5
[71] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 18
[72] Rom. 1.25
[73] Ps. 148.11-13
[74] Ps. 113(114).4
[75] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 24-26
[76] Jis. N. 3.10 etj. Vep. 14.15; I Thes. 1.10; I Tim. 3.15
[77] Dan. 3.25
[78] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[79] Joan 4.27
[80] Ps. 27(28).9
[81] Ps. 67(68).16
[82] I Kor. 12.9,28
[83] I Kron. 29.11; Ps. 102(103).19; Urt. Sol. 12.16
[84] Gjen. 3.16-19,24

MË 24 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i hieromartirit të shenjtë e të lavdëruar Kozma, i barabartë me apostujt.

Tipikon

Nëse bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore dhe 6 të shenjtit. Lavdi i shenjtit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni. Leximet e shenjtit. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i shenjtit dhe Tani i tij (Hyjlindësore). Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij.*

Të dielën, në Shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik dhe Litia e shenjtit. Himnet Triadike. Trishenjti dhe Përlëshorja e shenjtit. Në Mëngjesore, në Stihologji, në dy të parat, nga një Ndenjësore ngjallësore dhe e shenjtit me Hyjlindësoret e tij. Pas Polieleit, Ndenjësorja e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat e Tingullit. Proqimeni. Kanunet: ngjallësor dhe i shenjtit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Ndenjësorja e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e shenjtit, dhe Sinaksari. Zbritësoret Një kryq vijosi*; dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore, e shenjtit dhe Hyjlindësorja e tij. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të shenjtit. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e shenjtit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e shenjtit dhe e kishës. Kontaqi Joakimi dhe Ana. *Apostulli i shenjtit. Ungjilli i së dielës. Kungatore* Lavdëroni.

NË MBRËMËSORE

Pas Qëndrimit të Parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)

Thirrtore
Ting. IV O eks ipsistu klithís

Në zemrën tënde krejt, drita qiellore* kish fushuar bashkë me zellin apostolik,* përsosmërin' e virtyteve* dhe të tregoi* të mbushur me Hir hyjnor; prandaj kështu* fekse ti si diell i shumëshkëlqyeshëm* nga Shenjti Mal, e përhape pra* kudo Ungjillin* me predikimin tënd; shfaqe, o Kozma,* i barabartë* me apostujt, se jeta ka vler', kuptim; këshilloje drejt,* shenjtërisht, duke pasur* një jetesë të kulluar fort.

Shpallës me nam i Ungjillit, instrumenti* fort i hirshëm i thjeshtësisë

së jetës qe,* i barabartë, o shën Kozma,* me shën apostujt,* mist Hiri, gojë e hyjshme, zë i madh* i Ngushëllimtarit, mësues i dashuris';* kush do rrëfejë siç meriton* lodhjen, luftimet,* që me sukses bëre drejt për dashurin'* hyjnore? Pra si* Pavli[1] mbajte, o atë, kryqin,[2] që të predikoje fort* gjëra tepër të mira* në shumicë vetash përmbi dhé.[3]

Veshe fuqinë nga lart,[4] burove fjalë* shpëtimtare[5] qartë nga buzët e tua ti* me frymëzimin e Shpirtit Shenjt;* me rrjedhje bollshëm* i ke vaditur brazdat e shpirtrave,* që, i lumur, ishin më parë të tharë keq* për shkak të lëndës së veseve,* Kozma hyjfolës;* me predikime ndriçove fshatra ti,* ishuj, qytete* dhe u kurorëzove me rreth martirësh; çlirona pra* ne të gjithë nga çdo dert* dhe trishtim me ndërmjetimin tënd.

Thirrtore të tjera:
I njëjti Os jeneon en mártisin

Kremtimdashës, Kozmanë shenjt* ne le ta lumërojmë pra* denjësisht; ai është bir i Etolis',* mbjellës i çiltër i jetës krejt të thjeshtë; dhe egjrat ky* shkul me fjalën, kultivon* shpirtrat tanë me frikë, tmerr* të hyjnueshëm;* ësht' mësues i urtë, predikues i Ungjillit[6] dhe mbështetje e Kishës sonë në Shpirtin Shenjt.

Në mësim dhe veprimtari* nga besimi hyjnor, Kozma,* në qytet që kish emrin e Bizantit mbret* si dhe në Malin e Shenjtë u dallove; përshkove ti* me vrapim apostolik* ishuj, mbarë Epirin si* dhe Maqedonin';* me plot dhimbje i nxitje besimtarët të fitonin më të mirat dhe dashurinë e hyjshme pra.

Predikove kudo, Kozma,* pra Ungjillin e Krishtit Zot,* si i hyjshmi Pavël me forc' prej Shpirtit Shenjt;* o fort i hyjshëm, fillove nga Bizanti, në Iliri*[7] ti arrite dhe përmes* luftës sate shpëtove krejt* shumë njerëz pra;* dhe, si udhën e kreve, përmes lakut u stolise si martir, ndaj i barabart' me apostujt je.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Sot lindi shkëlqyeshëm panairi i Kozmait të barabartë me apostujt, duke ndriçuar Kishën. Ejani, pra, ju që ndiqni mësimin e tij, le t'i thërrasim: Gëzohu, ti që fekse nga drita hyjnore dhe e shpalle fuqishëm fjalën e shpresëtarisë me hirin që t'u dha;[8] gëzohu, imituesi i apostujve, si ata i mbushur me zell dhe i ngjashëm në udhë; gëzohu, bima e Etolisë, mburrja e Malit të Shenjtë dhe stolia e hyjnueshme e Kishës së tërë; o bashkatlet i dëshmorëve, hieromartir i urtë,

ndërmjeto te Krishti Perëndi për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit[9] pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier; atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Fjalëve të Urta
(10.6-7; 3.13-16; 8.35 etj.)

Kujtimi i të drejtit *është* me lavdërime dhe bekimi i Zotit mbi kryet e tij. Lum njeriu që gjeti urtësi dhe i vdekshmi që njohu mençuri; sepse *është* më mirë të tregtosh atë se thesare ari dhe argjendi. Dhe është më e vyer se gurët e çmuar; dhe çdo gjë e çmuar nuk është e barasvlershme me të; sepse nga goja e saj del drejtësi, ndërsa ligj dhe mëshirë mban në gjuhë. Prandaj, më dëgjoni, o fëmijë, sepse do të them *gjëra* modeste; dhe lum njeriu që do të ruajë udhët e mia; sepse daljet e mia *janë* dalje jete dhe përgatitet vullnet nga Zoti. Prandaj, ju lutem, dhe ua lëshoj zërin tim bijve të njerëzve; se unë, urtësia, bëra mendim dhe dituri, dhe kuptim unë thirra. Imi *është* mendimi dhe siguria, dhe imja edhe fuqia. Unë, ata që më duan, i dua; ndërsa, ata që më kërkojnë, do të gjejnë hir. Kuptoni, pra, o të patëkeq, zgjuarsi dhe ju, o të paedukuar, futeni zemrën. Më dëgjoni përsëri, sepse do të them *gjëra* modeste dhe nga buzët *unë* hap *gjëra* të drejta. Sepse do të studioj *një* të vërtetë laringu im, ndërsa të neveritshme janë para meje buzë të gënjeshtërta. Me drejtësi *janë* gjithë fjalët e gojës sime, brenda këtyre *s'ka* asgjë të shtrembër, as të zhdrejtë. Të gjitha janë të drejta për ata që kuptojnë, dhe korrekte për ata që gjejnë dituri; sepse ju mësoj *gjëra* të vërteta, që të bëhet në Zot shpresa juaj dhe që të mbusheni me shpirt.

Këndimi i profecisë së Isaias
(43.9-14)

Këto thotë Zoti: "Gjithë kombet u mblodhën së bashku dhe do të mblidhen arkondë nga ato. Kush do t'i njoftojë këto? Ose *gjërat* që nga fillimi kush do t'jua njoftojë? Le t'i

sjellin dëshmitarët e tyre, dhe le të drejtohen, dhe le të dëgjojnë, dhe le të thonë të vërteta. Bëhuni dëshmitarët e mi dhe unë dëshmitar", thotë Zoti, Perëndia, "dhe fëmija im që zgjodha; që të njihni dhe të besoni, dhe të kuptoni se unë jam. Përpara meje nuk u bë Perëndi tjetër dhe pas meje nuk do të jetë. Unë *jam* Perëndia dhe, veç meje, nuk është ndonjë që shpëton. Unë lajmërova dhe shpëtova, talla dhe nuk ishte mes jush i huaj. Ju, dëshmitarë për mua dhe unë, Zoti, Perëndia, ende nga fillimi, dhe nuk ka njeri që të shpëtojë nga duart e mia. Do të bëj, dhe kush do ta kthejë mbrapsht këtë?". Kështu thotë Zoti, Perëndia, që ju çliron, i Shenjti i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve *janë* në dorë Perëndie dhe nuk do t'i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën, dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre, dhe ecja nga ne dërrmim, por ata janë në paqe; sepse, edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre *është* plot pavdekësi; dhe pasi do të edukohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata, dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë, dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojë në ta Zot*i* ndër shekuj. Ata që kanë besim në të, do të kuptojnë të vërtetën, dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij; sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Në Liti Idhiomele
Ting. I

Gëzohu më Zotin, o Kisha e Krishtit, duke fituar pas apostujve të shenjtë Kozmanë e barabartë me apostujt si mbles hyjnor, mësues të perëndishëm dhe gojë të hyjurtë; sepse predikoi urtësisht fjalën e Ungjillit[10] dhe i rregulloi me frikë të hyjnueshme zemrat e shpresëtarëve; dhe, meqenëse e lavdëroi Krishtin me mbarim martirik, u denjësua për lavdin e amshuar,[11] duke qenë tok me kore apostujsh dhe dëshmorësh; me ta ndërmjeton për shpirtrat tanë.

Ting. II

Pasi bëre udhëtim apostolik, përshkove shumë qytete dhe vende si

njeri qiellor dhe engjëll tokësor, o Kozma i barabartë me apostujt; sepse, duke e forcuar dobësinë e mishit[12] me dashuri hyjnore, kërkove me gjithë shpirt shpëtimin e të afërmit; dhe meqë u bëre gojë hyjnore, i solle Krishtit shumë të denjë prej të padenjëve,[13] dhe e tregove Kishën me gjelbërim prej veprave të hyjnueshme; se me anën e urtësisë dhe të hirit[14] e vërtetove fjalën, dhe me fuqi çudish i vulose të dyja; dhe si u shfaqe udhëheqës të humburish, i nxite të gjithë të thërrasin: Lavdi më ty, o Zot.

Ting. III

I shkëlqyer prej dritës së Shpirtit, u dërgove nga Zoti tek ata që ishin larg dhe tek ata që ishin afër, që të predikoje[15] Ungjillin e Mbretërisë[16] së Qiejve, o atë; sepse u përçua te ti, porsi te Pavli i madh, ky hir në vitet e mëpasshme, o i lumur; dhe duke shkuar në mjaft vende, dhe duke kapërcyer dete, u bëre shkak shpëtimi[17] për shumë veta si imitues i Shpëtimtarit; prandaj flitet në Shqipëri fuqishëm dhe lavdërueshëm dhe në tërë Epirin që nëpërmjet fjalës sate përfituan shpëtim, dhe i thërrasin atij që të madhështoi: Lavdi më ty, o Zot.

Ting. IV

Pasi e pastrove mendjen me asketizim dhe ia besove veten mirëdashjes hyjnore, dole nga Athosi si burim nga shtëpia e Zotit, siç thotë profeti,[18] o Kozma tepër i hyjshëm; dhe ua kanalizove ujin e jetës[19] të eturve me anën e fjalës sate të bollshme, pasi mbyte egjrën e mashtrimit dhe pastrove plagët e shpirtrave; sepse u bëre të gjitha për të gjithë,[20] që të fitosh më të shumtët e njerëzve[3] si mist fort i perëndishëm i Pavlit; dhe si kreve udhën përmes martirizimit, i thërret Shpëtimtarit së bashku me dëshmorët: Lavdi më ty, o Zot.

Lavdi *I njëjti*

Kush do ta himnojë, siç e meriton, pasurinë e dashurisë sate që e kishe për të afërmin, o atë oshënar Kozma? A cila gjuhë do t'i rrëfejë luftërat, djersën, lodhjet dhe udhët që vuajte si i patrup për hir të shpëtimit të të shumtëve, duke garuar në stadiumin e shpresëtarisë? Prandaj u lavdërove denjësisht prej Krishtit, o i tërëlumur, si një tjetër apostull dhe i barasvlershëm me martirët, dhe të gjithë lartësojnë kujtimin tënd të shenjtë; nga njëra anë Athosi, dhe nga ana tjetër Epiri dhe Etolia, që të

lulëzoi, shpallin hirin tënd, sepse u tregove mësues i mbarë Kishës, duke ndërmjetuar pranë Trinisë, që t'u japë të gjithëve faljen dhe përdëllimin e madh.[20a]

Tani *Hyjlindësore*

Nga çdo lloj rreziku ruaji shërbëtorët e tu, o Hyjlindëse e bekuar, që të të lavdërojmë ty, shpresën e shpirtrave tanë.

Pasvargje
Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu, se imitues ke qen'* vërtet i ngjashëm me apostujt e Krishtit tënd;* o atë, si more zellin e tyre hyjshëm, qe bër'* predikues Zoti, i Ungjillit pra,*[6] dhe gojë hyjfolëse* për gjith' sa rrezikonin keq* në skllavëri tmerr;* oshënar, sistemove drejt* dhe etikën tok* me fjalimet, mësimin tënd;* dhe me çudi të shumta e mbështete fort në themel* bese mendimin e tyre, Kozma hyjshpallës; prandaj dhe ne* ta lusim kujtimin* mjaft të shenjtë që na sjell mirësi dhe begati.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

G'zohu, o enë e çmuar fort,* o instrument i frymëzimit të Perëndis';* shijove ndriçim hyjnor përmes jetës plot me virtyt,* porsi Moisiu, shën Kozma, në Mal;*[21] andej si apostull ti* perëndishëm vrapove shpejt* dhe predikoje* te të gjithë; shpresëtarí,* dogma dhe pendim* këshilloje te çdo besnik;* ndaj përmes predikimit tënd Epiri dhe ishujt tok* Maqedonia dhe më tej u edukuan siç duhej krejt,* sipas Krishtit tonë,* që himnonin, se me lavd të madh të lëvdoi ty.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

G'zohu, filizi i Etolis',* hyjprurës dhe mësues hiri për Kishën je,* o gojë shpresëtarie, i barabartë, Kozma,* me apostujt, thika e hyjnueshme* me dy presa;[22] preve drejt* çdo zakon të gabueshëm* edhe nga llumi,* kotësia, i nxore lart* shumë njerëz pra* përmes fjalës së Zotit tënd;* se vure para çdokujt mësimdhënien hyjnore ti,* para pra të dimëruarve më përpara në injoranc',* mashtrim; lypi Krishtit* që të jepet përdëllimi i madh[20a] te shpirtrat tan'.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Pasi ripërtërite me fjalën e Hirit[23] shpirtrat e besimtarëve, i tregove bij drite[24] dhe enë të çmuara për Zotin të skllavëruarit, të fëlliqurit, o Kozma i hyjurtë; dhe kur shumëfishove si apostull talentin që t'u dha,[25] i lavdërove

me martirizim buzët e tua hyjfolëse; dhe tani, duke shijuar pa masë lavdinë e sipërme, përgjërohu pa pushim për shpirtrat tanë dhe llirinë.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, priti lutjet e shërbëtorëve të tu edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Përlëshore
Ting. III Thias písteos

Me mësim hyjnor* për besën, Kishën* e stolise nur,* pasi u bëre* ti zelltari i apostujve; mbolle pra* mësime,[26] dogma të shenjta krejt, o Kozma* i lavdëruar, dhe luftën e kreve[27] drejt* si martir; ndaj Perëndisë Krisht përgjëroju, lyp* të na dhurohet përdëllim i madh[20a] dhe hir.

Hyjlindësore

Ti që ndërmjetove për shpëtimin e gjindjes son', të përhimnojmë, o Hyjlindëse Virgjëreshë; se duke denjuar pësimin e Kryqit me trupin që more prej teje Biri yt dhe Perëndia ynë, na çliroi prej prishjes si njeridashës.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotír

Nga Shenjti Mal mjaft shpejt* dole, kur kishe marrë,* i urtë, hir prej qiellit dhe predikoje* si një dishepull tjetër shpresëtarí, dogmat e asaj,* dhe mësimet; ndaj* kujtimin tënd dritëprurës* e kremtojmë sot,* nderojmë luftën që bëre,* Kozma, si apostull krejt.

Hyjlindësore

Në bark kishe në mish* Fjalën, Mbiperëndinë,* për shkak të përdëllimit të shumtë[28] mbi mendje,* madje pa hiç trazim, e tërëpacen; zhduke pra mallkim* stërnënor,[29] kështu* bekim burove për botën;* ndaj me një zë ne* të lavdërojmë o Zonjë,* si derë shpëtimi ty.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV O ipsothís en to stavró

O atë plot lavdi,* në mot skllavërie* ke qen' vërtet mbjellës* pra shpresëtarie;* përhape dhe ungjillin paqësor, mbolle ti* fjalën[26] e besimit te çdokush* dhe pastrove etikën,* gjendjet shpirtërore pra;* drejt një rruge shpëtimi*[30] i udhëhiqje popujt, o Kozma,*

është e saktë* kjo, s'ka humbje, as mashtrim.

Hyjlindësore

Kur linde pa shpjegim,* Hyjlindëse vajzë,* atë që jetë jep* te njerëzit mbarë,*[31] pa prishje dhe pas lindjes mbete; shpirtin e ndyr'* nga çdo prishje ma çliro, edhe* mendjen fortifikoje* me mendimin qiellor* që, pasi të jetoj mir',* me mençuri mbi tokë, pjesëtar* jete të shenjtë* të shfaqem un' në amshim.

Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. IV Tahí prokatálave

Kur prite hyjnorin frymëzim, të shenjtë nga lart,* prej Ngushëllimtarit,[32] o i urt', në shpirtin tënd fort të pastër, përshkove ti* si një apostull tjetër* fshatra edhe qytete;* në shumë vende, shpallje, o Kozma i hyjlumur,* mjaft fjalë shpëtimi[5] dhe garove drejt, ligjërisht.[33]

Hyjlindësore

Kur pa shpjegim linde ti Bërësin e Gjithësis',* e pacen, shpëtove nga mallkim i lashtë[34] sa e lëvdojnë me buz' e shpirt,* pra besërisht, o Zonjë,* Birin tënd që s'përshkruhet;* je zbutje, o Hyjlindëse, për botën e tërë,* më jep pra përkrahjen tënde fort të hyjnueshme.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

Ungjilli. (Kërkoje në të mërkurën e Javës së Tretë të Mattheut: 10.16-22).
Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e mësuesit. Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses. Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. Tërth. II

Kur linde si diell me anën e ndriçimit të mësimit në vitet e skllavërisë së errët pus, u dhe ndriçim shpresëtarie zemrave të besnikëve, të errësuara nga mashtrimi i gënjimit; sepse u shfaqe goja e hyjshme, dhe more përsipër punë ungjillori me pasuri më të madhe urtësie dhe dije më hyjnore; prandaj, o Kozma i barabartë me apostujt, përgjëroju Fjalës jetëdhënës, për ata që të nderojnë.

Kanunet e Hyjlindëses (shih fq. 11) dhe të shenjtit që ka Akrostihidhë: "O Kozma, të psal melodi të perëndishme. Gjerasimi".
Ting. IV

Ode I
Anikso to stoma mu

O Zot, ti shkëlqeje zemrën time të errësuar pus* me dritën e Hirit tënd, që ta himnoj me psalmim* të hyjnueshëm* hyjfolësin, Kozmanë,* që fjalën e shenjtë u shpalli të gjithëve.

Trumbetën me plot kuptim të mësimdhënies hyjnore krejt,* pra gojën hyjfolëse plot me urti, shën Kozman',* predikuesin* e shenjtë të Ungjillit* të Hirit[35] për jetën modeste, le ta himnoj.

Kozma, kur në mendje shndrite nga urtia e Shpirtit Shenjt,* shkëlqeve prej Athosit, ndriçues tepër i madh,* dhe porsi pishtar* në çdo vend rrezatove* përmes mësimdhënies njësoj me apostujt pra.

Hyjlindësore

Si s'dogji me zjarrin e Hyjnisë barkun tënd Fjala Zot* i panisshëm, e Dëlirë krejt, fushoi në ty* dhe u bë ky mish* që s'ka shpjegim prej teje;* prandaj ne të gjithë të shpallim Hyjlindëse.

Zbritësore: Stavrón haraksas
(shih fq. 246)

Një kryq vijosi

Ode III
Tus sus imnologus

Meqë u plagose, atë, prej dashurisë hyjnore, deshe fort* si veten dhe të afërmin;[36] ndaj në rreziqe, vuajtje,* pra në të gjitha kishe sjellje, akt hyjnor dhe apostolik.

I shndritur me mençuri hyjnore, kudo predikon shpresëtarí,* fjalën e saj; mbështet me frik' të hyjshme, oshënar, mendjen* e besëmirëve njësoj pra me apostujt në shenjtëri.

Si priti në Athos mendja jote ndriçimet hyjnore mistikisht,* për hirin e besnikëve buroi, o hyjlum Kozma,* si krua mësimdhënie shpëtimtare, o hieromartir.

Hyjlindësore

Hyjlindëse e dëlirë, forcë më jep që të shkel mbi çdo dredhi,* kurth të armikut,[37] që sulmon me tinëzi çdo ditë pra,* dhe shpirtin tim mbështete fort mbi urdhërimet e Birit tënd.

Zbritësore: Ravdhos is tipon

Shkopi një herë

Ndenjësore
Ting. IV Tahí prokatálave

Kozma, me ndriçim prej mrekullish, me fjalë të urt'* ndriçove mjaft njerëz

që thell' ishin brenda mashtrimit, natës së veseve;* ecje ti po në gjurmët* e apostujve hyjshëm,* ndaj punën e atyre saktë e imitove,* të bëri pra të çuditshëm Hiri Hyjnor, o at'.

Hyjlindësore

Hiq mijëra vrere, çdo rrezik, mendim plot me tmerr,* që janë ndikimi i armikut që na sulmon, e Virgjra Hyjlindëse;* ndaj ne në strehën tënde* po përikim, kërkojmë,* o e tërëhimnuar, ndihm', shpëtim; nga andrallat* që sjellin, çlirona; jepi jetës pendim, paqe.

Ode IV
O kathímenos en dhoksi

Në kohën e skllavërisë dhe vështirësisë së hidhur u dërgove, o atë, prej Perëndisë së Tërëpushtetshëm, që ta mbështetje mendjen e atyre që lëkundeshin dhe të shpëtoje me fjalë të urtë ata që po humbnin.

Duke lajmëruar me zë të lartë ligjin hyjnor,[38] vrapove në qytete, fshatra dhe ishuj si apostull i perëndishëm, o atë; dhe të rënët në errësirë pasionesh i ngrite drejt agimit shpëtimtar, o Kozma i lavdishëm.

Me gjuhën tënde hyjfolëse e shpalle hyjurtësisht predikimin e besimit; dhe shumë vende, o shën Kozma, i ndriçove me hiret e mësimeve të tua.

Hyjlindësore

Nga barku yt, o Zonjë e pacenuar, pa ndryshim dhe pa përzier doli me mish përmbi logjikë dhe mendje ai që u dha të gjithëve qenien,[31] dhe shpëton ata që lavdërojnë madhështitë e tua.

Zbritësore: Isakíkoa Kírie
tis ikonomias su

Kam dëgjuar, o Zoti

Ode V
Eksesti ta símpanta

Si mësues i madh dhe shpallës i perëndishëm i Ungjillit të paqes, përderisa u dogje në shpirt nga zelli i Pavlit, pasi kalove tërë Greqinë, predikove me ngazëllim deri në Iliri, o Kozma.

Me fjalën e Hirit[23] shërove shpirtra të sëmurë dhe i mjekon sëmundjet e trupave me thirrjen e Krishtit, o atë Kozma i barabartë me apostujt, sepse more karizmë apostolike në vitet e fundit.

Me rrezet e fjalëve të tua, o Kozma oshënar hyjmendës, shkëlqen tërë Epirin, ndërsa Ilirinë, Qefalininë, Za-

kinthin dhe Nafpaktin i vadit bollshëm me rrjedhjet hyjnore të mësimeve të tua të urta.

Hyjlindësore

O Zonjë, Vajzë, shpirtin tim, të sëmurë nga pasionet dhe nga sulmet e të "huajit", forcoje me vrullin tënd të dhembshur; dhe drejtojmë në udhë pendese mua që përik te streha jote, të lutem.

Zbritërose: O trismakáriston ksilon

O dru i lumur tri herë

Ode VI
Tin thian taftin

Ti kishe zell si apostujt, ndaj, o atë, kreve udhët e tyre me moral të fortë mjaft;* mbjellës i besës u shfaqe pra* hyjurtësisht, Kozma oshënar i madh, i lum.

Epiri dhe Shqipëria ty të dinë si mësues të madh, se me mësim, urti dhe fjal',* o i hyjlumi Kozma shenjtor,* prej grope ateizmi i ke shpëtuar ti.

Nga Etolia ke lindur dhe ndriçove shumë vende me zellin e besimit, o shenjtor;* Kisha pra të madhështon me lavd* porsi të barabart' me apostujt, atë, ty.

Hyjlindësore

Kandil me shtat' drita[39] dukeshe kur linde vezullimin e Atit Zot[40] me lëndë mishi ti,* Zonjë e Hyjhirshme, për shpëtim* në botë, meqë kishte ai plot mirësi.

Zbritësore: Notiu thirós en splahnis

Në barkun e bishës

Kontaqi
Ting. IV Epefanis símeron

Kishën mbarë si një yll* tani i shfaqur* e ndriçon, Kozma shenjtor,* përmes mësimit ungjillor;* i barabart' me apostujt je,* ndaj denjësisht e lëvdon kjo kujtimin tënd.

Shtëpia

O hieromartir, u dallove si imitues i apostujve, shtyllë[41] e Kishës, bukuri e priftërinjve, prototip i oshënarëve dhe bashkatlet i dëshmorëve, meqë more pjesë në luftërat e tyre; sepse, pasi linde nga Etolia dhe u shenjtërove në Malin e Shenjtë, dhe e pranove në manastirin e hyjshëm të Filotheut misionin hyjnor mistikisht prej Perëndisë, me njoftim të shenjtë dhe energji drite hyjnore si Isaia[42] tepër hyjpamës, dole duke predikuar dhe duke mësuar popujt, dhe duke kthy-

er nga udha e humbjes[43] shumë veta drejt Zotit;[44] dhe, duke nisur udhëtimin shpëtimtar nga Bizanti, shkove rreth e rrotull në një mori qytetesh, vendesh dhe ishujsh porsi Pavli i madh, duke ungjillëzuar paqen[45] dhe të mirat e Mbretërisë së Qiejve;[46] dhe, pasi nëpërmjet fjalës e kape Ilirinë dhe tërë Epirin, u shpërngule me martirizim drejt Perëndisë, i stolisur me dhurata të pasura, o Kozma i barabartë me apostujt e Kishës; ndaj denjësisht e lëvdon kjo kujtimin tënd.

Sinaksari

Më 24 të të njëjtit muaj, kujtimi i hieromartirit të shenjtë e të lavdëruar Kozma, i barabartë me apostujt, që garoi me lak në vitin 1779.
Vargje: Kozmai u duk si stolia hyjnore e besimtarëve,/ përderisa eci fuqishëm në gjurmët e apostujve.
Në të njëzetekatërtën, besëkëqij varën Kozmanë e hyjfrymëzuar.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Eftih, nxënës i shën Joan Theologut dhe i apostullit të shenjtë Pavël.
Vargje: Sa i trilum je, o Eftih,/ që fatmirësisht gjete trashëgimi hyjnore!
Në të njëzetekatërtën, e mbuloi plotësisht gur varri Eftihin.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirit të shenjtë Tation.
Vargje: Pasi përmes zvarritjes mate dynymë tokësorë tepër të shumtë,/ fitofsh dynymë të panumërt në Eden, o Tation.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë oshënar omologjet Gjergj Limnioti.
Vargje: Gjergji, duke mbaruar me mbarimin e përbashkët,/ ka si shenjë fitoreje hundë të prerë.

Në të njëjtën ditë, kujtojmë zhvarrosjen e lipsanit të nderuar të atit tonë ndër shenjtorë Dionisi, kryepiskop i Egjinës, dhe të rikthimit të tij nga Strofadhat në Zakinth.
Vargje: O Zakinth, dëfre gëzueshëm, meqë prite/ lipsanin e qytetarit tënd, Dionisit të hyjshëm.
Në të njëzetekatërtën, erdhi trupi shërues i njeriut.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Uq elátrefsan

Nuk u epe në shtrëngimet e udhëtimeve të predikimit, o atë i shenjtë, por me gatishmëri në shpirt u predikove të gjithëve fjalë besimi,[47] dhe i nxite për praktikimin e sjelljes së virtytshme.

Si simbol mirësie hyjnore, o i shenjtë, ngul kryq duke shpallur urtësisht si tepër i perëndishëm mësimet e hyjnueshme, ndërsa pas fjalës sate vinin grumbuj besimtarësh si delet pas bariut.[48]

O shën Kozma, atyre që anonin më përpara në injorancë dhe mashtrim, u kultivove me parmendë Hiri njohuri të perëndishme, frikë shpëtimtare dhe jetë më të mirë.

Hyjlindësore

O Zonjë e pacenuar, si nënë e Perëndisë dhe e Zotit, të cilin e kishe në bark, ke guxim të shumtë para tij; prandaj ndërmjeto të më dhembshurojë mua që pa mend rrokullisem në pasione të panumërta.

Zbritësore: Éknoon próstagma

Urdhër të çmendur

Ode VIII
Pedhas evajís

Me rrjedhat e mësimeve të tua të perëndishme, o Kozma i shenjtë, i barabartë me apostujt, ujite me mbushulli gjithë tërësitë e Kishës dhe udhëhoqe çdo rend drejt jete të hyjshme; sepse, sipas profetit, dole si burim[18] nga Athosi me shenjë hyjnore.

Me bukën e mësimdhënieve të tua të shenjta, o Kozma i hyjshëm, ushqeve në kohë zie mendore shumicë shpresëplotësh që kishin uri[49] për gjëra më të mira; dhe si administrator shpirtrash i stolise me zakone tepër të thjeshta ata që më përpara jetonin në shëmtirën e jetës së gabuar.

O atë, u tregove gojë Perëndie[13] dhe me fjalën e hirit[23] tënd i rrëmbeve nga goja e armikut ata që i kishte më përpara si ushqim; i udhëhoqe drejt zbatimit të porosive të të Tërëpushtetshmit, si shfaqës i madh i shpresëtarisë dhe udhëzues mistik i pendimit, o hyjmendës.

Hyjlindësore

O Virgjëreshë e bekuar dhe e përmbilavdëruar, që ta madhështoj lavdinë tënde, çliromë nga poshtërsia, papastërtia e frikshme e pasioneve që më bëjnë të huaj, që më ndajnë prej Birit tënd të mirë, dhe shkëlqeje me dritë pendimi shpirtin tim të errësuar për shkak të mashtrimit.

Zbritësore: Evlojite Pedhes

E bekoni, Djema

Ode IX
Apas jijenís

Mist hyjnor, dëshmor me famë, apostull i hyjnueshëm, shenjtor* na u

shfaqe, se kishe* mjaft dashuri hyjnore për Zotin mbret* të lavdit,[50] dhe vulose predikimin tënd hyjnor* si martir pra;* ndaj lart për shkëlqim dhe nder* ti i denjë u bëre, Kozma me nam.

Atë, nga një lak mbërrite në gji të qetë, në të mirën jet',* fund të dëshirueshëm* ti gjete pra; lipsanin tënd plot me nder* i hyjshmi Mark prej rrjedhjeve të lumit plot me mall* jasht' e nxori,* rrymat e shërimeve* po buronte, i shenjti Kozma me nam.

Ngre drejt Perëndisë duart për lutje,[51] ta shpëtojë ky tani* Kishën Orthodhokse pra* nga çdo mashtrim, dhe paqen, o shën Kozma,* krejt t'ia dhurojë, ndërsa mua, që himnimin tënd* thura, atë,* ndjesë fajesh dhe pendim,* o shenjtor me apostujt i barabart'.

Hyjlindësore

Vajzë e bekuar, prirjen e zemrës sonë lartësoje pra* drejt hyjnores dashuri* dhe na çliro, e Tërëdëlira ti,* nga çdo e keqe, çdo e ulët ne që himnin tënd* ty të psalim,* pjes' të marrim në ndriçim* madhështor dhe mistik pra të Birit tënd.

Zbritësore: Mistikós i Theotoqe
dhe
O dhiá vróseos tu ksilu

O Hyjlindëse, parajsë
dhe
Mallkim i vjetër

Dërgimësore
Jineqes akutísthite

Të madhin, të hyjnueshmin* Kozma, pra predikuesin,* bazën e Kishës dhe gojën* e së vërtetës, të besës* me jetën e martirëve* besërisht ta lëvdojmë fort,* që të shpëtojmë nga çdo dëm* me ndërmjetimet e tij pra,* se ësht' njësoj me apostujt.

Hyjlindësore

E kishe ti përmbi mendim* në bark të përmbiqenshmin Zot,* botën e ripërtërinte* përmes substance njeriu* me mirësi të skajshme ky;* dhe tani jepi shpirtit tim,* o Vajzë hyjhirplotë krejt,* një rigatim shpëtimtar pra* nga shumë shkelje dhe faje.

Lavdërime
Ting. I Ton uranion tagmaton

Fuqishëm fjalën e shpresëtarisë predikon,* se imiton ti zellin* e apostujve, atë;* shumë popuj i drejton

në ndriçim,* dritë pa perëndim, Kozma,* që kanë urdhrat[52] e Zotit Krisht Shpëtimtar;* je mësues bese, shpirtmbajtës.

Ke lindur, atë, si diell i madh prej Athosit;* me mësimdhënien tënde* dhe me rreze çudish mjaft* popuj që nuk kishin dije i shndrit,* i mbështet që të mos gabojn',* mos devijojnë nga besa e Krishtit Zot* në trishtime dhe në skllavëri.

Gëzohet fort Etolia që të ka mbirë ty,* shpall hirin tënd dhe Mali* Athos plot me hare, gaz,* shën Kozma i hyjshëm; të lumëron* Kisha mbarë e Krishtit Zot,* që në mësimet e tua hyjnore kjo* po mbështetet; si apostull je.

Hirin e Ngushëllimtarit e sillje, shën Kozma,* me fjalën tënde; shkove* në qytete të ndryshme,* dhe arrite deri në Iliri,* ku dhe udhë martiri ti* me gaz e kreve, çuditshëm; pra Krishti Zot,* ty të madhështoi, o atë.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Përderisa u solle sipas Ungjillit, u dallove mist, udhëzues dhe predikues i Ungjillit të Hirit, o atë Kozma i lumur; sepse, duke i shërbyer me çdo mënyrë vullnetit hyjnor, edukon me mësime të hyjshme shpirtrat e besimtarëve, që të kërkojnë dhe që aspirojnë të sipërmet[53] me jetë të shenjtë; dhe pasi e paraqite veten si prototip në fjalë dhe vepra,[54] u shfaqe në kohët e fundit shtyllë[41] e Kishës, duke u stolisur me veçori apostolike; prandaj Krishti të lavdëroi si të hyjshëm, të barabartë me apostujt dhe atlet të shquar; të lutemi, ndërmjeto për ne që të nderojmë.

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlind'se e virgjër, dhe të lavdërojmë ne besnikët, siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i Shenjtit Ode III dhe IV. Kontaqi: Joakimi dhe Ana prej përqeshjes së pafëmijësisë dhe Adami e Eva u çliruan prej prishjes së vdekjes,[34] me lindjen tënde të shenjtë, o e pacenuar; të kremton dhe populli yt, se u shpërblye nga barr' e fajeve, duke thirrur: Beronja lind Hyjlindësen dhe ushqenjësen e jetës son'.* *Apostullin kërkoje në të Dielën pas Theofanisë (Ef. 4.7-13), Ungjillin kërkoje në 1 nëntor ose 1 korrik (Matth. 1.5-8). Kungatore* Në gjithë dheun.

CITIME

[1] II Kor. 11.23-28
[2] Lluk. 14.27
[3] I Kor. 9.19
[4] Lluk. 24.49
[5] Vep. 13.26
[6] II Tim. 1.11
[7] Rom. 15.19
[8] Rom. 15.15
[9] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[10] Vep. 15.7
[11] II Tim. 2.10; I Petr. 5.10
[12] Gal. 4.13
[13] Jer. 15.19
[14] Lluk. 2.52
[15] Est. 9.20; Ef. 2.17
[16] Matth. 4.23; 9.35; 24.14; Mark 1.14
[17] Hebr. 5.9
[18] Joel 3(4).18
[19] Apok. 21.6; 22.1,17
[20] I Kor. 9.22
[20a] Num. 14.19 etj.
[21] Eks. 34.29-30; II Kor. 3.7
[22] Hebr. 4.12
[23] Vep. 14.3; 20.32
[24] Joan 12.36; Ef. 5.8; I Thes. 5.5
[25] Matth. 25.14-23
[26] Matth. 13.3-19; Mark 4.3-14; Lluk. 8.5-11
[27] II Tim. 4.7
[28] Ps. 5.8; 68(69).14; 105(106).7,45; Sirak 51.3; Is. 63.15; Vaj. 3.32; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 18
[29] Gjen. 3.16
[30] Vep. 16.17
[31] Vep. 17.25
[32] Vep. 2.2-4
[33] II Tim. 2.5
[34] Gjen. 3.16-19
[35] Vep. 20.24
[36] Lev. 19.18; Matth. 5.43; 19.19; 22.39; Mark 12.31,33; Lluk. 10.27; Rom. 13.9; Gal. 5.14
[37] Lluk. 10.19
[38] IV Makk. 5.18; 6.21; 9.15; 11.27
[39] Eks. 25.37; Num. 8.2
[40] Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3
[41] Gal. 2.9
[42] Is. 6.8-9
[43] Jov 30.12
[44] Ligji i Dytë 30.10 etj.
[45] Is. 52.7; Vep. 10.36; Rom. 10.15
[46] Matth. 3.2 etj.
[47] I Tim. 4.6
[48] Joan 10.4
[49] Matth. 14.15-21; Mark 6.35-44; Lluk. 9.12-17; Joan 6.5-12
[50] Ps. 23(24).7-10
[51] I Tim. 2.8
[52] Fja. Urt. 6.23
[53] Kol. 3.1
[54] I Tim. 4.12; Tit. 2.7

MË 26 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i martirit të shenjtë Adrian dhe i bashkëshortes së tij Natalia.

NË MBRËMËSORE

Thirrtore
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Si i pe mundjet trime ti,* atletizmin e çmuar fort* të martirëve, në aren' shkon me vullnet,* me burrëri në moral, dhe mishin tënd s'e kurseve hiç,* sepse kishe dashuri* të hyjnueshme; garat pra* me guxim të plot'* i mbarove, zëmadh, e ule vetullën e kundërshtarit, o Adrian i shumëdurueshëm.

I burgosur me pranga keq* me kamxhikë goditeshe* i rënduar, o i kënduar, me zinxhir'* dhe i dërrmuar me lloze ti me shumë martirë tok,* bashkërisht arritët lart* te të mirat e qiejve;* se e kishe pran'* Natalinë, pra gruan tënde të hyjdashur, që ty të stërviste, o Adrian shumë trim, me lavd.

Nga Parajsa dëboi larg* bashkëshortja Adamin burr'*[1] me këshillë gjarpri,[2] teksa tërurtësish* shën Natalia e futi në Parajs' Adrianin pra;* duke folur kjo hyjnisht,* e mësoi me mençuri* të duronte fort* atletizmin e lodhshëm, se shkakton shpërblime qiellore si dhe lavd të përjetshëm plot me shkëlqim.

Lavdi
Ting. I I Efremit të Karies

Zell burri shpresëplotë tërhoqi një grua të hyjdashur drejt nxitjeje të hijshme; sepse Adriani i tërëshkëlqyer, duke iu nënshtruar fjalëve të Natalisë, kreu udhën[3] e atletizmit. O grua e hyjdashur! Sepse ajo, jo si Eva që i solli Adamit prishje,[4] i shkaktoi bashkëshortit jetë pa mbarim. Duke e mburrur atë së bashku me burrin, le t'i thërrasim Krishtit: Na jep ndihmë,[5] me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu.

Tani *Hyjlindësore*
Ton uranion tagmaton

Atyre që vijn' me besë, u jepen pa kursim,* e tërëpacenuar,* pra karizma shërimesh* prej ikonës sate të shenjtë fort;* ndaj sëmundjet m'i vizito* dhe shpirtin tim mëshiroje, e mira Zonj',* si edhe kuroje trupin tim.

ose Kryqhyjlindësore

Ty qengjin[6] edhe bariun[7] të pa, o Shpëtimtar,* përmbi dru nëna jote* që të lindi pa njollë,* ndaj thërriste me vajtim: Biri im,* Perëndi, drit' e ëmbël fort* e botës,[8] si mbi një dru

kryqëzor të shoh* ty të varur si një kriminel?

Pasvargje
Ting. I Panéfimi mártires

Ngjyrose të purpurt pra stolin'* përmes gjakut tënd, martir,* me të, siç ishte premtimi, mbretëron me Zotin[9] tënd* ti tani; i bukur* me ndriçim dhe hijeshi hyjnore nga fitoret, po mburresh nur; pra përgjëroju mjaft* të dhurohet përdëllim i madh,*[9a] ndjesë, paqe, si dhe hir te shpirtrat tan'.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtorët e tij.

Nga udhët e veseve, martir* Adrian, u shmange krejt,* kur ndiqje rrugë shpëtimi; në banesa pa prishje,* o i tërëfamshëm,* u fushove bashkë me të gjithë që u bindën te Krishti yt; pra përgjëroju mjaft* të dhurohet përdëllim i madh,*[9a] ndjesë, paqe, si dhe hir te shpirtrat tan'.

Varg: Te shenjtorët që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

E madhe, e re vërtet çudi* dhe paradoksale krejt!* Si e tërurta, shën Natalia, bashkëshortin pra* e bind të durojë* shpata prerëse? Kush pa diçka të tillë, a kush dëgjoi? Se atë që kish si syt'* gjatë jetës, deshi me dëshir'* që t'ia jepte vdekjes shpëtimtare krejt.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O çift i paqortuar dhe i zgjedhur në Krishtin! O dyshja e shtrenjtë dhe e dashur prej Krishtit! O bashkëjetesë e shkëlqyer dhe e lumur në Perëndi! Cili nuk do të çuditet për këtë duke dëgjuar veprat e tyre përmbinjerëzore? Si femra u bë si burrë kundër tiranit të hidhur, dhe e përforcoi bashkëshortin e saj të mos përkulej në tmerre, por të preferonte vdekjen më shumë se jetën për hir të besimit? O fjalë të hyjpleksura të Natalisë së urtë! O nxitje të hyjshme që tejkaluan qiejt, dhe Adrianin e lavdishëm e bënë të njohur te vetë froni i Mbretit të madh! O ju, shoqëri e shenjtë, lypini Perëndisë për ne që me zell kryejmë kujtimin tuaj, që të çlirohemi nga ngasje dhe çdo trishtim.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[10] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me athloforët dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

ose Kryqhyjlindësore
Triímeros anestis Hristé

O Krisht, kur të shikonte mbi Kryq* të kryqëzoheshe ajo* që të lindi,* po thërriste: Biri im,* ç'ësht' ky mister i

huaj që shoh? Si vdes në mish ti* mbi dru i varur, jetëdhënës Zot?[11]

Përlëshore
Ting. III Thias písteos

I fortlumi ti,* konsiderove* si thesar të madh* që s'vidhet besën* shpëtimtare, le besim atëror të keq;* dhe, meqë shkove pas gjurmëve të Zotit,*[12] të pasuruan karizma të hyjshme ty;* Adrian i lavdëruar, lyp Krishtin Perëndi* të na shpëtojë shpirtrat tanë në amshim.

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme,
Kanunet e Oktoihut dhe i shenjtëve.
Poezi e Theofanit.
Ting. Tërth. II
Ode I
Os en ipiro pezefsas

Meqë u kapa në natën e jetës un'* prej një gjumi fort të keq,* me veprim pendimi,[13] Zot* Perëndi, më ngri në drit',* o Krisht, me uratat e martirëve, që të të mburr.

I ëmbëlsuar nga buzët, o Adrian,* që pikonin ëmbëlsi* pra hyjnjohje, nxore ti* si me vjellje helmin tmerr* të padijenisë së mëparshme, i hyjlum vërtet.

Të ndritshëm më shum' se lindja e diellit* kishe shpirtin, Natali,* bukuri për gratë, pra* drejt shkëlqimi atletik* nxit burrin tënd dhe fiton me të lavdin' e shenjtëve.

Hyjlindësore

Meqë Gatuesin prite, o e dëlir',* siç e deshi mbi mendim,* kur po mishërohej ky* pafarisht nga barku yt,* u duke vërtet ti Zonja e gjithë Krijesave.

Ode III
Uq estin ájios os si

Nga prangat, kotësia, pra* idhujtaria, ike* dhe me mall, o martir, me dashurin' e Krishtit tënd* u lidhe, more me gaz* pjes' në prangat e atletëve[14] të tij.

Dërrmuan këmbët tuaja,* o athlofore Zoti,* përmes llozesh të hekurta, por me durim si lloz* krejt i thërrmuat vërtet* burrërisht ju kockat e besimit bosh.

E flakëruar si me zjarr* prej dashuris' hyjnore,* në shpirt mallin që burri kish për Krishtin, Natali,* e ndeze; epshet në trup* i urreve tërësisht, përfundimisht.

Hyjlindësore

Çdo rregull të natyrës son'* e tejkalon çudia,* e dëlirë, e lindjes sate, se në bark ke zën'* mbi mendje Zot Perëndi* dhe pas lindjes mbetesh Virgjëresh' gjithnjë.

Irmosi: Uq estin ájios os si

»Nuk ka të shenjtë pra si ti,* o Pe»rëndia im, Zot,* që e ngrite lart bri»rin e besnikëve të tu* dhe na for»cove[15] të gjith',* o i mir', mbi gurin e »pohimit[16] tënd.

Ndenjësore
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Përqafove mundin martirik, dëshmor,* Adrian i lavdishëm, i tërëlum;* i fortifikuar ti* burrërisht edhe me besim,*[17] te Zoti veten tënde e dhe me gatishmëri,* në Hir pra arrogancë armiku e mposhte krejt;* ndaj, si Natalia të pa që po garoje,* me fjalë shpëtimi kjo* të stërviste, o famëmadh;* pra thërrasim* te ti me mall:* Ndërmjeto te Zoti yt Krisht,* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

O e virgjër dhe nënë e Perëndis',* ti pasionet e egra, e Tërëshenjt',* të shpirtit tim m'i shëro,* lutem, dhe falje më dhuro* për shkeljet që kam bërë i marri, se ndota keq* si shpirtin, edhe trupin mjerani un'. Oh, ç'do bëj* po në atë orë, ndërsa engjëjt do ndajnë* nga trupi im shpirtin tim* të pandreqshëm që ra përdhé?* Atëherë,* o Zonja jon',* forca, ndihma ime m'u bëj* dhe mbrojtëse mjaft e flaktë* me plot fuqi,* sepse unë shërbyesi yt të kam shpresë.

ose Kryqhyjlindësore

Çlirimtarin, Bariun[7] dhe Qengjin[6] Krisht,* kur e shihte në Kryq shqerra, me vajtim,* me lot dhe me hidhërim* i thërriste: "Gëzohet fort* e tërë bota, se pret çlirimin, por un' me zjarr* përbrenda flakërohem kur shoh kryqëzimin tënd,* që duron për hir të përdëllimit tënd, o Zot,* i mbimiri Perëndi,* që nuk mban kurrë zemërim".* T'i thërrasim* asaj me bes':* Virgjëreshë, na dhembshuro,* dhe na dhuro ndjesë fajesh,* se me besim* po u falemi ne pësimeve të atij.

Ode IV
Hristós mu dhínamis

Martirët, pasi vunë Krishtin si fuqi, arrogancën e pafuqishme të përndje-

kësve e shkelën me të vërtetë, dhe fituan çmimet e fitores nga qielli.

Me gjakrat e tua ende për veten stoli pavdekësie,[18] pasi zhveshe rrobën e prishjes,[19] dhe qëndron pranë Perëndisë[20] tani me lavdi, o Adrian.

Duke rrjedhur gjithkund prej plagëve, gjaku i shenjtorëve vërtet iu ofrua Perëndisë si miro, duke pastruar tepër fuqishëm qelbin e mashtrimit.

Adami u mashtrua me fjalët dinake të bashkëshortes,[2] por me të tuat, o Natali, Adriani çlirohet nga hilja dhe futet me ngazëllim për banim në Parajsë.

Hyjlindësore

Me të vërtetë misteret e shtatzënisë sate të hyjduhur, o Perëndilindëse e gjithmonëvirgjër, janë të pashprehura dhe të pakuptueshme nga ata që janë mbi tokë dhe në qiell.

Ode V
To thio fegi su agathé

Shumë trima, dhjetëshja e dyfishtë e atletëve së bashku me treshen e thjeshtë, duke u lidhur tani me Krishtin, zgjidhën me forcën e Trinisë lidhje pabesie, vërtet të pafuqishme.

O Adrian, duke qëndruar si diell mes yjesh të shkëlqyera, pra të bashkatletëve të tu, fekse shkëlqim shpresëtarie, sapo dëbove mjegullën e pabesisë dhe ndriçove anët e sferës.

O Natali hyjmendëse, e fushuar tok me martirët, shërimi i dhembjeve të burrit tënd u bë me të vërtetë freskimi i fjalëve të tua të nderuara, që përfunduan në dashurinë e më të mirave.

Hyjlindësore

O Zonjë e mirë e botës, shpëtoji ata që të himnojnë nga shpirti si Perëndilindëse, sepse të kemi mbrojtje të paluftueshme ty, Hyjnënën e vërtetë.

Ode VI
Tu viu tin thálasan

Meqë u drejtuat ju* nga pëllëmba e Krishtit,* det ateizmi pa dëmtim* e kaluat;[21] në gjirin e qetë, pra* të shndritjes së sipërme* ankoruat, atletë të Jisuit Zot.

Si lule lëshojnë er'* çmimet pra përmbi natyr'* nga ndeshjet, o i urti ti,* Adrian; u tregove porsi temjan* i mirë për Perëndin',* kur u ndeze nga zjarri i torturave.

S'dështove në mallin tënd,* fort e thjeshta Natali,* kur e kërkove bukurin'* mbimendore të Krishtit vërtet; stoli* besimi që kishe nur,* e stolise fort shpirtin tënd të shenjtë krejt.

Hyjlindësore

Qeto turbullimin tim* të vështirë nga trazir'* që më shkaktojnë veset tmerr;* jepi pra butësi zemrës sime ti, e tërëdëlira Zonj',* që për njerëzit linde kapedanin Krisht.

Irmosi: Tu viu tin thálasan

»Ja detin e jetës tash* e shikoj të »ngrihet prej furtune ngasjesh ash- »përsisht,* te limani yt shumë i qetë »rend pra dhe të thërras: Ma ngri* »shpirtin tim, o mëshirëplot', nga pri- »shja ti.[22]

Kontaqi
Ting. IV Epefanis símeron

Fjalët e hyjnueshme* të gruas sate,* si i vure, Adrian,* në zemër,[23] rende në tortur',* martir i Krishtit, dhe more pra* me bashkëshorten hyjmendëse rreth, kuror'.

Shtëpia

Erdhi koha për besnikët, dita gazmore e Adrianit të hyjshëm; le të dëfrejmë perëndishëm duke i thirrur: O martir i Zotit, që garove qartësisht ndeshjen e mirë[3] dhe more nga qielli kurorën e drejtësisë,[24] çlirona ne të gjithë nga çdo ndikim i të "huajit", na dërgo shërimin e shpirtrave dhe të trupave dhe pastroje tërë njollën e mendjes ti që nga qielli more me bashkëshorten hyjmendëse rreth, kuror'.

Sinaksari

Më 26 të të njëjtit muaj, kujtimi i martirëve të shenjtë Adriani dhe Natalia, si dhe i shoqërisë së tyre.
Vargje: Presin duart dhe këmbët e Adrianit,/ duar dinakësh me këmbë që rendin për vrasje.
Natalia, në jetë ishte tok në të njëjtin krevat me Adrianin,/ ndërsa në qiell është në të njëjtën tendë me të.
Adrianit i prenë duart, këmbët në të njëzet e gjashtën.

Në të njëjtën ditë, ata që garuan bashkë me shën Adrianin, mbarojnë me shpatë.
Vargje: Presin gjymtyrët e trupit të njëzet e tre burrave,/ d.m.th. njëzet e tre me katër duar dhe këmbë bashkë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i martirëve të shenjtë Atikos dhe Sisin dhe i atit tonë oshënar Ivistioni.
Vargje: Bashkëpërparojnë dy atletë,/ pasi vrapuan me lehtësi në stadiumin e shpatës.
O Ivistion, meqë u pastrove me hisop[25] lotësh,/ shkon i ngazëlluar në vend pa lot.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i një tjetër martiri Adrian.
Vargje: Adrianin e prerë do ta zbukurojë kurorë/ në ditën tepër të madhe të rrathëve.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënarit Joasaf, bir i mbretit Avenir.
Vargje: Përmes zellit, banoi në pallatet e Tërëmbretit/ një bir mbreti tokësor.

Në të njëjtën ditë, oshënar Tithoi mbaron në paqe.
Vargje: Më duket se s'kishte fare mish Tithoi, por, nëse kishte,/ nuk e la si ushqim në varr, ngaqë u tret.

Me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
Dhrosolovon men tin káminon

O martirë, u treguat si pirgje të parrëzueshme të Sionit të sipërm,[26] pasi vithisët të gjitha makinacionet ushtarake të armikut me anën e llozit të atletizmit tuaj; prandaj e nderojmë besërisht kujtimin tuaj përgjithmonë.

Prej Perëndisë iu dhurua Adrianit si ndihmëse[27] Natalia, se kishte edhe një mendje me të; ajo e nxori atë kur ishte ngulitur në thellësinë e mashtrimit, dhe e bindi të thërriste: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[28]

Pasi u pasurove me dorën e martirit si me thesar të çmuar, nuk ua dorëzove thesarin e mençurisë atyre që nxitoheshin ta vidhnin, o e thjeshtë; sepse udhëzoheshe nga dora e Perëndisë[21] së të gjithave.

Hyjlindësore

Kamina nuk dogji tre të rinj,[29] duke paraikonizuar ajo lindjen tënde; sepse zjarri hyjnor, meqë nuk të flakëroi, banoi në ty dhe i ndriçoi të gjithë të thërrasin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.[28]

Ode VIII
Ek flogós tis osiis

Duke u djegur tërësisht prej zjarrit të torturave, e fikët flakën e tërë të pabesisë me gjakrat tuaja, o athloforë, duke thirrur: Të përmbilartësojmë, o Krisht, në jetë.

Rrëketë e gjakrave të athloforëve të tu u bënë për botën lumenj shërimesh, duke tharë det pësimesh të tmerrshme; duke i mburrur ata, të bekojmë ty, o Krisht.

Kush nuk do të admirojë dashurinë e një gruaje të mrekullueshme për Zotin? Ashtu siç urreu dashuri mishi, e bindi bashkëshortin ta nderonte dhe ta lavdëronte Krishtin në jetë.

Hyjlindësore

Zure Fjalë dritëdhënëse[8] prej Drite; dhe, meqenëse e linde atë pashprehshëm, u lavdërove, sepse fushoi në ty, o Vajzë, Shpirt Hyjnor;[30] e përmbilartësojmë Birin në gjithë jetët.

Irmosi: Ek flogós tis osiis

»Ves' burove prej flakës tek oshë»narët, Zot,*[29] dhe e dogje flijimin »shkrumb të të drejtit shenjt;[31] * ve»tëm me vullnetin tënd, o Krisht, bën »çdo gjë[32] pra;* ne në gjithë jetët të »përmbilartësojmë.

Ode IX
Theón anthropis

Nuk mundën fare, o athloforë, dot* pra që t'ju ndanin ju nga dashuria e Krishtit Zot* shtrembërim gjymtyrësh, tmerre të gjata shum'* a shpata,[33] zjarr a vdekje trupi me cen të keq;* ndaj, o të lavdishëm, tok me të dëfreni përgjithnjë.

Ushtri që s'mposhtet nga krejt armiqt', qytet* për Perëndinë,[34] mbretëri e fortifikuar mjaft,* dhe kolonë tropeprurëse, dhe Parajs'* që s'vidhet si e mbyllur,[35] kor që u mblodh hyjnisht,* dhe në Kish' u shfaqët, o martirë, shtylla[36] pa çarje.

Kandil, llambadhe hyjdrite, yj në pah,* si dhe pishtar që dritën e besimit e feksni[37] ju,* vezullim i diellit e lavdit,[38] dhe bij* të lumturisë që asnjëherë s'perëndon,* na u shfaqët, o martirë të nderuar të Krishtit.

Burim me plot rrjedhje që nga Shpirti del,* lumë që me karizma të hyjnueshme mbushet krejt,* kanë që derdh çurka atletizmi dhe det* me mjaft shpëtim, që na çliron pra prej ngasjeve* e shtrëngatës së çdo lloji, o martirë, u shfaqët.

Qëndron ti pran' fronit të Sunduesit*[20] përmbi çdo gjë,[39] i tërëfamshëm, tok me kor martirik;* sa kremtojm' kujtimin tënd me gatishmëri* dhe me besim, me përgjërimin tënd na shpëto,* duke na çliruar nga çdo ngasje shqetësuese.

Hyjlindësore

Tani të vdekurit morën si dhurim* pra ngjalljen përmes shtatzënisë sate që s'shprehet dot,* fort e thjeshtë; se shkëlqeu mbi gjithë ne* jeta[40] nga ti, me mish e veshur, shpërbëri pra* zymtësin' e vdekjes qartë, o Perëndilindëse.

Irmosi: Theón anthropis

»Nuk munden Zotin ta shohin nje»rëzit,*[41] që rreshta engjëjsh s'kan'

»guxim ta shohin,[42] veçse nga ti,* e »dëlirë, njerëzve u duk ky njeri* Fjala »e mishëruar;[43] e madhështojmë ne,* »dhe të lumërojmë me ushtritë en»gjëllore tok.

Dërgimësore
Tis mathités sinélthomen

I tërëmiri Adrian,* martiri i pamposhtur,* si baza e atletëve* prej nesh të lavdërohet* me Natalin' e nderuar;* me ta ndriçon kolonë* triumfi, shenjtja bashkësi* pra dëshmorësh; dhe duke kremtuar ne* fill kujtimin e tyre të shkëlqyer,* i përhimnojm', se për të gjith'* te Krishti ndërmjetojnë.

Hyjlindësore

Si mur që s'mposhtet, si strehim,* shpëtim që s'çahet, rojë,* fortifikim hyjnor, mbrojtje* që nuk luftohet, forcë,* e Tërëshenjtë, të ka ty* bota e gjithë, kur ka* lloj-lloj nevojash; ti o nën'* dhe shërbyese Zoti[44] Krisht tërëmbret,* më shpëto dhe mua shërbyesin tënd* nga çdo rrezik dhe hidhërim,* o Virgjëreshë Zonjë.

Lavdërime
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

O trim shumë Adrian, përmbushe çfarë Zoti na tha,* hodhe posht' tokësoret pra,* çdo kënaqësi dhe epsh;* ngrite kryqin në sup[45] kështu,* dhe more pjes' në pësimet e atij,*[46] edhe u duke vërtet me plot sukses* ti në të dyja tok;* ndaj kujtimin tënd të hyjshëm me lavdi* ne besnikët sot e lavdërojmë me hare.

(2x)

O martir shën Adrian i tërëfamshëm plot me durim,* kur po vuaje vazhdimisht* me tortura si në det* plot me dallgë, e kishe mir'* si timoniere pra gruan tënde ti,* që të drejtonte në gji të qetë krejt,* duke të çuar kjo* drejt qytetit lart;[47] nga ku fort ndërmjeto,* lutemi, për ne që të lëvdojmë përgjithnjë.

O martirë të lavdishëm tepër, të nderuar në kulm,* rezistuat me plot durim* deri në zinxhirë ju,* shtrembërime dhe prerje tok* në mjaft gjymtyrë; ndaj kthyet përsëri* shpirtrat te Bërësi, morët pra vërtet* prehje përjetësisht,* lumëri që s'plaket kurrë. O, ç'shpërblim* krejt hyjnor nga Krishti, që arritët me sukses!

Lavdi *Ting. II*

Zoti, që paranjeh të gjitha me providencë të parrëfyeshme, të familjarizoi, o martir, si hardhi me pjellori të shumtë, që pritej llojllojshmërisht me shpatë martirizimi, dhe sillte fryte[48]

durimi të madh, nga ushqehen zemrat e besimtarëve, të cilët të mburrin me aspiratë, o Adrian i lavdëruar.

Tani *Hyjlindësore*

Gjith' shpresën time e besoj te ti, o nën' e Perëndis', ruajmë nën strehën tënde.

Dhe të tjera si zakonisht

CITIME

[1] Gjen. 3.24
[2] Gjen. 3.1-6; I Tim. 2.14
[3] II Tim. 4.7
[4] Gjen. 3.19
[5] Ps. 59(60).13; 107(108).13
[6] Is. 53.7; Joan 1.29,36; I Petr. 1.19
[7] Matth. 26.31; Mark 14.27; Joan 10.11; Hebr. 13.20; I Petr. 2.25; 5.4
[8] Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
[9] II Tim. 2.12
[9a] Num. 14.19 etj.
[10] Joan 15.1
[11] Joan 11.25-26
[12] I Petr. 2.21
[13] Vep. 26.20
[14] Hebr. 10.34
[15] I Mbret. [Sam.] 2.1-2
[16] Matth. 16.16-18
[17] Ef. 6.16
[18] I Kor. 15.53-54
[19] Gjen. 3.21
[20] III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
[21] Urt. Sol. 14.5-6
[22] Jona 2.7
[23] Lluk. 1.66; 2.19,51
[24] II Tim. 4.8
[25] Ps. 50(51).9
[26] Gal. 4.26
[27] Gjen. 2.18-22; Tov. 8.6
[28] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,34
[29] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 24-26
[30] Lluk. 1.35
[31] III [I] Mbret. 18.38
[32] Hebr. 1.3
[33] Rom. 8.35
[34] Ps. 45(46).5; 47(48).2,9; Hebr. 12.22; Apok. 3.12
[35] Kënga 4.12
[36] Gal. 2.9
[37] II Petr. 1.19
[38] Urt. Sol. 7.26; Hebr. 1.3
[39] I Kron. 29.11; Est. 4.17b; Ps. 102(103).19; Jov 9.19; Urt. Sol. 12.16
[40] Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
[41] Eks. 33.20; Joan 1.18
[42] Is. 6.2
[43] Joan 1.14
[44] Lluk. 1.38
[45] Matth. 16.24; Mark 8.34; 10.21; Lluk. 9.23; 14.27
[46] II Kor. 1.7
[47] Gal. 4.26; Hebr. 13.14
[48] Joan 15.2

MË 29 TË TË NJËJTIT MUAJ

Prerja e kokës së çmuar të profetit të shenjtë e të lavdëruar, Pararendësit dhe Pagëzorit Joan.

Tipikon

Nëse bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore dhe 6 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Leximet e Pagëzorit. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi si dhe Tani i Pagëzorit. Përlëshoret: ngjallësore, e Pagëzorit dhe Hyjlindësorja e tij.*

Të dielën, në shërbesën e Mesnatës, pas Psalmit 50, Kanuni Triadik. Litia e Pagëzorit. Himne Triadike. Trishenjti dhe Përlëshorja e Pagëzorit. Në Mëngjesore, pas Stihologjisë së parë dhe të dytë, nga një Ndenjësore ngjallësore dhe Ndenjësoret e Pagëzorit (me Hyjlindësoret e tyre). Pas Polieleit, Ndenjësoret e Pagëzorit. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe të Pagëzorit. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore. Ndenjësoret e Pagëzorit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Pagëzorit dhe Sinaksari. Zbritësoret Një kryq vijosi; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore dhe të Pagëzorit. Lavdërimet 4 ngjallësore dhe 4 të Pagëzorit. Lavdi i Pagëzorit. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Oda VI e Kanunit të parë të Pagëzorit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Pagëzorit dhe e kishës. Kontaqi Joakimi dhe Ana. *Apostulli dhe Ungjilli i Pagëzorit.* Të meriton. *Kungatore [*Lavdëroni *dhe]* Në kujtim të përjetshëm.

NË MBRËMËSORE

Pas Qëndrimit të parë të Psaltirit
(Lum ai njeri)

Thirrtore Idhiomele
Ting. Tërth. II I Joan Monakut

Kur festohej ditëlindja e Herodit tepër të paturpshëm, përmbushej qejfi i betimit të kërcyeses imorale; sepse, sapo u pre koka e Pararendësit, u sillej gostarëve si gjellë në pjatë. O gosti e urryer, e mbushur me krim sakrilegji të neveritshëm dhe vrasje të përlyer! Por ne Pagëzorin e lumërojmë duke e nderuar denjësisht, si më të madhin midis atyre që linden prej grash.[1]

(2x)

I njëjti

Kërceu nxënësja e djallit tërëdinak dhe e hoqi si shpërblim kokën tënde, o Prodhrom. O gosti plot me gjakra! Makar të mos ishe betuar, o Herod i paligjshëm, pasardhës gënjeshtre;[1a] sado që u betove, makar të mos e kishe mbajtur fjalën, sepse do të ishte më mirë të gënjeje dhe të arrije jetën, sesa të tregoheshe i sinqertë, dhe të prisje kokën e Pararendësit. Por ne Pagëzorin e lumërojmë duke e nderuar denjësisht, si më të madhin midis atyre që linden prej grash.[1]

(2x)

I njëjti

Nuk duhej, o Herod, që kritikuesin e shkeljes së kurorës ta dënoje me vdekje për shkak të dashurisë satanike dhe zekthit për femra; nuk duhej që kokën e tij të gjithëçmuar t'ia jepje duke bërë gabim një gruaje të paligjshme për shkak të betimit të kërcimit. Oh! Si guxove të bësh një vrasje të tillë? Si nuk u shkrumbua kërcyesja imorale, duke e mbajtur në pjatë në mes të gostisë? Por ne Pagëzorin e lumërojmë duke e nderuar denjësisht, si më të madhin midis atyre që linden prej grash.[1]

I njëjti

Sërish Herodiada bëhet maniake, sërish trazohet. O kërcim djallëzor dhe dehje me tinëzari! Pritej koka e Pagëzorit dhe Herodi tronditej. O Zot, me ndërmjetimet e Prodhromit tënd jepua paqen shpirtrave tanë.

Lavdi *I pari*

Kur festohej ditëlindja

Tani *Hyjlindësore*

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë? Cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur, që shkëlqeu prej Atit[2] pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier; atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i profecisë së Isaias
(40.1-5,9; 41.17-18; 45.8; 48.20-21; 54.1)

Këto thotë Zoti: "Ngushëlloni, ngushëlloni popullin tim", thotë Perëndia. "Priftërinj, flisni në zemrën e Jerusalemit. Ngushëllojeni sepse u mbush përulja e tij, sepse u zgjidh mëkati i

tij, sepse pranoi prej dore Zoti dyfish mëkatet e tij". Zë i dikujt që thërret në shkretëtirë: "Përgatisni udhën e Zotit, të drejta bëjini rrugët e Perëndisë sonë. Çdo grykë e thellë do të mbushet, dhe çdo mal e kodër do të ulet; dhe do të jenë tërë të shtrembrat në të drejta, dhe të ashprat në udhë të buta; dhe do ta shikojë çdo mish shpëtimin e Perëndisë". Mbi mal të lartë ngrihu ti që ungjillëzon Sionin, lartësoje me fuqi zërin tënd ti që ungjillëzon Jerusalemin; lartësoni, mos kini frikë. "Unë *jam* Perëndia Zot, unë do të dëgjoj, Perëndia i Izraelit, dhe nuk do t'i braktis ata; por do të hap mbi male lumenj dhe mes fushave burime; do ta bëj shkretinë në kënetë ujërash dhe dheun e etur në ujësjellëse. Le të dëfrejë qielli lart dhe retë le të spërkasin drejtësi, le të lindë toka dhe le të nxjerrë mëshirë, dhe drejtësi le të lindë së bashku". Njoftoni zë ngazëllimi deri në fund të dheut dhe le të bëhet e dëgjuar kjo. Thoni: "Çliroi Zot*i* shërbëtorin e tij, Jakovin". Dhe nëse do të kenë etje, përmes shkretëtire do t'i udhëzojë ata, do t'u nxjerrë ujë prej guri. Dëfre, o shterpë që nuk lind, shpërthe dhe bërtit ti që nuk ke dhimbje lindjeje, sepse shumë *do të jenë* fëmijët e së shkretës, më shumë se të asaj që e ka burrin.

Këndimi i profecisë së Malakias

(Përzgjedhje nga kap. 3 dhe 4)

Këto thotë Zot*i* i tërëpushtetshëm: "Ja, unë po dërgoj engjëllin tim para fytyrës sate, i cili do ta rregullojë udhën tënde para teje". Dhe do të arrijë në tempullin e tij Zot*i*, të cilin ju kërkoni. Dhe kush do të durojë ditën e hyrjes së tij? Ose kush do të rezistojë në vizionin e tij? Sepse ai futet si zjarr në fonderi dhe si blerim i atyre që lajnë. Dhe do të rrijë duke shkrirë dhe duke pastruar si *pastrohet* argjendi dhe ari. Dhe do të vijë drejt nesh në gjykim; dhe do të jetë dëshmitar i shpejtë kundër të ligjve dhe kundër kurorëshkelëseve dhe kundër atyre që betohen në emrin e tij për gënjeshtër dhe atyre që nuk e kanë frikë, thotë Zot*i* i tërëfuqishëm. "Sepse unë *jam* Zoti, Perëndia juaj, dhe nuk u ndryshova; dhe ju, bijtë e Jakovit, devijuat nga ligjet dhe nuk *i* ruajtët. Kthehuni drejt meje dhe do të kthehem drejt jush", thotë Zot*i* i tërëpushtetshëm. "Dhe do t'ju lumërojnë të gjitha kombet dhe do të njihni se unë *jam* Zot*i*, që mbikëqyr në mes të drejti dhe në mes të paligji, në atë ditë, në të cilën unë bëj për shërbimin e atyre që më duan. Prandaj njihni mirë dhe kujtoni ligjin e Moisiut, të shërbëtorit tim, sikurse i porosita në Horev drejt

gjithë Izraelit, urdhërime dhe të drejta. Dhe ja unë do t'ju dërgoj Ilia Thesvitin para se të vijë dita e madhe dhe e shquar e Zotit. Ai do të rimëkëmbë zemër ati drejt biri dhe zemër njeriu drejt të afërmit të tij, që, pasi të vij, të mos godas dheun krejtësisht", thotë Zot*i* i tërëpushtetshëm, Perëndia i shenjtë i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(4.7,16-17,19-20; 5.1-7)

I drejti, nëse do të arrijë të vdesë, do të jetë në prehje. Dhe i drejti i lodhur do të shpallë fajtorë të gjallët e pabesë; sepse *këta* do të shikojnë fund të urti dhe nuk do të kuptojnë çfarë mendoi për të Zot*i*; sepse *Zoti* do të plasë barkas të pabesët që nuk do të nxjerrin zë, dhe do t'i tundë nga themelet; dhe deri në fund do të jenë djerr në dhimbje, dhe kujtimi i tyre do të humbasë. Do të vijnë *si* frikacakë në mendimin e mëkateve të tyre, dhe do t'i qortojë përballë paligjësitë e tyre. Atëherë do të qëndrojë me shumë guxim i drejti para fytyrës së atyre që e shtrënguan dhe që i shpërfillnin mundimet e tij. Pasi do *ta* shikojnë, do të tunden nga frika e tmerrshme dhe do të shtangen nga paradoksi i shpëtimit të tij. Do të thoshin me vete duke u penduar, dhe nga shqetësimi i shpirtit do të psherëtijnë dhe do të thonë: "Ky është ai që dikur e kishim për përqeshje dhe për anekdotë tallje ne të pamendët? Jetën e tij e konsideruam mani dhe mbarimin e tij çnderim. Si u llogarit mes bijsh Perëndie, dhe trashëgimia e tij është mes shenjtorësh? Pra, gabuam nga udha e së vërtetës dhe drita e drejtësisë nuk na shkëlqeu, dhe dielli nuk na lindi. U mbushëm me rrugë paligjësie dhe humbjeje, dhe ecëm përmes shkretëtirash të pashkelura, ndërsa udhën e Zotit nuk e njohëm".

Në Liti Idhiomele
Ting. I I Gjermanoit patriark

Si do të të quajmë, o profet? Engjëll,[3] apostull apo martir? Engjëll, sepse kalove si pa trup; apostull, sepse i mësove kombet;[4] dhe martir, sepse koka jote u pre për hir të Krishtit; atij përgjëroju që të mëshirohen shpirtrat tanë.

I njëjti

Le të bëjmë përkujtimoren e kokës së prerë të Pararendësit, e cila dikur buronte gjakra në pjatë, ndërsa tani derdh shërime anembanë.

I njëjti

Sot e përdhosura në sjellje, nëna e vrasjes, me këshillë vrasëse ndaj bi-

jës së saj tërimorale që lindi nga bashkimi i paligjshëm, intrigoi kundër më të madhit mes profetëve, sipas vendimit hyjnor;[5] sepse, kur Herodi tepër armiqësor po bënte gostinë e ditëlindjes së tij të paligjshme, e sajoi që ta kërkonte me betim kokën e çmuar çudiburuese të hyjpredikuesit; dhe e bëri këtë paranojaku, kur e dha atë si shpërblim për kërcim kobi, për hir të mbajtjes së betimit. Mirëpo misti i pranisë së Krishtit[6] nuk pushoi së demaskuari, edhe pas vdekjes, bashkimin e tyre të hyjneveritshëm dhe thërriste duke e qortuar: "Nuk të lejohet të kesh me kurorëshkelje gruan e vëllait tënd Filip". O ditëlindje profetvrasëse dhe gosti e mbushur me gjakra! Por ne me mendim shpresëtar, të veshur me të bardha, le të kremtojmë në prerjen e kokës së Prodhromit, le të ngazëllohemi si në një ditë të shënuar;[7] dhe le të kërkojmë nga ai ta zbusë Trininë, që të na çlirojë nga pasionet e çnderimit[8] dhe të shpëtojë shpirtrat tanë.

Lavdi
Ting. Tërth. I I Joan Monakut

Herodi, kur deshi që të shpëtonte nga kritikat e veprës së paligjshme, ia dorëzoi në mënyrë të gabuar kokën tënde, o Pararendës, një gruaje të paligjshme, sepse mjerani nuk kuptoi se qortonte veten kur e lëvizte mbi një tabaka. Por si mësues praktik dëlirësie dhe udhëzues shpëtimtar pendimi,[9] ndërmjeto, o Pagëzor i Krishtit, që të na çlirojë nga pasionet e çnderimit.[8]

Tani *Hyjlindësore*

Ty të lumërojmë, o Hyjlindëse e virgjër, dhe të lavdërojmë ne besnikët, siç të ka hije ty, qytetin e patundshëm dhe murin që s'çahet dot, mbrojtjen e pathyeshme dhe strehën e shpirtrave tanë.

Pasvargje Idhiomele
Ting. II

O Joan Pagëzor, predikues i pendimit,[9] kur të prenë kokën, shenjtërove tokën, sepse ligjin e Perëndisë ua shpalle me fuqi besimtarëve dhe zhduke paligjësi; përderisa qëndron pranë fronit të mbretit[10] përmbiqiellor Krisht, lyp atë që të përdëllehen shpirtrat tanë.

Varg: I drejti si palmë do të lulëzohet dhe si kedër në Liban do të shumëfishohet.

Për hir të ligjit të Zotit të prenë kokën, o Joan i tërëshenjtë; kritikove me guxim të paqortueshëm mbret

besëkeq që bëri paligjësi; prandaj të admirojnë ushtritë e engjëjve, të lavdërojnë koret e apostujve dhe të martirëve; e nderojmë edhe ne kujtimin e përvitshëm, o i gjithëlëvduar, duke e mburrur Trininë e Shenjtë që të kurorëzoi, o Pararendës i lumur.

Varg: Do të ngazëllohet i drejti në Zotin.

Profetit prej profeti[11] që u bë më i madhi se profetët,[5] i të shenjtëruarit që nga barku i nënës për shërbim Zoti,[12] sot iu pre koka nga një mbret i paligjshëm; dhe pasi qortoi fuqishëm edhe para prerjes si edhe pas saj vajzën që kërceu ndyrësisht, e turpëroi kolonën e mëkatit; dhe prandaj thërrasim: O Prodhrom Joan, meqenëse ke guxim, përgjërohu pa pushim për shpirtrat tanë.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

O Pararendës i Shpëtimtarit, ti qortove mbretër që të mos bënin paligjësi; ndaj lodër gruaje të paligjshme e bindi Herodin që ta priste kokën tënde; dhe prandaj emri yt është i himnuar nga lindja e diellit deri në perëndim;[13] meqë ke guxim te Zoti, përgjërohu pa pushim që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

Virgjëresh' e panusëruar që zure trupërisht Perëndinë pa tregim, nën' e Perëndisë së lartë, prit lutjet e shërbëtorëve të tu, o e gjithëpanjollëshme, ti që u fal të gjithëve paqësim mëkatesh, prit lutjet tona tani, dhe lutu që të shpëtohen shpirtrat tanë.*

Përlëshore Ting. II

Kujtimi i të drejtit bëhet me lavdërime,[14] por ty do të të mjaftojë dëshmia e Zotit, o Prodhrom;[1] sepse u dallove vërtet më i respektuari nga profetët,[5] meqë u denjësove ta pagëzosh në rrjedha atë që predikohej;[15] prandaj, pasi luftove shumë për të vërtetën,[16] me ngazëllim u ungjillëzove dhe atyre që ishin në Hadh Perëndinë që u shfaq në mish,[17] që ngre mëkatin e botës[18] dhe na jep përdëllimin e madh.[19]

Hyjlindësore

Të gjitha përmbi mendim, të gjitha të përmbilavdishme misteret e tua, o Hyjlindëse. E vulosur me pastërti dhe e ruajtur me virgjëri, u njohe nën' e vërtetë, duke lindur Perëndin' e vërtetë. Atij iu lut të shpëtohen shpirtrat tanë.*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

O besnikë të mbledhur, ta mburrim me një zë* mesin e Ligjit dhe Hirit, sepse pendimin ai* na e parapredikoi[9] dhe, meqenëse* haptas qortoi me guxim* ky Herodin mbret, i prenë kokën; tani jeton pra* tok me engjëjt dhe ndërmjeton pranë Krishtit, që të na shpëtojë krejt ne.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Mrekullin' e mahnitshme të zënies mbi mendim* si dhe mënyrën që s'shprehet të shtatzënisë i dim'* te ti, o e fortdëlira Virgjëresh' gjithnjë;* shtanget arsyeja, çudit* trurin tim lavdia jote, Hyjlindëse e shenjtë,* lavdi që mbi të gjithë shtrihet, për hirin dhe shpëtimin ton' shpirtëror.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Ta himnojmë me këngë atletin fitimtar* që u dallua nga mitra profet,[12] që gruaja shterp'* nxori[20] si ndriçues botëror[21] me hijeshi,* pra Pararendësin Joan,* Pagëzorin e Jisuit Krisht, shenjtin e dëgjuar,* sepse ky ndërmjeton te Zoti të mëshirohen shpirtrat tanë me hir.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

Strehën tënde të shpejt', ndihmën, përdëllimin tënd* tek un' që jam shërbëtori yt, m'i trego, Zonjë ti,* zbuti edhe dallgët e mendimeve që kam,* se jan' të kota, ngrije pra* shpirtin tim që ra, Mari Hyjlindëse Virgjëreshë,* se e di unë, e di se mundesh t'i bësh të gjitha, e dëlirë, sa do.[22]

Pas Polieleit, Ndenjësore
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Me vendim Zoti shndrite nga shterpa ti,*[20] theve prangat e gjuhës së atit tënd,*[23] tregove dhe diellin* dritëprurës me plot ndriçim;* në shkretëtirë qengjin që fajet e botës ngre,*[18] ti fort e predikove te popujt,[24] Ndërtuesin;* ndaj, kur kritikove zellshëm mbretin, ta preu,* Joan i kënduar mjaft,* kokën tënde që ka lavdi,* i krejtfamshmi* i kozmosit;* ndërmjeto te Zoti yt Krisht* të na dhurojë ky ndjesën* e fajeve* ne që bëjmë kujtimin tënd fort të shenjt' me mall.

Lavdi *dhe* Tani
Hyjlindësore

O e virgjër dhe nënë e Perëndis',* ti pasionet e egra, e Tërëshenjt',* të shpirtit tim m'i shëro,* lutem, dhe falje më dhuro* për shkeljet që kam bërë i marri, se ndota keq* si shpirtin, edhe trupin, mjerani un'. Oh, ç'do bëj* po në atë orë, ndërsa engjëjt do ndajnë* nga trupi im shpirtin tim* të pandreqshëm që ra përdhé?* Atëherë,* o Zonja jon',* forca, ndihma ime m'u bëj* dhe mbrojtëse mjaft e flaktë* me plot fuqi,* sepse unë shërbyesi yt të kam shpresë.

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV
Proqimeni Ting. IV

E çmuar është para Zotit vdekja e oshënarit të tij.

Varg: **Me çfarë do t'ia shpërblejmë Zotit për gjithë sa na shpërbleu?**

Ungjilli. Psalmi 50.

Lavdi. Me ndërmjetimet e Pararendësit.
Tani. Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.
Përdëllemë, o Perëndi. *Dhe Idhiomeli.*

Ting. II

O Joan, predikues i pendimit
(Kërkoje te Pasvargjet)

Kanunet: I Hyjlindëses në 6
së bashku me Irmoset (shih fq. 11)
dhe të dy të shenjtit në 8.

Ode I
Kanuni i parë i shenjtit
Poezi e Joan Damaskinoit
Ting. Tërth. IV
Igrán dhiodhefsas

Prodhromin e hyjshëm ta përhimnojm,'* ky nga mitra shterp'[20] u shfaq profeti i Krishtit Zot,*[25] që kish qenë mbarsur në një mitër* krejt virgjërore pashprehshëm, pa hiç shpjegim.

Kanunet dhe ligjet e drejtësis'* drejt i ruajte, prandaj qortove bashkim pa ligj;* s'kishe frikë arrogancë mbreti,* si kapërceve krejt kushte natyre[26] pra.

Urrite me qumësht prej Ligjit ti,* pra legjislacion Ligjor përkatës vulose mir';* dhe si vulë Ligji[27] rezistove* ndaj neveritjes së shthurur plot ndyrësi.

Hyjlindësore

Rreshtim engjëllor si dhe njerëzor,* nënë e panusëruar, pa pushim të lëvdojn',* se Ndërtuesin e tyre kishe* në prehrin tënd, si një foshnjë e mbajte ti.

Kanuni i dytë
Ting. Tërth. IV
Ton Israíl ek dhulias

Le ta lavdërojmë të gjithë si Pararendës dhe mik të Krishtit[28] Joanin e

hyjshëm, që u dëshmua prej tij më shumë se tërë njerëzit.[1]

Le ta lavdërojmë të gjithë qytetarin e shkretëtirës,[29] bashkëbanorin me engjëjt, krenarinë e popullit të ri, Joanin e hyjnueshëm.

Le të kërcejmë si engjëj në rastin e kujtimit të Prodhromit, dhe le t'i thërrasim Krishtit: Me përgjërimet e tij, o Krisht, paqësoje botën tënde.

Hyjlindësore

Përgjithmonë, o Hyjlindëse, lyp Perëndinë që me logjikë të parrëfyeshme u mishërua prej teje, që t'i çlirojë shërbëtorët e tu nga çdo peripeci.

Zbritësore: Stavrón haraksas Mosís

»Një kryq vijosi me shkop* Moisi »profeti* dhe Det' i Kuq u ça më dysh »dhe Izraeli shkoi përtej,* pastaj pra»më e bashkoj* me të njëjtin shkop »dhe kryq përsipër valëve* dhe for»cat edhe qerret Faraonit ia mbyti, »pra Krishtin këndojmë si* Perëndi »dhe Zot[30] me brohori dhe gaz.*

Ode III
Kanuni i parë: Si i to steréoma

Një vajz' e pahijshme mjaft,* si krejt u deh me paturpësi,* tha: Më jep tash* kokën e Joanit* në një pjatë, o mbret Herod.

Dëfreu me një kërcim* vajza të pahijshmin mbret Herod;* e shtyn për krim,* vrasjen e Prodhromit,* predikuesit famëmadh.

O sa poshtërsi ke ti,* Herod i marrë, që s'mbaje ligj!* Pra, me ç'guxim,* kur po shthurej vajza,* bëre vrasje padrejtësisht?

Hyjlindësore

E Tërëdëlirë, jep* me ndërmjetimet e tua ndihm',* pra zmbrapsi larg* sulmet e armiqve* të çdo gjendjeje të vështir'.

Kanuni i dytë: Uranias apsidhos

Qe në mes të së Vjetrës dhe të së Res', o Prodhrom,* si edhe i pari në predikim ungjillor, kështu* fort pra qortove bashkim* që ish pa ligj, tiranik keq;* me gaz dhe me lavd tejkalove drejt vdekjen ti.

Nga një nën' e paligjshme e kështilluar, një vajz'* plot me epsh dhe dehje i tha Herodit: Në pjat' më jep* që unë nënës t'ia fal,* pra kokën e Pagëzorit,* e Joanit, është dhuratë që dëshiron.

I kënduar me lavd, Pararendës, s'duronte dot* mbret tirani pa turp që gjuha jote e ruajtur* nga Zoti ta rrihte fort;* dha kokën tënde të shenjtë*

çmim kërcimi plot ndyrësi te një vajzë pra.

Hyjlindësore

Si banove me mish në një Virgjëreshë, o Zot,* njerëzve u shfaqe[31] siç duhej të të shikonin ty;* atë e shfaqe vërtet* Perëndilindëse, ndihmë* për besnikët, o njeridashës i vetëm Krisht.

Zbritësore: Ravdhos is tipon

»Shkopi njëherë si një simbol i mis»terit na u shfaq,* se filizat na tregu»an priftërinë;*[32] edhe për Kishën be»ronjë ja ku mbiu edhe lulëzoj* Kryqi »tani për forcë dhe për siguri.*

Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotír

Profetin Pagëzor* dhe Prodhromin e Krishtit,* besnikë, ta nderojm' me ndërgjegje të pastër* porsi martir të fortvërtet',[18] predikues me plot lavdi,* pra mësuesin,* fton në pendim,[9] çon te Zoti* Shpëtimtar; i pren'* kokën, sepse e qortoi* marrin' e Herodit ky.

Lavdi
Ting. IV Kateplaji Iosíf

Na u duk tani stoli* shkretie,[29] vul' profetësh[27] pra,* Pagëzori zotëror,* i Shpëtimtarit, dhe dëfren* logjikën e shpresëplotëve mendërisht ky;* ndaj u shfaq Prodhromi i Krishtit Zot,* dëshmitar vërtet për pranin' e tij;*[18] me këngë shpirtërore t'i thërresim* Joanit dhe me një zë: Profet* dhe predikues* i së vërtetës,* ndërmjeto të shpëtojmë.

Tani *Hyjlindësore*

Koret mbar' të engjëjve* ndjenë çudi, o e dëlir',* për misterin plot me tmerr* të shtatzënisë sate pra,* se si ai që me shenjë thjesht mban të gjitha*[33] si njeri e mban kraharori yt* dhe i parajetshmi pranon fillim,* thith qumësht ky, ushqyesi i botës* dhe i çdo fryme, prej mirësis',* edhe të mburrin* me lavdërime* si Hyjlindësen vërtet.

Ode IV
Kanuni i parë: Si mu iskís Kírie

Meqenëse nuk duroi qortimet e prera dhe as guxim shpresëplotë, përgjegjësi për dënimet e ligjit, ai që përzihej në kënaqësitë e imoraliteteve, pasi e lidhi, e ruante atë që para fundit bashkohej me koret e sipërme në mënyrë të palëndët.

I sëmuri me dehje shpirtdëmtuese dhe zekth kurvërie, si edhe i sprovuar si mizor, si i lëshuar në zhurmat e kërcimit të këmbëve, u bë vrasës profeti;

sepse ngjizi dehje, nënën e shthurjes, dhe lindi paligjësi[34] të frikshme.

Me të vërtetë në ty nuk u përgënjeshtrua zëri hyjnor, se ti je më i madhi i profetëve;[5] sepse u denjësove për profeci që nga vetë mitra, me trup të papërsosur,[25] dhe sepse edhe pe, edhe pagëzove në trup Fjalën Perëndi[15] që u profetizua prej teje.[6]

Hyjlindësore

Ti je krenaria e besnikëve, o e panusëruar, je mbrojtje, je edhe strehë e të krishterëve, mur dhe liman; sepse çon lutje te Biri yt, o e tërëpaqortueshme, dhe shpëton nga rreziqe ata që me besë dhe dëshirë të njohin si Perëndilindëse të kulluar.

Kanuni i dytë: Eks orus katasqiu

O shërbyes i Krishtit, Joan i tërëlumur, nuk i duronte qortimet e tua Herodi, prandaj e armatos kundër teje vrasjen e padrejtë, pasi nuk i erdhi ndrojtje nga ndershmëria jote.

Mbreti i padrejtë, i zhytur brenda epshit nga zekthi dhe dehja së bashku, vendos paligjërisht kundër teje vendim vdekjeprurës, o profet i tërëlumur, pasi nuk i erdhi turp nga ndershmëria jote.

Herodi besëkeq dhe mjeran, meqë iu nënshtrua fjalëve të vajzës, vërtet ia jep kurorëshkelëses si dhuratë kokën tënde, nga e cila ti na buron hir neve të gjithëve.

Hyjlindësore

"Gëzohu" ne thërrasim, "o Perëndilindëse e shenjtë; gëzohu, ti që kishe në bark gëzim për botën; gëzohu, përkrahja e vetme e njerëzve, o Hyjlindëse e bekuar dhe e papërlyer".

Zbritësore: Isakíkoa Kírie

»Kam dëgjuar, o Zoti Krisht,* si e rre»gullove këtë mister të madh,* i kup»tova veprat që ke bër'* dhe të lav»dërova, Perëndia im.[34a]*

Ode V

Kanuni i parë: Ina ti me aposo

Me këshilla nënore, pjella më e egër se luanesha e egër kërkoi si çmim të kërcimit të keq dhe satanik kokën e Pararendësit dhe predikuesit, të cilën e respektonin të gjitha bishat në shkretëtira.[29]

O gjykimet e tua të paarritshme dhe të pakuptueshme, o Njeridashës! Një vajzë kurve me kërcim tallej me atë që nga mitra u shfaq enë e Shpirtit[12]

dhe që u rrit bashkë me mençuri dhe dëlirësi.

Ishte e dashur dhe e zakonshme për atë që deshi bashkimin e ndyrë, që të bashkonte me gosti ditëlindjeje edhe vrasjen e profetit, dhe t'i përziente edhe t'i qeraste epshorët me kanë[35] mbushur plot me gjakra profetike dhe të shenjta.

Hyjlindësore

Duke pasur guxim nënor para Birit tënd, o e Tërëkulluar, të përgjërohemi, të mos e shpërfillësh përkujdesjen tonë farefisnore, sepse ne të krishterët të vëmë para Zotit vetëm ty si zbutje dashamirëse.

Kanuni i dytë:
Orthrízontes voomen si

Nëpërmjet një mashtrimi i jepej vajzës kokë profeti në pjatë, si shpërblim për kërcim: O çmenduri!

Kur po pikonte gjak koka jote, o hyjpredikues, kurorëshkelësja gëzohej duke u hequr si e madhe: O çmenduri!

Herodi mendoi se do të heshtte gjuha jote, por ajo, megjithëse heshti, qorton më shumë, o i tërëfamshëm.

Hyjlindësore

O Perëndilindëse, të himnojmë si të virgjër pas lindjes, përderisa ishe mbarsur për botën me Fjalën Perëndi në mish.

Zbritësore: O trismakáriston ksilon

»O dru i lumur tri herë, përmbi të cilin »u nde pra mbret' i lartë Zoti Krisht,* »se prej teje u rrëzua djalli gjarpër*[36] »i gënjyer tmerrësisht prej Zotit të »mbërthyer mbi Kryq,* q'u fal shpir»trave* përdëllim dhe paqe[37] për»gjithnjë.*

Ode VI
Kanuni i parë: Ilásthití mi Sotír

I lum, ti po rrezikon* për hir të detyrave të Ligjit, urtëson me qortim* të paligjshmin, se s'je ti kallam që lëkundesh leht',* sa her' fryjnë frymë*[38] dashakeqe plot me kërcënim.

Pikonte prej therjes gjak,* kur sillej si çmim në gara kurvërie koka e shenjt';* por dhe pas mbarimit e qortonte Herodin mbret,* se ky turbulloi* fisin si edhe natyrën keq.

Lëvizje në shkretëtir',*[29] banoje në të si në pallat plot dritë, perandorak,* i veshur me qime deveje,[39] i kishe si* zbukurime mbreti,* se sundove përmbi veset krejt.

Hyjlindësore

Le të çlirohemi pra* nga shkeljet e rënda, o Hyjnënë e kulluar, ne krejt* dhe me përgjërimin tënd të gjejmë ndriçim hyjnor* nga ai që mori* mish prej teje, Bir i Perëndis'.

Kanuni i dytë: Hitona mi parasku

Shumicës së besnikëve, Joan* zëmadh, i burove mësime hyjnore krejt,* duke shpallur te ne qengjin e Perëndis'.[18]

O shembull i sinqertë për jetes'* krejt të sakt', të thjeshtë, Prodhrom, duke ndenjur ti* pranë Krishtit, kujto sa të himnojnë ty.

Ti paqësoje botën, na shpëto* shpirtrat nga rreziqet përmes ndërmjetimit tënd,* Pagëzor, Prodhrom, profeti i Krishtit Zot.

Hyjlindësore

E vetmja që me fjalë Fjalën Zot* gjatë shtatzënisë e kishe,[40] çliro, lypim,* shpirtrat tanë nga çdo kurth i armikut djall.

Zbritësore: Notiu thirós en splahnis

»Në barkun e bishës në det, profeti »shën Jona kish hapur duart në form' »kryqi* dhe pësimin e Krishtit para»tregonte qart'sisht;* pra i triditshmi »jasht' u hodh[41] dhe ngjalljen e për»mbinatyrëshme e paralajmëroj* të »Jisuit[42] të mbërthyer përmbi Kryq për »ne,* që na e ndriti Krijesën me ngrit»jen prej varreve.*

Kontaqi Ting. Tërth. I

Prerja e lavdishme e Pararendësit u bë një ekonomi hyjnore, që t'ua predikonte ardhjen e Shpëtimtarit atyre që ishin në Hadh. Le të qajë pra Herodiada që kërkoi vrasje të paligjshme, sepse nuk deshi ligjin e Perëndisë, as jetë të gjallë, por një false, të përkohshme.

Shtëpia

Ditëlindja e Herodit u duk te të gjithë sakrilegj, meqë në mes të dëfryesve u shtrua si gjellë koka e kreshmuesit. Me gëzimin u lidh keqardhja dhe me qeshjen u përzje vajtimi i hidhur; sepse, para të gjithëve hyri vajza, siç tha, duke sjellë në pjatë kokën e Pagëzorit; dhe për hir zekthi, ra vajtim mbi të gjithë sa darkonin atëherë së bashku me mbretin, se nuk i kënaqi ata, as vetë Herodin, se - thotë - u trishtuan me keqardhje jo të vërtetë, por me një false, të përkohshme.

Sinaksari

Më 29 të të njëjtit muaj, kujtimi i prerjes së kokës së çmuar të profetit

të shenjtë e të lavdëruar, Pararendësit dhe Pagëzorit Joan.
Vargje: Një dorë vrasëse e fëlliqur pret me shpatë/ kokën e atij që vuri dorën mbi kokën e Zotit.[15]
Rreth të njëzet e nëntës, bakri preu qafën e Prodhromit.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënares Theodhora në Selanik, me prejardhje nga Egjina.

Me ndërmjetimet e Pararendësit tënd, o Krisht, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

Ode VII
Kanuni i parë: Theú sigatávasin

O Herod i paligjshëm, duke u armatosur me oreks të paturpshëm dhe dehje të tmerrshme, u dërrmove kur sulmove kundër pirgu të palëkundshëm vetëpërmbajtjeje dhe qyteti të pamposhtur mençurie, pra kundër Pagëzorit të Krishtit.

O Pararendës, nuk u frikësua, nuk u drodh dhe nuk u paralizua nxënësja e djallit, duke ofruar në pjatë pa turp kokën tënde të çmuar, pasi u mposht në mendje nga këshilla nënore.

Si kandil parandriçove,[43] dhe u paradërgove si engjëll;[3] si profet predikon porsi qengj Perëndie Krishtin që u shfaq;[18] si martir ta prenë kokën me shpatë ty që ua paralajmëroje atë edhe të vdekurve në Hadh.

Hyjlindësore

Meqë u çliruam me lindjen tënde nga dënimi i rënies qëmoti,[44] ty, o Nënëvirgjëreshë, që u duke shkak lirie, të lavdërojmë përherë me Birin tënd që dha veten si shpërblim për ne.[45]

Kanuni i dytë: Pedhes Evreon

Si shërbëtor që lajmëronte prani zotërie[46] dhe yll që lajmëronte diell, kështu Joani vrapoi në Hadh, duke thirrur: I bekuar je, o Zot Perëndi në jetë.[47]

O çmenduri e Herodit! Gruas së përdalë si lodër ia dhuron atë që ish në trup të palëndët, të barabartin me engjëjt,[48] i cili thërriste: I bekuar je, o Perëndi, në jetë.[47]

«**P**ranomë mua që përgjërohem për Kishën, o i shenjti i shenjtorëve»,[48a] i thërret Zotit Pagëzori, duke thënë me zë të lartë: I bekuar je, o Zot, Perëndi në jetë.[47]

Hyjlindësore

O e Dëlirë, ndalove vrullin e vdekjes, sapo zure Perëndinë e pavdekshëm dhe linde atë, të cilit i këndojmë të

gjithë: I bekuar je, o Zot, Perëndi në jetë.[47]

Zbritësore: Éknoon próstagma

»Urdhër të çmendur dha tirani besë-
»lig, e tundi popullin,* botën e tmerroj
»me blasfemi dhe paudhësi;* po të
»tre Djemtë nuk i tronditi dot*[49] tër-
»bimi i egër as furra me zjarr,* dhe
»kur po frynte era vesëprurëse,[50] kë-
»ndonin brenda mu në zjarr:* I për-
»himnuar je, Perëndi dhe Zot i madh,*
»përjetë i bekuar.[51]*

Ode VIII
Kanuni i parë: Eptaplasios káminon

Joani, që pararendi para lindjes sate[52] dhe pësimit hyjnor, përmes shpate bëhet profeti në më të poshtmet, dhe engjëlli lajmëtar edhe i hyrjes sate atje, si zëri i Fjalës,[29] duke thirrur: O të vdekur, përmbilartësojeni jetëdhënësin; të verbër, dritëdhënësin;[53] të robëruar, çliruesin, Krishtin.[54]

Pasi kishe pararendur nga shterpësia para lindjeje virgjërore, je bërë tani paramarshuesi[52] i kryqëzimit vullnetar[55] të atij që i ndërtoi të gjitha;[56] dhe me prerjen e kokës u thërrisje atyre që ishin në Hadh:[57] O të vdekur, përmbilartësojeni jetëdhënësin; të verbër, dritëdhënësin;[53] të robëruar, çliruesin, Krishtin.[54]

Kur u pre koka nga trupi yt, o Pararendës, shpirti, që sundonte[58] përmbi mishin tënd, u nda nga ai; por Hyjnia nuk u nda nga mishi i Emanuelit, kështu nuk u dërrmua ndonjë kockë e Perëndisë dhe Zotit;[59] prandaj e përmbilartësojmë atë në jetë.

Hyjlindësore

O Zonjë zotlindëse, traumat dhe shenjat e plagëve të shpirtit tim zhduki me ndërmjetimin tënd të dhembshur; dhe mua të rënin ngrimë, shpëtomë të pashpëtueshmin, sepse ti je mbrojtësja ime dhe përkrahja e vetme, o Virgjëreshë e tërëpaqortueshme, e kulluar, e bekuar në gjithë jetët.

Kanuni i dytë: Irmosi i njëjti

Dikur, tirani, Herod keqbërësi, duke shkelur ligjin dhe duke devijuar në dëfrim gostie ditëlindjeje, e bën vajzën të kërcejë, si e bindi me betime se do të përmbushte çdo kërkesë të saj; dhe ajo, e këshilluar nga mësimet nënore, e kërkon në pjatë kokën e Pararendësit.

Meqenëse i trashëgoi vetes krim të fëlliqur, Herodi, mbret mjeran, merr dënim pa kufi, se shkeli ligj padrejtësisht; sepse si gjellë e sjell në tryezë kokën e Pararendësit, e cila e qorton atë tok me Herodiadën në gjithë jetët.

O apostulli i ndritshëm dhe Pararendësi i Zotit, Joan i lumur, arkondi i profetëve,[5] me anën e përgjërimeve të tua shpëtoji ata që e kremtojnë kujtimin tënd të hijshëm dhe dritëprurës, duke thirrur: O Djem, bekojeni;[51] priftërinj, përhimnojeni;[60] popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Hyjlindësore

Ke qenë më e shenjta se engjëjt, duke pasur në bark të shenjtin ndër të shenjtë,[48a] i cili nga dhembshuria u bë pa përzierje ajo që jemi ne vdekatarët, o Vajzë e tërëshenjtë, që të shpëtojë ata që thërrasin pa pushim për hir të tij: O Djem, bekojeni;[51] priftërinj, përhimnojeni;[60] popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Zbritësore: Evlojite Pedhes

»E bekoni, Djema,*[51] si Trinia nga »numëri, Atin q'ellor, të vetmin pra »Zot,* himnoni* Fjalën që mbi dhenë »zbriti* dhe e bëri vesë zjarrin e fu»rrave,*[50] dhe e lartësoni ju Shpirtin »e Tërëshenjtë,* që u dhuroi që të »gjith've jetën.*

Ode IX
Kanuni i parë: Éfrikse pasa akoí

Ish frikësuar fort kolon'* ligjësie dhe eprori i saj satan* prej theologes gjuh',* se predikoje Krishtin; ndaj bindi ky* Herodin përmes vajze imorale, profet me nam,* të preu kokën ty,* por të madhështojmë ne, besimtarët mbar'.

Vdekja dhe vetulla e saj,* mali pra, u ul; lëndina, natyra pra* që poshtë ish, u ngrit,*[61] se zëri i atij që thërriste[29] fort,* në fushat e shkretisë pa ndriçim brenda Hadhit, tha:* Ju, portat ngrijini,* se do hyjë mbret[62] i fortë me madhështi.

Veset e njerëzve kan' tmerr* dhe demonët arratisen nga frika tok,* kur hiri yt i dhën'* prej Perëndisë mbihijeson; na mbro* ne, grigjën tënde, nga të dyja ngasjet, se ne me bes'* të madhështojm' gjithnjë,* o Prodhrom i Zotit Krisht dhe profet i madh.

Hyjlindësore

Përpara bëj me çdo sukses,* mbretëro,[63] o bir hyjnëne, dhe mposhte krejt* popull ismailit,*[64] që na lufton, nën mbretin që do Jisun',* me ndërmjetimet e asaj që ty të kish lindur pra* pa burrë, pa dasmë,* ne të lutemi, se je Perëndi i mir'.

Kanuni i dytë: Eksesti epi tuto

Profet nga një profet,[11] shndrite në shkreti,* ishe zë nga dikush që thërriste,[29] ndaj thoshe, Prodhrom:* "Gji-

thë ju pendohuni”;[9] mbretin pra* që bënte me kënaqësi* të paligjshmet keq, e qortove fort,* Herodin, dhe shpejt rende* më par’, dhe predikove* në Hadh[57] ti mbretërin’ e Zotit ton’.

Pasi Herodiada, nëna, me zor* bindi vajzën që s’kish turp, kërkoi kjo të pritej shpejt* koka e Pag’zorit, që ish e shenjt’.* Herodi menjëherë jep* urdhër që t’i jepej porsi dhunti* në pjatë, si një gjellë* e sjellë për t’u ngrënë,* sepse qortonte marrëzin’ e tij.

Si engjëll,[3] Pagëzor, zë,[29] martir, profet* dhe kandil,[43] u dëshmove prej Perëndis’ si më i madh* nga profetët mbarë;[5] lyp Zotin fort,* që të çlirohen nga çdo dëm* kundërshtar, nga ngasje të ndryshme pra* ata që, Pararendës,* me mallëngjim kremtojnë* kujtimin tënd që sjell ndriçim dhe gaz.

Hyjlindësore

U shfaqe nënë Zoti, e Virgjra ti* mbi natyrë, kur linde me trup atë, Fjalën e mir’,* që nga zemra Ati e nxori[65] pra,* përpara gjithë jetëve,* se ish edhe është gjithnjë i mir’;* ndaj e konsiderojmë* se është dhe tani pra* mbi çdo trup, edhe pse ka veshur trup.

Zbritësore: Mistikós i Theotoqe
dhe
O dhiá vróseos tu ksilu

»O Hyjlindëse, parajsë mistike je,*
»se pa lërim lulëzove Zotin Krisht,*
»që mbolli përmbi dhé jetëprurësin
»Kryq* që po lusim me besë,* se ky
»po lartësohet* dhe me anën e tij të
»madhështojmë sot.*

»Mallkim i vjetër i stërgjyshit,*[44] që
»rrodhi prej helmimit të gjarpërit,*[36]
»e shkatërroi Kryqi i[44] Zotit Krisht;
»bekimi erdhi prapë për njerinë me
»Mari Hyjlindësen,* që na lindi Jisu-
»në Çlironjësin, të gjitha pra fuqitë e
»lavdërojnë në qiellin.*

Dërgimësore
Ton mathitón oronton se

Le ta kurorëzojm’ me himn lavdërimi* të njohurin si më të madh ndër profetë,*[5] që u bë i shquar ndër apostuj mbar’,* Hiri e kish Prodhrom atë;* i prenë kokën për ligjin* e Perëndisë së lartë.

Tjetër O uranón tis astris

Herodi aq i shthurur,* o Pagëzor i Krishtit Zot,* dhe mbjellës dëlirësie,* të theri tinëzisht, se ky* nuk mundi të priste fare* qortimet e gjuhës sate.

Hyjlindësore

O Vajzë, që mallkimin* e botës mbarë[44] zhduke krejt* përmes lindjes sate hyjnisht,* me ndërmjetimin tënd çliro* nga çdo rrezik grigjën tënde* që ty të lyp, o modeste.

Lavdërime
Ting. Tërth. IV
O tu paradhoksu thávmatos

O çudi paradoksale krejt! Kokën e hyjshme, të shenjt',* të nderuar prej engjëjve* vajza kurvë dhe pa turp* rreth e rrotull e sillte keq,* dhe ia ofronte kurorëshkelëses,* nënës, pra gjuhën që e qortonte fort.* O njeridashës Krisht,* sa durim që s'shprehet dot ke ti! Me të* shpirtrat na shpëto, porsi i vetmi mëshirplot'.

(2x)

O sa i pandjeshëm qe Herodi! Shkeli ligjin, kështu* Perëndinë përbuzi krejt* dhe mashtron dhe bën sikur* mban betimin dhe vrasjen shton* tok në tradhti bashkëshorti; shtiret ky* se i vjen keq dhe ka zymtësi, trishtim;* o Krisht, sa dhembshuri* të pashprehshme ke! Prandaj, o Zot, me të* shpirtrat na shpëto, porsi i vetmi mëshirplot'.

O çudi përmbi çdo mendje! Vula e profetëve[27] mbar'* edhe engjëlli[3] tokësor* shfaqet çmim për një kërcim* prostitute; dërgohet posht'* gjuh' theologe, te sa në Hadh[57] pra jan',* si lajmëtare e Krishtit Shpëtimtar;* sa providencë ke* që nuk shprehet, o Jisu! Kështu me të* shpirtrat na shpëto, porsi i vetmi mëshirplot'.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Sërish Herodiada bëhet maniake, sërish trazohet. O kërcim djallëzor dhe dehje me tinëzari! Pritej koka e Pagëzorit dhe Herodi tronditej. O Zot, me ndërmjetimet e Prodhromit tënd jepua paqen shpirtrave tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[66] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndërmjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Dhoksologjia e Madhe

U jepet dhe vaj i shenjtë vëllezërve, kur psalen Idhiomelet:

Ting. IV

Herodi bëri një ditëlindje të paligjshme dhe gosti tepër të paturpshme; sepse, i joshur prej kurvërie femërore dhe i nxitur nga mania e pahyjshme

për gra, preu kokë pararendëse, por nuk shkëputi gjuhë profetike që qortonte marrëzinë e tij. Derdhi gjak të pafajshëm, duke dashur të mbulonte mëkat të paudhë; por me këtë nuk fshehu zërin e atij që u thërriste[29] të gjithëve për pendim.[9] Nga njëra anë, ai bashkëdëfrente me vrasje, por, nga ana tjetër, ne le të bashkëkremtojmë me aspiratë therjen e lumur të Joan Pagëzorit, përderisa arriti i pari t'ua predikonte në Hadh[57] atyre që rrinin në terr dhe hije vdekjeje,[67] jetën, lindjen nga lart,[68] Krishtin Perëndinë tonë, të vetmin të shumëmëshirshëm.

I njëjti

Ejani, o popuj, le ta mburrim profetin, martirin dhe Pagëzorin e Shpëtimtarit; sepse ai, duke qenë engjëll[3] në mish, qortoi Herodin, duke akuzuar veprën e kurorëshkeljes së tij ilegale; dhe nëpërmjet kërcimit të kundërligjshëm, i presin kokën e çmuar atij që u ungjillëzon atyre që janë në Hadh ngjalljen prej së vdekurish, dhe ndërmjeton pareshtur te Zoti që të shpëtohen shpirtrat tanë.

Lavdi *I njëjti*

Ejani, o besnikë, le ta mburrim profetin dhe Pagëzorin e Shpëtimtarit, sepse, pasi u largua, rrinte në shkretëtirë[69] duke ngrënë mjaltë të egër dhe karkaleca;[39] dhe kritikoi një mbret që shkelte ligjin, ndërsa përtacinë tonë e nxiste duke thënë: Pendohuni, se u afrua mbretëria e qiejve.[9]

Tani *Hyjlindësore*

Nga çdo lloj rreziku ruaji shërbëtorët e tu, o Hyjlindëse e bekuar, që të të lavdërojmë ty, shpresën e shpirtrave tanë.

Në Liturgji, Tipiket dhe nga Kanuni i parë i Pagëzorit Ode III dhe i dyti Ode VI. Kontaqi Ting. IV: Joakimi dhe Ana prej përqeshjes së pafëmijësisë dhe Adami e Eva u çliruan prej prishjes së vdekjes,[44] me lindjen tënde të shenjtë, o e pacenuar; të kremton dhe populli yt, se u shpërblye nga barr' e fajeve, duke thirrur: Beronja lind Hyjlindësen dhe ushqenjësen e jetës son'.* *Kungatore* Në kujtim të përjetshëm.

CITIME

[1] Matth. 11.11; Lluk. 7.28
[1a] Joan 8.44
[2] Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
[3] Mal. 3.1; Matth. 11.10; Mark 1.2; Lluk. 7.27
[4] Lluk. 3.12-14
[5] Matth. 11.9; Lluk. 7.26
[6] Matth. 3.11; Mark 1.7; Joan 1.15,30
[7] Ps. 80(81).2-4

[8] Rom. 1.26
[9] Matth. 3.2
[10] III [I] Mbret. 17.1; 18.15;
IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
[11] Lluk. 1.67
[12] Gjyq. 16.17; Jer. 1.5; Gal. 1.15
[13] Ps. 112(113).3; Mal. 1.11
[14] Fja. Urt. 10.7
[15] Matth. 3.13-17; Mark 1.9-11;
Lluk. 3.21-23; Joan 1.32-34
[16] Sirak 4.28
[17] I Tim. 3.16
[18] Joan 1.29
[19] Num. 14.19 etj.
[20] Lluk. 1.7,36
[21] Fil. 2.15
[22] Mark 1.40
[23] Lluk. 1.64
[24] Lluk. 3.18,21
[25] Lluk. 1.44
[26] Lluk. 1.7,18
[27] Matth. 11.13
[28] Joan 3.29
[29] Is. 40.3; Matth. 3.1-3; Mark 1.3;
Lluk. 3.4; Joan 1.23
[30] Eks. 14.15-15.21
[31] Baruk 3.38
[32] Num. 17.16-28; Hebr. 9.4
[33] Est. 4.17b; Jov 9.19
[34] Ps. 7.15
[34a] Abak. 3.1-2
[35] Fja. Urt. 9.2
[36] Gjen. 3.1-7
[37] Lluk. 24.36; Joan 14.27; 20.19,21,26;
Gal. 1.3; Ef. 2.17; II Thes. 3.16
[38] Matth. 11.7
[39] Matth. 3.4; Mark 1.6
[40] Lluk. 1.31
[41] Jona kap. 2
[42] Matth. 12.40
[43] Joan 5.35
[44] Gjen. 3.16-19
[45] Matth. 20.28; Mark 10.45; II Tim. 2.6
[46] Mark 1.7; Lluk. 3.16; Joan 1.27
[47] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[48] Lluk. 20.36
[48a] III Makk. 2.21; Is. 57.15
[49] Dan. 3.4-12
[50] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
[51] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 27-28
[52] Lluk. 1.36
[53] Joan 9.7 etj.
[54] Gal. 5.1; Hebr. 2.15
[55] Matth. 16.23; 20.18;
Mark 8.31; 10.33-34;
Lluk. 18.32-33;
Joan 10.15,17; 18.11
[56] Ef. 3.9; Kol. 1.16
[57] I Petr. 3.19
[58] Ps. 50(51).14
[59] Joan 19.33
[60] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[61] Is. 40.4; Lluk. 3.5
[62] Ps. 23(24).7,9
[63] Ps. 44(45).5
[64] Gjen. 21.9-13
[65] Ps. 44(45).2
[66] Joan 15.1
[67] Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
[68] Lluk. 1.78
[69] Ps. 54(55).8

MË 30 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i patriarkëve të shenjtë të Konstandinopojës Aleksandri, Joani dhe Pavli i Ri.

Tipikon

Nëse bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 4 ngjallësore, të 3 të Pagëzorit dhe të 3 të patriarkëve. Lavdi i Pagëzorit. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi i Pagëzorit. Tani Hyjlindësore ngjallësore (Ulu te lutjet e shërbëtorëve). *Përlëshoret: ngjallësore, e Pagëzorit dhe Hyjlindësore ngjallësore* (Të gjitha përmbi mendim).

Shërbesa e Mesnatës të së dielës. Në Mëngjesore, Ndenjësore ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor, i Pagëzorit dhe i patriarkëve. Pas Odes III, Ndenjësoret: e Pagëzorit dhe të patriarkëve. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore, dhe Sinaksari. Zbritësoret Një kryq vijosi *(shih fq. 246); dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore dhe të Pagëzorit. Lavdërimet ngjallësore. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e Kanunit të Pagëzorit. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Pagëzorit dhe e kishës. Kontaqi: Joakimi dhe Ana prej përqeshjes së pafëmijësisë, dhe Adami e Eva u çliruan prej prishjes së vdekjes, me lindjen tënde të shenjtë, o e pacenuar; të kremton dhe populli yt, se u shpërblye nga barr' e fajeve, duke thirrur: Beronja lind Hyjlindësen dhe ushqenjësen e jetës son'.* *Apostulli dhe Ungjilli i së dielës.* Të meriton. *Kungatore* Lavdëroni.

NË MBRËMËSORE

Thirrtore të Pagëzorit
Ting. IV O eks ipsistu klithís

Profet dhe engjëll[1] në mish, o Pararendës* fort i hyjshëm edhe ndërmjetës mes Dhiatave,* së Vjetrës edhe së Resë pra,* kritikë faji,* filiz nga mitra krejt shterpë,[2] gjuh' si zjarr,* e qortove mbretin Herod që vepronte keq;* meqë s'duronte qortimin tënd,* ky urdhëron shpejt* që koka të pritet ty; edhe kështu* sillesh si gjellë* ti, shijimi hyjnor i vetëpërmbajtjes, edhe më fort* demaskon mbi një pjatë* imoralin, aq të shthururin.

E nxitur nga nëna e paligjshme, bija* shkelëse kërkon kryet tënd të

kënduar fort,* të respektuar prej engjëjve,* se nuk duron dot* qortimet e tij; ndaj vajza po e sjell* mbi një pjatë, duke kërcyer me këmbë kjo,* kështu haren' e gostarëve* e kthen në zi tmerr;* por, o i lumur, më shumë kritikon* ti neveritjen* që ka shthurja, dhe Krishtit i përgjërohesh për gjithë ne,* që të falë, shpëtojë* shpirtrat tanë, o profet i madh.

Me zekth prej dehjes në shpirt Herodi vidhet* përmes kërcimtares, me zërin e saj krejt fals;* tok me betim, o profet zëmadh,* i drejtë, vrasjen* padrejtësisht të sajon; po pavdek'si* qartas u paranjoftoi të vdekurve* kjo vdekja jote, sepse në Hadh* shenjt parashpallës* dhe lajmëtar ti u bëre, dhe pranin'* krejt shpëtimtare* të Jisuit Zot, Perëndisë son', e lajmërove nur;* lut atë të shpëtojë* dhe t'i shndritë shpirtrat tanë pra.

Thirrtore të shenjtorëve
Ting. I Panéfimi mártires

Për Kishën u bëre ti bari,* Aleksandër fort i lum,* dhe luftëtar për Orthodhoksinë, mposhte krenarin'* ariane boshe* përmes lutjes sate plot fuqi; kërko nga Zoti, Çliruesi i çdokujt, lyp tani* të dhurohet përdëllim i madh,*[3] paqe, hir te shpirtrat tanë me bollëk.

Urreve, i çmuari Joan,* prishje mishi plot mëkat,* u duke si engjëll tokësor, njeri krejt qiellor* përmes agripnisë* dhe omologjisë, besës dhe vetëpërmbajtjes, o oshënar; për ne lyp Krishtin Zot* të dhurohet përdëllim i madh,*[3] paqe, hir te shpirtrat tanë me bollëk.

U binde te dogmat e hyjshme* të shën Pavlit qart', vërtet;* me të vrapove drejt qiellit të tretë, oshënar,* përmes lartësisë* së virtytit, fjalë krejt hyjnore të pashprehshme nga Shpirti ti dëgjove,[4] o i lum;* baz' pa tundje për Orthodhoksin',* Pavël, lutju Shpëtimtarit pa pushim.

Lavdi
Ting. Tërth. II I Joan Monakut

Kur festohej ditëlindja e Herodit tepër të paturpshëm, përmbushej qejfi i betimit të kërcyeses imorale; sepse, sapo u pre koka e Pararendësit, u sillej gostarëve si gjellë në pjatë. O gosti e urryer, e mbushur me krim sakrilegji të neveritshëm dhe vrasje të përlyer! Por ne Pagëzorin e lumërojmë duke e nderuar denjësisht, si më të madhin midis atyre që linden prej grash.[5]

Tani *Hyjlindësore*

O Hyjlindëse, ti je hardhia e vërtetë,[6] që nxore frytin e jetës; të lypim, ndër-

mjeto, o Zonjë, bashkë me Pararendësin dhe me gjithë shenjtorët, që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Pasvargjet e Oktoihut

Lavdi *Ting. IV*

Herodi bëri një ditëlindje të paligjshme dhe gosti tepër të paturpshme; sepse, i joshur prej kurvërie femërore dhe i nxitur nga mania e pahyjshme për gra, preu kokë pararendëse, por nuk shkëputi gjuhë profetike që qortonte marrëzinë e tij. Derdhi gjak të pafajshëm, duke dashur të mbulonte mëkat të paudhë; por me këtë nuk fshehu zërin e atij që u thërriste[7] të gjithëve për pendim.[8] Nga njëra anë, ai bashkëdëfrente me vrasje, por, nga ana tjetër, ne le të bashkëkremtojmë me aspiratë therjen e lumur të Joan Pagëzorit, përderisa arriti i pari t'ua predikonte në Hadh[9] atyre që rrinin në terr dhe hije vdekjeje,[10] jetën, lindjen nga lart,[11] Krishtin, Perëndinë tonë, të vetmin të shumëmëshirshëm.

Tani *Hyjlindësore*

Nga çdo lloj rreziku ruaji shërbëtorët e tu, o Hyjlindëse e bekuar, që të të lavdërojmë ty, shpresën e shpirtrave tanë.

Përlëshore
E Pararendësit Ting. II

Kujtimi i të drejtit bëhet me lavdërime,[12] por ty do të të mjaftojë dëshmia e Zotit, o Prodhrom;[5] sepse u dallove vërtet më i respektuari nga profetët,[13] meqë u denjësove ta pagëzosh në rrjedha atë që predikohej;[14] prandaj, pasi luftove shumë për të vërtetën,[15] me ngazëllim u ungjillëzove dhe atyre që ishin në Hadh Perëndinë që u shfaq në mish,[16] që ngre mëkatin e botës[17] dhe na jep përdëllimin e madh.[3]

Lavdi
I shenjtorëve Ting. IV

O Perëndi i etërve tanë,[18] që vepron gjithnjë për ne sipas butësisë sate,[19] mos e largo përdëllimin tënd nga ne,[20] por me përgjërimet e tyre në paqe qeverise jetën tonë.

Tani *Hyjlindësore*

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së zakonshme, një kanun i Oktoihut dhe të dy të shenjtorëve.

Ode I
Kanuni i Pararendësit që ka Akrostihidhë: "Këndoj Pararendësin e hyjdëshmuar".
Ting. Tërth. IV
Anikso to stoma mu

Kandilin[21] e ndritshëm fort dhe shërbëtorin e Krishtit Zot,* apostullin, predikuesin e botës, kush ka* forc' që denjësisht* ta lavdërojë shenjtin,* Prodhromin, që u hyjdëshmua prej Perëndis'?[5]

Arriti te Tempulli i hyjshëm i Perëndisë Zot* hyjnori, pra gjenerali i fuqive pa trup,* i dha lajm me gaz* ky plakut: O i vjetër,* do lindësh, do kesh Pararendësin zotëror.[22]

Një mitër krejt shterpë[23] dhe e vjetër[24] kish të shkëlqyeshmin,* profetin, Prodhromin, Pagëzorin; nga bark nënor* ky Jisuit Krisht,* që sillej brenda barkut* të Vajzës Hyjnënë, iu fal pra,[25] - çudi mbi mend!

Hyjlindësore

I tha Virgjëreshës kryegjenerali i Perëndis':* Hyjnuse, në udh' shko, tek Elisabeta mjaft shpejt;* do ta gjesh atë* shtatzënë,[26] do kuptosh ti* pra lindjen që s'shprehet, të cilën të lajmëroj.

Kanuni i patriarkëve
Ting. Tërth. IV
Ásomen to Kirio

Sot drita e trefishtë,* e tejdukshme, pra kujtimi plot me lavd* i Etërve na lindi,* ta shijojmë me bes' dhe dhoksologji.

O hierark, ti zgjidhe* krejt fortifikimet heretike pra,* kur me guxim dhe besë* shpalle, o Aleksandër, Trininë Zot.

Kishe të njëjtin emër,* i kënduar, tok me Pavlin famëmadh,* u duke pra ikona* e virtytit të tij, siç do Zoti yn'.

Është paratreguar* gjuha jote, pra pas Shkrimit krejt hyjnor,* kallam i Shpirtit Shenjt, pend',*[27] se, Joan atë, besën e shpalle fort.

Hyjlindësore

Le t'i këndojmë Zotit* që u mishërua prej së Virgjrës pra* pa far' nga mirëdashja* për shpëtimin, çlirimin dhe faljen ton'.

Ode III
I Pararendësit: Tus sus imnologus

Kur lindi nga shterpa,[23] zgjidhi gjuhën e atit Joani[28] natyrisht,* se ishte zëri[7] fort i mir' me ëmbëlsi i Fjalës

Krisht* dhe po bekonte, thoshte: Ti i vetmi Zot dhe i shenjti je.

Meqë s'deshe gjë nga të tanishmet, vrapon në shkreti, ku dhe banon*[7] si në qytet, pasi ty të forcoi Shenjti Shpirt, Hyjnor;* jetove ti si jolëndor, si i çuditshmi Ilia pra.[29]

Si zog, o i urtë, u largove dhe rrije në shkretëtirë[30] ti,* se nuk duroje zhurmat që ka bota, gjete Zotin pra* që krejt të lehtësonte ty nga çdo stuhi dhe nga çdo shtrëngim.[31]

Hyjlindësore

E Virgjra Vajz', duke mbajtur Fjalën Zot[32] pa nisje brenda barkut, shkon* te shën Elisabeta, në shtëpin' e saj[26] dhe, kur ato* u përshëndetën, menjëher' kupton Joani, dhe falet pra.[25]

I patriarkëve: Si i to steréoma

Kullote shkëlqyeshëm* grigjën e Zotit tënd, kryeprift,* ndaj të lëvdon* në përjetësi ty,* Aleksandër, barí i mir'.

Burove prej gjuhës ti* për grigjën tënde, Joan i lum,* si ujëra* shpëtimtare, dogma* të shëndosha të besës son'.

O Pavël i tërëlum,* në jet', në emër u shfaqe ti* i ngjashëm mjaft* me shën Pavlin, enë* zgjedhjeje;[33] të nderojmë tash.

Hyjlindësore

Të gjithë të kemi ty* përikjen tonë dhe strehën tok;* çdo i krishter'* pra të lavdëron fort* pa pushim, o Hyjnënë Zonj'.

Irmosi: Si i to steréoma

»Ti je përforcim për ne* që po përi»kim te ti, o Zot;*[34] je drit' për sa* ja»në errësuar;*[35] ndaj dhe shpirti im »të himnon.

Ndenjësore e Pararendësit
Ting. I Ton tafon su Sotír

Besnikë, ta nderojm'* me ndërgjegje të pastër* profetin Pagëzor dhe Prodhromin e Krishtit,* se ishte predikues zëmadh, mësues pendimi[8] tok* dhe martir i drejt'* për Shpëtimtarin, i çiltër;* kur qortoi prer'* ky marrëzin' e Herodit,* ia prenë pra kokën keq.

Lavdi *I patriarkëve*
Ting. IV Tahí prokatálave

Shkëlqeu kandili me tri drita, Etërit shenjt';* dëfrejn' fort këta organizata bese, i çojn' në dije hyjnore pra;* zgjidhin çdo ateizëm* të paganëve

pa fe* përmes urtie, dogmash dhe guximi të shumtë,* Joani me Palvin plot lavd dhe Aleksandrin tok.

Tani *Hyjlindësore*

O shpresë që s'turpëron, sa te ti kanë besim,* e vetmja që mbajte gjatë shtatzënis' sate me mish Krishtin Zot, Perëndi;* lutju atij së bashku* me Prodhromin Joan shenjt,* t'i japë botës falje, si dhe paqe e ndreqje* në jetë përpara fundit, Vajzë, të gjithëve.

Ode IV
I Pararendësit: Tin aneksihníaston

O Pararendës i lumur, haje gjellë të pëlqyeshme, rrënjë, mjaltë të egër dhe karkaleca, ndërsa vishje stoli prej qimesh gamileje,[36] më të mirë se prej purpuri mbretëror.

Të gjithëve ua lajmërove, o i lum, si bujk[6] atë që krijoi çdo gjë nëpërmjet fjale;[37] sepse ky është ai që e ka në dorë lopatën, dhe si i drejtë e ndan mrekullisht lëmin.[38]

Si i pamish nuk u dhe gjumë syve të tu, o i urtë, i lavdëruar e i lumur, as qepallave për prehje[39] trupi, derisa e ndërtove veten porsi shtëpi për Shpirtin Hyjnor.[40]

Hyjlindësore

Në ty, o Virgjëreshë e tërëhimnuar, u përmbush thënia e Abakumit, përderisa nga mali i tërëhijesuar, nga ti, erdhi Perëndia,[41] duke u mishëruar dhe duke çliruar vdekatarët nga mashtrimi.

I patriarkëve: Isakíkoa Kírie

Tradhtarin e Krishtit ashtu si Juda[42] e hodhe në vend me erë të keqe, sepse e trashëgoi denjësisht mallkimin e tij, o Aleksandër.

Duke qëndruar në kishën e Perëndisë, si pemë tërëfrutore ulliri,[43] ia solle këtij ata që besonin si frutë të pjekur, o Joan.

Me anë krahësh përulësie, u arratise nga kurthet e dashakeqit; prandaj, o oshënar Pavël, duke u lartësuar, u bëre qytetar qielli.

Hyjlindësore

Le ta himnojmë Virgjëreshën, Virgjëreshën e dëlirë përsëri pas lindjes, meqenëse kishte në bark Krishtin, Perëndinë, që e çliroi botën prej mashtrimit.

Ode V
I Pararendësit: Eksesti ta símpanta

O i lavdishëm, duke veshur fuqi[44] Shpirti Hyjnor, u thërrisje të pranish-

mëve të tërë: Pendohuni,[8] ja qartazi kazma dergjet afër rrënjës së pemëve[45] tani, duke prerë të pafrytshmet dhe duke pastruar të mirat.[46]

O Pararendës i Zotit, duke pasur gjuhën si trumbetë, u thërrisje të pranishmëve me zë të mirë: Unë ju pagëzoj në ujë tani, mirëpo mbrapa meje do të vijë një tjetër i fuqishëm, që do të pagëzojë në zjarr dhe në Shpirt.[47]

Profeti i hyjshëm paratha: Do të vijë Zoti, ndërsa para personit të tij dërgohet një engjëll, për të përgatitur udhët e atij,[1] i cili do ta shpëtojë popullin e pabindur dhe do ta bëjë trashëgimi të shenjtë Perëndie.[48]

Hyjlindësore

Duke u mbajtur në mitrën nënore, Prodhromi, sapo kuptoi Bërësin e tij që mbahej frikshëm brenda mitrës virgjërore, pasi u ndriçua prej Shpirti të Shenjtë, kërcente brenda[25] dhe, pasi ra, iu fal.

I patriarkëve: Orthrízontes voómen

O Aleksandër, duke stolisur fronin e Mitrofanit, shkëlqeve mes hierarkëve dhe para fronit me anën e dogmave.

U dallove mrekullisht në mes të barinjve ti, o i lumur, sepse u duke në Nike si drita në mes të Etërve.

Hiri i fjalëve të tua e mbështeti Kishën, o Joan, sepse të kemi si shtyllë[49] orthodhoksie.

Hyjlindësore

O Perëndilindëse, të himnojmë si të virgjër pas lindjes, përderisa ishe mbarsur për botën me Fjalën Perëndi në mish.

Ode VI

I Pararendësit: Tin thian taftin

Drejt teje erdhi një popull fort dinak dhe të ngacmoi, tha: “Ti je Zot”, por ti atij i the:* S’jam unë, por do të vij’ dikush,* një tjetër prapa meje, i pari është ky.[50]

E kam natyrën të rrjedhshme, por ai që prapa meje vjen nuk ka rrjedhje, s’ka as kohë, mot;* bëri, ndërtoi ky çdo krijes’;*[51] nuk kam fuqi të zgjidh as sandalet e atij.[47]

Të gjith’ shikonin dhe rendnin, tagrambledhës dhe të shthurur,[52] lavire, edhe pagëzoheshin* nga ti, i tërëlëvdueshëm,* duke mësuar udhën drejt Krishtit, o profet.

Hyjlindësore

Rrëmbe nga çdo hall shërbyesit e tu, këta përikin nën strehën tënde që s’luftohet dot;* o Virgjëreshë hyj-

nënë Zonj',* çliroji nga ndëshkimi i ardhshëm plot me tmerr.

I patriarkëve: Hitona mi parasku

O atë fort i hyjshëm, vrave ti* sinonimin e manis' me shigjetim lutjesh;* luftëtar trim qe për Kishën e Krishtit Zot.

Si degë, o Joan i tërëlum,* prej hardhis'[53] së jetës, për Zotin tënd frut' të madh* madje dhe të çmuar e lulëzove ti.

Drejtimin e qytetit mbretëror* e braktise, hoqe dor', se kundërligjshëm tmerr* po shpërfillte, Pavël, falje ikonash krejt.

Hyjlindësore

E vetmja që në bark zure me mish* Fjalën përmes fjale,[54] çliro shpirtrat tanë ti* nga armiku dhe nga kurthet e tij, lypim.

Irmosi: Hitona mi parasku

»**M**ë jep këmish' të ndritshme, Zoti »im* Krisht, ti që vesh dritën si rrob'[55] »të shkëlqyeshme,* Perëndi mëshirë»plotë, i dhembshur fort.

Kontaqi i Pararendësit
Ting. Tërth. I

Prerja e lavdishme e Pararendësit u bë një ekonomi hyjnore, që t'ua predikonte ardhjen e Shpëtimtarit atyre që ishin në Hadh. Le të qajë pra Herodiada që kërkoi vrasje të paligjshme, sepse nuk deshi ligjin e Perëndisë, as jetë të gjallë, por një false, të përkohshme.

Sinaksari

Më 30 të të njëjtit muaj, kujtimi i patriarkëve të shenjtë të Konstandinopojës Aleksandri, Joani dhe Pavli i Ri.

Vargje: Meqë shpëtove nga litarë mishi, o Aleksandër,/ je në trashëgimi Zoti, e cila u mat me litar.[56]
Janë të zymta fytyrat e Kishës,/ duke mos duruar privimin e Joanit.
Kur u privua nga udhët e jetës,/Pavli gjeti pushimin e lodhjeve të jetës.
Në të tridhjetën, sot, treshja shkoi pranë Trinisë.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënarit Fantin çudibërësi.

Vargje: Pasi u fut nën dhé, Fantin çudibërësi/ na buron nga lart mana[57] mrekullish.
Fantini u tërhoq nga jeta në të tridhjetën.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i gjashtëmbëdhjetë martirëve thiveas.

Në të njëjtën ditë, gjashtë martirët e shenjtë në Melitini/ mbarojnë pasi u hodhën në det.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i oshënares Vriena.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorë Evlali.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i atit tonë ndër shenjtorë Aleksandri në Svir.

Me ndërmjetimet e tyre të shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII
I Pararendësit: Uk elátrefsan

Duke e kundërshtuar fuqishëm Herodin, o Pararendës i lavdëruar, e qorton duke thirrur: "Nuk lejohet të kesh krevat vëllai, se është e paligjshme". Dhe ai, duke mos duruar, e pret kokën tënde.

Si profet i lavdishëm, para lindjes e njohe Zotin,[25] dhe ua tregove të gjithëve si qengjin e Perëndisë,[17] duke i tërhequr të tërë drejt besimit te Zoti, që t'i thërrasin: O Perëndi, je i bekuar.

Kur ishe duke pritur fundin e lumur, o Pararendës i lavdishëm, i dërgove nxënësit e tu drejt Krishtit Perëndi, për ta pyetur: Ti je, o Zot, ai që vjen për të shpëtuar, apo të presim një tjetër?[58]

Krishti u deklaroi dishepujve: "Shkoni, thuajini Joanit: Ja, të vdekur ngjallen, të shurdhër dëgjojnë, të lebrosur pastrohen dhe të çalë ecin[59] porsi drerët".

I patriarkëve: I ek tis Iudheas

O i tërëlavdëruari hierark Aleksandër, u duke mist i Trinisë së lartë, përmbihyjnore, duke e adhuruar sinqerisht dhe duke psalur pa u përkulur: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.[60]

Krishti të tregoi thesar dogmash dhe burim mrekullish, duke buruar ti pasurinë e hyjdijes, o Joan, tek ata që thërrasin: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.[60]

O i tërëlumur, meqë fitove jetë të barabartë me engjëjt,[61] sipas Pavlit të hyjnueshëm si dhe sinonim me të, Krishti të jep pa kursim pasurinë e fjalëve ty që thërret: I bekuar është Krishti në jetë.

Hyjlindësore

Pasi u mishërove nga mitra virgjërore, u shfaqe për shpëtimin tonë; prandaj, duke e ditur ne nënën tënde si Perëndilindëse, thërrasim ngazëllueshëm: O Perëndi i etërve tanë, je i bekuar.[60]

Ode VIII
I Pararendësit: Pedhas evajís

O i tërëfamshëm, je profet dhe më i madhi se profetët mbarë[13] të Ligjit të së Vjetrës dhe të së Resë; sepse nuk ishe kallam që tundej nga era,[62] por qëndroje i palëkundshëm, duke thirrur: Bekojeni Zotin dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.[63]

Maniak nga zekthi, Herodi, kur shihte të kërcente goca e Herodiadës që shthurej, i tha asaj mjerani: "Çfarëdo që të më kërkosh, deri dhe gjysmën e mbretërisë sime, ta jap me betim". Dhe ajo kërkon kokën e Pararendësit.

Burgu kishte Joanin, ndërsa pija Herodin që dëfrente. Atëherë vajza e tërëpahijshme kërcente dhe, meqenëse i pëlqeu mbretit, mori kokën e tërënderuar të Prodhromit dhe, si të shenjtë, ia çoi si dhuratë të shumëçmuar së ëmës.

Hyjlindësore

Çliroje qytetin tënd, o Virgjëreshë, nga çdo kërcënim, keqtrajtim, tërmet, vithisje, pushtim barbar dhe nga çdo dështim i frikshëm i zjarrit të amshuar,[64] sepse ne të krishterët mbarë, pas Perëndisë, ty të kemi shpëtim, si pasuri.

I patriarkëve:
Ton ek Patrós pro eonon

O Aleksandër hyjmendës, me lutjen tënde të tërëfuqishme e vrave në vende të neveritshme Ariosin heretik; e zmbrapse atë që kishte sharë, kur e vare si Judë.[42]

Luftuesi kundër Hyjnisë, pasi grisi këmishën e Krishtit,[65] si tradhtari barkas u ça në mes;[42] dhe tani me vdekjen e drejtë qan në Hadh vdekje shpirtrash të padrejtë.

O Joan i tërëlumur, u shfaqe në vetëpërmbajtje si pa mish, në agripni për pak si pa gjak dhe në mësimdhënie si burim i Parajsës.

Hyjlindësore

O Mari, cili grup nga vdekatarët nuk do ta himnojë lindjen tënde të pashpjegueshme? Sepse, o e bekuar përjetësisht, je virgjëreshë para lindjes dhe gjatë lindjes.

Irmosi: Ton ek Patrós pro eonon

»Atë që para jetëve lindi nga Ati
»dhe në fund u mishërua nga nëna,
»o priftërinj, bekojeni;[66] popull, për»mbilartësojeni në gjithë jetët.

Ode IX
I Pararendësit: Apas jijenís

Darkë e pahijshme, dehje me neveri, kërcim pa takt, pëlqim* joshën për mjaft kurvëri,* për zekth plot tmerr mjeranin; i jep shpërblim* maniakes kokën e Prodhromit, s'ish e denjë pra* për të fare* tërë bota.[67] O çudi!* O mister që s'kuptohet, i frikshëm fort!

O si nuk u tremb Herodi nga Zoti yn', gjykatës pa gabim!* Por ky tinëzar, mjeran* ushqente vrasje brenda në zemër, shpirt* ta zhdukte Pagëzorin, se e kritikonte fort;* si maniak pra* nuk duronte, donte rast,* kur e gjeti,[68] e theri të drejtin keq.

Brenda shenjtërores hyre[69] vërtet si engjëll[1] që nga toka posht',* o Prodhrom i Zotit tënd,* i urtë, se jetove si engjëll ti* mbi dhé; kujto nga lart himnuesit e tu, kërko* ndjesë fajesh,* o i lavdëruar fort,* dhe dhuro, jep mëshirë dhe paqe tok.

Hyjlindësore

O Zot zemërgjerë, Biri i Perëndisë, i mëshirshëm krejt,*[70] përmes përgjërimeve* të Pagëzorit tënd, të Hyjlindëses* dhe të shenjtorëve të tu të gjithë na shpëto,* shërbëtorët* e tu; jep trofe nga lart,* njeridashës, te mbretërit tanë pra.

I patriarkëve: Se tin apirógamon

Si u bë vërtet hyjnor i ligjshmi nxënësi yt, o Zot,* dhe u bind te fjala jote aq jetëprurëse, si oshënar,* hierark i butë[71] dhe i mençur u shfaq; tani* lumërohet ky, Aleksandri shenjt pra, denjësisht.

Përmes mallit për të parrëfyeshmet, u bëre mist ti* me të madhen saktësi, shpallës dogmash hyjshëm, mësues mistik* për mistere si dhe adhurues i Shën Trinis',* i hyjlum fort, i pasur plot lavd, ati yn' Joan.

Atë, ty bariun që mëri nuk mbaje, oshënarin* e pacen, të paqortueshëm,[71] të nderuar, mësuesin pra* të Orthodhoksisë, predikues të besës son',*[72] me një zë, Pavël, denjësisht të lumërojm' krejt ne.

Hyjlindësore

Fort e paqortueshme pa cen dhe enë kundërmimi,* ti prej Krishtit që e linde, kërko për mbretin trofe, dhe për ne,* popullin krishtdashës, të na japë ndjes' shkeljesh pra;* sepse ne ty të madhështojmë pa pushim gjithnjë.

Irmosi: Se tin apirógamon

»Ty të madhërojmë me lëvdata pa »pushim, e virgjër,* më e larta se Fuqi-

»të pa cen që kishe pa burrë në bark*
»përmes fjalës[54] Fjalën Perëndi të vër-
»tetë krejt* përmbi mendje; je nëna
»pra e Perëndisë Zot.

Dërgimësore
Tis mathités sinélthomen

I marri, i paligjshmi aq* Herodi, preu kokën* e çmuar, të hyjnueshme* të shën Joanit Prodhrom,* se nuk duronte mizori* qortimet e saj. O çfarë* guximi tmerr vërtet! Të qaj',* se jasht' ligji ky vrau! Por ne tani* mburrim Pagëzorin e Krishtit, Zotit,* me himne, dhe nderojmë pra* kokën e tij siç duhet.

Hyjlindësore

Po humbet çdo natyr' me mend* dhe s'ka fuqi për mburrjet* edhe për lavdërimin tënd,* meqë je më e lartë* se çdo krijesë mjaft qartë;* por, sidoqoftë, s'është* pa vlerë mundësia jon',* himnin tim aq të shkurtër ti ma prano,* si i priti Biri yt Zot më parë* të hollat e vejushës pra,*[73] o nën' e Perëndisë.

Pasvargjet e Oktoihut

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

O Pararendës i Shpëtimtarit, edhe pse Herodi të shfarosi ty, shpallësin e së vërtetës,[72] megjithatë llambadhja dritërrezatuese e gojës sate ua shkëlqente mirë si me pishtar dritën e besimit atyre që ishin në Hadh; prandaj përgjërohu që të mëshirohen shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore*

O Zonjë, priti lutjet e shërbëtorëve të tu, edhe çlirona ne nga çdo nevojë dhe pikëllim.

Dhe të tjera si zakonisht.

CITIME

[1] Mal. 3.1; Matth. 11.10; Mark 1.2; Lluk. 7.27
[2] Lluk. 1.7,36
[3] Num. 14.19 etj.
[4] II Kor. 12.3-4
[5] Matth. 11.11; Lluk. 7.28
[6] Joan 15.1
[7] Is. 40.3; Matth. 3.1-3; Mark 1.3; Lluk. 3.4; Joan 1.23
[8] Matth. 3.2
[9] I Petr. 3.19
[10] Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
[11] Lluk. 1.78
[12] Fja. Urt. 10.7
[13] Matth. 11.9; Lluk. 7.26
[14] Matth. 3.13-17; Mark 1.9-11; Lluk. 3.21-23; Joan 1.32-34
[15] Sirak 4.28
[16] I Tim. 3.16
[17] Joan 1.29,36; I Petr. 1.19
[18] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2 etj.
[19] Baruh 2.27; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 18

[20] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 11
[21] Joan 5.35
[22] Lluk. 1.11-17
[23] Lluk. 1.7,36
[24] Lluk. 1.7,18
[25] Lluk. 1.44
[26] Lluk. 1.36-40
[27] Ps. 44(45).2
[28] Lluk. 1.64
[29] III [I] Mbret. 19.4-8
[30] Ps. 54(55).8
[31] Ps. 54(55).9
[32] Joan 1.1
[33] Vep. 9.15
[34] Ps. 70(71).3
[35] Ps. 111(112).4; Lluk. 1.79; Rom. 2.19
[36] Matth. 3.4; Mark 1.6
[37] Ps. 148.5 etj.
[38] Matth. 3.12; Lluk. 3.17
[39] Ps. 131(132).3
[40] I Kor. 3.16-17; 6.19
[41] Abak. 3.3
[42] Vep. 1.18
[43] Ps. 51(52).10; Osia 14.7
[44] Lluk. 24.49
[45] Matth. 3.10; Lluk. 3.9
[46] Joan 15.2
[47] Matth. 3.11; Mark 1.7-8; Joan 1.15,27,30
[48] Lluk. 1.17
[49] Gal. 2.9
[50] Lluk. 3.15-16; Joan 1.19-27
[51] Ef. 3.9; Kol. 1.16
[52] Lluk. 3.12-14
[53] Joan 15.5
[54] Lluk. 1.30-31
[55] Ps. 103(104).2
[56] Ligji i Dytë 32.9
[57] Eks. 16.14-35 etj.
[58] Matth. 11.2-3; Lluk. 7.19-20
[59] Is. 26.19; 35.5-6; 61.1-2; Ez. 37.1-8; Dan. 12.2; Matth. 11.5; Lluk. 4.19; 7.21-22
[60] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
[61] Lluk. 20.36
[62] Matth. 11.7
[63] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[64] Matth.18.8; 25.41,46; Juda 7
[65] Joan 19.23-24
[66] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
[67] Hebr. 11.38
[68] Mark 6.21
[69] Hebr. 9.25
[70] Eks. 34.6 etj.
[71] Hebr. 7.26
[72] I Tim. 2.7
[73] Mark 12.42; Lluk. 21.2

MË 31 TË TË NJËJTIT MUAJ

Kujtimi i Vendosjes së Brezit të çmuar të Perëndilindëses së Përmbishenjtë.

Tipikon

Nëse bie të dielën, të shtunën në Mbrëmësore, Thirrtoret: 6 ngjallësore dhe 4 të Perëndilindëses. Lavdi i Perëndilindëses. Tani Hyjlindësore dogmatike e Tingullit të javës. Hyrje. O dritë gazmore. *Proqimeni i ditës. Pasvargjet ngjallësore. Lavdi dhe Tani i Perëndilindëses. Përlëshoret: ngjallësore dhe e Perëndilindëses.*

Shërbesa e Mesnatës të së dielës. Në Mëngjesore, Përlëshoret: ngjallësore (2x) dhe e Perëndilindëses. Ndenjësoret ngjallësore. Bekimtoret. Ipakoia. Shkallesat dhe Proqimeni i Tingullit. Kanunet: ngjallësor dhe të Perëndilindëses. Pas Odes III, Kontaqi dhe Shtëpia e Perëndilindëses. Ndenjësorja e Perëndilindëses (2x). Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia ngjallësore dhe Sinaksari. Zbritësoret Një kryq vijosi me shkop [Ja gojën e çel tani]; *dhe i gjithë rendi i Ungjillit Mëngjesor.* Më të nderuarën. *Dërgimësoret: ngjallësore dhe e Perëndilindëses. Lavdërimet: 4 ngjallësore dhe 4 të Perëndilindëses. Lavdi Eothinoni. Tani* E përmbibekuar. Sot erdhi.

Në Liturgji, Tipiket. Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e një Kanuni të Perëndilindëses. Pas Hyrjes, Përlëshoret: ngjallësore, e Perëndilindëses dhe e kishës. Kontaqi i Perëndilindëses. Apostulli i Perëndilindëses dhe Ungjilli i së dielës. Të meriton. *Kungatore* Lavdëroni *[dhe* Kupë shpëtimi*].*

NË MBRËMËSORE

Thirrtore

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Sarkofagu që brenda mban* rrobën tënde, përditë ësht',* njihet prej shërbyesve të tu si një ark'* me shenjtërim[1] dhe burim shërimesh, mur i hyjnueshëm,* krenari edhe lavdi;* ndaj këtu, si u mblodhëm tok* perëndishëm ne,* madhështitë e tua i himnojmë tash dhe detin e çudive, o e kulluar pa cen aspak.

(2x)

Në vendosjen e shenjtë mjaft,* Zonjë, të rrobës sate, pra* ne me gaz kremtojmë, sepse denjove ti* që sot t'i jepet qytetit tënd, si veshje e hyjshme krejt,* një thesar i çmuar fort,* pasuri terapish, shëndet* që nuk vidhet dot,* lum' i mbushur me

plot dhunti të Shpirtit edhe ruajtje që kurrë nuk hiqet dot nga keqbërësit.

(2x)

Ja një vend i lavdishëm krejt,* ja shtëpi me shkëlqim gjithnjë* përmes Hirit; rrobën e çmuar, që e kish* Hyjbija, kjo e ka. Ejani dhe nxirrni prej saj, njerëz,* dritësim dhe zbutje tok,* dhe në zemër me gaz të madh* thirrni tek ajo:* Virgjëreshë e tërëshenjtë, të bekojmë ne që u shpëtuam prej Birit tënd, që nga ti u lind.

(2x)

Lavdi *dhe* Tani
Ting. II

Si një kurorë të përmbishkëlqyeshme, o Hyjlindëse, Zonjë e tërëpacenuar, rrobën tënde të shenjtë e veshi Kisha e Perëndisë,[2] dhe ngazëllohet me hijeshi sot, dhe kërcen mistikisht, duke të thirrur: Gëzohu, o rreth i çmuar dhe kurorë e lavdisë[3] së tij hyjnore; gëzohu, lavdia e vetme e tërësisë, dhe hareja e amshuar; gëzohu, limani dhe mbrojtja e atyre që rendin te ti, dhe shpëtimi ynë.

Pasvargje
Ting. IV Édhokas simíosin

Brezin tënd ia dhe qytetit tënd, e Tërëlavdishmja ti,* si një lidhje me siguri,* që nga çdo rrezik e mbron* me veprim të hyjshëm;* ky të paluftueshëm nga armiqtë mban atë* që po thërret: Gaz i hijshëm dhe pushtet,* si dhe fuqi për mua është vetëm Biri yt, Zoti[4] Krisht,* Shpëtimtari, i dhembshuri* që për botën e linde ti.

Varg: Shenjtëroi tendën e tij i Shumëlarti.

Mbretërit me besë, o e Tërëpacenshme, si kuror',* rreth të çmuar, me plot gëzim* e veshin pra brezin tënd,* mburren për çuditë,* madhështit' e tua hyjnore; njihen përgjithnjë* të frikshëm fort nga armiqtë që luftojn';* thërrasin duke të lëvduar drejt atij që ke lindur ti* përmbi fjalë: Shpëto çdokënd,* i pushtetshmi Jisu i mir'.

Varg: Vrullet e lumit dëfrejnë qytetin e Perëndisë.

Ngjishna me fuqi,[5] e Virgjër, përmes brezit tënd, na forco* ndaj armiqsh ne, nënshtroji ti* pasionet që na luftojn',* na tiranizojnë,* jepna dhe fitore përmes përmbajtjes përgjithnjë,* të të lëvdojmë me pastërti, besim* si edhe të thërrasim vazhdimisht te Biri yt: O Jisu,* si i dhembshur me plot fuqi,* na shpëto ne të gjithë pra.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. II

Pasi të pastrojmë mendjen dhe arsyen, së bashku me engjëjt le të krem-

tojmë edhe ne panair, duke nisur me ëndje një melodi davidiane për nusen e re të mbretit Krisht, Perëndisë sonë, duke thënë: Ngrihu, o Zot, në prehjen tënde, ti dhe arka e shenjtërimit tënd;[1] sepse si një pallat mbretëror e stolise bukur dhe ia dhe si trashëgim qytetit tënd, o Zot, që të kujdeset për të dhe ta mbrojë nga armiq barbarë, me anën e fuqisë sate të pushtetshme, nëpërmjet përgjërimeve të saj.

Përlëshore
Ting. Tërth. IV

O Hyjlindëse gjithmonë e virgjër, streha e njerëzve, ia dhurove si veshje të fuqishme qytetit tënd rrobën dhe brezin e trupit tënd të pacenuar, të cilat mbeten të paprishura në lindjen tënde të pafarshme; se në ty bëjnë novacion edhe natyra, edhe koha; për këtë të lypim ty, që t'i dhurohet botës paqe, dhe shpirtrave tanë përdëllim i madh.[5a]

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoret
Ting. I Ton tafon su Sotír

Besnikët, ne, himnojm'* brezin tënd të nderuar* të trupit tënd pa cen, e hyjftuar, e Virgjër,* e Tërëshenjtë; nga ky nxjerrim shërim për sëmundje pra* dhe thërrasim tok:* Nëna e Zotit të lart' krejt,* o Mari, ti je* çlirim për sa të nderojnë* me besë dhe mallëngjim.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
Ting. IV Epefanis símeron

Populli yt sot kremton,* e përhimnuar,* Virgjëresh', vendosjen pra* të brezit tënd, thërret me zë* dhe pandërprerë: Gëzohu, ti,* o krenaria e gjith' të krishterëve.

Lavdi *dhe* Tani
I njëjti

Kanunet: të dy të Perëndilindëses dhe Zbritësoret Një kryq vijosi me shkop *(shih. fq. 246), por në kishat e së Tërëshenjtës është e mundur të psalen* Ja gojën e çel tani *(shih fq. 12)*

Ode I
Kanuni i parë, i zotit Kozma
Ting. IV
Irmosi: Thalasis to erithreon

»Formonte* me duar Moisiu kryq, »kështu dhe populli,* i vjetri Izrael,

»me këmbë pra* të palagura Detin e »Kuq*[6] e shkeli, prishi dhe fuqin' e »Amalikut nëpër shkretëtir'.[7]

Pra kisha* e Virgjëreshës Zonj' si qiell i kënaqshëm krejt,* plot dritë gjeti brezin e asaj* si llambadhe shkëlqyese fort,* që s'perëndon, dhe sot veron me llamburitje hiri rruzullin.

Si forcë* dhe lidhje sigurie, dhe pushtet që s'thyet dot,* qyteti yt, o Zonjë, ka vërtet* brezin tënd të shenjt' pra, mendërisht,* dhe, o e tërëpacenuar, po krenohet me gëzim në ty.

Hyjnënë,* vërtet te të mbidheshmit sarkofagu yt u duk* fort më i çmuar se, në lashtësi,* ishte Arka; se s'kishte simbol,*[8] por besërisht i ruante tiparet që ka e vërteta pra.

Në Kishën* e së Dëlirës derdhen miro sot mistikërisht* që nga kutia fort e çmuar pra,* dhe me erë të mir' Shpirti Shenjt* i mbushi tërësisht të gjithë sa me mall po vijnë pranë saj.

Kanuni i dytë që ka Akrostihidhë:
"Më ngjish me fuqinë tënde,
o Virgjëreshë e dëlirë. Josif".
Ting. Tërth. IV
Armatilatin Faraó

Më ngjish me forcë[5] të hyjnueshme tani që po himnoj besërisht* brezin tënd të shenjtë,* ësht' pushtet, fortifikim pa çarje, Vajzë, edhe mur* për qytetin tënd si dhe për grigjën tënde, e virgjër krejt* pa cen, e dëlirë, Hyjlindëse.

Në bark ti kishe Perëndin' e fortë që ngjesh me fuqi çdo besnik;*[5] ndaj të lumërojmë* dhe, kur puthim brezin tënd të hyjshëm me gëzim, hare,* nxjerrim hir dhe mëshirë, e tërëpanjollshme, pa qortim,* pa cen, e dëlirë, Hyjlindëse.

Brezi i hyjshëm pleksi një stoli paprishjeje për ne edhe rrob'* që nuk griset, mantel* që nuk humbet; ndaj le të kërcejmë sot me ngazëllim* në vendosjen e tij, pra të brezit plot me bekim të madh* të Hyjbijës Vajz', të dëlirës nur.

Nën forcën tënde, o e Tërëpaqortueshme, rend populli yt* dhe përik nën strehën* që ti disponon gjithnjë; për tërë ne pra bëhu ndihm',* plotëso dhe kërkesat që për shpëtim bëjmë gjithë ne,* shpirtrat tan' çliroji prej tmerreve.

Ode III
Irmosi: Efrénete epí si

»Dëfrehet në ty,[8a] o Krisht,* dhe të »thërret pra Kisha jote me gaz:* »Streha, përforcimi im* dhe fuqia »ime je ti, o Zot.[8b]

Besnikë, sot ta nderojm',* me bes' t'i falemi pra brezit që kish* e dëlira, sepse ky* përmes prekjes me Perëndin' na lidh.

Na rrjedhin gjithnjë rrëke* që nga kutia jote fare pa cen* dhe vadisin çdo besnik* me karizma, o e Dëlirë nur.

Sot brezi i çmuar fort* i së dëlirës së himnuar me nam,* përmes Hirit po buron* për besnikët mjaft terapi, shëndet.

Si vesë rrjedh në agim,*[9] e pastër, gazi yt; gjithnjë vë në gjum'* furrën e pasioneve* të atyre që të himnojnë ty.

Tjetri: Uranias apsidhos

Zemra ripërtërihet kur prek me besë të zjarrt'* brezin e hyjnueshëm të së Virgjrës, dhe ngjishet mjaft* me forc'[5] që s'mundet në luft'* kundër pasionesh të ndyra* dhe keqdashës pa lëndë, mbetet pa plagë pra.

Brezi yt i hyjnueshëm mbetet ende pa dëm* dhe pa prishje, Vajzë; e ngjeshi trupi yt krejt pa cen,* dhe shenjtëron sa me bes'* i vijnë, edhe nga prishja* i çliron, si dhe nga sëmundjet dhe çdo trishtim.

E Pacen, kishe qenë shtëpi e bukur plot hir* pra për Fjalën e mishëruar që mori trup nga ti;* vet' deshe që mirësisht* në kishën tënde të shenjtë* brezi yt të futej; me puthje jep shenjtërim.

Përqafojmë të gjithë me gaz në zemër, nderim* brezin aq të çmuar që është hir për besnikët mbar',* se preku ky trupin tënd* të përmbiçmuar, o Vajzë* e kulluar ndritshëm, Hyjlindëse plot me hir.

Ndenjësore
Ting. IV O ipsothís en to stavró

O Virgjëreshë e* dëlirë, vendosjen* e shenjtit brez tëndin* kremton Kisha jote* me ngazëllim, dhe pa pushim thërret: Na shpëto* ne të gjithë nga pushtim i keq,* nga armiq, si dhe thyeje* çdo tërbim pra të pabes'* të barbarëve bisha* dhe qeverisna jetën, që të bëjm'* urdhrat, vullnetet* hyjnore të Zotit Krisht.

Lavdi *dhe* Tani

Perëndilindëse,* lumenj me çudira* prej sarkofagut tënd* të gjithënderuar* si prej Edenit dalin; dheun, faqen e tij* e vaditin,[10] duke nxjerrë hir* për besnikët që të nderojn';* ndaj të përhimnojmë ne,* me kushtim ty të mburrim* dhe me hare thërrasim përgjithnjë:* Shpresa e vetme* për sa të himnojn', ki gaz.

Ode IV
Irmosi: Eparthenta se idhusa

»Kisha, kur të pa ty, Diellin e drejt'si-
»së,*[11] që ishe ngritur përmbi Kryq,*
»për hirin e saj pra,* mbeti e çuditur
»në vend;*[12] thërriste siç duhej fort:*
»Lavd fuqisë sate, o Zoti Krisht.

Bërësi dhe Ndërtuesi, pasi të fiksoi si qiell të përmbiçmuar, si me yje të stolisi nur me vezullime[13] të hyjshme, me anën e të cilave hijeson anët e botës, o Perëndilindëse.

Qyteti yt, o Perëndilindëse, duke të pasur ty si forcë dhe mbështetje të sigurt, rrethohet nga brezi yt i hyjnueshëm, të cilin në luftëra e vë para si lidhje të pathyeshme.

O Hyjnënë e thjeshtë, na ngre nga toka drejt qiellit brezi yt i hyjshëm ne që u ndezëm zjarr nga malli për të; prandaj të lavdërojmë si shkakun e lavdisë më të lartë.

O kremtimdashës, ja hir që nuk shteron; ejani të gjithë me zemër të sinqertë, nxirrni rrjedha të hyjnueshme, që burojnë pa kursim nga arkivoli i respektuar i Nënës së tërëdëlirë.

Tjetri: Si mu iskís Kírie

O e Kulluar dhe e Pacenuar, duke u shpërngulur, u ngjite drejt drite të paperënduar, por u le atyre që të lumërojnë, në vend të trupit tënd, brezin e çmuar, që është burim mrekullish, vend shpëtimi dhe fortifikim i këtij qyteti që të nderon.

Futemi si në qiell të ri[14] në shtëpinë tënde, që pasurohet me brezin tënd të hyjshëm porsi me diell dritëdhënës, i cili dërgon rreze çudish dhe i llamburit zemrat e të gjithëve dhe dëbon mjegullën e pasioneve, o Vajzë.

Ti je arka e shenjtërimit[1] mendor, o e Pacenuar e tërëhimnuar; dhe këtë kuti që ka brezin që ti ngjeshe në mes, ia jep popullit tënd si përikje për të gjithë dhe burim të pashtershëm terapish.

I erdhi qytetit tënd si dhuratë e shumëpasur brezi yt i çmuar, o Perëndilindëse e tërëhimnuar, dhe u vendos lavdishëm po në këtë ditë në këtë kishën tënde të hyjshme; dhe u bë ngjarje, festë tepër e madhe për ata që të aspirojnë nxehtësisht.

Hijet e Ligjit[15] dhe enigmat[16] e profetëve të paradeklaronin se do të bëheshe nënë e tërëvërtetë Perëndie, o e Tërëkulluar; nëpërmjet teje mallkimi[17] u sterilizua dhe u lulëzua bekim i përsosur dhe hir shpëtimtar[18] për ata që të himnojnë me besim dhe mallëngjim.

Ode V
Irmosi: Si Kírié mu fos

»Si dritë, Zoti im,* në mbar' botën »ke ardhur ti,*[19] si shndritje e shenj- »të, që nxjerr* nga padija e errët[20] sa »të himnojnë me besim.

Ti, o Zot, e madhërove Nënën tënde, ti e lartësove lavdinë e saj pakrahasueshëm përmbi të gjitha esencat mendore.

O Hyjlindëse e tërëpacenuar, tani Hiri i Perëndisë[21] u dhurohet pa kursim nga arkivoli yt i shenjtë atyre që të falen ty me mall.

Qyteti yt krenohet, o Perëndilindëse, duke të pasur koherencë përmes brezit tënd të shenjtë; mbretërit besnikë të ngjeshin ty si fuqi.[5]

Hiri yt, o e Tërëpacenuar, vërtet u tregua haptazi, duke bërë paradoksalisht fuqi dhe çudi[22] në gjithë dheun.

Tjetri: Ina ti me aposo

Tok me brezin tënd që u vendos sot në shtëpinë tënde, o Hyjhirplote, u vendos dhe çdo dhënie e të mirave[23] për ata që kanë nevojë; dhe çdokush që afrohet, mbushet me shenjtërim, duke marrë besërisht çfarë kërkoi.

U zbukurove, o Virgjëreshë, duke lindur Fjalën tepër të bukur; dhe deshe mirësisht të vendoset në këtë shtëpinë tënde të bukur brezi yt i bukur, i cili ngjeshi bukur trupin tënd të bukur, o Perëndilindëse.

Shtëpia jote e shenjtë u njoh nga të gjithë si një tjetër Parajsë, duke pasur në mes[24] porsi një trëndafil erëmirë brezin tënd, që mbush me aroma hyjnore zemrat e atyre që afrohen besërisht, o e Tërëpaqortuar.

U bëre, o e Tërëpaqortuar, re shiu hyjnor që pikon ujë[25] shpëtimi, dhe që transformon për frytdhënie shpresëtarie tokën që u bë djerr nga krimet; ndaj të lavdërojmë besërisht.

Ode VI
Irmosi: Thiso si metá fonís

»Do flijoj* me zë himnimi,[26] Kisha »thërret te ti,* o Zot, sepse përmes »gjakut,* që nga brinja jote për për- »dëllim rrjedh,* u pastrua* nga çdo »pisllëk prej gjakrash demonësh kjo.

Mbi mendim* të tërën Zoti të lavdëroi ty,* ty vetëm pra krejt të ngriti,* Vajzë, të nderoi të tërën mbi fjal'* tok me kishën* edhe kutinë, brezin, Hyjlindëse.

Po burojn'* nga sarkofagu yt i pacenshëm krejt,* si nga një det, çurka Hiri,* dhe rrethojnë tërë[27] Krijesën përqark;* i vadisin sa Birit tënd i falen me plot besim.

Për fuqi* dhe krenari të kanë besnikët ty,* me lavdin ngjishen, se kanë,* o Hyjnënë, brezin tënd të nderuar,* si stoli pra* të shkëlqyer si edhe të çmuar fort.

Tjetri: Ávisos amartión

Si fëmij' të ri për ne* linde ti të qenin para çdo jete,* dhe zemra që pranuan vjetërsinë e fajeve,* brezi yt i çmuar i ripërtërin me të ren' vendosje,* o Virgjëreshë përgjithnjë, Vajzë.

O Hyjnënë virgjëresh',* e çuditshmja, kisha jote pra është* në drejtësi;[28] ajo ka brezin tënd të çuditshëm fort* dhe buron çudi për besnikët dhe shfaqet si det shërimesh;* ndaj të lëvdojmë me hare në shpirt* ty, e pacen krejt dhe Hyjlindëse.

Çdo shpirt ka gëzim, hare* brenda kishës sate të shenjt', kur merr vesh* edhe sheh brezin tënd në të si diell të hyjshëm pra,* që shndrit llamburitje karizmash nga Shpirti Hyjnor gjith'bërës,* o Zonjë dhe Perëndilindëse.

Zemrat sigurona fort,* se na jan' paralizuar nga çdo lloj* mëkati, dhe me forcë ngjishi[5] sa kanë besërisht* si thesar të çmuar krejt, që s'vidhet[29] kurrfarë, brezin tënd pra,* o e dëlira dhe Hyjlindëse.

Kontaqi
Ting. II Tin en presvies

Perëndilindëse, barkun tënd hyjpranues* e kish rrethuar brezi yt i çmuar, ndaj është'* forcë që s'mposhtet dot për qytetin tënd,* thesar i çdo të mire, që nuk shterohet fare pra,* e vetmja, gjithnjë e virgjra lindëse.

Shtëpia

Cila fjalë nga të vdekshmit do të rrëfejë madhështitë e tua? Cila gjuhë e njerëzve? Sepse as mendje qiellore nuk mundet t'i rrëfejë; por ti që linde detin e pafund të dhembshurisë, pranoji dhe tani këngët prej buzësh të pafrytshme dhe më jep hir të hyjshëm që ta mburr, o Zonjë, brezin tënd, me anën e të cilit bota ngazëllohet duke himnuar së bashku me engjëjt çuditë e tua, o e vetmja, gjithnjë e virgjra lindëse.

Sinaksari

Më 31 të të njëjtit muaj, kujtimi i vendosjes së brezit të çmuar të Hyjlindëses së Përmbishenjtë në kutinë e shenjtë, në shtëpinë e saj të nderuar, e cila është në Halkopratitë, pasi u transferua nga episkopata e Ziles në kohën e mbretit Justinian. Dhe gjithashtu kujtimi i çudisë që u

bë nëpërmjet vendosjes së brezit të çmuar mbi mbretëreshën Zoi, bashkëshorte e mbretit Leon.
Vargje: Porsi kurorë të artë, o Virgjëreshë e thjeshtë,/ e vendos brezin tënd në fund të vitit.
Në tridhjetë e një vunë në kuti brezin e së Tërëdëlirës.

Në të njëjtën ditë, kujtimi i rikonstruksionit të kishës së Perëndilindëses së Përmbishenjtë në Neori.

Me ndërmjetimet e Nënës sate të pacenuar, o Krisht Perëndia ynë, mëshirona. Amin.

Ode VII
Irmosi: En ti kamino avramiei

»Në furrë persiane Djem abraham»ianë, duke u djegur më shumë prej »mallëngjimit të shpresëtarisë sesa »prej flakës, thërrisnin: I bekuar je në »tempullin e lavdisë sate, o Zot.[30]

Ti, o Dritëbërës, duke qenë si i vetmi diell drejtësie,[11] e bëre të kënaqshme hyjnisht kishën e së Thjeshtës nëpërmjet karizmave të larmishme;[31] në të ajo e lartëson brezin e saj dhe i dërgon rrezet e tij.

Duke rrethuar si shtambë të artë[32] sarkofagun tënd, o e vetmja e Dëlirë, tani marrim pjesë vërtet në shijimin hyjnor të hireve dhe e nderojmë atë, sepse është më superior se simbolet, o e tërëbekuar.

Kanat e tua të hyjshme të çudive u burojnë vërtet me bollëk hir besnikëve, dhe nga sorkofagu yt u derdhen me mbushulli atyre që të nderojnë, si lumenj mendorë prej një tjetër Edeni,[27] o e Tërëdëlirë.

Nxit mistikisht sarkofagu i Zonjës: Ejani tani me ngazëllim gjithë sa jeni mbi dhé, ejani, përqafoni brezin e saj të përmbilavdishëm, që mbaj brenda meje si thesar.

Tjetri: Theú sigatávasin

Mbretëresha e të gjithave, duke u nisur për në tenda qiellore, i la si pasuri qytetit mbretëror mbi çdo qytet brezin e saj, me anën e të cilit shpëton nga sulmet e armiqve të dukshëm dhe të padukshëm.

Le t'i afrohemi tani burimit që pikon hir dhe mëshirë, sarkofagut të çmuar që posedon brezin e tërënderuar të nënës dhe Virgjëreshës, që nderoi esencën e njerëzve nëpërmjet lindjes së saj të çmuar.

Të gjitha ju Fuqitë mbiqiellore, himnojeni Zotin[33] si dhe atë që e lindi; të rë gjuhët e njerëzve, lavdërojeni këtë, sepse ua dhuroi besimtarëve brezin e saj si përikje të vërtetë dhe shpëtim.

Le të pikojnë sot nga lart re drejtësie[34] me rastin e vendosjes së brezit tënd, o re[35] Hyjhirplote, dhe le të këndojë çdo shpirt me ngazëllim: I bekuar është Perëndia i etërve tanë.[36]

Ode VIII
Irmosi: Hiras ekpetasas

»Duke* ngritur duart, Danieli mby»lli gojët e luanëve në grop';*[37] dhe »shuan forcën e zjarrit krejt,*[38] kur u »ngjeshën me virtyt Djemtë,* pra »miqtë e shpresëtaris',* tok duke »thirrur me gaz: Bekoni,* ju gjithë »veprat e Zotit, pra Zotin ton'.[39]

O Zonjë e tërëkulluar dhe e pacenuar, qëmoti një arkë mbante pllaka[40] hyjnore që u shkruan prej dore Perëndie,[41] ndërsa sarkofagu yt i nderuar dhe i çmuar ka brezin që vetë ligjvënësin e përmbante në ty. Misteri është i frikshëm!

O Zonjë e tërëpacenuar dhe e qashtër, engjëj tani kërcejnë bashkë në kishën tënde të nderuar, dhe kujdesen për brezin tënd të çmuar dhe të shenjtë; ne, duke iu falur me mall, hare dhe shumë ngazëllim, të përhimnojmë ty, lavdinë e gjinisë sonë.

O e pacenuar, ti je shkopi që nxori lulen[42] e jetës, gëzimi i të gjithëve, kutia e shumëçmuar e Shpirtit, thesari i të mirave, burimi i aromave nga i cili sarkofagu i hyjshëm gufon mirot e shërimeve.

Ushtritë mendore himnojnë madhështitë e tua, o e Dëlirë e tërëpacenuar; i shpallin fuqishëm të gjithë patriarkët, profetët, kori i apostujve, tërësia e martirëve dhe mbarë turma e oshënarëve; tok me ta dhe ne me besim të falemi dhe të lavdërojmë ty.

Tjetri: Eptaplasios káminon

Sarkofagu si fron i shenjtë[43] dedikohet tepër hijshëm brenda të të pashkelurave të hyjnueshme, sepse në të prehet brezi i hyjbijës së vetme dhe mbretëreshës së kulluar të të gjithëve; nga ai del pa kursim prehje e përsosur për të munduarit në mëkate të shumta.

Mbi tokë e trupëzove hyjshëm Zotin dhe me duar të shenjta e ngjeshe vërtet atë që ngjesh me fuqi[5] besimtarët; dhe tani që u ngjite në qiej, u le njerëzve brezin tënd të çmuar si përforcim dhe strehë, o Perëndilindëse e virgjër.

Me të vërtetë, o Virgjëreshë e kulluar, hiri që shoqëron brezin tënd të çmuar është shërim për të sëmurët, mbështetje për ata që rrëshqasin, rigjallëri e perëndishme për përtacët,

kapiten për ata që lundrojnë dhe kthim për të humburit; atij i falemi besërisht në gjithë jetët.

Sot ne shërbëtorët e tu bëjmë panair të shenjtë, duke kryer vendosjen e hyjshme të brezit tënd të hyjshëm; dhe me gëzim të thërrasim: Gëzohu, o Perëndilindëse, hareja e engjëjve dhe e të gjithë njerëzve që këndojnë besërisht: O popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Ode IX
Irmosi: Lithos ahirótmitos orus

»Si një gur i prerë pa dorë nga mali »yt i palatuar,* Virgjëresh', u pre por»si gur[44] qosheje,* [45] pra Krishti, i cili i »bashkoi* natyrat krejt të kundërta;[46] »ndaj me gëzim të madhështojmë ty.

Sarkofagu yt, o Hyjnënë, u duk si dhomë mjaft e vlefshme,* se ka brezin tënd fort të çmuar; porsi* stoli virgjërore, nusërore* e ka, dhe denjësisht e mban* ky si thesar për jetën përgjithnjë.

O Perëndilindëse, Kisha rreth kokës vuri si kurorë* krejt të bukur[47] brezin tënd tepër të shenjt',* të hyjshëm sot; dhe si mbretëreshë* dëfren, dhe përmes lavdit tënd* na zbukurohet dhe stoliset nur.

Sot në kishën e Virgjëreshës që imiton mbarë sistemin* qiellor, të bukur, besnikë, erdhëm* dhe shndritëm me hir nga llamburitjet* e dhurëtive që shkëlqejn'* si yje lart me hijeshi[13] dhe lavd.

Lidhje, paqe, mur pra qyteti yt e ka brezin tënd të shenjtë* dhe bashkim të hyjshëm, grupim dogmash ky* dhe mburrje për mbarë orthodhoksët,* triumf, trofe për mbretërit,* o e kulluar dhe Hyjnënë ti.

Hirin tënd që s'imagjinohet dhe lavdin tënd që nuk rrëfehet* i himnojmë, se je burim me urti,*[48] nga vjen fjala, o e pacenuar,* për gjithë sa e madhërojn'* Birin tënd edhe të nderojnë ty.

Tjetri: Eksesti epí tuto o uranós

Ja shtrati aq i hyjshëm solomonik,* e rrethojn' gjashtëdhjetë të fortë pra siç Shkrimi tha;*[49] shtrin sot si në shtrat mbretëror me lavd,* në sarkofag të çmuar krejt* brezin e saj Zonja për rinovim,* rithirrjen e secilit* dhe mirëqenien, jetën* për besëmirët e përulur keq.

Ti si qytet për mbretin e qiejve,* për të cilin u than'[50] të çuditshme, ke vënë porsi* një dhurim të çmuar, me nder hyjnor* pra brezin tënd të shenjtë

krejt* në qytetin tënd për fuqi dhe lavd* të çdo besniku, që k'të* e ka kurorë, shndrit fort* orthodhoksisht dhe mposht armiqtë tmerr.

Tani pikoni, ju male, ëmbëlsi;* kodra ju,[51] ngazëllim të përjetshëm; edhe bashkësi* patriarkësh, kore martirike* të tëra, grup profetësh tok,* kolektiv apostujsh hyjnor' plot nder,* me gjithë ne dëfreni* në rastin e vendosjes* së të fortshenjtit brez të Hyjbijës.

E shenjtërove çdo gjë me shtatzënin',* Virgjëreshë e Tërëshenjt', dhe na dhe për dritësim* më të madh tani brezin tënd që ka* plot shenjtërim, ndaj toka krejt* ka gaz në vendosjen e tij, kërcen,* të mburr ty që njeriun* e mbush me ngazëllimin* që nuk rrëfehet dhe nuk shprehet dot.

E dhembshur je, çliromë shpejt, e Dëlir',* mua që drejt mëshirës që ke, po përik nga miqësi* djallëzore vesesh, nga një armik* që nget përditë, gjithashtu* nga ngarkesa plot dhimbje, përtaci,* që fajet kanë sjellë,* dhe robëri të tmerrshme* e skllavëri, plaçkitje e mjerim.

Dërgimësore
Jineqes akutíshtite

Ai që kreu të tuat* të tëra përmbi mendje krejt,* rrobën dhe brezin i bëri* pa prishje me nder të plotë,* edhe i dha si përforcim,* sigurim te qyteti yt:* po bëjm' me mall, gaz panair* pra në vendosjen e tyre,* o Zonjë e pacenuar.

Tjetër E ngjashme

Ti, Zonjë e krijesave* të gjitha, plot me urtësi* të përmbindritshme, vërtet je;* si nënë e Perëndisë* së plotfuqishëm[52] mbushmë pra* dhe me dije hyjnore, hir* edhe shkëlqim, se himnin tënd* e përfundova, e pastra* dhe e dëlira Hyjlind'se.

Lavdërime
Ting. IV Os jeneon en mártisin

Si kurorë që përmbishndrit,* o Hyjlindëse krejt pa cen,* brezin tënd të shenjtë e veshi me gëzim* Kisha edhe hijeshohet sot, kërcen, Zonjë, mistikisht,* të thërret: Gëzohu pra,* rreth, kurorë hyjnore je,* vetëm ti je lavd* dhe hare e përjetshme,[53] ndaj shijim për tërësinë time të kam; gëzohu, o ndërmjetimi im.

(2x)

Meqë je, Zonjë krejt pa cen,* mur rrethues që s'çahet dot* dhe shpëtim, mbështetje e fortë për të gjith',* pra për qytetin dhe popullin tënd, brezin tënd plot me nder* e ke dhënë porsi rrob'* të kënaqshme, dhe ky çliron*

nga fatkeqësi* të llojllojshme ata që me besim, gatishmëri të flaktë vijnë dhe e nderojnë, Hyjnuse Vajz'.

U tregua, e Pacen krejt,* kisha jote sot si burim* i pashtershëm, tërë çudi, meqë lumenj* hiri na derdhen nga sarkofagu plot shenjtërim pa fund,* dhe dëfrejnë thellësisht* mendjen pra të besnikëve* që me mallëngjim* dhe me besë thërrasin: Ti je jeta jonë, gazi dhe hareja, e Tërëshenjta Hyjlindëse.

Lavdi *dhe* Tani
Ting. II

Si një kurorë të përmbishkëlqyeshme, o Hyjlindëse, Zonjë e tërëpacenuar, rrobën tënde të shenjtë e veshi Kisha e Perëndisë,[2] dhe ngazëllohet me hijeshi sot, dhe kërcen mistikisht, duke të thirrur: Gëzohu, o rreth i çmuar dhe kurorë e lavdisë[3] së tij hyjnore; gëzohu, lavdia e vetme e tërësisë, dhe hareja e amshuar; gëzohu, limani dhe mbrojtja e atyre që rendin te ti, dhe shpëtimi ynë.

Dhoksologjia e Madhe.

*Në Liturgji Tipiket dhe nga Kanuni i parë Ode III dhe i dyti Ode VI. Kontaqi i sotëm (*Perëndilindëse, barkun tënd hyjpranues*). Kungatore* Kupë shpëtimi.

CITIME

[1] II Kron. 6.41; Ps. 131(132).8
[2] I Kor. 1.2 etj.
[3] I Petr. 5.4
[4] Ps. 17(18).3; 70(71).3
[5] I Mbret. [Sam.] 2.4; Ps. 17(18).33,40
[5a] Num. 14.19 etj.
[6] Eks. 14.29
[7] Eks. 17.8-13
[8] Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; II Kron. 6.41; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
[8a] Est. 4.17ff
[8b] Ps. 17(18).2
[9] Urt. Sol. 11.22; Osia 6.4; 13.3
[10] Gjen. 2.6-8
[11] Mal. 4.2(3.20)
[12] Abak. 3.11
[13] Sirak 43.9
[14] II Petr. 3.13
[15] Kol. 2.17; Hebr. 8.5; 10.1
[16] Fjala Urta 1.6
[17] Gjen. 3.16-20
[18] Tit. 2.11
[19] Joan 3.19; 12.46
[20] Vepr. 26.18
[21] Vepr. 13.43 etj.
[22] Rom. 15.19
[23] Jak. 1.17
[24] Gjen. 2.9
[25] Jud. 5.4
[26] Jona 2.10
[27] Gjen. 2.11
[28] Ps. 64(65).5-6
[29] Urt. Sol. 7.14
[30] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 30
[31] I Petr. 4.10
[32] Eks. 16.33; Hebr. 9.4
[33] Ps. 148.1-2
[34] Is. 45.8
[35] Is. 19.1

[36] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 3.28
[37] Dan. 6.18
[38] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 26
[39] Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
[40] Ligji i Dytë 10.2; Hebr. 9.4
[41] Eks. 31.18
[42] Num. 17.23; Is. 11.1
[43] Ps. 46(47).9
[44] Dan. 2.34-35
[45] Is. 28.16; Ps. 117(118).22; Ef. 2.20; I Petr. 2.6
[46] Rom. 5.10-11; II Kor. 5.18-19; Ef. 2.17-18
[47] Urt. Sol. 5.16
[48] Baruh 3.12
[49] Kënga 3.7
[50] Ps. 86(87).3
[51] Amos 9.13; Joel 3(4).18
[52] II Mbret. [Sam.] 7.25 etj.
[53] Is. 35.10; 51.11; 61.7

Përmbajtja

MUAJI KORRIK

1 Korrik
Kujtimi i anargjendëve të shenjtë e çudibërës Kozma dhe Damian,
që u martirizuan në Romë 3

2 Korrik
Kujtimi i vendosjes së Rrobës së çmuar të Perëndilindëses së Tërëshenjtë
në Vllahernë 24

5 Korrik
Kujtimi i atit tonë oshënar Athanas Athoniti dhe i atit tonë oshënar
Llambadh Çudibërësi 38

7 Korrik
Kujtimi i shën Thomait në Maleó dhe i martires së shenjtë Kiriakia 57

8 Korrik
Kujtimi i martirit të madh e të shenjtë Prokop 69

10 Korrik
Kujtimi i neomartirit të shenjtë dhe të lavdëruar Nikodhimi në Berat 80

11 Korrik
Kujtimi i martires së madhe Efimia e tërëfamshme dhe
i Olgës, mbretëreshë e shenjtë dhe e barabartë me apostujt 100

13 Korrik
Të dielën pas datës 12 korrik (13-19)
Kujtimi i Etërve të Shenjtë të Sinodit IV Ekumenik 121

17 Korrik
Kujtimi i martires së madhe e të shenjtë Marina 136

20 Korrik
Kujtimi i profetit të shenjtë e të lavdëruar Ilia thesviti 152

22 Korrik
Kujtimi i miroprurëses së shenjtë dhe të barabartë me apostujt
Maria Magdalena 173

24 Korrik
Kujtimi i martires së madhe e të shenjtë Kristina 182

25 Korrik
Kujtimi i fjetjes së shën Anës, nëna e Perëndilindëses së Tërëshenjtë 192

26 Korrik
Kujtimi i hieromartirit të shenjtë Hermolau dhe i atyre që ishin me të,
Hermipi dhe Hermokrati, si dhe i martires oshënare Parashqevia 205

27 Korrik
Kujtimi i martirit të madh e të shenjtë Pandelejmon shëruesi 221

MUAJI GUSHT

1 Gusht
Dalja e Kryqit të Çmuar, kujtimi i Shtatë Djemve të shenjtë Makkabenj,
i mësuesit të tyre Eleazar dhe i nënës së tyre Solomona, si dhe kujtimi i
Elesës, i martires së shenjtë 240

2 Gusht
Kujtimi i Transferimit të lipsanit të shën Stefanit, kryedhjak dhe
martir i parë 264

6 Gusht
Metamorfoza e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht 275

E Diela pas Metamorfozës 294

8 Gusht
Kujtimi i atit tonë ndër shenjtorë Emiliani, episkop i Kizikit 295

15 Gusht
Kujtimi i Fjetjes së Zonjës sonë të Tërëshenjtë
Perëndilindëse dhe të gjithmonëvirgjër Maria 306

24 Gusht
Kujtimi i hieromartirit të shenjtë e të lavdëruar Kozma,
i barabartë me apostujt 325

26 Gusht
Kujtimi i martirit të shenjtë Adrian dhe
i bashkëshortes së tij Natalia 341

29 Gusht
Prerja e kokës së çmuar të profetit të shenjtë e të lavdëruar,
Pararendësit dhe Pagëzorit Joan 351

30 Gusht
Kujtimi i patriarkëve të shenjtë të Konstandinopojës
Aleksandri, Joani dhe Pavli i Ri 371

31 Gusht
Kujtimi i Vendosjes së Brezit të çmuar të Perëndilindëses
së Përmbishenjtë 384